

JETA E SAHABËVE

JETA E SAHABËVE



2

Muhamed Jusuf KANDEHLEUI



Titulli i librit

Jeta e Sahabëve (variant i shkurtuar)

Titulli i origjinalit

Hajatu's-Sahabe

Autor

Muhamed Jusuf Kandehleui

Përktheu

Silvester Manaj

Redaktoi

Andrin Rasha

Mehmet Disha

Detin Kotrri

Korrekttoi

Dorian Demetja

Kopertina & Grafika

Indrit Isufi

ISBN 978-9928-194-86-2

©KMSH - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Tiranë, 2021

SAHABËT JAPIN NGA PASURIA E TYRE NË RRUGËN E ALLAHUT



Si e dhanë, Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) dhe sahabët e tij pasurinë e tyre në rrugën e Allahut, vetëm e vetëm për të fituar pëlqimin dhe kënaqësinë e Tij (xh.sh)? Si u bë dhënia e gjithë pasurisë së tyre në rrugën e Allahut më e dashur edhe sesa shpenzimi i saj për ndonjë dëshirë të vetën? Megjithëse kishin shumë nevoja edhe vetë, si arritën ata të zgjidhnin dhe parapëlqenin të tjerët përpara vetes?

1. I DËRGUARI I ALLAHUT I NXIT SAHABËT E TIJ TË JAPIN PREJ PASURISË SË TYRE DHE SAHABËT I PËRGJIGJEN GJITHË DËSHIRË

**I Dërguari i Allahu i nxit besimtarët të japin
prej pasurisë së tyre në rrugën e Allahut**

Tregon Xheriri (radijallahu anhu): “Në orët e para të agimit, tek i Dërguari i Allahut erdhi një grup njerëzish nga Mudari, të cilët ishin këmbëzbathur, të veshur me një copë mbi trup dhe me shpata të veshura në mill. I Dërguari i Allahut u prek jashtë mase kur pa se sa të varfër ishin ata njerëz, aq sa i ndryshoi fare edhe ngjyra në fytyrë. Hyri brenda, pastaj doli dhe i urdhëroi Bilalit që të këndonte ezanin.

Dhe Bilali atë bëri, këndoi ezanin dhe thirri ikametin. Profeti ynë u fali namazin besimtarëve dhe u drejtua nga njerëzit dhe filloi të këndojë këto ajete:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.” (Nisa, 4/1) **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!”** (Hashr, 59/18)

Pastaj Profeti ynë tha:

- *“Kushdo, sipas mundësive që ka; dinarë, dërbemë, tesha, grurë, hurma, madje edhe gjysmë hurmash, të japë nga ato që ka për vete!”* Një burrë nga Ensarët erdhi me një rrobë me para, ndërsa në dorën tjetër kishte hurmat, të cilat dukej që me zor i mbante. Pastaj, me radhë, erdhën edhe të tjerët të sillnin diçka nga të tyret. Ushqimet dhe veshjet që sollën ata formuan dy dengje të mëdha. Teksa shikonte se çfarë po bënë në moment sahabët, fytyra e të Dërguarit të Allahut shkëlqente nga gëzimi. Në fund, Profeti ynë i nderuar tha këto fjalë:

- *“Kushdo që hap një rrugë të re të të bërit mirë në Islam, jo vetëm që do të marrë shpërblimin e asaj që ka bërë e ka punuar vetë, por do të marrë edhe po aq shpërblime sa ç’do të marrin të gjithë ata që do të vazhdojnë ta bëjnë edhe në të ardhmen atë të mirë. Askujt nuk do t’i pakësohet asfare prej shpërblimit të merituar. Dhe, kushdo që hap një rrugë të re të të bërit keq në Islam, ta dijë se ai nuk do të marrë vetëm mëkatet e veta, por bashkë me to atij do t’i ngarkohen edhe të gjitha mëkatet e atyre që do ta përsërisin edhe në të ardhmen atë të keqe. Po ashtu askujt nuk do t’i pakësohet asnjë prej mëkateve që i ka shtyrë të tjerët në mëkatet e tyre.”¹*

Interesimi i skajshëm i të Dërguarit Fisnik dhe i sahabëve të tij për të dhënë nga pasuria e tyre

Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Tek i Dërguari i Allahut

¹. Muslim, *Sahih*, 2/704 (1017).

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi një burrë dhe diç i kërkoi që t'i jepte. Profeti ynë i tha atij:

- *“Nuk kam asgjë me vete se çfarë të të jap; por ti shko dhe kërkoji dikujt në emrin tim dhe unë do t'ia paguaj atij kur të kem.”* Omeri (radijallahu anhu) nuk duroi dot dhe u hodh e tha:

- *“O Resulullah! Ti jep çdo gjë që ke me vete; askush nuk thotë dot të kundërtën për këtë dhe nuk i thua askujt që ‘nuk kam’. Mirëpo, Allahu ty nuk të ka ngarkuar me përgjegjësinë që të japësh edhe atë që nuk e ke!”* Profetit tonë nuk i pëlqyen këto fjalë që dolën nga goja e Omerit (radijallahu anhu). Në atë çast njëri prej Ensarëve tha:

- *“Jep nga plaçka jote, o Resulullah! Mos u shqetëso, se Allahu i Madhërishëm nuk t'i pakëson mirësitë që Ai të ka falur!”*

Profetit tonë i pëlqeu dhe e gëzoi shumë kjo fjalë e atij burri, ndaj duke buzëqeshur tha:

- *“Ja, me këtë më ka urdhëruar mua Allahu i Madhërishëm.”*²

I Dërguari i Allahut e urdhëron Bilalin (r.a.) që të ndajë nga e tija në rrugën e Allahut

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) tregon se: “Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati ardhur te Bilali (radijallahu anhu). Aty, në shtëpinë e Bilalit, sytë i zunë një sasi të madhe hurmash.

- *“Çjanë këto kështu, o Bilal?”, – e pyeti ai Bilalin. Bilali iu përgjigj duke i thënë:*

- *“I mbaj gati, që të gostit mysafirët e tu, o i Dërguari i Allahut!”* Atëherë, Profeti ynë iu drejtua atij me fjalët:

- *“Po ti, o Bilal, nuk ke frikë nga të përgatiturit e zjarrit të Xhebenemit për veten? Ndajua këto të tjerëve, o Bilal! Dhe mos ke frikë e mos u shqetëso se mos Allahu t'i pakëson ato?”*³

². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/56.

³. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/149.

Një ngjarje që ka ndodhur mes Omerit (r.a.) dhe Aliut (r.a.), në kohën që mes myslimanëve po ndahej plaçka e luftës

E tregon Talha bin Ubejdullahu (radijallahu anhu): “Plaçkën e luftës e sollën tek Omeri (radijallahu anhu). Dhe ai ua ndau atë myslimanëve mes tyre. Mirëpo, një pjesë teproi, kështu që Omeri (radijallahu anhu) filloi të pyeste se çfarë do të bënte me atë që kishte tepruar. Ndërkaq, bashkësia e njerëzve që ishin të pranishëm i thanë atij:

- “Po, përdore sipas nevojave që mund të dalin në vijim.” Aty ishte i pranishëm edhe Aliu (radijallahu anhu), mirëpo ai po qëndronte i heshtur, e nuk po e shprehte mendimin e tij. Omeri (radijallahu anhu) u kthye nga Aliu (radijallahu anhu) dhe i tha:

- “O Ebu’l-Hasen! Po ti pse rri i heshtur e nuk flet asnjë fjalë?” Aliu (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- “Njerëzit e thanë atë që ishte për t’u thënë, ç’të them unë.” Mirëpo, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti me këmbëngulje:

- “Jo, duhet të flasësh edhe ti!” Sakaq, Aliu (radijallahu anhu) tha njëherë:

- “Allahu i Madhërishëm na e ka shprehur fare mirë se si duhet të ndahet kjo plaçkë.”, – pastaj filloi të tregojë historinë e plaçkës dhe pasurisë që myslimanët kishin arritur të fitonin në Bahrejn.

- “Nga Bahrejni pati ardhur plaçka e luftës, vetëm se ra muzgu dhe i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk e ndau dot gjithë atë plaçkë. Atë natë e kaloi të tërën në xhami, duke falur namaz. Në fytyrë i dallohej qartë që nuk ishte aspak i qetë, por, përkundrazi, ishte shumë i shqetësuar. Vetëm kur arriti që ta ndante të tërë atë plaçkë sikur i hyri pak qetësi në shpirt.”

Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) u kthye nga Aliu (radijallahu anhu) dhe i tha atij:

- “Atëherë, këtë që ka mbetur duhet ta ndash ti medoemos, nuk ke aspak se nga t’ia mbash!”

Talhaja (radijallahu anhu) thotë se: “Aliu (radijallahu anhu) e ndau atë pjesë të mbetur të pandarë nga plaçka e luftës dhe mua më takuan tetëqind dërhëm.”⁴

⁴. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 10/414 (17754).

Një transmetim i Umu Selemes lidhur me dhënien nga ajo që është e jotja

Tregon vetë Umu Selemeja: “Tek unë pati ardhur i Dërguari i Allahut. Fytyrën e kishte tejet të zbehtë. U shqetësova mos i dhimbte ndonjë pjesë e trupit dhe i thashë:

- “Çfarë keni, o Resulullah, keni ndonjë gjë, qenkeni shumë i zbehtë!”

- “*Jam shumë i shqetësuar për ata shtatë dinarët që na sollën mbrëmë. E kaluam natën pranë atyre parave, ndaj jam i brengosur.*”, – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

Sipas një transmetimi tjetër, është ruajtur me kujdes se ai thotë:

- “*Na erdhën këto para, por ende nuk ia kemi dhënë ndokujt që është në nevojë.*”⁵

Një ngjarje e ndodhur mes Osmanit (r.a.) dhe dikujt tjetër

Tregon Hasan Basriu: “Dikush erdhi tek Osmani (radijallahu anhu) dhe na tha:

- “O ju të pasur, ju po i rrëmbeni të gjitha shpërblimet e Allahut! U jepni lëmoshë njerëzve në nevojë, lironi skllëvër, keni mundësi ta vizitoni Qaben sa herë që të dëshironi dhe prapë keni edhe për të dhënë nga pasuria juaj në rrugën e Allahut...” Osmani (radijallahu anhu) tha:

- “Pra, ju na lakmoni, apo jo?”

- “Po, ne ju shohim me lakmi ju, kjo është e vërtetë.”, – u përgjigj ai njeri. Atëherë, Osmani (radijallahu anhu) tha:

- “Uallahi, një dërrhem i dhënë nga një njeri i skamur, i cili jeton vetë në kushte të vështira është shumë herë më e mirë se sa dhjetëmijë dërrhemë që i jep nga pasuria e vet një njeri shumë i kamur e që jeton në mes të gjithë të mirave!”⁶

⁵. Hejthemi, *Mexhmu'ü-Zeuaid*, 10/414 (17752).

⁶. Bejheki, *Şhuabu'l-Iman*, 3/251 (3456).

Një bisedë e Aliut (r.a.) me një lypës

Transmeton Ubejdullah bin Muhamedi: “Në derën e Prijësit të Besimtarëve, Aliut (radijallahu anhu) trokiti një lypës. Aliu (radijallahu anhu) i thirri menjëherë Hasanit a Husejnit, duke i thënë:

- “Shko te mamaja, i pata lënë gjashtë dërhëmë, kërkoja njërin prej tyre dhe eja me vrap!” Hasani a Husejni shkoi dhe u kthye menjëherë dhe i tha:

- “Mamaja thotë se ato gjashtë dërhëmë i ka ndarë veçantë për të blerë miell.” Atëherë, Aliu (radijallahu anhu) i dërgoi asaj fjalë se:

- “Nëse një besimtari shpenzimi i diçkaje në rrugën e Allahut nuk i bëhet më e dashur sesa mbajtja e saj në dorën e tij, kjo do të thotë se besimi i tij është ende i mangët!”, – duke i kërkuar që t’ia dërgonte me djalin të gjashtë dërhëmët. Një t’i dërguar Fatimja (radijallahu anha) ata gjashtë dërhëmë, Aliu (radijallahu anhu) të gjitha sa ishin ia dha menjëherë të gjitha atij lypësi të varfër. Ende pa u larguar mirë që aty ai njeri nevojtar, aty erdhi një burrë që donte të shiste devenë e tij dhe Aliu (radijallahu anhu) e pyeti për çmimin, sa e shiste atë.

- “Njëqind e dyzet dërhëmë”, - iu përgjigj ai.

- “Ma jep mua këtë deve dhe t’i jap më vonë paratë.”, – i tha Aliu (radijallahu anhu) atij. Nuk kaloi shumë dhe aty erdhi dikush tjetër dhe pyeti:

- “E kujt është kjo deve?”

- “E imja.”, – u përgjigj Aliu (radijallahu anhu).

- “A nuk ma shet mua?”, – e pyeti ai.

- “Po, ta shes.”, – ia priti Aliu (radijallahu anhu).

- “Me sa e shet?”

- “Dyqind dërhëmë.”

Ai burrë e pranoi çmimin, i pagoi dyqind dërhëmët dhe u largua. Aliu (radijallahu anhu) i dha njëqind e dyzet dërhëmët njeriut, të cilit ia pati blerë devenë, ndërsa gjashtëdhjetë dërhëmët e mbetur ia çoi Fatimes (radijallahu anha). Kur i pa dirhemët, ajo e pyeti Aliun (radijallahu anhu):

- “Po këto ç’janë? Aty, Aliu i nderuar (radijallahu anhu) iu përgjigj shoqes së tij të jetës duke i kënduar një ajet nga Kur’ani Famëlartë, në të cilin thuhet: **“Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t’i bëhet kurrfarë padrejtësie.”** (En’am, 6/160)⁷

Bujaria e Aishes (r.a.) dhe motrës së saj Esmasë

Abdullah bin Zubejri (radijallahu anhu) tregon: “Aishja dhe motra e saj Esmaja (radijallahu anhumā) kanë qenë gratë më bujare që kam parë ndonjëherë. Bujaria e tyre ishte e ndryshme. Aishja (radijallahu anha) mbledhte pak e nga pak dhe kur bëheshin shumë, ua ndante ato të varfërve dhe njerëzve në nevojë. Kurse Esmaja nuk mendonte fare për të nesërmen, nuk linte asgjë për të, por e ndante menjëherë gjithçka me të tjerët që kishin nevojë.”⁸

2. DHËNIA NË RRUGËN E ALLAHUT EDHE E GJËRAVE MË TË ÇMUARA E MË TË DASHURA

Një transmetim lidhur me Ibni Omerin, i cili liron shërbëtoren e tij

Tregon ibni Omeri: “Kur dëgjova ajetin: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni më së shumti. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.”** (Al ‘Imran, 3/92) - në mendje më erdhën një e nga një gjithë të mirat që më kishte falur Allahu: asgjë nuk m’u duk më e dashur se sa shërbëtorja me origjinë bizantine, Merxhaneja dhe thashë:

- “Për hir të Allahut, Merxhaneja këtej e tutje është e lirë.” – dhe e lirova. Po të ishte e drejtë që më vonë ta merrje prapë mbrapsht atë që e ke dhënë në rrugën e Allahut, do të isha martuar me atë shërbëtores.”

Ndërsa, në përcjelljen që i bën Hakimi kësaj ngjarjeje, gjendet edhe një e dhënë më shumë: “Ibni Omeri e martoi atë robinjë, të cilën e

⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/887 (16976).

⁸. Buhari, *Ebedu’l-Mufred*, 1/106 (280).

liroi, me Nafiun, madje ajo pati edhe fëmijë me Nafiun.”⁹

Nafiu thotë: “Pashë Ibni Omerin. Kishte marrë fëmijën në krahë dhe po e puthte. ‘Sa shumë që i ngjan së ëmës!’, – thoshte.”¹⁰

Një transmetim nga Nafiu në lidhje me bamirësinë e Ibni Omerit

Tregon Nafiu: “Ibni Omeri, çdo gjë që niste ta donte me tepri, e jepte menjëherë në rrugën e Allahut dhe për hir të Tij. Madje, njëherë, një prej skllëvërve të tij, që e kishte kuptuar mirë gjendjen e Ibni Omerit, përveshi mëngët dhe filloi të falte namazin së bashku me xhematin. Kësisoj, Ibni Omeri, kur vërejti sjelljen e bukur të skllavit të tij, e liroi atë menjëherë. Shokët filluan t’i thoshin:

- “Ebu Abdurrahman! Po të mashtrojnë skllëvërit.” Mirëpo ai u përgjigjej gjithmonë: - “Ne gënjehemi me dëshirë, mjaft që dikush të na mashtrojë për hir të Allahut.”¹¹

Ebu Talhaja jep kopshtin e hurmave që e donte jashtëzakonisht shumë

Enesi (radijallahu anhu) na tregon: “Ebu Talhaja ishte një ndër ensarët që kishte më shumë kopshte hurmash nga të gjithë. Ndër ato kopshte, ai që donte më së shumti ishte ai i quajtur “Bejruha”. Ai kopsht gjendej mu përballë faltores dhe ndonjëherë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) shkonte atje dhe pinte prej ujit të tij. Kur u zbrit ajeti: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni më së shumti. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.”** (Al ‘Imran, 3/92) - Ebu Talhaja shkoi menjëherë pranë Profetit të profetëve (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i tha:

- “O Resulullah! Allahu i Madhërishëm na tha se ‘për sa kohë që nuk japim prej asaj që duam më së shumti, ne nuk e kemi arritur mirësinë e vërtetë.’ Nga e gjithë pasuria që kam ajo që dua më shumë është ‘Bejruhaja’. Ndaj, dua që ta jap atë për hir të Allahut. Dashtë Zoti e ma

⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/889 (17022).

¹⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/167.

¹¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/294.

pranon këtë vepër e mbetet i kënaqur prej meje. O Resulullah! Merre atë kopsht dhe përdore aty ku do të të urdhërojë Allahu!” I Dërguari i Allahut e përgëzoi atë me fjalët:

- “*Ç’tregti fitimprurëse! Ç’tregti fitimprurëse!*”

Në një transmetim tjetër, i Dërguari i Allahut i thotë kështu Ebu Talhasë:

- “*I dëgjova të gjitha sa më the. Unë jam i mendimit që ti t’ua ndash të afërmve të tu atë pasuri.*” - Ebu Talhaja e dëgjoi dhe iu përgjigj:

- “Në rregull, si të thuash ti, ashtu të bëhet.”, – dhe, sakaq, ua ndau atë kopsht hurmash kushërinjve dhe djemve të xhaxhallarëve të tij.¹²

Ebu Dherri (r.a.) jep devenë e tij më të dashur

Këtë ndodhi e tregon vetë Ebu Dherri (radijallahu anhu): “Në një pasuri janë gjithmonë tre ortakë: i pari, është kaderi. Kaderi; nuk i dihet, ti vdes ose ajo shkon dëm, dhe nuk të pyet ty, nëse do të shkojë për mirë apo do të shkojë për keq puna e asaj pasurie. Me një fjalë, ti nuk e di, nëse ajo pasuri do të të sjellë mirë, apo do të të sjellë keq. Ortaku i dytë janë trashëgimtarët e tu. Ai/ata që janë trashëgimtarë të pasurisë sate, mezi presin që ti të vdesësh dhe pasurinë ta gëzojnë ata. Nëse ke mundësi dhe ke ende fuqi, ti mos u bëj i treti, që është më i dobët se dy të parët, sepse Zoti na thotë: “**Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni më së shumti.**” (Al Imran, 3/92). Shiko, ajo deveja atje ishte gjëja më e dashur që kam, ndaj unë po e jap atë menjëherë në rrugën e Allahut.”¹³

3. KUR NDAN DHE JEP NGA E VETA EDHE VETË NEVOJTARI

Lidhja e fortë e Abdurrahman bin Aufit
me të dhënë në rrugën e Allahut

Tregojnë Ebu Selemeja me Ebu Hurejren: “I Dërguari i Allahut

¹². Buhari, *Sahih*, 2/530 (1392).

¹³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/163.

tha: *‘Jepni lëmoshë në rrugën e Allahut, sepse unë do të dërgoj ushtrinë në luftë.’* Abdurrahman bin Aufi, një të dëgjuar fjalët e të Dërguarit të Allahut, erdhi menjëherë dhe i tha:

- “O Resulullah, unë kam këto katërmijë dërhemë. Dymijë po i jap për hir të Allahut; kurse dymijtë e tjera po i lë për familjen dhe fëmijët.”

- “*Zoti u dhëntë begati, si atyre që dhe, si atyre që nuk i dhe dot e i mbajte.*”, – u lut Profeti ynë për të.

Në të gdhirë të asaj dite, erdhi një burrë nga ensarët dhe atë natë kishte fituar dy kilogramë hurma. I tha të Dërguarit të Allahut:

- “O Resulullah, unë punova dhe në këmbim të punës sime fitova këta dy kilogramë hurma. Një do t’ia jap Zotit, tjetrin po e ndaj për familjen dhe fëmijët.” Hipokritët dëgjuan për të dhe zunë ta vinin në lojë:

- “Deshti të dukej edhe ky, duke bërë njësoj si Ibni Aufi.” Ndërsa, sipas një transmetimi tjetër, idhujtarët thanë:

- “Sikur kanë nevojë, Allahu dhe i Dërguari i Tij, për atë një kile hurmat e tij!” Fill pas kësaj, Allahu i Madhërishëm foli nëpërmjet ajetit: **“Sa për ata (hipokritë) që përqeshin besimtarët që japin lëmoshë me vullnet dhe tallen me ata që nuk janë në gjendje të japin gjë përveç (fryteve të) punës së tyre, Allahu do të tallet me ta. Ata do të kenë dënim të dhembshëm.”** (Teube, 9/79)¹⁴

Ensarët si shembull i sakrificës

Tregon Ebu Hurejreja: “Tek i Dërguari i Allahut erdhi një mysliman dhe i tha:

- “O Resulullah, jam i varfër dhe kam mbetur shumë ngushtë.” Profeti ynë u dërgoi fjalë menjëherë grave të tij, që t’i jepnin atij njeriu diçka. Njëra prej tyre i tha:

- “I betohem Zotit që të dërgoi ty me fenë e së vërtetës, se përveç ujit nuk kemi asgjë tjetër!” Resulullahu i dërgoi fjalë një tjetre nga gratë e tij, por edhe prej saj erdhi po e njëjta përgjigje.

¹⁴. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 7/108 (11048).

Kur e pa se si ishte gjendja, Profeti i profetëve tha:

- “*Kush mund ta presë mik në shtëpinë e tij këtë njeri, që Allahu ta falë atë që e pret?*” U ngrit një nga ensarët dhe tha:

- “E pres unë, o Resulullah!”, - dhe e mori atë njeri në shtëpinë e tij dhe kur mbërritën në shtëpi, ai i tha së shoqes:

- “Çfarë ka për të ngrënë, moj grua?” E shoqja i tha se kishte mbetur ushqim vetëm sa për fëmijët. Atëherë ai i tha asaj:

- “Ti merrua fëmijëve mendjen me ndonjë gjë, derisa t’i zërë gjumi. Dhe, kur të ulemi për të ngrënë me mikun, fike kandilin, që ai të pandehë se po hamë edhe ne bashkë me të.”

U ulën dhe miku i hëngri të gjitha çfarë i vunë përpara, mirëpo, atë natë të zotët e shtëpisë e kaluan duke u përpëlitur nga uria. Me të zbardhur dita, ai mikpritës i rrallë shkoi te Profeti ynë. Me ta parë atë, i Dërguari i Allahut e pyeti atë:

- “*Allahu mbeti shumë i kënaqur dhe i pëlqeu shumë e mira që ju bëtë duke e pritur atë mik në shtëpinë tuaj.*” Madje, për këtë ndodhi, u zbrit edhe ajeti: “**Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndiejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.**” (Hashr, 59/9)¹⁵

4. DHËNIA BORXH PËR HIR TË KËNAQËSISË SË ALLAHUT

**Ebu’d-Dahdahu e jep kopshtin e tij
në këmbim të një kopshti në Xhenet**

E tregon Enesi (radijallahu anhu): “Njëherë tek i Dërguari i Allahut erdhi një burrë dhe i tha atij:

- “O Resulullah! Filani ka një kopsht hurmash. Unë dua që të ndërtoj një shtëpi në atë vend. Sikur t’i thuash të zotit të atij kopshti, që të më lejojë mua të ngre një shtëpi atje.” I Dërguari i Allahut i tha

¹⁵. Muslim, *Sahih*, 3/1642 (2054).

të zotit të kopshtit:

- “Jepja këtij njeriu kopshtin tënd të hurmave në këmbim të një kopshti me hurma në Xhenet.” Mirëpo, i zoti i pronës nuk deshë ta jepte atë kopsht. Ebu’d-Dahdahu erdhi dhe i tha atij njeriu:

- “Ma shit mua atë tokë, në këmbim të njëres prej shtëpive të mia!” Atëherë ai pranoi. Ebu’d-Dahdahu erdhi te Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) dhe i tha:

- “O Resulullah, atë tokë e bleva unë duke dhënë njëren nga shtëpitë e mia. Tani unë po ta dorëzoj atë ty, që t’ia japësh atij myslimanit që ta pati kërkuar.” Profeti ynë e dëgjoi atë dhe tha:

- “Sa madhështore po më duket ajo shtëpi e Ebu’d-Dahdahut në Xhenet!”

E përsëriti disa herë me radhë këtë fjali. Ebu’d-Dahdahu u kthye tek e shoqja dhe i tha:

- “O Ummu’d-Dahdah! Dil nga shtëpia, se këtë shtëpi unë e shita në këmbim të një kopshti hurmash në Xhenet.”

- “Kjo po që është tregti me fitim.”, – iu përgjigj e shoqja.”¹⁶

5. DHËNIA NË RRUGËN E ALLAHUT PËR PËRHAPJEN E ISLAMIT

Historia e një burri

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) do të ta jepte, çfarëdo që të ishte që do t’ia kërkoje në emër të lartësimiut e të përhapjes së Islamit. Një ditë, tek i Dërguari i Allahut erdhi dikush e i kërkoi që t’i jepte diçka dhe ai na urdhëroi t’i jepnim atij njeriu një prej tufave të dhenve. Ai burrë e mori tufën e tij dhe u kthye pranë pjesëtarëve të fisit dhe u tha:

- “O njerëzit e mi, eja bëhuni edhe ju myslimanë; sepse Muhamedi u jep aq shumë atyre që bëhen myslimanë, sa që duket sikur nuk ka fare frikë se mund të varfërohet një ditë!” Madje, në një tjetër transmetim thuhet edhe kjo:

¹⁶. Ibn Hibban, *Sahib*, 16/113 (7159).

- “Edhe nëse dikush bëhej mysliman sa për të fituar ndonjë gjë nga kjo botë, vinte dita që për të feja bëhej më e dashur edhe se e gjithë bota me tërë ç’ka në të.”¹⁷

Transmetimi i Zejd bin Thabitit

Tregon Zejd bin Thabiti: “Tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi një fshatar arab dhe i kërkoi që ai t’i jepte ndonjë tokë në luginë. Profeti ynë i dha atij njeriu pikërisht atë tokë që ai i kërkoi. Ai burrë u bë mysliman dhe kur shkoi pranë fisit të tij, u kishte thënë të gjithëve:

- “Bëhuni myslimanë. Unë tani po vij nga një njeri që jep pa u shqetësuar dhe pa pasur frikë se mos varfërohet!”¹⁸

6. DHËNIA PËR LUFTËN NË RRUGËN E ALLAHUT

Ebu Bekri (r.a.) jep një pjesë të pasurisë gjatë mërgimit të myslimanëve

E tregon vetë e bija e Ebu Bekrit (radijallahu anhu), Esmaja: “Babai im, Ebu Bekri, kur do të mërgonin, bashkë me të Dërguarin Fisnik, nga Meka në Medinë, mori me vete edhe pesë a gjashtëmijë dërhëmë që kishte. Pasi iu vunë rrugës së mërgimit, te ne erdhi gjyshi, Ebu Kuhafeja. Ai nuk shihte, ishte i verbër.

- “Uallahi, ky Ebu Bekri e mori me vete gjithë pasurinë, ju la në vështirësi edhe ju.” – tha Ebu Kuhafeja. Unë e kundërshtova:

- “Jo, o gjysh, babai neve na la një pasuri shumë të madhe.” Pak më vonë, mora një grusht gurë dhe i mbulova me një copë rrobe dhe mora dorën e gjyshit dhe e vura mbi atë rrobë dhe i thashë:

- “Shiko, o gjysh, këto janë paratë që na la babai.” Gjyshi më duket se u bind dhe tha:

- “Ah, në rregull, nëse ju paskalënë, atëherë në rregull!” E vërteta është se, kur iku, Ebu Bekri (radijallahu anhu) neve nuk na la asgjë. Atë veprim

¹⁷. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/107 (12070).

¹⁸. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 5/138 (4877).

unë e bëra vetëm si e si ta qetësoja gjyshin, i cili ishte tejet i moshuar.”¹⁹

Kur jepte Osmani (r.a.)

Abdurrahman bin Habab es-Selemi tregon: “Profeti ynë u foli njerëzve dhe u bëri atyre thirrje që të ndihmonin ‘*Xhejshu'l-usren*’, që do të nisej drejt Tebukut.

- “Unë do të jap njëqind deve me të gjitha pajimet e luftës.” – u hodh dhe tha Osmani (radijallahu anhu). I Dërguari i Allahut zbriti një shkallë nga minberi dhe u bëri sërish njerëzve thirrje, që të ndihmonin. Osmani (radijallahu anhu) përsëri tha:

- Unë do të jap edhe njëqind deve të tjera me të gjitha pajimet e luftës.” E pashë; Profeti ynë i gëzuar tej mase zgjati dorën dhe tha:

- “*Tani e tutje çfarëdo që të bëjë Osmani, ato nuk e dëmtojnë dot më atë.*” Dhe këto fjalë i përsëriti plot tri herë.”²⁰

Kur jepte Abdurrahman bin Aufi

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Aishja (radijallahu anha), gjendej në shtëpinë e saj në Medinë, kur dëgjoi një zhurmë. Pyeti:

- “Ç’është kjo zhurmë?” I thanë:

- “Është zhurma e karvanit që ka sjellë Abdurrahman bin Aufi nga Siria, e që është i mbushur plot e përplot me gjithë të mirat. Ai karvan përbëhej nga shtatëqind deve. Aq shumë ishte ngarkuar ai karvan, sa që dukej sikur Medinën po e lëkundte tërmeti.”

- “Nga i Dërguari i Allahut kam dëgjuar të thotë: “E pashë Abdurrahman bin Aufin teksa hynte në Xhenet duke u zvarritur.” Kur i shkuan në vesh Abdurrahman bin Aufit këto fjalë të Aishes (radijallahu anha), ai tha:

- “Po ia dola, unë do të hyj në këmbë në Xhenet.” – dhe e fali në rrugën e Allahut tërë atë karvan me shtatëqind deve.”²¹

¹⁹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/179.

²⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 5/4; Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/59.

²¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/98; Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/164.

Bujaria e Zejneb binti Xhahshit dhe dhënia e saj në rrugën e Allahut

Tregon Aishja (radijallahu anha): “Profeti ynë i nderuar na tha kështu: *“Tek unë do të vijë e para ajo që ka dorën më të gjatë.”* – Pas ndarjes nga jeta e Profetit tonë, bashkëshortet e tij filluan të matnin krahët me njëra-tjetrën, se cila “i kishte më të gjatë krahët”. Më bujarja nga ne ishte Zejnebi. I kishte duart të arta dhe ç’nuk bënte me to, dhe ato punë artizanale që bënte ajo ua falte menjëherë të tjerëve.”

Ndërsa, sipas një tjetër përcjelljeje, Aishja (radijallahu anha) tregon: “I zgjatnim duart në mur dhe i krahasonim, kush i kishte krahët më të gjatë. Këtë vazhduam ta bëjmë deri kur vdiq Zejnebi. Zejnebi ishte e shkurtër, nuk ishte më e gjata. Në fund e patëm kuptuar; i Dërguari i Allahut me gjatësinë e dorës kishte dashur të thoshte që është më bujarja e që jep më shumë në rrugën e Allahut. Zejnebi ishte shumë e aftë: bënte enë lëkure, i qepte dhe ua falte njerëzve si sadaka në rrugën e Allahut.”²²

7. DHËNIA TË SKAMURVE, TË VARFËRVE DHE NEVOJTARËVE

Historia e Omerit (r.a) me një grua të ve

Tregon Eslemi: “Unë dola në pazar bashkë me Omerin (radijallahu anhu). Një grua e re na u afrua dhe i tha Omerit (radijallahu anhu):

- “O Prijësi i Besimtarëve! Më ka vdekur burri dhe fëmijët m’i ka lënë fare të vegjël. Më duhet mua t’u siguroj për të ngrënë, pasi ata janë ende shumë të vegjël në moshë. Nuk kemi as të mbjella, as gjedhë. Jam shumë e shqetësuar, se mos më vdesin nga uria. Unë jam e bija e Hafaf bin Ejma el-Gifarit. Babai im ka qenë bashkë me Profetin tonë të dashur në Hudejbije.”

Për një çast Omeri (radijallahu anhu) ngeli si i ngrirë para asaj gruaje. Mblodhi njëherë veten, dhe pastaj i tha:

- “Përshëndetje, e mirë se ke ardhur; po ne qenkemi kushërinj me njëri-tjetrin.” Pastaj shkoi pranë një deveje që gjendej e lidhur aty

²². Muslim, *Sahih*, 4/1907 (2452).

pranë. I ngarkoi asaj dy thasë plot me ushqime, veshje, etj., dhe ia dorëzoi frerët e saj asaj gruaje, duke i thënë:

- “Merre këtë deve dhe kur të mbarohen këto që të kam ngarkuar mbi të, mos u mërzit, Allahu ka për t’ju dhënë të mira më të mëdha.”

Një nga ata që ishte bashkë me Omerin (radijallahu anhu) e pyeti atë:

- “O Prijësi i Besimtarëve, mos nuk i dhatë pak si shumë kësaj gruaje?”, – ndërsa, Omeri (radijallahu anhu) ia priti atij me fjalët:

- “Zoti të dhëntë edhe ty të mira. A e di ti se babai i saj ka qenë bashkë me Profetin tonë të Dashur në Hudejbije. I Betohem Allahut, i ati i kësaj gruaje dhe i vëllai e patën rrethuar për një kohë shumë të gjatë një kështjellë, derisa ngadhënjyen mbi të dhe ne patëm ndarë mes nesh plaçkën e shumë që gjetëm brenda saj.”²³

Ibni Omeri ishte dhënë pas dhurimit në rrugën e Allahut

E rrëfen Nafiu: “Ibni Omeri (radijallahu anhu) ishte i sëmurë. Bleva një vesh rrush për një dërhëm dhe ia vura përpara, që ta hante. Në atë çast aty erdhi një i varfër. Ibni Omeri tha:

- “Jepjani këtëj njeriu atë rrush.” I varfri e mori rrushin dhe iku. Atij të varfri i doli dikush përpara, i cili ia bleu atë po për një dërhëm dhe ia sollën prapë Ibni Omerit. Pasi u përsërit disa herë kjo situatë, unë nuk durova dot më dhe u ktheva nga ai njeri i varfër:

- “Nuk të vjen turp, mor njeri!”, – i thashë.

I bleva edhe njëherë për një dërhëm dhe ia çova Ibni Omerit; gjersa, më në fund, e mori dhe e hëngri atë vesh rrushi.”²⁴

Kur jepte Aishja (r.a.)

Imam Maliku tregon se: “Një ditë, e shoqja e Profetit tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), ishte duke agjëruar, kur aty erdhi një i varfër që i kërkoi t’i jepte ndonjë gjë. Në shtëpinë e Aishes (radijallahu anha) nuk kishte asgjë, përveç një copë buke. I thirri

²³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/912 (17085).

²⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/27.

shërbyeses dhe i tha:

- “Jepja atë bukën që është aty.”

- “Po ju nuk keni asgjë me çfarë të çelni iftarin në darkë pastaj.”, – iu përgjigj ajo, mirëpo Aishja (radijallahu anha) këmbënguli:

- “Jepja, jepja këtij njeriu atë bukë.”

Kur e rrëfen shërbyesja këtë histori, ajo tregon:

- “Ashtu bëra, siç më kërkoi Aishja (radijallahu anha), dhe ia dhashë atij të varfri atë copë buke. Në të rënë të muzgut, dikush na dërgoi një dele të pjekur dhe një copë buke تازه. Aishja (radijallahu anhu) më thirri dhe më tha:

- “Eja, ha edhe ti! Me siguri kjo është më e mirë se ajo buka jote (që nuk deshe ta jepje)!”²⁵

T’ua japësh lëmoshën të varfërve vetë në dorë

Amr el-Lejthij tregon: “Ishim tek Uathile bin el-Eska. Atje erdhi një i varfër. Uathileja mori një copë bukë, nxori edhe ca para dhe ia dha atij nevojtari me dorën e vet. I thashë:

- “O Ebu’l-Eska! Nuk kishe asnjë njeri në familje, që të shkonte ta ndihmonte atë të varfër, po u ngrite dhe ia çove vetë?” Ja se si m’u përgjigj:

- “Kam, po e di si është puna: ai që merr diçka dhe shkon vetë t’ia çojë të varfrit atë që ka për t’i dhënë, për çdo hap që hedh i fshihet nga një mëkat. Dhe kur ia jep atë gjë në dorë, për çdo hap atij i fshihen dhjetë gabime.”²⁶

8. T’U JAPËSH ATYRE QË DALIN PËR TË LYPUR

Historia e të Dërguarit të Allahut me një beduin

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) hyri një ditë në xhami. Të veshur kishte një petk të thurur trashë tek anët, dukej që ishte punim nga ai i Nexhranit. Nga

²⁵. Bejheki, *Shuabu’l-Iman*, 3/260 (3482).

²⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/890 (17024).

pas i vinte një beduin, i cili e arriti dhe e kapi Profetin tonë të nderuar nga rroba dhe e tërhoqi drejt vetes. Duhet ta ketë tërhequr shumë fort, sepse Profeti tonë i mbeti shenjë në qafë. Mandej, beduini i tha atij:

- “O Muhamed! Na jep edhe neve nga ajo që të ka dhënë Allahu.” Profeti ynë u kthye nga beduini, i buzëqeshi dhe tha:

- “*Jepini këtij njeriu çfarë të dojë ai.*”²⁷

Një rrëfim tjetër, po për këtë ndodhi

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Mëngjeseve, pas namazit, ne rrinim një copë kohë bashkë me të Dërguarin e Allahut. Kur Resulullahu donte të futej në dhomën e tij, ne çoheshim dhe pritnim derisa të hynte ai në dhomë. Një mëngjes ai sapo po bëhej gati të hynte në dhomë, kur aty u shfaq një beduin.

- “O Muhamed, më jep mua dy deve, se ato deve nuk janë as të tuat, as të babait tënd!”, – tha ai dhe e tërhoqi Profetin tonë për rrobe. Aq shumë e tërhoqi atë rrobë, sa që në qafën e të Dërguarit të Allahut ngeli një shenjë e kuqe. Profeti ynë, për të na qetësuar edhe ne, që u bëmë si të tërbuar, foli i pari dhe tha:

- “*Jo, mos e prekni. Lus Allahun të më falë. Pa ta kthyer edhe unë me të njëjtën monedhë këtë tërheqje nuk të jap asnjë deve.*” Dhe e përsëriti tri herë këtë fjali dhe pas pak na tha:

- “*Jepini dy deve këtij njeriu; njëren ngarkojeni me elb, kurse tjetrën me hurma.*”²⁸

9. LËMOSHA DHE TË DHËNËT VULLNETARISHT

Historitë e Ebu Bekrit dhe Omerit

Hasan Basriu tregon: “Një ditë, Ebu Bekr Besniku (radijallahu anhu) shkoi te Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që t’i jepte atij fshehtazi lëmoshën që kishte për të dhënë dhe i tha:

- “O Resulullah! Kjo është sadakaja ime; më vonë do të jap prapë. I kam dhënë fjalën Allahut që do të jap prapë.” Mandej, erdhi Omeri

²⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/38; El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 7/357 (18651).

²⁸. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/38.

(radijallahu anhu), i cili e dha haptazi sadakanë që kishte për të dhënë, dhe tha:

- “O Resulullah! Kjo është sadakaja ime, shpërblimin mua nuk mund të ma japë vetëm se Allahu.”

I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “O Omer! *Deshe t’ia kaloje Ebu Bekrit, po nuk ia dole dot. Dalloni në lëmoshën e dhënë, ashtu siç dallojnë edhe fjalët që më thatë!*”²⁹

Një hadith nga Asakiri lidhur me këtë ndodhi

Tregon Beshir el-Eslemiu: “Në kohën që në Medinë erdhën myslimanët muhaxhirë, ditët e para ata e patën të vështirë të mësoheshin me ujin e Medinës. Një nga bijtë e Gifarit kishte një burim të vetin të ujit, të cilin e quanin ‘Rume’. Ky njeri e shiste ujin në këmbim të një çmimi të caktuar dhe me të e siguronte jetesën. Një ditë, i Dërguari i Allahut i tha atij:

- “Ma shit mua këtë burim në këmbim të një burimi më të madh në Xhenet.” Ndërsa ai iu përgjigj:

- “O Resulullah, po unë me këtë burim e mbaj familjen, prandaj e kam të pamundur që të ta shes.” Një të dëgjuar Osmani (radijallahu anhu) se çfarë kishte ndodhur dhe ia bleu atë burim dhe erdhi drejt e te Profeti ynë i nderuar dhe i tha:

- “O Resulullah! Po nëse e blej unë atë burim, a do të ma premtosh edhe mua atë burim në Xhenet, të cilin ia premtove edhe atij njeriu?”

- “Po, patjetër që po!”, – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

- “Epo mirë, se unë e bleva atë, o Resulullah, dhe tani dua ta fal, që nga ai ujë të përfitojnë të tërë vëllezërit e mi myslimanë.”, – tha ai.³⁰

Pasioni i Talha bin Ubejdullahut për të dhënë lëmoshë

E tregon vetë e shoqja e Talhasë (radijallahu anhuma), Su’daja: “Një ditë, Talhaja kishte shpërndarë njëqindmijë dërrhemë lëmoshë dhe nuk

²⁹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/132.

³⁰. El-Hindi, *Kenzul’Ummal*, 13/34 (36183).

pati shkuar dot në xhami, që ta falte namazin bashkë me besimtarët, ngase unë u vonova ca duke i arnuar rrobën që do të vishte.”³¹

Pasioni i Selman Farisiut për të dhënë lëmoshë

Numan bin Humejdi tregon: “Bashkë me dajën tim shkua për vizitë te Selman Farisiu, i cili, asokohe, ishte vali në Medain. Po thurte shportë me gjethe hurmash. Unë e dëgjova atë të thoshte:

- “Gjethet e hurmave i blej për një dërhëm, pastaj i shndërroj në shporta dhe i shes me nga tre dërhëmë secila. Me një dërhëm blej prapë gjethe, një dërhëm e shpenzoj për të mbajtur familjen, kurse një tjetër e jap lëmoshë. Sikur të mos ma kish ndaluar Omeri (radijallahu anhu), këtë punë do të kisha vazhduar ta bëja përgjithmonë.”³²

10. T’U JAPËSH NJERËZVE PËR TË NGRËNË PËR HIR TË ALLAHUT

I Dërguari i Allahut gostit Xhabirin

E tregon vetë Xhabiri (radijallahu anhu): “Isha ulur në shtëpi. Kur aty erdhi Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe më thirri. Më kapi nga dora dhe më çoi në dhomën e njëres prej grave të tij. I pari hyri vetë dhe kur më dha leje edhe mua të hyja, hyra edhe unë dhe u ula në një qoshe që ishte ndarë me një si perde. Profeti ynë i nderuar pyeti:

- “*Ka ndonjë gjë për të ngrënë?*” Nga brenda u përgjigjën:

- “Ka.” – dhe na sollën tri bukë të mbushura dhe na i shtruan në një sofër. Njërën prej tyre e vuri përpara vetes, ndërsa tjetrën i Dërguari i Allahut ma vuri mua përpara. Kurse të tretën e ndau në mes dhe njërën ma dha mua, ndërsa tjetrën e vuri përpara vetes. Pastaj ai u foli edhe njëherë atyre që ishin brenda:

- “*Ka ndonjë gjë për t’ia hedhur sipër?*”

- “Ka pak uthull.” – iu përgjigjën.

³¹. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/88.

³². Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 6/241 (6110).

- “*Silleni, silleni, uthulla është e mirë për ta shoqëruar ushqimin.*”³³

Një hadith i përcjellë nga Xhabiri (r.a.) për uthullën

Abduluahid bin Ejmeni na përcjell nga i ati: “Te Xhabiri (radijallahu anhu) kishin ardhur mysafirë. Ai u nxori miqve edhe uthull, që ta shoqëronin ushqimin me të.

- “Urdhëroni, hani. Unë e kam dëgjuar vetë të Dërguarin Fisnik kur ka thënë:

- “*Uthulla është shumë e mirë për të shoqëruar ushqimin! Ashtu siç nuk është aspak e hijshme dhe e mirë që miqtë ta nënvlerësojnë ushqimin e gostitur, po aq e shëmtuar dhe e keqe është që i zoti i shtëpisë të përbuzë ushqimet, me të cilat gostit miqtë e tij!*”³⁴

Kur Ebu Bekri u shtronte gosti miqve të tij

E tregon Abdurrahman bin Ebu Bekri: “Ishte mbrëmje dhe te ne kishin ardhur miq. Babai doli jashtë të fliste me të Dërguarin e Allahut dhe u drejtua nga unë dhe më porositi:

- “O Ebu Abdurrahman, qerasi miqtë!” Kur erdhi darka, ne shtruam sofrën, mirëpo miqtë nuk hëngrën.

- “Ne nuk fusim asnjë kafshatë në gojë pa ardhur i zoti i shtëpisë.”

- “Babai është pak nevrrik dhe është shumë i kujdesshëm në këto gjëra; do të mërzhitet shumë, nëse ju nuk hani.”, – u thashë por ata këmbëngulën, që nuk do të hanin pa ardhur babai.

Më në fund, erdhi babai. Pa që asnjëri nuk kishte nisur të hante.

- “A i ngopët miqtë?”, – na pyeti.

- “Jo!”, – akoma i thamë ne të shtëpisë.

- “Po unë, a nuk e porosita Abdurrahmanin para se të dilja?”, – tha ai.

Kur e dëgjova të thoshte këto fjalë, u largova që aty. Babai filloi të thërriste:

³³. Muslim, *Sabih*, 3/1622 (2052).

³⁴. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 9/480 (25983).

- “Ebu Abdurrahman!” Nuk i shkova pranë.

- “More i pagdhendur! Të betohem: nëse më dëgjon, ku je, hajde këtu menjëherë!..”

Në fund, nuk kisha ç’të bëja, kështu që shkova dhe i tregova se si qëndronte puna:

- “Uallahi,” – i thashë, – “unë nuk kam faj. Ja ku janë miqtë, pyeti edhe ata po deshe. Unë ua shtrova ushqimet, mirëpo ata thanë se nuk do të hanin pa ardhur ti.”

Kësaj here, babai iu kthye miqve:

- “Po pse nuk pranoni që ta hani ushqimin që ju është gostitur? Uallahi, sonte as unë nuk do të fus asnjë kafshatë në gojë!”

- “Uallahi, as ne nuk hamë po nuk hëngre ti.”, – u përgjigjën mysafirët.

- “Nuk kam pasur ndonjëherë ndonjë natë më të keqe se kjo. T’ju vijë turp, pse nuk e hani ushqimin që ju është shtruar përpara?

Abdurrahmani thotë se: “Babai më vonë tha kështu:

- “Betimi i parë më shpëtoi nga goja, më shtyu shejtani, kështu që sillmani ushqimin!” Ia çuam ushqimin, babai tha:

- “Bismil’lah” dhe filloi të hajë; bashkë me të hëngrën edhe miqtë.

Në të aguar, babai u nis drejt e për tek i Dërguari i Allahut. Ai na tha:

- “O Resulullah! Ata e mbajtën fjalën, kurse unë e prishta betimin.”

- “Jo, jo, ti je më i mirë dhe më i mbarë se ata.”, – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.

Nuk kam dëgjuar nga ndokush që babai të ketë paguar shpagim për atë betim të prishur.”³⁵

Ftesa e Omerit (r.a.) për të ngrënë

Eslemi tregon: “Unë i thashë Omerit (radijallahu anhu):

- “Në vendin e quajtur Dhahr ka një deve të verbër.”

³⁵. Muslim, *Sahih*, 3/1627 (2057).

- “Çojuani Familjes së Bekuar, ta përdorin ata.”, – tha Omeri (radijallahu anhu).

- “Po ajo deve është e verbër!”, – i thashë unë.

- “Atëherë vëreni pranë deveve të tjera, që janë të shëndetshme.”, – tha atëherë Omeri (radijallahu anhu).

- “Po po e vumë atje, si do të kullotë ajo?”, – e pyeta unë.

- “Kjo deve, për të cilën po flisni, është nga kafshët e ardhura nga xhizja, apo është nga devetë e zekatit?”, – pyeti ai.

- “Nga ato që kanë ardhur nga xhizja.”, – i thashë unë.

- “Me sa po kuptoj unë, atëherë, ju e doni për vete atë deve të verbër, doni ta therni, ta piqni e ta hani vetë!”

- “Sipër ka vulën e deveve të ardhura nga kafshët e mbledhura si xhizje.”, – thashë unë.

Omeri (radijallahu anhu) urdhëroi t’ia sillnin aty atë deve. E sollën dhe e therëm. Tek Omeri (radijallahu anhu) gjendeshin nëntë enë, të cilat ai i përdorte për t’i mbushur me fruta dhe ushqime të mira e të rralla dhe ua dërgonte grave të të Dërguarit të Allahut. Mirëpo, duke qenë se pjesën e së bijës, Hafsasë, e vinte të fundit, asaj qëllonte që t’i dërgonte gjithmonë më pak. Edhe atë ditë, ai i mbushi enët nga mishi i asaj deveje dhe ua dërgoi bashkëshorteve të Profetit tonë. Ndërkaq, pjesën e mbetur urdhëroi të piqej dhe në gosti ftoi muhaxhirët dhe ensarët.”³⁶

Po të mos kishte miq, Abdullah bin Omeri (r.a.)

nuk ulej kurrë për të ngrënë

Muhamed bin Kajsî tregon: “Abdullah bin Omeri nuk ulej në sofër, po të mos kishte të varfër e nevojtarë që të uleshin e të hanin bashkë me të. Kur hante drekë ose darkë, ai thërriste edhe jetimët dhe hante bashkë me ta. Një drekë, e kishte marrë uria dhe donte të hante. I dërgoi fjalë një jetimi, mirëpo nuk e gjetën. Kur mbaroi së ngrëni, aty erdhi ai jetim. Abdullah bin Omeri ia dha atij shurupin që kishte në dorë dhe i tha:

³⁶. Imam Malik, *Muuatta*, 1/279 (618).

- “Merre këtë, jam i sigurt që ka për të të pëlqyer shumë.” Ai e mori dhe e piu të gjithin gjithë kënaqësi.³⁷

Një transmetim i Mejmun bin Mihranit po për këtë çështje

Mejmun bin Mihrani tregon: “I thanë bashkëshortes së Ibni Omerit:

- “Nuk po e mban mirë burrin!”, – sikur donin ta qortonin, duke shtuar:

- “Pse nuk kujdesesh më shumë për këtë burrë të moshuar?”

- “Po çfarë t’i bëj unë atij, sa herë që ia bëj gati ushqimin dhe ia shtroj sofrën, ai do të ftojë edhe të tjerë!”, – u ankua e shoqja.

Pas kësaj ngjarje, e shoqja e Ibni Omerit, me ta parë të shoqin që dilte nga xhamia, filloi t’ua dërgonte vetë ushqimin të varfërve që qëndronin të ulur rrugëve, duke u ngopur barkun. Ata i porositi:

- “Po ju thirrri Ibni Omeri, të mos vijë asnjëri.”

Kur Ibni Omeri doli nga xhamia dhe erdhi në shtëpi, u tha:

- “Thirrini në shtëpi aksh e aksh njeri!” Mirëpo, asnjëri prej tyre nuk erdhi, ashtu siç i pati porositur e shoqja e Ibni Omerit. Paskëtaj, Ibni Omeri tha:

- “Me sa shoh doni që të mos ha fare sonte.”, – dhe kështu bëri, vërtet, atë natë nuk futi asgjë në gojë.³⁸

Gostitë e Abdullah bin Amr bin Asit

Sulejman bin Rabia tregon: “Në kohën që në krye të shtetit islam ishte Muauja, unë pata shkuar në haxh bashkë me Muntisir bin Harithin dhe një grup hafëzësh. Ata më kërkuan mua, që të mos iknim pa u takuar me ndonjë sahab, që të na tregonte ndonjë hadith nga i Dërguari i Allahut. Unë fillova të kërkoja, se cilin nga sahabët mund të gjenim dhe sakaq, më njoftuan se asokohe në një luginë të Mekës banonte Abdullah bin Amr bin el-Asi. U nisëm, që të shkonim e të

³⁷. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/298.

³⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/298.

takoheshim me të. Gjatë rrugës përballë na doli një karvan i madh me treqind deve, dyqind prej të cilave të ngarkuara, kurse njëqind si kafshë rruge. I pyetëm ata që e shoqëronin atë karvan, se i kujt ishte ai karvan. Ata na thanë se ishte i Abdullah bin Amrit.

- “Pse, ai i ka të gjitha këto deve?”, – pyetëm ne, sepse ne e patëm njohur atë për thjeshtësinë që e dallonte. Ata na thanë:

- “Këto njëqind deve janë për vëllezërit e tij. Kurse dyqind të tjerat janë për mysafirët e tij.” U habitëm shumë.

- “Nuk ka përse të habiteni, Abdullah bin Amri është shumë i pasur dhe mendon se gostitja e miqve është një detyrë.”, – na thanë ata.

- “Po mirë, a nuk na çoni edhe ne tek ai?”, – pyetëm ne.

- “Tani ai është në Xhaminë e Shenjtë.”, – na thanë. E kërkuam, e kërkuam, gjersa e gjetëm të ulur diku pas Qabes. Ishte një trupvogël, me sytë të skleposur; kishte veshur dy veshje dhe në kokë mbante një çallmë. Këmishë nuk kishte veshur. Kurse sandalet i kishte hedhur në supin e majtë.”³⁹

Sa’d bin Ubadeja e fton të Dërguarin e Allahut të hanë bashkë

E tregon Enesi (radijallahu anhu): “Sa’d bin Ubadeja e ftoi të Dërguarin Fisnik të hanin bashkë. Për të ngrënë i nxori hurma dhe bukë. Profeti ynë i hëngri ato. Pastaj i solli edhe një gotë me qumësht, e piu dhe qumështin dhe u lut kështu:

- “*Lus Zotin, që bukën t’jua hanë përherë njerëz të mirë. Ata që agjërojnë, në shtëpinë tuaj e paçin iftarin. E le të luten engjëjt për ju, e t’i përgjërohen Allahut që Ai t’ju falë.*”⁴⁰

Pritja e mysafirëve që vinin në Medinën e bukur

E tregon Seleme bin Ekuaja (radijallahu anh): “Pasi u fali namazin xhematit të besimtarëve, i Dërguari i Allahut u kthye dhe na tha:

- “*Le të marrë secili aq mysafirë sa ka edhe ushqim në shtëpi!*” Dhe secili nga

³⁹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/291.

⁴⁰. Ebu Daud, *Sunen*, 2/395.

sahabët, sipas mundësive, filloi të merrte nga një ose nga dy mysafirë. Nëse mbetej ndonjë që nuk e kishte marrë njeri, ata i mirëpriste vetë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).⁴¹

I Dërguari i Allahut fton sahabët e Sufes

E tregon Ebu Hurejreja: “I Dërguari i Allahut erdhi një ditë tek unë dhe më foli:

- “O Ebu Hurejre!”

- “Urdhëroni, o i Dërguari i Allahut!”, – i thashë unë.

- “*Shko te sahabët e Sufes dhe thirri ata të vijnë këtu.*”, – më tha.

Sahabët e Sufes ishin mysafirët e myslimanëve. Ata nuk kishin as familje, as plaçkë e pasuri. I Dërguari i Allahut, kur qëllonte që dikush t’i dorëzonte ndonjë lëmoshë, ai ua dërgonte atë menjëherë atyre pa marrë vetë asgjë. Edhe nëse vinte ndonjë gjë si dhuratë, atyre ua dërgonte; nganjëherë qëllonte edhe që ta mbante një pjesë të dhuratës për vete. Ai edhe dhuratat i ndante gjithmonë me të tjerët.⁴²

Një hadith i lidhur me këtë çështje që e transmeton Ibni Kajsi

Tuhfe bin Kajsi tregon: “Një ditë, i Dërguari ynë Fisnik u tha sahabëve të tij, që të merrnin secili sa të mundte prej sahabëve të Sufes dhe t’i gostitnin në shtëpitë e tyre. Kështu, ata filluan të merrnin secili nga një ose nga dy syresh. Kishin mbetur edhe pesë vetë që nuk i kishte marrë njeri, e njëri prej tyre isha edhe unë. I Dërguari i Allahut na tha neve:

- “*Ju ejani me mua!*”, – dhe na çoi në shtëpinë e Aishes (radijallahu anha). Aishes (radijallahu anha) i tha:

- “O Aishë! Na sill ndonjë gjë për të ngrënë.” Nëna jonë Aishja na solli për të ngrënë një ushqim të bërë me mish e me miell, të cilit i thoshin “xheshishe”. Pasi e hëngrëm atë, na solli edhe një ëmbëlsirë hurmash, së cilës i thoshin “hajse”; e hëngrëm edhe atë. Mandej, Profeti ynë i tha asaj:

⁴¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 9/476 (25973).

⁴². Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/338.

- “O Aishë, na sill edhe ndonjë gjë për të pirë!” Aishja (radijallahu anha) na nxori një enë të vogël me qumësht dhe ne e pimë edhe qumështin.

Profeti ynë tha:

- “Po deshët, sot të rrini këtu tek unë; ose, po të doni, mund të shkoni të qëndroni edhe në xhami.”

- “Të shkojmë më mirë në xhami.”, – i thamë ne dhe u çuam e shkuam u shtrimë në xhami. Mua më kish zënë gjumi përmbys, kur dikush erdhi e më ngacmoi me këmbë dhe dëgjova që më tha:

- “A nuk e di se fjetja me kokë poshtë thërret ndëshkimin e Allahut!” Kur, ç’të shihja, përpara meje ishte në këmbë i Dërguari i Allahut!”⁴³

Gosti për ata që do të bëhen rishtazi myslimanë

E tregon Xhehxhah el-Gifari: “Unë erdha në Medinë bashkë me një grup njerëzish që donin të bëheshin myslimanë. Në atë kohë, i Dërguari i Allahut po u falte besimtarëve namazin e akshamit. Kur mbaroi së faluri namazin, ai u kthye nga sahabët e tij dhe u tha:

- “Çdokush të marrë në shtëpi shokun që ka pranë vetes!” Në xhami mbetëm vetëm unë dhe i Dërguari i Allahut. Meqenëse unë isha paksa i mbushur e trupmadh, askush nuk i hodhi sytë nga unë. Derisa, në fund, mua më mori në shtëpinë e tij i Dërguari i Allahut. Moli një dhi për mua dhe e piva atë qumësht. Pastaj më nxorën përpara një enë të vogël me ushqim, e hëngra edhe atë. Atë natë piva qumështin e tërë-tërë shtatë dhive. Umu Ejmeni filloi të ankohej:

- “Allahu e lëntë të uritur atë që e la të uritur të Dërguarin e Allahut sontë.”

- “Po rri, o Umu Ejmen! Ai hëngri atë që i kish caktuar Allahu të hante, e nuk ka dyshim se Allahu do të na e japë edhe neve atë që na takon.”

Në të aguar, të gjithë nisën t’i tregonin shoku-shokut se si e kishin gositur bujtësit ku kishte qenë në darkë. Unë u tregova atyre se kisha pirë qumështin e shtatë dhive dhe se kisha ngrënë plot një tenxhere me gjellë të mirë.

⁴³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/374.

Ditën tjetër, ishim sërish në namazin e akshamit, të cilin po na e falte i Dërguari i Allahut. Po ashtu si një natë më parë, i Dërguari i Allahut tha që ‘gjithkush të merrte në shtëpi atë që kishte pranë vetes.’ Prapë nuk doli njeri që të më merrte mua. Ndoshta ngase unë isha trupmadh e i mbushur, andaj nuk më pati ftuar askush. Po njësoj, mua më mori në shtëpinë e tij i Dërguari i Allahut dhe moli një dhi e më dha ta pija qumështin. E piva dhe u ngopa. Umu Ejmeni e pyeti të Dërguarin e Allahut:

- “Kush është ky, o Resulullah, ai miku i djeshëm është, apo jo?”

- “Po!”, — u përgjigj i Dërguari i Allahut dhe tha: *“Ai sonte hëngri si besimtar, kurse dje pati ngrënë si mobues. Ai që është mobues ha derisa t’i mbushen shtatë zorrrë; kurse njeriu që beson ha vetëm sa për të mbushur zorrrën e tij.”*⁴⁴

Kur shtrohet gosti për sahabët e Sufes gjatë Ramazanit

E tregon Uathile bin en-Eskaja: “Teksa qëndronim mes sahabëve të Sufes, filluam edhe ne të agjëronim gjatë muajit të Ramazanit. Në kohën e iftarit, erdhi një nga ata që kishin lidhur besë me të Dërguarin e Allahut (ishin nga ata që kishin marrë pjesë në besëlidhjen e Akabesë ose të Riduanit), të na çonte në shtëpinë e tij për të na shtruar iftar. Një mbrëmje, edhe pse erdhi koha e iftarit e kaloi madje, tek ne nuk erdhi askush të na çonte ndokund për të ngrënë. Atë natë e zbardhëm pa futur asgjë në gojë. Kur as në mbrëmjen tjetër nuk erdhi askush që të na ftonte, ne shkuam tek i Dërguari i Allahut t’i tregonim se si i kishim kaluar ato ditë. Ai u dërgoi fjalë secilës prej bashkëshorteve të tij, për t’i pyetur nëse kishte për të ngrënë apo jo. Të gjitha iu betuan se në shtëpitë e tyre nuk kishte mbetur asgjë. Pas kësaj, Profeti ynë kërkoi të mblidheshin të gjithë dhe u lut kështu:

- “O Zot, të kërkoj prej mirësisë dhe mëshirës Sate. Ti e ke në dorë t’i japësh kujt të duash nga mirësia dhe mëshira Jote, sepse askush tjetër nuk e ka në dorë dhe nuk ka se si ta ketë.”

Nuk kish përfunduar ende së u luturi, kur ia behu dikush që

⁴⁴. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 2/274 (2152).

kërkonte leje të hynte, sepse kishte prurë një qengi të pjekur dhe bukë të bardhë. I Dërguari i Allahut kërkoi të na shtrohej përpara ai ushqim dhe ne hëngrëm të gjithë gjersa u ngopëm mirë. Pas ushqimit, Profeti ynë u lut kështu:

- *“Ne i kërkuam Allahut të na jepte prej mëshirës dhe mirësisë së Tij. Ja; e këtëllë është mirësia e Tij. Kurse mëshirën Ai e ka ruajtur për në jetën e përtejme.”*⁴⁵

Edhe në kohët më të vështira, Omeri (r.a.) i shtronte gosti kujtdo që vinte nga rrethinat

Eslemi tregon: “Në kohën e kalifatit të Omerit (radijallahu anhu), kur ndodhi që të ishte thatësirë dhe kohë e keqe, njerëzit e rrethinave erdhën në Medinë. Omeri (radijallahu anhu) ngarkoi disa njerëz që të gjenin ushqim dhe ndonjë gjë për ta shoqëruar për mysafirët. Në mbrëmje, të gjithë ata po jepnin llogari përpara Omerit (radijallahu anhu). Një natë, teksa po shtrohej ushqimi, Omeri (radijallahu anhu) u dha urdhër njerëzve të tij, që t’i numëronin ata që po hanin. U numëruan dhe i thanë se bëheshin shtatë mijë vetë. Kësaj here Omeri (radijallahu anhu) u tha atyre:

- “Numëroni edhe ato familje që nuk kanë ardhur dot, të sëmurët, jetimët, numërojini edhe ata!” U numëruan edhe ata dhe në fund i thanë se ishin dyzet mijë vetë gjithsej. Për disa net ne i ndoqëm me sy ata që vinin e iknin. Njerëzit sa vinin e shtoheshin. Omeri (radijallahu anhu) kërkoi të numëroheshin sërish. Kësaj here ata që po hanin ishin dhjetë mijë, kurse ata që nuk kishin ardhur dot aty bëheshin pesëdhjetë mijë vetë. Nuk kaloi shumë kohë dhe filluan të binin shira. Kur ra shi, Omeri (radijallahu anhu) e dërgoi secilin prej njerëzve të tij që të shkonin nëpër zona të ndryshme të Medinës. Ai u urdhëroi atyre që të çonin ushqime dhe ç’do gjë që ishte e nevojshme për ata që kishin qenë mysafirët e Medinës në ato ditë të vështira, si dhe që t’i ndihmonin të rivendoseshin në banesat e tyre. Omeri (radijallahu anhu) e ndiqte vetë nga afër këtë çështje. Kishte edhe nga ata që kishin vdekur gjatë kthimit. Ma merr mendja se dy të tretat patën vdekur. Punëtorët mbanin në krahë kazanë të mëdhenj, në të cilët ziente

⁴⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/120.

ushqimi dhe gatuanin nga mëngjesi deri në mbrëmje. Me atë ushqim ushqeheshin të sëmuret. Bënin një ushqim që përgatitej duke përzierë miellin me vaj të trashë. Omeri (radijallahu anhu) u kishte urdhëruar që të hidhej vaj i trashë, si dhe i kishte porositur që ta skuqnin mirë atë vaj, që t'i ikte hidhësira. Nga ana tjetër priteshin bukë njëra pas tjetrës, të cilat mbusheshin me këtë gjellë me miell dhe vaj. Në atë vit të thatësirës së madhe, Omeri (radijallahu anhu) nuk arriti të hante ndonjë ditë në shtëpi apo me ndonjërin nga familjarët e tij. Atë e gjeje gjithmonë në mes të njerëzve dhe bashkë me ta hante.”⁴⁶

Omeri (r.a.) e mbante vetë mbi shpinë ushqimin që do t'u çonte jetimëve

Eslemi tregon: “Omeri (radijallahu anhu), një natë, teksa po shëtiste nëpër qytet, në një shtëpi dëgjo i një grua të rrethuar nga fëmijët që qanin. Pa njëherë, në zjarr ishte vënë një tenxhere, të cilën ajo grua e kishte mbushur me ujë. Omeri (radijallahu anhu) u afrua mirë te dera e shtëpisë dhe e pyeti:

- “O robëreshë e Allahut! Çfarë kanë fëmijët që qajnë?”

- “Qajnë nga urial”, – tha ajo.

- “Po mirë, po në atë tenxhere që është mbi zjarr çfarë ka?”, – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- “Në tenxhere ka vetëm ujë. Orvatem t'u marr mendjen; mbase i zë gjumi duke menduar se po gatuhet diçka dhe do të hanë.”, – u përgjigj ajo.

Kjo gjendje e bëri Omerin (radijallahu anhu) t'i mbusheshin sytë me lot. U çua dhe shkoi menjëherë në hambarin ku mbahej zekati. Mori një thes të madh me miell, vaj, hurma, veshje dhe para. Kur thesi u mbush mirë, ai u kthye nga unë dhe më tha:

- “Eslem, ma hidh pak në shpinë këtë thes!”

- “Ç'është ajo fjalë, lëre se e mbaj unë, o Prijësi i Besimtarëve!”, – i thashë unë, por ai ma ktheu:

⁴⁶. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 3/316.

- “Jo, Eslem, jo, do ta mbaj unë, sepse, në jetën e përtejme, jam unë ai që do të japë llogari që ata janë në këtë gjendje!”, – dhe, sakaq, e mori thesin në shpinë dhe u nis drejt asaj shtëpie. Mbërriti atje, hodhi pak miell, vaj dhe hurma në tenxhere, e, ndërsa nga njëra anë përziante tenxheren, nga ana tjetër i frynte zjarrit që të mos shuhej. Fytyra iu mbulua krejtësisht nga tymi e hiri, derisa e përgatiti ushqimin. U ul edhe vetë afër fëmijëve. Në atë kohë ngurrova e nuk i thashë dot asgjë Omerit (radijallahu anhu). Fëmijët u ngopën dhe filluan të luajnë e të gëzojnë me njëri-tjetrin, ndërsa ai nuk u çua, por i ndiqte me sy. Pastaj, u çua, u kthye nga unë dhe më pyeti:

- “O Eslem, a e di pse u ula edhe unë me ta?”

- “Jo!”, – i thashë unë.

- “Po unë i gjeta ata duke qarë. Nuk guxoja të largohesha dot pa i parë njëherë edhe duke qeshur e në hare!”, – më tha.⁴⁷

11. KUR I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ SHPËRNDANIN USHQIM

Një transmetim i Enesit (r.a.) lidhur me këtë

E rrëfen Enesi (radijallahu anhu): “Ukejdiri, sundimtari i Dumetu’l-Xhendelit, i kishte nisur të Dërguarit të Allahut si dhuratë një enë balte të mbushur plot me hallvë. Profeti ynë, në kthim e sipër nga namazi u takua edhe me një grup njerëzish. U dha edhe atyre nga pak hallvë. Xhabirit, megjithëse i kishte dhënë njëherë, i dha edhe njëherë.

- “Mua më dhe, o Resulullah!”, – i tha Xhabiri.

- “*Kjo është për motrat e tua, o Xhabir.*”, – ia ktheu ai.”⁴⁸

Profeti ynë i ndante hurmat me sahabët e tij

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u shpërndau sahabëve të tij hurma. I dha secilit nga shtatë hurma. Edhe mua shtatë kokrra më dha. Njëra ishte

⁴⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/136.

⁴⁸. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/122 (12246).

pa farë dhe ishte e vogël. Mirëpo, ajo më pati pëlqyer më shumë nga të gjitha; se ishte nga ato që përtypen lehtë.”⁴⁹

12. TË VESHURIT E TË VARFËRVE DHE NEVOJTARËVE

Qëndrimi i Omerit (r.a.) kur shpërndanin veshje

Tregon Xhafer bin Muhamedi, transmetuar prej të atit, se: “Omerit (radijallahu anhu) i kishin ardhur veshje nga Jemeni. Ua vishte njerëzve dhe ata gëzoheshin jashtë mase. Omeri (radijallahu anhu) qëndronte i ulur diku midis varrit të bekuar të të Dërguarit të Allahut dhe minberit; njerëzit vinin, i jepnin selam dhe luteshin për të. Në atë kohë, nga shtëpia sapo kishin ardhur edhe Hasani me Husejnin, për të zënë radhët e para në xhami. Omeri (radijallahu anhu) ishte shumë i mërzhitur, që nuk u kishte dhënë dot edhe atyre nga ato veshjet që kishin ardhur nga Jemeni.

- “Uallahi, jam shumë i mërzhitur, që nuk ju dhashë dot edhe juve.”, – u tha atyre.

- “O Prijësi i Besimtarëve, ti bëre atë që është më e mira, veshe njerëzit!”, – u përgjigjën ata.

- “Po nuk i vesha dot edhe Hasanin me Husejnin, se o u vinin më të mëdha, o u vinin më të vogla.”, – u thoshte të gjithëve.

Më vonë, i shkroi valiut të Jemenit, që të nisinin menjëherë edhe dy palë rroba për Hasanin dhe Husejnin. Dhe ai ia përmbushi menjëherë urdhrin kalifit të të Dërguarit të Allahut. Omeri (radijallahu anhu) i mori dhe ua dha teshat e reja Hasanit dhe Husejnit.”⁵⁰

Shpërblimi për atë që vesh jetimin

Ibni Abasi tregon: “Tek unë erdhi një njeri i varfër dhe më kërkoi që t’i jepja ndonjë gjë. Dhe unë i thashë:

- “A dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij?”

⁴⁹. Buhari, *Sabih*, 5/2065 (5095).

⁵⁰. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 8/10 (11446).

- “Po!”, – m’u përgjigj ai.

- “Po Ramazanin a e agjëron?”, – e pyeta unë sërish.

- “Po!”, – m’u përgjigj ai njeri.

- “Ti më kërkove të të jap diçka dhe ne e kemi për detyrë që t’u japim njerëzve e t’ua përmbushim atyre nevojat që kanë.” – dhe sakaq i dhashë një veshje. Mandej, atij njeriu i përcolla edhe një hadith, të cilin e kisha dëgjuar vetë nga i Dërguari i Allahut: *“Kushdo që vesh një mysliman është nën ruajtjen dhe mbrojtjen e posaçme të Allahut për sa kohë që ai e mban në trup atë veshje.”*⁵¹

13. SI JEPTE PROFETI YNË NË RRUGËN E ALLAHUT?

Abdullah el-Heuzeni tregon: “Me muezinin e Profetit tonë, Bilalin, u njoha në Halep.

- “O Bilal! A nuk më tregon, si u jepte i Dërguari i Allahut njerëzve, si sillej me ta kur u jepte diçka e në ç’mënyrë ua jepte ato që kishte për t’u dhënë?”, – e pyeta.

- “Ai (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), qëkurse u shpall profet, e derisa shkoi në jetën e përtejme, detyrën e shpërndarjes së gjërave që u jepte njerëzve ma ka dhënë mua. Sa herë që tek ai do të vinte ndonjë mysliman, Profeti ynë, nëse e kuptonte se ai njeri ishte me të vërtetë i varfër, atëherë më urdhëronte mua që t’i jepja diçka. Unë gjeja borxh te ndokush dhe i blija atij njeriu për të veshur e për të ngrënë. Një ditë, tek unë erdhi një idhujtar dhe më tha:

- “O Bilal! Unë jam i pasur; i kam të gjitha të mirat. Këtej e tutje mos shko më tek askush të kërkosh borxh; eja më kërkto mua sa të duash dhe do të të jap.”

Kështu, edhe unë fillova të merrja tek ai borxh. Një ditë, sapo kisha marrë abdes dhe po bëhesha gati për të kënduar ezanin, kur ç’të shoh, nga përtej ishte duke ardhur ai idhujtar bashkë me një grup tregtarësh. Më thirri, me të më parë: “O abisinas!”

- “Ç’ka ndodhur, pse më thërret?”, – e pyeta unë.

⁵¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/556 (16073).

Ai e vrenjti fytyrën, më hodhi një shikim të ashpër dhe më shau:

- “A e di se edhe sa ditë kanë mbetur deri në hënën e re?”

- “Shumë pak.”, – iu përgjigja unë.

- “Vetëm katër net kanë mbetur. Pas katër ditësh do të vij tek ti, që të më kthesh borxhet. Unë ato para nuk t’i dhashë për qejfin tënd apo të atij të madhit tënd (e kishte fjalën për të Dërguarin e Allahut). T’i dhashë, që ti të bëheshe skllavi im. Njësoj si në të shkuarën, që të vazhdosh të m’i kullotësh ti dhentë!”, – më tha ai njeri.

U mërzita shumë kur i dëgjova ato fjalë. Dola të eci, shkova dhe thirra ezanin. Falëm edhe namazin e jasisë, e pastaj u ktheva te familja e të Dërguarit të Allahut. Kërkova leje për t’u takuar me të. Më tha të hyja. Hyra dhe i tregova:

- “O Resulullah! T’u bëfshin kurban nëna dhe babai im! Ai njeriu që i kam kërkuar borxh vazhdimisht, erdhi sot e më tha kështu e kështu. Unë e di, tani as ti, as unë nuk kemi mundësi që ta kthejmë atë borxh. Po këtij njeriu i ka hipur në kokë, që të më poshtërojë përpara njerëzve. Më lejo, të iki e të strehohem në ndonjë nga këto fiset që janë bërë rishtazi myslimane. Të qëndroj atje, derisa Allahu t’i dërgojë diçka të Dërguarit të Tij dhe t’ia paguajmë të gjitha sa i detyrohemi atij idhujtari.”

I kërkoja Resulullahut leje të largohesha dhe u ktheva në shtëpi. Shpatën, syngjinë, heshtën dhe këpucët i vura te koka. U shtriva dhe kokën e mbajta në anën nga mund të shihja jashtë. Isha i shqetësuar, më kishte kapluar njëfarë sikleti; më doli shumë herë gjumi atë natë dhe vetëm aty pasi kaloi mesnata m’u mbyllën sytë. Dhe, një t’u shfaqur drita e parë e mëngjesit, u zgjova. Sapo u bëra gati të largohesha, nga jashtë dëgjova dikë të më thërriste:

- “Bilal! Eja, se të kërkon Resulullahu!” Dola. Kur mbërrita te porta e të Dërguarit të Allahut, ç’të shoh, në këmbë ishin katër deve të ngarkuara plot e përplot! Kërkova leje dhe hyra brenda.

- “Bilal! Lajm i mirë për ty! Allahu na dërgoi plaçkë, që ta paguajmë atë borxh!”, – më tha Profeti ynë. Lëvdova Allahun.

- “Nuk i pe ato katër deve që ishin përpara shtëpisë?”, – më pyeti ai.

- “I pashë!”, – iu gjegja unë.

- “Ja, pra, ato katër deve me gjithë ç’kanë përsipër janë të tuat. I ka dërguar sulltani i Fedekut. Merri dhe shpjerja atij njeriu, e mbylli të gjitha borxhet me të.” – më tha i Dërguari i Allahut.

Dhe unë ashtu bëra, siç më porosi Resulullahu. I zbrita barrët dhe u dhashë deveve për të ngrënë. Më vonë, shkova të thërrisja ezanin e sabahut. Pasi Profeti na fali namazin, unë dola andej nga varreza e Përjetshme, i vura duart në vesh dhe thirra me sa të kisha në kokë:

- “Le të vijë këtu, kushdo që i ka hua Resulullahu!”

Atë ditë, herë duke shitur plaçkat kundrejt vlerës në para e herë duke paguar borxhin me to, arrita t’i paguaja të gjitha borxhet që kishte Profeti ynë i nderuar. Më në fund, në rruzullin tokësor nuk mbeti më asnjëri që Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) t’i kishte hua. Jo vetëm kaq, por pasi i pagova të gjitha borxhet, mbetën edhe ca para. Pashë njëherë, Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte ulur te hyrja e faltores. E përshëndeta. Ai më tha:

- “Hë, si shkoi, çfarë bëre?”

- “Allahu i pagoi të tëra borxhet e Profetit të Tij; nuk ka mbetur më asnjë detyrim ndaj askujt.” – i thashë unë.

- “Po mirë, ka tepruar gjë?”, – më pyeti ai.

- “Po, kanë tepruar edhe dy dinarë.”

- “Mirë, atëherë, më shpëto edhe nga ata dy dinarë. Jepi edhe ata, që të më bjerë koka në paqe, përndryshe nuk do të shkoj tek asnjëri prej familjarëve të mi!”, – më tha i Dërguari i Allahut.

Atë ditë aty nuk gjeta askënd, që t’ia jepja ato dy dinarë dhe Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e kaloi natën në xhami; edhe ditën e dytë, po në xhami fjeti. Më në fund, aty në të rënë të muzgut të ditës së tretë, aty erdhën dy kalorës. I mora ata dhe i çova në pazar dhe me ata dy dinarë i veshja me rroba të reja dhe u dhashë për të ngrënë.

Pasi na fali namazin e jacisë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më thirri mua, për të më pyetur:

- “Çfarë u bë me ato që kishe me vete?”

- “Ua dhashë të gjitha atyre që u takonin.” – i thashë unë.

Me të marrë lajmin, i Dërguari Fisnik tha:

- “Allahu Ekber.” Lëvdoi Allahun, që e kishte shpëtuar nga rreziku se mos vdiste duke i pasur ai ata dy dinarë. Mandej u ngrit. Pas tij dola edhe unë dhe e ndoqa nga pas. Shkoi me radhë tek të gjitha gratë e tij dhe u dha selam. Mandej, u kthye tek e shoqja ku do të kalonte atë natë.

Ja, more Abdullah, kështu qëndron ajo punë për të cilën më pyete!”⁵²

14. KUJDESI I VEÇANTË NË NDARJEN E ZEKATIT, SADAKASË DHE PLAÇKËS SË LUFTËS

Kujdesi i veçantë që tregonte Profeti ynë kur do të ndante diçka

E tregon vetë nëna jonë Umu Selemeja (radijallahu anha): “Unë i di të gjitha çfarë iu soll të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), deri kur erdhi ora dhe ai iku nga kjo jetë. Njëherë, dikush pati ardhur në mes të natës dhe i pati sjellë një trastë me tetëqind dërhëmë. Atë natë i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) do të qëndronte tek unë, kështu që e nisi për tek unë atë trastë me para. Vetë erdhi pasi falën namazin e jasisë dhe u tërhoq në qoshen e dhomës ku edhe falte namaz. Kurse unë isha bërë gati dhe po e prisja. E zgjati shumë namazin. Pastaj, doli jashtë, hyri prapë brenda dhe në këtë gjendje vazhdoi deri në namazin e sabahut. Fali namazin e sabahut dhe u kthye e më pyeti:

- “*Ku është ajo trastë që erdhi mbrëmë e nuk më la të qetë deri në mëngjes?*” E sollën trastën aty. Resulullahu i shpërndau për në vendet e nevojshme të gjitha ato para.

- “O Resulullah! Ti bërë diçka që nuk e ke bërë kurrë deri më tani, pse?”, – e pyeta unë.

- “*Edhe në namaz më vinte në mendje. Kthehesha dhe e shihja, pastaj filloja të falja sërish namaz.*”, – m’u përgjigj ai.”⁵³

⁵². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/55.

⁵³. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 23/414 (999).

I Dërguari i Allahut shpërndan tetëdhjetë mijë dërrhemët që i dërgoi Ala bin el-Hadramiu

Ebu Musa el-Esh'ari tregon: “Ala bin el-Hadrami i dërgoi nga Bahrejni të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) plot tetëdhjetë mijë dërrhemë. Asnjëherë më parë nuk kishte dërguar ndokush një shumë kaq të madhe parash. I Dërguari Fisnik urdhëroi që paratë të zbrazeshin të gjitha mbi një rrogoz. Në atë kohë u thirr ezani. Falëm namazin dhe pasi u falëm, ai erdhi dhe u ul përpara parave. Erdhën edhe sahabët. Meqenëse në atë kohë nuk përdorej edhe aq shumë peshorja, i Dërguari i Allahut i shpërndau ato duke i dhënë me grushte. Ndërkaq, aty erdhi edhe Abasi (radijallahu anhu), i cili tha:

- “O i Dërguari i Allahut, në luftën e Bedrit, unë pata dhënë edhe shpagimin tim, edhe shpagimin për vëllanë tim, Akilin. Më jep edhe mua tani nga këto para.”

- “*Merr!*”, – iu përgjigj Profeti ynë.

Abasi hoqi këmishën që kishte veshur dhe i hodhi në të paratë që mori. U përpoq ta ngrinte, por ishte e pamundur, nuk po e ngrinte që nuk po e ngrinte dot. Ktheu kokën nga i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i tha:

- “O Resulallah, a nuk më ndihmon sa ta hedh mbi shpinë?” Profeti ynë i dashur buzëqeshi sa iu dukën edhe dhëmbët rruazë, duke i thënë:

- “*Lër pak, o Abas, merr aq sa mund të ngresh.*” Dhe Abasi ashtu bëri, i hoqi një pjesë të parave dhe pastaj e ngriti rrobën dhe u largua. Teksa po ikte, Abasi (radijallahu anhu) filloi të thoshte me vete:

- “U përmbush edhe një nga premtimet e Allahut. Po tjetri nuk e di a do të ndodhë. Premtimi tjetër ishte ky ajet: **“O Profet! Thuaju robërve që gjenden në duart tuaja: ‘Nëse Allahu gjen mirësi në zemrat tuaja, do t’ju japë diçka edhe më të mirë nga ajo që ju është marrë dhe do t’ju falë.’ Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**” (Enfal, 8/70)

Këto para janë shumë herë më të mira sesa ato që dhashë unë më parë. Të shohim, po faljen dhe mëshirën e Allahut a do ta fitoj dot?”⁵⁴

⁵⁴. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/372 (5423).

Ndjeshmëria e Ebu Bekrit (r.a.)

Ismail bin Muhamedi tregon: “Ebu Bekri (radijallahu anhu) kishte ndarë ushqimet dhe paratë që ishin në gjendje në mënyrë të drejtë. Megjithatë, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti atë:

- “O kalifi i të Dërguarit të Allahut, pse i mban të barabartë me të tjerët sahabët e Bedrit?” Dhe, Ebu Bekri (radijallahu anhu) iu përgjigj kështu:

- “Kjo botë është vetëm një mjet, që do të na çojë ne në qëllimin tonë; një shkak. Dhe nuk ka shkak më të mirë sesa ai i rrugës së mesme. Ndërsa, për sa u përket sahabëve të Bedrit, fitimi i vërtetë për ta janë shpërblimet që do të marrin në jetën e amshuar. Domethënë, jo se është gjë e keqe, përkundrazi është mbarësi, që t’i trajtojmë të gjithë të barabartë në sigurimin e jetesës së kësaj bote.” – u përgjigj Ebu Bekri (radijallahu anhu).”⁵⁵

Ndjeshmëria e Omerit (r.a.)

Nashize bin Sumej el-Jezenu tregon: “Omerin (radijallahu anhu) e dëgjova kur mbajti fjalimin e mirënjohur të Xhabijes; ja se çfarë thoshte:

- “Allahu i Madhërishëm më ka caktuar mua si roje të kësaj plaçke dhe ma ka lënë mua barrën për ta ndarë atë me drejtësi. Megjithatë, ndarësi i vërtetë i saj është Allahu (duke pasur parasysh se kriteri i ndarjes së plaçkës ishte i përcaktuar në Kur’anin Famëlartë). Këtë punë unë kam menduar t’ia nis nga familja e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe ata që qëndrojnë më lart se të tjerët për nga pozita shoqërore që kanë.”

Omeri (radijallahu anhu), kur i ndau paratë, grave të Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem u dha nga dhjetëmijë secilës. Ndërsa Xhuejries, Safijes dhe Mejmunes nuk u dha aq sa u dha të tjerave. Por kur Aishja (radijallahu anha) kundërshtoi, duke thënë: “I Dërguari i Allahut na trajtonte të gjithave njësoj.”, Omeri (radijallahu anhu) u dha edhe atyre të njëjtën shumë. Mandej, Omeri (radijallahu anhu) vazhdoi të thoshte:

⁵⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1255 (8543).

- “Ndërsa tani do t’u jap atyre që mërguan të parët, sepse ne u përзумë nga atdheu ynë, të vënë përballë padrejtësive dhe armiqësisë më të ashpër që mund të tregohet ndaj një njeriu. Mandej do t’u jap myslimanëve të tjerë, më poshtë, duke pasur parasysh pozitat e tyre në shoqëri.” Ai u dha nga pesë mijë atyre mërgimtarëve që kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit, katërmijë Ensarëve dhe nga tremijë atyre që kishin marrë pjesë në luftën e Uhudit. Ai u tha se: “Ata që kanë mërguar të parët do të marrin në fillim, kurse ata që mërguan më vonë, do të marrin më pas. Të mos më gjykojë askush pse po veproj kështu. Ndoshta është më mirë të gjykojnë sadopak veten, që iu bashkuan më vonë se të tjerët karvanit të muhaxhirëve...”⁵⁶

Përgjigjja e Omerit (r.a.) ndaj kundërshtimit të djalit të tij Abdullahut

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) e pati kundërshtuar kësisoj babanë e tij:

- “Baba, Usame bin Zejdit i dhe katërmijë, kurse mua vetëm tremijë. Mirëpo, ai dhe babai i tij nuk qëndrojnë më lart sesa ne në virtyte.” Omeri (radijallahu anhu) i dha këtë përgjigje të birit:

- “I Dërguari i Allahut e donte babanë e tij më shumë seç donte babanë tënd. Kurse Usamen e donte më shumë sesa ty.”⁵⁷

Përgjigjja e Omerit (r.a.) ndaj të afërmeve të tij, të cilët donin që ai të tregonte përparësi ndaj tyre

E tregon Eslemi: “Bijtë e Adijit erdhën tek Omeri i nderuar (radijallahu anhu) dhe i thanë kështu:

- “Ti je kalifi i të Dërguarit të Allahut, ashtu siç edhe i Ebu Bekrit, sepse kalifi i të Dërguarit të Allahut ishte Ebu Bekri. Kjo është e vërteta. A nuk bën që t’i shkruash edhe ti të tjerët në radhë, ashtu siç e kanë radhën, sipas postit që kanë?” Omeri (radijallahu anhu) u nervozua dhe tha:

⁵⁶. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 4/898 (11696).

⁵⁷. Hejthemî, *Mexhmen'Z-Zenaid*, 5/260 (9772).

- “Më shikoni mua, ju bijtë e Adijit! Çfarë doni ju, t’ia hidhni paq e të jetoni më mirë sesa të tjerët, duke përfutuar nga unë, dhe që unë t’i zhbëj tërë të mirat e mia duke përmbushur interesat tuaja? Jo, nuk mund ta bëj kurrsesi atë që më kërkoni ju të bëj. Ju nuk jeni më të mirë në sytë e mi, edhe sikur në fund të radhës t’ju kenë shkruar. Nuk ka dyshim, se kur t’ju vijë radha, edhe ju do të merrni atë që ju takon. Edhe mua më duhet të ndjek të njëjtën rrugë që ndoqën edhe ata të dy që qenë në këtë pozitë përpara meje, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe Ebu Bekri (radijallahu anhu). Nëse unë shkel amanetin e tyre dhe veproj ndryshe nga ata, atëherë edhe mua nuk do të mbetet më asnjë njeri që nuk do të më kundërshtojë. Uallahi, ne në shkallët e tij, të Krenarisë së Njerëzimit, si në këtë botë, ashtu edhe në jetën e përtejme, nuk mund të ngjitemi vetëm se duke e ndjekur me përkushtim sunetin e tij. Më i madhi dhe më i nderuari ndër ne është i Dërguari i Allahut. Kurse familja e tij janë arabët më të nderuar. Nderin për të qenë më afër me të do ta kenë vetëm ata që do t’i afrohen më së shumti virtytshmërisë së tij, sepse arabët të gjitha nderimet nuk i fituan vetëm se në sajë të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ndoshta disa nga ne janë të lidhur me të në farefisni, por para shumë e shumë brezash. Dhe mes nesh dhe familjarëve të tij ka breza të tërë që na ndajnë. Madje, edhe deri tek profeti Adem (alejhis’selam) nuk na ndajnë më shumë sesa disa baballarë. E, megjithatë, uallahi, nëse në ditën e Kiametit, përpara Allahut, ata që nuk janë arabë do të kenë vetëm vepra të mira dhe arabët nuk do të jenë duarbosh, për të Dërguarin e Allahut ata joarabë do të jenë më afër se arabët me të Dërguarit e Allahut. Askush të mos i mbajë shpresat te lidhjet familjare e farefisnore. Ju përpikuni të gjithë që t’u bindeni urdhrave të Allahut, sepse fisi e soji nuk do t’ju hyjnë hiç në punë, nëse atje do t’ju mungojnë punët e mira, apo do t’ju teprojnë ato që i keni plot të meta.”⁵⁸

⁵⁸. El-Hindî, *Kenzu'l-Ummal*, 4/885 (11658).

Kthimi i Omerit (r.a.) në mendimin e Ebu Bekrit (r.a.) për ndarjen e plaçkës

Omer bin Abdullahu tregon: “Një dite të premte, Omeri (radijallahu anhu) doli të mbante një ligjëratë; lëvdoi dhe përmendi fillimisht cilësitë e përkryera të Allahut dhe na tha kështu:

- “Në vesh më kanë ardhur disa fjalë të tipit: ‘Nëse vdes Omeri, në vend të tij të vendosim aksh njeri a aksh tjetër, sepse, kur zgjodhëm kalif Ebu Bekrin u ngutëm.’ Po, uallahi, është e vërtetë, ashtu ndodhi dhe të gjithë u ngutën; kjo është e vërtetë. Por, a nuk më thoni ju mua njëherë, ‘nëse ju nuk do ta ulnit kokën e t’i bindeshit Ebu Bekrit, kujt mendoni se do të mund t’i bindeshit tjetër? Ebu Bekri (radijallahu anhu) na mësoi neve se si ndahet plaçka në mënyrë të barabartë, sepse ai përherë ashtu e ndante, me përkujdesjen më të madhe. Kurse unë, në ndarjen e plaçkës kam zgjedhur kriterin se kush ka shërbyer më shumë në rrugën e Allahut dhe atë të virtyteve. Nëse do të më gjejë në jetë viti tjetër, mendoj të kthehem te mendimi i Ebu Bekrit, sepse, tani, edhe unë mendoj se metoda e tij ishte më e mirë dhe më e mbarë se e imja.’”⁵⁹

Omeri (r.a.) i gostiste veçanërisht besimtarët që Profeti ynë i dashur i donte më shumë

E tregon Aishja (radijallahu anha): “Omerit (radijallahu anhu) i kishin sjellë dhuratë një pako. Ata që ishin afër Omerit (radijallahu anhu) e kishin hapur, kishin parë se çfarë kishte brenda në të dhe e kishin pyetur:

- “E kujt është kjo?”

- “A do të më lejoni që këtë t’ia dërgoj Aishes (radijallahu anha), sepse i Dërguari i Allahut atë e donte shumë?”, – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- “Patjetër, t’ia çosh!”, – i thanë ata.

Pakon ma sollën mua, duke më thënë se ma kish dërguar Omeri

⁵⁹. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenaid*, 5/620 (9772).

(radijallahu anhu). E hapa menjëherë.

Kur e pa Aishja (radijallahu anhu) se ç'kishte në atë pako, filloi të lutet:

- “Pas të Dërguarit të Allahut, Zoti i fali Omerit shumë ngadhënjime njëri pas tjetrit! O Zot, mos më lër të jetoj më deri në vitin tjetër në këtë kohë, që pas kësaj të mos marr më dhuratë tjetër!”⁶⁰

Trajtimi i veçantë i Omerit (r.a.) për një luftëtar të plagosur

Abdullah bin Ubejd bin Umejri tregon: “Çdo mysliman shkonte përpara Omerit (radijallahu anhu) dhe merrte atë që i takonte për pjesë. Njëherë, Omeri (radijallahu anhu) ngriti kokën dhe pa një burrë me një shenjë të madhe të çare në fytyrë. E pyeti, se ç'e kishte atë plagë aq të madhe në fytyrë. Ai burrë i tregoi se i kishte mbetur nga lufta. Omeri (radijallahu anhu) dha urdhër:

- “Jepini njëmijë derhemë këtij burri!” Ai i mori njëmijë derhemët dhe i vërtiti nëpër duar për pak çaste. Omeri (radijallahu anhu) mendoi se atij burri i ishin dukur pak ato para, ndaj tha:

- “Jepini edhe njëmijë derhemë të tjerë!” Dhe atij njeriu i dhanë edhe njëmijë derhemë më shumë. Kjo situatë u përsërit për katër herë me radhë dhe në secilën, atij burri iu dhanë nga njëmijë derhemë. Në fund, atij i erdhi turp, kur pa se sa shumë para kishte marrë, kështu që doli e iku. Omeri (radijallahu anhu) donte që t'i flisnin më shumë rreth atij njeriu dhe kur i thanë:

- “I erdhi zor, sepse mori më shumë sesa të tjerët, ndaj edhe iku.” Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) tha:

- “Po të kishte pritur, unë do t'i kisha dhënë derisa të mbaronin fare të tëra paratë, sepse në fytyrë ai kishte një të çarë të madhe të zezë sterrë, që e kish marrë duke luftuar për Allahun.”⁶¹

⁶⁰. Hejthemi, *Mexbmen'z-Zenaid*, 5/624 (9774).

⁶¹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 3/355.

Omeri (r.a.) shpërndan gjithë pasuritë e thesarit të shtetit islam

Jahja bin Saidi përcjell nga i ati se: “Omeri (radijallahu anhu) i tha Abdullah bin Erkamin:

- “Paratë që janë pjesë e pasurisë së myslimanëve shpërndajua myslimanëve një herë në muaj, pastaj çdo të premte, pastaj çdo ditë.” Një nga bashkësia e besimtarëve u ngrit në këmbë dhe tha:

- “O Prijësi i Besimtarëve! A nuk do të ishte mirë, sikur të linim ca para në arkë për ndonjë të papritur?”

- “Më duket se të shtyn djalli që ta thuash atë fjali.” – ndërhyri Omeri (radijallahu anhu), i cili e kuptoi menjëherë.

- “Megjithatë Allahu na e ka mësuar edhe se si të përballemi me dyshimet që shejtani përpiket të na fusë në kokë. Masat që kam marrë unë për ndonjë të papritur a ndonjë fatkeqësi janë ajo përgatitje që bënte edhe vetë i Dërguari i Allahut; domethënë, të mos kursehem në bindjen time ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.”⁶²

Aliu (r.a.) ua shpërndan njerëzve të gjithë thesarin e shtetit

E tregon Antere esh-Shejbani: “Aliu (radijallahu anhu) merrte taksë prej çdo artisti a zanatçiu, por edhe nga puna e tyre. Më vonë, çdo taksë që merrte ai ua ndante njerëzve. Nuk linte asgjë për nesër në arkë, por përpiquej që si e si ta shpërndante një orë e më parë. Mirëpo, kur qëllonte që ishte shumë i ngarkuar me punë e përgjegjësi të tjera, ai nuk arrinte ta shpërndante dot, ndaj edhe thoshte:

- “Ah moj botë! Pse nuk më hiqesh e të më lësh të qetë, mos u merr me mua, shko të mashtrosh dikë tjetër!”

Ndërsa, në transmetimin e Ebu Ubejdit, i cili e përcjell atë po nga Antereja, thuhet:

- “Pata shkuar të vizitoja Aliun (radijallahu anhu). Erdhi Kanberi dhe i foli:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Kanë ardhur mallrat e taksat, duhet t'i ndash menjëherë. Mos harro, se në këto që kanë ardhur është edhe

⁶². Bejheki, *Sunen*, 6/357 (12811).

e drejta juaj dhe e familjes suaj. Ja, këtë pjesë e ndava veçanërisht për ty.”

- “Çfarë qenka ajo që e ke ruajtur veçantë për mua?”, – ia preu Aliu (radijallahu anhu).

- “Eja, të shkojmë ta shohim bashkë.”, – iu përgjigj Kanberi.

Kanberi e çoi Aliun (radijallahu anhu) në një vend ku gjendeshin shumë enë të veshura me ar dhe argjend. Një t’i parë ato, Aliu (radijallahu anhu) i tha prerazi:

- “Të të vijë turp, çfarë do ti, do që të m’i vësh zjarrin shtëpisë?” Aliu (radijallahu anhu) i peshoi ato sende të çmuara e shumë të kushtueshme dhe ua shpërndau të gjitha sa ishin atyre që ndihmonin duke u mësuar Kur’anin edhe të tjerëve.”⁶³

Talha bin Ubejdullahu e shpërndante çdo gjë pa e lënë fare të presë

Tregon Sudaja, gruaja e Talhasë: “Një ditë, Talhaja erdhi tek unë dhe m’u duk shumë i mërzitur.

- “Talha, pse je kaq i mërzitur; apo kemi bërë ndonjë gjë që ta ka shqetësuar?”

- “Jo, ti je një grua myslimane shumë e mirë! Më është mbledhur ca plaçkë dhe nuk e di se ç’të bëj me të!”, – m’u përgjigj ai. Por unë i thashë:

- “Po, nëse është kjo ajo që të mërzit, atëherë thirr të afërmit dhe miqtë e tu; të vijnë dhe ndajua atyre dhe mbaron kjo punë.” Ashtu bëri, siç i thashë, i thirri njërit prej ndihmësve të tij, që të thërriste të afërmit e tij; kishte ç’nuk kishte ua dha atyre. I tha llogaritarit:

- “Sa shpërndave?”

- “Katërqindmijë derhemë.”, – u përgjigj ai. Të ardhurat ditore të Talhasë ishin tërë-tërë njëmijë derhemë. Prandaj edhe atë e thërrisnin “Talha zemërgjeri”.⁶⁴

⁶³. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/82.

⁶⁴. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 1/112.

Shpirti i bujarisë tek Ebu Ubejde bin Xherrahu, Muadh bin Xhebeli dhe Hudhejfetu'l-Jemani

Na tregon babai i Zejd bin Eslemit: “Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) u tha njerëzve që kishte përreth, “të bëjë secili një lutje a dëshirë.” U çua dikush dhe tha:

- “Sikur të kisha një shtëpi plot me argjend, e ta jepja si lëmoshë në rrugën e Allahut!” Omeri (radijallahu anhu) e përsëriti sërish atë pyetje dhe u ngrit në këmbë edhe një tjetër dhe tha:

- “Ah sikur ta kisha shtëpinë plot me flori, e ta jepja atë në rrugën e Allahut!” Një tjetër shok i tiji tha:

- “Të kisha një shtëpi me xhevahire dhe t’i falja të gjitha në rrugën e Allahut!”

- “Thoni, thoni çfarë t’ju vijë në mendje.” – tha Omeri (radijallahu anhu). Derisa, në fund, ata thanë:

- “Nuk na vjen më asgjë tjetër në mendje.” Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) e shprehu kështu dëshirën e tij:

- “Edhe unë, do të doja të kisha një shtëpi plot me trima e bij trimash të pashoq si Ebu Ubejde bin Xherrahu, Muadh bin Xhebeli dhe Hudhejfetu'l-Jemani (radijallahu anhum) dhe t’u jepja atyre detyra për Allahun.” Më vonë, ai i dërgoi Hudhejfes një sasi të hollash, duke e porositur shërbyesin:

- “Shikoje me kujdes, çfarë do të bëjë me paratë?” Sapo ia çoi paratë shërbyesi i kalifit të të Dërguarit të Allahut, Hudhejfeja ua shpërndau ato të tjerëve, sipas nevojës. Kësaj here, Omeri (radijallahu anhu) i dërgoi të njëjtën sasi parash Muadh bin Xhebelit (radijallahu anhu); edhe ai i shpërndau paratë. I Dërgoi Ebu Ubejde bin Xherrahut (radijallahu anhu), edhe ai i ndau menjëherë. Paskëtaj, Omeri (radijallahu anhu) u tha atyre që kishte pranë:

- “A nuk ju thashë.”⁶⁵

⁶⁵. El-Hakim, *Mustedreke*, 3/252 (5005).

Botëkuptimi i Abdullah bin Omerit për të dhënë në rrugën e Allahut

Ejub bin Uail er-Rasibi tregon: “Kisha ardhur në Medinë. Një burrë, i cili ishte fqinj me Ibni Omerin (radijallahu anhu) më tha mua se Muauija i kishte dhënë Ibni Omerit katërmijë derhemë, katërmijë edhe dikush tjetër, kurse dikush tjetër i kishte sjellë dymijë derhemë dhe shumë stofra të larmishëm, kur në pazar doli dikush. Kishte dalë për të marrë tagji veresie për kafshën e tij. Unë e kuptova menjëherë, se ky njeri ishte njeri që i vinin shumë të mira e para nga anë të ndryshme. Shkova te shërbyesi i tij dhe e pyeta:

- “Dua të të pyes në lidhje me diçka; por më thuaj të vërtetën: A është e vërtetë që Ebu Abdurrahmanit (Ibni Omerit) i kanë ardhur katërmijë derhemë nga Muauija, katërmijë derhemë nga dikush tjetër dhe nga dikush tjetër dymijë derhemë dhe stofra cilësorë?”

- “Po, i erdhën!”, – u përgjigj ai.

- “Por unë e pashë atë që kishte dalë të kërkonte tagji veresie, për të ushqyer kafshët e tij.”

- “Deri në mbrëmje ai i shpërndau të gjitha paratë. Kurse, për sa u përket stofrave, ai ua dha ato me vete atyre që kishin më së shumti nevojë për to, pra i dha të gjitha në rrugën e Allahut.”

Kur i dëgjova këto fjalë, nuk durova dot dhe bërtita:

- “O tregtarë! Ibni Omerit jo më vonë se dje i dërguan dhjetë mijë derhemë, por ai prapëseprapë del prapë për të marrë borxh tagji, që të mund të ushqejë kafshët. Ç’do ta bëni ju gjithë atë pasuri që keni vënë?”⁶⁶

Dëshira e Aishes (r.a.) për të dhënë

Tregon Umu Durreja: “Aishes (radijallahu anha) i sollën njëqind mijë derhemë. Ajo i shpërndau ato të gjitha dhe atë ditë agjëronte.

- “Po sikur të kishe marrë të paktën pak mish për vete me një derhem të vetëm.”, – i thashë unë.

⁶⁶. Ebu Nu’ajm, *Hiŧje*, 1/296.

- “Të më kishe kujtuar pak më parë, ndoshta do ta kisha marrë.”,
– m’u përgjigj ajo.”⁶⁷

**Dëshira e nënës së besimtarëve, Seude binti Zem’asë,
për të dhënë në rrugën e Allahut**

Tregon Muhamed bin Sirini: “Omeri (radijallahu anhu) i pati dërguar Seudes (radijallahu anha) një torbë plot me monedha argjendi. Seudeja pyeti:

- “Çfarë janë këto?”

- “Monedha argjendi!”, – i thanë ata që ia prunë.

- “Në një thes hurmash!..”, – tha ajo e çuditur dhe ua ndau të tëra njerëzve nevojtarë.”⁶⁸

**Dëshira e nënës së besimtarëve, Zejneb binti Xhahshit,
për të dhënë në rrugën e Allahut**

Muhamed bin Ka’bi tregon: “Pjesa që i takonte Zejneb binti Xhahshit ishte diku te dymbëdhjetë mijë derhemët. Zejnebi (radijallahu anha) i mori vetëm njëherë këto para, që i takonin vetë asaj. Kur i mori, hapi duart dhe iu lut Allahut:

- “O Zoti im, mos lejo që të më vijnë më këto para, sepse një pasuri kaq e madhe nuk mund të jetë veçse një sprovë shumë e fortë për mua!” Të gjitha ato para ua ndau të afërmeve dhe shumë njerëzve të tjerë, që ishin në nevojë. Omerin (radijallahu anhu) e njoftuan se si ishte sjellë nëna jonë, Zejnebi, dhe ai tha:

- “Nga ajo grua nuk vjen asgjë, pos të mirave.”, – dhe i dërgoi asaj selamet e tij, duke i thënë se:

- “Dëgjova se i ke shpërndarë të gjitha paratë. Këtë herë po të dërgoj edhe një mijë derhemë. Por këto t’i mbash për vete, mos ua shpërnda të tjerëve.” Megjithatë, Zejnebi (radijallahu anha) nuk e dëgjoi atë, por i dha edhe ata një mijë derhemë.”⁶⁹

⁶⁷. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 8/20.

⁶⁸. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 7/721.

⁶⁹. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 7/669.

Vënia e një page për fëmijët e porsalindur

Tregon Ibni Omeri: “Në Medinë pati ardhur një grup me tregtarë; ata do të qëndronin në xhami. Omeri (radijallahu anhu) i tha Abdurrahman bin Aufit (radijallahu anhu):

- “Si thua, sikur t’i ruaje ti sonte këta tregtarë, se mos vjen ndonjë i paudhë e kërkon t’i grabisë?” Atë natë, ata qëndruan të dy, për t’i ruajtur ata tregtarë që bujtën në xhami. Teksa prisnin e bënin roje, falnin edhe namaz. Në një çast, Omeri (radijallahu anhu) dëgjoi një të qarë foshnje dhe doli të shkonte tek ai vend nga vinte ajo e qarë. Atje gjeti nënën e asaj foshnje dhe i tha:

- “Kije frikë Allahun, pse nuk kujdesesh mirë për fëmijën!” Pastaj, kur fëmija zuri të qajë sërish, Omeri (radijallahu anhu) shkoi sërish tek ajo grua dhe e qortoi sërish; pastaj u kthye te vendi i tij. Kur e dëgjoi edhe njëherë të qarën e atij fëmije, Omeri (radijallahu anhu) shkoi tek ajo grua dhe i tha:

- “Turp të të vijë, paske qenë nënë shumë e keqe! Si nuk pushoi së qari ky fëmijë gjatë gjithë natës, vetëm qau.”

- “O rob i Allahut! Sot edhe mua më shkatërroi fare ky fëmijë. Dua ta shkëpus nga gjiri, por nuk do që ta lërë.”, – iu përgjigj nëna e fëmijës.

- “E pse?”, – pyeti Omeri.

- “Sepse Omeri (radijallahu anhu) vetëm kur të shkëputet fëmija nga qumështi do të fillojë të na e japë ndihmën ditore, prandaj edhe unë dua që ta shkëpus një orë e më parë nga gjiri.”

- “Po mirë, sa vjeç është fëmija tani?”

- “Kaq muajsh.”

Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) i tha asaj gruaje:

- “Ti mos u ngut dhe mos e shkëput menjëherë nga gjiri.”, – dhe, sakaq, shkoi në xhami që t’u falte besimtarëve namazin e sabahut. Duke qenë se gjatë faljes kishte zënë të qante, Omeri (radijallahu anhu) i dilte zëri i mbytur, aq sa vështirë ta kuptojë se çfarë ishte duke thënë. Një të dhënë selam, tha:

- “Turp për Omerin! Kushedi se për vdekjen e sa e sa foshnjave myslimane është bërë shkas që ato të vdesin!”, – dhe u drejtua nga njëri prej të pranishmëve dhe e urdhëroi që të lajmëronte popullin, se që nga ai çast çdo fëmijë të lindur do t’i lidhej një rrogë e posaçme.”⁷⁰

NDJESHMËRIA E TË PARIT TË VENDIT LIDHUR ME SHPENZIMET E KRYERA NGA THESARI PËR VETEN DHE TË AFËRMIT E VET

**Ndjeshmëria që tregonte Omeri (r.a.)
kur përdorte pasurinë e thesarit**

Eslemi tregon: “Isha vetë dëshmitar kur Abdullah bin Erkami erdhi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- “O Prijësi i Besimtarëve, në shtëpi kemi një veshje të qepur nga copa më e mirë, si edhe ca enë prej argjendi. Sikur të vije kur të jesh ndopak më i lirë dhe të na japësh ndonjë këshillë.” Dhe Omeri (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Nëse më sheh që jam i lirë, atëherë eja menjëherë edhe më thirr.” Një ditë, erdhi Abdullah bin Erkami dhe i tha Omerit (radijallahu anhu):

- “Më duket se sot qenke pak i lirë.”

- “Po, sot nuk jam i zënë, por shtro diçka këtu njëherë.”, – i tha Omeri (radijallahu anhu), duke urdhëruar që sendet e çmuara për të cilat i kishte folur Abdullahu të zbrazeshin mbi atë mbulesë. Vetë qëndroi në këmbë dhe po e ndiqte me sy mbulesën e shtruar dhe me vete thoshte:

- “O Zot! Ti, në librin Tënd, na urdhërove kështu për këto mallra: - **“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.”** (Al ‘Imran, 3/14), – dhe po ashtu na mësove se: **“(Këtë përcaktim e kemi bërë) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka**

⁷⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/301.

dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë [...]” (Hadid, 57/23) Ne nuk mund të bëjmë ndryshe, përveçse të mjaftohemi me ato gjëra që Ti na i mësove se janë të bukura.

O Zot, mundësona ne, që të mund t’i shpenzojmë atje ku është më e duhura këto pasuri, se vetëm mëshira Jote mund të na shpëtojë ne nga e keqja e kësaj plaçke dhe e këtyre parave.”

Në ato çaste, aty Omerit (radijallahu anhu) i sollën djalin e tij, të cilin e quanin Abdurrahman bin Behije. I biri i kërkoi Omerit (radijallahu anhu) që t’i jepte një unazë:

- “Ik, o bir, ik tani, shko te nëna jote të të ushqejë, të të japë ndopak supë.”, – duke e dërguar, kësisoj, pa i dhënë asgjë.”⁷¹

Historia e Asim bin Omerit

Tregon Asim bin Omeri: “Kur Omeri i nderuar (radijallahu anhu) më martoi mua, ai më ndihmoi edhe veçanërisht nga thesari për një muaj me radhë. Pastaj më dërgoi fjalë me Jerfen, që ishte shërbyesi i tij dhe unë shkova menjëherë. Ja se çfarë më tha:

- “Shiko, o bir, uallahi, para se të bëhesha kalif unë besoja se pasuria e thesarit ishte e ndaluar për mua, përveç asaj pjese që më takon nga plaçka e fituar në luftë. Por, tani që u bëra kalif, nuk më duket edhe aq gabim po të marr një rrogë sado të vogël për vete, sepse kjo është detyra ime, ta ruaj këtë pasuri me kujdesin më të madh. Nga ajo që është pasuri e përbashkët, unë të dhashë ty pagesë ditore për një muaj rresht. Këtej e tutje nuk të jap dot më. Megjithatë, unë mund të të ndihmoj në njëfarë mënyre. Shko në bahçen e hurmave në Gabe, mbledhi të gjitha ato hurma dhe shiti. Pastaj, merri paratë e atyre hurmave dhe shko te ndonjë prej të afërmve tanë që merren me tregti dhe bëj tregti me të me ato para. Kur ai të blejë ndonjë gjë, merr pjesë edhe ti me paranë tënde, e kësisoj do të përballosh edhe shpenzimet e tua edhe do të mbash familjen.”⁷²

⁷¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/191 (44214).

⁷². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/869 (35998).

Një ndodhi mes Omerit (r.a.) dhe së shoqes

E tregon Malik bin Eus bin Hadethani: “Një korrier i mbretit bizantin i kishte sjellë diçka Omerit (radijallahu anhu). Bashkëshortja e Omerit (radijallahu anhu) kishte gjetur një dinar borxh dhe me të kishte blerë një erëmirë; e hodhi erëmirën në një shishe të vogël dhe ia dërgoi mbretit bizantin me korrierin që kishte ardhur. E shoqja e mbretit bizantin e zbrazti erëmirën e ardhur dhe e mbushi atë me xhevahire të vogla dhe ia ktheu prapë me korrierin. Në kohën që gruaja e Omerit (radijallahu anhu) po e zbrazte shishen mbi një copë beze, aty erdhi Omeri dhe e pyeti:

- “Çfarë janë këto?” Pasi e dëgjoi me vëmendje të gjithën çfarë kishte ndodhur, Omeri (radijallahu anhu) i dha së shoqes një dinar për të mbyllur borxhin e marrë, ndërsa xhevahiret që kishin ardhur nga bizantinët i vuri në thesarin e myslimanëve.”⁷³

Një ngjarje e Ibni Omerit me babanë e tij

E tregon vetë Ibni Omeri: “Unë bleva disa deve dhe që të kullosnin, i lashë të lira në një kullotë që ishte pjesë e pasurisë së përbashkët e të gjithë myslimanëve. Pasi hëngrën për njëfarë kohe, i mora ato dhe i çova drejt e në pazar. Omeri (radijallahu anhu), kur i pa ato deve të ngopura në pazar, pyeti:

- “Të kujt janë kështu këto deve?” Dhe njerëzit iu përgjigjën:

- “Janë të Abdullah bin Omerit.”

- “Domethënë janë të Abdullah bin Omerit, hël! Pa shikoje pa shikoje të birin e Prijësit të Besimtarëve!”, – kishte thënë nja dy herë me vete me zë të ulët. Bash në atë kohë, aty erdha edhe unë duke rendur dhe e pyeta:

- “Çfarë është, çfarë ka ndodhur o Prijësi i Myslimanëve?”

- “Ç’janë këto deve? Nga dolën?”, – më pyeti.

- “I bleva; siç bëjnë të gjithë dhe i dërgova në kullotë, për të fituar ndonjë gjë.”, – iu përgjigja unë.

⁷³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/875 (36015).

Atëherë babai u kthye nga të tjerët që ishin mbledhur përreth dhe u tha:

- “Pa hajdeni tani, merrini dhe nxirrini, kullotini e jepuni të pinë ujë deveve të të birit të Prijësit të Besimtarëve!” Dhe u kthye nga unë dhe më tha:

- “Merre, o Abdullah, merre që këtu atë që të takon, e pjesën tjetër lërta myslimanëve, se u takon të gjithëve, e nuk është e jotja!”⁷⁴

15. AS I DËRGUARI I ALLAHUT, AS SAHABËT E TIJ NUK I GËZOHESHIN PASURISË SË KËSAJ BOTE

Kur i Dërguari i Allahut, edhe kur i ofrojnë gjithë botën, e refuzon

Ibni Abasi e tregon: “Një ditë, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) gjendej në kodrën e Safasë, kur tek ai erdhi Xhibrili (alejhis’selam). Profeti ynë i tha Xhibrilit:

- “O Xhibril, unë i betohem Allahut që të ka dërguar ty me të drejtën e të vërtetën, se në shtëpinë e Muhamedit nuk ka as miell, as gjellë në vatër!” Ende pa e përfunduar mirë fjalën i Dërguari i Allahut, nga qielli erdhi një zhurmë sikur do ta çante tokën në mes. I Dërguari i Allahut u tremb dhe e pyeti Xhibrilin:

- “Çfarë ndodhi, mos vallë Allahu urdhëroi ardhjen e Kiametit?”

- “Jo, nuk është ai urdhër; Ai urdhëroi Israfilin. Israfilin e mori fjalën e Zotit dhe zbriti.” Israfilin erdhi pranë të Dërguarit Fisnik dhe e pyeti:

- “Allahu dëgjoi fjalën tënde, o i Dërguar, e më dërgoi mua me çelësat e tërë thesareve të mbarë botës. Nëse do ti, Ai më urdhëroi mua që ta kthej në ar, argjend, diamante dhe smerald tërë këtë mal të Mekës. Çfarë do ti, të jesh një profet mbret, apo një profet rob?” Në atë kohë Profetit tonë Xhibrili (alejhis’selam) i bëri me shenjë që të ishte i thjeshtë. Dhe Profeti ynë i dashur (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i ktheu përgjigje:

- “Jo, unë dua të jem një profet rob i Allahut.” Dhe këtë fjali e

⁷⁴. El-Hindi, *Kenzul-Ummal*, 12/872 (36006).

përsëriti plot tri herë.⁷⁵

Ndërsa, në një tjetër transmetim, Profeti ynë ka thënë: “Një engjëll i Zotit zbriti nga qiejt dhe më tha:

- “O Muhamed! Zoti yt të dërgon salam dhe thotë: ‘Po deshe ti, unë do ta shndërroj në ar gjithë relievin e Mekës.’” Ndërsa unë iu përgjigja:

- “Jo, o Zot, nuk dua; më mirë është që unë një ditë të ha sa për t’u ngopur dhe të të falënderoj Ty, e një ditë tjetër të jem i uritur, që të të lutem e të përgjërohem që Ti të më falësh diçka prej mirësisë e bujarisë Sate!”⁷⁶

I Dërguari i Allahut e kthen mbrapsht dhuratën që i dërgojnë idhujtarët

Tregon Urueja: “Hakim bin Hizami, para se të bëhej mysliman kishte shkuar në Jemen dhe atje kishte blerë një petk të sundimtarit të Jemenit Dhi Jezenit. Hakim bin Hizami erdhi në Medinë dhe deshë që atë rrobë t’ia dhuronte Profetit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), të cilin e kishte mik të vjetër qysh nga koha e injorancës. I Dërguari i Allahut nuk e pranoi, duke i thënë:

- “Ne nuk i pranojmë dhuratat e idhujtarëve!” – Kësodore, Hakimi nuk kishte ç’të bënte, kështu që doli dhe e shiti atë veshje të shtrenjtë, të cilën e kishte sjellë që nga Jemeni. I Dërguari i Allahut më porositi mua që të shkoja e ta blija unë atë veshje. Dhe unë shkova, e bleva, siç më tha Profeti ynë dhe ia çova. Profeti ynë e veshi dhe shkoi në xhami.”

Hakimi thotë se: “Aq shumë i kishte hije ajo veshje, saqë njeri më të bukur se ai atë ditë nuk kam parë ndonjëherë. Shkëlqente njësoj siç shkëlqen hëna e plotë.”⁷⁷

⁷⁵. Bejheki, *Sunen*, 7/49 (13105).

⁷⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 7/344 (18616).

⁷⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 5/988 (14479). Me sa duket, i Dërguari i Allahut nuk i pranonte dhuratat e idhujtarëve, pasi nuk donte që të kishte asnjë detyrim ndaj tyre, si dhe nuk donte që të ishte i detyruar të pranonte ndonjë prej kërkesave të tyre për të bërë ndonjë lëshim.

Qëndrimi i Omerit (r.a.) ndaj dhuratave

Ata bin Jesari tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i dërgoi Omerit (radijallahu anhu) një dhuratë. Mirëpo, Omeri nuk donte ta pranonte atë dhuratë. Andaj, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e pyeti, se pse nuk e pranonte dhuratën që po i bënte i Dërguari i Allahut, ai iu përgjigj:

- “O i Dërguari i Allahut, po ti a nuk na ke thënë, se ‘më i miri ndër ju është ai që nuk pranon asgjë nga askush?’”

- “Po unë e kam pasur fjalën që t’i kërkoj dikujt të të japë ndonjë gjë. Kurse kjo është diçka që po të vjen pa e kërkuar ti vetë; kjo është diçka që po ta jep e ta ka caktuar Allahu.” – i tha i Dërguari i Allahut Omerit (radijallahu anhu).

- “Unë i betohem Allahut se nuk kam për t’i kërkuar kurrë asgjë njeriu. Por, nëse më vjen pa e kërkuar unë, nuk do ta kthej, do ta pranoj.”⁷⁸

Refuzimi i shpërblimit nga Ebu Ubejde bin Xherrahu

Eslemi tregon se: “Ka qenë një vit kur u përjetua një thatësi shumë e madhe dhe Omeri (radijallahu anhu) i nisi një letër Amr bin el-Asit që asokohe ishte vali i Egjiptit dhe detyrën e dërgimit të letrës ia caktoi Ebu Ubejdes. Pasi u kthye Ebu Ubejdeja, Omeri (radijallahu anhu) i dërgoi atij njëmijë dinarë, të cilat ai nuk donte që t’i pranonte, ndaj i tha:

- “O Omer! Po ne këto shërbime nuk i japim për të fituar para, unë atje shkova në kërkim të pëlqimit dhe të kënaqësisë së Allahut. Për këtë arsye, unë nuk mund t’i pranoj këto para!”

- “I Dërguari i Allahut, sa herë që na dërgonte ne në ndonjë vend, ashtu siç të dërgova edhe unë ty, na dërgonte edhe një pagesë. Ne nuk donim ta prananim, mirëpo, ai ngulte këmbë që duhej ta prananim. Prandaj, merri këto dhe përdori si të duash, në daç për besimin, në daç për jetën tënde në këtë botë.” – i tha atij Omeri (radijallahu anhu). Kësisoj, edhe Ebu Ubejdeja i pranoi.”⁷⁹

⁷⁸. Imam Malik, *Munatta*, 2/998 (1814).

⁷⁹. Bejheki, *Sunen*, 6/354 (12795).

Refuzimi i shpërblimit nga Said bin Amiri

Zejd bin Eslemi e tregon: “Omeri (radijallahu anhu) i tha Said bin Amirit:

- “Ty populli sirian të do shumë, pse të duan kaq shumë ty ata?” Dhe Saidi (radijallahu anhu) iu përgjigj atij se ai kujdesej shumë për ta dhe përherë rrekej që t’i gjente zgjidhje çdo problemi që ata kishin. Për këtë, Omeri (radijallahu anhu) i dha atij dhjetëmijë dinarë. Kurse ai nuk ia pranoi, duke i thënë:

- “Nuk kam nevojë unë për to, unë kam kuaj, kam edhe skllevër e shërbyes. Pastaj, më e rëndësishmja, unë nuk e kam marrë këtë detyrë përsipër për para, por që t’u vij në ndihmë e t’u shërbej myslimanëve.”

- “Mos u ngut kur vendos. Shikomë mua, se do të të tregoj një fjalë që ma ka thënë vetë i Dërguari i Allahut, pastaj bëj si të duash, në daç merri, në daç mos i merr, e di vetë ti.”, – i tha Omeri (radijallahu anhu).

I dërguari i Allahut më pati dhënë diçka dhe unë nuk desha ta pranoja. Atëherë, ai më pati thënë:

- “*Merre kur dikush ta jep diçka që nuk e ke dashur e nuk e ke kërkuar vetë, sepse ajo është diçka që ta ka dhënë e ta ka caktuar Allahu.*”

- “Vërtet, nga ai e ke dëgjuar ti këtë?”, – pyeti Said bin Amiri (radijallahu anhu)” Omeri i nderuar tha:

- “Po!” Dhe ai pranoi menjëherë t’i merrte paratë që i kish dhënë kalifi i të Dërguarit të Allahut.”⁸⁰

Abdullah bin Sa’di donte që t’u shërbente njerëzve pa u paguar për atë që bënte

Abdullah bin Sa’di erdhi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe Omeri (radijallahu anhu) i tha:

- “Me sa kam marrë vesh, ti do që t’i ndihmosh njerëzit e t’u shërbesh atyre në punët që mund të kenë, por jo vetëm kaq, por edhe ke refuzuar që të paguhesh për këtë, hë, kështu është e vërteta?”

⁸⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/938 (17155).

- “Po, e vërtetë është.”, – u përgjigj ai.

- “Po pse do që ta bësh këtë?”, – vazhdoi ta pyeste Omeri (radijallahu anhu).

- “Unë kam kuaj, kam edhe sklevër. Jam shumë mirë nga gjendja ekonomike. Prandaj dua dhe shpresoj që shërbimi në rrugën e Allahut të jetë një sadaka në rrugën e Allahut.”

- “Shiko, mos bëj kështu. Njëherë e një kohë edhe unë kam qenë kështu, si ti. Kur i Dërguari i Allahut donte të më paguante për një punë që kisha bërë, unë i thosha: ‘Po t’ia kishit dhënë më mirë ndonjë nevojtar...’ Megjithatë, ai këmbëngulte e m’i jepte prapë; unë i thosha: ‘Po t’ia kishit dhënë ndonjë nevojtar më mirë...’, e nuk doja që t’i merrja. Gjersa, në fund, një ditë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më porosi duke më thënë kështu:

- “*Merri këto, pastaj në daç mbaji për vete e përdori si të duash, në daç shpërndajua të varfërve si lëmoshë. Dhe parinë merre gjithmonë, për sa kohë që nuk e ke dashur e nuk ia ke kërkuar vetë njerëzve. Kurrë mos rend ti pas pasurisë.*”⁸¹

Refuzimi i shpërblimit nga Hakim bin Hizami

Hakim bin Hizami tregon vetë: “Unë i kërkoja diçka të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe ai ma dha. I kërkoja edhe njëherë tjetër, për herë të dytë, e prapë më dha. Më dha edhe kur i kërkoja për herë të tretë, derisa, më në fund, më tha:

- “Shiko, o Hakim, gjërat e kësaj bote janë të dashura dhe fillojnë e të duken të ëmbla e të mira. Kush i merr dhe i shijon ato me zemrën të mbështjellë prej bujarisë dhe i përdor ato më së miri, edhe begatia e tyre shtohet edhe më shumë. E, kushdo që ngarend pas saj, gjithë lakmi, e siguron dhe e përdor atë në mënyrë të keqe, atëherë ikën edhe begatia e asaj pasurie. Këta lloj njerëzish i ngjajnë një tamahqari e lakmitari që ha e ha, por nuk ka të ngopur. Dora që jep qëndron përherë më lart se dora që merr.”

Në vijim ai që e transmeton këtë thotë kështu: “Ebu Bekri

⁸¹. El-Hindi, *Kenzul-Ummal*, 6/938 (17154).

(radijallahu anhu) e thërriste Hakim bin Hizamin për t'i dhuruar diçka, mirëpo Hakimi nuk e pranonte dhuratën. Kur u zgjodh kalif, edhe Omeri (radijallahu anhu) deshi që t'i dhuronte diçka dhe ai nuk e pati pranuar. Hakimi (radijallahu anhu) nuk e pati pranuar as dhuratën e tij. Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) pati dalë përpara njerëzve, për t'u thënë:

- “O njerëz, ja ku jeni edhe ju dëshmitarë: dua t'i jap edhe Hakimit një pjesë nga plaçka e luftës; ai nuk pranon që ta marrël”

Vërtet, Hakimi, pas ndarjes nga jeta të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), jo vetëm që nuk pranoi asgjë nga askush, por ai nuk pranonte as ato gjëra që ia dërgonin si dhuratë.”⁸²

Refuzimi i shpërblimit nga Amir bin Rabia

Tek Amir bin Rabia kish ardhur për mysafir një beduin. Amiri që përkujdesur shumë mirë për të. Prandaj, ky beduin kishte shkuar tek i Dërguari i Allahut, që t'i kërkonte ndonjë gjë për t'ia dhënë Amirin dhe që kthyer tek ai dhe i pati thënë:

- “Unë i kërkoja të Dërguarit të Allahut, që të ma jepte mua një ngastër toke, e cila është shumë e mirë. Dhe ai ma dha mua atë vend; vetëm se një pjesë të saj unë dua të ta dhuroj ty. Të përfitoni edhe ti me djemtë e tu prej saj.” Amiri iu kthye bedunit:

- “Më shiko mua, unë nuk kam nevojë për atë tokë që do të më japësh ti, sepse sot u zbrit një sure e Kur'anit, e cila na e tërhoqi vëmendjen larg kësaj bote: **“Po u afrohet njerëzve dita për të dhënë llogari, por ata vazhdojnë të jenë të shkujdesur e të shmangur** (nga e vërteta).” (Enbija, 21/1)⁸³

Refuzimi i shpërblimit nga Ebu Dherri

Tregon Ebu Bekr bin Munkediri: “Valiu i Sirisë, Hubejb bin Meslemeja i pati dërguar Ebu Dherrit treqind dinarë, me porosinë:

- “T'i përdorësh për ndonjë nevojë që mund të kesh.” Megjithatë,

⁸². El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 6/924 (17116).

⁸³. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/179.

Ebu Dherri e pati pritur atë që i shpuri paratë me fjalët:

- “Ktheji andej nga i more ato. Ata që të dërguan, nuk gjetën ndokënd më të hutuar e më të devijuar nga Allahu? Shyqyr Zotit, unë kam edhe shtëpi, edhe një kopsht ku mund të kaloj të nxehtë e diellit. Nëpër fusha ne kemi kushedi sa e sa skllevër të liruar e robinja, të cilët kullotin delet tona me dëshirën e tyre. Më shumë se kaq, unë kam frikë, nuk ia jap dot llogarinë Allahut!”⁸⁴

Ndërkohë, sipas një përcjelljeje tjetër që i bëhet kësaj ndodhie, Ebu Dherri kishte dyzet dërhëmë, dyzet dele dhe dy shërbyes.”⁸⁵

Refuzimi i shpërblimit nga Abdurrahman bin Ebu Bekri

Ibrahim bin Muhamed bin Abdulaziz bin Omer bin Abdurrahman bin Aufi tregon: “Muauija i dërgoi Abdurrahmanit, i cili nuk pranonte t’i lidhte besë djalit të tij Jezidit, njëqindmijë dërhëmë. Abdurrahmani nuk pranoi t’i merrte dhe i tha:

- “Nuk e shes dot fenë time unë për këtë botë që nuk vlen qindarkën!” Shkoi në Mekë dhe jetoi atje gjer në ditën kur u nda nga kjo jetë.”⁸⁶

Refuzimi i shpërblimit nga Abdullah bin Omeri

Mejmun bin Imrani tregon se: “Muauija dërgon dikë tek Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu). Njeriu që i dërgoi ishte Amr bin Asi dhe ky i propozoi:

- “A do t’i betohesh edhe ti atij që e kanë parapëlqyer të gjithë në një mendje si kalif? Nëse lidh besën me të, atëherë do të të jepen pasuri dhe ara pa fund, që të të mjaftojnë ty e fëmijëve të tu.”

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) e dëgjoi dhe ja se ç’përgjigje i ktheu Amr bin Asit:

- “Turp të të vijë, ik tani e mos u kthe më! Feja ime nuk blihet dot nga floriri dhe argjendi juaj. Ik, se unë dua të shkoj më se i pastër në jetën e përtejme.”⁸⁷

⁸⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/161.

⁸⁵. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 9/551 (15826).

⁸⁶. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/542 (6015).

⁸⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/164.

Refuzimi i shpërblimit nga Abdullah bin Erkami

Amr bin Dinari tregon: “Osmani (radijallahu anhu) e emëroi Abdullah bin el-Erkamin si kujdestar të thesarit, pasurisë së përbashkët të mbarë myslimanëve. Si pagesë, ai i caktoi atij shumën prej treqindmijë derhemësh, vetëm se Abdullahu nuk pranoi që të paguhej për punën e bërë, ndaj i tha:

- “Unë nuk kam ardhur këtu për asgjë tjetër, veçse për të punuar për hir të Allahut.”⁸⁸

Refuzimi i shpërblimit nga Amr bin Numan bin Mukarrinit

E tregon Muauije bin Kurreja: “Njëherë unë shkova si mik tek Amr bin Nu'man bin Mukarrini (radijallahu anhu). Në të hyrë të Ramazanit, aty erdhi dikush që kish sjellë një trastë me para dhe i tha Amrit:

- “Kam ardhur të të sjell përshëndetjet e valiut tonë, Mus'ab bin Zubejrit. Ai më tha që t'ju them se: “Ne nuk lëmë pa mbështetje, asnjë nga lexuesit më të mirë të Kur'anit. T'i pranojë këto para dhe të përmbushë ndonjë nevojë që mund të ketë.” Amri i dha përgjigjen:

- “Thuaji atij, që unë i them se, ‘uallahi, ne nuk e lexojmë Kur'anin për të fituar para!’”, – dhe, sakaq ia ktheu mbrapsht paratë.”⁸⁹

Qëndrimi i Aishes (r.a.) dhe i motrës së saj Esmasë (r.a.) kur dikush u dhuronte ndonjë gjë

Abdullah bin Zubejri tregon: “Kutejleja, e shoqja e Ebu Bekrit (radijallahu anhu), që nuk ishte bërë ende myslimane kishte përgatitur diçka për të ngrënë për të bijën, Esmanë, dhe ia pati sjellë si dhuratë. Esmaja (radijallahu anha) nuk desh i t'i pranonte, madje nuk desh i as që t'i fuste në shtëpi. Aishja (radijallahu anha) pyeti Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe, enkas për këtë çështje u zbrit pastaj ky ajet:

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre

⁸⁸. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 4/4.

⁸⁹. Darimi, *Sunen*, 1/153 (585).

që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” (Mumtchine, 60/8)

Nisur nga ky ajet i Dërguari i Allahut i urdhëroi Esmasë që ta pranonte dhuratën që i kishte sjellë dhe ta fuste nënën brenda.”⁹⁰

Aishja (r.a.) dhe një grua e varfër

Aishja (radijallahu anha) rrëfen: “Tek unë erdhi një grua shumë e varfër. Në dorë kishte ca gjëra që m’i kish sjellë mua si dhuratë. Më erdhi keq, kur e pashë në atë gjendje dhe nuk m’u duk aspak e drejtë që ta pranoja dhuratën që më kishte sjellë. Por, Profeti ynë i dashur (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më tha:

- “*Aishe! Pse nuk ia pranon dhuratën, e ti t’i japësh diçka me të njëjtën vlerë në këmbim? Në mos, do ta mërzhitësh, sepse do të mendojë se e ke nënvlerësuar. O Aishe, ji e thjeshtë, sepse Allahu i do ata që janë të thjeshtë, kurse ata që janë mendjemëdhenj, Allahu i privon nga dashuria e Tij.*”⁹¹

Ruajtja nga zgjatja e dorës të tjerëve

Ebu Said Hudriu tregon: “Ne ishim në një gjendje shumë të vështirë ekonomike. Familja më ngarkoi mua, që të shkoja tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe t’i kërkoja të më jepte gjëkafshë. Kur dola përpara të Dërguarit të Allahut, fjalja e parë që dëgjova ishte kjo:

- “*Kushdo që e ka zemrën plot, të ngopur, dhe nuk e lakmon këtë botë, Allahu e pasuron atë. Njësoj siç e përnderon këdo që përpiqet që ta ruajë të pastër nderin e vet. Ne nuk i mbajmë asgjë, po të kemi ia japim, kujtdo që na kërkon diçka.*” Një të dëgjuar këtë fjali, u ktheva menjëherë pa i thënë e pa i kërkuar asgjë. Nuk kaloi shumë kohë dhe gjendja jonë u përmirësua, ishim më mirë. Aq më mirë ishim, saqë mund të them se ishim ndër më të pasurit në mesin e ensarëve.”⁹²

⁹⁰. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/4 (16156).

⁹¹. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 4/204.

⁹². Ebu Ja’la, *Musned*, 2/367 (1129).

Shqetësimi për ahiretin nga pasuria shumë e madhe e kësaj bote

Ukbe bin Amiri tregon: “I Dërguari i Allahut, afro tetë vjet pasi kishte ndodhur Uhudi, u lut për të rënë në atë luftë; teksa lutej ai dukej sikur u thoshte ‘përshëndetjet e Zotit’ të gjithë, me të gjallë e me të vdekur. Pastaj, ngjiti shkallët e minberit dhe iu drejtua njerëzve:

“Unë jam këtu, përpara jush; edhe pak ka mbetur dhe do të vij të takohem me ju. Do të shoh se çfarë bëni, si keni qenë. Do të takohemi te Burimi i Keutherit. Ja, tani jam, këtu ku jam, e shoh mjaft mirë Keutherin.

*O njerëz! Unë nuk shqetësohem më se ju mund të bini në idhujtari. I vetmi shqetësim që unë kam për ju, është se mos ju filloni të garoni me njëri-tjetrin se kush e kush të bëhet më i pasur dhe filloni ta doni të fituarin e parave më shumë se ç’dubet dhe në mes jush hyn përçarja.”*⁹³

Çfarë i tha i Dërguari i Allahut Ebu Ubejdes teksa ky kthehej nga Bahrejni

E tregon Amr bin Auf el-Ensari: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e pati dërguar Ebu Ubejden në Bahrejn për të mbledhur taksat. Ebu Ubejdeja i kishte mbledhur të gjitha dhe u kthye në Medinë. Ensarët, një të dëgjuar se ishte kthyer Ebu Ubejdeja (radijallahu anhu), pasi falën namazin e sabahut me të Dërguarin Fisnik, u ndalën aty ku do të kalonte Ebu Ubejdeja kur të kthehej, por edhe që i Dërguari i Allahut t’i shihte e t’u jepte edhe atyre ndonjë gjë. I Dërguari i Allahut e kuptoi mesazhin e kësaj sjelljeje, buzëqeshi dhe u tha:

- “Ma merr mendja, se keni dalë ngaqë keni marrë lajmin se po vjen Ebu Ubejdeja bashkë me plaçkën që ka marrë në Bahrejn.”

- “Po, o i Dërguari i Allahut.”, – i thanë ata. Atëherë, i Dërguari i Allahut iu drejtua atyre me këto fjalë:

- “Po, s’bëni për ju. Ashtu është, ju mund të prisni, se do të merrni shumë gjëra që do t’ju gëzojnë zemrën. Ç’është e vërteta, unë nuk jam i shqetësuar se ju mund të mbeteni të varfër, por se mos bota ju buzëqesh edhe juve, ashtu siç u pati buzëqeshur edhe atyre që erdhën përpara jush, duke ju bërë që të filloni e të garoni

⁹³. Buhari, *Sahib*, 4/1486 (3816).

*e të shtyni njëri-tjetrin, që kush e kush të ftojë më shumë dhe t'ju shpjerë edhe ju drejt shkatërrimit pa kthim, siç tërboqi ata që ishin përpara jush dhe i rrokullisi në gropën e rrënimit!*⁹⁴

Frika e Omerit (r.a.) nga pasuria e kësaj bote dhe lotët e tij

Hasan Basriu tregon: “Pas luftës së Kadisijes, Omerit (radijallahu anhu) i sollën dhe i vunë përpara byzylykët dhe qyrkun e Kisras. Në mesin e atyre që ishin të pranishëm në ato çaste ishte edhe Suraka bin Malik bin Xhu’shumi. Omeri (radijallahu anhu) ia dha atij të dy byzylykët e Kisras. Ai i vuri ato në kyçet e dorës, por duke qenë se ishin shumë të gjerë, iu zgjatën deri drejt bërrylit. Omeri (radijallahu anhu) e pa njëherë Surakan dhe tha:

- “LëvdUAR qoftë Allahu, që dy byzylykët e Kisras tani i ka në dorë Suraka bin Maliku, beduin nga bijtë e Mudlixhit.” Mandej vazhdoi të thoshte:

- “O Zot, unë e di, i Dërguari Yt Fisnik donte shumë që të fitonte nga pasuria e kësaj bote dhe ta shpenzonte atë në rrugën Tënde. Mirëpo, Ti deshe më shumë se kaq, nuk i dhe atij mundësi që ai të pasurohej me plaçkën e kësaj bote.

O Zot, po ashtu unë e di, se edhe Ebu Bekrit i pëlqente shumë që, çfarë t’i binte në dorë ta jepte për robt e Tu. Por, Ti prapë mendove atë që ishte më e mirë dhe më e mbarë për të dhe nuk e bëre shumë të pasur.

O Zot! Kam shumë frikë, se kjo pasuri dhe plaçkë lufte kaq e madhe duhet të jetë ndonjë sprovë për Omerin e ngratë. Çfarë është kjo, mos vallë është ndonjë qortim hyjnor për mua, e nuk kam se kujt t’i kërkoj të më ndihmojë veç Teje.”

Mandej, Omeri (radijallahu anhu) këndoi ajetin: “**A mos mendojnë ata që Ne, duke u ardhur në ndihmë me pasuri dhe djem, po nxitojmë drejt tyre me të mira?! Kurrresi, por ata nuk janë të vetëdijshëm (për këtë).**” (Mu’minun, 23/55-56)⁹⁵

⁹⁴. Buhari, *Sabih*, 4/1473 (3791).

⁹⁵. Bejheki, *Sunen*, 6/358 (12813).

Abdurrahman bin Aufi qante karshi pasurisë së kësaj bote

Abdurrahman bin Aufi tregon vetë: “Omeri (radijallahu anhu) dërgoi dikë për të më thirrur. Vrapova menjëherë të shkoja për tek ai. Kur arrita te porta, nga brenda dëgjova një të qarë me ngashërim.

- “In’na lil’lahi ue in’na ilejhi raxhiun, Prijësit të Besimtarëve do t’i ketë ndodhur ndonjë gjë e keqe!”, – thashë me vete dhe hyra brenda menjëherë. E kapa nga supet dhe e pyeta:

- “Çfarë ka bërë vaki, o Prijësi i Besimtarëve?”

- “Ç’te ndodhë më shumë, më ka rënë gjëma mbi kokë!”, – tha dhe më mori me vete për në dhomën e tij. Në dhomën e tij kishte thasë të tërë plot e përplot njëri mbi tjetrin.

- “Familjen e Omer bin Hatabit tani e mori lumi! Po të donte Allahu, gjithë këtë pasuri mund t’ia kishte dhënë edhe Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) në fillim, ose Ebu Bekrit më vonë, sepse mua rrugën që duhet të ndjek ata ma mësuan, duke më lënë shembull vetë jetën e tyre.” – më tha.

- “Po mirë, eja të ulemi, të mendohemi dhe të vendosim, ç’do të bëjmë me to.” – i thashë unë. Vendosëm, që t’u jepnim nga katërmijë derhemë nënave të mbarë besimtarëve, nga katërmijë t’u jepnim edhe muhaxhirëve dhe ensarëve, kurse të tjerëve t’u jepnim nga dymijë derhemë. Kësisoj arritëm t’i ndanim gjithë ato para.”⁹⁶

Ballafaqimi i Abdurrahman bin Aufit me egon e vet për pasurinë e tij

Sa’d bin Ibrahim na përcjell nga i ati: “Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu) agjëronte atë ditë. Pak para akshamit i sollën ushqime, që të çelte iftarin. E pa njëherë ushqimin dhe tha kështu:

- “Mus’ab bin Umejri (radijallahu anhu) ishte më i mirë se unë, prandaj ra dëshmor; edhe qefin nuk kishte për të, e mbuluan me një copë. Kur përpiqeshin t’i mbulonin këmbët, i zbulohej koka; kur i mbulonin kokën i zbulohehin këmbët. Kështu ndodhi edhe me

⁹⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 4/894 (11684).

Hamzanë (radijallahu anhu), ra dëshmor, sepse ishte më i mirë se unë. Tani që bota na buzëqeshi dhe u bëmë të pasur... Kam frikë se mos ky është shpërblimi i të mirave që kemi bërë dhe po na jepet që në këtë botë.”, pastaj filloi të qajë dhe nuk hëngri gjë prej gjëje nga ato që i kishin shtruar përpara.”⁹⁷

Pyetja që i bën Abdurrahman bin Aufi

Ummu Selemes dhe përgjigja e saj

Umu Selemeja (radijallahu anha) tregon: “Abdurrahman bin Aufi shkoi për vizitë tek Umu Selemeja dhe i tha:

- “Nënokja ime, kam shumë frikë se kjo pasuri që kam do të më rrënojë të tërin, sepse unë jam më i pasuri në të gjithë kurejshët.”

Nëna jonë, Umu Selemeja e këshilloi duke i thënë këto fjalë:

- “Shiko, o bir, shpërndajua pasurinë tënde edhe të tjerëve, sepse mua i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më ka thënë: *‘Nga sahabët e mi ka të atillë, që kur të iki unë e të mos jem më mes tyre, ata nuk do të më shohin dot më kurrë.’* Abdurrahman bin Aufi doli me një frymë jashtë i tmerruar dhe në rrugë u takua me Omerin (radijallahu anhu). Ia përcolli edhe atij hadithin që i kishte treguar Umu Selemeja. Omeri (radijallahu anhu) vrapoi fill e për tek Umu Selemeja dhe e pyeti:

- “Vërtet, ashtu ka thënë i Dërguari i Allahut? Vallë mos jam edhe unë një prej atyre që nuk do ta takojnë më kurrë të Dërguarin e Allahut?”

- “Jo, ti nuk je, por për ata që do të vijnë pas teje nuk di ç’të them!”, – i tha Umu Selemeja (radijallahu anha) për ta qetësuar.”⁹⁸

Ballafaqimi i Habab bin Eretit me egon e vet

për pasurinë e vënë në këtë botë

Habab bin Ereti tregon vetë: “Njëherë, ne u nisëm bashkë me të Dërguarin e Allahut në një udhëtim. Dhe vetëm Allahu ka për të na e dhënë shpërblimin e atij mërgimi. Por ç’e do, që shumë nga shokët tanë ikën e mërguan nga kjo botë shumë herët, pa parë e pa ngrënë asgjë

⁹⁷. Buhari, *Sabih*, 1/428 (1216).

⁹⁸. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zeuaid*, 9/73 (14449).

prej shpërblimit të atij mërgimi. Për shembull, Mus'ab bin Umejri. Ai, kur ra dëshmor në luftën e Uhudit, me vete nuk kish asgjë, përveç asaj këmishë të hedhur mbi trup. Kur do ta varrosnim, ne e mbuluam me atë këmishë si qefin, mirëpo, kur i mbulonim kokën, atij i zbuloheshin këmbët dhe kur i mbulonim këmbët, i zbuloheshin koka. Derisa, në fund, i Dërguari i Allahut na tha:

- “T’i mbulojmë kokën, kurse këmbët t’ia mbulojmë me gjethe idhkhiri.” Kurse, sot, ne po mbledhim frutat e shërbimit të tyre të pashembullt.”⁹⁹

Ballafaqimi i Selman Farisiut me egon e vet për pasurinë e tij

Ja se si e tregon Amir bin Abdullahu: “Në çastet e fundit të jetës, pak para se të ndahej nga kjo jetë, ne e pamë Selman Farisiun shumë të shqetësuar dhe të tensionuar, ndaj edhe e pyetëm:

- “Çfarë të shqetëson kaq shumë, o Ebu Abdullah, pse po qan? T’i ke një të shkuar të lavdishme me kushedi sa e sa shërbime të mira e të hairit për të gjithë besimtarët. Ke luftuar bashkë me të Dërguarin e Allahut në sa e sa luftëra dhe keni dalë sa e sa herë ngadhënjimtarë.”

- “Unë nuk po qaj as se jam shumë i lidhur me këtë botë, as se nuk dua që të shkoj në atë botë. Ajo që më shqetëson dhe më bën të qaj është se i Dërguari i Fisnik na paralajmëroi kushedi se sa herë prerazi, madje ne i dhamë edhe fjalën; Ai na pati thënë: *“Ju mjafton aq ushqim sa ç’i duhet edhe një udhëtar i gjatë rrugës.”*

Kur vdiq Selmani, u mbledh pasuria e tij dhe të gjithë e panë se vlera e saj ishte pesëmbëdhjetë derhemë gjithsej.”¹⁰⁰

Ebu Ubejde bin Xherrahu i kërkon llogari vetes për pasurinë e vënë

Kur u sëmur Ebu Ubejdeja, dikush erdhi për vizitë dhe e gjeti duke qarë, andaj e pyeti:

- “Pse qan, o Ebu Ubejde?” Ebu Ubejdeja (radijallahu anhu) i përgjigjet:

⁹⁹. Buhari, *Sahih*, 3/1415 (3684).

¹⁰⁰. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, 7/76 (34312); Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/197.

- “Ja përse qaj: Një ditë, i Dërguari i Allahut na dha sihariqin se Allahu i Madhërishëm do të na falte ne fitore e ngadhënjime të shumta dhe prej tyre myslimanët do të fitonin shumë plaçkë e pasuri. Ndërkohë, tha që ne do të ngadhënjënim edhe mbi Sirinë dhe u kthye nga unë e më foli:

- “*Shiko, o Ebu Ubejde! Nëse do të kesh jetë dhe do t'i shohësh edhe ti ato ditë, ta dish: tre shërbyes dhe tri kafshë rrugë të mjaftojnë. Njëri të të shërbejë ty, njëri të të shoqërojë kur të nisesh për rrugë, kurse tjetri t’ju ndihmojë me punët e familjes. Njëra nga kafshët që t’i hipësh ti, tjetra për të mbajtur barrët, kurse tjetra le të jetë për shërbyesin.*” Mirëpo, tani unë po shoh se shtëpia më është mbushur plot me shërbëtorë, kurse hauri përplot me kafshë. Si të dal unë kështu përpara Resulullahut tim të dashur? Ai na pati dhënë edhe një porosi si amanet, e cila ishte: “*Nga ju, më i dashur dhe më i afërt për mua është ai që kur unë të largohem prej jush, tek unë do të vijë i njëjtë, ashtu siç e kam lënë unë.*”¹⁰¹

16. QËNDRIMI ASKETIK NDAJ KËSAJ BOTE I PROFETIT TONË DHE I SAHABËVE TË TIJ

Jeta e Resulullahut në boshtin e veçimit nga jeta e kësaj bote

Ibni Abasi tregon: “Omeri (radijallahu anhu) erdhi njëherë te Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e gjeti atë duke fjetur mbi një shtrojë kashte. Ajo shtrojë i kishte lënë shenja në trupin e tij të bekuar. Kur e pa Omeri (radijallahu anhu), i tha:

- “O i Dërguari i Allahut, a nuk bën të përgatitësh një shtrat pak më të butë për veten?” Resulullahu e dëgjoi dhe iu përgjigj, duke i thënë këto fjalë:

- “*Unë nuk kam kurrfarë lidhjeje me këtë botë! As nuk do të jem i përvetshëm në këtë botë. Unë jam pors i udhëtar, i cili është nisur për rrugë në një ditë shumë të nxehtë vere dhe ndalet nën hijen e ndonjë peme, për t’u çlodhur dhe pastaj ngrihet e vazhdon rrugën për ku është nisur.*”¹⁰²

Ibni Omeri tregon: “Ne po ecnim bashkë me të Dërguarin e Allahut. Gjatë rrugës ne patëm hyrë nëpër kopshtet me hurma të

¹⁰¹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/195 (1696).

¹⁰². Hejthemî, *Mexhmu’at-Zenaid*, 10/587 (18299).

njërit prej ensarëve dhe Profeti ynë filloi të hante ndonjë hurmë nga ato që binin nga pemët. Ai më tha mua:

- “O *Ibni Omer*, po ti pse nuk ha?” Ndërkohë, unë iu përgjigja:

- “Nuk kam oreks, o i Dërguari i Allahut!”

- “Kurse unë jam i uritur, sepse kam katër ditë që nuk kam vënë asgjë prej gjëje në gojë. Po të doja, i lutesha Allahut dhe Ai më jepte gjithë salltanetin e Kajserit dhe të Kistrës. O *Ibni Omer*, imagjino se në ç’gjendje katandisesh kur jeton në një shogëri, ku njerëzit beqim mënjanë ushqimin e një viti të tërë dhe besimi u është dobësuar fare!”

Ibni Omeri thotë se: “Uallahi, shumë pak kohë pati kaluar nga ajo ndodhi, kur nga Allahu u zbrit ajeti: **“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.”** (Ankebut, 29/60) Fill pas shpalljes së këtij ajeti, i Dërguari i Allahut tha:

- “*Allahu nuk më ka urdhëruar mua të grumbulloj pasuri, apo që t’u bindem dëshirave të mia. Ai që grumbullon pasuri, sikur të ishte i sigurt se do të jetojë përjetësisht në këtë botë, ta dijë mirë se kjo jetë është vetëm në dorën e Allahut. Unë dua t’jua bëj me dije: Unë nuk grumbulloj kurrë as dinarë, as dërbemë dhe as nuk lë ushqim për nesër.*”¹⁰³

Një transmetim i Aishes (r.a.) për këtë çështje

Aishja (radijallahu anha) tha: “Të Dërguarit të Allahut i sollën diçka për të pirë, ishte një përzierje me qumësht dhe me mjaltë. I Dërguari i Allahut tha:

- “*Këtu ka dy pije dhe dy përbërës, nuk e dua. Mos më keqkuptoni, nuk po ju them që kjo është e ndaluar. Por jam i shqetësuar, se, në ditën e Kiametit, mund të më duhet të jap llogari për të. Unë duhet të sillem sa më thjesht përpara Allahut. Allahu e lartëson këdo që tregobet i thjeshtë për hir të Tij, ashtu siç edhe e poshtëron atë që tregobet me të madh. Kushdo që zgjedh për veten rrugën e mesme, atë të ekonomisë, Allahu atij ka për t’i dhënë një pasuri shumë të madhe, si materiale, ashtu edhe shpirtërore. Allahu i do shumë ata që e përmendin shpesh vdekjen.*”¹⁰⁴

¹⁰³. Ibn Kethir, *Tefsir*, 3/420.

¹⁰⁴. Hejthemî, *Mexhmen’-Zeuaid*, 10/585 (18294).

Asketizmi i Ebu Bekrit (r.a.) dhe qëndrimi i tij karshi jetës së kësaj bote

Zejd bin Erkami tregon: “Ebu Bekri (radijallahu anhu) pati kërkuar pak ujë. Në vend të ujit atij i sollën sherbet të përgatitur me mjaltë. Sapo e çoi te buzët dhe do të pinte, ai filloi të qajë. Ne menduam se kushedi se ç’kish ndodhur dhe e kishim të vështirë që ta pyesnim. Kur u qetësua, ne e pyetëm:

- “O kalifi i Resulullahut! Çfarë ndodhi, që të bëri për të qarë?” Sakaq, Ebu Bekri (radijallahu anhu) filloi të na tregojë:

- “Një ditë ishim bashkë me Profetin tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ç’të shihja, pashë Resulullahun që bënte sikur të ishte duke përzënë diçka! Mirëpo unë nuk shihja asgjë prej gjëje aty, veç nesh. E pyeta:

- “O Resulullah, më duket sikur diç do që të përzësh; por unë nuk pashë asgjë!”

- “*Ishte bota, u përpoq të më bindte, që unë ta pranoja; e unë i thashë: ‘M’u hiq sysh, larg prej meje!’*, atë po përzija. Kur po e përzija, bota më tha: *‘Ti nuk ke për të më kuptuar fare mua.’*”

Ebu Bekri thotë se: “Kjo botë më la një mbresë shumë të fortë. Përherë kam pasur shumë frikë se mos shkel ndonjë nga këshillat e tij dhe kjo botë ia del të më mashtrojë.”¹⁰⁵

Asketizmi i Omerit (r.a.) dhe qëndrimi i tij karshi kësaj jete

Salim bin Abdullahu tregon: “Kur në krye të kalifatit u zgjodh Omeri (radijallahu anhu), filloi të më paguhej edhe mua e njëjta rrogë që i ishte paguar edhe Ebu Bekrit gjër në atë kohë. Njëherë, Omeri (radijallahu anhu) pati ngelur shumë ngushtë, madje një grup muhaxhirësh, Osmani, Aliu dhe Zubejr bin Auami (radijallahu anhum), u mblodhën dhe biseduan me njëri-tjetrin për të gjetur ndonjë zgjidhje. Zubejri u propozoi atyre:

- “Sikur t’i themi Omerit dhe t’ia rritim pak rrogën.” Kurse Aliu

¹⁰⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/30.

(radijallahu anhu) tha:

- “Kam shumë shpresë, se Omeri do ta pranojë këtë vlerësim.” Aty, u ngritën të tre dhe u nisën për tek Omeri (radijallahu anhu). Ndërkohë, Osmani (radijallahu anhu) u tha atyre:

- “Sikur nuk e njihni ju Omerin! Ne këtë propozim më mirë t’ia bëjmë dikujt, të cilit Omeri (radijallahu anhu) nuk ia kthen fjalën. Të shkojmë te Hafsaja, t’i themi asaj dhe ajo ta mbajë të fshehtë, të mos i thotë gjë Omerit se nga erdhi ky mendim.” Ashtu bënë, shkuan te Hafsaja dhe i kërkuan që të fliste ajo me Omerin (radijallahu anhu); e paralajmëruan disa herë, që Hafsaja të mos thoshte gjë se kush ia kishte futur në kokë këtë mendim dhe u larguan prej andej

Hafsaja (radijallahu anha) shkoi tek i ati, Omeri (radijallahu anhu) dhe i foli se si qëndronte puna. E kuptoi nga fytyra e të atit, u nxeh. Omeri (radijallahu anhu) e pyeti atë se kush kishte shkuar tek ajo. Mirëpo Hafsaja nuk i tregoi, i tha:

- “Nuk të them asgjë pa më thënë ti njëherë se ç’mendim ke për këtë që sapo të thashë.”

- “Po ta dija se kush të ka folur, do t’u kisha dhënë një mësim të mirë! Po t’i luten Zotit, që në mes të kësaj je edhe ti. Më thuaj Hafsja, kur rrinte në shtëpinë tënde, çfarë mbante të veshur i Dërguari i Allahut?”

- “Resulullahu dy palë tesha kishte gjithsej: një palë i mbante për miqtë e rëndësishëm; kurse të tjerat ishin ato që vishte kur dilte përpara myslimanëve.” – i tha Hafsaja.

- “Po ushqimi më i mirë që hante kush ishte, a nuk ma thua edhe atë?”

- “Ne hanim bukë elbi. Kur buka ishte ende e ngrohtë i hidhnim edhe vaj përsipër dhe ajo na shijonte shumë, andaj u jepnim edhe mysafirëve të hanin prej saj.”

- “Po mirë, o Hafsja, pa nuk më thua cila ishte shtroja më e mirë që përdorte Profeti ynë i nderuar kur rrinte tek ti?”

- “Ne kishim një mbulojë të bërë nga një stof i trashë. Kur ishte kohë vere, ndodhte edhe që ta palosnim në katërsh dhe të uleshim mbi të. Dhe, kur vinte dimri, gjysmën e asaj shtroje e shtronim poshtë,

ndërsa gjysmën tjetër e hidhnim sipër.”

Omeri (radijallahu anhu) tha:

- “Shiko, o Hafsa, unë dua që këto fjalë t’ia transmetosh edhe atyre fjalë për fjalë: I Dërguari i Allahut përcaktonte një masë që do t’i mjaftonte atij vetë, kurse çdo gjë tjetër që ishte më shumë se ç’i duhej, ai ua ndante atë menjëherë atyre që mund të kishin nevojë. Uallahi, edhe unë përcaktova një masë që do të mjaftonte për mua. Pjesën që tepron do t’ua jap njerëzve në nevojë dhe unë do të mjaftohem me atë që më gjendet. Unë dhe dy shokët e mi përpara meje, Profeti ynë dhe Ebu Bekri, jemi si tre vetë që ecin në të njëjtën rrugë. I pari mori me vete ushqimin shpirtëror dhe iku. Pas tij iku edhe i dyti dhe u takua më në fund me të. Kurse i treti (duke pasur parasysht veten), do të ndjekë rrugën e tyre dhe vetëm nëse do të mjaftohet vetëm me masën e nevojshme të kësaj bote, do të mund t’u bashkohet dy shokëve të tij dhe të rrijë bashkë me ta. Nëse ndjek rrugë tjetër, ai nuk do të takohet dot me ta.”¹⁰⁶

Omeri (r.a.) këshillon djalin e tij, Abdullahun, në lidhje me llojet e ushqimeve

Tregon Ibni Omeri: “Ishim në sofër, kur në shtëpi erdhi Omeri (radijallahu anhu). I hapa menjëherë vend, që të ulej. Ai u ul, tha ‘Bismil’lah’ dhe mori një kafshatë dhe e futi në gojë, mori edhe një kafshatë tjetër dhe pastaj tha:

- “Kjo yndyrë nuk ngjan fare me dhjamin e mishit.”

- “O Prijësi i Besimtarëve, sot dola në pazar për të blerë ndonjë kafshë të majme dhe me dhjamë. Çmimi i gjedhëve m’u duk pak i shtrenjtë, ndaj bleva një dërrhem vaj dhe një dërrhem gjalpë. Dhe kjo u bë më mirë, se hëngrën edhe fëmija.”

- “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), nëse do të kishte dy lloj gjërash për të shoqëruar bukën, njërën do t’ia jepte ndonjë tjetri, e vetë do të hante vetëm njërën.”, – i tha Omeri (radijallahu anhu).

¹⁰⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/853 (35958).

- “Mirë, haje të paktën kësaj here.”, – i thashë unë, – “dhe, këtej e tutje, do të bëj siç më thua ti.”, dhe që prej asaj dite nuk shtrova më tryezë ku buka të shoqërohej me më shumë se një shoqërues tjetër.”¹⁰⁷

Omeri (r.a.) ua kujtonte njerëzve vazhdimisht ajetin:

**“Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën
tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to...”**

Salim bin Abdullahu tregon: “Omeri (radijallahu anhu) thoshte kështu:

- “Ullahi, ne nuk kemi kurrfarë lidhjeje me kënaqësitë e kësaj jete. Po të duam, ne i therim tërë dhinë e qumështit dhe na shtrohen sa hap e mbyll sytë përpara të pjekura. Dhe prapë, po të duam ne mund të gatuajmë edhe bukët më të mira me miell të bardhë gruri. Mund të ziejmë rrush të thatë; të hamë rrushin dhe t’i pimë shurupin. Mirëpo, ne nuk duam këtë, ne duam që ta marrim në amshim shpërblimin e të mirave tona në këtë jetë. Dhe këtë ne e kuptuam kur Allahu na tha: **“Ditën, kur ata që kanë mohuar do të vihen para Zjarrit (do t’u thuhet): ‘Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues, sepse keni qenë arrogantë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe nuk i jeni bindur Allahut.’”** (Ahkaf, 46/20)¹⁰⁸

**Kalifi Omer mban hutbe me një veshje
me dymbëdhjetë arna në shpinë**

Transmetohet nga Hasan Basriu: “Kur ishte kalif Omeri (radijallahu anhu), ai na e mbajti neve hutben i veshur me një rrobë, e cila kishte plot dymbëdhjetë arna në shpinë.”¹⁰⁹

Ibni Omeri tregon: “Omeri (radijallahu anhu) gjatë kohës që ishte kalif, nevojat e veta dhe ato të mbajtjes së familjes i përballonte të gjitha vetë. Çdo verë ai merrte një rrobë dhe e vishte. E qepte atë sërish

¹⁰⁷. Ibn Maxhe, *Sunen*, 2/1115 (3361).

¹⁰⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/49.

¹⁰⁹. Mubarekfuri, *Tuhfetul-Abnedhi*, 5/388.

me arna, derisa të vjetrohej fare e të bëhej që nuk mund të vishej më; nuk e hidhte dhe nuk e ndërronte duke marrë ndonjë të re.

Ai ishte një vit shumë pjellor për thesarin e shtetit të myslimanëve. Pavarësisht kësaj, unë e kam parë atë që të veshë një veshje më të vjetër se ajo që kish mbajtur një vit më parë. Kur Hafsa (radijallahu anha) shkoi ta pyesë se pse e kishte veshur atë rrobë të arnuar, Omeri (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- “Unë vishem nga plaçka në thesarin e myslimanëve dhe kaq është më se e mjaftueshme për mua.”¹¹⁰

Qëndrimi i Osmanit (r.a.) karshi kësaj bote

Abdumelik bin Shedadi tregon: “Ishte ditë e premtë dhe Osmani (radijallahu anhu) ishte ngjitur në minber; atë ditë kishte veshur një veshje shumë të thjeshtë që kushtonte a nuk kushtonte katër a pesë dërhëmë gjithsej, e cila dukej që ishte punim i stofit të Adenit, kurse punimin e kishte me vija, si ato që punonin artizanët e Kufes.”

Shurahbil bin Muslimi na transmeton se Osmani (radijallahu anhu) u jepte njerëzve të hanin ushqimet më të mira e më të shijshme, kurse vetë, në shtëpinë e tij, hante vetëm uthull dhe vaj.”¹¹¹

Qëndrimi i Aliut (r.a.) karshi kësaj bote

Një burrë nga fisi i Thakifit tregon: “Aliu (radijallahu anhu) më pati emëruar mua vali të qytezës së Ukberas. Kur më ngarkoi detyrën, ai më tha:

- “Iraku nuk është një vend ku falet shumica e njerëzve.” Pastaj më tha:

- “Në drekë, eja tek unë!”

Unë shkova tek ai në orarin që më pati thënë të vija dhe hyra menjëherë drejt e tek ai, sepse nuk kishte asnjë roje me vete. Po rrinte ulur dhe përpara kishte një enë dhe një gotë të mbushur plot me ujë. Ai

¹¹⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/308.

¹¹¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/60.

tha që t'i sillnin një torbë. Ndërkohë unë fillova të thosha me vete:

- “Nuk e di se çfarë ka brenda, por më duket se më besoi; më duket se do të nxjerrë diçka nga ajo trastë e do të ma japë mua.” Kur, Aliu (radijallahu anhu) hapi grykën e asaj traste dhe ç’të shihja! Ajo ishte plot me një ushqim (përzierje e miellit me sheqer)! Mori një masë prej atij ushqimi dhe e hodhi në enën që kishte përpara dhe përsipër i hodhi pak ujë. E përzjeu mirë e mirë, piu njëherë, pastaj më dha që të pija edhe unë. Nuk u përmbajta dot dhe thashë:

- “O Prijësi i Besimtarëve, po pse këtë ha ti, në Irak ka shumë ushqime që janë tejet të shijshme?”, – i thashë unë.

Aliu (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Më lejo të të them diçka, që ta kuptosh. Mos shiko se unë hapa grykën e trastës, sepse unë nuk e bëra atë nga koprracia. Unë blej mjaftueshëm. Kam frikë se mos derdhet ndonjë gjë nga ato që janë brenda dhe përzihet me ato që njerëzit do të gatujnë për mua. Ja pra, kjo është arsyeja pse unë e lidh grykën e trastës. Nuk dua që në bark të më hyjë ndonjë gjë tjetër, pos asaj që është e lejuar për mua.”

A’meshi na transmeton se Aliu (radijallahu anhu), si në drekë, ashtu edhe në mbrëmje, hante vetëm ato gjëra që i kishte sjellë me vete nga Medina.”¹¹²

Reagimi i Aliut (r.a.) për një ëmbëlsirë Falluxhi që i kishte sjellë dikush

Abdullah bin Sheriku na përcjell nga gjyshi i tij, se: “Aliut (radijallahu anhu) i prunë dhe i vunë përpara një lloj ëmbëlsire, të cilën vendasit e quanin “*falluxh*”. Aliu (radijallahu anhu) gjithë ndrojë pa njëherë ëmbëlsirën dhe tha:

- “Aromën dhe ngjyrat i paske shumë të bukura dhe nuk kam dyshim që shumë të mirë e ke edhe shijen. Por unë nuk dua që ta mësoj veten me ushqime të reja, që nuk jam mësuar të ha.”¹¹³

¹¹². Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/82.

¹¹³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/81.

Masa që i takon kalifit nga pasuria e thesarit, sipas Aliut (r.a.)

Abdullah bin Rezini tregon: “Pata shkuar të vizitoja Aliun (radijallahu anhu) për Kurban Bajramin. Ai na gostiti ne me një paçe shumë të mirë. Ne i thamë:

- “Të sheh Zoti, o Ali, nuk e therje dot atë patë e të na gostitje me diçka më të mirë, sepse ty Allahu të ka falur shumë të mira e pasuri?” Aliu (radijallahu anhu) na dëgjoi dhe u përgjigj:

- “Më dëgjo mua, o Ibni Rezin, Resulullahu ka thënë: *“Kalifit nga pasuria e përbashkët i takojnë vetëm dy enë me ushqim. Njëra për veten dhe familjen e tij, kurse tjetra për miqtë që vijnë e vizitojnë.”*¹¹⁴

Qëndrimi i Ebu Ubejde bin Xherrahut karshi kësaj bote

Urueja na tregon: “Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) pati shkuar të vizitonte Ebu Ubejden. Ebu Ubejdeja e kishte shtruar në tokë samarin e kalit të tij dhe ishte shtrirë mbi të. Omeri (radijallahu anhu) i tha atij:

- “Po pse nuk ke marrë edhe ti një dyshek, siç kanë bërë të gjithë shokët e tu!” Ebu Ubejdeja u përgjigj:

- “O Prijësi i Besimtarëve, kaq më mjafton për të fjetur nga pak gjatë drekës.”

Ndërsa, transmetimi i Ma’merit lidhur me këtë ngjarje thotë: “Kur erdhi Omeri (radijallahu anhu) në Siri, atë doli dhe e priti e tërë paria dhe populli sirian. Omeri (radijallahu anhu) pyeti:

- “Ku është vëllai im?”

- “Kush është vëllai yt?”, – e pyetën dhe Omeri (radijallahu anhu) tha:

- “Ebu Ubejdeja.”

- “Tani vjen.”, – ia kthyen ata. Me të ardhur Ebu Ubejdeja (radijallahu anhu), Omeri (radijallahu anhu) zbriti nga kali, u përqaftuan me njëri-tjetrin dhe të dy bashkë shkuan në shtëpinë e Ebu Ubejdes. Omeri (radijallahu anhu), në shtëpinë e Ebu Ubejdes nuk pa asgjë tjetër veç shpatës, parzmores dhe kafshës së tij të rrugës.”¹¹⁵

¹¹⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 8/3.

¹¹⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/101.

Qëndrimi që mbante Mus'ab bin Umejri karshi kësaj bote

Tregon Aliu (radijallahu anhu): “Një ditë, Mus’abi erdhi i veshur me një rrobë të trashë e të arnuar. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur e pa në atë gjendje, solli ndërmend jetën e tij të mëparshme, mes bollëkut dhe pasurisë së pamasë. Resulullahut iu mbushën sytë me lot dhe filloi të qajë. Pastaj tha:

- “*Kur të pasuroheni dhe të keni bollëk e të vishni rroba nga më të ndryshmet e ngjyra-ngjyra, vallë si do të jetë gjendja juaj?*” Ne iu përgjigjëm:

- “Atëherë do të jetë më mirë për ne, me të mirat që do të na ketë dërguar Allahu (xhel’le xhelaluhu) do ta sigurojmë më lehtë jetesën, kështu që të gjithë pjesën tjetër të kohës do ta kalojmë duke adhuruar Zotin.”

- “Jo”, – ndërhyri i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), – “*kjo gjendje e juaja sot është shumë herë më e mirë e më e hairit për ju.*”¹¹⁶

Gjendja ekonomike e Mus’abit pasi u bë mysliman

Tregon Omeri (radijallahu anhu): “Një ditë, i Dërguari i Allahut pa Mus’abin tek po vinte me një lëkurë dashi të lidhur për beli dhe u drejtua nga ne e na tha:

- “E shikoni atë njeri, të cilit Zoti ia ka ndriçuar zemrën me besim, para ca kohësh e kam parë të veshur me një rrobë dyqind dërrhemësh. Nëna dhe babai i jepnin atij ushqimet më të mira e më të shijshme për të ngrënë. Mirëpo, shihni se si e shndërroi atë dashuria që ka për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”¹¹⁷

Si ishte Selman Farisiu përballë jetës në këtë botë

Hasan Basriu tregon: “Selman Farisiu ishte komandant i gati tridhjetëmijë luftëtarëve myslimanë dhe paguhej me një pagesë prej pesëmijë dërrhemësh. Kur dilte përpara popullit, për t’u folur, ai hidhte supeve një jelek të gjatë shajaku. Kur binte të flinte atë e përdorte edhe si dyshek që të mos ia vriste trupin toka; gjysmën e shtronte

¹¹⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/921 (17110).

¹¹⁷. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/108.

poshtë, ndërsa tjetrën sipër, për t'u mbuluar. Kur merrte pagën, ai ua shpërndante atë të varfërve, kurse vetë jetonte me ndonjë punë tjetër që u bënte njerëzve.”¹¹⁸

Selman Farisiu (radijallahu anhu) nuk kishte shtëpi, prandaj shkonte shtrihej në hije dhe ndërronte vend kur fillonte t'i binte dielli. Një ditë, Hudhejfeja e pyet:

- “A do që të të ndërtoj një shtëpi?” Selman Farisiu nuk e priti aspak mirë këtë mendim. Hudhejfeja i tha:

- “Po prit njëherë, mos u ngut të vendosësh menjëherë; të ta tregoj njëherë si do ta ndërtoj, pastaj vendos.”, dhe vazhdoi t'i shpjegonte:

- “Unë do të të bëj ty një shtëpi të atillë, që madhësia e shtëpisë nuk do të jetë më e madhe se trupi yt. Kur të shtrihesh, kryet do të të prekin njëren anë të murit, kurse këmbët në anën tjetër; ndërsa, kur të ngrihesh në këmbë, koka do të të prekë në tavan.”

- “Ja, kjo është shtëpia që dua unë.”, – tha menjëherë Selmani dhe e pranoi propozimin e Hudhejfes.”¹¹⁹

Qëndrimi i Ebu Dherr Gifariut karshi kësaj bote

Ebu Esmaja e tregon: “Unë pata shkuar njëherë tek Ebu Dherri (radijallahu anhu), atëherë kur ai qëndronte në Rebedhe. Tek ai ishte edhe një grua me ngjyrë, po shumë e shëmtuar, sikur t'i kishte kokë e këmbë një. Ebu Dherri (radijallahu anhu) bëri me shenjë nga gruaja me ngjyrë dhe tha:

- “Hë, e shikoni se çfarë më këshillon mua kjo grua? Më thotë të iki në Irak. Po, se po të ikkam unë në Irak, atje do të më japin shumë të mira të kësaj jete. Po mua miku im i vetëm, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), më ka thënë se: *‘Ura e Siratit është një rrugë shumë e ngushtë, e rrëshqitshme dhe plot pengesa.’*, – dhe unë mendoj se do të jetë më e lehtë dhe shumë herë më mirë e më e hairit, nëse e kaloj atë me sa më pak barrë nga kjo e kësaj bote, sesa të kaloj mbi të me një barrë shumë të rëndë prej saj.”¹²⁰

¹¹⁸. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/197.

¹¹⁹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/202.

¹²⁰. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/161.

Ushqimi që hante Ebu Dherri

Ibrahim et-Tejmiu transmeton nga i ati, se: “E pyetën Ebu Dherrin (radijallahu anhu):

- “A nuk do edhe ti, që të bëhesh i pasur e të kesh plaçkë e toka njësoj si ata?” Ebu Dherri dëgjoi njëherë, pastaj u përgjigj:

- “Unë nuk dua të bëhem mbret. Mjaft e kam edhe pak ujë ose qumësht përditë dhe ndonjë masë grurë njëherë në javë. Kaq kam marrë unë edhe në kohën kur ishte gjallë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem); gjersa të më vijë vdekja, nuk dua të kem asnjë fije gjë më tepër.”¹²¹

Qëndrimi që mbante Ebu Derdaja përballë jetës në këtë botë

Muhamed bin Ka’bi tregon: “Në shtëpinë e Ebu Derdasë kishin ardhur si mysafirë për të fjetur një grup myslimanësh. Ebu Derdaja u nxori atyre një ushqim të ngrohtë, vetëm se, për të fjetur, ai nuk u shtroi atyre asgjë. Një nga miqtë u ngrit dhe tha:

- “Na dërgoi ushqim për të ngrënë, po nuk e kuptuam, ç’do të thotë të hash e të rrish në këtë të ftohtë? Unë do të shkoj tek ai, t’i flas.” Mirëpo, një nga shokët i tha:

- “Lëre, mos shko t’i thuash gjë.” – por nuk e dëgjoi, këmbënguli dhe shkoi e u ngul te dera e Ebu Derdasë. Mbërriti, por qëndroi pak dhe pa Ebu Derdanë që rrinte ulur dhe e shoqja nuk quhej se e kishte mbuluar kokën. Ai u kthye drejt tij dhe i tha:

- “Po edhe ti e paske kaluar natën pa u shtruar mbi asgjë, njësoj si ne.” Atëherë, Ebu Derdaja ia ktheu atij burri:

- “Pas kësaj bote ku jetojmë tani ne do të shkojmë në një vend tjetër. Ne shtretërit dhe jorganët i kemi dërguar për atje. Po të na gjendeshin këtu, patjetër që do t’ju kisha sjellë edhe dyshek, edhe jorganë për t’u mbuluar. Përpara ne kemi një mal shumë të thepisur. Ata që kanë më pak barrë kur ta kalojnë atë mal do ta kenë shumë më mirë dhe më lehtë, sesa ata që do t’i nisen të ngarkuar me barrë shumë të rënda. Po

¹²¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/162.

tani, a më kuptove se çfarë dua të të them?”

- “Po, e kuptova.”, – iu përgjigj ai burrë.”¹²²

Qëndrimi i Muadh bin Afrasë përballë të mirave të kësaj bote

Sklavi i liruar i Ebu Ejubit (radijallahu anhu), Eflahu, tregon: “Omeri (radijallahu anhu) kishte kërkuar që për familjet që kishin marrë pjesë në Bedër të qepeshin veshje të veçanta dhe një nga këto veshje ia pati dërguar edhe Muadh bin Afrasë (radijallahu anhu). Muadhi më tha mua:

- “Eflah, merre këtë rrobë dhe çoje ta shesësh.” E mora dhe shkova e shita për njëmijë e pesëqind derhemë. Kur u ktheva që t’ia jepja paratë Muadhit, ai më tha:

- “Tani shko dhe bli ndonjë skllav me këto para.” Ashtu bëra dhe me ato para arrita të blej plot pesë skllavë dhe ia çova Muadhit. Kësaj here Muadhi më priti me fjalët:

- “Unë kam vërtet shumë dyshime për mendjen e atij njeriu që vesh një veshje të tillë, të bërë nga dy copa leckë, që kushton sa për të çliruar nga skllavëria pesë skllavë!”, – dhe pastaj u drejtua nga skllavërit, duke u thënë:

- “Hajde, ikni tani, që sot jeni të lirë të gjithë.”, dhe i liroi.

Omeri (radijallahu anhu), një të dëgjuar se Muadhi nuk e kishte veshur atë që ai e kishte qepur enkas edhe për të, i qepi atij një veshje tjetër, jo aq të mirë, e cila nuk kushtonte më shumë se njëqind derhemë dhe ia dërgoi. Muadhi (radijallahu anhu) i tha atij që ia pruri veshjen:

- “Nuk ma merr mendja që këtë të ma ketë dërguar Omeri (radijallahu anhu).”

- “Po, vërtet Omeri jua ka dërguar.”, – i tha atij ai që ia solli. Atëherë Muadhi e merr atë rrobë dhe vjen vetë drejt e tek Omeri (radijallahu anhu).

- “O Prijësi i Besimtarëve, ti ma ke dërguar mua këtë veshje?”, – e pyeti.

¹²². Ibnu’l-Xheuzi, *Sifetu’s-Safue*, 1/263.

- “Dëgjova që nuk e ke veshur atë veshje që unë e qepa veçanërisht për ty dhe vëllezërit e tu. Prandaj edhe të dërgova këtë.”

- “O Prijësi i Besimtarëve, unë nuk e veshja atë që ti më dërgove në fillim, sepse unë desha që ti të më dërgoje diçka nga ajo që është e jotja.”, – i tha Muadh bin Afraja (radijallahu anhu) Omerit (radijallahu anhu) dhe ia ktheu pas veshjen e dërguar.”¹²³

Po Abdullah bin Omeri, çfarë qëndrimi mbante ndaj të mirave të kësaj bote?

Sklavi i liruar i Ibni Omerit (radijallahu anhu), Ubejdullah bin Adiji (radijallahu anhu), pasi u kthye nga Iraku, shkoi për vizitë tek Ibni Omeri. I dha selam dhe i tha:

- “Të kam sjellë një dhuratë nga Iraku.” Ibni Omeri e pyeti se çfarë ishte ajo dhuratë që i kishte sjellë prej andej. Ubejdullah bin Adiji iu përgjigj:

- “Xhuarish ~ *karamele erëmira*.”

- “E ç’na qenka ky *xhuarish*?”

- “Janë karamele erëmira, që janë ilaç për ta bërë më të lehtë tretjen.”, – iu përgjigj ai.

- “Po unë u bënë dyzet vjet që nuk ha sa të ngopem, ç’ta dua atë ilaç?”, – tha Abdullah Ibni Omeri (radijallahu anhu).”¹²⁴

Qëndrimi që mbante Hudhejfe bin el-Jemani karshi të mirave të kësaj bote

Tregon Saide bin Sa’d bin Hudhejfeja: “Hudhejfeja vazhdimisht thoshte:

- “Dita që më pëlqen më shumë është dita kur vij në shtëpi dhe mësoj se nuk ka asgjë për të ngrënë dhe njerëzit e shtëpisë më thonë: ‘Nuk kishim asgjë për të gatuar!’, sepse unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që na ka thënë:

¹²³. Ibnu’l-Xheuzi, *Sifetu’s-Safue*, 1/473.

¹²⁴. Ebu Nu’ajm, *Hiŕje*, 1/300.

- “Allahu e ruan besimtarin e vërtetë nga varësia e plaçkës e pasurisë në këtë botë ashtu siç një familjar ruan nga ushqimet e dëmshme njerëzit e familjes së tij, sepse Allahu e do të mirën e robve të Tij, që i besojnë, më shumë sesa i do të mirën femijës së tij një baba i mirë.”¹²⁵

17. GJYKIMI I ATYRE NJERËZVE QË NUK I VININ FRE VETES NDAJ TË MIRAVE DHE KËNAQËSIVE TË KËSAJ BOTE

Kur njerëzit gjykojnë ata që hanë dy vakte me ushqim

E tregon Aishja (radijallahu anha): “Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kur dalloi se unë haja dy herë në ditë, më tha:

- “O Aishe! Çfarë do t’i, që mos të të shqetësojë asgjë tjetër veç barkut? Çfarë do të bësh, do që ta fusësh të tërë botën në stomakun tënd? Të bash dy herë në ditë është shpërdorim dhe Allahu i Madhërishëm nuk i do ata që shpërdorojnë.”¹²⁶

Një këshillë e të Dërguarit Fisnik për Aishen (r.a.)

Aishja (radijallahu anha) u ul pranë Krenarisë së Njerëzimit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe filloi të qajë. I Dërguari i Allahut e pyeti:

- “Po pse qan, moj Aishe? Nëse do që të jesh pranë meje në jetën e përtejme, atëherë pranë vetes mbaj aq ushqim sa ç’i duhet edhe një udhëtar kur niset për rrugë. Në asnjë mënyrë mos u përfshi në mesin e të kamurve! Dhe kurrësi të mos të shkojë në mendje që të thuash për veshjet ‘u vjetruan’ dhe t’i hedbësh pa i arnuar dhe pa i qepur nëse është e nevojshme!”¹²⁷

Një këshillë nga i Dërguari Fisnik për Ebu Xhuhajfen

Tregon Ebu Xhuhajfeja: “Pata ngrënë therijde të bërë me mish e me vaj dhe pata shkuar pastaj tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Pata ngrënë pak si shumë, ndaj pa ndërprerë gromësija. I Dërguari i Allahut më tha:

¹²⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/277.

¹²⁶. Bejheki, *Shuabul’Iman*, 5/26 (5640).

¹²⁷. El-Hindi, *Kenzul’Ummal*, 2/150.

- “O Ebu Xhubajfe, po largohu dhe gromësi pak më tutje! Ata që e mbushin barkun sa nuk mban më në këtë botë, në jetën e përtejme do të qëndrojnë të uritur për një kohë të gjatë.” Vërtet, që nga ajo ditë e deri sa vdiq, Ebu Xhubajfeja nuk hëngri më kurrë gjer në ngopje. Nëse i qëllonte të hante në mëngjes, nuk hante më në mbrëmje dhe nëse hante në darkë, në mëngjes nuk hante më.”¹²⁸

Kur Omeri (r.a.) gjykon Xhabir bin Abdullahun

E tregon Jahja bin Saidi: “Omeri (radijallahu anhu) takoi Xhabir bin Abdullahun dhe kur pa që në dorë kishte ca para, e pyeti:

- “Çfarë ke ndërmend të bësh me këto para?” Ai iu përgjigj:

- “U kishte shkuar mendja për mish atyre të shtëpisë, ndaj po shkoj t’u blej pak mish.”

- “Po ti, ua blen çdo gjë që u shkon mendja atyre njerëzve të shtëpisë? Çfarë bëni, mendoni vetëm për të ngopur barkun tuaj, kur duhet t’u jepni të hanë edhe fqinjëve dhe të afërmve tuaj? Ju e keni harruar më duket ajetin kur’anor: **“Ditën, kur ata që kanë mohuar do të vihen para Zjarrit (do t’u thuhet): ‘Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues, sepse keni qenë arrogantë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe nuk i jeni bindur Allahut.’”** (Ahkaf, 46/20)!” – e qortoi Omeri (radijallahu anhu) Xhabir bin Abdullahun.”¹²⁹

Letra e Omerit (r.a.) për Ebu Derdanë

Këtë na e tregojnë, si Seleme bin Gulthumi, ashtu edhe Rashid bin Sa’di: “Omeri i nderuar (radijallahu anhu) dëgjoi se Ebu Derdaja (radijallahu anhu), i cili asokohe jetonte në qytetin e Humusit, kishte ndërtuar një shtëpi pak më të lartë se të tjerat, i shkroi atij një letër ku i thoshte:

- “Ebu Derda! A nuk të mjaftojnë ty shtëpitë e ndërtuara prej persëve dhe të bizantinëve si bukuri të jetës në këtë botë, që ndërton

¹²⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 7/256.

¹²⁹. Bejheki, *Shuabu’l-Iman*, 5/34 (5673).

shtëpi tjetër për veten? Kur e drejta është që ju, sahabët e Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), jeni njerëz që duhet të jeni shembull për të gjithë umetin e tij. Me ta marrë këtë letër, eja menjëherë tek unë në Sham.”

Thuhet se vetëm për këtë arsye Omeri (radijallahu anh) e ndëshkoi Ebu Derdanë duke e emëruar në Sham.”¹³⁰

Këshilla e Omerit (r.a.) për të gjithë drejtuesit

Tregon Abdullah Err-Rumij: “Shkova në shtëpinë e Umu Talkut dhe vura re se ajo shtëpi e kishte shumë të ulët tavanin.

- “O Umu Talk! Po shumë të ulët e paskeni këtë tavan!”, – i thashë.

- “O bir, Omeri (radijallahu anhu) u ka dhënë urdhër të gjithë drejtuesve që ka emëruar:

- “Mos i ndërtoni shumë të larta ndërtesat; koha më e keqe e jona do të jetë kur ju t'i ndërtoni ato të larta.”¹³¹

Kur Ebu Ejubit nuk i pëlqen diçka prej Ibni Omerit

Salim bin Abdullahu (radijallahu anhu) tregon se: “Babai ishte ende gjallë kur u martova unë. Ai i pati ftuar që të gjithë në dasmën time. Mes të ftuarve ishte edhe Ebu Ejubi (radijallahu anhu). Ne kishim varur perde të gjelbra nëpër muret e shtëpisë. Kur Ebu Ejubi erdhi dhe pa që dhoma ime ishte stolisur me perde të gjelbra, më pyeti:

- “More Abdullah, po pse edhe mureve u vini perde ju?” Dhe, babai, Ibni Omeri, i vënë paksa në siklet, iu përgjigj:

- “O Ebu Ejub, kështu kishin qejf gratë.”

- “E besoja që të gjithë dëgjojnë fjalën e gruas; po që do të ishte edhe ti kështu, këtë nuk do ta kisha besuar kurrë. Kjo është hera e fundit, këtë e tutje as nuk ju vi më në shtëpi, as nuk ha nga buka që do të shtroni ju!”, – i tha Ebu Ejubi (radijallahu anhu) babait.”¹³²

¹³⁰. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 7/305.

¹³¹. Buhari, *Ebedu'l-Mufred*, 1/161 (452).

¹³². El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 15/786 (41950).

Fjalët që i tha Ebu Bekri (r.a.) Abdurrahman bin Aufit pak çaste para se të ndahej nga jeta

Tregon vetë Abdurrahman bin Afi (radijallahu anhu): “Unë shkova për vizitë tek Ebu Bekri (radijallahu anhu), pasi ishte i sëmurë. Pasi i dhashë salam Ebu Bekri më tha:

- “Unë e shoh që tani, se, shumë shpejt, ju do të pasuroheni shumë e do të fitoni shumë prej të mirave të kësaj bote. Do të vijë ajo ditë e mirëqenies dhe njerëzit do të qepin perde prej mëndafshi dhe jastëkë atlas; nuk do t’ju pëlqejnë më krevetat e punuara me lesh nga ai i Azerbajxhanit. E vërteta është se për ju do të ishte më mirë sikur dikush t’ju vriste, sesa të prireni sadopak kësaj kah të mirat e kësaj bote.”¹³³

Këshillat e Abdullah bin Omerit për të birin që vesh rroba të reja

Mejmuni (radijallahu anhu) na tregon se: “Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) i kishte qepur një palë rroba njërit prej fëmijëve të tij dhe ia veshi për t’ia parë se si i rrinin. Fëmija i veshi ato rroba dhe pas pak erdhi tek ai dhe i tha se veshja e re i ishte grisur në një vend. Ibni Omeri (radijallahu anhu) i tha atij:

- “Prije atë pjesë ku është grisur dhe vazhdo ta veshësh” Por, fëmijës nuk i pëlqeu aspak kjo këshillë. Kur e pa se fëmija u mërzi shumë, Ibni Omeri i tha:

- “Duhet të të vij turp, ta kesh frikë Allahun! Kurrë mos u bëj nga ata që Allahu u fal ndonjë të mirë dhe ata vrapojnë ta hedhin menjëherë në bark, apo mbi shpinë!”¹³⁴

Çfarë i tha Ebu Bekri (r.a.) vajzës së tij, Aishes, kur pa se ajo kishte veshur një veshje të re

Tregon Aishja (radijallahu anha): “Një ditë, unë kisha veshur një veshje të re. E doja shumë, ndaj rrija rrija dhe e shikoja. Babai, Ebu Bekri (radijallahu anhu), më tha:

¹³³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/34.

¹³⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/301.

- “Ç’bën që e shikon ashtu atë veshje? Allahu nuk të sheh, në këtë gjendje që je ti.”

- “E pse nuk më sheh?”, – e pyeta unë dhe ai m’u përgjigj:

- “Ta dish se nëse robi jepet pas stolive dhe madhështisë së gënjeshtërt të kësaj bote, Allahu nuk e sheh me mëshirë atë rob, derisa ai të heqë dorë nga ajo stoli.” E hoqa menjëherë atë veshje dhe ia dhashë dikujt si sadaka.”¹³⁵

¹³⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/37.

SAHABËT FISNIKË I MPOSHTNIN DËSHIRAT EGOISTE DHE QEJFET E TYRE



Si ia kishin arritur sahabët e të Dërguarit të Allahut të largoheshin nga dëshirat e egos së tyre? Si i lanë ata mënjanë, babanë, nënën, fëmijët, vëllezërit dhe bashkëshortet e tyre dhe u lidhën aq fort pas Allahut (xhel'le she'nuhu) dhe të Dërguarit të Tij (sal'lallahu alejhi ue sel'lem)? Cilat ishin masat dhe kriteret e tyre në lidhje me marrëdhëniet me njerëzit?

1. SI ARRITËN SAHABËT TË SHKËPUTNIN ÇDO LIDHJE ME KOHËN E INJORANCËS, DUKE FORCUAR BESIMIN DHE LIDHJEN E TYRE ME ISLAMIN?

Në luftën e Bedrit, Ebu Ubejde bin Xherrahu detyrohet të vrasë të atin

Tregon Ibni Sheudhebi: “Gjatë përplasjes së Bedrit, Ebu Ubejde bin Xherrahu (radijallahu anhu) dhe babai i tij ishin kundërshtarë të njëri-tjetrit. Babai e sulmonte me këmbëngulje të birin e tij, tashmë

të bërë mysliman, pa reshtur për asnjë çast. Kurse Ebu Ubejdeja në çdo rast rrekej t'i shmangej, të ndërronte drejtim, vetëm e vetëm që të mos mbetet vetëm për vetëm me të atin. Kur i ati filloi të ngulë këmbë edhe më shumë, Ebu Ubejdeja nuk duroi dot por u përlesh me të dhe e vrau. Posaçërisht për këtë ndodhi u zbrit ajeti kuranor:

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjërë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet, që Pala e Allahut do të jetë fituese.” (Muxhadele, 58/22)¹

Djali i Abdullah bin Ubej bin Selulit vjen tek i Dërguari i Allahut dhe i kërkon leje për të vrarë babanë e tij

Asim bin Omer bin Katadeja tregon: “I biri i Abdullah bin Ubej bin Selulit erdhi tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha:

- “O i Dërguari i Allahut, kam dëgjuar që do të vritet babai im, Abdullah bin Ubej bin Seluli. Nëse e kenë marrë ju këtë vendim, atëherë ma jepni mua urdhrin, se do të shkoj ta vras atë me duart e mia. Uallahi, çdo njeri i Hazrexhit e di mjaft mirë, unë jam djali që është sjellë më mirë nga të gjithë me babanë tim. Por frika ime është se, nëse ti ia jep dikujt tjetër detyrën për të vrarë babanë tim dhe ai e vret, sedra mund të mos e durojë dot që vrasësi i Ibni Ubejit të shëtisë i lirë në mesin e njerëzve. Kam frikë se unë vras një mysliman që vrau atë mohues dhe kësisoj marr veten më qafë dhe përfundoj si një nga banorët e Xhehenemit.” I Dërguari i Allahut e dëgjoi, pastaj i tha:

- “*Nuk bëhet fjalë kurrësi për ta vrarë atë; përkundrazi, për sa kohë që ai do të jetojë mes nesh, ne duhet të sillemi mirë me të dhe do të përpiqemi të afrohemi*

¹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/101.

e të shkojmë sa më mirë me të.”²

Usame bin Zejdi (radijallahu anhu) tregon: “Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) sapo u kthye nga udhëtimi që kishte ndërmarrë për tek bijtë e Mustalikut dhe Abdullahu i nxori shpatën babait të tij, Abdullah bin Ubejit, që asokohe ishte më i pari i të gjithë hipokritëve, duke i thënë:

- “Shiko, baba! Pa thënë tani, që ‘Muhamedi është më i nderuari, ndërsa unë jam më i poshtri!’, nuk kam për ta futur këtë shpatë në brez.” I ati iu përgjigj:

- “Të të vijë turp! Mirë, si të duash ti, Muhamedi është më i nderuari, kurse unë jam më i poshtri!” Unë shkova tek Resulullahu (alejhis’selam) dhe ia tregova një për një të gjitha sa kishin ndodhur. E pëlqeu dhe e lavdëroi këtë veprim të tijin.”³

Një dialog i zhvilluar mes Omerit (r.a.) dhe Said bin el-Asit

Ibni Hishami, i mbështetur në transmetimet që kanë bërë Ebu Ubejdeja dhe disa historianë të tjerë, na tregon: “Omeri (radijallahu anhu) i tha Said bin el-Asit:

- “Më duket sikur je bezdisur nga unë, sepse mendon se ta kam vrrarë unë babanë, Asin. Më dëgjo, nëse do të ta kisha vrrarë unë babanë, nuk vija tani tek ti dhe të të kërkoja falje. Unë kam vrrarë dajën tim As bin Hishamin dhe Mugiren. Kurse babanë tënd, kur shkova unë atje, ai ishte bërë si një dem i tërbuar dhe kërkonte me çdo çmim të vriste dikë. Unë ndërrova menjëherë rrugë. Aty erdhi nipi i tij, Aliu, që e sulmoi dhe e vrau.”

- “Shiko, o Omer, edhe po ta kishe vrrarë ti, unë nuk do të thosha asgjë prej gjëje, sepse ti ishe në kërkim të së drejtës, kurse ai në mbrojtje të së rremes!”, – iu përgjigj Said bin el-Asi. Kjo përgjigje nga ana e tij e la shumë të kënaqur Omerin (radijallahu anhu).”⁴

². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/158.

³. Hejthemi, *Mexhmenü’-Zeuaid*, 9/527 (15759).

⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/290.

Gjendja e Ebu Hudhejjes kur sheh babanë që po ia tërheqin zvarrë për t'ia hedhur në gropë

Kjo është transmetuar prej Aishes (radijallahu anha): “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), në luftën e Bedrit, urdhëroi që trupat e idhujtarëve të vrarë të tërhiqeshin zvarrë dhe të hidheshin në një gropë. Kur sahabët përfunduan së hedhuri në gropë të gjithë trupat, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) shkoi qëndroi në buzë të asaj grope dhe tha:

- “O ju që jeni këtu në këtë gropë! A e gjetët atë që Allahu jua premtoi se ishte e vërteta, sepse për mua fjala e Zotit tim është e vërteta e vetme?” Sahabët fisnikë e pyetën atë:

- “O i Dërguari i Allahut! Ti po flet me të vdekurit?” Dhe ai iu përgjigj:

- “Ata mësuan se ajo që u kishte premtuar Zoti ishte e vërtetë.”

Ebu Hudhejfeja (radijallahu anhu), kur pa që babanë e tij po e tërhiqnin zvarrë, për ta hedhur në atë gropë, u mërzit shumë dhe Resulullahu (alejhis’selam), i cili e kuptoi këtë menjëherë, i tha atij:

- “Ebu Hudhejfe! Më duket sikur nuk po të pëlqen ajo që po sheh!” Ebu Hudhejfeja (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- “O Resulullah! Babai im ishte njeri me personalitet të fortë. Gjithmonë shpresoja se Zoti ynë një ditë do t’ia bënte edhe atij të mundur që të pranonte fenë islame dhe të bëhej mysliman. U mërzita shumë, kur e pashë kështu, në këtë gjendje.” I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u lut për Ebu Hudhejfen që të begatohej me mirësi.”⁵

Një dialog interesant mes Mus’ab bin Umejrit dhe vëllait të tij të zënë peng

Tregon Nebih bin Uehbi: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) robërit e zënë në luftën e Bedrit ua shpërndau sahabëve të tij, duke i porositur:

⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/694 (29976).

- “*Kujdesuni mirë për ta!*” Midis atyre robërve ishte edhe vëllai nga të dy prindërit i Mus’ab bin Umejrit, Ebu Azizi.

Ebu Azizi thotë se: “Mua më pati zënë rob një ensar. (Në përcjelljen e transmetimeve të ndryshme thuhet se ky ensar quhej Muhriz bin Nadle.) Vëllai im, Mus’abi po kalonte andejpari, më pa dhe i tha atij që më kishte zënë rob:

- “Mbaje fort atë; sepse nënën e ka të pasur dhe mund të të paguajë mirë për ta liruar të birin.” Në kthim e sipër nga Bedri, mua më dorëzuan te një familje shumë e madhe ensarësh. Njerëzit e asaj shtëpie mjaftoheshin, mëngjes-darkë, vetëm me hurma; kurse mua, duke qenë se i Dërguari i Allahut i pati porositur që të silleshin mirë me ne pengjet e luftës, më jepnin të haja bukë. Kujtdo që t’i vinte në dorë ndonjë copë buke, ma jepte atë menjëherë mua. Ndërsa mua më vinte zor, e ua ktheja prapë mbrapsht; por ai që ma kishte dhënë nuk e pranonte dhe ma kthente. Vëllai im, Mus’abi i tha Ebu’l-Jeserit që më kishte zënë rob mua:

- “Mbaje mirë atë, se e ka nënën shumë të pasur.” – e unë ia ktheva:

- “O vëlla, kjo ishte këshilla më e mirë që mund të jepje për mua?”, – dhe Mus’abi ma ktheu:

- “Ai është vëllai im, jo ti!”

Sipas asaj që është transmetuar, nëna e Ebu Azizit pati pyetur se kush ishte shpagimi më i lartë që ishte paguar për një rob nga të kurejshët dhe i thanë se ishte katërmijë derhemë. Dhe ajo dërgoi plot katërmijë derhemë, për ta shpëtuar djalin e saj nga robëria.”⁶

2. DASHURIA E THELLË E SAHABËVE FISNIKË PËR PROFETIN TONË TË DASHUR

Dashuria që ndiente Sa’d bin Muadhi për të Dërguarin e Allahut

Tregon Abdullah bin Ebi Bekri (radijallahu anhu): “Sa’d bin Muadhi (radijallahu anhu) i tha Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Resulallah! Na lejo që ne të të ndërtojmë një çardak, e ti të

⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/307.

ulesh aty e të na shikosh, teksa ne luftojmë me armikun. Nëse Allahu na nxjerr ne fitimtarë, sa mirë, do të na përmbushet ajo që ne e kemi njëkohësisht dëshirë e qëllim. Në të kundërt, ti mund t'i hipësh kafshës sate të rrugës dhe të kthehesh pranë njerëzve tanë në Medinë, të cilët nuk janë këtu, sepse edhe ata të duan shumë ty, njësoj si ne. Sikur ta dinin ata se do të luftoje edhe ti, Allahu nuk do t'i kishte lënë edhe ata pa ardhur, që të luftonin këtu krah për krah me ty, duke t'u bërë krah, si në numra, ashtu edhe në shpirt.”

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e përgëzoi Sa'din për këtë mendim kaq të mirë dhe u lut që Zoti t'i falte atij më të mirat. Dhe kështu u bë, më vonë u ndërtua edhe një çardak për të Dërguarin e Allahut.”⁷

Kur një sahab shprehte dashurinë për të Dërguarin e Allahut

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Dikush erdhi te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha:

- “O Resulallah, unë ty të dua më shumë se jetën dhe se fëmijët e mi. Kur jam në shtëpi, sa më vjen ti në mendje nuk rri dot në shtëpi, dua të vij e të të shoh. Por, një të më ardhur në mendje jeta e përtejme, më kujtohet se ti do të hysh në Xhenet dhe do të jesh bashkë me profetët e tjerë; edhe sikur të hyj unë në Xhenet, s'di si do t'ia bëj pa të parë ty dhe kjo më mërzit për vdekje.”

Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) heshti dhe nuk iu përgjigj. Pak më vonë, erdhi Xhibrili (alejhis'selam), për t'i zbritur ajetin: “**Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të jetë me ata, të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh, sa shokë të mrekullueshëm janë këta!**” (Nisa, 4/69)⁸

⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/368.

⁸. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 4/240.

Historia e sahabit, i cili, përgatitje për në ditën e Kiametit, kishte dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Një burrë i tha Profetit tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O i Dërguari i Allahut, kur do të ndodhë Kiameti?” I Dërguari i Allahut i tha:

- “*Çfarë ke përgatitur ti për atë ditë?*”

- “Unë nuk kam asgjë tjetër, kapital kam veç dashurinë që kam për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.” – i tha ai. Kurse Profeti ynë i dashuria ktheu:

- “*Epo, nëse është kështu, ta dish se atje do të jesh me ata që do.*”

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: “Ne nuk jemi gëzuar kurrë nga asgjë, sa ç’jemi gëzuar kur Resulullahu më tha:

- “*Ti do të jesh me ata që do më së shumti.*” Andaj, unë më së shumti dua Profetin tonë të nderuar, Ebu Bekrin dhe Omerin (radijallahu anhuma). Shpresoj të jem bashkë me ta edhe në jetën e përtejme, sepse me të vërtetë i dua shumë.”

Uria që ndjen Profeti ynë i nderuar dhe një ngjarje në lidhje me Aliun (r.a.)

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Njëherë Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kishte rënë në vështirësi dhe në shtëpinë e tij nuk kishte mbetur as edhe një thërrime bukë. Aliu (radijallahu anhu), me të mësuar për gjendjen në të cilën ndodhej ai, doli jashtë dhe shkoi të kërkojë punë, për t’i ardhur në ndihmë të Dërguarit të Allahut. Hyri të punojë në kopshtin e një hebreu. Ai i tha se për çdo kovë ujë që do t’i çonte mund të merrte nga një kokërr hurmë dhe Aliu (radijallahu anhu) nxori plot shtatëmbëdhjetë kova me ujë. Hebreu i tha atij të merrte cilat kokrra të donte nga hurmat. Edhe ai kështu bëri, mori shtatëmbëdhjetë kokrra hurma, ato që ishin më të freskëtat dhe ia solli Profetit tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Resulullahu e pyeti:

- “O Ebu’l-Hasen, po këto ku i gjete?” Dhe Aliu (radijallahu anhu) i tha:

- “O Resulallah, unë dëgjova se ju keni mbetur pa ushqim dhe jeni të uritur, prandaj dola të kërkoja punë, e me paratë e fituara t’ju sillja diçka për të ngrënë. Ja, këto fitova.”

- “Po mirë, o Ali, çfarë të shtyu ty të veprosh kështu, dashuria për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij?”, – e pyeti ai.

- “Po!”, – tha Aliu (radijallahu anhu).

- “Nuk ka asnjë rob besimtar, që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, që atë të mos e pllakosë varfëria më shpejt seç vjen uji vërshues i përmbytjeve. Le të jetë i përgatitur e i pajisur me çka është e nevojshme për fatkeqësitë çdokush që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”, – tha i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).⁹

Dashuria e Talha bin Berasë për Profetin tonë

Husajn bin Uahuah el-Ensari (radijallahu anhu) tregon se: “Talhaja (radijallahu anhu) u takua me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e përqafoi njëherë dhe filloi ta puthë, duke i thënë:

- “O i Dërguari i Allahut! Më urdhëro mua ç’të duash ti dhe nuk do të kundërshtoj asnjë fjalë që do të më thuash ti.” Talhaja atëherë ishte ende djalë i ri; fjalët e tij i pëlqyen tej mase Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). (Deshi ta vinte disi në provë)

- “Mirë, shko e vrit babanë tënd!”, – i tha. (Sipas një transmetimi tjetër, ai i thotë: “Shko dhe shkëput çdo marrëdhënie me nënën dhe babanë.”) Talhaja doli menjëherë jashtë, për të çuar në vend fjalën e Resulullahut. Nga pas doli edhe Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i thirri:

- “Eja, eja këtu! Mua nuk më kanë dërguar që t’i ndaj njerëzit nga familjet dhe të afërmit e tyre.” Pas kësaj ndodhie Talhaja u sëmur. Ishte ditë e ftohtë dimri, qielli ishte me re, dhe Profeti ynë i dashur shkoi për të parë Talhanë. Kur do të largohej, ai u tha familjarëve të tij:

- “Shikoni, Talhaja më duket se e ka shumë pranë vdekjen; më njoftoni kur të ndodhë, sepse do të jem edhe unë në varrimin e tij dhe do t’i fal namazin

⁹. Bejheki, *Sunen*, 6/119 (11429).

e xhenazes. Dhe varrimin t'ia bëjmë pa u vonuar shumë.” Resulullahu nuk kishte arritur ende në lagjen e bijve të Salim bin Aufit, kur Talhaja dha shpirt; ra errësira e natës. Talhaja u kishte lënë atyre amanet:

- “Kur të vdes, më varrosni shpejt, sepse dua të takohem një çast e më parë me Zotin. Dhe mos e thërrisni Profetin tonë për mua, sepse kam frikë mos i ngrenë ndonjë kurth hebrenjtë.” – andaj, ata nuk e njoftuan Resulullahun, por e varrosën shpejt e shpejt në errësirën e natës. Në agim, Resulullahun e njoftuan se çfarë kishte ndodhur. Profeti ynë i dashur shkoi te koka e varrit të Talhasë. Pas tij u mbledhën në rresht edhe sahabë të tjerë. Profeti ynë ngriti duart dhe u lut:

- “O Zot! Prite me buzëqeshje Talbanë, që t'i qeshë buzja edhe atij.”¹⁰

Dashuria e Abdullah bin Hudhafes për Profetin tonë

Tregon Zuhriu: “Disa sahabë shkuan tek i Dërguari ynë Fisnik dhe iu ankuan për Abdullah bin Hudhafen (radijallahu anhu), pasi ai kishte një tip shumë shakaxhi dhe i pëlqente të merrej me gjëra të kota. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha atyre:

- “Mos e ngacmoni atë, lëreni të qetë, ai ka një cilësi të veçantë që ju nuk e dini: Ai e do shumë Allahun dhe të Dërguarin e Tij!”¹¹

Fjalët e të Dërguarit Fisnik për Abdullah bin Dhu'l-bixhadejnin, gjatë xhenazes së tij

El-Edre' tregon: “Një natë unë qëndrova t'i bëja roje të Dërguarit të Allahut. Dëgjova një zë, dikush po lexonte Kur'an me zë të lartë. I Dërguari i Allahut doli jashtë.

- “O i Dërguari i Allahut, ky duhet të jetë ndokush që e bën për t'u dukur!”, – i thashë unë.

- “Jo”, - më tha Profeti ynë, – “*ky është Abdullah bin Dhu'l-Bixhadejini.*”

Kaluan ca kohë dhe ai njeri ndërroi jetë në Medinë. Sahabët e lanë dhe e veshën me qefin, pastaj, kur e morën mbi supe xhenazen e tij, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

¹⁰. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 13/414 (37160).

¹¹. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 13/461 (37282).

- “Tregohuni të butë dhe të ëmbël me të, ashtu siç Allahu u tregua i butë dhe i ëmbël me të, sepse ai e donte shumë Allahun dhe të Dërguarin e Tij.” Kur po hapej gropa e varrit, i Dërguari i Allahut tha:

- “Hapeni të gjerë varrin, që edhe Allahu t’i falë atij gjerësi.” Paskëtaj, një nga sahabët tha:

- “O Resulallah, qenkeni mërzhitur shumë për të!”

- “Po ai e donte aq shumë Allahun dhe të Dërguarin e Tij!”, – ia ktheu ai.”¹²

3. SAHABËT ZGJIDHNIN ATË QË DONTË MË SHUMË I DËRGUARI I ALLAHUT NË VEND TË ASAJ QË DONIN VETË

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Kur babai i Ebu Bekrit (radijallahu anhu), Ebu Kuhafeja (radijallahu anhu) zgjati dorën për të lidhur besën, Ebu Bekri nisi të qajë. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e pyeti:

- “Po pse qan, o Ebu Bekr?”

- “O Resulullah! Mendova se sa shumë do të gëzohesha sikur ajo dorë që t’u zgjat të mos ishte dora e babait tim, por të ishte dora e Ebu Talibit dhe me këtë Zoti të ta mbushte zemrën plot gëzim!”, – i përgjigj Ebu Bekri (radijallahu anhu).¹³

Një bisedë e zhvilluar mes Omerit (r.a.) dhe xhaxhait të Profetit tonë, Abasit

Këtë e tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): “Në mes të robërve të zënë gjatë luftës së Bedrit ishte edhe xhaxhai i Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Myslimanët ensarë i ishin kanosur atij me vdekje dhe këtë e kishte dëgjuar edhe i Dërguari i Allahut. Ditën tjetër, ai tha:

- “Sonte, për shkak të Abasit, nuk kam mundur të vë dot gjumë në sy fare; sepse dëgjova që ensarët donin që ta vrisnin.” Për këtë arsye, babai im, Omeri (radijallahu anhu) i tha atij:

- “O Resulullah, të shkoj njëherë unë tek ensarët.”

- “Në rregull, o Omer, shko ti njëherë.”, – i tha ai. Omeri (radijallahu

¹². Ibn Maxhe, *Sunen*, 1/497 (1559).

¹³. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 7/238.

anhu) shkoi pranë ensarëve dhe u tha:

- “Lëreni të lirë Abasin.”

- “Jo, uallahi nuk e lëshojmë.”, – u përgjigjën ata.

- “Po mirë, po sikur të jetë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) që do që ju ta lëshoni atë!”, – vazhdoi ai të këmbëngulë.

- “Nëse është Resulullahu që e kërkon, atëherë ne nuk ka se ç’të themi, merre me vete.”, – u përgjigjën ata. Omeri (radijallahu anhu) e mori Abasin në dorëzim dhe iu drejtua:

- “O Abas, bëhu mysliman! I betohem Allahut, se po u bëre ti mysliman unë do të gëzohem më shumë edhe sesa sikur të bëhej babai im Hatabi mysliman. E di pse, sepse kjo, - nëse ti bëhesh mysliman, - do ta gëzojë shumë të Dërguarin e Allahut!”¹⁴

Ka edhe një transmetim tjetër në lidhje me këtë çështje, i cili përcillet nga Sha’biu, ku thuhet: “Xhaxhai i Profetit tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) filloi të këmbëngulte në një pyetje që po i bënte Omerit (radijallahu anhu):

- “O Prijësi i Besimtarëve! Çfarë do të bëje me të, sikur tani të vinte tek ti xhaxhai i Musait (alejhis’selam)?”

- “Uallahi, do ta trajtoja mirë dhe do të sillesha shumë mirë me të!”, – u përgjigj Omeri (radijallahu anhu). Atëherë, Abasi ia ktheu duke i thënë:

- “Kësodore, edhe unë jam xhaxhai i Resulullahut!”

- “Ebu’l-Fadl, çfarë pandeh ti? Uallahi, unë edhe babanë tënd e dua më shumë sesa babanë tim.”, – iu përgjigj aty për aty Omeri (radijallahu anhu).

- “Vërtet?”, – e pyeti Abasi (radijallahu anhu).

- “Po, ashtu është, sepse unë e di shumë mirë, se i Dërguari i Allahut e donte babanë tënd më shumë sesa donte babanë tim. Dhe ajo që më takon mua është që të dua më shumë atë që donte Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) sesa atë që dua vetë.”, – e mbylli fjalën e tij Omeri (radijallahu anhu).”¹⁵

¹⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/298.

¹⁵. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/30.

Resulullahu dhe ata që vdiqën në Medinë

Ebu Said el-Hudri (radijallahu anhu) tregon: “Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kohët e para, kur erdhi në Medinë, e ndonjëri prej nesh ishte në shtratin e vdekjes, e lajmëronim edhe atë. Ai vinte dhe i qëndronte atij që ishte sëmurë te kryet, i lutej Allahut që ta falte; kur i sëmuri ndërronte jetë, edhe ne ktheheshim pas të gjithë si xhemat. Ndërsa, nganjëherë Resulullahu qëndronte dhe priste derisa të përfundonte varrimi. Ndonjëherë ne mendonim se e mundonim më shumë se ç’duhej dhe me njëri-tjetrin thoshim: “Të mos i themi gjë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) deri kur të ndahet nga jeta. Kësisoj as nuk do të lodhet, as nuk do të humbasë nga koha e tij e vyer.” Dhe kështu filluam të bëjmë. Në çastin kur ndokush që ishte i sëmurë jepte shpirt, dërgonim dikë që ta lajmëronte. Dhe Resulullahu vinte, i falte atij namazin, i lutej Allahut që ta falte, mandej kthehej për në Medinë. Ndonjëherë priste edhe derisa të përfundonte varrimi. Për njëfarë kohe kështu e bëmë. Më vonë, prapë u vumë në mendime: “Uallahi të mos e bëjmë as këtë. I Dërguari i Allahut lodhet shumë nga këto udhëtime. Kur të ketë ndonjë xhenaze, ta marrim xhenazen dhe ta çojmë te dera e shtëpisë së Resulullahut dhe ai t’ia falë atje namazin. Kështu ka për të qenë edhe më e lehtë për të.” Dhe ashtu vazhduam të bëjmë.

Transmetuesi i kësaj ndodhie, Muhamed bin Omeri thotë se: “Prandaj edhe ai vend mori emrin “Vendi i xhenazeve” ~ *‘vend ku falet namazi i xhenazës’*. Të gjitha xhenazet çoheshin njëherë atje, para se të dërgoheshin për në varrezë. Kjo vijoi të praktikohet edhe pas ndarjes nga jeta e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).”¹⁶

Dashuria e Omerit (r.a.) për Fatimen (r.a.)

Eslemi e tregon: “Një ditë, Omer bin Hatabi (radijallahu anhu) shkoi për vizitë te vajza e Profetit tonë, Fatimja dhe i tha:

¹⁶. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/257.

- “O Fatime! Unë i betohem Allahut, se asnjëherë nuk kam njohur ndonjë njeri që i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ta ketë dashur më shumë sesa ty. Prandaj, pas babait tënd, nuk ka njeri më të dashur për mua sesa ti.”¹⁷

4. RESPEKTI QË NDIENIN SAHABËT PËR PROFETIN TONË

**Sahabët, nga edukata që kishin as sytë
nuk i ngrinin kur rrinin me Resulullahun**

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, një grup sahabësh nga muhaxhirët dhe ensarët, midis të cilëve ishin edhe Ebu Bekri me Omerin (radijallahu anhuma), ishin ulur dhe po prisnin Resulullahun, kur aty ia behu i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Përveç Ebu Bekrit dhe Omerit (radijallahu anhuma), askush nuk e ngriti shikimin për ta parë në sy, sepse askush nuk e shikonte dot në fytyrë. Vetëm Ebu Bekri dhe Omeri (radijallahu anhuma) e shikonin të Dërguarin e Allahut (alejhis’selam) në sy, madje edhe i buzëqeshnin. Edhe ai i shikonte ata në sy dhe u kthente buzëqeshjen.”¹⁸

Si uleshin sahabët fisnikë kur ishin në praninë e Profetit tonë?

E rrëfen Usame bin Sheriku (radijallahu anhu): “Kur ishim me Profetin tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ne rrinim të ulur, pa lëvizur fare, sikur mbi krye të na kish zbritur ndonjë zog e nuk donim që të trembej dhe nuk pipëtinte asgjë. (Edhe një ditë ishim ulur kështu dhe po dëgjonim të Dërguarin e Allahut) Erdhën disa vetë dhe e pyetën Atë:

- “O i Dërguari i Allahut, kush janë robërit më të dashur për Allahun (xhel’le she’nuhu)?”

- “*Ata që kanë moralin më të bukur?*”, – u përgjigj Profeti ynë.”¹⁹

¹⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/652 (37727).

¹⁸. Kadi Ijad, *Shifa*, 2/33.

¹⁹. El-Hakim, *Mustedreke*, 4/443 (8214).

I Dërguari i Allahut, me personalitetin e tij, i shtynte njerëzit të tregonin respekt për të

Bera bin Azibi (radijallahu anhu) thotë: “Unë doja që ta pyesja Profetin tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) në lidhje me një çështje të caktuar. Mirëpo, personaliteti e tij më bëri të druham dhe m’u deshën thuajse dy vjet për t’ia bërë atë pyetje!”²⁰

Sahabët e merrnin ujin që merrte abdes Profetit ynë dhe fërkonin trupin me të

Zuhriu transmeton: “Dikush nga ensarët, për të cilin nuk mund të kishte dyshim se ishte një njeri shumë i drejtë, më pati treguar se: “Kur Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) merrte abdes, sahabët vraponin kush e kush ta kapte i pari ujin që kishte marrë abdes ai dhe me të fërkonin fytyrën dhe trupin. Njëherë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i pyeti ata:

- “Pse e bëni këtë?”

- “Sepse shpresojmë që ai ujë të bëhet shkas begatie dhe mbarësie për ne.”, – thanë ata. Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), pasi i dëgjoi, u tha atyre:

- “*Kushdo që do të gëzojë dashurinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, të thotë gjithmonë vetëm të vërtetën, të tregohet besnik i amanetit dhe i fjalës së dhënë dhe të mos i lëndojë fqinjët e vet.*”²¹

Respekti i Ebu Ejub el-Ensarit për Profetin tonë

Ebu Ejub el-Ensari tregon: “Në kohën që erdhi në Medinë, Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) qëndroi në katin e poshtëm të shtëpisë sime. Unë rrija në katin sipër. Në mbrëmje Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ra të flinte, unë nisa të mendohesha: “Ne qëndrojmë mbi të Dërguarin e Allahut, kurse ai qëndron poshtë. Mos bëhemi pengesë që shpallja hyjnore të zbresë tek i Dërguari i Allahut! Sa herë që ktheheshim nëpër shtrat, njëherë andej njëherë

²⁰. Kadi Ijad, *Shifa*, 2/33.

²¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/220 (44293).

këtej, shqetësohesha edhe se mos nga tavani binte pluhur tek Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), e nuk më hyri gjumë në sy atë natë.” Me të gdhirë zbrita menjëherë te Resulullahu dhe i thashë:

- “O Resulallah, sonte as unë, as Ummu Ejubi nuk mbyllëm dot sy.”

- “*Po pse, o Eba Ejub?*”, – më pyeti Resulullahu.

- “Mendimet se ti ishe poshtë nesh dhe duke u kthyer nëpër shtrat mund të bënim që nga tavani mbi ty të binte ndonjë pluhur, por edhe se mos pengonim zbritjen e shpalljes hyjnore, nuk na lanë të flinim!”, – iu përgjigja unë.

- “*Shiko, o Ebu Ejub, mos e bëj më këtë! Shiko, unë do të të mësoj ty disa fjalë: nëse ti i lexon ato dhjetë herë në mëngjes dhe dhjetë herë në mbrëmje, ti do të fitosh dhjetë shpërblime, do të të fshihen dhjetë mëkate dhe ti do të lartësohesh dhjetë gradë. Veç kësaj, në ditën e Kiametit ti do të shpërblehesh sikur të kesh liruuar dhjetë skllavër! Ja fjalët që do të thuash ti: ‘Nuk ka zot tjetër veç Allahut, e Tija është e tërë pasuria dhe i tërë mbretërimi. Vetëm Ai meriton të lëvdohet; Ai nuk ka as shok, as ortak në krijimin e gjithësisë.’*”, – i tha Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).”²²

Në një transmetim tjetër, te Taberaniu, thuhet: E tregon Ebu Ejub el-Ensari (radijallahu anhu): “Kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mërgoi në Medinë, ai erdhi të qëndrojë në shtëpinë time. Unë i thashë:

- “O Resulallah! T’u bëfshin kurban nëna dhe babai im, mua nuk më duket aspak e hijshme, që unë të qëndroj sipër dhe ti të qëndrosh këtu, poshtënesh.” Por, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më tha:

- “*Për ne më e duhura është që të qëndrojmë në katin e poshtëm, sepse të shumtë do të jenë ata që do të ikin e do të vijnë.*” Një ditë ne na u thye shtamba që kishim dhe u derdh ujë. Nga frika se mos ai ujë rridhte poshtë dhe bezdiste Resulullahun, unë dhe gruaja ime morëm një jorgan kadifeje që kishim dhe e hodhëm mbi ujë dhe u përpoqëm që ta thithnim ujin në jorgan. Nuk kishim jorgan tjetër veç tij.

Po ashtu, kur i përgatitnim ushqim Resulullahut dhe qëllonte që Resulullahu të na e kthente pas ushqimin që kishte mbetur; ne

²². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/749 (4959).

menjëherë gjurmonim vendet ku kishin prekur gishtat e tij dhe e hanim atë që kishte mbetur, duke shpresuar që Zoti të na falte begati. Një mbrëmje ai na e ktheu ushqimin të paprekur, ashtu siç ia patëm çuar. Në ushqim kishim hedhur a qepë a hudhra. Pashë që nuk e kishte prekur fare ushqimin, kështu që shkova ta pyesja, se pse nuk kishte ngrënë fare. Ja se si më tha:

- “Në ushqim dallohej era e asaj zarzavateje. Unë jam një njeri që i përgjërohet vazhdimisht Zotit të tij; nuk doja që ajo aromë të përhapej në gojën time. Por ju mund ta hani.”²³

Çështja e një ulluku mes Omerit dhe Abasit (r.a.)

E tregon Ibni Abasi (radijallahu anhu): “Në murin e shtëpisë së babait tim, Abasit (radijallahu anhu), ishte një ulluk i gjatë, i cili zgjatej tej rrugës nga kalonte edhe Omeri (radijallahu anhu). Një dite të premte, Omeri (radijallahu anhu) u vesh dhe doli jashtë. Në atë kohë, Abasi kishte therur dy zogj të vegjël. Dhe, ndërsa po kalonte Omeri (radijallahu anhu) andejpari, mbi rroba i pikuan nja dy pika gjak nga gjaku i zogjve. Omeri (radijallahu anhu) urdhëroi menjëherë që të hiqej ai ulluk, ndërsa vetë u kthye në shtëpi, për t’u ndërruar; veshi diçka tjetër dhe erdhi tek ne, të na falte namazin e xhumasë. Pas namazit, babai im, Abasi (radijallahu anhu), erdhi te Prijësi i Besimtarëve dhe i tha:

- “Pse e hoqe atë ulluk, uallahi atë e ka vendosur vetë i Dërguari i Allahut!” E dëgjoi Omeri (radijallahu anhu) dhe i tha Abasit:

- “Për hir të Zotit, të shkojmë tani dhe hip mbi shpinën time dhe vëre në vend atë ulluk, atje ku ishte!” Dhe kështu bënë, Abasi bëri atë që i tha Omeri (radijallahu anhu).”²⁴

Sa shumë e respektonin minberin e Profetit tonë Abdullah bin Omeri dhe disa sahabë të tjerë

Tregon Ibrahim bin Abdurrahman bin Abdulkariu: “Njëherë, e

²³. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir*, 4/119 (3855).

²⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/210 (1790).

gjeta Ibni Omerin (radijallahu anhu) teksa e vuri dorën në minberin e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), pastaj e hoqi dhe fërkoj ballin e tij.”

Kurse Jezid bin Abdullah bin Kusajti tregon: “Unë pashë disa nga sahabët e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), pasi u larguan besimtarët nga xhamia, që vendosnin dorën e djathtë në rrethimin në krah të Varrit të Bekuar të Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe minberit të tij, pastaj ktheheshin kah kibleja dhe luteshin.”²⁵

5. SAHABËT NISËN TË QANIN, KUR NË UHUD DIKUSH THA “VRANË RESULULLAHUN!”

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) rrëfen: “Atë ditë që u zhvillua lufta e Uhudit, medinasit (dëgjuan se ishte vrarë i Dërguari i Allahut) filluan nga përgatitjet për të braktisur qytetin dhe lajmëronin këdo që u dilte përpara:

- “Kanë vrarë Muhamedin!” Medina u mbulua nga klithmat e vajtimit. Në atë kohë, një grua nga ensarët, e veshur me një veshje të trashë leshi u nis drejt fushëbetejës, që të mësonte se si qëndronte e vërteta. Atje ajo gjeti edhe trupat e të shoqit dhe të të vëllait, por nuk e mbaj mend se cilin syresh gjeti të parin. Ecte nëpër fushëbetejë dhe pyeste për trupat:

- “Po ky kush është?”, – dhe ata i përgjigjeshin:

- “Babai yt, vëllai, burri, djali!” Kurse ajo nuk reagonte, por pyeste:

- “Po Resulullahu ku është, si është?” Derisa, më në fund dikush i tha:

- “Është atje tej!” Ajo grua shkoj tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), e kapi atë nga rroba e tij dhe i tha:

- “O i Dërguari i Allahut! T’u bëfshin ty kurban nëna dhe babai im! Mjafton që qenke gjallë ti, pa le të ketë vdekur kush të dojë, nuk mërzitem kaq! Tani mua çdo e keqe më duket fare e vogël!”²⁶

²⁵. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/254.

²⁶. Taberani, *Mu’xhemu’l-Eusat*, 7/280 (7499).

Dashuria që ndiente Ebu Talhaja për Profetin tonë

E tregon Enesi (radijallahu anhu): “Ebu Talhaja (radijallahu anhu), në luftën e Uhudit, qëndronte përpara Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe shigjetonte armikun me hark dhe qëndronte para të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) për ta mbrojtur. Ebu Talhaja (radijallahu anhu) ishte një shigjetar mjaft i mirë. Sa herë që ai lëshonte ndonjë shigjetë, Resulullahu e ndiqte me sy shigjetën, deri në vendin ku binte ajo. Kurse Ebu Talhaja i thoshte:

- “Kurban t’u bëfshin ty nëna dhe babai im, o Resulullah, kujdes mos të prek ndonjë shigjetë!”, – dhe, sakaq, e rrekej ta vinte kraharorin e vet përpara kraharorit të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), duke shtuar:

- “O Resulullah, unë jam i fortë dhe duroj, më dërgo mua në çdo punë që ke, mjafton që të më urdhërosh ti, se nuk kam punë që nuk do ta bëj!”²⁷

6. SI QANIN SAHABËT FISNIKË, KUR KUPTUAN SE PROFETI YNË DO TË NDAHEJ NGA KJO BOTË

Të qarët e Ebu Bekrit (r.a.)

Tregon Ebu Saidi (radijallahu anhu): “Kur Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte i sëmurë, ai erdhi tek ne me një rrobë të lidhur në kokë; bëri disa hapa përpara dhe u ngjit në minber, e tha:

- “*I betohem Allahut, se tani më duket sikur po qëndroj mbi një hauz me ujë.*” (Kishte një arsye Resulullahu që i tha këto fjalë; në një hadith të tijin të bekuar thuhet: “*Minberi im qëndron si mbi një hauz.*”, duke dashur që t’u bëjë të ditur të gjithëve se vendi ku qëndronte minberi ishte pikërisht vendi ku shtrihej Burimi i Keutherit.) Pastaj, duke folur për veten, tha:

- “*Një rob e lanë të zgjidhte mes kësaj bote dhe jetës së përtejme; megjithatë, ai zgjodhi jetën e përtejme.*”

Përpos Ebu Bekrit (radijallahu anhu), askush nuk e kuptoi se çfarë donte të thoshte Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) me ato fjalë.

²⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/27.

Nga sytë e Ebu Bekrit filluan të rridhnin lot; qau dhe u ngrit e i tha:

- “O i Dërguari i Allahut, kurban t’u bëfshin nëna dhe babai im! Jo, jo, gjithë baballarët, nënat, jetët dhe gjithë ç’kemi ne t’u bëfshin kurban!” Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) zbriti nga minberi dhe pas asaj dite nuk u ngjit më në të.”²⁸

Alaja (radijallahu anhu) përcjell se: “Në kohën që te Profeti ynë i dashur (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) filluan të shfaqeshin shenjat e para që nuk do të jetonte edhe shumë gjatë, vajza e tij Fatimja filloi të qajë.

- “*Mos qaj, bija ime! Dhe kur të vdes unë, thuaj ‘in’na lil’lahi ue in’na ilejhi raxhiun’, sepse kjo fjalë e qetëson njeriun përballë të gjitha fatkeqësive.*”, – e këshilloi Fatimen i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). E dëgjoi Fatimja (radijallahu anha) dhe e pyeti:

- “O i Dërguari i Allahut, *In’na lil’lahi ue in’na ilejhi raxhiun’*; ‘Ne të Allahut jemi dhe nuk ka dyshim se vetëm tek Ai do të kthehemi’, a e qetëson kjo njeriun edhe për vdekjen tënde?”

- “*Po!*”, – iu përgjigj Resulullahu.”²⁹

Të qarët e Muadhrit (r.a.)

Tregon Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu): “Në kohën që Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më dërgoi mua si vali në Jemen, ai erdhi të më përcjellë mua deri në të dalë të Medinës. Unë kisha hipur mbi deve, kurse ai ecte në këmbë. Më këshilloi për disa gjëra, pastaj më tha:

- “*Muadh! Ta dish mirë, se pas një viti mund të mos më shohësh dot më! Me shumë gjasa do të vish të më vizitosh te varri im pranë xhamisë!*” Një t’i dëgjuar ato fjalë, më kaploi një hidhërim që nuk mund ta përshkruaj dot me fjalë, që do të ndahesha nga miku im, nga i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe fillova të qaja.

- “Mos qaj, o Muadh,” – më tha i Dërguari Fisnik, – “njerëzit që janë më të afërt me mua, kushdo dhe ngado qofshin, janë ata që i frikësohen me të vërtetë Allahut.”³⁰

²⁸. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/91 (11881).

²⁹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 2/312.

³⁰. Hejthemî, *Mexhmen’u’Zenaid*, 3/103 (4036).

7. NDARJA NGA JETA E PROFETIT TONË TË DASHUR

Jezid bin Babenusi tregon: “Bashkë me një mikun tim shkuam për vizitë tek Aishja (radijallahu anha). Kërkuam leje për të hyrë brenda dhe ajo na e dha. Na vuri edhe një jastëk, ku të uleshim në tokë dhe filloi të na tregojë:

- “Sa herë që i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) shkonte te gratë e tjera, kalonte përpara derës sime dhe më thoshte ndonjë këshillë, nga e cila mund të përfitoja shumë. Por, një ditë kaloi pa u kthyer, që të më thoshte ndonjë gjë. Pastaj kaloi prapë, e prapë nuk më tha asnjë fjalë. Kaloi edhe njëherë tjetër, për herë të tretë, e nuk më tha asgjë. Paskëtaj i thashë shërbyeses që kisha në shtëpi:

- “Vendos një jastëk te pragu i derës!” Dhe lidha kokën me një rrobë. Kësaj here, kur kaloi sërish, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më pyeti:

- “*Çfarë ke kështu, moj Aishe?*”

- “Më dhemb pak koka.”, – iu përgjigja unë.

- “*Ah, edhe mua po më dhemb shumë koka.*”, – tha dhe u largua. Nuk kaloi shumë, kur atë e sollën te dhoma ime, duke e ngritur mbi një copë të madhe rrobe.

- “Jam i sëmurë, e nuk mund të vij dot më nëpër ju. Më lejoni, që të qëndroj këtu, pranë Aishes.”, – u tha ai grave të tjera.

Tanimë për të nisa të kujdesesha unë. Megjithëse, më herët nuk isha kujdesur kurrë për një të sëmurë. Një ditë, e kishte kokën mbi supin tim dhe e afroi edhe më shumë drejt kokës sime. Mendova se donte ndonjë gjë, kur në atë çast nga goja i rrodhi një pikë shumë e ftohtë, e cila më ra mu në mes të kraharorit, m’u rrëqeth mishi. Mendova se ra pa ndjenja, ndaj e mbulova me një shtrojë që kisha aty pranë. Bash në atë çast erdhi Omeri (radijallahu anhu) me Mugire bin Shu’ben dhe kërkuam leje për të hyrë. U dhashë leje. Omeri pa nga Resulullahu dhe tha:

- “I Dërguari i Allahut paska rënë pa ndjenja! Po paska rënë shumë rëndë!” Pastaj u ngritën, e kur iu afruan derës, gati për të dalë, Mugireja tha:

- “O Omer! Resulullahu ka mbaruar!”

- “Jo, ai nuk ka vdekur, ti do që të nxitësh ngatërresa! I Dërguari i Allahut nuk ka për të vdekur pa i qeruar mirë hipokritët me rrënjë!”, – tha menjëherë Omeri.

Pasi ikën ata, erdhi babai im, Ebu Bekri. E ngrita shtrojën. Babai pa fytyrën e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe tha:

- “*In’na lil’lahi ue un’na ilejhi raxhiun*, Profeti ynë paska vdekur.” Pastaj iu ul te kryet, u përkul dhe e puthi në ballë.

- “Ah, ah, na iku Profeti ynë!”, – tha dhe ngriti kokën. Pastaj u përkul prapë, e puthi në ballë dhe tha:

- “Iku miku im!” – dhe e ngriti kokën. U përkul edhe njëherë, e puthi Resulullahun në ballë dhe tha:

- “I mjeri unë! Iku miku im, shpirti im, i dashuri im; vdiq i Dërguari i Allahut!” Doli dhe shkoi drejt e në xhami. Në atë kohë Omeri (radijallahu anhu) po u fliste besimtarëve duke u thënë:

- “Jo, Profeti nuk vdes pa i qeruar njëherë mirë e mirë Allahu të gjithë hipokritët!”

Aty filloi të flasë babai, lëvdoi dhe përgëzoi emrat e Allahut dhe u këndoi atyre ajetet: “**Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht, që edhe ata do të vdesin.**” (Zumer, 39/30); ajetin e sures Al ‘Imran, “**Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahu. Dhe Allahu do t’i shpërblejë falënderuesit.**” (Al ‘Imran, 3/144). Mandej u tha atyre:

- “Kushdo që e njeh Allahun si Zot, ta dijë se Allahu është i Gjallë, Ai ua fal jetën tërë gjallesave, nuk vdes kurrë. Por kush ka adhuruar Muhamedin, ta dijë se Muhamedi ka vdekur!” Pas kësaj, Omeri (radijallahu anhu) tha:

- “Këto ajete, janë në librin e zbritur nga Allahu?!”, – dhe, menjëherë, u drejtua nga njerëzit, duke u thënë:

- “O njerëz! Ky është Ebu Bekri, myslimani i parë, të lidhni menjëherë besën me të!”³¹

³¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 5/24.

Të larët e Profetit tonë të dashur dhe përgatitja e tij me qefin

Ja se si e tregon Aliu (radijallahu anhu): “Kur filluam të bënim gati Resulullahun, ta lanim dhe ta vishnim me qefin, e mbyllëm derën dhe nuk lejuam askënd të hynte brenda. Ensarët kërkonin:

- “Ne jemi dajat e tij! Ju e dini mjaft mirë vendin tonë në Islam!” Ndërsa kurejshët thoshin:

- “Ne jemi fisi i tij nga babai! Duhet të na merrni edhe ne brenda!” Atëherë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) doli dhe u foli:

- “O myslimanë! Mbajta e xhenazes, më shumë se kujtdo, u takon të afërmeve të tij. Largohuni më tutje, nëse e doni Allahun! Nëse hyni brenda, ju do t’i lini larg ata që ishin më të afërt me Resulullahun. Të mos hyjë atje askush, përveç pjesëtarëve të familjes së tij (duke pasur parasysh Aliun dhe Abasin radijallahu anhumë).”³²

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Në kohën që Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u rëndua, bashkë me të ishin edhe Aishja me Hafsanë (radijallahu anhumë). Aty hyri Aliu (radijallahu anhu) dhe Profeti ynë kur pa Aliun ngriti kokën dhe i tha:

- “*Afrohu, afrohu këtu pranë meje.*” – Aliu (radijallahu anhu) u afrua shumë pranë tij dhe deri sa dha shpirt, Aliu (radijallahu anhu) i qëndroi te koka Resulullahut.

Kur Resulullahut e dorëzoi shpirtin te Zotit, Aliu (radijallahu anhu) u ngrit dhe mbylli derën. Te dera erdhën babai im, Abasi, dhe ata që ishin nga bijtë e Abdulmutalibit, të cilët qëndruan aty, përpara derës. Aliu (radijallahu anhu) i thoshte:

- “Kurban t’u bëftë ty babai im! I bukur ishe i gjallë e sa të bukur e ke edhe vdekjen!” Në atë kohë nëpër dhomë u përhap një aromë shumë e mirë, që ç’të thuash. Babai im, Abasi, i tha Aliut:

- “Hesht, mjaft qave si gratë dhe eja filloni ta bëni gati e ta vishni me qefin.” Aliu (radijallahu anhu) tha:

- “Më thërrisni Fadl bin Abasin!” Ensarët thoshin:

³². Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 2/61.

- “Në e do Zotin, o Ali, na merr edhe ne brenda!”, – dhe Aliu (radijallahu anhu) mori vetëm Eus bin Haulin (radijallahu anh) prej tyre. Eusi kishte një shtambë në dorë. Bash në atë kohë, në shtëpi dëgjuan një zë që tha:

- “Mos ia hiqni Resulullahut këmishën; lajeni ashtu, siç është, pa ia hequr këmishën.” Prandaj, ata nuk ia hoqën rrobat. Ishte Aliu që e fuste dorën poshtë këmishës, kurse Fadli thjesht sa e ngrinte këmishën, ndërsa Eusi hidhte ujë. Aliu (radijallahu anhu) kishte lidhur një copë rrobë rreth dorës, për ta futur atë poshtë këmishës.”³³

Si u fal namazi për të Dërguarin e Allahut?

Sipas një transmetimi që vjen nga Aliu (radijallahu anhu), Profetin tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e vunë mbi një mbështetëse dhe Aliu (radijallahu anhu) tha:

- “Në xhenazën e Resulullahut nuk mund të dalë askush imam. Ai ishte imami juaj, si në këtë jetë, ashtu edhe tani që është i vdekur!” Atëherë njerëzit hynë në grumbuj, krijuan radhët dhe thirrën *tekbirë*, duke e falur namazin pa imam. Aliu (radijallahu anhu) qëndroi mu përpara të Dërguarit të Allahut dhe nisi të lutej:

“Es-Selamu Alejke, o Profet! Qofshin mbi ty mëshira dhe begatia e Allahut! O Zot, ne të dëshmojmë se ai e përcolli më së miri gjithçka që iu zbrit, duke i treguar umetit të tij rrugën e së drejtës dhe të së vërtetës. Dhe ai luftoi në rrugën e Allahut, derisa Allahu e nxori ngadhënjimtare fenë e tij, duke e përplotësuar fjalën e dhënë.

O Zoti im! Bëna ne prej atyre që i binden Kur’anit që iu zbrit atij. Na mbaj ne të palëkundur e të qëndrueshëm në Islam edhe tani që ai nuk është më mes nesh, e na bashko ne me të kur të vdesim.” Ndërsa gjithë besimtarët i thoshin “amin”. Në këtë mënyrë, njëherë burrat, pastaj gratë dhe, në fund, fëmijët, e falën të gjithë namazin për të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).”³⁴

³³. Hejthemî, *Mexhmu’u’-Zenaid*, 8/612 (14266).

³⁴. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/70.

8. NDARJA NGA JETA E PROFETIT TONË I BËNTE SAHABËT TË PREKESHIN E TË QANIN EDHE MË PAS

Nga mërzia Osmani (r.a.) u bë si i hutuar për njëfarë kohe

E rrëfen vetë Osmani (radijallahu anhu): “Pasi u nda nga jeta Resulullahu, sahabët e tij u mërzitën aq shumë, saqë shumë syresh filluan të flisnin pa i kontrolluar mirë fjalët që thoshin. Ja, një prej tyre isha edhe unë. Një ditë pasi të gjithë lidhën besën me Ebu Bekrin (radijallahu anhu), unë isha ngjitur në njërën prej ndërtesave më të larta të Medinës, po rrija në hije. Kishte kaluar Omeri dhe më kishte përshëndetur; kurse unë nuk e pata dalluar as atë, që kishte kaluar, as selamin nuk e kisha dëgjuar fare. Omeri (radijallahu anhu) kishte shkuar tek Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe i kishte thënë:

- “O kalifi i të Dërguarit të Allahut! Kam diçka të çuditshme për të të thënë. Teksa po vija, pashë Osmanin dhe i dhashë selam, por ai nuk ma ktheu selamin!”³⁵

Të qarat e nënës sonë, Ummu Selemes (r.a.)

Ummu Selemeja (radijallahu anha) tregon vetë: “Atë ditë që u nda nga jeta Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue se’l’lem) ne u mbledhëm të gjitha përreth dhe po qanim. Atë natë nuk vumë gjumë në sy. E kishim ende në shtëpi të Dërguarin e Allahut; shikonim trupin e tij shtrirë dhe kjo ende sikur na qetësonte pak. Mirëpo, në agim, kur dëgjuam zhurmën që lëshonin kazmat lëshuam të gjithë një klithmë. Edhe besimtarët, që ishin mbledhur në xhami lëshuan një klithmë akoma edhe më të madhe! Medina u tund nga klithmat! Sidomos kur Bilali (radijallahu anhu) këndoi ezanin e mëngjesit dhe zuri të qajë me ngashërim sapo arriti te pjesa “*Esb’bedu en’ne Muhamede’r-Resulullah*”, na tronditi edhe më shumë. Njerëzit u turrën të hynin ata vetë në gropën e varrit, prandaj edhe e mbyllën nga brenda. Çfarë ishte ajo fatkeqësi, që o Zot! Sa herë që na ndodhte ndonjë e keqe, ne na kujtohej ndarja nga jeta e Resulullahut dhe nuk i jepnim shumë rëndësi të keqes që na kishte ndodhur.”³⁶

³⁵. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 2/84.

³⁶. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/121.

Gjendja e sahabëve në Mekë, kur morën vesh se Profeti ynë i dashur ishte ndarë nga kjo jetë

Tregon Ubejdullah bin Umejri (radijallahu anhu): “Atëherë, kur vdiq Profeti Fisnik, në Mekë vali ishte Atab bin Esidi (radijallahu anhu). Me të ardhur lajmi i kobshëm për të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) në Mekë, të gjithë sa ishin në Xhaminë e Shenjtë filluan të vajtonin e të ulërinin. Atabi doli nga Meka dhe u fut në luginë. Nga pas i shkoi edhe Suhejl bin Amri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- “Hajde, kthehu përpara njerëzve, thuaju diçka, ata kanë nevojë që ti t’u thuash një fjalë.”

- “Nuk kam as fuqi, as takat t’i flas kujt.” – tha Atabi.

- “Mirë,” – ia ktheu Suhejli, – “eja me mua. Do të flas unë në vendin tënd.” Të dy bashkë u kthyen në Xhaminë e Shenjtë. Suhejli u ngrit në këmbë, lëvdoi dhe përgëzoi cilësitë e Allahut (xhel’le xhelaluhu) dhe mbajti një fjalë të ngjashme me atë që kishte mbajtur edhe Ebu Bekri (radijallahu anhu) në Medinë; nuk la asgjë pa thënë.

Ai që e përcjell këtë transmetim thotë se: “Në kohën që Suhejl bin Amri ishte rob lufte ditën e Bedrit, Omeri (radijallahu anhu) kishte tentuar që t’i hiqte dhëmbët një e nga një, mirëpo Resulullahu (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) pati ndërhyrë dhe i pati thënë: *“Mos e ngacmo atë! Kushedi, ndoshta Allahu e lartëson atë në një gradë që ty ka për të të pëlqyer.”* Ja, kjo ishte grada që kishte paralajmëruar i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të); grada e atij që një ditë do të qetësonte mbarë myslimanët e Mekës!”³⁷

9. CILAT ISHIN FJALËT E PARA TË SAHABËVE KUR MORËN VESH PËR VDEKJEN E PROFETIT TONË?

Ebu Bekri (r.a.)

Muhamed bin Is’haku, në ato që transmeton prej të atit, tregon se: “Kur u nda nga kjo jetë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), Ebu Bekri (radijallahu anhu) tha:

³⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/401 (37136).

- “Ja, sot, ne humbëm fjalën hyjnore, atë fjalë që na vinte përherë nga lartësitë e Allahut! Ajo nuk do të na vijë më.”³⁸

Ummu Ejmeni (r.a.)

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Pak kohë pas ndarjes nga jeta e Resulullahut, Ebu Bekri i tha Omerit (radijallahu anhum):

- “Eja, shkojmë tek e liruara e Profetit, Umu Ejmeni, t’i shkojmë edhe ne për vizitë, siç bënte Resulullahu.” Kur të dy miqtë shkuan tek Umu Ejmeni, ajo filloi të qajë. E pyetën:

- “Po pse qan? A nuk e di ti, që shpërblimet e Allahut për Profetin (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) janë shumë herë më të mira?”

- “Po unë nuk qaj ngaqë nuk e di se pranë Allahut e pret diçka më e mirë Resulullahun, por që këtej e tutje nuk do të na vijë më asnjë fjalë, asnjë shpallje, nga Allahu i Madhërishëm.” – u përgjigj ajo. Këto fjalë të Ummu Ejmenit i prekën shumë, si Omerin, ashtu edhe Ebu Bekrin (radijallahu anhum), e filluan edhe ata të qanin.³⁹

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) vdiq dhe Fatimja (radijallahu anhu) i shprehte ndjenjat e saj me këto vargje:

“Zgjobu baba, zgjobu, se erdhi thirrja e Allahut!

Baba, që vendin e ke në Xhenetin Firdeus!

Zgjobu baba, se e njoftuam dhe Xhibrilin që ti na ike!”

Në çastin kur u varros Profeti ynë i nderuar, Fatimja (radijallahu anha) më tha: “Ah, more Enes! Si jua bën zemra dhe hidhni dhë mbi të Dërguarin e Allahut?”⁴⁰

³⁸. El-Hindi, *Kenẓul-Ummal*, 7/395 (18760).

³⁹. Bejhaki, *Sünen*, 7/93 (13314).

⁴⁰. Buhari, *Sabih*, 4/1619 (4193).

Elegjia e hallës së tij, Safijes, kur mori vesh për vdekjen e Profetit tonë

Tregon Urueja: “Safije binti Abdulmutalibi (radijallahu anha), një të marrë vesh për ndarjen nga jeta të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) filloi të thurte menjëherë një elegji:

“U vrava në shpirt, e si ata që u kanë grabitur tërë pasurinë, nuk m’u mbyllën fare sytë këtë natë. Ah ta kisha shijuar unë atë vdekje!

O i Dërguari i Allahut! Ne ty të kishim shpresë, se ti na bëje më të mirat. Aq shumë na doje, e kurrë nuk na u rëndove.

O Profeti ynë, ku kishte njeri më të dhembshur e plot mëshirë si ti, o Profeti ynë. Të qajë kush të dojë, që sot që ike ti. Ju betohem për jetën time, se unë nuk qaj pse vdiq Profeti! Qaj se e di se ç’rrëmuja e ngatërresa do të lindin pas ikjes së Muhamedit. Unë humba Muhamedin, e zemra më djeg sikur të kisha hedhur në xham të shkrirë.

O Fatime! Zoti i Muhamedit e mëshiroftë atë trup që prehet në tokën e Medinës.

O Resulullah! E le jetim Hasanin. Sot ai qan e qajnë e të tjerët me të, kërkon ku është gjyshi. Kurban iu bëfshin nëna, tezja, halla, shpirti im, gjithë ç’kam të afërt dhe të largët, atij të Dërguari. Durove e durove, gjersa profetësinë tënde përmbushe. Na le ne një fe të pastër, të fortë e të kulluar, pastaj ike në amshim, e na le ne këtu të vetmuar.

Të të kishte lënë ty Zoti mes nesh, të na bënte ne fatlumë. Por ne e dimë, se urdhri i Tij vjen një ditë e do të ndodhë. Mbi ty qoftë paqja e Zotit, e ti i kënaqur të hysh, në shtëpinë tënde të merituar, në Xhenetin Adn!”⁴¹

Qëndrimi i sahabëve fisnikë ndaj atyre që shfaqnin mungesë respekti ndaj Profetit tonë

Ka’b bin Alkameja tregon: “Garafe bin Harith el-Kindiu (radijallahu anhu), i cili ishte një prej atyre të nderuarve që kishin pasur nderin të merrnin pjesë në bisedat me Profetin tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi

⁴¹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 2/325.

ue sel'lem), kur mori vesh se një i krishterë kishte sharë Profetin tonë, e kishte kapur atë njeri të mallkuar, e pati rrahur, aq sa i pati thyer edhe hundën. Për këtë ngjarje e mori vesh edhe Amr bin Asi. Amr bin Asi (radijallahu anhu) e pyeti Garafen:

- “Po ne u kemi garantuar se do të jenë të sigurt jomyslimanëve. Pse e bërë atë?” Garafeja iu përgjigj:

- “Ç’do të thotë kjo! Ne nuk u thamë atyre që nuk do t’i prekim që ata të na shajnë Profetin, apo jo? Ne atyre u thamë se nuk do t’ua preknim kishat, se mund të shkonin kur të dëshironin, të thonë atje çfarë të duan, që nuk do t’u kërkonim asgjë që ata nuk mund ta përballonin, se do t’i mbronim kundër armiqve, se mund ta zbatojnë si të duan fenë e tyre mes veti, dhe, se, për aq kohë sa ata do t’i pranonin vendimet tona, ne do të vendosnim për ta duke u bazuar te Libri i Allahut dhe te Suneti i të Dërguarit të Tij, e, nëse nuk do të vinin për të kërkuar një vendim nga ana jonë, ne nuk do të përziheshim në punët e tyre; nuk ishte kështu?”

10. REALIZIMI I PËRPIKTË I ÇDO URDHRI TË PROFETIT TONË

E tregon Urue bin Zubejri (radijallahu anhu): “Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati dërguar në Nahle një grup prej tetë vetash dhe në krye u kishte zgjedhur si komandant Abdullah bin Xhahshin (radijallahu anhu) dhe, teksa do t’i niste, ai i tha Abdullahut:

- “*Qëndroni atje derisa të merrni vesh çfarë po ndodh me kurejshët.*” Nuk i dha atij asnjë urdhër, që të luftonin, apo të mos luftonin. Këtë ekip i Dërguari i Allahut e pati dërguar gjatë muajit Rexhep, kur është e ndaluar të luftosh. Ende pa u nisur ai ekip dhe pa mësuar se ku do të shkonin, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i dha një letër Abdullah bin Xhahshit dhe i tha:

- “*Nisuni; mos e lexo këtë letër pa kaluar dy ditë. Pasi të keni udhëtuar për dy ditë rresbt, hape letrën, lexoje dhe bëj ato që të kam urdhëruar në të. Dhe mos detyro asnjë prej shokëve të tu!*”

Pasi ecën për dy ditë, Abdullahu (radijallahu anhu) e hapi letrën

dhe ç'të shihte, në letër shkruhej: *“Lëviz menjëherë dhe vendosu në Nable. Kontrolllo se çfarë janë duke bërë kurejshët dhe na njofto për ato që do të mësosh.”*

Ibni Xhahshi (radijallahu anhu), një ta lexuar letrën tha:

- “Si urdhëron.” Pastaj u drejtua nga shokët dhe u tha:

- “Profeti ynë më urdhëron që të shkojmë menjëherë në Nahle dhe të ruajmë kurejshët dhe të mbledhim informata se çfarë janë duke bërë ata. Si edhe më ndalon që të detyroj ndonjërin prej jush. Prandaj, kushdo që dëshiron të bjerë dëshmor të vijë me mua; unë po shkoj të zbatoj urdhrin e Profetit. Kush nuk do mund të kthehet pas!”, – dhe, sakaq, u nis në drejtim të Nahles. Me të shkuan edhe shokët e tij dhe asnjëri nuk u kthye pas. Shkuan në drejtim të Hixhazit. Kur mbërritën në vendin e quajtur “Buhran”, Sa’d bin Ebi Uakasi dhe Utbe bin Gazuani humbën devenë e tyre, të cilës i hipnin me radhë, njëherë njëri e njëherë tjetri. Duke u përpjekur që të gjenin devetë, mbetën mbrapa, kur të tjerët zbritën për në Nahle. Pas pak, aty kalon një karvan i kurejshëve që po sillte ushqime, si rrushi i thatë, nga Taifi. Në karvan ishte Amr bin Hadramiu, Hakem bin Kejsani dhe dy djemtë e Abdullahut, Osmani me Mugiren. Një nga sahabët, Uakid bin Abdullahu (radijallahu anhu) u afrua të ndiqte karvanin me sy; kokën e kishte të rruar. Kur kurejshët e panë Uakidin me kokë të rruar, thanë: “Këta do kenë ardhur për të vizituar Qaben, nga këta nuk vjen ndonjë e keqe.”

Atë ditë ishte dita e fundit e muajit Rexhep. Abdullahu dhe shokët e tij u mbledhën dhe thanë:

- “Nëse i vrasim ata, ne do të shkelim një muaj që duhet ta respektojmë. Nëse i lëmë, ata do të hyjnë në Mekë dhe ne nuk i sulmojmë dot, duke i humbur kësisoj nga duart.”, – kështu që vendosën të luftojnë me ta.

Uakid bin Abdullah Temimiu një shigjetë hedh dhe vret Amr bin Hadramiun. Osman bin Abdullahun dhe Hakem bin Kejsanin i zunë robër. Mugireja ia mbathi, atë nuk e kapën dot. Abdullahu me shokë, e morën karvanin dhe dy robërit e zënë dhe i çuan te Profeti ynë (pagja e Zotit qoftë mbi të) në Medinë. I Dërguari i Allahut tha:

- “Po unë nuk ju pata urdhëruar ju që të luftoni në një muaj, të cilin nuk

dubet ta shkelim.”; karvanin dhe dy robërit nuk i preku me dorë dhe nuk mori asgjë. Qortimi i të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i bëri të pendoheshin shumë, si Abdullahun, si shokët e tij. Mbetën duarlidhur. Pandehën se do të rrënoheshin aty në vend. Veç kësaj, shumë nga myslimanët i gjykuan rëndë.

Kurejshët një të marrë vesh për atë që kishte ndodhur, thanë:

- “Muhamedi derdhi gjak në muajin Rexhep; na ka marrë njerëzit peng; e shkeli edhe respektin që duhet të kemi ndaj muajve të ndaluar.” Lajmi mori dhenë. Për këtë, Allahu i Drejtë zbriti ajetin: **“Të pyesin ty për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaju: ‘Luftimi në atë kohë është gjynah i madh, por pengimi i njerëzve prej udhës së Allahut, mohimi i Tij, pengimi i njerëzve nga vizita e Xhamisë së Shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynah më i madh tek Allahu. Kurse adhurimi i idhujve është gjynah më i madh se vrasja.’ Ata vazhdimisht do të luftojnë kundër jush, që të mund t’ju kthejnë nga besimi juaj. Ata që e mohojnë fenë dhe vdesin si mohues, – veprat e tyre (të mira) do të humbasin në këtë botë dhe në tjetrën. Ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”** (Bekare, 2/217) Me zbritjen e këtij ajeti, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e mori plaçkën e atij karvani, ndërsa dy robërit i liroi në këmbim të shpagimit të paguar për ta.

Abdullahu dhe myslimanët që kishin qenë me të e pyetën:

- “O Resulallah, a do të ketë shpërblim si ai i të luftuarit në rrugën e Allahut edhe për këtë ndodhi?” Kur Allahu zbriti ajetin tjetër: **“Vërtet, ata që besuan dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në mëshirën e Allahut. Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”** (Bekare, 2/218)⁴²

Sahabët fisnikë i binden të Dërguarit të Allahut për t’u nisur në betejën kundër hebrenjve të Beni Kurejdhas

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) ka thënë: “Ditën që Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u kthye nga lufta e Hendekut në

⁴². Bejheki, *Sunen*, 9/58 (17768).

Medinë, nuk patën lënë mirë armët që kishin mbi trup, kur Xhibrili Besnik i urdhëroi atij: “Të mos e falë askush namazin e ikindisë pa mbërritur në vendin e Beni Kurejdhas!” Koha e ikindisë hyri në një kohë kur një pjesë e sahabëve nuk ishin kthyer ende. Megjithatë, një pjesë e tyre thanë se ‘nuk do ta falnin namazin pa mbërritur te Beni Kurejdha’, ndërsa një pjesë tjetër thoshte se ‘nuk ishte ky qëllimi i fjalëve të të Dërguarit të Allahut. Ai donte që ne të tregoheshim sa më të shpejtë. Prandaj, ne do ta falim namazin e ikindisë në kohën e vet.’ Megjithatë, më vonë, të dyja grupet i treguan Profetit tonë se si ishin sjellë, por Profeti ynë nuk mbajti asnjë qëndrim për asnjërin nga grupet.”⁴³

Sahabët në Hunejn u kapën fort pas urdhrave të Profetit të nderuar dhe dolën fitimtarë

Për këtë tregon Xhabiri (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), në ditën e Hunejnit, kur pa se myslimanët po pësonin disfatë, e urdhëroi Abasin (radijallahu anhu) që të thërriste:

- “*O ensarë! O ju që e lidhët besën nën hijen e pemës!*”

Në çastet kur zëri i Abasit (radijallahu anhu) filloi të dëgjohej anekënd, qielli u mbush nga zëra që bërtitnin:

- “Leb’bejk! Leb’bejk ja Resulallah, këtu jemi, gati si të na urdhërosh ti!” Asisoj, që ende pa e kthyer mirë devenë, çdokush hidhte parzmoren përsipër, nxirrte shpatën dhe mburojën dhe rendte për andej nga vinte zëri. Vetëm përreth të Dërguarit të Allahut u mblodhën, sa hap e mbyll sytë, njëqind vetë, të cilët u vërsulën menjëherë në drejtim të armikut. Thirrja e parë kishte qenë për të gjithë ensarët. Pastaj u bë edhe një thirrje tjetër, e cila i drejtohej vetëm fisit të Hazrexhëve, po nga ensarët, sepse ata luftonin me një mjeshtëri më të veçantë. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u zgjat të shikonte andej nga po luftohej kokë për kokë e shpatë për shpatë dhe tha:

- “*Ja, tani lufta është nxebur mirë!*” I betohem Allahut, se asnjë prej atyre që ia mbathën në fillim të luftës nuk qe kthyer ende, kur ne pamë që robërit ishin sjellë duarlidhur para Resulullahut! Kush ishte për t’u vrrarë nga armiqtë ishte vrrarë, ndërsa kush kishte mbetur gjallë kish

⁴³. Buhari, *Sahib*, 1/321 (904); Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/117.

përjetuar në moment disfatën më të rëndë të jetës së vet. Allahu ia fali Profetit të Tij të gjithë fëmijët dhe pasuritë e tyre.”⁴⁴

Dëshira e Abdullah bin Reuahas për t’iu bindur çdo urdhri të Profetit tonë

Tregon Abdurrahman bin Ebi Lejlaja: “Abdullah bin Reuaha (radijallahu anhu), një ditë, ndërsa vinte për në xhami, kaloi nëpër lagjen e Beni Ganmit dhe dëgjoi fjalën e të Dërguarit të Allahut, i cili në atë çast u tha besimtarëve:

- “*Uluni.*” Dhe ai u ul menjëherë aty ku ishte. Aty qëndroi i ulur, gjersa Profeti ynë mbaroi hutben. Kur e mori vesh për sjelljen e Abdullah bin Reuahas, Resulullahu i tha atij:

- “*Zoti ta shtoftë edhe më shumë dëshirën e zjarrit për t’iu bindur Atij dhe të Dërguarit të Tij!*”⁴⁵

Dëshira e Abdullah bin Mes’udit për t’iu bindur të Dërguarit të Allahut

Ataja (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte duke mbajtur një fjalë përpara bashkësisë në xhami dhe u tha atyre të uleshin. Abdullahu në atë kohë ishte te porta e xhamisë dhe me të dëgjuar fjalën ‘uluni’ të të Dërguarit të Allahut, u ul në tokë. Profeti ynë i nderuar e pa dhe i foli:

- “*Eja, Abdullah, byr brenda!*”⁴⁶

Kur një nga sahabët e shemb shtëpinë e sapondërtuar që nuk i pati pëlqyer Resulullahut

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, Profeti ynë i nderuar (paqja e Zotit qoftë mbi të), doli të shëtiste nëpër Medinë bashkë me ne. Rrugës pamë një konak më të lartë se të tjerët.

- “*I kujt është ky?*”, – na pyeti ai ne.

⁴⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/329.

⁴⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/419 (37172).

⁴⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/433.

- “Është i aksh njeriu, nga ensarët.” – i thanë. Resulullahu heshti, nuk tha asnjë fjalë. Por, me ç’duket ai nuk e pati harruar, sepse, një ditë, i zoti i asaj shtëpie e pati përshëndetur dhe Resulullahu nuk ia pati kthyer përshëndetjen, por edhe e pati kthyer fytyrën në anën tjetër. Kjo u përsërit disa herë. I ngrati burrë, e kuptoi menjëherë që Profeti ishte hidhëruar me të, kështu që shkoi dhe iu ankua sahabëve:

- “Uallahi, nuk e di ç’ka Resulullahu me mua, pse sillet kështu?” Ata e dëgjuan dhe i thanë:

- “Një ditë, Resulullahu doli të shëtiste dhe pa shtëpinë tënde, që ishte më e lartë se të tjerat.” Ky njeri nga ensarët u kthye menjëherë në shtëpi dhe e rrëzoi atë të gjithën, e bëri njësh me tokën.

Pas kësaj ngjarjeje, Profeti ynë (sal’allahu alejhi ue sel’lem) pati dalë sërish të shëtiste nëpër qytet. Nuk ia zunë sytë më atë shtëpi, kështu që pyeti ata që kishte përreth:

- “Çfarë i ndodhi asaj shtëpisë që ishte më e lartë se të tjerat?”

- “O Resulallah! Ai që e kishte erdhi e na pyeti, na u ankua ç’ka Resulullahu që nuk më kthen sytë. Dhe ne ia treguam kush ishte shkaku. Andaj, ai shkoi dhe e rrëzoi menjëherë të gjithë shtëpinë.” – iu përgjigjën ata.

- “Zoti e faltë!”, – tha Resulullahu për të. – “*Allahu e faltë! Allahu e faltë! Nuk ka pikë dyshimi, se çdo ndërtesë më e madhe se nevojat është një barrë shumë e madhe për atë që e ka.*”⁴⁷

Një prej sahabëve djeg veshjen e tij

Amr bin Shuajbi na tregon: “Njëherë, bashkë me Profetin tonë (paqja e Zotit qoftë mbi të) shkuam deri në kalimin e Edhahirit, që gjendet mes Mekës dhe Medinës. Unë kisha veshur një veshje të hollë, të butë dhe me ngjyra. I Dërguari i Allahut më pa dhe më pyeti:

- “Po këtë që ke veshur çfarë e ke?” E kuptova menjëherë, nuk i kishte pëlqyer ajo që kisha veshur. Sapo u ktheva në shtëpi, pashë, fëmijët kishin ndezur furrën e dheut, kështu që e mora atë veshje dhe e hodha në të, të digjej, pastaj u ktheva te Profeti ynë.

⁴⁷. Ebu Daud, *Sunen*, 2/781 (5237).

- “*Ku e çove atë që kishe veshur?*”, – më pyeti.
 - “E hodha në furrën e dheut, o i Dërguari i Allahut.”, – i thashë.
- Priti pak, pastaj më tha:
- “*T’ia kishe dhënë dikujt nga familja!*”⁴⁸

Sahabi me emrin “Khurejm” që pati shkurtuar flokët dhe rrobat

Sehl bin Handhalije el-Abshemiu (radijallahu anhu) tregon: “Për Khurejmin Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Sikur të mos i rriste ata flokë dhe të mos i tërbigte zvarrë ato rroba, sa njeri i mirë është Hurejm el-Esediu.*” Khurejmi, dëgjoi se çfarë kishte thënë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) për të, flokët që i derdheshin deri te supet i preu në mes, kurse rrobat që vishte i preu deri në lartësinë e pulpës së këmbës.”⁴⁹

Dëshira që tregonte Muhamed bin Eslemi për t’iu bindur çdo fjale të të Dërguarit të Allahut

Muhamed bin Eslem bin Buxhre, i cili ishte nga fisi i bijve të Harith bin Hazrexhit, ishte një burrë shumë i moshuar. Edhe shtëpinë e kishte në një zonë goxha larg qytetit të Medinës. Zbriste në Medinë, merrte çfarë kishte për të marrë në pazar, kthehej pranë familjes, hiqte teshat që kishte pasur veshur dhe sapo bëhej gati për t’u mbështetur, që të pushonte, i kujtohej menjëherë që nuk kishte falur namaz në xhaminë e të Dërguarit të Allahut dhe thoshte:

- “Uallahi nuk fala dy rekate namaz në xhaminë e Resulullahut; po ai na pati thënë, që: “*Kushdo nga ju që zbret në qytet, të mos kthehet pranë familjes pa falur njëherë dy rekate namaz në këtë xhami!*”, – vishte rrobat prapë, kthehej në Medinë dhe falte dy rekate namaz në Xhaminë e Profetit.”⁵⁰

Historia e një vajze të re nga ensarët

Mugire bin Shu’beja (radijallahu anh) tregon: “Unë i thashë

⁴⁸. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/179 (17659).

⁴⁹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/179 (17659).

⁵⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 6/1115 (17620).

Resulullahut se doja të martohesha me një vajzë nga ensarët. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) e pyeti:

- “*E ke parë vajzën?*”

- “Jo!”, – iu përgjigja unë.

- “*Shikoje njëherë, sepse kur e shikon, kjo është më e mirë, si për ta bërë më të mundur dasburinë për të, si për t’u mësuar me të.*” Ashtu bëra edhe unë, shkova dhe i tregova familjes së vajzës për qëllimin tim. Ata panë njëherë njëri-tjetrin. Unë u ngrita dhe dola jashtë. Sapo do të largohesha prej andej, kur vajza u tha atyre:

- “Ku është ai njeri, thërriteni!” Ajo vetë kishte qëndruar në një qoshe të shtëpisë. Mua më tha:

- “Nëse ty të ka këshilluar Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) që të vish e të më shohësh, atëherë më shih; përndryshe unë nuk dal përpara teje.” Atëherë unë i thashë se po, i Dërguari i Allahut më kishte këshilluar që të shkoja e ta shihja dhe nuk kaloi shumë kohë dhe ne u martuam me njëri-tjetrin. Kjo martesë ka qenë më e mira e më e mbara që kam bërë deri më tani.”⁵¹

**Ebu Dherri (r.a.) e zbatonte shkronjë për shkronjë
urdhrit e të Dërguarit të Allahut që të gjithë duhet
të silleshin sa më mirë me shërbyesit e tyre**

Tregon Ma’rur bin Suejdi: “Në Rebedhe, pranë Medinës, pashë Ebu Dherr Gifariun (radijallahu anhu) që kishte hedhur supeve një veshje të trashë. Edhe skllavin ashtu e kishte veshur. Disa vetë i thanë:

- “O Ebu Dherr, po t’i kishe blerë një veshje më të lirë skllavit dhe vetë të kishe blerë diçka më të shtrenjtë!” Paskëtaj, Ebu Dherri u tregoi atyre një ndodhi:

- “Në kohën e Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), njëherë unë qeshë përzier në një zënkë shumë të rëndë me dikë dhe e pata sharë nga nëna, i pata thënë:

- “O i biri i nënës me ngjyrë!” Pas kësaj, ai njeri shkoi drejt e te

⁵¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/798 (45619).

Resulullahu për t'u ankuar për mua. I Dërguari i Allahut më priti me fjalët:

- “*Shiko, Ebu Dherr, ti qenke një njeri që ke ende huqe nga ato të injorancës! Po skellëvërit janë vëllezërit tuaj. Përmes tyre Allahu ju ka falur juve shumë të mira. Nëse nuk mësoheni me ndonjërin syresh, shiteni; po të mos i mundoni dhe të mos i torturoni robt e Allahut.*”⁵²

Ndërsa në transmetimet e ardhura prej Buhariut, Muslimit, Tirmidhiut dhe shumë të tjerëve thuhet se i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i ka thënë kështu Ebu Dherrit (radijallahu anhu): “[...] *Ata skellëvër ju i keni vëllezër. Allahu jua ka dhënë ata në shërbimin tuaj. Kushdo që Allahu i ka dhënë një vëlla për t'i shërbyer, t'i japë atij të hajë nga ajo që ha edhe vetë, ta veshë me atë që vesh edhe vetë dhe të mos e ngarkojë me asnjë punë që nuk do ta bënte dot vetë. Dhe t'i vijë atij në ndihmë, nëse ai i kërkon ndihmë.*”⁵³

11. QËNDRIMI I SAHABËVE NDAJ ATYRE QË NUK I BINDESHIN FJALËS SË PROFETIT TONË TË NDERUAR

Aliu (r.a.) e kap Said bin Sufjanin për pelerine dhe e tërheq

Tregon Said bin Sufjani vetë: “Kur më vdiq vëllai, ai më porositi që njëqind dinarë nga trashëgimia e tij t'i shpenzoja në rrugën e Allahut. Për këtë arsye shkova te Prijësi i Besimtarëve, Osman bin Afani (radijallahu anhu). Afër tij qëndronte i ulur edhe dikush tjetër. Atë ditë mbi trup kisha të hedhur një pelerinë me jakë dhe anë të thurura me thekë mëndafshi. Ai burrë, vetëm se më pa të veshur ashtu më kapi për pelerine dhe zuri të më tërheqë. Edhe pak edhe do ta griste. Osmani (radijallahu anhu) i tha:

- “Lëshoje!”, – dhe ai më lëshoi, duke thënë:

- “Sa shpejt që i braktisë këshillat e të Dërguarit të Allahut!” Unë i thashë Osmanit (radijallahu anhu):

- “O Prijësi i Besimtarëve! Më ka vdekur vëllai, por para se të ndahej nga kjo botë më la amanet që të jepja nga paratë e tij njëqind dinarë në

⁵². Ebu Daud, *Sunen*, 2/761 (5157).

⁵³. Buhari, *Sabih*, 5/2248 (5703).

rrugën e Allahut. Çfarë më këshilloni të bëj? Si t’ia bëj?”

- “A pyete ndokënd përpara meje në lidhje me këtë punë?”, – më pyeti Osmani (radijallahu anhu).

- “Jo!”, – iu përgjigja unë.

- “Nëse ke shkuar më parë te ndokush tjetër, për t’i marrë mendim, dhe ai të ka dhënë një gjykim të ndryshëm nga gjykimi që do të të jap unë, ta dish se do të ta pres kokën! Allahu na urdhëroi ne të pranojmë Islamin dhe ne u bëmë myslimanë. Na urdhëroi të mërgonim nga vendlindja jonë, e ne mërguam pranë popullit të Medinës. Pastaj Ai na urdhëroi ne të luftonim në rrugën e Tij, luftuam. O sirianë, ju jeni luftëtarë. Ato para t’i përdorësh për veten, për familjen tënde dhe të tjerë që ke përreth vetes e mund të kenë shumë nevojë për to. Nëse ti e përdor një dërhem për të blerë mish, që ta çosh në shtëpi, ta hanë fëmija, ajo lëmoshë ty do të të shkruhet sikur të kesh dhënë shtatëqind dërhemë, jo një.” – më tha ai.

Kur dola nga Osmani (radijallahu anhu), pyeta se kush ishte ai që më kishte tërhequr fort për jake, e më thanë se kish qenë Ali bin Ebi Talibi. Paskëtaj shkova menjëherë në shtëpinë e Aliut (radijallahu anhu), për ta pyetur:

- “Pse u solle në atë mënyrë me mua, më vure re ndonjë të metë? Përgjigjia e tij ishte:

- “Unë nga Profeti i dashur (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kam dëgjuar se: *‘Nuk do të kalojë shumë kohë dhe umeti im do ta quajë si diçka të lejuar e të zakonshme qëndrimin pranë grave të huaja, ashtu si edhe veshjen me mëndafsh.’* I pari mysliman që shoh të veshur me mëndafsh je ti.”

Saidi thotë se: “Pas atyre fjalëve, e hoqa menjëherë atë pelerinë dhe shkova e shita.”⁵⁴

12. SHQETËSIMI I MADH I SAHABËVE FISNIKË SE MOS SILLESHIN NDRYSHE NGA AJO QË U KISHTE URDHËRUAR PROFETI YNË

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Atë ditë që u zhvillua lufta e

⁵⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 15/752 (41860).

Bedrit, Profeti i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha sahabëve të tij:

- “Në mesin e armiqve tanë unë njoh njerëz të atillë, nga fisi i bijve të Hashimit dhe fiseve të tjera, që i kanë nxjerrë me zor kundër nesh. Ata nuk kanë kurrfarë interesi për t’u përballur me ne. Nëse gjendeni ballë për ballë me ndonjërin prej tyre, të mos i vrisni. Nëse dikush përballët me Ebu’l-Bahteri bin Hishamin, të mos e vrasë atë. Kush përballët me xhaxhain tim, Abasin, të mos e vrasë atë; sepse ata i kanë detyruar që të dalin kundër nesh?” Atëherë Ebu Hudhejfeja (radijallahu anhu) i tha atij:

- “Do të vrasim etërit, djemtë dhe vëllezërit tanë, kurse Abasin do ta lëmë, apo jo? I betohem Allahut se po më doli përballë, unë do t’ia pres mishin në copa me shpatë.” Kur dëgjoi fjalët e Ebu Hudhejfes, i Dërguari Fisnik i tha Omerit (radijallahu anhu):

- “O Eba Hafs! (Ja, atë ditë më ngeli mua llagapi Ebu Hafs, kur më thirri i Dërguari i Allahut për herë të parë me atë emër) A qëllohet xhaxhai i të Dërguarit të Allahut me shpatë?”

- “O Resulallah! Më lejo mua t’ia ndaj kokën nga trupi Ebu Hudhejfes. Ky qenka bërë hipokrit!”

Ebu Hudhejfeja (radijallahu anhu) thoshte gjithmonë: “Thashë atë fjalë atë ditë dhe nuk e di se si do ta kem fundin, jam gjithmonë i shqetësuar; këtë mëkat nuk mund ta laj vetëm se duke rënë dëshmor!” Dhe, vërtet, Ebu Hudhejfeja (radijallahu anhu) ra dëshmor gjatë luftës së Jemames.”⁵⁵

Shqetësimi i Thabit bin Kajsit dhe sihariqi i të Dërguarit të Allahut për të

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: “Profeti i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte kohë që nuk e kishte parë Thabit bin Kajsin (radijallahu anhu).

- “Çfarë i ka ndodhur Thabitit, nuk është dukur fare?”, – pyeti ai njëherë. U ngrit dikush dhe i tha:

- “O i Dërguari i Allahut! Të shkoj unë dhe të shoh se çfarë ka

⁵⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/284.

Thabiti, ta mësoj unë për ju.” – dhe u nis të shkonte për te Thabiti. Ai e gjeti atë në shtëpi, kishte ulur kokën dhe rrinte i ulur, ndaj e pyeti:

- “Ç’është kjo gjendje? Çfarë të ka ndodhur?” Dhe ai iu përgjigj:

- “Jam shumë keq! Jam shumë keq, sepse Thabiti e ngre zërin më shumë se zëri i Resulullahut, e i janë shumëzuar me zero të gjitha punët që ka bërë deri më sot. Nuk ka më shpëtim për të, ai është tanimë një prej banorëve të Xhehenemit!” Sahabi që u takua me Thabitin u kthye te Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe i përcolli të tëra fjalët që i kishte thënë Thabiti. Më vonë, ai sahab u kthye për te Thabiti edhe njëherë, por kësaj here shkoi tek ai për t’i dhënë një lajm shumë të mirë. Profeti ynë i kishte thënë atij sahabi të shkonte te Thabiti dhe t’i thoshte:

- “*Ti nuk je nga banorët e Xhehenemit, përkundrazi, ti je një nga banorët e Xhenetit.*”⁵⁶

Ndërkohë që, nga e bija e Thabitit përcillet një tjetër transmetim, ku thuhet: “Babai mua më ka thënë se, kur u zbrit ajeti: **“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburravecët!”** (Lukman, 31/18), – unë u mbylla në shtëpi, e mbylla derën me reze nga brenda dhe fillova të qaja. Kur e mori vesh Resulullahu se në ç’gjendje isha, më dërgoi fjalë se më ftonte të shkoja tek ai. Unë i thashë atij:

- “O i Dërguari i Allahu! Allahu na thotë se ai nuk i do ata që u pëlqen vetja dhe mburren përpara njerëzve. Por unë jam një njeri që i pëlqen shumë të duket sa më bukur dhe që të jetë i pari në mesin e fisit të vet.” Por Resulullahu ma priti me fjalët:

- “*Ti nuk je nga ata. Ti bën një jetë për t’u lavdëruar nga të gjithë; ti do të vdesësh mirë dhe Allahu ka për të të futur ty në Xhenetin e Tij.*”⁵⁷

13. SAHABËT FISNIKË RREKESHIN QË TA IMITONIN PROFETIN TONË NË ÇDO LËVIZJE TË TIJ

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue

⁵⁶. Buhari, *Sahih*, 3/1322 (3417).

⁵⁷. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/261 (5036).

sel'lem) kishte një rrogë dhe gjatë natës atë e përdorte edhe si mur-perde, e vinte atë në këmbë dhe vetë kalonte pas saj dhe falte namaz. Kurse, gjatë ditës, e shtronte në tokë dhe ulej mbi të. Sahabët vinin te Resulullahu dhe falnin edhe ata aq namaz saç falte edhe ai. Kur numri i sahabëve që vinin për të falur namaz bashkë me të u shtua shumë, një ditë, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u tha:

- “O njerëz, kryeni aq adhurime sa mundësi të kenë. Nëse ju nuk mërzhiteni duke e adhuruar Zotin, Ai nuk lodhet që nuk lodhet nga të shëruarit e shpërblimeve për ju. Puna më e dashur tek Allahu është ajo punë që bëhet rregullisht e pa ndërprerje, sado e vogël a e pak të jetë ajo.”⁵⁸

I Dërguari i Allahut hoqi unazën dhe e hodhi poshtë, ashtu bënë edhe sahabët, i hodhën të gjithë unazat e tyre

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: “Sahabët panë një ditë në gishtin e Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) një unazë argjendi, kështu që morën edhe ata nga një unazë argjendi dhe e vunë në të njëjtin gisht. Dhe, kur i Dërguari i Allahut e hodhi poshtë unazën e tij edhe ata i hodhën menjëherë unazat e tyre.”⁵⁹

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më përpara përdorte unaza floriri. Por, një ditë, ai e hoqi atë unazë dhe e hodhi, e u kthye nga sahabët duke u thënë:

- “Këtë e tutje nuk do ta vë më këtë.” Që pas asaj dite edhe sahabët i hodhën poshtë unazat e tyre.”⁶⁰

Shtimi i fundit të pelerinës nga Osmani (r.a.) dhe pasimi prej tij i Profetit tonë gjatë tavafit të Qabes

Ijas bin Selemeja (radijallahu anhu) na përcjell nga babai i tij, se: “Para Paqes së Hudejbijes, drejtuesit e kurejshëve dërguan për të vlerësuar gjendjen e myslimanëve Harixhe bin Kurzin. Harixheja, kur u kthye në Mekë, filloi të mburrtë myslimanët, duke folur aq mirë për

⁵⁸. Buhari, *Sahih*, 5/2201 (5523).

⁵⁹. Buhari, *Sahih*, 5/2203 (5530).

⁶⁰. Buhari, *Sahih*, 5/2203 (5529).

ta, saqë kurejshët i thanë:

- “Ti je një arab beduin, të kanë treguar armët ata dhe ti je trembur! Ti nuk i kupton ato që të kanë thënë ata”, – dhe, kësaj here, dërguan Urue bin Mesudin, për të parë se në ç’gjendje ishin myslimanët. Urueja i tha Profetit tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Muhamed, si është kjo punë? Ti i thërret njerëzit që t’i besojnë Zotit, pastaj mbledh ca njerëz që as nuk i njeh fare dhe lufton me njerëzit e tu! Ti vetë po i shkëput marrëdhëniet me të afërmit e tu, duke tentuar t’u marrësh jetën dhe gjithçka që kanë ata në këtë jetë!” I Dërguari i Allahut ia priti me fjalët:

- “*Uallahi unë jam dërguar për t’i përforcuar edhe më tej lidhjet farefisnore, t’ua përmirësoj atyre fenë ku besojnë, duke sjellë një fe më të mirë, si dhe që t’u mundësoj atyre të jetojnë një jetë më të mirë.*” Kur u kthye Urueja në Mekë, ai u foli mekasve me fjalët dhe lavdërimet më të mira për myslimanët.

Selemeja thotë se: “Që pas asaj dite, idhujtarët e Mekës e shtuan edhe më shumë trysninë dhe ashpërsinë kundër myslimanëve. Profeti i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i tha Omerit (radijallahu anhu):

- “O Omer! A mund t’u dërgosh fjalë myslimanëve që janë zënë rob nga idhujtarët?”

- “O Resulullah! Unë nuk kam asnjë njeri të fisit tim në Mekë dhe ti e di që nuk kam të afërm atje. Por ka shumë myslimanë të tjerë që kanë shumë njerëz të afërm në Mekë, sikur të dërgonit njërin prej tyre, a nuk do të ishte më mirë?”, – iu përgjigj Omeri i nderuar (radijallahu anhu). Atëherë, Profeti ynë thirri Osmanin (radijallahu anhu) dhe e dërgoi në Mekë. Ndërsa po ikte drejt Mekës, i hipur mbi devenë e tij, në një pjesë të rrugës Osmani (radijallahu anhu) u përball me ushtrinë e idhujtarëve. Ata ushtarë e fyen rëndë Osmanin (radijallahu anhu), duke mos lënë asnjë fjalë pa thënë. Mirëpo atij i doli në mbrojtje djali i tij i xhaxhait, djali i Said bin Asit, e mori Osmanin (radijallahu anhu) dhe e hipi mbi samarin e kalit të vet, kurse vetë qëndroi në fundin e shpinës së kalit. Eban bin Saidi i tha Osmanit (radijallahu anhu):

- “O djali i xhaxhait, pse e ke kaq të vjetër këtë rrobë që ke veshur? Kurse fundin e paske më të gjatë.” Palët e fundit të veshjes së Osmanit të nderuar arrinin deri te pjesa e pasme e kërcirit të këmbës. Kësodore,

Osmani (radijallahu anhu) u tha atyre:

- “(Duke pasur parasysh të Dërguarin e Allahut). Sepse kështu vishet ai që është më i madhi ynë, prandaj vishem kështu!”

Osmani (radijallahu anhu), me të mbërritur në Mekë, nuk la asnjë rob mysliman pa i dhënë selamet e Resulullahut.

Selemeja thotë se: “Ne po flisnim me njëra-tjetrën, kur dëgjuam një tellall të thërriste:

- “O njerëz! Nxitoni të lidhni besën, nxitoni të lidhni besën, është zbritur *shpallja hyjnore*.” Vrapuam menjëherë drejt e tek i Dërguari i Allahut. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte poshtë pemës së samrasë; shkuam dhe i shpallëm besën tonë.

Ngjarja tregohet në ajetet: **“Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t’u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç’kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt e me një plaçkë të madhe që do ta fitojnë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”** (Fet’h, 48/18-19)

Gjatë betimit ndaj të Dërguarit të Allahut (pagja qoftë mbi të) Osmani (radijallahu anhu) ishte ende në Mekë. Prandaj, ai e goditi njëherë dorën me dorën tjetër, duke thënë:

- “Dhe kjo është besëlidhja e Osmanit!”

- “Sa mirë për Ebu Abdullahun (kështu e thërrisnin Osmanin radijallahu anhu)! Ai po shëtiti Qaben përreth, kurse ne jemi këtu.” – thoshin besimtarët me njëri-tjetrin. I Dërguari Fisnik tha:

- “*Sikur edhe kaq vite të rrijë Osmani atje, ai nuk i vjen Qabes përreth pa shkuar edhe unë për t’i ardhur asaj përreth.*”⁶¹

Një bisedë mes Ebu Bekrit (r.a.) dhe Omerit (r.a.) gjatë grumbullimit të Kur’anit Fisnik

Zejd bin Thabiti (radijallahu anhu) tregon: “Ebu Bekri (radijallahu anhu), pas luftës së Jemames, më dërgoi mua fjalë që të shkoja tek ai. Kur mbërrita, tek Ebu Bekri (radijallahu anhu) atje ishte edhe Omer

⁶¹. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, 7/386 (36852).

bin Hatabi. Ebu Bekri (radijallahu anhu), duke më treguar Omerin (radijallahu anhu), më tha:

- “Ky njeri më thotë se gjatë luftës së Jemames shumë prej hafëzëve ranë dëshmorë dhe hafëzët e tjerë mund të vriten në luftëra të tjera, prandaj është i shqetësuar se mos Kur’ani na del nga duart dhe e humbasim; për këtë arsye, thotë se ne duhet ta bashkojmë e ta lidhim Kur’anin (bërja bashkë e të gjitha ajeteve dhe të gjitha sureve në një lidhje të vetme, në trajtë libri). Unë i thashë (Omerit):

- “Si mund të bëjmë ne diçka që nuk e bëri Resulullahu?”, - por ai më tha se kjo që do të bëjmë është diçka shumë e mirë dhe nguli këmbë në të tijën. Më vonë, Allahu ma futi në zemër edhe mua atë që i futi në zemër Omerit; më duket me vend ky mendim i Omerit.” Omeri (radijallahu anhu) heshte, thjesht rrinte ulur dhe dëgjonte pa thënë asnjë fjalë. Pastaj Ebu Bekri vazhdoi:

- “O Zejd! Ti je një djalosh i zgjuar dhe i pjekur. Nuk kemi se me çfarë të të akuzojmë. Ti ishe ai që i shkruaje shpalljet hyjnore që i vinin Resulullahut, ndaj Kur’anin (në trajtë libri) do ta grumbullosh ti.”, – ky ishte propozimi i Ebu Bekrit (radijallahu anhu) për mua.

Zejdi (radijallahu anhu) thotë se: “Uallahi, sikur malin të më kërkonin ta luaja vendit, nuk do të më dukej aq i rëndë sa kjo fjalë e Ebu Bekrit, që unë të mbledhja Kur’anin në një lidhje të vetme. Në atë kohë edhe unë u thashë:

- “Po mirë, si ju shkon juve në mendje të bëni diçka që nuk e bëri as vetë i Dërguari i Allahut?” Ebu Bekri (radijallahu anhu) tha:

- “Uallahi, kjo është me një qëllim shumë të mbarë.”, – duke këmbëngulur kësodore në propozimin e tij.

Gjersa, më në fund, Allahu bëri që atë çështje ta merrja edhe unë për zemër, njëloj siç e futi në zemrat e tyre. Mendimi i tyre m’u duk me vend, kështu që fillova të kërkoja nëpër Kur’an. Fillova t’i mbledh ajetet e Kur’anit nga gurët e hollë e të bardhë, nga kockat e legenit, nga degët e hurmave dhe kujtesa e besimtarëve të ndryshëm që i kishin përvetësuar ato ajete në çastin që i ishin zbritur të Dërguarit të Allahut dhe i bashkova, në fillim ajetet, mandej edhe suret. Vetëm dy ajetet e fundit të sures Teube: **“Nga mesi juaj juve ju erdhi një Profet i atillë, që**

e ka të vështirë t’ju ngarkojë me punë të rënda. Atij i drithërohet zemra kur ju sheh dhe ai është shumë i dhembshur dhe i mëshirshëm ndaj besimtarëve. Megjithatë, nëse ata nuk e kuptojnë dhe të shpërfillin ty, ti thuaju atyre: ‘Mua më mjafton Allahu. Ai Allah që nuk ka zot tjetër veç Tij. Unë vetëm tek Ai mbështetem. Sepse Ai është Zotëruesi i Vetëm i Fronit të Lartë e Madhështor.’”, – i dinte vetëm Huzejme bin Thabit el-Ensari (radijallahu anhu); asnjë tjetër nuk i dinte ato ajete. Edhe ato i vendosa duke ua marrë atyre, e ata i kishin ruajtur shumë mirë ato. Derisa, në fund të punës, unë ia dorëzova Kur’anin e grumbulluar Ebu Bekrit (radijallahu anhu), e ai e mbajti përherë pranë vetes atë, deri në ditën që u nda nga kjo jetë. Pastaj, ajo mbeti tek Omeri (radijallahu anhu), derisa u nda edhe ai nga kjo jetë. Kur vdiq Omeri (radijallahu anhu), atë e mbajti vajza e tij Hafsa. ⁶²

Një bisedë e Omerit (r.a.) me vajzën e tij, Hafsanë (r.a.), në lidhje me të ngrënët dhe të veshurit

E tregon Sa’d bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu): “Hafsaja i tha një ditë babait të saj, Omerit:

- “O i Pari i Besimtarëve! Sikur ta ndërrosh këtë rrobë e të veshësh diçka më cilësore, e të hash ushqime pak më të shijshme sesa këto ushqime, me të cilat je mësuar të hash? Shiko, Allahu na ka falur ne mundësi më të mëdha dhe ushqimi nuk na mungon.” Omeri (radijallahu anhu) e dëgjoi të bijën dhe i tha:

- “Mendohu mirë, bija ime! I harrove ti vështirësitë që kaloi i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) për të mbajtur familjen?, – duke ia përsëritur ato disa herë, gjersa e bëri të bijën për të qarë. Pastaj i tha:

- “E kush i thotë këto, i thua ti! I betohem Allahut, se me sa mundësi të kem unë do të jetoj në mes të vështirësive, ashtu siç jetuan Resulullahu dhe Ebu Bekri, që në jetën e përtejme të jetoj më së miri me ta, ashtu siç do të jetojnë ata!” ⁶³

⁶². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/676 (4751).

⁶³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/48.

Omerit (r.a.) i dhurojnë një këmishë të re

Tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): “Babai, Omeri, njëherë kishte veshur një këmishë të re. Më tha mua:

- “O bir, tërhiqma pak këmishën deri te majat e gishtave dhe pjesën që del përtej gishtërinjve prite.” E unë ashtu bëra, ia tërhoqa të dyja mëngët dhe ia preva, siç më kërkoi t’ia prija. Mirëpo nuk i rrinte më aq mirë, si më parë.

- “O baba, më lejo që ta rregulloj pak me gërshërë.” – i thashë.

- “Jo, o bir, lëre siç është, se mirë është. Unë kam parë edhe Resulullahun të veshur kështu.” – m’u përgjigj.

Ibni Omeri (radijallahu anhu) thotë se: “Uallahi, mëngët e asaj këmishe ashtu mbetën, derisa ajo zuri të rripej në pjesën e shpinës. Madje, fijet e shkëputura nga mëngët ka pasur herë që i kam parë t’i zgjateshin babait deri te këmbët.”⁶⁴

Mendimet e sahabëve lidhur me puthjen dhe prekjen me dorë të Gurit të Zi

Omer bin Hatabi (radijallahu anhu), gjatë një haxhi, u afrua te Haxheru’l-Esuedi dhe e puthi duke thënë:

- “Unë e di shumë mirë, ti je një gurë që as nuk sjell mirë, as nuk bën dëm. Po të mos kisha parë Resulullahun që të prekte me dorë dhe të puthte, unë as të prekja, as të puthja ndonjëherë!” Pastaj tha:

- “Ne pse e bëjmë *heruelenë* (vrpimin e atyre që shkojnë në haxh me shpatullën dhe krahun e djathtë të hapur mes Safasë dhe Meruesë)? Ne e patëm bërë atë, për t’u treguar idhujtarëve se ishim të fortë e të shëndetshëm, kur bëjmë zëvendësimin e haxhit dhe umres që nuk i bëjmë dot gjatë atij viti kur u bë Hudejbija. Tani Allahu i shpartalloi ata, por ne nuk duam ta braktisim atë që e ka bërë Resulullahu!”⁶⁵

⁶⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/4.

⁶⁵. Buhari, *Sahib*, 2/582.

Një bisedë e zhvilluar mes Abdullah bin Abasit dhe një beduini

Bekr bin Abdullahu (radijallahu anhu) e tregon këtë: “Ishte një arab beduin ai që erdhi tek Abdullah bin Abasi (radijallahu anhu) dhe i tha:

- “Fëmijët e Muauijes gostitnin njerëzit me ujë dhe me mjaltë; kurse akshët jepnin qumësht. Kurse ju u jepni atyre shurup (lëng rrushi ose hurmash)! Cila është arsyeja e kësaj, jeni duarshtrenguar, apo me kaq keni mundësi t’i gostitni njerëzit?” Ibni Abasi (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- “Nuk e kam as nga koprracia, as ngase nuk kam. Ja të ta tregoj unë tani. Një ditë, i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pati ardhur tek ne, megjithëse nga pas kishte marrë edhe Usamen. Na kërkoi diçka për të pirë dhe ne e gostitëm atë me “shurup”. Pasi piu prej tij, na tha:

- “*E paskeni bërë shumë të mirë, kështu ta bëni gjithmonë.*”⁶⁶

Ndjeshmëria e Abdullah bin Omerit në çështjen e ndjekjes së Sunetit të Profetit tonë me përpikërinë më të madhe

Tregon Muxhahidi: “Njëherë, ne po udhëtonim bashkë me Ibni Omerin. Mbërritëm në një vend dhe rruga ndahej dhe ai vazhdoi në të djathtë a në të majtë.”

- “Pse e bërë këtë?”, – e pyeta dhe ai m’u përgjigj:

- “Kam parë Resulullahun që ka bërë kështu, ndaj edhe unë kalova këtëj!”⁶⁷

Transmeton Nafiu se: “Ibni Omeri ecte rrugës së Mekës dhe e kishte kapur devenë nga frerët dhe e tërhiqte me kujdes, duke ndjekur çdo hap të saj dhe thoshte:

- “Ku i dihet, inshallah këmbët e devesë sime prekin pikërisht në ato vende ku ka hedhur këmbët e saj deveja e Resulullahut.”⁶⁸

Nafiu thotë: “Miku im, të kishe parë njëherë përkushtimin dhe kujdesin aq të veçantë të Ibni Omerit për të jetuar Sunetin e Profetit

⁶⁶. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/372 (3528).

⁶⁷. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2/32 (4870).

⁶⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/310.

tonë; 'ky njeri është i çmendur!' do të thoshe.”⁶⁹

Tregon Uarid bin Ebi Asimi: “Në Mina rastisa Ibni Omerin dhe e pyeta për namazin e udhëtarit.

- “Dy rekate është.”, – më tha. Thashë ta pyes:

- “Si thua? Ne tani jemi në Mina. Nuk kemi frikë as se na ikën karvani, as ndonjë shqetësim tjetër; prapë dy rekate do ta falim?” Pas kësaj fjale që i thashë Ibni Omerin e zunë ca të dridhura dhe më tha:

- “Të të vijë turp! E ke dëgjuar gjë të Dërguarin e Allahut të ketë thënë diçka të këtillë?”

- “Po, e kam dëgjuar dhe i kam besuar fjalës së tij!”, – iu përgjigja unë.

- “Epo mirë, Resulullahu i falte me nga dy rekate. Tani ti në daç fali, në daç mos i fal!”, – ma preu Ibni Omeri (radijallahu anhu).”

Ja se si e tregon Ebu Munib el-Xhureshiu këtë ndjeshmëri: “Një ditë Ibni Omerit (radijallahu anhu) i kërkuan që t’u interpretonte ajetin kur’anor: **“Kur të udhëtoni, nuk është gjynah që ta shkurtoni namazin, nëse druheni që jobesimtarët do t’ju bëjnë ndonjë dëm. Me të vërtetë, jobesimtarët janë armiq të tuaj të hapur.”** (Nisa, 4/101) – dhe ai u përgjigj:

- “Ne tani jemi të sigurt, nuk ekziston më rreziku i armikut.”

- “Po mirë, a do ta shkurtojme namazin gjatë udhëtimeve?”, – e pyetën sërish atë dhe Ibni Omeri (radijallahu anhu) dha një përgjigje të tillë:

- “I Dërguari i Allahut është shembulli më i mirë për ju!”⁷⁰

14. ÇFARË KISHTE PARASYSH I DËRGUARI FISNIK NË SJELLJEN E TIJ ME SAHABËT, FAMILJEN DHE UMETIN

Abdullah bin Ebi Eufaja tregon: “Abdurrahman bin Auferi (radijallahu anhu) i ishte ankuar të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) për Halid bin Uelidin (radijallahu anhu). Për këtë arsye, Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha këto fjalë:

⁶⁹. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/647 (6376).

⁷⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/407 (22747).

- “O Halid! Mos e mundo askënd nga ata që kanë marrë pjesë në Bedër, sepse sikur male sa mali i Uhudit me flori të falësh në rrugën e Allahut, prapëseprapë shpërblimin e punës së tyre nuk e arrin dot.”

- “Ata më ngacmojnë dhe unë u kthej atyre përgjigje.”, – tha ai duke u përpjekur që të mbrohej përpara të Dërguarit të Allahut. Kësaj here Resulullahu (paqja qoftë mbi të) u kthye nga sahabët dhe u tha:

- “Askush të mos e shqetësojë në asnjë mënyrë Halidin, sepse ai është një shpatë nga shpatat që Allahu ka lëshuar mbi mobuesit.”⁷¹

Profeti ynë: “Allahu, sahabët e mi i lartësoi mbi botët.”

Xhabir bin Abdullahu, përcjell kështu nga më i Dashuri i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “Allahu, përveç profetëve të tjerë, sahabët e mi i lartësoi mbi gjithë botët. Mes tyre Ai ka përzgjedhur veçanërisht katër prej tyre: Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin dhe Aliun (radijallahu anhum). Ata i ka shpallur sahabët e mi më të afërt. Çdonjëri nga sahabët e mi është i mirë dhe i mbarë. Ndërsa umetin tim e ka shpallur më lart se çdo popull tjetër. Ashtu siç pjesën e umetit tim që u përket katër shëkujeve të parë e ka shpallur si më të virtytshëm nga ata që do të vijnë më vonë.”⁷²

Profeti ynë e ndalon që t’i shahet ndonjë prej sahabëve të tij

Këtë e transmeton Aishja (radijallahu anha), nëna e të gjithë besimtarëve:

- “Të mos i shani sahabët e mi, të mos thoni asgjë të pahijshme për ta. Allahu e privoftë nga mëshira e tij çdokënd që shan ndonjërin prej tyre!”⁷³

I Dërguari i Allahut u jep këshilla pjesëtarëve të familjes së tij

Tregon nëna jonë, Ummu Selemeja (radijallahu anha): “Një ditë, e bija e Prijësit të të gjithë profetëve, erdhi në Shtëpinë e Lumturisë, me një tenxhere me gjellë të ngrohtë dhe Hasanin me Husejnin kalipic.

⁷¹. Taberani, *Mu’xhemu’s-Sagir*, 1/348 (580).

⁷². Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 9/736 (16383).

⁷³. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 9/747 (16429).

Tenxherenë ia vuri përpara në sofër të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Resulullahu e pyeti:

- *“Ku është babai i Hasanit?”* Fatimja iu përgjigj se ai ishte në shtëpi. I Dërguari i Allahut dërgoi dikë që të thërriste Aliun (radijallahu anhu). I Dërguari Fisnik, Aliu, Fatimja, Hasani dhe Husejini (radijallahu anhum) u ulën të gjithë tok për të ngrënë.”

Umu Selemeja thotë se: “Më përpara, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), sa herë që do të hante bukë, po të më kishte mua pranë, do të më ftonte edhe mua për të ngrënë, por kësaj here nuk më thirri. Kur përfunduan së ngrëni, i mbështolli të gjithë brenda rrobës së tij që mbante të veshur dhe u lut:

- *“O Zot! Bëhu Ti armiku i atyre që sillen me armiqësi ndaj këtyre dhe pranoji si miqtë e Tu të gjithë ata që bëhen miq me ta!”*⁷⁴

Një sihariq i madh i të Dërguarit Fisnik për atë pjesë të umetit që do të vijë kohë pas tij

Ja, kështu e tregon Omeri (radijallahu anhu) këtë ngjarje: “Tshim ulur me Profetin Fisnik, kur ai tha:

- *“A nuk më thua, kush janë besimtarët që kanë arritur besimin më të lartë nga të gjithë?”*

- “Engjëjt, o i Dërguari i Allahut.”, – iu përgjigjën besimtarët. Ai u tha që:

- *“Engjëjt zaten të atillë janë dhe Allahu u ka dhënë atyre një shkallë të përcaktuar mirë; engjëjt e kanë të pamundur të dalin jashtë asaj që u ka përcaktuar Allahu.”* Kësaj here ishin sahabët që i thanë:

- “Ata që janë të përgëzuar të bien dëshmorë bashkë me profetët.” I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i dëgjoi dhe u tha:

- *“E kush mund ta mobojë virtytin e tyre, atë që Allahu ua ka falur dhe ata e kanë arritur duke rënë dëshmorë? Jo, jo, unë e kam fjalën për ca të tjerë.”* Atëherë, ne e pyetëm të Dërguarin e Allahut:

⁷⁴. Hejthemî, *Mexhemu'z-Zenaid*, 9/262 (14971).

- “Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut?” Profeti ynë i dashur dha këtë përgjigje:

“Ata janë ende në palcën e kurrizit të njerëzve; ata kanë për të ardhur kohë pas meje dhe do të më besojnë mua, pavarësisht se nuk më kanë parë kurrë. Shpalljen e Allahut ata do ta gjejnë të varur kudo, të shkruar në letër; do të bazohen tek ajo që është shkruar në letër dhe do ta jetojnë jetën e tyre vetëm sipas saj. Ja pra, këta janë besimtarët me virtytet më të mëdha në mesin e njerëzve që besojnë.”⁷⁵

Transmetime të tjera për këtë temë

Siç e transmeton Ebu Umameja (radijallahu anhu): “Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Sa mirë ata që më kanë parë dhe më kanë besuar mua! Dhe sa mirë ata që më besojnë mua pa më parë asnjëherë!*”⁷⁶

Ndërsa në transmetimin e Enesit (radijallahu anhu), i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) e ka përshkruar me këto fjalë dëshirën e zjarrtë të atyre që e besojnë atë pa e parë asnjëherë:

- “*Sa shumë do të doja që t’i shihja vëllezërit e mi, të cilët më besojnë pa më parë asnjëherë!*”⁷⁷

Tregon Amar bin Jasiri (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut na tha kështu:

- “*Umeti im është si shiu; nuk mund ta dish se kush është më i mirë e më i mbarë, ai që vjen në fillim, apo ai që vjen në fund.*”⁷⁸

Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) transmeton se Profeti ynë i nderuar (paqja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë:

- “*Allahu ka disa engjëj, të cilët vetëm udhëtojnë nga njëri vend në tjetrin; ata më sjellin mua përshëndetjet e besimtarëve të umetit tim.*”⁷⁹

⁷⁵. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 10/50 (16689).

⁷⁶. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/71 (11691).

⁷⁷. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 10/53 (16697).

⁷⁸. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/130 (12349).

⁷⁹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/441 (4210).

15. JETA DHE PASURIA E MYSLIMANËVE ËSHTË E PAPREKSHME

Hadithet që kanosen për ata që vrasin myslimanë

Ebu Saidi (radijallahu anhu) tregon: “Në kohën e të Dërguarit të Allahut, një njeri u gjet i vrarë. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u ngjit në minber dhe u foli njerëzve:

- “*A nuk e dini ju se kush në mesin tuaj e vrau atë njeri?*” (Dhe këtë pyetje e përsëriti tri herë me radhë). Njerëzit u përgjigjën të gjithë:

- Jo!” Pas kësaj, i Dërguari Fisnik u tha atyre:

- “*Unë i betohem Zotit që e ka në dorë frymën time, se sikur gjithë banorët e tokës dhe të qiellit të bëhen bashkë, për të derdhur gjakun e një besimtari, Allahu i çon të gjithë sa janë në Xhebenem. Edhe ata që na përçmojnë në të Ehli Bejtit, Allahu i lë të poshtëruar dhe pastaj i hedh në zjarrin e Xhebenemit.*”⁸⁰

I Dërguari i Allahut e paralajmëron shumë ashpër Usame bin Zejdin

Usame bin Zejdi (radijallahu anhu) tregon vetë: “I Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) na pati dërguar ne te një nga fiset e Xhuhejnes, që quhej Huraka. Sulmin ndaj tyre ne e ndërmorëm me të zbardhur dita. Në mesin e tyre ishte një burrë, i cili na sulmonte më egër nga gjithë të tjerët. Njerëzit e fisit iknin nga ne, për të shpëtuar dhe ai i merrte ata menjëherë në mbrojtje. Ja, atë njeri unë dhe dikush nga ensarët e zumë ngushtë dhe kur e pa se nuk kishte nga t’ia mbante, tha:

- “La ilahe il’lallah”. Shoku im nga ensarët nuk e preku, bëri disa hapa mbrapa; kurse unë e vrava. Për këtë ngjarje e mori vesh menjëherë i Dërguari i Allahut. Ai më tha mua:

- “*Usame! Çfarë bëre, e vrave atë njeri pasi të tha ‘La ilahe il’lallah’, kështu bë?*”

- “O i Dërguari i Allahut! Ai njeri e tha atë fjalë ngaqë iu frikësua vdekjes.” – u justifikova unë. Atëherë i Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) ma përsëriti mua këtë fjali aq shumë herë, saqë, në jetën

⁸⁰. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenaid*, 7/580 (12300).

time, vetëm atë ditë kam dashur që të mos kisha qenë mysliman.”⁸¹

Po për të njëjtën çështje i Dërguari i Allahut paralajmëron edhe Bekr bin Harithen

Bekr bin Haritheja e tregon vetë: “Unë isha në një ekip që i Dërguari Fisnik (pagja e Zotit qoftë mbi të) e pati dërguar diku. Ne luftuam me armikun me mish e me shpirt. Unë iu vura këmba-këmbës njërit prej idhujtarëve dhe sa do ta vrisja, kur ai, për t’i shpëtuar vdekjes, kërkoi mbrojtje tek Islami, me pak fjalë tha fjalën e dëshmisë, *‘Esh’bedu en la ilabe il’allah ue esh’bedu en’ne Muhammeden abduhu ue resuluhu’*, por unë, prapëseprapë, e vrava atë. I Dërguari i Allahut e mori vesh se çfarë kishte ndodhur dhe u nevrikos shumë me mua, sa që më përzuri, të mos i qëndroja më pranë. Nuk kaloi shumë kohë dhe u zbrit ajeti: **“Nuk bën që besimtari të vrasë besimtarin, përveçse gabimisht. Kush vret një besimtar gabimisht, duhet të lirojë një besimtar të robëruar dhe t’u paguajë gjakun trashëgimtarëve të të vrarit, përpos rastit kur familja e të vrarit ia fal gjakun. Nëse i vrari është një popull që e keni armik e njëkohësisht është besimtar, duhet të lirohet një besimtar i robëruar. Nëse i vrari është nga një popull me të cilin ju keni lidhur marrëveshje, i duhet paguar gjaku familjes së tij, duke liruar edhe një besimtar të robëruar. Ai që s’mund të gjejë rob, duhet të agjërojë dy muaj rresht. (Kjo është bërë) në shenjë pendimi para Allahut. Se Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.”** (Nisa, 4/92) – atëherë Resulullahu u afrua sërish me mua, duke më pranuar edhe mua pranë vetes.”⁸²

I Dërguari i Allahut nuk ia hidhte më sytë atyre që vrisnin besimtarët

Ukbe bin Halid el-Lejthij tregon: “I Dërguari i Allahut zgjodhi një grup luftëtarësh dhe e dërgoi atë kundër një bashkësie. Atje, njëri nga armiqtë u përpoq t’ia mbathte, andaj njëri prej luftëtarëve tanë iu vu pas, me shpatë në dorë, që të mos e linte të arratisëj. Kur, bash në atë çast një prej njerëzve në radhët e armiqve filloi të thoshte:

⁸¹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/200 (21793).

⁸². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 15/234 (40451).

- “Unë jam mysliman, jam mysliman.” Por një nga luftëtarët myslimanë nuk ua vuri veshin fjalëve të tij dhe një të goditur me shpatë i bëri dhe e la të vrarë në vend. I Dërguari i Allahut, me ta marrë vesh se çfarë kishte ndodhur, tha për të fjalë shumë të ashpra. Personi që kishte kryer vrasjen i pati dëgjuar fjalët e të Dërguarit të Allahut dhe një ditë, kur i Dërguari i Allahut ishte duke mbajtur hutben e së premtes, i tha atij:

- “O i Dërguari i Allahut, unë i betohem Allahut, se ai njeri e pati thënë fjalën e dëshmisë nga frika e vdekjes.” Resulullahu i nderuar e hoqi shikimin nga ana e tij dhe e besimtarëve që rrinin në atë anë dhe vazhdoi të fliste, duke parë besimtarët që qëndronin në anën tjetër. Ai njeri e përsëriti sërish fjalën e tij, duke thënë se ai njeri që kishte vrarë e kishte thënë fjalën e dëshmisë nga frika. Por, i Dërguari Fisnik e largoi sërish shikimin prej tij. Ai nuk duroi dot më dhe e tha edhe njëherë për herë të tretë, kur Krenaria e Gjithësisë u kthye nga ai, por në tërë fytyrën i lexohej pakënaqësia e madhe që kishte ndaj atij njeriu. Dhe i tha kështu i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të): “Allahut nuk i pëlqen që unë të vras një besimtar dhe kurrsesi nuk e aprovon një veprim të tillë.”⁸³

Ajeti që zbriti kur Mikdad bin Esuedi vrau një njeri që kishte thënë fjalën e dëshmisë

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon se: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kishte dërguar një ekspeditë diku dhe në radhët e asaj ekspedite gjendej edhe Mikdad bin Esuedi. Ata mbërritën tek armiqtë me të cilët do të luftonin dhe i gjetën ata të shpërndarë dhe vendbanimin e tyre të braktisur. Vetëm një burrë, i cili ishte shumë i kamur e kishte jashtëzakonisht shumë pasuri, nuk ishte larguar. Edhe pse ai u tha myslimanëve, “*Esh’bedu en la ilabe illallah*”, Mikdadi një të hedhur bëri mbi atë njeri dhe e la të vrarë në vend. Një nga luftëtarët e tjerë, pjesë e asaj ekspedite, i tha Mikdadit:

- “Do t’i tregoj të Dërguarit të Allahut për këtë që bërë.” Andaj, kur u kthyen te Profeti ynë, ai sahab i tha atij:

⁸³. Hejthemî, *Meaxhmen’-Zenaid*, 7/573 (12284).

- “O i Dërguari i Allahut! Një burrë dëshmoi se nuk ka zot tjetër veç Allahut, mirëpo Mikdadi, megjithëse e dëgjoji mjaft mirë se çfarë tha, e vrau atë njeri.” I Dërguari Fisnik dha urdhër:

- “*Më thirrni menjëherë Mikdadin, të vijë këtu!*” Kur erdhi Mikdadi, ai i tha atij:

- “*More Mikdad! Çfarë ke bërë ti, ke vrarë një njeri që ka thënë ‘la ilahe illallah’, kështu bë? Kushedi se si do të ndihesh nesër, kur ai njeri në Kiamet të thotë ‘la ilahe illallah’, a nuk të shkoj fare nëpër mend se si do t’ia dalësh atje?’*”

Ishte pikërisht kjo ndodhi, pas së cilës Allahu u zbriti besimtarëve ajetin e sures Nisa: **“O besimtarë! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të Allahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: ‘Nuk je besimtar’, me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete, ndërkohë që tek Allahu ka fitime të shumta. Të tillë keni qenë edhe ju më parë e Allahu ju dha mirësi; prandaj, gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se Allahu është Njohës i veprave tuaja.”** (Nisa, 4/94)⁸⁴

Njeriu që nuk e pranonte toka, sepse kishte vrarë një besimtar

Tregon Kabisa bin Zuejbi: “Njëri nga sahabët e të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) kishte sulmuar një ekspeditë të armiqve të Islamit dhe ekspedita kishte pësuar disfatë. Sahabi e zuri ngushtë njërin nga idhujtarët dhe sa bëri gati të ngrinte shpatën, ai njeri tha ‘*la ilahe illallah*’. Por sahabi nuk hoqi dorë nga vrasja e tij dhe e vrau; mirëpo përbrenda një shqetësim nisi ta bluajë. Ia tregoi të Dërguarit të Allahut se çfarë kishte ndodhur, duke i shprehur se ai njeri e kishte thënë fjalën e dëshmisë vetëm e vetëm që t’i shpëtonte vdekjes. Profeti i profetëve (sal’allahu alejhi ue sel’lem) e pyeti:

- “*Po ti ç’bërë, mos vallë i hape zemrën dhe ia pe se çfarë kishte në të? Njeriu shpreh me gojë atë që ndien në zemër.*” Nuk kaloi shumë kohë dhe ai që vrau vdiq edhe vetë. E varrosën trupin e tij, por toka nuk e pranonte trupin e tij, e nxirrte jashtë. Të afërmit e atij njeriu shkuan tek i Dërguari i Allahut (alejhis’selam) t’i tregonin për atë që u kishte ndodhur. I Dërguari i Allahut u tha atyre:

⁸⁴. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 7/66 (10943).

- “*Varroseni prapë!*” E varrosën, por toka e nxirrte atë sërish. Familja për këtë e njoftoi prapë Profetin tonë. Atëherë, Profeti Fisnik u tha atyre:

- “*Toka hoqi dorë, nuk do ta pranojë, prandaj hidhjeni atë ku të gjeni ndonjë gropë.*”⁸⁵

Aventura e Halid bin Uelidit me bijtë e Xhedhijmes

E tregon Ebu Xhafer Muhamed bin Aliu: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), në kohën kur u ngadhënjye mbi Mekën, e pati caktuar Halid bin Uelidin (radijallahu anhu) me detyrë vetëm që t’u çonte njoftime popullit të Mekës, e jo për të luftuar me ta. Me të ishin edhe disa fise arabe; njerëz si Sulejm bin Mensuri dhe Mudlexh bin Murreja. Të gjithë bashkë ata sulmuan mbi bijtë e Xhedhijmes. Njerëzit, një të parë Halidin, vrapuan të merrnin armët. Halidi u tha t’i linin armët, sepse njerëzit ishin dorëzuar. I lanë armët dhe Halidi i urdhëroi ata të vireshin të gjithë në rresht. Pastaj i kaloi të gjithë nëpër shpatën e tij dhe vrau sa munda të vriste. Kur kjo ndodhi shkoj në vesh të të Dërguarit të Allahut, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i ngriti duart në qiell dhe tha kështu:

- “*O Allah! Unë të kërkoj falje Ty për atë që ka bërë Halid bin Uelidi.*” Pastaj, i Dërguari i Allahut thirri Aliun, për t’i thënë:

- “*Ali! Shko tek ata njerëz dhe shiko me kujdes se çfarë bëjnë. Pastroje këtë punë të injorancës që është bërë.*”

Aliu (radijallahu anhu) u nis dhe me vete kishte edhe plaçkën që i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi ta) ia dha për ata njerëz. Ai ua shpërndau atë plaçkë banorëve të atij fisi si shpagim për gjakun dhe e pasurinë e dëmtuar gjatë luftës. Madje ai u kishte siguruar atyre deri edhe mundësitë për enët ku hanin qentë e tyre. Ua shpërndau atyre të gjitha sa u takonin dhe në dorë i mbetën edhe ca gjëra të tjera, prandaj i pyeti ata:

- “A ka ndonjë që nuk i është paguar ajo që i takonte?”

- “Jo.”, – u përgjigjën ata. Atëherë, Aliu (radijallahu anhu) tha:

⁸⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 15/235 (40454).

- “Unë po jua jap edhe këto që më mbetën, le të përdoren nëse ka mbetur pa u vënë re edhe ndonjë dëm tjetër.” Bëri siç e kishte porositur i Dërguari Fisnik dhe u kthye dhe e njoftoi atë se i kishte bërë të gjitha siç ia kishte kërkuar. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ia priti atij me përgëzimin:

- “*Paske vepruar drejt, duke bërë atë që ishte më e mira për t’u bërë.*”, – dhe, më vonë, i Dërguari i Allahut u kthye nga kibleja dhe i ngriti duart aq sa i dukeshin edhe sqetullat dhe u përgjërua:

- “*O Zot, të kërkoj falje e vetëm Ti mund të më ruash mua nga ajo që bëri Halid bin Uelidi!*”, – duke e përsëritur lutjen e tij plot tri herë.”⁸⁶

Një ngjarje e ndodhur mes të Dërguarit të Allahut dhe Sahr el-Ahmesiut

I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte nisur drejt Thakifit për të luftuar. Sahri, me të dëgjuar për këtë, u nis me një tufë kuajsh, për t’i ardhur në ndihmë Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të). Ai mësoi se i Dërguari i Allahut ishte nisur, por nuk kishte ngadhënjyer ende mbi Taifin. Tha me vete, sikur të donte t’i jepte fjalën vetes për diçka:

- “Nuk kam për t’i braktisur bedenat e Taifit, gjersa këta taifasit t’i binden gjykimit të të Dërguarit të Allahut!” Vërtet, Sahri e mbajti fjalën dhe deri në çastin që taifasit ulën kokën përpara autoritetit të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk e braktisi istikamin që kishte zënë, madje i shkroi edhe një letër të këtillë Resulullahut:

“O Resulullah, taifasit u dorëzuan dhe e pranuan gjykimin tënd. Ndërkaq unë kam shkuar dhe po kontrolloj se ç’bën populli i Thakifit.”

I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u bëri thirrje sahabëve që të mblidheshin për të falur namazin të gjithë bashkë, siç ishin. Ai u lut plot tri herë për Ahmesiun, duke thënë:

- “*O Zot, falu begati ushtarëve dhe kuajve të Ahmesiut!*”⁸⁷

Pas njëfarë kohe, erdhën taifasit dhe Mugire bin Shubeja foli:

⁸⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/313.

⁸⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/351.

- “O Resulallah! Sahri, megjithëse unë u trajtova ashtu siç trajtohen besimtarët, më mori hallën peng dhe me të është sjellë sikur ta kishte shërbëtoren e tij.”

I Dërguari i Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem) e dëgjoi ankesën e Mugires, kështu që thirri Sahrin dhe i tha atij:

- “O Sahr! Kur një bashkësi pranon Islamin dhe bëhen myslimanë, jeta dhe pasuria e tyre nuk preket. Andaj, ti duhet ta kthesh menjëherë hallën e Mugires.” Sahri e dorëzoi hallën e tij, por më vonë shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe i kërkoi që t’ia jepte atij ujërat e braktisura të Beni Sulejmit, duke i thënë:

- “O i Dërguari i Allahut! A na jep leje mua dhe të afërmve të mi që të vendosemi atje tek ato ujëra?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) ua lejoi. Mirëpo, gjatë atyre ditëve Benu Sulejm pranuan Islamin dhe u bënë myslimanë dhe shkuan te Sahri dhe i kërkuan që t’u kthente ujin, sepse ai u kishte përkitur atyre më parë, mirëpo Sahri nuk pranoi t’ua kthente. Kësodore, ata shkuan dhe njoftuan të Dërguarin e Allahut. I Dërguari Fisnik foli me Sahrin:

- “Sahr! Kur një bashkësi pranon Islamin dhe hyn nën mbrojtjen e tij, jeta dhe pasuria e tyre është e mbrojtur gjithashtu. Tani ti duhet t’ua kthesh atyre ujërat që i kanë pasur të tyret më parë.”

- “Në rregull!”, – tha Sahri.

Sahri vetë ka transmetuar: “Më vinte turp nga shikimi i të Dërguarit të Allahut, më vinte zor, sepse fytyra e tij u skuq ngaqë unë pata marrë ato ujëra, apo që isha sjellë me hallën e Mugires sikur ta kisha robinjë të shtëpisë sime.”⁸⁸

16. NDALIMI I DERDHJES SË GJAKUT TË MYSLIMANËVE DHE SHËMTIA E TË LUFTUARIT PËR TË VËNË PASURI

**Ndalohet lufta me atë që pranojnë se Zoti është një
dhe që pranojnë të Dërguarin e Allahut**

E tregon Eus bin Eus eth-Thekafi: “Isha ulur në një cep të faltores së Medinës, kur aty ia behu i Dërguari i Allahut. Në atë çast tek ai u

⁸⁸. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/351.

afrua dikush dhe seç i pëshpëriti në vesh. Askush nga ne nuk e kuptoi se çfarë i tha. I Dërguari i Allahut i tha atij:

- “*Shko thuaju atyre, ta vrasin.*” Pastaj e thirri prapë atë njeri dhe i tha:

- “*Ndoshta edhe ai e pranon se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe dëshmon se unë jam i Dërguari i Allahut.*” Ai burrë tha:

- “Po!” Atëherë, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha:

- “*Ik atëherë, thuaju atyre ta lënë të lirë; sepse mua kaq më është urdhëruar, që të përpiqem me njerëzit derisa ata të pranojnë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe unë jam i Dërguari i Tij. Nëse e thonë këtë fjalë të dëshmisë, atëherë ne e kemi të ndaluar që ta prekim jetën dhe pasurinë e tyre; por, nëse ata i kanë bërë keq ndokujt tjetër, atëherë edhe ata do të ndëshkohen, si gjithë të tjerët; e për këtë do të japin llogari edhe përpara Allahut.*”⁸⁹

Një tjetër transmetim, po për këtë çështje

E tregon Abdullah bin Adij el-Ensari: “I Dërguari i Allahut po rrinte i ulur në mes të xhematit, kur aty erdhi një burrë dhe tha se duhej vrarë një hipokrit dhe diç i tha në vesh duke pëshpëritur. Pastaj, i Dërguari i Allahut i vazhdoi fjalët me zë të lartë:

- “*Po mirë, ai njeri a e pranon se nuk ka zot tjetër veç Allahut?*”

- “Po, e pranon dhe e dëshmon; por dëshmia e tij nuk pranohet.”, – u përgjigj ai. I Dërguari i Allahut pyeti sërish:

- “*Po që unë jam Profeti i Allahut, a e dëshmon?*”

- “Po, e dëshmon, po ne nuk mund t’i besojmë dëshmisë së tij, apo jo?”, – tha ai burrë.

- “*Ai njeri, a e fal namazin?*” – pyeti sërish i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).

- “Po, falet po namazi i tij nuk mund të quhet namaz!”, – u përgjigj ai njeri. Sakaq, i Dërguari Fisnik na tha:

⁸⁹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/348.

Sahabët fisnikë i mposhtin dëshirat egoiste dhe qejfet e tyre

- “Mua më është ndaluar që t’i ngacmoj pikërisht këta njerëz.”⁹⁰

Osmani (r.a) i shmanget luftës në ditën që i rrethuan shtëpinë

E tregon Aishja (radijallahu anha): “I Dërguari i Allahut tha:

- “*Më thërrisni disa nga sahabët e mi.*”

- “Ebu Bekrin?”, – e pyeta unë.

- “Jo!”, – m’u përgjigj.

- “Omerin?”, - e pyeta.

- “Jo!”, – m’u përgjigj.

- “Djalën tënd të xhaxhait, Aliun?”, – i thashë.

- “Jo!”, – m’u përgjigj prapë.

- “Osmanin?”

- “Po!”, – m’u përgjigj, dhe, kur erdhi Osmani, mua më tha të largohesha. Filluan të flisnin me njëri-tjetrin në fshehtësi, me zë të ulët. Kur fliste ai, Osmanit i ndryshonte vazhdimisht ngjyra e fytyrës.

Atë ditë kur Osmanit (radijallahu anhu) erdhën e i rrethuan shtëpinë, ne e pyetëm atë:

- “O Prijësi i Besimtarëve, nuk do të luftosh me ta?” Dhe ai na ktheu neve këtë përgjigje:

- “Jo, sepse i kam dhënë fjalën të Dërguarit të Allahut; më duhet të jem besnik ndaj tij.”⁹¹

Në ditën e rrethimit të shtëpisë së Osmanit (r.a.), mes Mugire bin Shu’bes dhe Osmanit (r.a.) zhvillohet një bisedë

E tregon vetë Mugire bin Shu’beja: “Unë shkova pranë Osmanit (radijallahu anhu) kur ai gjendej i rrethuar dhe i izoluar në shtëpinë e tij dhe i thashë:

- “Nuk ka pikë dyshimi se ti je imami i të gjithë besimtarëve. Ti e

⁹⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 1/509 (1458).

⁹¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/181.

sheh edhe vetë se çfarë të ka ndodhur. Unë do të të jap ty tri alternativa dhe të këshilloj që të zgjedhësh njërën prej tyre: Rruga e parë, të dalësh dhe të luftosh; sepse ti ke më shumë ushtarë nën urdhrat e tu. Pastaj je ti ai që ka të drejtë, kurse ata janë në të padrejtë. Alternativa e dytë: Të të hapim një dalje tjetër, e të dalësh prej andej, jo nga porta që po ruajnë ata, të të nxjerrim edhe deve dhe të largohesh menjëherë në drejtim të Mekës, sepse, për sa kohë që ti do të jesh në Mekë, ata nuk e derdhin dot gjakun tënd. Kurse rruga e tretë është që të ikësh në Siri. Edhe ata sirianë janë, pastaj atje është edhe Muauija.”

Osmani (radijallahu anhu) e dëgjoi dhe i tha atij:

- “Për sa i përket mundësisë për të dalë e për të luftuar, unë nuk bëhem kurrë i pari kalif i umetit të të Dërguarit Fisnik që derdh gjak. Sa i përket alternativës për të shkuar në Mekë, ke të drejtë, atje ata nuk më vrasin dot, sepse unë e kam dëgjuar vetë nga i Dërguari Fisnik të thotë: *“Një burrë nga kurejshët do të braktisë Islamin në Mekë, duke u bërë mohues. Gjysma e ndëshkimit që do t’u jepet gjithë njerëzve, do t’i jepet vetëm atij njeriu.”*, prandaj, unë nuk dua të bëhem shkak që dikush të marrë një dënim kaq të ashpër. E, për sa i përket ikjes në Siri, ata në të vërtetë sirianë janë dhe ndër ta është Muauija, por unë nuk kam aspak ndërmend që ta braktis vendin e mërgimit, ku jam fqinj me të Dërguarin e Allahut.”⁹²

Çfarë pati thënë Ibni Omeri kur zunë të lindnin ngatërresat mes myslimanëve

Nafiu na e bën të ditur, duke na e përcjellë nga vetë Ibni Omeri, se: “Dy vetë erdhën tek Ibni Omeri dhe i thanë për Abdullah bin Zubejrin, se: “Njerëzit po shkojnë dëm. Ti je djali i Omerit dhe njëri prej sahabëve të Profetit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Çfarë të pengon që të dalësh përpara njerëzve dhe të zësh një rol më aktiv në mesin e tyre?”

- “Ajo që më pengon mua është se Allahu ma ka ndaluar që të derdh gjak nga ai i vëllait tim në fe.”, – u përgjigj qartësisht Ibni Omeri. Kësisoj, ata i thanë atij:

⁹². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/1641 (4243).

- “Mirë atëherë, po a nuk na ka urdhëruar ne Allahu, **‘luftoni me ta derisa të mos mbetet më asnjë ngatërresë dhe feja të jetë tërësej e Allahut?’**”

Ibni Omeri (radijallahu anhu) u dha atyre përgjigjen:

- “Ne luftuam derisa nuk mbeti më asnjë shpifje dhe ngatërresë, por ju po përpiqeni me çdo kush që të dalin sa më shumë ngatërresa dhe feja t’i përkasë ndokujt tjetër, e jo Allahut!”⁹³

Fjalët e Ibni Omerit për mospranimin e tij për të lidhur besën me Ibnu’z-Zubejrin

E tregon Ebu’l-Alije: “Abdullah bin Zubejri me Abdullah bin Safuanin ishin vendosur një ditë në Hixhr. Në atë kohë Ibni Omeri po i bënte tauaf Qabes, duke i ardhur asaj përqark. Aty kaloi dikush, i cili i tha shokut të tij:

- “A thua ka mbetur në këtë botë ndonjë njeri më i hairit se ky këtu?” Pastaj i tha dikujt, që kur të mbaronte tavafin e Qabes, t’i thoshte Ibni Omerit të vinte tek ai. Ibni Omeri e përfundoi tavafin e tij përreth Qabes, fali edhe dy rekate namaz, kur tek ai erdhi lajmëtari i dërguar, i cili i tha atij:

- “Të kërkojnë Abdullah bin Zubejri dhe Abdullah bin Safuani, që janë ulur atje tej.” Dhe ibni Omeri shkoi pranë tyre. I pari fjalën e mori ibni Safuani, duke i thënë:

- “O Ebu Abdurrahman! Çfarë të pengon ty që të lidhësh besën me Prijësin e Besimtarëve, Ibnu’z-Zubejrin?” Atij i janë betuar gjithë populli i Mekës, i Medinës, i Jemenit, i Irakut dhe i Sirisë.” Ibni Omeri ia ktheu atij:

- “Unë nuk e lidh besën me ju, për sa kohë që nga duart dhe tehu i shpatave tuaja të pikojë gjaku i myslimanëve.”⁹⁴

Ibni Omeri u shmanget atyre që duan të lidhin besën me të

Hasan Basriu tregon: “Disa njerëz, kur në mesin e umetit lindën

⁹³. Buhari, *Sabih*, 4/1641 (4243).

⁹⁴. Bejheki, *Sunen*, 8/192 (16585).

ngatërresat dhe kudo filloi të mbizotërojë anarkia, erdhën tek Ibni Omeri dhe i thanë:

- “Ti je një nga njerëzit më të respektuar ndër njerëz dhe djali i një njeriu akoma edhe më të respektuar i tyre. Njerëzit ty të duan shumë. Dil ti prijes, e ne të të lidhim besën.” Ibni Omeri tha:

- “Uallahi, nuk bëhet! Nuk dua kurrresi që për mua të derdhet gjak apo të humben jetë njerëzish.” Madje ata u përpoqën edhe që ta trembnin Ibni Omerin, duke e kërcënuar:

- “Ose do të dalësh në krye të myslimanëve, ose ne do të të vrasim në shtrat!” Por ai u ktheu po të njëjtën përgjigje.

Hasan Basriu thotë se: “Uallahi, askush nuk arriti të vërente ndonjë lëshim sado të vogël të Ibni Omerit (radijallahu anhu) deri në ditën kur ai u nda nga kjo jetë.”⁹⁵

Hasani (r.a.) i ikën luftës për pushtet dhe bën marrëveshje me Muauijen

E tregon Ebu'l-Garifi: “Ne ishim në ushtrinë e Hasanit (radijallahu anhu) dhe po luftonim kundër sirianëve. Aq shumë të nxehur dhe të nevrikosur ishim, saqë shpatat na kullonin gjak. Në krye si komandant kishim Ebu'l-Amranë. Kur na erdhi lajmi i marrëveshjes së paqes mes Hasanit dhe Muauijes, ne ishim aq të nxehur me armikun, saqë na u duk sikur dikush na theu mesin. Hasani ishte kthyer në Kufe. Atje, u çua një njeri i quajtur Ebu Amir dhe i tha Hasanit (radijallahu anhu):

- “O ti që i poshtërove besimtarët!” Hasani (radijallahu anhu) e dëgjoi dhe iu përgjigj me fjalët:

- “Mos thuaj ashtu, Ebu Amir! Unë nuk i poshtërova besimtarët. Mua thjesht m'u duk e shëmtuar që t'i vrisja ata për hir të pushtetit, kaq është e gjitha!”

Në mes të Muauijes dhe Hasanit (radijallahu anhu) u vendos paqja, e Muauija i tha Hasanit (radijallahu anhu):

- “Çohu tani dhe mbaj një fjalim përpara njerëzve, tregoju atyre se në ç'gjendje je.”

⁹⁵. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/293.

Hasani (radijallahu anhu) u ngrit dhe iu drejtua popullit:

- “Lëvdoj Allahun që na çoi drejt paqes dhe na pengoi që të derdhnim gjakun e njëri-tjetrit. Bëni kujdes, nuk ka arsye më të mirë sesa ajo që të mëson devotshmëria. Dhe nuk ka dobësi më të madhe sesa anarkia. Për sa i përket çështjes së drejtimit të myslimanëve, për të cilën kemi rënë ndesh me Muauijen, unë ju bëj juve me dije se ai është më i denjë sesa unë për këtë detyrë, megjithëse ajo ishte e drejta ime. Më lejoni t’ju theksoj, se unë e braktisa atë detyrë me qëllim vetëm e vetëm për hir të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, e që të mos derdhet gjak nga gjaku i umetit të Muhamedit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).”⁹⁶

Abdullah bin Ebi Eufa i shmanget sherrit me Jezidin

E tregon Ebu’l-Esh’ath es-San’aniu: “Jezid bin Muauija më pati dërguar mua tek Abdullah bin Ebi Eufa. Me vete ai kishte edhe disa nga sahabët e Resulullahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Unë i thashë atij:

- “Çfarë u këshillon ti njerëzve të bëjnë?” Ibni Ebi Eufa u përgjigj:

- “I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) mua më ka thënë, se nëse përballem me situata si kjo, të shkoj drejt Uhudit, të thyej shpatën dhe të mbyllem në shtëpinë time.”⁹⁷

Amaneti i Resulullahut për Abdullah bin Meslemenë lidhur me ngatërresat e lindura mes myslimanëve

Tregon vetë Muhamed bin Meslemeja: “I Dërguari i Allahut pati thënë:

- “Nëse vjen një ditë, që shikon se njerëzit do të fillojnë të luftojnë për këtë botë, merre shpatën dhe me të gjuaji shkëmbit të Harres, derisa shpata të thyet. Pastaj kthehu në shtëpi dhe mbyllu brenda dhe prit derisa të të vijë vdekja, apo ndonjë dorë e pistë të të zgjatet për të të bërë keq.” – dhe, ja, unë jam duke ndjekur këshillën e tij.”⁹⁸

Dhe, vërtet, pasi u vra Osmani (radijallahu anhu) dhe ra dëshmor, e

⁹⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 8/19.

⁹⁷. Hejthemî, *Mexhmen’u-Zenaid*, 7/587 (12326).

⁹⁸. Hejthemî, *Mexhmen’u-Zenaid*, 7/587 (12327).

mes myslimanëve nisën të shfaqeshin gjithfarë ngjarjesh ngatërresash të njëpasnjëshme, Muhamed bin Meslemeja shkoi në një vend ku kishte shkëmbinj dhe e theu shpatën duke goditur mbi shkëmbinj.”⁹⁹

17. T’I SHQETËSOSH APO TREMBËSH MYSLIMANËT

**Një hadith i transmetuar nga Ebu’l-Haseni lidhur
me ndalesën për t’i frikësuar besimtarët**

E tregon Ebu’l-Haseni, i cili ka qenë edhe në besëlidhjen e Akabesë edhe në luftën e Bedrit: “Ne ishim ulur me të Dërguarin Fisnik. U çua një burrë, por harroi sandalet. Një tjetër, që e vuri re këtë, i mori sandalet dhe i fshehu nën vete. Kur ai që kishte harruar sandalet u kthye dhe pyeti nëse i kishte parë ndokush ato, ata që ishin ulur aty i thanë se nuk kishin parë asnjë sandale. Në atë çast, ai që i pati fshehur u çua dhe bëri sikur i gjeti dhe tha:

- “Ja tek janë!”, – dhe ia ktheu sandalet të zotit. Atëherë, i Dërguari Fisnik tha:

- “*Si guxon ti ta shqetësosh një besimtar, gjë që bëhet është kjo?*”, – duke e qortuar atë që i kishte fshehur sandalet. I përsëriti dy-a tri herë ato që tha.”¹⁰⁰

Një transmetim tjerë prej Nu’mān bin Beshirit për të njëjtën temë

Nu’mān bin Beshiri (radijallahu anhu) tregon: “Ishte një beduin, që teksa falte namaz pas të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) në trup mbante edhe një trastë shigjetash të qepur me lëkurë. Erdhi dikush, që ia mori dhe e ia fshehu atë trastë diku. Pasi i Dërguari Fisnik mbaroi namazin dhe dha selam, beduini u shqetësua dhe pyeti:

- “Po ku është trasta ime e shigjetave?” Në atë çast disa filluan të qeshin me njëri-tjetrin. I Dërguari i Allahut e vërejti këtë dhe u tha:

- “*Kush beson në Allahun dhe në jetën e përtejme, të mos i shqetësojë dhe të mos u hapë ngatërresa myslimanëve!*”¹⁰¹

⁹⁹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/20.

¹⁰⁰. Hejthemî, *Mexhmu’u’l-Zenaid*, 6/385 (10526).

¹⁰¹. Hejthemî, *Mexhmu’u’l-Zenaid*, 6/386 (10529).

18. PËRÇMIMI OSE NËNVLERËSIMI I MYSLIMANËVE

Transmetimi i një hadithi në lidhje me Usamen

Nëna jonë, Aishja (radijallahu anha), na bën me dije se: “Usames (radijallahu anhu) i ngeci këmba te pragu i portës dhe u rrëzua; u çka te balli. I Dërguari Fisnik më urdhëroi mua:

- “Çohu, fshija gjakun dhe ndihmoje të pastrohet!”, – por mua nuk më bëri zemra.

Nëna jonë, Aishja (radijallahu anha), në vazhdim, thotë: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) po i pastronte gjakun Usames dhe thoshte:

- “*Të kishte qenë Usameja ndonjë vajzë e re, do ta kisha veshur, do ta kisha stolisur dhe do e kisha martuar me dikë.*”¹⁰²

Kurse, po për Usamen (radijallahu anhu), Ata bin Ebi Jesari transmeton se: “Ditët e para, kur Usame bin Zejdi (radijallahu anhu) erdhi në Medinë, i dolën plagë në trup. Ai ishte ende një djalë i vogël, aq sa qurrat i dilnin nga hunda dhe i vareshin drejt gojës. Aishes (radijallahu anha) iu neverit kjo gjë. Erdhi i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), ia pastroi fytyrën mirë e mirë dhe e puthi. Kur e pa nëna jonë, Aishja (radijallahu anha), atë skenë, ajo tha:

- “Për Zotin, këtej e tutje unë do të kujdesem më shumë për të!”¹⁰³

19. TË NEVRIKOSËSH NJË MYSLIMAN

Një debat i Ebu Bekrit (r.a.) dhe i disa sahabëve të tjerë për Ebu Sufjanin

Tregon Aidh bin Amri: “Ebu Sufjani, bashkë me një grup njerëzish, po kalonin përpara Selmanit, Suhejbit dhe Bilalit (radijallahu anhum). Në atë kohë, ata thanë për Ebu Sufjanin: “Nuk e pati që nuk e pati rrësk njërën nga shpatat e Allahut ky armiku i Zotit!” Atëherë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) u tha atyre kështu:

¹⁰². Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/62.

¹⁰³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/249 (36800).

- “Si guxoni ju të flisni kështu për një nga më të mëdhenjtë dhe njërin prej prijësve të kurejshëve?” Ebu Bekri (radijallahu anhu) u kthye tek i Nderuari i të nderuarve (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e informoi për atë që kishte ndodhur teksa vinte për tek ai. Profeti ynë i tha atij:

- “*Dubet t’i kesh nxebur shokët e tu. Nëse atyre u është thyer zemra nga fjalët e tua, atëherë edhe Zotin e ke mërçitur.*” Atëherë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) u kthye menjëherë tek shokët e tij, për t’u thënë:

- “O vëllezër, mos ju mërçita qëparë?”

- “Jo, të faltë Zoti, o vëllai ynë!”, – ia kthyen ata.”¹⁰⁴

20. TË MALLKOSH MYSLIMANËT

I Dërguari i Allahut e ndalon mallkimin e atyre që pinin verë

E tregon Omeri (radijallahu anhu): “Në kohën e të Dërguarit Fisnik, ishte një njeri që e quanin Abdullah. Të gjithë e thërrisnin me llagapin “gomar”, ndërsa Profeti ynë (pagja e Zotit qoftë mbi të) buzëqeshte. I Dërguari i Allahut e pati ndëshkuar njëherë atë, sepse pinte. Por, edhe një ditë tjetër atë e sollën tek ai, ishte i pirë dhe Profeti ynë urdhëroi që të ndëshkohej. Kur, pikërisht në atë çast, nga bashkësia u ngrit dikush dhe tha:

- “O Zot, mallkoje këtë njeri! Dënoje sa të duash këtë, ky nuk vë që nuk vë mend!” – I Pari i gjithë profetëve e dëgjoi atë mallkim dhe i këshilloi të gjithë:

- “*Mos e mallkoni atë. Për Zotin, ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij.*”¹⁰⁵

Seleme ibnu’l-Ekuaja thotë se: “Ne, kur dëgjonim që ndonjëri kishte mallkuar ndonjë nga vëllezërit tanë myslimanë, e shihnim atë si një person që kishte kryer një mëkat shumë të rëndë.”¹⁰⁶

¹⁰⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/346.

¹⁰⁵. Buhari, *Sabih*, 6/2489 (6398).

¹⁰⁶. Hejthemî, *Mexhmu’at-Zenaid*, 8/139 (13009).

21. TË SHASH NJË MYSLIMAN

Transmetimi i një hadithi për një njeri që shante shërbyesit e tij

E tregon Aishja (radijallahu anha): “Erdhi një burrë dhe u ul përballë të Dërguarit Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e pyeti:

- “Unë kam dy skllëvër. Ata gjithmonë më gënjejnë, përpiqen të ma hedhin dhe ngrenë krye ndaj meje. Andaj unë i shaj edhe i rrah ngandonjëherë. A do të jap llogari unë edhe për këtë?”

- “*Në ditën e Kiametit ato që u ke bërë ti atyre do të peshohen me ato që të kanë bërë ata ty. Nëse ajo që ti i ke rrahur e i ke sharë do të peshojë njësoj me gabimet e tyre, atëherë nuk do të ketë dënim as për ty, as për ta. Por, nëse të sharat dhe të rrahurat e tua do të jenë më të rënda sesa të këqijat e tyre, atëherë ata do të ta marrin medoemos bakun ty.*”, – iu përgjigj atij i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).

Sahabi e dëgjoi të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u tërhoq mënjandë dhe filloi të qajë me ngashërim. I Dërguari Fisnik e pyeti atë:

- “*Ti nuk e ke lexuar ajetin kur’anor: “Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.”* (Enbija, 21/47) Ai sahab iu përgjigj duke i thënë:

- “O Resulullah, atëherë nuk paska asnjë zgjidhje tjetër veç ndarjes nga këta skllëvër. Të jesh ti dëshmitar, se, për hir të Allahut, unë po i liroj ata.”¹⁰⁷

Sjellja e Ebu Bekrit (r.a.) ndaj një burri që e shan dhe përgëzimi i të Dërguarit të Allahut për të

E tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte ulur, kur aty erdhi një burrë dhe shau Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Profeti ynë e ndoqi me sy i habitur, por edhe buzëqeshi. Kur të sharat e atij njeriu u shtuan, Ebu Bekri (radijallahu anhu) u detyrua që t’u kthente përgjigje disa prej të sharave

¹⁰⁷. Tirmidhi, *Sunen*, 5/320 (3165).

të tij. Kurse i Dërguari Fisnik u nevrikos shumë me këtë sjellje të atij njeriu, ndaj u çua prej aty dhe u largua. Ebu Bekri (radijallahu anhu) ngarendi pas Resulullahut, e arriti dhe i tha:

- “O i Dërguari i Allahut! Ti e pe, ishe ulur aty, e ai njeri më shau. Mirëpo, kur unë u ktheva përgjigje disa prej fjalëve të atij njeriu ti u ngrite dhe u largove. Ngaqë u mërzite me mua u çove?” I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

- “Në të vërtetë, aty kishte një engjëll që i përgjigjej atij njeriu në vendin tënd pas çdo të share. Por, kur ti u ktheve përgjigje disa prej fjalëve të tyre, aty hyri shejtani. Dhe unë thjesht u largova nga një vend ku hyri djalli.”

Pastaj, i Dërguari i Allahut i tha atij:

- “O Ebu Bekr! Tri janë gjërat që janë të vërteta gjithmonë:

1. Kur një njeri e duron padrejtësinë që i bëhet; Allahu medoemos e mbështet atë rob me ndihmën e Tij.

2. Nëse dikush i çel portën dhe i vjen në ndihmë një familjari, për hir të marrëdhënieve të gjakut; Allahu, për hir të kësaj të mire, ia shton atij edhe më shumë pasurinë.

3. Nëse dikush çobet dhe i lutet dikujt për të fituar më shumë pasuri, Allahu ia zgjeron akoma edhe më shumë varfërinë.”¹⁰⁸

22. TË FLASËSH PAS KRAHËVE PËR MYSLIMANËT

Dikush ishte pranë të Dërguarit të Nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kur filloi të flasë pas krahëve për dikë. I Dërguari i Allahut i tha atij këto fjalë:

- “Çohu ikë që këtu, sepse ti nuk mund të jesh dëshmitar.”

- “Por, o i Dërguari i Allahut, të kërkoj ndjesë e nuk do ta bëj më!” I Dërguari Fisnik i tha atij:

- “A je i vetëdijshëm se me atë që thua je duke u tallur me Kur’anin? Ata që i quajnë të lejuara ato që Kur’ani i ka shpallur si të ndaluara, nuk quben se i kanë besuar Kur’anit?”¹⁰⁹

Tarik bin Shihabi tregon: “Halid bin Uelidi me Sa’d bin Ebi Ukasin (radijallahu anhuma) kishin pasur një diskutim të ashpër me njëri-

¹⁰⁸. Hejthemî, *Mexbmen’-Zuaid*, 8/346 (13698).

¹⁰⁹. El-Hindî, *Kenzu’l-Ummal*, 2/460 (4197).

tjetrin dhe ishin paksa të hidhëruar me njëri-tjetrin. Te Sa'di shkoi dikush dhe filloi t'i fliste mbarë e prapë për Halidin. Sa'di u shqetësua shumë nga e folura e atij njeriu, ndaj i tha:

- “Qepe tani, se çfarë kemi ne me Halidin, nuk është bërë ende çështje sa për të lejuar shkeljen e fesë sonë!”¹¹⁰

23. TË PËRGOJOSH MYSLIMANËT

Transmetimi i një hadithi në lidhje me gjykimin e Resulullahut për dikë që kishte përgojuar një mysliman

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Dikush nga fisi i Eslemit erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe e pranoi katër herë me radhë se kishte rënë në zina me një grua. Dhe, sa herë që e pranonte, i Dërguari i Allahut largonte shikimin prej tij. Si përfundim, dha urdhër dhe ai që e kishte pranuar fajin u ndëshkua me dënimin e rexhmit. Në atë kohë, Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të) dëgjoi dy njerëz që flisnin me njëri-tjetrin, duke thënë:

- “Shikoje, shikoje atë njeri! Megjithëse Allahu ia mbuloi mëkatin e kryer, ai nuk e mbajti dot veten po shkoi e shpalli faqeza të gjithëve, e tani po e qëllonjë me gurë si qentë!”

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk bëri zë, nuk u ktheu përgjigje. Pasi bëri një copë rrugë, në rrugë pa një gomar të ngordhur me këmbët e ngritura përpjetë. Kur e pa atë, i Dërguari i Allahut pyeti:

- “*Ku janë filani dhe filani?*”

- “Këtu jemi, o i Dërguari i Allahut.”, – thanë ata.

- “*Uluni pak dhe hajeni mishin e këtij gomari të ngordhur?*”, – u tha i Dërguari i Allahut. Ata të dy nuk kuptuan asgjë, ndaj e pyetën Resulullahun:

- “E kush mund ta hajë atë mish, o i Dërguari i Allahut?” Dhe i Dërguari i Allahut u tha atyre:

- “*Në fakt ajo që bëtë ju duke e përgojuar vëllanë tuaj është diçka më e keqe*

¹¹⁰. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/94.

sesa të ngrënë e mishit të kësaj kufome! Unë i betohem Allahut, se ai njeri që u dënua me gurë tani është duke notuar në lumenjtë e Xhenetit.”¹¹¹

Transmetimi i Aishes (r.a.) dhe i Zejd bin Eslemit për Safijen (r.a.) dhe për një grua tjetër

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Safije binti Hujejit i kishte zënë sëmundja devenë. Për këtë arsye, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i tha Zejnebit:

- “Ti ke shumë deve. Do të ishte mirë t’ia jepje një prej tyre Safijes.” Dhe Zejnebi iu përgjigj:

- “Kujt, asaj hebrejeje do t’ia jap unë një nga devetë e mia!”

Vetëm për këtë fjalë që tha, i Dërguari Fisnik qëndroi larg nënës sonë, Zejnebit, për një kohë më të gjatë se dy muaj. Aq sa, Zejnebi thotë:

- “Fillova thuajse ta humb shpresën se do të kthehej një ditë.”¹¹²

Një ndodhi të ngjashme e tregon edhe Zejd bin Eslemi: “Gjatë kohës që Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte i sëmurë me atë sëmundje që i mori edhe jetën, gratë e tij u mbledhën përreth trupit të tij, kur Safije binti Hujeji tha kështu:

- “Uallahi, o Resulullah! Sa do të doja, të më kishte ndodhur mua kjo që të ka gjetur ty!”

Nënat tona të tjera dëgjuan dhe filluan të shikonin njëra-tjetrën në sy. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kur i pa të shoqet që po ia bënë njëra-tjetrës me sy, tha kështu:

- “*Shkoni të shpëlani gojën!*”

- “Po pse, o Resulullah?” – e pyetën ato.

- “*Sepse folët dhe bëtë me shenja pas shpinës së shoqes suaj. Për Zotin ajo i tha me sinqeritet ato fjalë.*”, – ua ktheu i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).¹¹³

¹¹¹. Ebu Daud, *Sunen*, 2/553 (4428).

¹¹². Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 7/127.

¹¹³. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 4/348; Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 2/313.

I Dërguari Fisnik i gjykon rëndë disa nga sahabët e tij, vetëm sepse ata përgojnë njerëzit

E tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Ne ishim me të Dërguarin Fisnik. Aty erdhi një burrë. Disa nga sahabët e panë dhe thanë:

- “Sa i dobët dhe pafuqishëm është ky njeri, o i Dërguari i Allahut!”

- “*A e dini se ju tani përgojnat një shokun tuaj dhe kjo është si t’i keni ngrënë mishin për së gjalli.*”, – foli i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).

- “O Resulullah,” – thanë sahanët, – “ne thamë diçka që është e vërtetë.”

- “*Nëse ai njeri nuk do ta kishte atë që thatë ju, atëherë ju do të kishit shpëtur për të.*”, – u tha atyre Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).¹¹⁴

24. TË KËRKOSH TË METAT E MYSLIMANËVE NË FSHEHTËSI

Omeri (r.a.), kur shikonte ata që uleshin për të pirë, ndërronte rrugë

Tregon Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu): “Një natë, teksa po shëtitnim nëpër Medinë bashkë me Omerin (radijallahu anhu), dalluam që në një shtëpi kandili vazhdonte të ishte i ndezur. Ne u drejtuam kah ajo shtëpi. Kur u afruam mirë, pamë se derën e kishte të kyçur dhe nga brenda vinin ca zëra që nuk kuptohej fare se çfarë thoshin. Omeri (radijallahu anhu) më kapi për dore dhe më pyeti:

- “A e di ti se e kujt është kjo shtëpi?”

- “Kjo është shtëpia e Rabia bin Umeje bin Halefit.” – iu përgjigja unë.

- “Tani janë duke pirë. Çfarë të bëjmë?”

- “Për mendimin tim.” – tha Omeri (radijallahu anhu), – “ne kemi bërë diçka që na e ka ndaluar Allahu i Madhërishëm, sepse Allahu i Madhërishëm na ka urdhëruar: “**O ju që keni besuar! Mënjaroni**

¹¹⁴. Taberani, *Mu’xhemu’l-Eusat*, 1/145 (458).

shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrit! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Huxhurat, 49/12). Ne erdhëm këtu për t’i gjurmuar në mëkatin e tyre.” – tha dhe, sakaq, u largua që aty pa thënë më asnjë fjalë.”¹¹⁵

Një transmetim tjetër për këtë temë

Theur el-Kindiu tregon: “Një natë, Omeri (radijallahu anhu) kishte dalë të shëtiste nëpër Medinë. Duke kaluar pranë një shtëpie ai dëgjoi zërin e një burri teksa këndonte dhe pasi u ngjit në murin nga mund të shihje se ç’bëhej në atë shtëpi, tha:

- “O armiku i Allahut, çfarë pandehe ti, se ti do të vazhdosh të ngresh krye kundër urdhrave të Tij dhe Ai do të t’i mbulojë të metat?” Ai burrë iu përgjigj kështu Omerit (radijallahu anhu):

- “Shiko, Omer, mos vendos kaq nxituar për mua! Nëse unë kam ngritur krye ndaj Allahut njëherë, ti i ke ngritur Allahut krye tri herë; Allahu i Lartësuar ka thënë: **“O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrit! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.”** (Huxhurat, 49/12); ndërsa ti erdhe deri këtu që të më spiunosh. Allahu i Madhërishtëm urdhëron: **“[...] Nuk është mirësi të hysh në shtëpi nga dera e pasme (siç bënin paganët para Islamit). [...] Hyni në shtëpi nga dyert e tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni!”** (Bekare, 2/189), kurse ti u ngjite mbi mur e hyre në shtëpinë time pa ta lejuar unë! Allahu që është më i Madhi na thotë: **“O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përshëndetur banuesit e tyre. Kjo është më e mira për ju. Ndoshta do t’ia vini veshin!”** (Nur, 24/27), por, ti as këtij urdhri nuk iu binde.”

- “Po të fala unë ty,” – i tha Omeri (radijallahu anhu), – “a do të

¹¹⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1364 (8824).

më falësh edhe ti mua?” Ai burrë e fali Omerin (radijallahu anhu) dhe Omeri u largua menjëherë prej andej.”¹¹⁶

Një ngjarje e Omerit (r.a.) me një burrë të moshuar

Transmetohet nga Ebu’sh-Shejh Sudi: “Omeri (radijallahu anhu) ishte duke shëtitur një natë, kur dalloi dritën e një zjarri të ndezur. Bashkë me Omerin (radijallahu anhu) ishte edhe Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu). U afruan, u afruan andej nga vinte drita; derisa, më në fund, mbërritën në një shtëpi. Ishte mesnatë kur hyri në shtëpi. Kur ç’të shihte, gjen atje një burrë të moshuar, me enën e verës në dorë dhe aty pranë kishte një robinjë që këndonte për të! Omeri (radijallahu anhu) nuk duroi dot dhe iu vërsul atij burri, duke i thënë:

- “Deri sonte kurrë nuk kam parë ndonjë gjë më të shëmtuar sesa kjo pamje e këtij njeriu që pret exhelin!” Ai burrë ngriti kryet dhe tha:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Ti ke të drejtë, por kjo që po bën ti është të gjurmosh mëkatet e njerëzve dhe kjo është shumë më e keqe sesa gjynahu im! Gjurmimi i mëkateve dhe spiunimi është ndaluar, por ti vazhdon të gjurmosh, madje ke hyrë edhe pa leje në shtëpinë time.”

- “Ke të drejtë.”, – ia ktheu Omeri (radijallahu anhu) dhe kafshoi rrobën që kishte veshur e u largua së andejmi me sytë me lot. Teksa largohej, me vete thoshte:

- “Nëse nuk ta fal Zoti këtë që bëre, pisk e ke punën, o Omer! Ky njeri, mëkatin që bënte e fshihte deri edhe nga familja e tij. Kurse tani do të thotë ‘mua më ka parë Omeri’ dhe do të zhytet edhe më shumë në mëkat.”

Për njëfarë kohe, ai burrë i moshuar nuk shkoi të falte namazin me xhemat me Omerin (radijallahu anhu). Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) ishte ulur, kur vërejti se aty drejt fundit të xhematit ishte ulur ai burrë, i cili përpiqej të mos dukej.

- “Ma thërrisni këtu, atë burrin e moshuar që është atje tej.”, – i tha ai atyre që kishte pranë. Ata shkuan dhe i thanë:

- “Omeri të thërret, eja!” Ai burrë u çua. Teksa i hidhte hapat filloi

¹¹⁶. El-Hindî, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1365 (8827).

të ndihej i shqetësuar, se mos Omeri (radijallahu anhu) do ta vinte në pozitë të vështirë dhe do ta poshtëronte në sytë e gjithë xhematit.

- “Eja afër meje!”, – i tha atij Omeri (radijallahu anhu). Ai burrë u afrua aq shumë, saqë shkoi deri afër Omerit (radijallahu anhu).

- “Afroma veshin, dua të të them diçka.”, – dhe i tha:

- “Unë i betohem atij Zoti që na e dërgoi ne Muhamedin si profet të së vërtetës, se as unë, as Ibni Mesudi që ishte me mua atë natë nuk kemi thënë asnjë gjysmë fjale për ty!” Ai njeri i tha Omerit (radijallahu anhu):

- “Afroma edhe ti veshin mua.” Dhe i tha kështu Omerit (radijallahu anhu) në vesh:

- “Uallahi, edhe unë që prej asaj nate nuk e kam vënë më në buzë gotën e verës!”

Omeri (radijallahu anhu) tha ‘Allahu Ekber’ me zë të lartë. Mirëpo njerëzit nuk e kuptuan se pse ai bërtiti ‘Allahu Ekber’ në sytë e njerëzve.”¹¹⁷

25. TË MBULUARIT E GABIMEVE TË MYSLIMANËVE

Këshilla e Omerit (r.a.) për familjen e një vajze

Tregon Sha’biu: “Një burrë erdhi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe tha:

- “Unë kisha një vajzë dhe unë e varrosa atë në një gropë për së gjalli, siç bënim në kohën e injorancës. Ende pa vdekur ne shkuam dhe e nxorëm atë nga toka. Edhe ajo, njësoj si ne, kuptoi Islamin dhe u bë myslimane. Pasi u bë myslimane, ajo bëri një gabim, që ne duhet t’i tregonim vendin, por ajo mori një thikë dhe tentoi të vriste veten. Kur e gjetëm ajo kishte prerë disa nga damarët e qafës. E mjekuam dhe, më në fund, ajo u shërua. Edhe u pendua, ashtu siç duhej të bënte. Erdhën krushq dhe unë u tregova atyre atë që kishte bërë ajo në të shkuarën.”

- “Me një fjalë, ti u ngrite të hapje ato të meta të saj, të cilat Allahu

¹¹⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1229 (8485).

i kishte fshehur? Uallahi, po tregove qoftë edhe një gjë të vetme për atë njeri, do të të jap një ndëshkim të atillë që do të të bëj shembull për të tjerët. Tani ik dhe martoje vajzën siç i ka hije një myslimaneje të mirë e të ndershme.” – ia ktheu Omeri (radijallahu anhu) atij njeriu.”¹¹⁸

Një ngjarje mes Omerit (r.a.) dhe Xheririt

Tregon Sha’biu: “Omeri (radijallahu anhu) ishte në shtëpi dhe me të ishte edhe Xheriri. Omeri (radijallahu anhu) ndieu një aromë dhe tha:

- “Kush e ka hedhur këtë aromë duhet të marrë abdes edhe njëherë.” Xheriri ia ktheu:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Po a nuk duhet që i tërë xhemati të marrë abdes?”

- “Ti je një zotëri i vërtetë, e kështu ke qenë edhe para se të bëheshe mysliman.” – i tha Omeri (radijallahu anhu) Xheririt. – “Allahu të faltë mëshirën e Tij, o Xherir!”¹¹⁹ Xheriri këtë e pati thënë që ai që e kish hedhur aromën të mos ndihej i ofenduar në sytë e të gjithë besimtarëve.

26. TOLERANCA DHE TË QENËT FALËS NDAJ MYSLIMANËVE

Rrëfenja e Hatib bin Ebi Belteas

E tregon Aliu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më pati dërguar mua, Zubejrin dhe Mikdadin në një vend dhe kur na nisi na tha:

- “Ju do të përparoni deri në vendin e quajtur ‘Kopshti i Habut’. Kur të mbërrini atje, do të gjeni një grua në një kosh deveje. Ajo grua ka edhe një letër me vete, do ta gjeni dhe do të ma sillni mua atë letër.”

Ne përparuam me nxitim. Dhe, kur kuajt na prunë në atë kopsht, ç’të shohim përpara syve kishim një kosh deveje! Brenda ishte një

¹¹⁸. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1229 (8485).

¹¹⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1277 (8608).

grua, së cilës ne i thamë:

- “Nxirre letrën, ku e ke?”

- “Nuk e kam me vete.”, – na u përgjigj ajo.

- “Ose nxirr letrën, e na e jep, ose ne do ta gjejmë atë kudo që të jetë, e do të t’i heqim edhe rrobat fare po të jetë nevoja!”, – i thamë ne. Atëherë, ajo grua futi duart mes flokëve të lidhur dhe nxori letrën e fshehur dhe na e dha neve. Ne ia sollëm letrën të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të). E dini seç dëgjuam, letra ishte e Hatib bin Ebi Belteas, i cili ua kishte dërguar atë disa idhujtarëve! Në letër kishte disa informata lidhur me ato që do të bënte i Dërguari Fisnik.

- “O Hatib, ç’është ajo letër?”, – e pyeti i Dërguari i Allahut. Hatibi tha:

- “O i Dërguari i Allahut, do të ishte mirë të mos merrje vendim të nxituar me mua! Unë jam një njeri që jam në marrëveshje me kurejshët. Por kurrsesi nuk jam njëri prej tyre. Shumë nga muhaxhirët që janë këtu me ty kanë marrëveshje me njerëzit që janë këtu dhe falë këtyre mundësive ata mbrojnë pasurinë, familjet dhe marrëdhëniet e tyre me njerëzit. Dhe unë, duke qenë se nuk kam asnjë të afërm timin këtu, u lidha me mekasit, në mënyrë që të mund t’u dal në mbrojtje njerëzve që kam lënë atje. Unë nuk e bëj diçka të këtille kurrë, pasi unë nuk jam kurrsesi një i kthyer nga feja islame. Dhe, qëkurse jam bërë mysliman, nuk e duroj dot mohimin!”

I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e dëgjoi atë dhe tha:

- “Ky njeri na thotë me të vërtetë të drejtën.” Omeri (radijallahu anhu) ndërhyri duke thënë:

- “Më lejo mua, o i Dërguari i Allahut, t’ia fluturoj kokën këtij dyftytrëshi!”

- “Jo!”, – tha i Dërguari i Allahut, – “e vërteta është se Hatibi është prej atyre që kanë marrë pjesë në Bedër. Ku e di ti që Allahu nuk ka thënë për ata që kanë marrë pjesë në Bedër, ‘Bëni çfarë të doni, ju kam falur të gjithëve!’” Fill pas kësaj ngjarjeje u zbrit ajeti kur’anor: **“O besimtarë, mos i bëni miq armiqtë e Mi dhe tuajt, duke u shprehur atyre dashuri, ndërkohë që ata kanë mohuar të vërtetën, që ju ka ardhur dhe kanë dëbuar të**

Dërguarin dhe ju, vetëm se besonit në Allahun, Zotin tuaj. Nëse keni dalë luftëtarë në rrugën Time dhe për të fituar kënaqësinë e pëlqimin Tim dhe fshehurazi u shfaqni atyre dashuri, atëherë gaboheni. Unë e di çfarë fshihni dhe çfarë bëni haptazi. Secili prej jush që vepron ashtu, është shmangur nga rruga e drejtë.” (Mumtehine, 60/1)¹²⁰

Një ngjarje që ka ndodhur mes Aliut (r.a.) dhe një hajduti

Ebu Matari tregon: “Një ditë, unë pashë se tek Aliu (radijallahu anhu) sollën një njeri. Ata thanë se:

- “Ky njeri ka vjedhur një deve.” Aliu (radijallahu anhu) i tha atij njeriu:

- “Mua nuk ma merr mendja që ta kesh vjedhur ti.”

- “Jo, unë e vodha!”, – iu përgjigj ai njeri. Atëherë, Aliu (radijallahu anhu):

- “Jo, ti do t’u kesh ngjarë atyre me hajdutin, he, nuk mund të jetë kështu?” Por, jo, ai njeri këmbëngulte:

- “Jo, vërtet unë e kam vjedhur.”, – thoshte ai. Aliu (radijallahu anhu) e dëgjoi dhe dha urdhër:

- “O Kanber! Merre këtë, lidhja gishtat fort, ndiz zjarrin, thirr edhe xhelatin, t’i pritet dora! Më pritni të vij edhe unë, mos ia pritni atij dorën pa ardhur unë.” Erdhi Aliu (radijallahu anhu) dhe e pyeti atë burrë:

- “Ti e vodhe?”

- “Jo, nuk e vodha unë.”, – u përgjigj ai, kështu që Aliu (radijallahu anhu) e la të lirë. I thanë:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Ai njeri e pranoi vetë fajin, ti pse e le të lirë?” Dhe Aliu (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Sipas deklaratës së tij e lidha dhe po sipas deklaratës së tij e lashë të lirë.”, – duke e vazhduar fjalën e tij, – “Tek i Dërguari i Allahut

¹²⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/284.

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem) sollën dikë që kishte bërë një vjedhje. Ne e dënuam atë sipas urdhrit që na erdhi nga Resulullahu. Mirëpo, më vonë, i Dërguari i Allahut filloi të qajë. E pyeta:

- “Po pse qan, o i Dërguari i Allahut?”

- “*E si të mos qaj? Po i pritet dora dikujt nga umeti im, po nuk qava unë, kush do të qajë?*”, – m’u përgjigj Krenaria e Njerëzimit (paqja e Zotit goftë mbi të). I thanë:

- “Po ta kishe falur, o Resulullah!”, – dhe ai u dha këtë përgjigje:

- “*Ai drejtues që nuk i zbaton ligjet e fesë dhe që fal një fajtor është një prijës shumë i keq. Megjithatë, ju faleni njëri-tjetrin kur shkelni një rregull dhe bëni ndonjë gabim ndaj shokut shokut, mos e kërkon gjykimin e vëllezërve tuaj.*”¹²¹

Një transmetim tjetër lidhur me këtë çështje

E tregon Amr bin Shuajbi: “I pari zbatim i ndëshkimit sipas ligjit islam ka qenë ky: Një burrë e sollën te Profeti i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe erdhën edhe dëshmitarët që ai kishte bërë vjedhje. Profeti ynë i nderuar dha urdhër të zbatohet dënimi sipas ligjit. Dënimi u zbatua, mirëpo fytyra e Profetit tonë u bë e bardhë, sikur t’i kishe hedhur hi.

- “O i Dërguari i Allahut! Më duket se u mërzitët shumë që iu pre dora atij njeriu.”, – i thanë atij.

- “*E si të mos mërzitem,*” – u përgjigj i Dërguari Fisnik (paqja e Zotit goftë mbi të), – “*kur ju i erdhët djallit në ndihmë kundër njërit prej vëllezërve tuaj?*”

- “Po mirë, pse nuk na e ndaluat që t’ia pritnim dorën.”, – i thanë ata atëherë. Resulullahu u përgjigj:

- “*Po ju, pse nuk i menduat të gjitha këto para se ta sillnit tek unë atë njeri? Nuk është e drejtë që një gjykatës të mos e ndëshkojë një fajtor, kur ia kanë sjellë përpara bashkë me provat e fajit të tij.*”¹²²

¹²¹. Hejthemî, *Mexbmu'z-Zenaid*, 6/397 (10567).

¹²². Abdu'r-Rrezzak, *Musannef*, 7/313 (13318).

27. MËRI NDAJ VETË MËKATIT, JO NDAJ ATIJ QË E KRYEN ATË

**Ebu Derdaja dhe Ibni Mesudi ndalojnë fyerjen e
atyre që kanë rënë në mëkat**

E tregon Ebu Kilabe: “Një ditë, teksa po ecte në rrugë, Ebu’d-Derdaja u bë dëshmitar i një ngjarjeje, ku populli po fyente e shante me fjalë dikë që kishte kryer një mëkat. Ebu’d-Derdaja u tha atyre kështu:

- “Po ta kishit gjetur këtë njeri të rënë në një pus të thellë, a nuk do të përpiqeshit për t’i ardhur në ndihmë, që ta nxirrnit që andej?”

- “Patjetër, do të bënim çdo përpjekje!”, – u përgjigjën njerëzit. Atëherë, Ebu’d-Derdaja iu drejtua atyre me fjalët:

- “Atëherë, në vend që ta shani vëllanë tuaj në fe, lutjuni Zotit që nuk ju ka lënë juve të bini në të njëjtën pozitë.”

- “Pra, ti nuk e përçmon këtë njeri, apo jo?”, – e pyetën ata Ebu Derdanë (radijallahu anhu). “Jo, unë nuk e përçmoj atë; unë përçmoj mëkatin e kryer prej tij. Ai do të jetë sërish vëllai im mysliman kur ai të heqë dorë nga e keqja që ka bërë.”¹²³

Një transmetim i Ibni Mesudit

“Kur të shikoni ndonjë prej vëllezërve tuaj, që të jetë duke bërë ndonjë gjynah, mos e mallkoni atë: ‘O Zot, poshtëroje këtë njeri!’, duke i ardhur në ndihmë djallit kundër vëllait tuaj. Lutjuni Zotit që të mos lejojë që të bini edhe ju në atë mëkat, sepse, ne që jemi sahabë të të Dërguarit Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të), nuk thoshim asnjë fjalë të keqe për askënd, nëse nuk ia dinim se si do të ishte ai njeri në çastet e fundit të jetës. Ne vetëm për ata njerëz që e mbyllnin kapitalin e tyre jetësor me një vepër të mirë thoshim: ‘E fitoi amshimin’. Ashtu siç shqetësoheshim për ndonjë, jeta e të cilit përmbylej me ndonjë punë të keqe.”¹²⁴

¹²³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/125.

¹²⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 4/205.

28. PASTRIMI I ZEMRËS NGA SMIRA DHE MLLEFI

Historia e një myslimani, të cilin i Dërguari i Allahut dhe Abdullah bin Amri e përgëzuan me parajsën

Tregon Enes bin Maliku (radijallahu anhu): “Ne ishim ulur e po rrinim me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Resulullahu na tha:

- “*Tani, këtu tek ne do të vijë një njeri që është njëri prej banorëve të Xbenetit.*”

Tek ne erdhi një burrë nga ensarët, i cili sapo kishte marrë abdes, kishte këpucë vetëm në këmbën e majtë, ndërsa nga mjekra i pikonin ende pika uji. Kaloi ajo ditë dhe Profeti ynë na tha sërish të njëjtat fjalë. Aty erdhi po i njëjti person. I Dërguari i Allahut i përsëriti fjalët e tij edhe në ditën e tretë dhe aty erdhi po i njëjti person dhe po në të njëjtën gjendje. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u ngrit dhe Abdullah bin Amr bin Asi e ndoqi atë njeri deri te porta e shtëpisë dhe i tha kështu:

- “Diskutova me babanë dhe iu betova se tre ditë nuk do të shkoja tek ai. Do të të falënderoja shumë, po të më pranoje në shtëpinë tënde për tri ditë.”

- “Patjetër!”, – i tha ai, duke e pranuar atë që i kërkoi Abdullahu.

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: “Abdullahu këtë ngjarje neve na e pati treguar me këto fjalë:

- “Unë ndenja tri ditë në shtëpinë e atij njeriu. Gjatë natës nuk e pashë asnjëherë që të çohet për të falur namaz. Mirëpo, gjatë natës, ashtu siç ishte i shtrirë në krevat, edhe kur kthehej sa nga njëra anë në anën tjetër, përmendte vazhdimisht Allahun dhe thoshte ‘Allahu Ekber’. Ajo që më bëri përshtypje ishte se për tri ditë me radhë nga goja e atij njeriu nuk doli asnjë fjalë e keqe, por vetëm fjalë të mira. Kaluan tri ditë dhe unë nuk pashë asgjë të jashtëzakonshme tek ai njeri, derisa më në fund e pyeta:

- “O rob i Zotit! Unë nuk pata asnjë zënkë, e as urrejtje, për babanë tim. Por unë dëgjova të Dërguarin e Allahut që më tha për ty plot tri

herë: “*Tani tek ne do të vijë një njeri që është prej banorëve të Xhenetit.*”, – dhe, që të tria herët njeriu që erdhi ishte ti. U bëra shumë kureshtar, ‘vallë ç’jetë bën ky njeri, që është prej banorëve të parajsës, ta shoh, që ta ndjek si shembull e të bëhem edhe unë si ai’, prandaj erdha tek ti, të qëndroja si mysafir. Mirëpo, unë nuk pashë asgjë të jashtëzakonshme tek ti, nuk pashë asgjë nga ato që prisja të shihja. Cila duhet të jetë ajo punë që bën ti, që i Dërguari i Allahut të ka përgëzuar me parajsën?” Ai m’u përgjigj:

- “Ajo çfarë ke parë duhet të jetë, sepse unë nuk se bëj ndonjë gjë më shumë.”

U largova prej andej dhe teksa po ikja dëgjova që ai njeri diç thoshte me zë të lartë:

- “Po ta përsëris, e gjithë jeta dhe bëmat e mia janë ato që pe. Por, ta dish se unë në zemrën time nuk ushqej smirë dhe urrejtje ndaj askujt. Nuk ka vend e keqja në zemrën time. Nëse i Dërguari ynë Fisnik e i Nderuar i ka thënë për këtë arsye ato fjalë, unë nuk di ç’të them.”

- “Kjo mirësi duhet të jetë medoemos ajo që të ka lartësuar drejt asaj grade, o njeri.”, – i thashë unë dhe u largova.”¹²⁵

29. GËZIMI PREJ SJELLJEVE DHE BËMAVE TË MIRA TË MYSLIMANËVE

Abdullah bin Abasi gëzonte kur gëzoheshin myslimanët

E tregon Ibn Burejde el-Eslemiu: “Dikush e pati sharë Ibni Abasin (radijallahu anhu) me fjalë, mirëpo ibni Abasi ia pati pritur duke i thënë:

- “Ti po më shan mua, por a e di ti, se unë kam tri cilësi: e para, kur këndoj ndonjë prej ajeteve të Kur’anit Famëlartë, me vete them: ‘Ah sikur njerëzit t’i dinin ajetet e Kur’anit kështu siç i di unë!’ E dyta, kënaqem jashtëzakonisht shumë kur marr vesh se ndonjë prej gjykatësve myslimanë merr një vendim të drejtë. Kur mua as që më

¹²⁵. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 8/150 (13048).

lidh fare asnjë punë me atë gjykatës. E treta, sa herë që dëgjoj se në ndonjë prej qyteteve ku jetojnë myslimanë bie shi shumë i madh e i begatë, edhe pse e di që ata nuk kanë kafshë për të ecur nëpër ujë, por toka do të përfitojë shumë prej atij uji, gëzohem tej mase për ta dhe brenda vetes më kaplon një ngazëllim i papërshekrueshëm.”¹²⁶

30. UDHËHEQJA E NJERËZVE DHE KALIMI SA MË MIRË ME TA

Si e drejtonte i Dërguari i Allahut një njeri të keq

Nëna jonë, Aishja (radijallahu anha) tregon: “Erdhi një burrë dhe kërkoi leje për t’u takuar me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Profeti ynë tha:

- “*Ky është një njeri shumë i keq me fisin e vet!*” Megjithatë, kur ai hyri për t’u takuar me të Dërguarin e Allahut, Profeti e priti atë i buzëqeshur, madje edhe e përgëzoi. Pastaj, aty erdhi edhe dikush tjetër, për të takuar të Dërguarin e Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të), mirëpo, këtë, interesante, Profeti ynë nuk e priti ashtu siç kishte pritur atë që ishte përpara tij, madje nuk i bëri as ndonjë kompliment. Por për të tha:

- “*Në mesin e fisit të vet ky njeri është një njeri shumë i mirë!*” Pasi doli edhe burri i dytë, unë e pyeta të Dërguarin e Allahut:

- “O i Dërguari i Allahut! Ju për atë që hyri i pari nuk kishit një mendim aspak të mirë, por prapëseprapë e pritët atë me buzëqeshje, madje edhe e përgëzuat me fjalë të bukura. Ndërsa të dytin, megjithëse kishit një mendim shumë pozitiv për të, jo vetëm që nuk i thatë ndonjë përgëzim, por as me buzëqeshje nuk e pritët! Cila është urtësia e kësaj, pse e bëtë këtë?”, – dhe ai m’u përgjigj duke më thënë:

- “*O Aishe! Në mes njerëzve ka aq shumë njerëz të këqij, saqë duhet të ruhesh gjithmonë nga e keqja e tyre.*”¹²⁷

¹²⁶. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 2/334; Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/332.

¹²⁷. Hejthemi, *Mexhmu’u’-Zenaid*, 8/38 (12631).

Një transmetim i Safuan bin Asalit po për të njëjtën temë

Safuan bin Asali (radijallahu anhu) tregon: “Gjatë një udhëtimi të Profetit tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) bashkë me të ishim edhe ne. Nga përballë na erdhi një burrë, të cilin Profeti ynë e njohu dhe na tha:

- “*Ky është njeri shumë i keq, nga bijtë më të këqij të fisit të vet!*” Kur ai burrë na u afrua më shumë, Profeti ynë i nderuar u përkujdes për të. Kur ai burrë u largua nga ne, e pyetëm:

- “O i Dërguari i Allahut, po ju kur e patë atë njeri na thatë se ‘ai është një njeri shumë i keq’, por kur ai erdhi drejt nesh, ju e pritët atë me fjalët më të mira!”

- “*Ai është një hipokrit, një njeri me dy fytyra. I flas mirë, që të mos i ndërsejë të tjerët kundër meje; të mos ua ndotë edhe atyre mendjen, siç ka ndotur të vetën!*”¹²⁸

31. MARRJA ME TË MIRË E MYSLIMANËVE

Një ngjarje që ka ndodhur mes Ebu Bekrit (r.a.) dhe Omerit (r.a.)

Tregon Ebu’d-Derdaja (radijallahu anhu): “Unë isha ulur bashkë me të Dërguarin Fisnik të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ebu Bekri (radijallahu anhu) kishte kapur rrobën e tij me grusht, aq sa kishin filluar t’i dukeshin kupat e gjunjëve dhe po vinte drejt nesh. Profeti ynë, kur e pa atë në atë gjendje, tha:

- “*Ma merr mendja se do të ketë diskutuar rëndë me ndonjë prej shokëve tuaj.*” Ebu Bekri pasi e përshëndeti Profetin tonë me selame, tha:

- “Patëm një diskutim të vogël me Omerin dhe më duket se iu rëndova pak, por u pendova më vonë. Iu luta që të më falë, por nguli këmbë, se nuk më falte aspak. Prandaj kam ardhur këtu, tek ju.” I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha tri herë me radhë:

- “*Zoti të falë ty, o Ebu Bekr!*”

Nuk kaloi shumë kohë dhe aty erdhi edhe Omeri (radijallahu anhu), ishte bërë pishman për atë që kishte ndodhur me Ebu Bekrin

¹²⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 4/191.

(radijallahu anhu), ndaj edhe frymën e mbajti drejt e te porta e tij, ku pyeti:

- “Është Ebu Bekri në shtëpi?, – dhe, kur mori përgjigjen, - “Nuk është në shtëpi.” – rendi drejt e te Profeti ynë dhe e përshëndeti. Kur pa se Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të) nuk i dha shumë rëndësi ardhjes së Omerit, edhe Ebu Bekri u mërzit tej mase; i shqetësuar siç ishte, filluan t’i dridheshin gjunjët dhe ra në gjunjë, duke i thënë dy herë të Dërguarit të Allahut:

- “O Resulullah, uallahi fajin më të madh e kam unë!”

- “*Allahu i Lartësuar, kur më ngarkoi mua me detyrën e profetësisë, e të gjithë ju më akuzonit mua si gënjeshtar, mua vetëm Ebu Bekri më pranoi pa më vënë në diskutim, madje edhe më mbështeti me jetë e me pasuri, me ç’të kishte. Ju akoma nuk keni ndërmend të ma lini mua shokun tim?*”, – foli i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).

Që prej asaj dite, askush nuk e ngacmoi apo i bëri ndonjë të padrejtë Ebu Bekrit (radijallahu anhu).¹²⁹

Sëmuret Fatimja (r.a.) dhe Ebu Bekri (r.a.) shkon t’i kërkojë që t’ia bëjë hallall për çdo gjë

Tregon Sha’biu: “Kur u sëmur Fatimja (radijallahu anha), Ebu Bekr Besniku shkoi për vizitë tek ajo dhe kërkoi leje për të hyrë brenda. Aliu (radijallahu anhu) i tha asaj:

- “Ka ardhur Ebu Bekri, o Fatime, do të hyjë këtu tek ti, a i jep leje?”

- “Po!”, – u përgjigj Fatimja (radijallahu anha) dhe Aliu (radijallahu anhu) e futi brenda Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Besniku më i madh u afrua te kryet e Fatimes së nderuar (radijallahu anha) dhe i kërkoi që ajo t’ia bënte hallall për çdo gjë, duke i thënë:

- “Uallahi, unë gjithë ç’kisha, atdheun, pasurinë, familjen dhe të afërmit e mi i braktisa të gjitha vetëm e vetëm për hir të Allahut, të të Dërguarit të Tij dhe të familjes së tij të bekuar.”

Pastaj ai iu lut asaj që t’ia bënte hallall për çdo gjë që mund të kishte bërë të padrejtë ndaj saj dhe Fatimja i tha se ia kish bërë hallall.¹³⁰

¹²⁹. Bejheki, *Sunen*, 10/236 (20884).

¹³⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 8/27.

32. PLOTËSIMI I NEVOJAVE TË NJË MYSLIMANI DHE NDIHMA NDAJ TIJ

Aliu (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Ekzistojnë dy lloje të mirësisë, por unë nuk e di se cila është më e madhe se tjetra: njëra është t’i plotësosh nevojat një njeriu që ka nevojë vërtet për ndihmën tënde dhe vjen tek unë për të më kërkuar ndihmë. Kurse tjetra, është ajo që Allahu i Lartësuar t’ia përmbushë atij nevojën që ka nëpërmjet meje. Unë i betohem Allahut, se të ndihmosh një besimtar, për t’i hequr atij një vështirësi, për mua është më e dashur edhe sikur të më jepnin tërë rruzullin tokësor me flori dhe argjend.”¹³¹

33. KUR MERR VESH SE MYSLIMANËT JANË NË NEVOJË

Historia e gruas që ndali Omerin (r.a.) në rrugë

E tregon Ebu Jezidi: “Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) po shëtiste mes një grumbulli shumë të madh njerëzish, kur përpara i doli një grua e moshuar, të cilën e quanin Haule. Ajo grua i tha Omerit (radijallahu anhu):

- “Ndalu pak, se kam nja dy fjalë për të të thënë.” Omeri (radijallahu anhu) qëndroi pranë asaj gruaje, duke e ulur kokën kah ajo; i vuri duart te supet dhe filloi ta dëgjonte. Ndërkohë, dikush nga bashkësia e njerëzve i thanë atij:

- “Ç’bën kështu, o Omer, ke lënë kaq shumë njerëz në këmbë për të dëgjuar një grua të moshuar.” Por, Omeri (radijallahu anhu) i tha atij që kish folur:

- “Si flet kështu ti! A e di ti se kush është kjo grua e moshuar?”

- “Jo, nuk e di!”, – u përgjigj ai burrë.

- “Allahu, hallin e ankesën e kësaj gruaje e ka dëgjuar nga shtatë kate qiejsh përtej! Ndërkohë që Allahu (xhel’le xhelaluhu) ka zbritur për të ajetin: “Allahu i ka dëgjuar fjalët e asaj, që diskutoi me ty për

¹³¹. El-Hindî, *Kenzu’l-Ummal*, 6/899 (17049).

burrin e vet dhe iu ankua Atij. Allahu e dëgjoi bisedën tuaj, sepse Ai dëgjon dhe sheh gjithçka.” (Muxhadele, 58/1), kush jam unë që të mos e dëgjoj ç’ka për të më thënë? Këtë grua e quajnë Haule binti Thalebe. Për Zotin, sikur deri në të errur të ditës të më mbante, për të më treguar hallin që kishte, nuk ikja pa ia zgjidhur.” – ishin fjalët që tha Omeri (radijallahu anhu).”¹³²

34. TË PËRPIQESH SI E SI QË TË ZGJIDHËSH ÇDO PUNË TË MYSLIMANËVE

Ibni Abasi ishte mbyllur në adhurim (itikaf) të dhjetë ditëve të fundit të muajit të Ramazanit në Xhaminë e Profetit. Erdhi dikush, i dha salam dhe u ul. Ibni Abasi i tha atij njeriu:

- “O filan, po më dukesh shumë i mërztur dhe i shqetësuar.”

- “Ashtu është.”, – iu përgjigj ai. – “Ndaj aksh njeriu unë kam detyrime, sepse e dua shumë; ai pati paguar para për mua, duke më çliruar nga skllavëria. Dhe unë, betohem se për hir të respektit që kam për atë njeri, që është në atë varr atje, se nuk kam me se t’ia paguaj.”

- “A do që të flas unë me të për ty?”, – e pyeti Ibni Abasi.

- “Po mirë, ti e di.”, – ia ktheu ai. Ibni Abasi veshi sandalet dhe doli nga xhamia. Ai burrë e ndoqi nga pas dhe i tha:

- “Mos harrove që je mbyllur në itikaf?”

- “Jo, nuk e harrova, por ai që rri shtrirë në atë varr, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), e kam dëgjuar vetë, kur ka thënë se: *“Kushdo që përpiket për t’i gjetur zgjidhje ballit të një vëllait të tij mysliman dhe ia zgjidh atë, për të ka shpërblime më shumë sesa dhjetë mbyllje në xhami gjatë dhjetë ditëve të fundit të agjërimit të Ramazanit. Dhe Allahu, për atë njeri që mbyllet në xhami gjatë dhjetë ditëve të fundit të muajit të Ramazanit, vetëm e vetëm për të adhuruar Allahun, mes tij dhe Xhehenemit vendos tre benedekë të mëdhenj sa distanca mes pikës ku lind dielli dhe asaj pike ku perëndon.”*¹³³

¹³². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/628 (4649).

¹³³. Mundhiri, *et-Tergib*, 2/96 (1650).

35. TË SHKUARIT PËR VIZITË TE MYSLIMANËT

I Dërguari i Allahut shkonte shumë shpesh për vizitë tek ensarët

Tregon Abdullah bin Kajsi (radijallahu anhu): “Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i vizitonte shumë shpesh ensarët, si një e nga një, ashtu edhe në grup. Në vizitat që ishin më të veçanta ai u shkonte vetë atyre në shtëpitë e tyre. Ndërsa kur donte që t’u bënte ndonjë vizitë në grup, ai shkonte në xhami dhe takohej atje me ensarët.”¹³⁴

Kur sahabët fisnikë shkonin te njëri-tjetri për vizitë

Tregon Enes bin Maliku (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i pati caktuar myslimanët vëllezër të njëri-tjetrit, disa prej të cilëve edhe duke i caktuar vetë dy e nga dy. Ata i merrte malli për njëri-tjetrin, nëse ndonjë ditë apo natë nuk do të ishin takuar me njëri-tjetrin, sepse një ditë-natë e plotë u dukej një kohë goxha e gjatë. Ata e trajtonin vëllai vëllanë gjithmonë me dashuri dhe mirësjellje. Gjithmonë pyeteshin:

- “Çfarë bëre që kur u ndamë bashkë?” Por edhe sahabët e tjerë nuk qëndronin dot më shumë se tri ditë pa dëgjuar vëllezërit e tyre myslimanë.”¹³⁵

36. GOSTITJA E ATYRE QË VININ PËR VIZITË

Kur Omeri (r.a.) dhe Selman Farisiu gostitin njëri-tjetrin

E tregon Enes bin Maliku (radijallahu anhu): “Selman Farisiu (radijallahu anhu) kishte shkuar për vizitë tek Omeri (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu) mori jastëkun ku ishte mbështetur vetë dhe ia zgjati atij. Selman Farisiu i tha:

- “Të vërtetën kanë thënë edhe Allahu dhe i Dërguari i Tij.”

¹³⁴. Hejthemî, *Mexbmen’z-Zeuaid*, 8/316 (13590).

¹³⁵. Hejthemî, *Mexbmen’z-Zeuaid*, 8/318 (13595).

- “Çfarë do të thotë kjo, o Ebu Abdullah, tregoma edhe mua?” – e pyeti Omeri (radijallahu anhu) dhe Selman Farisiu (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- “Një ditë, pata shkuar tek i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të). I Dërguari i Allahut e mori jastëkun që kishte pas shpinës dhe, duke ma zgjatur mua, më tha:

- “*Dëgjoni me kujdes, Selman: kur një mysliman shkon për vizitë në shtëpinë e vëllait të tij mysliman, ai që është mikpritësi, nëse i zgjat vëllait të tij jastëkun ku është mbështetur vetë, vetëm për këtë Allahu i Lartësuar ia fal atij të gjitha mëkatet.*”¹³⁶

37. NDERIMI DHE DHËNIA VLERË NDAJ TË PARËVE TË NJË POPULLI DUKE I RESPEKTUAR SA MË SHUMË

**I Dërguari i Allahut heq jelekun që vishte vetë
dhe e shtron në tokë, që të ulet Xheriri**

Tregon Xherir bin Abdullah el-Bexheliu: “Erdha njëherë tek i Dërguari i Allahut dhe ata jetonin shumë vetë në një shtëpi. Unë qëndrova në këmbë te dera. I Dërguari Fisnik pa njëherë majtas dhe djathtas, por nuk gjeti asnjë vend ku mund të ulesha unë. Hoqi menjëherë jelekun që kishte veshur, e palosi dhe ma zgjati mua, duke më thënë:

- “*Merre dhe ulu mbi këtë.*” E mora, e vura njëherë pranë zemrës dhe e putha, pastaj i thashë:

- “Allahu të prittë Ty me nderim, njësoj siç po më pret ti mua.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) m’u përgjigj:

- “*Kur vjen ndonjë nga njerëzit më të respektuar të një bashkësie a populli, pritëni e gostiteni atë sa më mirë që të mundëni.*”¹³⁷

¹³⁶. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/692 (6542).

¹³⁷. Hejthemî, *Meçhmu’-Zenaid*, 8/35 (12619).

38. KUR RESULULLAHU GOSTIT PJESETARËT E FAMILJES SË BEKUAR

Çohet Ebu Bekri (r.a.) dhe i liron vendin Abasit (r.a.)

Xhafer bin Muhamedi tregon: “Kur i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ulej, në të djathtë të tij ulej Ebu Bekri (radijallahu anhu), në të majtë Omeri (radijallahu anhu), ndërsa përballë ulej Osmani (radijallahu anhu); Osmani (radijallahu anhu) ishte shkruesi i posaçëm i të Dërguarit të Allahut. Dhe, kur qëllonte që aty të vinte Abas bin Abdulmutalibi (radijallahu anhu), Ebu Bekri (radijallahu anhu) çohet dhe ia lironte vendin atij, kurse vetë ulej diku tjetër.”¹³⁸

Kur Ebu Bekri (r.a.) i liron vendin e tij Aliut (r.a.)

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) po rrinte i ulur në xhami. Rreth tij ishin mbledhur edhe sahabët e tij, kur aty u erdhi Aliu (radijallahu anhu), i dhe selam të gjithëve dhe u ndal; po kërkonte për ndonjë vend ku mund të ulej. I Dërguari i Allahut i pyeti ata, duke i parë në fytyrë, se kush mund të hapte pak vend për Aliun. Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte ulur në të djathtë të tij. U largua që aty dhe i tha Aliut:

- “Eja, o Ebu’l-Hasen, mund të ulesh këtu.” Kësisoj, Aliu (radijallahu anhu) u ul në mes të Profetit tonë (paqja qoftë mbi të) dhe Ebu Bekrit (radijallahu anhu). Ne e kuptuam menjëherë se sjellja e Ebu Bekrit e kishte kënaqur tej mase të Dërguarin e Allahut. Profeti i profetëve u kthye nga Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- “*Virtytin e kuptojnë vetëm ata që janë të virtytshëm.*”¹³⁹

Profeti ynë i nderuar: “Aliu është i madhi i çdokujt që më sheh mua si të madhin e vet.”

Tregon Burejdeja: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na pati dërguar ne me një ekspeditë luftarake dhe në krye

¹³⁸. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/487 (37352).

¹³⁹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/359.

na pati caktuar komandant Aliun (radijallahu anhu). Kur u kthyem, Resulullahu na tha:

- “*Si e gjetët shokun tuaj?*” Të gjetur përpara një pyetjeje të këtillë, unë dhe disa shokë i shprehëm atij pakënaqësinë tonë. Unë sa ngrita kokën, që në fakt unë isha një njeri që shikoja në çdo anë, i Dërguari i Allahut ishte bërë i kuq në fytyrë. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na tha:

- “*Aliu është prijësi i atij që më sheh mua si prijësin e tij.*” Atëherë unë i thashë:

- “O i Dërguari i Allahut! Këtej e tutje unë nuk do të të them më asgjë të pahijshme në lidhje me Aliun (radijallahu anhu).”¹⁴⁰

39. RESPEKTIMI I NJERËZVE TË DITUR DHE TË VIRTYTSHËM DHE GOSTITJA E TYRE HERË PAS HERË

Respekti që kishin Ibni Abasi (r.a.) dhe Zejd bin Thabiti (r.a.) ndaj njeri-tjetrit

Tregon Amar bin Ebi Amari (radijallahu anhu): “Kur Zejd bin Thabiti hipi në kafshën e tij të rrugës, Ibni Abasi (radijallahu anhu) kalin e vet e mbajti nga frerët. Zejdi i tha:

- “Po lëshoje atë kafshë, o djalë i xhaxhait i të Dërguarit të Allahut!” Mirëpo, Ibni Abasi vazhdoi ta mbante atë me këmbëngulje dhe tha:

- “Ne kështu na është urdhëruar që të sillemi me njerëzit e ditur dhe të mëdhenjtë tanë.”

Zejdi i thotë:

- “Ma trego pak dorën?” Dhe Ibni Abasi nxori dorën për t’ia parë. Zejdi ia kapi menjëherë dorën Ibni Abasit, ia puthi dhe i tha:

- “Ne kështu na është urdhëruar që të sillemi me të afërmit e Profetit të profetëve.”¹⁴¹

¹⁴⁰. Tirmidhi, *Sunen*, 5/633 (3713).

¹⁴¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/370 (37061).

Vlera që i jepte i Dërguari Fisnik Sa'd bin Muadhrit

Tregon Ibni Abasi: “Sad bin Muadhi kishte një plagë në dorë, nga e cila i rridhte gjak, ndaj i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u çua dhe e përqafoi. Në atë kohë, gjaku i Sadit iu përhap në fytyrë dhe në mjekër edhe të Dërguarit të Allahut. Edhe pse u përpoqën që ta ruanin, të mos bëhej me gjak, i Dërguari i Allahut i qëndroi pranë Sadit, deri në momentin që ai dha shpirt.

Sipas një transmetimi që vjen nga njëri prej ensarëve, Sadi ishte gati për të vdekur dhe ishte pranë Beni Kurejdhas, por plaga iu hap prapë. I Dërguari i Allahut, një të dëgjuar, erdhi menjëherë aty; e mbajti Sa’din nga koka dhe ia mbështeti atë në prehër. Trupin e Sa’dit e mbuluan me një çarçaf të bardhë. Kur i mbulonim kokën, këmbët i mbeteshin jashtë. Ishte një njeri me lëkurën të bardhë dëborë dhe i mbushur. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit goftë mbi të) tha:

- “O Zot, *Sa’di luftoi në rrugën Tëndë. Ai e pranoi të Dërguarin Tënd dhe po me këto mendime e dorëzoi shpirtin. Të lutem, prite sa më mirë shpirtin e tij.*”

Sa’di kur i dëgjoji këto fjalë të të Dërguarit të Allahut, hapi sytë dhe i tha:

- “Paqja e Zotit goftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut! Unë e dëshmoj, se ti je i Dërguari i Allahut! Pjesëtarët e familjes së Sadit kur panë se i Dërguari i Allahut e vuri mbi prehër kokën e Sa’dit, u shqetësuan. Dhe, kur e shprehën shqetësimin, Profeti ynë u tha atyre:

- “*Unë e lus Allahun, që në shtëpinë e Sadit, në çastet e fundit të tij, sa ka njerëz të ketë edhe engjëj.*”

Nëna e Sadit filloi të qajë për të birin dhe ata që ishin të pranishëm, i thanë:

- “Për Sadin po e thua këtë poezi?!” I Dërguari i Allahut tha:

- “*Lëreni të qetë, ka sa e sa të tjerë që nuk lënë gënjeshtër pa thënë me poezi të tyre!*”¹⁴²

¹⁴². Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/426.

Vlera që i jepte Omeri (r.a.) Amr bin Tufejl ed-Deusit

Tregon Abduluahid ibn Aun: “Tufejl bin Amri kishte ardhur tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem); ishte bërë mysliman. Tufejli qëndroi në Medinë deri në kohën që i Dërguari i Allahut u nda nga kjo jetë dhe kur disa nga arabët filluan të ktheheshin nga feja, ai iu bashkua myslimanëve që morën pjesë në luftën e Jemames. Me vete kishte edhe djalin e tij, Amrin. Tufejli ra dëshmon në Jemame, kurse i biri iu plagos, i këputën krahun me një të goditur të shpatës. Amri ishte pranë Omerit (radijallahu anhu), kur atij i sollën për të ngrënë. Mirëpo, Amri u tërhoq në një qoshe. Omeri (radijallahu anhu) e dalloi veprimin e Amrit, kështu që e pyeti:

- “Çfarë të gjeti, apo të shkoi mendja te krahu i këputur?”

- “Po!”, - iu përgjigj ai dhe Omeri (radijallahu anhu) ia priti duke i thënë:

- “Uallahi, unë nuk kam për ta provuar këtë ushqim, gjersa ti të futësh dorën në pjatë e të hash. Nga të gjithë sa sheh këtu ti, asnjëri nuk e ka dërguar njërin nga krahët në Xhenet.” Më vonë, Amri mori pjesë në luftën e Jermukut, ku edhe ra dëshmor.”¹⁴³

40. QËNDRIMI NDAJ ATYRE QË FLISNIN KEQ PËR TË MËDHENJTË

Qëndrimi i Omerit (r.a.) ndaj atyre që e shihnin atë si më të lartë sesa Ebu Bekri (r.a.)

Tregon Hasan Basriu: “Omeri (radijallahu anhu) kishte informatorët e vet në mesin e njerëzve. Një ditë ata erdhën tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i thanë se kishte shumë njerëz që e shihnin atë si më të lartë sesa Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu) u nxeh shumë nga këto fjalë. Dërgoi menjëherë njerëz që t’ia sillnin menjëherë aty të gjithë ata që kishin thënë ato fjalë, të cilëve u tha:

- “Mor njerëz të këqij, krijesa të gjora, që nuk lini njerëz të pastër pa ndotur!” Kur ata e pyetën:

¹⁴³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/519 (37440).

- “Po pse na flet kështu? Çfarë gabimi kemi bërë kështu?” – Omeri (radijallahu anhu) i përsëriti edhe tri herë fjalët e rënda që u pati thënë pak më parë dhe u tha:

- “Pse keni filluar të bëni dallim mes meje dhe Ebu Bekrit (radijallahu anhu)? I betohem Allahut që e ka në dorë jetën time, se unë asgjë nuk dua më shumë sesa të kem një vend në Xhenet ku të mund të takohem me Ebu Bekrin!”

Omeri (radijallahu anhu) thoshte kështu: “Më i mbari i të gjithë umetit të të Dërguarit të Allahut është Ebu Bekri. Kushdo që thotë të kundërtën e kësaj që them unë, ta dijë se ai do të jetë duke shpifur.” Me pak fjalë unë do ta ndëshkoj atë me të njëjtin ndëshkim që i jepet atij që shpif.

Reagimi i Omerit (r.a.) ndaj dy burrave që fyen Ibni Mesudin

Ebu Uaili tregon: “Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) kishte parë dikë që e tërhiqte rrobën zvarrë dhe i pati thënë që ta shkurtonte atë që mbante të veshur.

- “Shkurtoje edhe ti!”, – iu përgjigj ai njeri Ibni Mesudit dhe Ibni Mesudi ia ktheu duke i thënë:

- “Po situata ime ndryshon nga ajo e jotja. Unë i kam këmbët të dobëta dhe veç kësaj unë dal edhe imam, për t’u falur namazin njerëzve!” Këtë ndodhi e mori vesh edhe Omeri (radijallahu anhu), ndaj e mori atë burrë dhe filloi ta godasë, duke e qortuar:

- “Kush je ti t’i kthesh përgjigje Ibni Mesudit!”

Omeri (radijallahu anhu), një ditë, ishte në Medinë dhe po ndiqte nga larg me sy shtëpinë e Ibni Mesudit. Në atë kohë, dikush nga kurejshët i tha atij:

- “O Prijësi i Besimtarëve, ja një shtëpi e këtillë na ka hije neve!” Omeri (radijallahu anhu) mori një gur balte nga toka dhe ia vërviti atij njeriu, duke i thënë:

- “Domethënë ty unë të dukem më i mirë se Ibni Mesudi, hë?”¹⁴⁴

¹⁴⁴. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 4/235.

41. TË QARËT DHE MËRZITJA NGA VDEKJA E TË MËDHENJVE

Të qarat e Suhejbit (r.a.) kur sheh Omerin (r.a.) të plagosur

Ibni Sirini tregon: “Kur u plagos Omeri (radijallahu anhu), atij i sollën diçka për të pirë. E piu, por ajo që piu i doli ashtu siç e piu nga vendi i plagës. Suhejbi e pa atë skenë aq të dhimbshme dhe tha:

- “Ah Omeri im, ah vëllai im! Kush do të na prijë ne kur të mos jesh më ti!” Dhe filloi të vajtojë me britma. Omeri (radijallahu anhu) i tha:

- “Pusho, vëlla, a nuk e di ti se shpirti për të cilin vajtohet pas vdekjes bëhet të vuajë?”¹⁴⁵

Një tjetër transmetim për këtë ngjarje

Ndërsa Mikdam bin Madikeribi e transmeton kështu këtë ngjarje: “Omeri (radijallahu anhu) ishte plagosur, e bija e tij, Hafsa, erdhi tek i ati dhe iu drejtua me fjalët:

- “O sahabi i të Dërguarit të Allahut, o vjehërri i Resulullahut, o Prijësi i Besimtarëve!”

- “Abdullah, më ngri se dua të qëndroj i ulur!”, - tha Omeri (radijallahu anhu).

- “Nuk i duroj dot gjithë këto lavdërime kaq të mëdha.” Abdullahu e ngriti dhe ia mbështeti kokën pas kraharorit të tij, kur Omeri (radijallahu anhu) tha:

- “Nëse vazhdon të qash, duke më numëruar të mira njëra pas tjetrës, ta dish se nuk ta bëj hallall të drejtën e babait! Unë nuk t'i ndaloj dot lotët. Por nuk ka asnjë të vdekur, që njerëzit e përmendin me cilësi që nuk i ka pasur, që engjëjt të mos ia mbajnë shënim të gjitha cilësitë e rreme që i numërojnë njerëzit e tij.”¹⁴⁶

¹⁴⁵. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 3/362.

¹⁴⁶. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 3/362.

42. NDRYSHIMI NË SHPIRT I NJERËZVE PAS VDEKJES SË TË MËDHENJVE

**Si e përshkruan Enesi (r.a.) ditën kur
ndërroi jetë i Dërguari i Allahut**

Në një prej transmetimeve të tij në lidhje me ndodhinë e hixhretit Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Unë Profetin tonë kur erdhi në Medinë e pata parë; nuk kam parë ndonjë ditë më të bukur dhe më të shndritshme sesa ajo ditë. Kam qenë edhe në ditën kur Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u nda nga kjo jetë; nuk kam parë ndonjëherë ditë më të shëmtuar e më të errët.”¹⁴⁷

Enesi (radijallahu anhu) gjithashtu thotë se: “Në atë ditë që vdiq Profeti ynë i nderuar (paqja e Zotit qoftë mbi të), Medinën sikur e mbuloi një errësirë totale. Edhe kur varrosëm trupin e bekuar të tij, nuk e kishim shkundur ende dheun që na ishte ngjitur pas teshave, kur ne filluam të ndiejmë se zemrën nuk e kishim më si më parë.”¹⁴⁸

Çfarë tha Ebu Talhaja kur u nda nga kjo jetë Omeri (r.a.)

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: “Kur u mbledh kuvendi i këshillimit, për të diskutuar në lidhje me çështjen e kalifatit, Ebu Talhaja (radijallahu anhu) u tha atyre që ishin të pranishëm në kuvend:

- “Nëse do të më pyesni mua, veprimi juaj për ta zgjedhur kalifin të lëkundur ka më shumë rrezeqes sesa po të garonit me njëri-tjetrin, kush e kush të bëhet kalif. Uallahi, me vdekjen e Omerit, si jeta fetare, si ajo e kësaj bote, kanë nisur të bëjnë hapa mbrapa.”¹⁴⁹

43. DHËNIA VLERË EDHE ATYRE QË JANË TË VARFËR DHE TË DOBËT

Rëndësia që u jepte i Dërguari i Allahut mysli-manëve të varfër

Tregon Habab bin Ereti (radijallahu anhu): “Akra bin Habisi dhe

¹⁴⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/234.

¹⁴⁸. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/274.

¹⁴⁹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/374.

Ujejne bin Hisni patën ardhur tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kur panë se i Dërguari i Allahut po qëndronte i ulur bashkë me Amarin, Suhejbin, Bilalin dhe Habab bin Eretin (radijallahu anhum), u thanë atyre disa fjalë të pakëndshme dhe u larguan së andejmi. Më vonë, kur mbetën vetëm për vetëm me Profetin e nderuar, ata i thanë atij:

- “Arabët janë duke ardhur në grupe tek ti. Dhe ne na vjen zor që ti qëndron i ulur me këta skllëvër. Kur të vijmë herë tjetër, largoji ata.”

- “*Në rregull!*”, - u tha Profeti i nderuar, i lëkundur në zemër. Atëherë, idhujtarët thanë:

- “Ta hedhim në letër këtë që biseduam.” Dhe, i Dërguari i Allahut thirri Aliun (radijallahu anhu), që ta nënshkruante ai marrëveshjen. Në atë çast ne ishim tërhequr në një qoshe, po rrinim ulur, kur Xhibrili (alejhis'selam) zbriti ajetet: **“Mos i dëbo ata që i luten Zotit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar Fytyrën (mirësinë) e Tij! Ti nuk je aspak përgjegjës për ata e as ata nuk janë përgjegjës për ty. Nëse ti i dëbon ata, atëherë do të jesh keqbërës. Kështu, Ne i kemi bërë disa prej tyre si sprovë për të tjerët, që të thonë: ‘Vallë, këta janë ata prej nesh, që Allahu u ka dhuruar mirësi?!’ - A mos vallë, Allahu nuk i njeh më mirë ata që i janë mirënjohës?”** (En'am, 6/52-53)

Atëherë i Dërguari i Allahut e prishi tekstin e asaj marrëveshjeje dhe na thirri duke na përshëndetur:

- “*Paqja e Zotit qoftë mbi ju!*” Tanimë, pas zbritjes së këtyre ajeteve, ne qëndruam me të aq pranë, sa që edhe pak edhe gjunjët tanë mund të preknin gjunjët e tij dhe i Dërguari i Allahut qëndronte vetëm me ne. Kur atij i duhej që të ngrihej, ngrihej ai dhe ngriheshim edhe ne. Fill pas kësaj u zbritën edhe këto ajete të Kur'anit Famëlartë: **“Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e, që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.”** (Kehf, 18/28)

Pasi u zbritën këto ajete ne qëndronim me të Dërguarin e Allahut, e kur vinte koha që atij i duhej të largohej, çoheshim edhe ne dhe ndaheshim prej tij. Në të kundërt, ai duronte derisa të çoheshim edhe ne.¹⁵⁰

Kur i Dërguari i Allahut gostit Ibni Umu Mektumin

Tregon Enesi (radijallahu anhu), lidhur me shkakun e zbritjes së sures Abese: “Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte duke folur me Ubej bin Halefin, kur aty erdhi Abdullah bin Umu Mektumi, i cili ishte i verbër. Ubej bin Halefi, një të parë Ibni Umu Mektumin që erdhi, e ktheu fytyrën në anën tjetër, për të mos e parë. Aty u zbrit sureja “Abese”, e cila niste me ajetet: **“E mrroli fytyrën, sepse erdhi aty i verbri.”** Pas kësaj ndodhie, Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e gostiste sa herë që e shikonte këtë njeri, i cili u përmend prej Allahut në Kur’anin Famëlartë.”¹⁵¹

44. DHËNIA VLERË NËNËS DHE BABAIT

Përgjigja e të Dërguarit të Allahut ndaj një sahabi që e pyeti se si duhet ta falënderonte nënën e tij

E tregon Burejdeja (radijallahu anhu): “Te Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi një burrë dhe e pyeti:

- “O Resulullah! Në një ditë të nxehtë unë e mbajta nënën mbi shpinë për gati ‘njëmbëdhjetë kilometra’. Ishte aq shumë nxehtë, sa që po të vije një copë mish në tokë, do të piqej. A mund të quhet se e kam paguar të drejtën e nënës tek unë?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) *in përgjigj*:

- “Ai shërbim që i ke bërë ti nënës, mund të këmbehet vetëm me një dhimbje të vetme të lindjes!”¹⁵²

¹⁵⁰. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/146.

¹⁵¹. Ebu Ja’la, *Musned*, 5/431 (3132).

¹⁵². Hejthemî, *Mexhmen’-Zeuaid*, 8/254 (13394).

I Dërguari Fisnik nuk e lejon Ebu Hurejren të marrë pjesë në luftën e Hajberit vetëm sepse nuk e lejon nëna e tij

Tregon Ebu Uameja: “I Dërguari i Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Bëhuni gati për luftë me këtë rrethinë që e ka popullin kaq zullumqar. Me lejen e Allahut, ju do të dilni ngadhënjimtarë edhe ndaj tyre. Kush e ka kafshën të sertë, apo të dobët të mos niset me ne.*” Ishte ky urdhër i të Dërguarit të Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem), që e bëri Ebu Hurejren të shkonte menjëherë pranë nënës së tij dhe i tha:

- “Nënë më bëj gati, se do të shkoj në luftë. I Dërguari i Allahut na tha përgatitnim armët dhe plaçkat për luftë.” E ëma iu përgjigj:

- “O bir, po ti e di që unë nuk kam askënd veç teje dhe unë pa qenë ti as deri në rrugë nuk dal dot.”

- “Nuk mund të rri pa shkuar me të Dërguarin e Allahut.”, - nguli këmbë Ebu Hurejreja. Ishte pikërisht kjo këmbëngulje e Ebu Hurejres (radijallahu anhu) që e shtyu nënën e tij t’i thoshte se nuk do t’ia falte të drejtën e qumështit. Mandej, ajo shkoi fshehtazi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha se nuk donte që i biri të merrte pjesë në atë luftë. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i dha përgjigje:

- “*Mirë, në rregull.*” Nuk kaloi gjatë, kur aty erdhi Ebu Hurejreja. I Dërguari i Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem) nuk pa fare nga ana e Ebu Hurejres; madje kokën e ktheu në anën tjetër. Ebu Hurejreja nuk duroi dot dhe e pyeti:

- “O Resulullah! Shoh se nuk doni të më shikoni, me siguri diç duhet të keni dëgjuar për mua.”

- “*Ti je i biri i asaj nëne që nuk ta fal hakun që të ka dhënë gj! Mos ka ndonjë nga ju që pandeh se duke qenë me nënën, apo babanë e tij, nuk është në rrugën e Allahut (xhell’e she’nubu)? Është kreyt e kundërta, kushdo që sillet mirë me nënën dhe babanë e tij dhe kujdeset që të mos lërë mangët asnjë prej të drejtave të tyre është vazhdimisht duke luftuar në rrugën e Allahut.*”, - foli i Dërguari i Allahut.

Ebu Hurejreja thotë se: “Pas këtyre fjalëve të Resulullahut unë nuk

mora pjesë në asnjë luftë për dy vite me radhë, derisa nëna u nda nga kjo jetë.”¹⁵³

45. DHEMBSHURIA NDAJ FËMIJËVE DHE SJELLJA ME TA ME DREJTËSI

**I Dërguari i Allahut ndërpret hutben dhe
zbret nga minberi për nipin e tij Husejnin**

Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) tregon: “Njëherë, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte mbi minber dhe po u fliste besimtarëve, kur aty erdhi nipi i tij, Husejni i vogël, me një rrobë gjysmë të veshur e që e tërhiqte zvarrë. Teksa ecte, këmba iu pengua pas saj dhe u rrëzua. Resulullahu zbreti menjëherë nga minberi, për të ngritur Husejnin e rrëzuar. Besimtarët, me ta parë fëmijën, e ngritën dhe e çuan tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). I Dërguari Fisnik e mori Husejnin në krahë dhe tha:

- “*Zoti e shkatërroftë djallin! Vërtet, fëmija është një shkak shumë i madh sprove. Uallahi, kur më prunë djalin e kuptova që kisha zbritur nga minberi!*”¹⁵⁴

**Kur i Dërguari i Allahut falte namazin, dy nipërit e tij,
Hasani me Husejnin i hipnin mbi shpinë**

E tregon Ebu Saidi (radijallahu anhu): “Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte në sexhde, kur aty erdhi Hasani i vogël (radijallahu anhu) dhe i hipi mbi shpinë. Resulullahu zgjati krahun dhe e mbajti fëmijën, u çua në këmbë dhe ashtu u ul edhe në ruku. Kur u drejtua pas rukusë, e lëshoi fëmijën në tokë dhe ai iku.”¹⁵⁵

Transmeton Zubejri (radijallahu anhu): “Uallahi e di shumë mirë, një ditë, Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte në sexhde dhe aty erdhi Hasani i vogël dhe iu ngjiti mbi shpinë. Ai nuk e zbreti atë derisa ai vetë deshi të zbriste. Resulullahu, kur ishte në sexhde, ndonjëherë i mbante këmbët të hapura dhe vinte Hasani, e

¹⁵³. Hejthemi, *Mexbmen’z-Zeuaid*, 5/582 (9650).

¹⁵⁴. Hejthemi, *Mexbmen’z-Zeuaid*, 8/284 (13481).

¹⁵⁵. Hejthemi, *Mexbmen’z-Zeuaid*, 9/279 (15033).

hynte nga njëra anë e dilte nga ana tjetër.”¹⁵⁶

Reagimi i Akra bin Habisit kur i Dërguari i Allahut puth Hasanin e vogël dhe përgjigjja që i ktheu Profeti ynë

Tregon Saib bin Jezidi: “I Dërguari Fisnik puthi Hasanin e vogël, kur atë e pa Akra bin Habis dhe i tha:

- “Unë kam dhjetë fëmijë, por nuk kam puthur asnjëherë asnjërin prej tyre.” Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të) e dëgjoi dhe i tha:

- “*As Allahu nuk i mëshiron ata që nuk janë të mëshirshëm ndaj njerëzve.*”¹⁵⁷

Sihariqi i të Dërguarit Fisnik për ata që tregohen të dhembshur e të mëshirshëm ndaj fëmijëve të tyre, si dhe ndaj atyre që veprojnë me drejtësi me ta

E tregon Enesi (radijallahu anhu): “Një grua, bashkë me dy vajzat e saj erdhën tek Aishja (radijallahu anha). Aishja (radijallahu anha) i dha asja gruaje tri kokrra hurma. Ajo grua u dha vajzave nga një kokërr hurmë. Fëmijët, pasi hëngrën hurmat që u dha e ëma, filluan ta shihnin nënën e tyre në sy edhe për hurmën që kishte mbetur. Kësaj here, ajo nënë e ndau edhe hurmën e tretë në gjysmë dhe ua dha fëmijëve. Pastaj ato u larguan nga Aishja (radijallahu anha). Më vonë, kur u kthye në shtëpi Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të), nëna jonë, Aishja (radijallahu anhu) ia tregoi edhe atij atë që kishte ndodhur gjatë ditës. I Dërguari i Allahut e dëgjoi dhe i tha:

- “*Kjo sjellje e çon në Xhenet atë grua.*”¹⁵⁸

46. VLERËSIMI I FQINJËVE DHE GOSTITJA E TYRE

Të drejtat e fqinjtit

Muauije bin Hajde tregon:

- “O i Dërguari i Allahut, çfarë të drejtash kanë fqinjët e mi tek unë?”,

¹⁵⁶. Hejthemî, *Meçhman'z-Zenadi*, 9/279 (15034).

¹⁵⁷. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2/228 (7121).

¹⁵⁸. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 2/231.

– e pyeta njëherë të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).

Profeti ynë m’u përgjigj:

- “*Kur të sëmuret fqinji, t’i shkosh për vizitë; kur të vdesë, ta shoqërosh trupin e tij deri në varrezë. Nëse mbetet ngushtë, t’i shkosh në ndihmë dhe t’i japësh mbështetje. Kur t’i vijë ndonjë mirësi prej Allahut, ta përgëzosh, duke i thënë: ‘Qoftë më e mira.’ Nëse i ndodh ndonjë e keqe, ta qetësosh. Çatinë e shtëpisë mos e bëj më të lartë sesa e tija, që të mos e pengosh atë të përfitojë prej ajrit. Ose mos i thuaj se çfarë je duke gatuar për vete, ose, nëse ia thua, atëherë gostite edhe atë me atë ushqim që je duke gatuar.*”¹⁵⁹

Historia e një burri që i mundonte fqinjët e tij

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) tregon se: “Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte bërë gati për t’u nisur për në njërën prej luftërave, kur na tha:

- “*Kushdo që i prek fqinjët e tij, duke u thënë ndonjë gjë të pahijshme, të mos vijë me ne sot.*”

Një prej atyre që ishin të pranishëm u hodh e tha:

- “Unë kam urinuar te fundi i murit të fqinjit tim.”

- “*Atëherë ti të mos vish me ne sot.*” – i tha atij njeriu Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të).”¹⁶⁰

47. GOSTITJA E SHOKUT TË MIRË

I Dërguari i Allahut i këshillon dy prej sahabëve të tij që të nderonin Rebah bin Rabian

Tregon vetë Rebah bin Rabia: “Ne ishim nisur me ushtrinë për diku dhe me ne ishte edhe vetë i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ai u pati dhënë çdo tri vetëve nga një deve, ku dy vetë hipnin mbi deve dhe njëri ecte në këmbë e drejtonte devenë. Teksa po zbrisnim malin teposhtë, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) më pa duke ecur dhe më tha:

¹⁵⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 9/92 (24897).

¹⁶⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 9/104 (24933).

- “O *Rebab*, po shoh që je duke ecur në këmbë.”

- “O i Dërguari i Allahut, unë tani sapo zbrita, se mbi deve isha. Tani erdhi radha e shokëve të hipnin.” – iu përgjigja unë. Mandej unë shkova pranë shokëve të mi. Ata më thanë mua:

- “Eja, hip mbi deve dhe mos zbrit më derisa të zbresim; ne do të të ndjekim nga pas.”

- “Po, pse?”, – i pyeta unë dhe ata m’u përgjigjën:

- “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na porositi për ty, *‘Ju keni një shok shumë të mirë, të silleni sa më mirë me të!’*”¹⁶¹

48. SJELLJA ME NJERËZIT SIPAS POZITËS SË TYRE

Tregon Amr bin Mihraku: “Njëherë, kur Aishja (radijallahu anha) ishte duke ngrënë, pranë i kaloi një burrë i veshur mirë. Aishja e nderuar e ftoi atë njeri të ulej në sofër me të. Në atë kohë aty erdhi edhe dikush tjetër. Aishja (radijallahu anha) i dha edhe atij një copë bukë. Dhe, kur e pyetën Aishen (radijallahu anha) për arsyen e atij ndryshimi në sjelljen me të dy ata njerëz, Aishja (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Resulullahu ne na ka urdhëruar, që me njerëzit të sillemi veçanërisht sipas pozitës së tyre në shoqëri.”¹⁶²

49. DHËNIA SELAM MYSLIMANËVE DHE PRANIMI I SELAMIT TË MYSLIMANIT

Rregulli i Ebu Umames

Muhamed bin Zijadi tregon: “Ebu Uameja po kthehej në shtëpi, kur unë futa krahun në krahun e tij dhe e bëmë bashkë atë copë rruge. Ai çdokënd që shihte në rrugë, pa dalluar, mysliman, i krishterë, i madh, i vogël, i përshëndeste të gjithë:

- “Selamun alejkum, selamun alejkum.” – dhe, kur mbërriti përpara shtëpisë, më porositi:

¹⁶¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 9/332 (25582).

¹⁶². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1237 (8503).

- “Nipçe! I Dërguari i Allahut neve na ka urdhëruar që ne ta përhapim sa më shumë përshëndetjen mes njerëzve, duke u uruar atyre paqen.”¹⁶³

Selmani (radijallahu anhu) tregon: “Një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha:

- “Es’selamu alejkum, o i Dërguari i Allahut!” Dhe i Dërguari i Allahut ia ktheu përshëndetjen duke thënë:

- “Ue alejkes’selam ue rahmetullahi ue berekatuh.” Paskëtaj erdhi dikush tjetër dhe tha:

- “Es’selamu alejkum ue rahmetullah.” I Dërguari i Allahut e përshëndeti:

- “Ue alejkes’selam ue rahmetullahi ue berekatuh.”

Por, kur aty erdhi dikush tjetër dhe e përshëndeti atë:

- “Es’selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuh.” I Dërguari i Allahut ia ktheu duke i thënë vetëm:

- “Ue alejke (edhe mbi ty)”. Paskëtaj ai njeri tha:

- “O Resulallah, po kur tek ti erdhi aksh e aksh njeri dhe të përshëndetën, ti atyre u dhe një përgjigje më të bukur se kjo.”

- “*Po ti nuk më le mua asgjë për të thënë, sepse Allahu i Madhërishtëm na urdhëron, që, “kur dikush t’ju përshëndetë, përgjigjuni atij duke e përshëndetur e uruar diçka edhe më të mirë se urimi i tij.” Prandaj, unë ty nuk kisha se ç’mund të të thosha, veçse ‘edhe ty’.*”¹⁶⁴

50. DËRGIMI I SELAMIT

Historia e Selman Farisiut dhe Esh’ath bin Kajsit me Xherir bin Abdullahun

Ebu’l-Bahteriu tregon: “Esh’ath bin Kajsi me Xherir bin Abdullah el-Bexheliun, dolën përpara Selman Farisiut, i cili qëndronte në një kala në zonën e Medainit dhe pasi i dhanë selam, e pyetën:

- “Ti je Selman Farisiu?”

¹⁶³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 6/112.

¹⁶⁴. Taberani, *Muxhemu’l-Kebir*, 6/246 (6114).

- “Po, unë jam!”, – u përgjigj ai.

- “Pra, ti je shoku i Profetit tonë?”, – vijuan ta pyesnin. Por përgjigjja e tij qe e pazakontë.

- “Nuk e di!” Kjo përgjigje i futi në dyshime ata dy burra. I thanë njëri-tjetrit:

- “Më duket se nuk është ky ai që kërkojmë.”

- “Shoku juaj që kërkonte unë jam. Po, është e vërtetë, unë e kam parë të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), edhe kam ndenjur me të; por jam, apo nuk jam, shoku i tij, këtë nuk e di, sepse shokët e tij të vërtetë janë ata që do të hyjnë bashkë me të në Xhenetin e amshuar! Sidoqoftë, çfarë ju ka sjellë deri këtu, çfarë kërkonte prej meje?” Ata iu përgjigjën:

- “Ne vijmë nga Siria, vendi ku qëndron vëllai juaj.”

- “Kush është ky?”, – pyeti Selmani.

- “Ebu Derdaja.”, i thanë ata. Në kohën kur Profeti ynë i dashur (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i pati lidhur sahabët e tij në vëllazëri mes njëri-tjetrit, Selmanin dhe Ebu Derdanë i pati shpallur vëllezër.

- “Po mirë, po ç’dhuratë më ka sjellë me ju?”, – pyeti Selmani. Dy burrat, shtangën dhe i thanë:

- “Jo, ai nuk ka dërguar asnjë dhuratë me ne.”

- “Kini frikë Allahun dhe më dorëzoni amanetin që ju ka dhënë me vete; sepse nuk ka njeri që të vijë tek unë prej tij dhe ai të mos më ketë dërguar diçka me të.”, – u tha atyre Selman Farisiu.

- “Të mos e dëgjosh kush, por ne kemi shumë plaçkë me vete, ndaj eja e merr çfarë të duash!”, – thanë ata.

- “Unë nuk kam nevojë për plaçkën e paratë tuaja, unë dua dhuratën që ma ka dërguar im vëllai!”, nguli këmbë Selman Farisiu.

- “I betohemi Allahut, se ai nuk na dha asgjë për të ta sjellë ty. Vetëm, se kur na dërgoi, ai na tha:

- “Në Medain është një njeri, që i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur ishte me të, nuk kërkonte më askënd tjetër. Kur të shkoni tek ai, çojini atij selamet e mia.”, – i thanë ata.

- “Po, ja pra, kjo ishte dhurata që prisja unë prej tij, asgjë tjetër! Pse, ka dhuratë më të mirë e më të bekuar sesa selami?!”, – u përgjigj Selman Farisiu.”¹⁶⁵

51. SHPREHJA E DASHURISË, SHTRËNGIMI I DORËS DHE PËRQAFIMET

**Hadithet e transmetuara nga Xhundubi (r.a.)
dhe Ebu Hurejreja (r.a.) në lidhje me këtë temë**

Xhundubi (radijallahu anhu) thotë: “Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur takohej me sahabët e tij, nuk ua jepte atyre dorën pa u dhënë atyre njëherë selam.”¹⁶⁶

Ebu Hurejreja tregon: “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) që takuar një ditë me Hudhejfen (radijallahu anhu) dhe deshi të shtrëngonte dorën me të. Mirëpo Hudhejfeja iu shmang. Si arsye pse i qe shmangur shtrëngimit të dorës me të Dërguarin e Allahut, Hudhejfeja pati thënë se ai ishte xhunub. Atëherë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Kur një mysliman shtrëngon dorën me një vëlla të fesë së tij, mëkatet e tyre bien e pastrohen njësoj siç bien gjetbet nga pemët.*”¹⁶⁷

Profeti ynë e ndalon përshëndetjen duke u përkulur

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Ne e pyetëm të Dërguarin e Allahut:

- “O Resulullah, a mund ta përshëndetim ne njëri-tjetrin duke iu përkulur?”

- “Jo!”, – u përgjigj Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) prerazi.

- “Po mirë, a mund ta përqafojmë njëri-tjetrin?”, – e pyetëm ne.

- “Jo!”, – ishte përgjigjja e tij.¹⁶⁸

- “Po dorën a mund t’ia japim njëri-tjetrit?”, – i thamë.

¹⁶⁵. Ebu Nu’ajm, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 2/176 (1721).

¹⁶⁶. Taberani, *Muxhemu’l-Kebir*, 2/176 (1721).

¹⁶⁷. Hejthemi, *Mexhmu’u’-Zeuaid*, 8/76 (12768).

¹⁶⁸. Ibn Maxhe, *Sunen*, 2/1220 (3702).

- “Po! Këtë mund ta bëni.” – u përgjigj ai.

Kurse te Tirmidhiu do të gjejmë edhe disa shprehje të tjera: Enesi (radijallahu anhu) thotë se: Një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe e pyeti:

- “O Resulullah! Kur takohemi ndonjëherë me ndonjë prej vëllezërve tanë, apo me ndonjë mik, a mund t’i përshëndetim ne ata duke iu përkulur?”

- “Jo!”, – u përgjigj ai.

- “Po dorën a mund t’ua japim?”, – vazhdoi ta pyesë ai. Profeti ynë iu përgjigj se këtë ‘*Po*’, mund ta bënim. Sipas disa transmetimeve, vërehet edhe kjo: “*Vetëm nëse ai vjen nga një rrugë e gjatë, kjo është tjetër gjë; atëherë mund ta përqafoi, madje edhe ta puthni.*”

Tregon Aishja (radijallahu anha): “Zejd bin Harithe (radijallahu anhu) pati ardhur në Medinë. Në atë kohë Resulullahu ishte në dhomën time. Erdhi Zejdi dhe trokiti në derë. I Dërguari i Allahut e tërhoqi mbulojën e tij zvarrë dhe u ngrit të hapte derën. Me ta parë Zejdin, e përqafoi dhe e puthi... Uallahi, pos asaj dite unë Resulullahun nuk e kam parë kurrë ashtu të zhveshur, as më parë, as më pas.”¹⁶⁹

Qëndrimi i përgjithshëm i sahabëve karshi shtrengimit të dorës dhe përqaimit të njëri-tjetrit

Enesi (radijallahu anhu) thotë kështu: “Sahabët e Profetit tonë të nderuar, kur takoheshin me njëri-tjetrin, shtrengonin duart, ndërsa kur ndonjëri vinte nga ndonjë vend i largët, përqafoheshin.”¹⁷⁰

52. PUTHJA E DORËS, E KËMBËS DHE E BALLIT TË NJË MYSLIMANI

Tregon Sha’biu: “Kur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u kthye nga Hajberi, atë doli për ta pritur Xhafer bin Ebi Talibi. I Dërguari i Allahut e përqafoi atë dhe pasi e puthi në ballë, i tha:

¹⁶⁹. Tirmidhi, *Sunen*, 5/76 (2732).

¹⁷⁰. Taberani, *Mu’xhemu’l-Eusat*, 1/37 (97).

- “*Nuk e di se nga se të gëzohem më parë! Që doli pikërisht Xhaferi për të më pritur, apo ngadhënjimi mbi Hajberin?*”¹⁷¹

Kur sahabët i puthnin duar e këmbë të Dërguarit të Allahut

Seleme bin Ekuja (radijallahu anhu) tregon: “Unë e pata lidhur besën me Profetin tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pikërisht me këtë dorë; i puthëm edhe dorën dhe ai nuk na tha asgjë.”¹⁷²

Umu Ebani tregon: “Gjyshi im, Uazi bin Amiri (radijallahu anhu) ka transmetuar kështu: “Kur shkuam në Medinë, ne na thanë:

- “Ja, ky është i Dërguari i Allahut!” Atëherë ne u ulëm dhe filluam menjëherë t’i puthnim kush duart e kush këmbët.”¹⁷³

Omeri (r.a.) e puthte në kokë Ebu Bekrin (r.a.)

Tregon Ebu Rexha el-Utaridiu (radijallahu anhu): “Pata shkuar në Medinë. Vura re që në një vend ishin grumbulluar shumë njerëz. Në mes tyre ishte një burrë që i puthte kokën një tjetri, duke i thënë:

- “T’u bëfsha kurban, po të mos ishe ti ne do të kishim marrë fund!” Pyeta njëherë se kush ishte ai që puthte dhe kush ishte ai që u puth?”

- “Ai është Omer bin Hatabi, puthi Ebu Bekrin në ballë, pasi ky u shpalli luftë të gjithë atyre që hoqën dorë nga Islami dhe nuk donin të jepnin zekatin!” – më thanë.”¹⁷⁴

53. TË PRITURIT NË KËMBË E NJË MYSLIMANI

Kur i Dërguari i Allahut priste të bijën, Fatimen

Tregon nëna jonë, Aishja (radijallahu anha): “Mes njerëzve unë nuk kam parë askënd që të ngjante aq shumë me të Dërguarin e Allahut në të ulur, në të ngritur, apo në të folur, sesa Fatimja. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur e dallonte se po vinte ajo, i thoshte

¹⁷¹. Ibn Sa’d, *Tabakatul-Kubra*, 4/34.

¹⁷². Taberani, *Muxhemul-Eusat*, 1/205 (657).

¹⁷³. Buhari, *Edeh*, 1/339 (975).

¹⁷⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/737 (35625).

‘*mirë se erdhë*’, çohet dhe e puthte. Mandej, e kapte Fatimen për dore dhe e çonte deri te vendi ku ajo do të ulej. Fatimja (radijallahu anha), gjatë asaj sëmundjeje që u bë edhe shkak për largimin e të Dërguarit të Allahut nga kjo jetë, pati ardhur njëherë për ta parë e për ta vizituar. Resulullahu i tha asaj ‘*mirë se erdhë*’, e puthi dhe sëq i foli fshehtëzi në vesh. Fatimja nisi të qajë. Pastaj, Resulullahu sëq i tha sërish fshehtëzi në vesh, e kësaj here Fatimja buzëqeshi.

Unë u thashë grave të tjera:

- “Edhe Fatimja është një grua, njësoj si ne, por ajo sëq ka ca anë të veçanta, që nuk i ka asnjë grua tjetër, qëndron më lart se të gjitha.” E pyeta Fatimen:

- “Çfarë të tha i Dërguari i Allahut në vesh?” Ajo në fillim nuk desh të flasë, duke më thënë:

- “Po e thashë, unë do të kem zbuluar një të fshehtë.” Pas ndarjes nga jeta e të Dërguarit të Allahut, Fatimja e nderuar tha:

- “Në fshehtësi Resulullahu më pati thënë se ai do të vdiste, ndaj edhe unë qava. Kurse herën e dytë ai më tha mua:

- “*Ti do të jesh e para nga familja ime që do të takohet me mua.*”, – e, kur e dëgjova këtë nga goja e tij, u gëzova pa masë, ndaj edhe nisa të buzëqesh.”, sakaq, duke na e zbuluar atë të fshehtë.”¹⁷⁵

Sahabët ngriheshin në këmbë kur vinte i Dërguari i Allahut, por si e priste i Dërguari i Allahut diçka të këtillë?

Ja se si e përcjell Muhamed bin Hilali nga i ati: “Kur Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ngrihej për t’u larguar, ngriheshim edhe ne dhe qëndronim në këmbë, nuk uleshim, derisa ai të hynte në shtëpi.”¹⁷⁶

Ebu Uameja (radijallahu anhu) tregon se: “I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) erdhi te ne i mbështetur mbi kërrabën e tij; ne u ngritëm vrik në këmbë. Ai na foli:

- “*Mos u çoni në këmbë, për të respektuar njëri-tjetrin, siç bënin persët!*”

¹⁷⁵. Ibn Hibban, *Sahib*, 15/403 (6953).

¹⁷⁶. Hejthemî, *Mexhmu’u’-Zenaid*, 8/81 (12786).

I Dërguari i Allahut rregullonte qëndrimin e tij kur në xhami hynte ndonjë mysliman

Uathile ibnu'l-Hatabi tregon: “Në xhami pati hyrë një burrë. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) rregulloi veshjen dhe qëndrimin e tij. E pyetën të Dërguarin e Allahut:

- “O Resulullah! Aty kishte gjithë atë vend, ju pse ndryshuat qëndrim, duke u mbledhur kështu?” Ai u përgjigj:

- “*Kur hyn një mysliman në xhami, besimtarët e tjerë që janë aty duhet të rregullojnë qëndrimin e tyre në shenjë respekti ndaj atij myslimani.*”¹⁷⁷

Një ngjarje që ka ndodhur mes Aliut (r.a.) dhe dy burrave në lidhje me pranimin e nderimit nga një mysliman

Tregon Ebu Xhaferi: “Tek Aliu (radijallahu anhu) erdhën dy burra. Aliu (radijallahu anhu) u shtroi atyre menjëherë minderet për t'u ulur. Njëri u ul në minder, por tjetri, nuk u ul në minder, u ul përdhe. Aliu (radijallahu anhu) iu drejtua atij që nuk u ul mbi minder me fjalët:

- “*Çobu dhe ulu edhe ti mbi minder; sepse nderimin dhe mirëpritjen vetëm kafshët e udhës ngulin këmbë e nuk e pranojnë!*”¹⁷⁸

54. RUAJTJA E SEKRETIT QË NDAN ME TY NJË MYSLIMAN

Enesi (r.a.) ruan të fshehtë të tregon Profeti ynë

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Një ditë, pasi i shërbeva Resulullahut me diçka dhe kisha mbaruar punë, thashë me vete: “Tani Resulullahu do të shtrihet për pushimin e drekës.”, - ndaj u largova prej tij. Kur pashë, fëmijët ishin duke luajtur. Isha duke ndjekur lojën e tyre me sy, ç'të shoh, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) erdhi pranë fëmijëve dhe u dha selam. Pastaj më thirri mua dhe më dërgoi që t'i kryeja një punë. Puna që më dha është një e fshehtë e imja, e unë shkova, e krewa dhe u ktheva. Isha bërë vonë për të shkuar te nëna ime.

¹⁷⁷. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 9/399 (25767).

¹⁷⁸. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 9/395 (25756).

- “Çfarë të bëri të vonoheshe? Ku ishte deri në këtë orë?”, – më pyeti nëna. Dhe unë iu përgjigja asaj, duke i thënë:

- “Më dërgoi Resulullahu diku.”

- “E ç’punë ishte ajo?”, – vazhdoi nëna të më pyeste.

- “Është një e fshehtë e Resulullahut,” – ia ktheva unë.

- “Atëherë ruaje të fshehtën e Resulullahut!”, më paralajmëroi prerë nëna.

Thabitit, një prej më të mëdhenjve në radhët e tabiinëve, Enesi, kur ia ka transmetuar këtë hadith, i ka thënë:

- “Uallahi, deri më sot atë të fshehtë unë nuk ia kam treguar askujt. Po t’ia kisha thënë ndokujt, o Thabit, nuk ka dyshim që do të ta kisha thënë edhe ty.”¹⁷⁹

55. T’I BËSH JETIMËT TË GËZOJNË

Këshillat e të Dërguarit të Allahut për jetimët

Ebu Hurejreja tregon: “Një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe iu ankua se ishte ngurtësuar shumë në zemër. I Dërguari i Allahut i tha atij:

- “*Përkëdheli kokat e jetimëve dhe jepu atyre të hanë, që të të zbutet zemra.*”¹⁸⁰

Tregon Bishr bin Akrebe (radijallahu anhu): “Pas luftës së Uhudit unë shkova te Profeti ynë dhe e pyeta:

- “Çfarë i ka ndodhur babait tim? Ku është ai?” Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) m’u përgjigj:

- “*Babai yt është një dëshmor, mëshira e Zotit qoftë mbi babanë tënd.*” Fillova të qaja. Më kapi përdore, më ledhatoi kokën dhe më hipi mbi devenë e tij duke më thënë:

- “*Eja, si thua, këtej e tutje të bëhem unë babai yt, kurse Aishja nëna jote, bë, nuk të pëlqen?*”¹⁸¹

¹⁷⁹. Buhari, *Edebu’l-Mufred*, 1/395 (1154).

¹⁸⁰. Hejthemi, *Mexbmeu’z-Zenaid*, 8/293 (13509).

¹⁸¹. Hejthemi, *Mexbmeu’z-Zenaid*, 8/295 (13517).

56. PËRKUJDESJA PËR MIQTË E BABAIT DHE NDERIMI I TYRE

Interesimi i veçantë i Abdullah bin Omerit për një beduin që ishte mik i babait të tij

Abdullah bin Dinari na tregon këtë histori në lidhje me Ibni Omerin: “Ibni Omeri, kur do të shkonte në Mekë, mori me vete edhe një gomar, që kur të mërzhitej nga të ecurit me deve, t’i hipte gomarit, e veç tyre edhe një çallmë, për ta lidhur në kokë. Teksa ishte duke udhëtuar në një nga këto udhëtime, i hipur mbi gomar, në rrugë hasi një beduin. Ibni Omeri e pyeti beduinin:

- “Ti, a nuk je i biri i aksh njeriu?”

- “Po, djali i tij jam.”, u përgjigj ai beduin. Atëherë Ibni Omeri i dha atij njeriu edhe gomarin edhe çallmën dhe i tha:

- “Këtë merre, ta kesh për rrugë, kurse këtë çallmë mbaje në kokë.” Një nga shokët e pyeti Ibni Omerin:

- “Zoti të dhëntë të mirën; çfarë bëre, ia dhe atij njeriu edhe gomarin në të cilin hipje vetë, edhe çallmën që mbaje në kokë?”

- “Unë e kam dëgjuar vetë të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) të thotë: “*Një nga të mirat më të mëdha të njeriut është edhe ajo kur ai kujdeset dhe i respekton miqtë dhe të afërmit e babait edhe pas vdekjes së tij.*”¹⁸²

T’u bësh të mira nënës dhe babait, edhe pas vdekjes së tyre

E tregon Ebu Usejd es-Saidi (radijallahu anhu): “Dikush nga fisi i bijve të Selemes i tha të Dërguarit të Zotit (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem):

- “O Profet i Zotit! A ka ndonjë të mirë që mund t’ua bëj nënës dhe babait tani që ata nuk jetojnë më?” I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

- “Po, ka. *Lutu për ta dhe kërkoji Zotit që t’i falë, përmbushi sjalet dhe amanetet që kanë lënë kur ishin ende në jetë dhe kujdesu për të drejtat e të afërmeve të tyre dhe nderoji miqtë e tyre.*”¹⁸³

¹⁸². Muslim, *Sabih*, 4/1979 (2552).

¹⁸³. Ebu Daud, *Sunen*, 2/758 (5142).

57. PËRGJIGJJA NDAJ FTESËS SË NJË MYSLIMANI

**Ebu Ejub el-Ensari pranon ftesën
e luftëtarëve gjatë një udhëtimi në det**

Zijad bin En'am el-Ifrikij tregon: “Në kohën e kalifatit të Muauijes (radijallahu anhu), ne patëm marrë pjesë në disa luftëra detare. Anija jonë u afrua shumë ndanë anijes në të cilën gjendej edhe Ebu Ejub el-Ensari (radijallahu anhu). Kur u bë dreka gati, ne i dërguam fjalë Ebu Ejubit, që të vinte e të hante me ne. Erdhi dhe na tha:

- “Ju më thirrët dhe unë erdha, sepse nuk mund të mos e pranoja ftesën tuaj, pavarësisht se sot jam duke agjëruar, sepse Resulullahu ka thënë: *“Një mysliman ka gjashtë të drejta mbi çdo vëlla të tij në fe, të cilat duhen përmbushur medoemos. Nëse ai nuk bën qoftë edhe njërin prej tyre, atëherë ai qubet se nuk e ka përmbushur një prej gjashtë të drejtave të vëllazërisë. Ja cilat janë këto të drejta: Kur ta shohë, ta përshëndesë me selam; të pranojë ftesën e tij; kur të teshtijë, t'i thotë “Zoti të mëshiroftë”; kur të sëmuret, t'i shkojë për vizitë; kur të vdesë, t'i shkojë në varrim dhe kur t'i kërkojë ndonjë këshillë, ta këshillojë drejt.”*”¹⁸⁴

58. LARGIMI NGA RRUGA I GJËRAVE QË MUND TË MUNDOJNË UDHËTARËT

Tregon Muauije bin Kurreja: “Po ecja bashkë me Ma'kil el-Muzeniun (radijallahu anhu); mori diçka nga rruga, që mund të bëhej pengesë nga rruga dhe e hodhi tutje. Pas një copë rruge edhe unë pashë diçka që mund të shqetësonte njerëzit që do të kalonin së andejmi dhe u tregova më i shpejtë se ai dhe e hodha në anë.

- “Nipi im, pse e bëre atë gjë?”, – më pyeti.

- “Po, ja, të pashë që e bëre ti më parë, ndaj bëra edhe unë të njëjtën gjë,” – iu përgjigja unë. Ai më dëgjoi dhe më foli:

- “Të lumtë, nipi im! Unë kam dëgjuar Profetin tonë, kur ka thënë: *“Për atë që heq nga rruga ndonjë gjë që mund të shqetësojë myslimanët që do të*

¹⁸⁴. Buhari, *Edebu'l-Mufred*, 1/317 (922).

kalojnë nëpër të shkrubet një e mirë. Dhe njeriu që ka bërë një të mirë, e cila i është pranuar, hyn në parajsë.”¹⁸⁵

59. T’I THUASH ‘JERHAMUKALLAH’ ATIJ QË TESHTIN

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, ne ishim ulur me Profetin tonë të nderuar. Në një çast i Dërguari i Allahut teshtiu dhe besimtarët thanë: “Jerhamukallah”, e Profeti ynë u tha atyre:

- “*Allahu ju ruajtë edhe ju të palëkundur në rrugën e drejtë, duke ju pastruar zemrat.*”¹⁸⁶

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Një burrë teshtiu në praninë e Profetit tonë dhe pyeti:

- “O Resulullah, çfarë të them?” I Dërguari i Allahut e mësoi:

- “*Thuaj ‘Elhamdulillah!’*” Ata që ishin aty e pyetën:

- “Po mirë, o i Dërguari i Allahut, po ne çfarë të themi për atë që teshtin?”

- “*Ju thoni ‘Zoti të mëshiroftë’.*”, – u tha atyre Profeti ynë. Kësaj here, ai që pati teshtirë e pyeti:

- “Po unë, si duhet t’u përgjigjem atyre?”

- “*Ti t’u thuash ‘Jehdijkumullah ue juslibu balekum’* (Allahu ju ruajtë të palëkundur në rrugën e drejtë, e u faltë përkryerje çdo punës suaj)!” – e mësoi atë i Dërguari i Zotit (paqja e Zotit qoftë mbi të).”¹⁸⁷

60. VIZITAT E MYSLIMANËVE TE NJERËZIT E TYRE TË SËMURË

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na pyeti:

- “*Kush nga ju po agjëron sot?*”

- “Unë.” – tha Ebu Bekri (radijallahu anhu).

¹⁸⁵. Buhari, *Edebu’l-Mufred*, 1/208 (593).

¹⁸⁶. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 12/411 (13516).

¹⁸⁷. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/79 (24540).

- “*Po kush nga ju ka shkuar për vizitë te ndonjë i sëmurë sot?*”, – pyeti ai. Prapë ishte Ebu Bekri i nderuar (radijallahu anh) që tha ‘Unë’.

- “*Kush nga ju ka marrë pjesë në ndonjë varrim?*”, vazhdoi të pyesë Profeti ynë i nderuar, dhe po Ebu Bekri (radijallahu anhu) i dha përgjigjen se kishte qenë ai. Atëherë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- “*Nëse një njeri bën kaç shumë punë të mira brenda një dite, nuk ka dyshim se ai hyn në parajsë.*”¹⁸⁸

Ebu Musai shkon për vizitë te Hasani (r.a.) që ishte sëmurë

Tregon Abdullah ibn Nafiu: “Hasani (radijallahu anhu) ishte i sëmurë, ndaj tek ai erdhi për vizitë Ebu Musai. Në atë kohë aty ishte edhe Aliu (radijallahu anhu), i cili tha:

- “Këtë ta dini mirë, myslimanin që shkon për vizitë te dikush që është i sëmurë e shoqërojnë shtatëdhjetëmijë engjëj. Engjëjt përreth tij i luten Zotit që ta falë atë që është i sëmurë. Nëse vizita bëhet në mëngjes, engjëjt vazhdojnë të luten deri në darkë. Për të ka një gostitje me fruta të mbledhura në kopshtet e parajsës. Nëse tek i sëmuri shkohet për vizitë në mbrëmje, atëherë engjëjt luten deri në agim për atë njeri.”¹⁸⁹

Fjalët e Selmanit (r.a.) për një të sëmurë në Kinde

Në atë që përcjell nga babai i tij, Abdurrahman bin Saidi (radijallahu anhu) tregon: “Unë isha bashkë me Selmanin. Ne shkuam bashkë me të për të vizituar një të sëmurë që banonte në lagjen e quajtur Kinde, e cila i përkiste Kufes. Kur shkoi tek ai njeri që ishte i sëmurë, Selmani i tha atij:

- “Lajme të mira për ty. Kur sëmuret një besimtar, Allahu e kthen sëmundjen e tij në një shkak për pastrimin e mëkateve të tij, ajo sëmundje e bën Atë të jetë i kënaqur me të. Por, nëse ai që është i

¹⁸⁸. Muslim, *Sabih*, 2/713 (1028).

¹⁸⁹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/121 (976).

sëmurë është një mohues, atëherë gjendja e tij është si ajo gjendja e devesë që të zotët i kanë lidhur këmbët dhe e kanë braktisur, por ai nuk e di as se pse e kanë lidhur, as se pse e braktisën.”¹⁹⁰

Si ishin vizitat e të Dërguarit të Allahut tek të sëmurët?

Tregon Abdullah bin Abasi (radijallahu anhu): “Kur Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) shkonte te ndonjë i sëmurë, ai i ulej atij te kryet dhe për shtatë herë me radhë thoshte lutjen: “*I lutem Allahut, që është Zoti i Fronit të Madhërishëm, të të falë shërimin.*” Nëse ai njeri i sëmurë kishte ende jetë për të jetuar, ai do të shërohej medoemos.”¹⁹¹

Tregon Aliu (radijallahu anhu): “Kur i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) shkonte pranë ndonjë njeriu që ishte i sëmurë, ai lutej me fjalët: “*O Zot, o Zoti i njerëzve! Hiqja këtij njeriu çdo vuajtje e fali atij shërim. Vetëm Ti mund të shërosh, sepse nuk ka tjetër që të ketë në dorë shërimin.*”¹⁹²

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur shkonte për vizitë te ndokush që ishte i sëmurë, apo kur të sëmurin e binin tek ai, thoshte kështu: “*O Zoti i njerëzve! Mos e lër të vuajë këtë njeri e jepi atij shërim. Ti je Ai që e fal shërimin, pasi veç shërimit që jep Ti nuk ka shërim tjetër. Asisoj që shërimi yt nuk lë asnjë sëmundje tjetër në trup.*”¹⁹³

Kurse në transmetimin që i bën Ibni Sa’di këtij hadithi do të vërejmë edhe këto fjalë:

Tregon Aishja (radijallahu anha): “Në kohën që sëmundja që u bë shkak për ndarjen nga jeta të të Dërguarit Fisnik u rëndua, e kapa për dore dhe me dorën e tij nisa të ledhatoja trupin tim. Për një çast e tërhoqi dorën dhe nisi të lutej: “*O Zot, falmë mua, e çomë mua te më i Lartësuar i Dashur për mua.*” Fjalët e kësaj luteje ishin të fundmet fjalë që dëgjova nga goja e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).”¹⁹⁴

¹⁹⁰. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/206.

¹⁹¹. Ibn Hibbani, *Sahib*, 7/243 (2978).

¹⁹². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 9/372 (25694).

¹⁹³. Hejthemi, *Mexhmu’u’-Zeuaid*, 3/24 (3780).

¹⁹⁴. Ibn Sa’d, *Tabakat*, 2/14.

61. TË KËRKUARIT E LEJES DHE EDUKATA E TË TROKITURIT NË DERË

**Historia e një burri që deshi të hynte
tek i Dërguari i Allahut pa e përshëndetur më parë**

Rib'i bin Hirashi tregon: “Dikush nga fisi i të bijve të Amirit më pati treguar njëherë këtë ngjarje: “Shkova në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut dhe pyeta:

- “A mund të hyj?” I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha shërbyeses që kishte në shtëpi:

- “*Dil te dera dhe thuaji atij njeriu të dalë jashtë dhe para se të kërkojë leje për të hyrë duhet të përshëndesë me selam njerëzit që janë aty, sepse ky njeri duket që nuk e ka edukatën e të kërkuarit leje për të hyrë diku.*” Unë i dëgjova të gjitha fjalët që i tha shërbyeses dhe, ende pa dalë mirë ajo grua, unë thashë:

- “Es'selamu alejkum, a mund të hyj?” Dhe i Dërguari i Allahut m'u përgjigj:

- “*Ue alejkum selam, hyr.*”¹⁹⁵

**I Dërguari i Allahut ia ndalon një prej sahabëve të tij
që të trokas in në derë me kokën të kthyer nga dera**

Tregon Sa'd bin Ubadeja: “Një ditë, isha kthyer me fytyrë nga dera dhe kërkoja leje për të hyrë pranë të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ai më pa dhe më tha:

- “*Kurrë më mos trokit e mos kërko leje kështu, duke e mbajtur fytyrën të kthyer nga dera!*” Ndërsa, në një tjetër transmetim thuhet se diçka të këtillë e ka thënë që ai që troket të mos shohë gjëra që nuk duhet t'i shohë brenda shtëpisë së dikujt tjetër.”¹⁹⁶

Një ndodhi mes Ebu Musa el-Esh'ariut dhe Omerit (r.a.)

Tregon Ebu Said el-Hudriu (radijallahu anhu): “Njëherë, unë isha ulur në një kuvend me burra të ensarëve dhe aty ia behu edhe Ebu

¹⁹⁵. Buhari, *Edebu'l-Mufred*, 1/372 (1084).

¹⁹⁶. Hejthemî, *Meaxhmen'Zenaid*, 8/87 (12808).

Musa el-Esh'ariu (radijallahu anhu); dukej i trembur. Papritur nisi të flasë, duke thënë:

- "I kërkova Omerit tri herë leje për të hyrë tek ai, por askush nuk m'u përgjigj, që të më lejonte të hyja, ndaj u ktheva pas. Pastaj Omeri më thirri dhe më tha:

- "Pse u largove?"

- "Unë kërkova tri herë leje dhe kur pashë që askush nuk m'u përgjigj, u ktheva të ikja, sepse Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë, që *'Kur ndonjëri prej jush të kërkojë leje për të hyrë diku, ta kërkojë atë tri herë; nëse i jepet leje të hyjë, nëse nuk i jepet të largohet.'*"

- "Për Zotin, ti tani duhet të më sjellësh mua një provë që e ke dëgjuar me të vërtetë këtë hadith. Në mesin tuaj, a ka ndonjë njeri që e ka dëgjuar këtë nga vetë Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të)?", – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Për një çështje të tillë nuk ka nevojë domosdoshmërisht për dëshminë e të mëdhenjve, edhe dëshmia e atyre që janë më të vegjël është e mjaftueshme.", – u hodh e foli Ubej bin Ka'bi."

Ebu Said el-Hudri thotë se: "Më i vogli në dhomë isha unë. Shkova bashkë me Ebu Musain drejt e tek Omeri (radijallahu anhu). I thashë se hadithi për të cilin bëhej fjalë ishte i vërtetë, ashtu kishte thënë Profeti ynë. Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) tha:

- "Domethënë ky urdhër i Resulullahut, që nëse nuk të jepet leje për tri herë me radhë, të mos hysh e të kthehesh mbrapa qenka kështu dhe pjesën e fundit unë nuk e paskam ditur. Dhe ashtu është, duke qenë se unë shkoja përherë nëpër tregje të ndryshme për të bërë tregti, kjo më ka penguar jashtëzakonisht shumë që të kaloja kohë me të Dërguarin e Allahut, e ta dëgjoja më me kujdes çdo fjalë që dilte nga goja e tij."¹⁹⁷

62. TA DUASH MYSLIMANIN PËR HIR TË ALLAHUT

Tregon Ebu Dherri (radijallahu anhu): "I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi tek ne dhe na pyeti:

¹⁹⁷. Buhari, *Sahih*, 5/2305 (5891).

- “*A e dini ju se kush është puna më e dashur për Allahun e Madhërishëm?*”

Dikush u çua dhe tha:

- “Namazi dhe zekati, o Resulullah.” Një tjetër u përgjigj:

- “Lufta në rrugën e Allahut.” Ndërsa, në fund, i Dërguari i Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të) tha se:

- “*Cilësia që do më së shumti Allahu është të duash për hir të Allahut dhe të përçmosh për hir të Allahut.*”¹⁹⁸

Dashuria e të Dërguarit të Allahut për Aishen dhe Ebu Bekrin e nderuar

Amr bin Asi (radijallahu anhu) tregon: “Profetin tonë e patën pyetur:

- “O Resulullah, kush është njeriu më i dashur për ju?” Dhe Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u përgjigj duke thënë:

- “*Aishja.*”

- “Po nga meshkujt?”, – e pyetën. Ai tha:

- “*Është Ebu Bekri.*” I thanë:

- “Po pas tij, kush vjen?” Ai u përgjigj:

- “*Ebu Ubejde bin Xherrahu.*”¹⁹⁹

Kush e do dikë t’ia bëjë atij të ditur që e do

Tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): “Unë isha ulur pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Aty ia behu një burrë, i cili na dha selam; pastaj u largua, iku. Unë thashë:

- “Unë e dua këtë njeri o Resulullah.” I Dërguari i Allahut më pyeti:

- “*A i the ti atij që e doje?*”

- “Jo, nuk ia thashë!”, – thashë unë.

- “*Atëherë bëja atij të ditur që e do.*”, – më tha i Dërguari i Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të.) Dhe unë dola menjëherë, që ta kërkoja

¹⁹⁸. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 1/268 (307).

¹⁹⁹. El-Hakim, *Mustedrek*, 4/13 (6740).

atë njeri, derisa e arrita. I dhashë selam dhe ia vura dorën mbi sup dhe i thashë:

- “Uallahi, unë të dua ty për hir të Allahut.”

- “Edhe unë të dua ty për hir të Allahut.”, – m’u përgjigj ai mua dhe unë ia ktheva:

- “Uallahi, më urdhëroi i Dërguari i Allahut që të vija e të ta thosha hapur këtë gjë, përndryshe nuk do të kisha ardhur deri këtu, për të të prerë rrugën.”²⁰⁰

Muxhahidi thotë se: “Ibni Omeri më ka thënë mua:

- “Njerëzit t’i duash për hir të Allahut dhe t’i urresh po për hir të Allahut. Bëhu mik për hir të Allahut dhe po për hir të Allahut të bëhesh armik me dikë. Kjo është rruga e vetme, nëse do që të bëhesh një nga miqtë e Allahut. Një njeri atëherë e kupton shijen e vërtetë të besimit, sa më shumë që të falë namaz dhe sa më shumë që të agjërojë. Vëllazëria e tij me njerëzit nuk mund t’i kapërcejë kufijtë e jetës së kësaj bote.”²⁰¹

63. MËRZITJA DHE HIDHËRIMI I MYSLIMANËVE ME NJËRI-TJETRIN

Hidhërimi i Aishes (r.a.) me Ibnu’z-Zubejrin

Tregon Urue bin Zubejri: “Pas Profetit tonë të nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe babait të saj, Ebu Bekrit (radijallahu anhu), njeriu që donte më së shumti Aishja (radijallahu anha) ishte nipi i saj, Abdullah bin Zubejri. Edhe Abdullahu tregonte një respekt të jashtëzakonshëm për Aishen (radijallahu anha). Aishja (radijallahu anha) ishte shumë bujare. Çfarë t’i falte Allahu i Madhërishëm ajo e jepte si lëmoshë për të tjerët, nuk mbante asgjë për veten e saj. Andaj, një ditë, nipi i saj, Abdullahu tha për të:

- “Asaj duhet t’ia lidhësh duart.” - E, Aishja (radijallahu anha), kur i dëgjoi ato fjalë, se ç’kishte thënë i nipi, tha e habitur:

- “Cilat, duart e mia u dashkan lidhur? Po i fola më këtej e tutje atij njeriu, premtimi im!”, – dhe dha fjalën që nuk do t’i fliste, e ashtu bëri

²⁰⁰. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zeuaid*, 10/501 (18035).

²⁰¹. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zeuaid*, 10/486 (17986).

vërtet, filloi të mos i fliste më me gojë.

Edhe pse Ibnu’z-Zubejri dërgoi te tezja e tij, Aishja (radijallahu anhu), shumë nga paria e kurejshëve, veçanërisht nga fisi i të bijve të Zuhres, që ishin edhe dajat e Resulullahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që t’i luteshin e ajo ta falte, ajo nuk pranoi të pajtoheshin. Derisa, në fund, Abdurrahman bin Esuedi dhe Misuer bin Mahremeja nga fisi i bijve të Zuhres, nga dajët e Resulullahut, i thanë Abdullahut:

- “Kur ne të kërkojmë leje për të hyrë brenda, ti kalo menjëherë pas perdes dhe hidhju tezes në qafë dhe përqafoje.” Dhe ai kështu bëri. Më vonë ai i nisi tezes së tij edhe dhjetë sklevër. Aishja (radijallahu anha) i liroi ata të dhjetë. Numri i sklevërve të liruuar, që ajo të prishte premtimin e saj, shkoi në dyzet. Në lidhje me këtë, Aishja (radijallahu anha) tha:

- “Kur u betova, do të dëshiroja sikur të isha betuar të bëja ndonjë punë të caktuar dhe ta bëja atë punë e të shpëtoja nga barra e shlyerjes së atij betimi!”²⁰²

64. ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE MES NJERËZVE DHE PAJTIMI I TYRE

I Dërguari Fisnik pajton popullin e Kubasë

Tregon Sehl bin Sa’di (radijallahu anhu): “Një ditë, populli i Kubasë kishin pasur një sherr mes veti dhe patën qëlluar kundër njëri-tjetrit me gurë. Kur Resulullahu mori vesh se çfarë kishte ndodhur, u tha sahabëve të tij:

- “*Ejani të shkojmë atje dhe t’i pajtojmë ata njerëz.*”²⁰³

I Dërguari i Allahut pajton fiset e Eusit dhe Hazrexhit

E tregon Enes bin Maliku (radijallahu anhu): “Në kohën e injorancës, mes dy fiseve të ensarëve, Eusëve dhe Hazrexhëve, kishte një armiqësi që nuk njihte të reshtur. Kur erdhi në Medinë Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), ajo armiqësi mori fund; Allahu ua

²⁰². Buhari, *Sabih*, 5/2255 (5725).

²⁰³. Buhari, *Sabih*, 2/958 (2547).

ngrohu atyre zemrën karshi njëri-tjetrit. Një ditë, teksa myslimanët ensarë ishin ulur e po kuvendonin me shoku shokun, dikush nga fisi i Eusëve filloi të këndonte një poezi që shante fisin e Hazrexhit. Atëherë u çua edhe dikush nga fisi i Hazrexhit dhe këndoi një poezi që fliste keq për fisin e Eusit. Filluan të hidhnin e të pritnin poezi kundër njëri-tjetrit, derisa u arrit pika e vlimit dhe ata nisën të kacafyten. Morën armët dhe u shkaktua një zënkë shumë e madhe. Këtë e mori vesh edhe i Dërguari Fisnik. Në atë kohë, të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) iu zbrit nga qiejt shpallja hyjnore. Resulullahu vrapoi për te njerëzit dhe teksa vraponte iu zbuluan këmbët e tij. Me t'i parë, ai u këndoi atyre këtë ajetet kur'anore: **“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun, ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë! Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.”** (Al Imran, 3/102-103)

Një të dëgjuar qortimin e Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), palët lëshuan armët dhe u përqafulan me njëri-tjetrin duke qarë.”²⁰⁴

65. SHMANGIA NGA TË MENDUARIT KEQ PËR TË TJERËT

Një rrëfim

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Në kohën e Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), një burrë po kalonte pranë një grupi njerëzish dhe u dha selam atyre. Ata që ishin atje ia kthyen selamin dhe kur ai burrë u largua, njëri syresh tha:

- “Unë e urrej atë njeri!” Shokët ia pritën duke i thënë:

- “Hesht! Uallahi do t'i themi që ti mendon kështu për të!” Madje, njëri prej tyre i tha:

- “Po ti shko e thuaja vetë në sy atij njeriu, që nuk e do.” Ai njeri, për të cilin kishin folur, me të mësuar se ç'kishin thënë për të, shkoi

²⁰⁴. Taberani, *Mu'xhemu'l-Sagir*, 1/359 (602); Hejthemi, *Mexhmen'z-Zeuaid*, 8/153 (13054).

drejt e te Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe i tregoi, që ata njerëz kishin menduar keq për të, duke i shtuar:

- “O Resulullah! Po deshe, dërgoi atij njeriu fjalë, ta pyesësh njëherë, pse më urren ai mua?” Kur erdhi ai që urrente, Resulullahu e pyeti:

- “Pse nuk e do ti këtë njeri?” Ai burrë u përgjigj:

- “O Resulullah! Unë jam fqinji i tij, e di çdo gjë për të; unë nuk e kam parë kurrë që të falë ndonjë namaz përveç pesë kohëve të namazit që falin të gjithë!” Personi që kishte ardhur të ankohej e pyeti të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “Pyeteni njëherë, o Resulullah: vallë kam ndonjë të metë në abdesin tim kur e fal namazin? A e kam lënë ndonjëherë namazin për më vonë?” Ai burrë tha:

- “Jo, o Resulullah.” Mandej, ai tha përsëri:

- “O Resulullah, unë jam fqinji i tij; e njoh atë shumë mirë. Përveç zekatit që japin të gjithë, të mirë a të këqij, unë nuk e kam parë atë kurrë që të ngopë barkun e një njeriu në nevojë!” Aty ndërhyri menjëherë tjetri:

- “O i Dërguari i Allahut, pyeteni atë: “A e ka parë ndonjëri që unë të kem përzënë ndokënd që ka qenë në nevojë për zekatin tim?”, – dhe Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) e pyeti.

- “Jo!”, – u përgjigj ai. Fjalën e mori sërish personi për të cilin kishte folur keq:

- “O i Dërguari i Allahut! Unë jam fqinji i tij dhe e njoh mjaft mirë; ai nuk agjëron asnjë ditë më shumë se ditëve të detyruara të muajit Ramazan, unë nuk e kam parë kurrë!” Atëherë tjetri ia pati:

- “O Resulullah, pyete njëherë këtë njeri, përveç rasteve kur kam qenë në udhëtim, a më ka parë ndonjëherë duke ngrënë gjatë muajit të Ramazanit?” Dhe Profeti ynë e pyeti.

- “Jo, nuk e kam parë.”, – u përgjigj tjetri. Pasi i dëgjoi mirë, i Dërguari Fisnik u kthye nga ai që kishte folur keq për tjetrin dhe i tha:

- “Nuk e di, por më duket se njeriu, për të cilin ti ke folur keq, është më i mirë se ti.”²⁰⁵

²⁰⁵. Hejthemî, *Mexhmu’at-Zenaid*, 2/18 (1601).

66. LAVDËRIMET E PRANUARA DHE JO TË PRANUARA PËR MYSLIMANËT

Tregon Ebu Bekreh (radijallahu anhu): “Një njeri kishte lavdëruar dikë tjetër në sytë e të Dërguarit të Allahut. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i pati thënë atij njeriu:

- “Ki kujdes, ti i këpute qafën shokut tënd!”, – duke vazhduar të thotë, – “Cilitdo që i duhet të lavdërojë, me doemos, njërin prej vëllezërve të tij në fe, le të thotë për të: ‘Mua më duket se filan person është...’, sepse vetëm Allahu e njeh se çfarë fsheh brenda vetes çdo njeri. Askush nuk mund të shfaqësohet, apo të nxirret i larë para Allahut nga të metat e tij. Edhe nëse ju besoni vërtet se personi i lavdëruar është vërtet i atillë, siç ju e pandehni, thoni: ‘Më duket se filan person është kështu apo ashtu...’”²⁰⁶

Tregon Nafiu: “Dikush iu drejtua Ibni Omerit (radijallahu anhu) me fjalët:

- “O i biri i atij njeriu, që ishte njeriu më i virtytshëm!” Ibni Omeri e dëgjoi dhe i tha:

- “Unë nuk jam as njeriu më i mirë, as i biri i njeriut më të mbarë. Unë nuk jam veçse një rob i dobët i Allahut të Madhërishëm. Unë jam në kërkim të pëlqimit dhe kënaqësisë së Tij, pasi më shqetëson pa masë ndëshkimi i ashpër i Tij. Për Zotin, kështu si bëni ju, edhe pak edhe e largoni njeriun nga feja. Nëse ju çoheni dhe i thoni dikujt: ‘Ti je kaq i mirë, aq i mirë...’, - ta dini, se nuk jeni duke i bërë atij asnjë të mirë, por jeni duke e shkatërruar atë.”²⁰⁷

Nëse dikush e mburrte, Mikdadi (r.a.) merrte një grusht dhë dhe e qëllonte

Tregon Heman bin Harithi: “Një burrë e mburri Osmanin (radijallahu anhu) në sytë e tij, kur Mikdadi (radijallahu anhu) ra në gjunjë dhe filloi t’i hidhte dhe në fytyrë atij personi. Osmani (radijallahu anhu) reagoi menjëherë:

²⁰⁶. Buhari, *Sahih*, 2/946 (2519).

²⁰⁷. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/307.

- “Çfarë bën kështu?”, – i tha. Mikdadi (radijallahu anhu) iu përgjigj:
- “Profeti ynë i Nderuar dhe Fisnik ka thënë: *‘Kur të shihni ndokënd që mburr e lavdëron, merrni një grusht dhë dhe bidhjani në fytyrë.’*”²⁰⁸

67. PRERJA E MARRËDHËNIEVE ME NJERËZ TË FAMILJES DHE TË AFËRM

**Çfarë i thotë Profeti ynë dikuft që i ankohet
se të afërmit e tij nuk sillen aspak mirë me të**

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) se: “Një burrë erdhi te Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i tha:

- “O Resulullah, unë kam ca të afërm; u shkoj atyre për vizitë, por ata nuk vijnë asnjëherë tek unë! Unë u bëj mirë, kurse ata përpiqen si e si të më bëjnë keq! Unë sillem ndaj tyre me butësi, kurse ata sillen duke shfaqur një mungesë të theksuar respekti ndaj meje.” I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Nëse ti je vërtet ashtu siç më thua, ti ke bërë atë që të takon të bësh. Madje, për sa kohë që ti vazhdon të sillesh kështu, ndihmesa e Allahut do të jetë gjithmonë me ty kundër çdo të keqeje që mund të të vijë prej tyre.*”²⁰⁹

Paralajmërimi i Ebu Hurejres për ata që nuk i ruajnë lidhjet e tyre me njerëzit e familjes

Këtë e përcjell Ebu Ejub Sulejmani: “Ishte nata e së premtes, kur, në mëngjes, te ne erdhi Ebu Hurejreja dhe na tha:

- “Ja ku po i paralajmëroj të gjithë ata që nuk u shkojnë të afërmeve të tyre për vizitë. Nëse ka ndonjë në mesin tonë, që nuk u shkon të afërmeve për vizitë, të largohet, të mos qëndrojë më në mesin tonë.”

Ebu Hurejreja i përsëriti fjalët e tij plot tri herë, kur pa që nuk u ngrit asnjëri në këmbë, për t’u larguar. Një djalosh tregoi se kishte pothuajse dy vjet që nuk kishte shkuar për vizitë te halla e tij, ndaj shkoi menjëherë për te halla e tij. Kur mbërriti atje ku banonte halla, ajo e priti me fjalët:

²⁰⁸. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, 5/297 (26260).

²⁰⁹. Muslim, *Sahih*, 4/1982 (2558).

- “Çfarë të solli deri këtu, o nipi im?” Djaloshi i ri iu përgjigj:

- “Me të dëgjuar Ebu Hurejren, i cili na tha kështu-kështu, erdha drejt e këtu.” Halla i tha:

- “Shko tek ai njeri dhe pyete, se pse jua ka thënë ato fjalë.” Djaloshi erdhi tek Ebu Hurejreja dhe i tregoi se si qëndronte puna, Ebu Hurejreja i dha atij këtë përgjigje:

- “Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, i cili ka thënë:

- “Të gjitha punët e bijve të Ademit i tregohen Allahut të Madhërishëm çdo natë të së premtes. Nëse ndonjëri prej jush nuk i ruan marrëdhëniet me familjarët e vet, Allahu nuk pranon asnjë nga punët e mira të atij njeriu.”²¹⁰

Gjatë lutjes, Ibni Mesudi kërkon të dalin jashtë të gjithë ata që presin lidhjen me familjen

Tregon A'meshi: “Pas namazit të sabahut, Ibni Mesudi e kishte kthyer në zakon që dilte dhe u fliste njerëzve për ndonjë çështje të caktuar, kur, një ditë, u tha atyre:

- “Për hir të Allahut, nëse ka ndonjë nga ju, që nuk i ruan lidhjet me familjarët e të afërmit e tij, të largohet, të dalë jashtë. Ne sa jemi këtu duam t'i lutemi Zotit, sepse, ju e dini, portat e qiejve janë të mbyllura për ata që i shkëpusin lidhjet me familjarët dhe të afërmit e tyre, e lutjet e tyre nuk janë të pranuarat!”²¹¹

²¹⁰. Buhari, *Edebu'l-Mufred*, 1/35 (61).

²¹¹. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir*, 9/158 (8793).

MORALI DHE PAMJA E JASHTME E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ



Cili ishte morali i Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe e sahabëve të tij, çfarë jetese kishin ata? Si silleshin sahabët në marrëdhëniet e tyre shoqërore? Si ishin dhe në ç'shikallë arrinin dashuria, respekti, dhembshuria dhe mëshira, thjeshtësia dhe modestia, mirësjellja, të mosmënduarit për veten para të tjerëve dhe bujaria, lidhja e fortë me të drejtën dhe të vërtetën, durimi, dorëzimi i plotë i vetes tek Allahu, shakatë, humori, të qarët dhe të qeshurit, të ngrënët, të pirët, veshja, kujdesi për veten, serioziteti, nervozizmi dhe xhelozia, marrëdhëniet e tyre me gratë, burrat dhe fëmijët; si arrinin ata të kalonin aq mirë me të gjithë?

1. MORALI I TË DËRGUARIT FISNIK

**Çfarë thoshte Aishja (r.a.) në lidhje
me moralin e të Dërguarit të Allahut**

Sa'd bin Hishami (radijallahu anhu) tregon: “E pyeta nënën e mbarë

besimtarëve, Aishen (radijallahu anha):

- “A do të më flasësh për moralin e Profetit tonë të nderuar?” Ajo m’u përgjigj duke më pyetur:

- “Po ti, nuk e lexon Kur’anin?”

- “Patjetër që e lexoj!”, – thashë unë.

- “Epo, morali i tij ishte vetë Kur’ani.”, – tha ajo.”¹

Çfarë ka thënë Zejd bin Thabiti lidhur me këtë temë

Tregon Harixhe bin Zejdi: “Te babai im, Zejd bin Thabiti (radijallahu anhu), erdhi një grup prej pesë a dhjetë vetash dhe i thanë:

- “Kemi ardhur që të na flasësh rreth moralit të Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).” Babai im filloi t’u fliste:

- “Unë isha fqinj me të Dërguarin e Allahut. Kur i zbriteshin ajete kur’anore, ai më dërgonte fjalë të shkoja tek ai. Shkoja dhe e shkruaja menjëherë ajetin që i ishte zbritur. Kur ne flisnim për këtë botë, edhe ai na fliste për këtë botë; kur zinim e flisnim për jetën e përtejme, edhe ai fillonte e na fliste neve për jetën e përtejme. Nëse flisnim për ushqimit, edhe ai për ushqimet na fliste. Ja pra, këto sa ju thashë flasin për moralin e tij.”²

Vëzhgimet dhe bindja e Enesit (r.a.) lidhur me këtë çështje

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte njeriu më i edukuar dhe më i mirësjellshëm. Një mëngjes të ftohtë tek ai vijnë një shërbyese dhe një fëmijë, që t’i sjellin ujin për të marrë abdes dhe ai nuk i kthente kurrë pas, i pranonte, pasi nuk donte të mërziste askënd. Kur dikush e pyeste për ndonjë gjë, ai e dëgjonte me tërë qenien e tij. Dhe pa u larguar ai që kishte ardhur për ta pyetur, ai nuk ikte kurrë i pari. Nëse dikush do ta mbante të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) përdore, Resulullahu nuk e lëshonte kurrë dorën e tjetrit i pari, pa e lëshuar ai

¹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/91 (24645).

². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/42.

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij vetë më parë.”³

Enesi (radijallahu anhu), tregon: “Unë i kam shërbyer të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) për dhjetë vite me radhë. Ai mua nuk më pati qortuar kurrë as kur jam vonuar për ta përfunduar ndonjë gjë, as kur nuk e kisha zbatuar siç duhej ndonjëherë prej porosive të tij. Edhe kur më ka qortuar ndonjë nga familja e tij, ai u thoshte atyre:

- “*Lëreni të qetë. Ajo punë do të ishte bërë, nëse për të do të ishte caktuar që të bëhej.*”⁴

E tregon po Enesi (radijallahu anh): “Pasi Profeti ynë u falte besimtarëve namazin e sabahut, aty vinin të gjitha sa shërbenin nëpër shtëpitë e Medinës, sillnin enët të mbushura me ujë dhe i vinin përpara të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ai fuste dorën në enët e sjella, madje këtë e bënte edhe kur mëngjesi dhe uji ishte shumë i ftohtë, nuk bezdisej, sepse nuk donte që njerëzit të mërzhiteshin.”⁵

Bindja e Ebu Hurejres (r.a.) për këtë gjë

Ebu Hurejreja tregon vetë: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ues’el’lem), kur shtrëngonte dorën me ndokënd, Ai nuk e tërhiqte dorën e vet pa e tërhequr tjetri më parë. Kur ulej me të tjerë, ai kujdesej që të ulej në të njëjtën vijë me të tjerët as më para, as më mbrapa. Kur takohej me ndokënd, kthehej me gjithë trupin dhe nuk kthehej, për t’u larguar, pa e mbaruar fjalën personi me të cilin po bisedonte.”⁶

Profeti ynë, sa herë që i propozoheshin dy punë, zgjidhte gjithmonë atë që ishte më e lehtë

Aishja (radijallahu anha) ka thënë: “Profeti ynë, sa herë që i kërkohej të zgjidhte mes dy punësh të ndryshme, për sa kohë që nuk ishin të ndaluara, do të zgjidhte medoemos atë që ishte më e lehtë. Nëse ishte ndonjë punë e gabuar, personi që i qëndronte asaj më larg se çdokush tjetër ishte Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të). Resulullahu nuk

³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 3/62.

⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/37; Ibn Sa’d, *Tabakat*, 7/11.

⁵. Muslim, *Sabih*, 4/1812 (2324).

⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/858 (35969).

është hakmarrë kurrë për veten. Vetëm kur nëpërkëmbeshin ligjet e Zotit, ja, atëherë ai ngrihej dhe hakmerrej për Zotin.”

Aishja (radijallahu anha), në një transmetim tjetër, shprehet: “Përveç rasteve të luftës, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk ka qëlluar kurrë askënd me dorë. Nëse do ta lije të lirë, për të zgjedhur mes dy punësh, ai zgjidhte atë që ishte më e lehtë, për sa kohë që asnjëra prej tyre nuk ishte e ndaluar prej Islamit. Nëse ishte e ndaluar, atëherë ai ishte njeriu që i qëndronte mëkatit më larg se kushdo tjetër.”⁷

Një transmetim tjetër në lidhje me moralin e lartë të Profetit tonë

E transmeton Ebu Abdullah el-Xhedeliu: “E pyeta Aishen (radijallahu anha) për moralin e të Dërguarit të Zotit. Ajo më dha këtë përgjigje:

- “Resulullahu nuk thoshte kurrë asnjë fjalë të keqe. Nuk dilte të fliste me zë të lartë dhe nuk u bërtiste njerëzve në rrugë. Nuk i përgjigjej asnjëherë të keqes me të keqe, e falte të keqen dhe i afrohej me tolerancë keqbërësit.”⁸

2. MORALI I SAHABËVE FISNIKË

Morali i bukur i Omerit (r.a.)

Tregon Ibni Omeri: “Kur Omeri i nderuar (radijallahu anh) nevríkosej, nëse pranë tij ndodhej dikush që do të përmendte Allahun, apo do ta trembte duke i përmendur ndëshkimin e ashpër të Allahut, apo nëse do të këndohej ndonjë ajet i Kur’anit, ai do të hiqte medoemos dorë nga ajo që kishte vënë në mendje të bënte.”⁹

Morali i bukur i Musab bin Umejrit

Këtë e tregon Amir bin Rabia: “Musab bin Umejri, që nga dita që pranoi Islamin dhe u bë mysliman, e deri në ditën që u vra dhe ra dëshmor në Uhud, ishte një nga shokët e miqtë e mi më të mirë.

⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/36.

⁸. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/36.

⁹. Buhari, *Sahih*, 4/1702 (4366).

Ai ka qenë me ne në të dyja mërgimet, si për në Abisini, ashtu edhe në Medinë. Në të dyja këto mërgime ne ishim shokë rruge me njëri-tjetrin. Në jetën time unë nuk kam parë ndonjëherë njeri me një sjellje aq të mirë dhe që të ketë shkuar aq mirë, pa pasur as problemin më të vogël, me të gjithë.”¹⁰

Morali i bukur i Abdullah bin Mesudit

E tregon Habe bin Xhujni: “Një ditë ishim tek Aliu (radijallahu anhu) dhe i përcollëm atij disa fjalë që i kishte thënë Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu). Ata që ishin aty gjatë asaj bisede nisën të lavdëronin Abdullah bin Mesudin, duke i thënë Aliut të nderuar:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Ne nuk kemi parë ndonjëherë ndonjë njeri që të ketë pasur sjellje më të mirë sesa ajo e Ibni Mesudit, që ishte aq i butë kur u mësonte të tjerëve ndonjë gjë, që sillej aq mirë me shokët e vet dhe që, për më tepër, ishte aq shumë i devotshëm karshi Allahut të Madhërishëm.” Aliu (radijallahu anhu) i dëgjoi njëherë deri në fund, pastaj u tha:

- “Pa më thoni, për hir të Allahut, a jeni të sinqertë në këto që po më thoni?”

- “Po!”, – u përgjigjën ata.

- “O Zot, Ty të kam lënë dëshmitar për të gjitha këto”, – tha Aliu (radijallahu anhu), – “sepse unë them të njëjtat gjëra, madje edhe më shumë se kaq, për Ibni Mesudin.”¹¹

3. BUTËSIA DHE TOLERANCA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ

I Dërguari i Allahut ishte shumë mirëkuptues dhe falës karshi njerëzve

Tregon Abdullahu: “Me të përfunduar lufta e Hunejnit, i Dërguari i Allahut (alejhis’selam) u shpërndau disa vetëve plaçkë lufte më shumë

¹⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/82.

¹¹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/110.

sesa u takonte. Për shembull, Akra' bin Habisit i pati dhënë njëqind deve. Po të njëjtën sasi i pati dhënë edhe Ujejes. Edhe të tjerëve u dha nga aq sa ç'e pa edhe më të arsyeshme. Kur, papritur, u shfaq një burrë dhe tha:

- “Kjo ndarje nuk është ndarja me të cilën do të ishte i kënaqur Allahu.”

- “Unë do të shkoj menjëherë t’ia përcjell të Dërguarit të Allahut këtë që ti sapo the!”, – i thashë unë atij dhe atë bëra, shkova drejt e te Resulullahu dhe ia tregova të tëra një për një. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Zoti e mëshiroftë Musain. Ai pati pasur më shumë vuajtje e pati hequr edhe më keq se kaq; por, prapëseprapë pati bërë durim.*”¹²

Qëndrimi i të Dërguarit të Allahut ndaj Dhulhuejsires

Tregon Ebu Saidi (radijallahu anhu): “Kur i Dërguari i Allahut po u ndante besimtarëve plaçkën e luftës, ne po qëndronim pranë tij. Në ato çast aty erdhi një person i quajtur Dhulhuejsire, i cili i përkiste fisit të bijve të Temimit, dhe tha:

- “Ji i drejtë, o i Dërguari i Zotit!”

- “Mjerë për ty, çfarë thua? Po kush do të jetë i drejtë po nuk qeshë unë?! Unë jam i marrë fund, nëse nuk tregohem i drejtë?”, – i tha atij i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).

Omeri (radijallahu anhu) iu hakërrye menjëherë atij burri, duke thënë:

- “Më jep leje, o i Dërguari i Allahut, t’ia këpus qafën!” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Lëre atë, sepse si ai ka shumë, të cilëve, nëse do t’ua shibnit namazin që falin dhe agjërimin që mbajnë, namazi dhe agjërimi juaj do t’ju duket shumë pak. Madje ata lexojnë edhe Kur’an, por Kur’ani nuk u kalon poshtë gurmazit. Me një fjalë, ata nuk i vënë në jetë ajetet që lexojnë në Kur’an. Tipat si këta, do të vijë dita dhe njësoj si shigjeta që godet në dërrasën e qitjes, do ta braktisin Islamin, duke u kthyer nga feja e Zotit...*”¹³

¹². Buhari, *Sabih*, 3/1148 (2981).

¹³. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/362.

Si u tregua i Dërguari i Allahut aq i butë ditën që vdiq Ibni Ubeji

Tregon Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu): “Në kohën që vdiq Abdullah bin Ubej bin Seluli, i biri i tij erdhi tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i tha:

- “Ma jep mua këmishën tënde, o i Dërguari i Allahut, që ta varros atë të mbuluar me këmishën tënde. Si edhe, a do të dilnit ju imam për t’ia falur atij namazin e xhenazes dhe t’i luteni Allahut që ta falë. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Më dërgoni fjalë, sepse do të vij t’ia fal unë namazin e xhenazes.*” Kur erdhi lajmi i vdekjes së tij, Omeri (radijallahu anhu) u përpoq që ta pengonte Profetin tonë të nderuar, që ai të mos merrte pjesë në varrimin e atij njeriu. Madje, ai arriti gjër aty sa t’i thoshte atij:

- “A nuk ta ndaloi ty Zoti faljen e namazit të xhenazes së hipokritëve?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u përgjigj:

- “Unë u lashë i lirë ta bëj vetë zgjedhjen kësaj here.”, – duke i kënduar Omerit të nderuar (radijallahu anhu) dhe ajetin kur’anor: **“U lute për ta apo nuk u lute (o Muhamed), Allahu nuk do t’i falë, edhe sikur ti të kërkosh falje për ta shtatëdhjetë herë! Kjo sepse ata e mohuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Allahu nuk i udhëzon në rrugë të mbarë njerëzit e pabindur.”** (Teube, 9/72) Shkoi, fali namazin e xhenazes dhe menjëherë pas namazit u zbrit ky ajet i sures “Teube”: **“Askujt prej hipokritëve, kur të vdesin, mos ia fal xhenazen, as mos rri afër varrit të hipokritit, sepse ata e kanë mohuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe qëndruan të pabindur deri në vdekje.”** (Teube, 9/84)¹⁴

I Dërguari i Allahut nuk nxehet as me atë që i kishte bërë magji

E tregon Zejd bin Erkami: “Ishte një hebre, që i kishte bërë magji të Dërguarit të Allahut. Për pasojë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u sëmur. Xhibrili (alejhis’selam) erdhi dhe e njoftoi: “Një hebre të ka bërë një magji. Gjërat që i lidhi nyje i ka hedhur në pusin që gjendet në aksh vend. Dërgo dikë, ta nxjerrë atë nyje që atje

¹⁴. Buhari, *Sahib*, 1/427 (1210).

dhe të ta sjellë ty.” Profeti ynë i nderuar (paqja e Zotit qoftë mbi të) për këtë punë dërgoi Aliun (radijallahu anhu). Aliu (radijallahu anhu) e nxori magjinë nga pusi dhe e solli te Profeti ynë, i cili e zgjidhi nyjën. Kur e zgjidhi nyjën Profeti ynë filloi të shpëtonte nga shqetësimet që ndiente, sikur të ishte duke shpëtuar nga litarë të lidhur pas trupit dhe u qetësua. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk i tha asgjë atij hebreu që i pati bërë magji. Madje, deri ditën që u nda nga kjo jetë ai nuk ia bëri kurrë të ditur që e dinte për atë magji.”¹⁵

I Dërguari i Allahut nuk nxehet me atë grua që i dha të hante mish të helmuar deleje

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: “Një grua hebreje nga Hajberi skuqi ca mish për të Dërguarin e Allahut dhe para se t’ia çonte e helmoi, pastaj ia çoi përpara. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) hëngri një copë nga ai mish, madje pati edhe nga sahabët që hëngrën prej tij. Pastaj Resulullahu u tha sahabëve të tij:

- “*Se mos vazhdoni të hani nga ai ushqim, hiqini duart!*” I Dërgoi fjalë asaj gruaje që pati sjellë mishin dhe e pyeti:

- “*Ti i hodhe helm mishit të deles që na solle për të ngrënë, apo jo?*”

- “Kush të njoftoi ty se e pata helmuar mishin?”, – e pyeti ajo grua Resulullahun, kur ai i tha:

- “*Ky mish më njoftoi vetë që ishte i helmuar.*”, – pastaj, në vazhdim, i tha asaj gruaje:

- “*Po pse e bëre diçka të këfillë?*”

- “E bëra për të kuptuar, nëse je vërtet një profet, apo jo.”, – u përgjigj grua.

- “Mendova se, nëse ti do të ishe vërtet një profet, atëherë ishte e pamundur që ai helm të të bënte dëm. Por, nëse do të ishe një gënjeshtar, unë do t’i kisha shpëtuar njerëzit prej teje.” Kësisoj, Resulullahu i nderuar e fali atë grua dhe nuk e ndëshkoi.”¹⁶

¹⁵. Nesai, *Sunen*, 7/112 (4080).

¹⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/230.

I Dërguari Fisnik e fal një grup kurejshësh që donin ta sulmonin ditën e Hudejbijes

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Në ditën e Hudejbijes, tetëdhjetë mekas të armatosur deshën t’i bënin pritë Resulullahut në anën e malit të Ten’imit dhe ta sulmonin me t’u afruar myslimanët; i Dërguari i Allahut u lut kundër tyre dhe ata u kapën të gjithë, e i sollën përpara tij. Profeti ynë i nderuar (paqja e Zotit qoftë mbi të) nuk i ndëshkoi ata, por i fali. Fill pas kësaj u zbrit ky ajet i sures “Fet’h”: **“Është Ai që i ka penguar duart e tyre ndaj jush dhe duart tuaja ndaj tyre brenda në Mekë, pasi ju dha fitoren mbi ata. Allahu i sheh të gjitha çfarë bëni ju.”** (Fet’h, 48/24)¹⁷

4. THELLËSIA E DHEMBSHURISË DHE MËSHIRËS SË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Nis të fal namaz dhe kam qejf që namazin njerëzve t’ua fal sa më gjatë. Nganjëherë dëgjoj ndonjë të qarë foshnje dhe përpiqem të mos e zgjas më shumë, sepse unë e ndiej vetë, në trupin tim, atë vuajtje që ndien nëna kur dëgjon zërin e të qarën e foshnjës së saj.”¹⁸

Dhembshuria e sahabëve

Tregon Esmaiu: “Disa besimtarë shkuan njëherë tek Abdurrahman bin Aufer (radijallahu anhu) dhe iu lutën që të shkonte njëherë tek Omeri (radijallahu anhu) dhe t’i kërkonte atij të tregohej pak më i butë me njerëzit. Ata thanë se edhe vajzat pas perdes i zë frika kur dëgjojnë zërin e tij. Kur Abdurrahman bin Aufer (radijallahu anhu) ia përcolli Omerit (radijallahu anhu) këto shqetësime vetë, Omeri i tha:

- “Për Zotin, sikur ta dinin ata se sa shumë dhembshuri dhe mëshirë ushqej unë ndaj tyre në të vërtetë, ata do të m’i kishin marrë edhe këto rroba që kam në trup.”¹⁹

¹⁷. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/122 (12249).

¹⁸. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/109 (12086).

¹⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/861 (35979).

5. NDJENJA E TURPIT TEK I DËRGUARI I ALLAHUT

Përshkrimi që i bën Ebu Said el-Hudriu ndjenjës së turpit tek i Dërguari i Allahut

Tregon Ebu Saidi: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte edhe më i turpshëm se sa një vajzë e virgjër në natën e parë të martesës së saj. Aq sa, kur nuk i pëlqente diçka, i dallohej menjëherë në fytyrë.”²⁰

Profetit tonë i vinte zor që t’ua përplaste sahabëve në fytyrë bëmat e tyre

Enes bin Maliku (radijallahu anh) tregon: “Një ditë Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) pa disa njolla të verdha mbi trupin e një burri dhe kjo nuk i pëlqeu aspak. Kur u bë gati për t’u larguar prej andej, u tha atyre që kishte pranë:

- “*Sikur t’i thoshit atij njeriu atje tej, e ta lante, ta pastronte, atë njollë të verdhë që ka mbi trup.*” I Dërguari i Allahut (pajja e Zotit qoftë mbi të), kur nuk i pëlqente diçka te dikush, Atij i vinte zor që t’ia përplaste të vërtetën në fytyrë.”²¹

Si e përshkruan Aishja (r.a.) ndjenjën e zorit që mbizotëronte te Profeti ynë i nderuar

Aishja (radijallahu anha) thotë se: “Kur Profeti ynë dëgjonte dikë që thoshte diçka për dikë tjetër, nuk thoshte: ‘Ç’punë ka aksh njeri që thotë këtë, apo atë!’, por na thoshte: ‘*Çfarë kanë disa njerëz që thonë kështu, apo ashtu!*’”²²

Sipas transmetimit të përcjellë nga Tirmidhiu, Aishja (radijallahu anha) ka thënë:

- “Unë nuk i kam parë kurrë pjesët intime të trupit të Profetit

²⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/36.

²¹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/133 (12390).

²². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/38.

tonë.”, ose: “Unë nuk e kam parë kurrë Resulullahun në pjesët intime të trupit të tij.”²³

6. NDJENJA E TURPIT TE SAHABËT FISNIKË

Ndjenja e turpit tek Osmani (r.a.)

Tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): “Një ditë, megjithëse Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte në shtëpi me Aishen (radijallahu anha), ishte në pjesën e pasme, Ebu Bekri (radijallahu anhu) kërkoi leje të hynte dhe u fut brenda. Pas tij hyri brenda edhe Sa’d bin Maliku. Kur hynë këta, Resulullahu e kishte kupën e gjurit të zbuluar dhe po fliste me ta. Pastaj erdhi Osmani (radijallahu anhu), kërkoi leje të hynte pranë Profetit të nderuar. Resulullahu mori rrobën dhe mbuloi pjesën e kupës së gjurit, që kishte mbetur e zbuluar, ndërsa të shoqes i tha:

- “*Futu brenda!*” Pasi folën për njëfarë kohe, ata u larguan të gjithë. Atëherë, Aishja (radijallahu anha) e pyeti të Dërguarin e Allahut:

- “O i Dërguari i Allahut! Kur hyri babai me shokët e tij, ti jo vetëm që nuk e mbulove pjesën e zbuluar të kupës së gjurit, por as mua nuk më kërkove që të largohesha, pse e bëre këtë?” Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u përgjigj:

- “*Po si, të mos më vijë mua turp përpara një njeriu, prej të cilit u vjen zor edhe engjëjve? Betohem tek Allahu, në dorën e fuqisë së të Cilit është edhe fryma ime, se engjëjve u vjen turp nga Allahu, nga i Dërguari i tij, por u vjen turp edhe nga Osmani. Nëse Osmani do të hynte brenda dhe ti do të qëndroje pranë meje, ai, jo vetëm që nuk do të fliste asnjë fjalë, por as kokën nuk do ta ngrinte nga toka.*”²⁴

Ndjenja e të ardhurit zor e Eshexh bin Abdu’lkajsit

E transmeton Eshexh bin Abdulkajsi (radijallahu anhu): “Një ditë, Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) më tha mua:

- “*Eshexh, ti ke dy cilësi që Allahu dhe i Dërguari i Tij i duan shumë.*”

- “*Cilat janë ato, o Resulullah?*”, – e pyeta unë menjëherë.

²³. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 8/193.

²⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/203-204.

- “*Je shumë i butë dhe ke një ndjenjë shumë të fortë të të ardhurit zor!*”

- “Po, a i kam ato pjesë të natyrës sime, apo i kam përfutur më vonë?” – e pyeta unë.

- “*Ti i ke të natyrshme ato, o Eshexh.*”, – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

Atëherë unë nuk kisha se ç’të thosha, veçse: “Lëvduar qoftë Allahu i Madhërishëm, që më ka krijuar mua me dy cilësi kaq të mira.”²⁵

7. THJESHTËSIA DHE MODESTIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE SAHABËVE

Një ngjarje që ka ndodhur mes të Dërguarit të Allahut dhe Xhibrilit (alejhis’selam)

Tregon Ebu Hurejreja: “Xhibrili (alejhis’selam) ishte ulur pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Mesa duket pa një engjëll teksa zbriste nga qielli, sepse i nguli sytë në drejtim të kaltërsisë dhe tha:

- “Qëkurse është krijuar ky engjëll nuk ka zbritur asnjëherë më parë mbi Tokë.” Engjëlli i ardhur tha:

- “O Muhamed! Mua më ka dërguar Zoti të të pyes. Ti do të jesh një profet mbret, apo një profet rob?” Nga ana tjetër qëndronte Xhibrili (alejhis’selam), që i thoshte:

- “O Muhamed! Ji sa më i thjeshtë përpara Zotit tënd.” Andaj, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u përgjigj duke thënë:

- “*Unë dua të jem një profet rob.*”²⁶

Aishja (radijallahu anha) thotë se: “Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që nga dita që zbriti ai engjëll dhe ai zgjodhi të ishte më mirë një profet rob, ai nuk hëngri më bukë i mbështetur, madje thoshte:

- “*Unë ha siç hanë skellëvërit e robërit dhe ulem siç ulen skellëvërit e robërit.*”²⁷

²⁵. Buhari, *Edebu’l-Mufred*, 1/205 (584).

²⁶. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 8/582 (14209).

²⁷. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 8/582 (14210).

Fjalët që ka thënë Ebu Umame el-Bahiliu në lidhje me thjeshtësinë e të Dërguarit të Allahut

Tregon Ebu Galibi: “Ne i kërkuam Ebu Umames (radijallahu anhu):

- “Na trego ndonjë prej haditheve që i ke dëgjuar vetë nga goja e Profetit tonë.” Ai na tha:

- “Fjalët që fliste Profeti ynë nuk ishin veçse fjalët e Kur’anit. Ai e përmendte jashtëzakonisht shumë Allahun (xhel’le xhelaluhu), hutbet i mbante të shkurtra, ndërsa namazin e falte gjatë. Nuk druhej kurrë që të ikte pas një të skamuri a nevojtar, për t’u përmbushur atyre ndonjë nevojë, për të cilën ata i kërkonin ndihmë.”²⁸

Resulullahu dhe një grua me natyrë të keqe

E tregon Ebu Umameja (radijallahu anhu): “Ishte një grua që qëndronte me burrat. Përdorte shumë fjalë të pista. Një ditë, ajo erdhi pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), i cili po hante therijd dhe tha:

- “Shikojeni pak këtë, ulet të hajë siç hanë skllëvërit!” I Dërguari i Allahut iu përgjigj duke e pyetur:

- “*E kush skllav mund t’i bëjë Allahut robëri më mirë se unë?*” Ajo grua tha:

- “Edhe ha vetëm, nuk më fton edhe mua të ha me të!” Atëherë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i tha asaj:

- “*Eja, ulu të hash edhe ti!*” Gruaja e pa se i Dërguari i Allahut e pranoi kërkesën e parë, e i tha me këmbëngulje:

- “Po unë dua të ha nga dora jote.” I Dërguari i Allahut filloi ta ushqejë vetë me dorën e tij. Gruaja nuk dinte të përmbahej dhe e teproi, duke i thënë:

- “Më jep atë kafshatë që ke vënë në gojën tënde, atë dua të ha unë.” I Dërguari i Allahut ia plotësoi edhe këtë kërkesë asaj gruaje. Pasi e hëngri atë kafshatë, ndjenja e nderit të asaj gruaje u bë aq e fortë, saqë askush nuk e pa më të rrinte me meshkuj.”²⁹

²⁸. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 8/287 (8103).

²⁹. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 8/200 (7812).

Fjalët e të Dërguarit Fisnik për atë burrë që dridhej përpara tij

E tregon Xheriri (radijallahu anh): “Atë ditë që u ngadhënjye mbi Mekën, te Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) erdhi një burrë. Kur erdhi, atë seç e zunë ca si të dridhura. I Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) i foli e i tha:

- “*Rri i qetë, mos u shqetëso! Unë nuk jam sundimtar; unë jam i biri i një gruaje nga fisi i kurejshëve, e cila hante mish të tharë!*”³⁰

Të Dërguarit të Allahut nuk i pëlqente kur e trajtonin ndryshe nga të tjerët

Tregon Abdullah bin Xhubejr el-Huzaiu (radijallahu anhu): “Një ditë, Profeti ynë ishte duke ecur në rrugë bashkë me një grup prej sahabëve të tij, kur njëri prej tyre deshi që të ngrinte një rrobë dhe ta ruante se mos i binte dielli të Dërguarit të Allahut. Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur ndjeu hijen e asaj mbulese, ngriti kokën dhe pa se ajo hije vinte nga një si çarçaf i ngritur mbi kokën e tij. I tha atij që e mbante atë çarçaf:

- “*Ule atë çarçaf!*” Pastaj e mori atë rrobë, e shtroi në tokë dhe u tha atyre që ishin me të:

- “*Edhe unë jam një njeri nësoj si ju!*”³¹

Çfarë ka thënë Aishja (r.a.) në lidhje me sjelljen e të Dërguarit të Allahut kur ai ishte në shtëpi?

Tregon Urueja (radijallahu anhu): “Një burrë erdhi tek Aishja (radijallahu anha) dhe e pyeti:

- “A punonte i Dërguari i Allahut kur qëndronte në shtëpi?” Aishja (radijallahu anha) iu përgjigj:

- “Patjetër që po, nësoj siç bëni ju të gjithë nëpër shtëpitë tuaja, edhe ai qepte sandalet e grisura, apo arnonte edhe ndonjë rrobë që ishte e nevojshme të qepte.”³²

³⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/294.

³¹. Hejthemi, *Mexbmen ‘Z-Zenaid*, 8/586 (14225).

³². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/44.

Modestia e të Dërguarit të Allahut teksa hyri si ngadhënjimtar në Mekë

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Për të parë të Dërguarin e Allahut teksa futej në Mekën e ngadhënjyer prej tij vetë dhe myslimanëve, populli ishte grumbulluar në grupe të mëdha dhe të gjithë bashkë ishin ngjitur nëpër kodrinat përreth. Kurse ai (paqja e Zotit qoftë mbi të), nga modestia, kryet e kishte ulur zëre se mbi trupin e devesë, në të cilën kishte hipur.”³³

8. THJESHTËSIA DHE MODESTIA E SAHABËVE FISNIKË

Si i hipte devesë Omeri (r.a.) gjatë rrugëtimit të tij për në Siri

Eslemi (radijallahu anhu) tregon: “Omeri (radijallahu anhu) pati ardhur në Siri i hipur mbi një deve. Populli i Sirisë e gjykoj faktin se Omeri (radijallahu anhu) kishte ardhur i hipur mbi deve, e ai iu pati thënë:

- “Këtyre u janë mësuar sytë duke parë kafshët e rrugës gjithë madhështi të fatzinjve që nuk kanë se ç’të presin prej jetës së përtejme!”³⁴

Omeri (r.a.) u mëson grave të bëjnë qull

Tregon Hisham bin Halidi (radijallahu anhu): “Unë e pata dëgjuar njëherë Omerin e nderuar (radijallahu anhu), teksa i thoshte një gruaje:

- “Kush gatuan qull, të mos e hedhë miellin pa e lënë ujin të ngrohet njëherë mirë. Dhe kur të ngrohet uji, të fillojë ta hedhë miellin pak e nga pak, duke e përzierë mirë e mirë me lugë. Po e gatove kështu, bëhet edhe më shumë qull, edhe mielli nuk ngrin të krijojë kokrra.”³⁵

Kur Omeri (r.a.) kritikon ashpër veten gjatë hutbes

Ja se si e tregon Muhamed bin Omer el-Mahzumi (radijallahu anhu) këtë ndodhi: “Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) na foli:

³³. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 6/249 (10238).

³⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/865 (35987).

³⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/865 (35989).

- “Ejani të falim namazin!” Kur u mbledh bashkësia e besimtarëve, ai shkoi drejt minberit dhe u ngjiti mbi të. Lëvdoi dhe lartësoi Allahun, dërgoi salavate mbi të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), pastaj iu drejtua besimtarëve, duke u thënë:

- “O njerëz, më kujtohet fare mirë, kur dilja për të kullotur dhentë e hallave të mia, të cilat jetojnë në fisin e Mahzumëve. Atë punë e bëja në këmbim të një grushti hurmash dhe rrushi. Nga e nisa dhe shihni se ku kam arritur tani! Ja, sot jam siç më shikoni edhe ju.” – dhe, sakaq, zbriti nga minberi. U çua Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu) dhe e qortoi Omerin (radijallahu anhu) me fjalët:

- “Mos e gjyko e mos kritiko kaq ashpër veten tënde, o Prijësi i Besimtarëve!” E dëgjoi Omeri (radijallahu anhu) dhe u përgjigj:

- “Më lër, o Abdurrahman! Pata mbetur vetëm, kur egoja filloi të rrekej të më joshte: “Ti je Prijësi i tërë besimtarëve! Hë, ka ndonjë njeri që të jetë më lart se ti?” I thashë këto fjalë që t’i kujtoj vetes se kush jam në të vërtetë!”³⁶

Omeri (r.a.) e shoqëron deri në shtëpi një fëmijë, për ta mbrojtur atë nga shokët që i kanoseshin

Sinan bin Mesleme el-Hudheliu (radijallahu anhu) tregon: “Ishim në Medinë dhe një ditë, dolëm bashkë me fëmijët, të mblidhnim prej hurmave të rëna nga pema. Sakaq, aty ia behu papritur Omeri (radijallahu anhu). Fëmijët, një të parë se kush erdhi ia mbathën, kush t’ia kalonte më parë shokut. Unë nuk vrapova, qëndrova në vend. Petkun e pata mbushur me hurma. E pritja duke i thënë:

- “O Prijësi i Besimtarëve, këto janë nga hurmat që i ka rrëzuar era!” Omeri (radijallahu anhu) pa njëherë nga hurmat që kisha mbledhur, por nuk më rrahu. Unë i thashë:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Pak më tutje duhet të jenë edhe të tjerët, nëse ikën ti, ata do të vijnë e do të m’i marrin hurmat.” Omeri (radijallahu anhu) më buzëqeshi dhe shtoi:

³⁶. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 12/866 (35992).

- “Jo, nuk ti marrin dot, andaj vazhdo të ecësh!”, – dhe kështu, më shoqëroi nga pas gjersa mbërrita pranë familjes sime.”³⁷

Modestia e Osmanit (r.a.)

E tregon Abdullah err-Rrumij (radijallahu anhu): “Osmani (radijallahu anhu), kur merrte abdes gjatë natës, ai e merrte vetë ujin e abdesit. Kur i thoshin:

- “Po pse nuk i thua ndonjërës prej shërbyeseve a shërbyesve, e të ta sjellin ata ujin për të marrë abdes!”, – ai u përgjigjej duke u thënë:

- “Jo, nata është kohë pushimi e çlodhjeje për ta.”³⁸

Hasani Basriu (radijallahu anhu) thotë se: “Pashë njëherë Osmanin (radijallahu anhu). Ishte kalif në atë kohë. I mbështjellë me një mbulojë si çarçaf, ishte mbështetur të flinte në xhami; atje nuk kishte asnjëri tjetër.”³⁹

Modestia e Selman Farisiut

Tregon Thabiti (radijallahu anhu): “Selmani (radijallahu anhu) ishte vali i qytetit të Medainit. Atje erdhi një nga fisi i bijve të Tejmit, i cili kishte me vete edhe një barrë fiqsh. Selman Farisiu (radijallahu anhu) kishte veshur një palë shallvare dhe një rrobë. Ai që pati ardhur nga Siria, pa e njohur Selmanin (radijallahu anhu), i tha atij:

- “Hajde e ngrije pak këtë thes, se është shumë i rëndë.” Vetëm se, ata që ishin përreth dhe u bënë dëshmitarë të kësaj skene e njihnin mjaft mirë Selmanin, ndaj nuk ndenjen dot pa ndërhyrë:

- “Shiko, more njeri, se ky është vali!” – duke e paralajmëruar. Burri një të dëgjuar fjalët e thëna, u përpoq disa herë t’i shpjegonte Selmanit (radijallahu anhu), se nuk e kish njohur, por, më kot, Selmani (radijallahu anhu) i tha atij:

- “Do ta mbaj unë këtë barrë gjersa të arrijmë te shtëpia jote.”⁴⁰

³⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 7/90.

³⁸. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 9/355 (25648).

³⁹. Ebu Nu’ajm, *Hiije*, 1/60.

⁴⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/63.

Modestia e Hudhejfetu'l-Jemanit

E përshkruan Muhamed bin Sirini, kur tregon: “Omeri (radijallahu anhu), në kohën që do të niste ndonjë mëkëmbës në ndonjë vend të caktuar, i niste më parë një letër emërimi popullit të atij vendi, ku u shkruante atyre:

- “Ta dëgjoni fjalët e valiut tuaj dhe t’i bindeni çdo fjale të tij, për sa kohë që ai tregohet i drejtë.”

Edhe kur emëroi Hudhejfen (radijallahu anhu) si vali të Medainit, në dekretin e tij pati shkruar kështu:

- “T’ia dëgjoni fjalën dhe t’u bindeni urdhrave të tij, duke ua dhënë ato që ai do t’ju kërkojë.” Hudhejfeja u largua nga Medina me një kafshë rruge të shaluar; me vete kishte marrë edhe pak ushqim. Sapo mbërriti në Medain, njerëzit e qytetit dhe paria dolën që ta prisnin. Në dorë Hudhejfeja kishte një copë buke të rrumbullakët dhe një copë mish. Hudhejfeja hodhi këmbën, qëndroi i ulur më një anë të kafshës së tij dhe u lexoi banorëve letrën që i kishte dhënë me vete Omeri (radijallahu anhu). Populli i Medainit e pyeti menjëherë:

- “A ke ndonjë kërkesë prej nesh?” E ai u përgjigj:

- “Për sa kohë që do të jem me ju, gjithçka që dua nga ju është të më siguron diçka për të ngrënë dhe tagji për kafshën time të rrugës.”

Hudhejfeja ndenji për njëfarë kohe në Medain, pastaj Omeri (radijallahu anhu) e thirri atë sërish mbrapsht. Omeri, me të marrë vesh se Hudhejfeja edhe pak e do të hynte në Medinë, doli dhe u fsheh diku ndanë rrugës. E pa që Hudhejfeja po kthehej i varfër, njësoj siç ishte larguar nga Medina dhe doli menjëherë nga vendi ku rrinte i fshehur dhe iu hodh në qafë, për ta përqaftuar, duke i thënë:

- “Ti je vëllai im e unë jam vëllai yt!”⁴¹

Modestia e Abdullah bin Selamit

Abdullah bin Selami (radijallahu anhu) kishte ngarkuar një barrë dru mbi shpinë dhe po ecte nëpër qytezë. E pyetën:

⁴¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/277.

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

- “Po pse e bën këtë punë, kur ty Zoti nuk të ka lënë në aq vështirësi, sa të bësh një punë të këtillë?” Abdullah bin Selami (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Desha të shpëtoja nga mendjemadhësia, sepse unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), i cili ka thënë: “Kush ka qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie brenda vetes, nuk do të hyjë në Xhenet.”⁴²

9. ILUSTRIME NGA HUMORI DHE SHAKATË E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE TË SAHABËVE TË TIJ

Botëkuptimi i të Dërguarit të Allahut për shakatë dhe humorin

E tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Njëherë, sahabët e patën pyetur të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O i Dërguari i Allahut, ti bën edhe shaka me ne!” Resulullahu ua ktheu duke u thënë:

- “*Edhe nëse bëj shaka me ju, unë nuk ju them vetëm se të vërtetën!*”⁴³

I Dërguari i Allahut bën shaka me një burrë

Enes bin Maliku (radijallahu anh) rrëfen: “Erdhi një burrë tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe donte që ta hipte atë në devenë e tij. I Dërguari i Allahut i tha atij njeriu:

- “*Ty të të hipim mbi të voglin e deveës.*”

- “Po si të hipi unë mbi të voglin e kësaj deveje, o i Dërguari i Allahut?”, – e pyeti ai i habitur dhe Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Po pse të gjitha devetë a nuk lindin nga një deve femër?*”⁴⁴

Kur i Dërguari Fisnik i Allahut bën shaka me një grua të moshuar

E tregon Hasani (radijallahu anhu): “Te Resulullahu (sal’lallahu

⁴². Hejthemi, *Meçhmen’-Zenaid*, 1/283 (361).

⁴³. Tirmidhi, *Sunen*, 4/357 (1990).

⁴⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/46; Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 8/224.

alejhi ue sel'lem) erdhi një grua e moshuar dhe i tha këto fjalë:

- “O i Dërguari i Allahut! Lutju Allahut, që të më pranojë edhe mua të gjorën në parajsën e Tij.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha asaj nëne:

- “O nëna e filanit, po zonjat e moshuara nuk hyjnë dot në Xhenet.” Ajo grua u kthye në anën tjetër dhe zuri të qajë. I Dërguari i Allahut dërgoi fjalë:

- “*Njoftojeni atë grua dhe thojini: ‘Ajo nuk do të hyjë dot në Xhenet e moshuar’, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë: “... dhe i kemi bërë ato virgjëresha, të dashura për bashkëshortët e tyre dhe moshatare me ta, për njerëzit e së djathtës.”* (Uakia, 56/36-38)⁴⁵

10. SHAKATË E SAHABËVE

Kur Auf bin Maliku bënte shaka me Profetin tonë të dashur

Tregon Auf bin Malik el-Eshxhaiu (radijallahu anhu): “Ishim në luftën e Tebukut, kur shkova tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Resulullahu ishte futur të pushonte në një çadër të bërë nga lëkura. I dhashë selam; ma ktheu dhe më lejoi të futesha brenda, duke më thënë:

- “*Eja brenda!*” – Ajo çadër ishte tejet e vogël, ndaj mendova që tapyes:

- “O Resulullah, a të hyj me gjithë trupin tim?”, – ndërsa ai ma ktheu me fjalët:

- “Po, po, me gjithë trup të vish!” Dhe unë hyra.”⁴⁶

Kur, për një shaka të vogël, Nuajmani e shet Suejbitin si skllav

Këtë e ritregon Umu Selemeja (radijallahu anha): “Ebu Bekri i nderuar (radijallahu anh) kishte marrë një rrugë, do të shkonte diku për të bërë tregti. Me vete kishte marrë edhe Nuajmanin me Suejbitin. Ishin të dy besimtarë që kishin marrë pjesë edhe në luftën e Bedrit. Ushqimi që do të hahej gjatë rrugës i qe dorëzuar Suejbitit. Një ditë,

⁴⁵. Hejthemi, *Mexbmen'z-Zenaid*, 10/776.

⁴⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/46.

Nuajmani i tha atij:

- “Më jep diçka për të ngrënë.” – e ky ia ktheu:

- “Do të të jap kur të vijë Ebu Bekri (radijallahu anhu).” Nuajmani ishte njeri shakaxhi, që të bënte për të qeshur dhe bënte shumë shaka. Shkoi pranë njërit prej pronarëve të atyre dhenve dhe i tha:

- “Unë kam një skllav shumë të bëshëm e të fuqishëm, a do që ta marrësh?” Ai iu përgjigj:

- “Po, e marr.”

- “Vetëm se ky skllav është shumë i gojës, e mund të të thotë një ditë, që ‘jam i lirë’. Hiqni dorë që tani sa pa e marrë, se kur të vijë ajo ditë ju do t’i besoni atij dhe do të veproni sipas fjalës së tij.” – i paralajmëroi ai ata. Por të zotët e kopeve i thanë:

- “Në rregull, po e marrim; pranojmë, sidoqoftë.” Kështu, Nuajmani e shiti Suejbitin në këmbim të dhjetë deveve të reja femra, i vuri përpara devetë dhe u nis. U tregoi pronarëve të kopeve Suejbitin, duke u thënë:

- “Ja tek e keni skllavin; mund ta merrni me vete.”

- “Mos i besoni atij, ju gënjen; unë jam i lirë.” – tha Suejbiti, por të zotët e kopeve e dinin, ndaj ia pritën:

- “Ne i dimë ato të tuat; e dinim edhe që do të na thoshe kështu.” – e sakaq i hodhën një litar në qafë Suejbitit dhe e morën me vete.

Pas njëfarë kohe, kjo ndodhi shkon në vesh të Ebu Bekrit (radijallahu anhu), i cili merr disa nga shokët e tij dhe shkojnë pranë të zotëve të kopeve; çuan devetë dhe morën Suejbitin mbrapsht. U kthyen në Medinë dhe ia treguan edhe të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) gjithë sa kishin ndodhur. Siç ishin bashkë, edhe Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të), edhe sahabët qeshën shumë atë ditë. Madje kjo që një ndodhi që nuk u harrua për një vit të tërë. Qeshnin me ç’kishte ndodhur, sa herë që u kujtohej.”⁴⁷

⁴⁷. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 2/98.

11. BUJARIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Tregon Ibni Abasi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte më i miri njeri dhe më bujari ndër njerëz. Gjatë muajit të Ramazanit, kur qëndronte me Xhibrilin (alejhis’selam), ai të gjitha ç’ti gjendeshin ua jepte të tjerëve. Çdo natë të Ramazanit Xhibrili vinte tek i Dërguari i Allahut dhe të dy bashkë i lexonin Kur’an njëri-tjetrit. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) ishte më bujar edhe se erërat më të begata.”⁴⁸

Kurse Xhabir bin Abdullahu tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk i ka thënë kurrë ‘jo’ ndonjërit që ka ardhur për t’i kërkuar ndonjë gjë.”⁴⁹

Aliu (radijallahu anhu) thotë se: “Po t’i kërkoje diçka Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), nëse ishte diçka që donte që ta bënte, ai të thoshte: “*Në rregull, bëhet.*”, nëse bëhej fjalë për diçka, të cilën ai nuk ishte në gjendje për ta përmbushur, atëherë ai heshtte. Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) nuk të thoshte kurrë ‘jo’.”⁵⁰

12. DURIMI TEK I DËRGUARI I ALLAHUT DHE TE SAHABËT E TIJ

Si i duronte sëmundjet Profeti ynë

Tregon Ebu Saidi: “Kur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u sëmur, unë shkova tek ai. Ishte mbuluar me një mbulojë të kadifenjtë. Vura dorën mbi shtrojnë, e i thashë:

- “Ç’janë këto ethe kaq të forta, o i Dërguari i Allahut!” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) më tha kështu:

- “*Ja, siç e sheh, fatkeqësi të tilla i presin njerëzit si ne. E sipas madhësisë së të keqes na është përgatitur edhe shpërblimi që do të marrim.*”

- “O Resulallah, po kujt i ndodhin fatkeqësitë më të rënda?”, – e pyeta unë.

- “*Profetëve.*”, – m’u përgjigj ai prerazi.

⁴⁸. Ibn Sa’d, *Tabakatul-Kubra*, 2/195.

⁴⁹. Ibn Kethir, *el-Bidaie*, 6/42.

⁵⁰. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 10/268 (17349).

- “Po pastaj?”, – vazhdova unë.

- “Dijetarëve.”, – më tha ai.

- “Po pastaj?”

- “*Pastaj njerëzve të mirë.*”, më tha ai, duke shtuar: – “Kishte prej këtyre që të përmenda, që u mbushej koka me insekte a morra, të cilat shtoheshin aq shumë, saqë kjo mund të bëhej shkak edhe për vdekjen e tyre. Kishte të tjerë që përballeshin me një varfëri të atillë, që vështirë të gjenin edhe ndonjë copë, që ta vishnin. Por ata u gëzoheshin fatkeqësive që u vinin më shumë sesa i gëzoheshin ardhjes së të mirave të Allahut (xhel’le xhelaluhu).”⁵¹

Aishja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) po përpëlitej në shtrat nga dhimbjet. Nuk durova dot e i thashë:

- “Po t’i kishim ne ato dhimbje e të vuanim aq shumë, e të të ankoheshim, ti do të mërzhiteshe me ne!” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) m’u përgjigj:

- “*Mos e harro çfarë do të të them: Besimtarët sprovohen me fatkeqësi. Kur një besimtar i hyn ndonjë gjemb në këmbë, apo trupin ia mbërthen ndonjë e dhembur, Allahu i fshin atij një mëkat dhe e ngjit në një shkallë shpirtërore më të epërme.*”⁵²

Durimi për vdekjen e fëmijëve, të afërmeve dhe të miqve

Tregon Enes bin Maliku (radijallahu anhu): “Unë isha aty, kur Ibrahim po jepte shpirt në sytë e të Dërguarit të Allahut. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk e shikonte dot në atë gjendje, ndaj sytë iu mbushën me lot dhe tha këto fjalë:

- “*Sytë përloten, zemrën e pushton hidhërimi; megjithatë, ne nuk themi dot asgjë përkundër caktimit e pëlqimit të Allahut të Madhërishëm, o Ibrahim! Jemi shumë të mërzhitur që do të të humbasim.*”

Në një transmetim tjetër nga Mekhuli, kjo ndodhi përcillet kështu: “Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) hyri i mbështetur tek Abdurrahman bin Aufo (radijallahu anhu) ndërkohë që Ibrahim po

⁵¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/370.

⁵². Bejheki, *Shuabul’Iman*, 7/144 (9781).

lëngonte. Kur ndërroi jetë sytë e Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) lotuan dhe Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu) i tha:

- “O Profet i Allahut, kjo është pikërisht ajo nga e cila i ke ndaluar njerëzit. Kur të të shohin myslimanët duke qarë, do të qajnë!” Pasi i ndaluan lotët, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- “*Lotët janë tregues i mëshirës së Allahut. E nuk do të ketë mëshirë për atë që nuk tregohet i mëshirshëm. Ne ua ndalojmë njerëzve që ata të qajnë e të ulërijnë, duke bërë titull, e ta përmendin njeriun e ndarë nga jeta me cilësi që nuk i meriton.*” Pastaj tha:

- “*Po të mos ekzistonte premtimi dhe ky rend i përkryer i Allahut, pra po të mos takobeshin pasardhësit me paraardhësit, ndoshta atëherë po, atëherë mund të nxebeshim e të mërziteshim vërtet aq shumë. Ne jemi të mërzitur për Ibrahimin. Përloten sytë, hidhërohet zemra, por nuk mund të themi dot asgjë që nuk do t'i pëlqente Zotit. Ibrahim, pjesën tjetër të gjurit, që nuk e piu këtu, do ta plotësojë në parajsë.*”⁵³

Ebu Bekri (r.a.) dhe Aliu (r.a.) këshillojnë njerëzit të bëjnë durim gjatë vdekjes së njerëzve të tyre të afërt

Ebu Ujejneja (radijallahu anhu) thotë se: “Ndërsa shkonte për ngushëllim te ndokush, Ebu Bekr Besniku (radijallahu anhu) thoshte: “Durimi e lehtëson dhimbjen e fatkeqësisë; ankimi nuk përbën kurrfarë dobie. Jeta përpara vdekjes është e thjeshtë, ndërsa më e vështira është jeta që vjen pas vdekjes! A nuk ju kujtohet dita kur u nda Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) prej nesh, nëse do të kujtoni atë ditë, atëherë fatkeqësia që ju ka gjetur sot do të bëhet fare e vogël në sytë tuaj, kurse Allahu do t’jua shtojë e do t’jua shumëfishojë shpërblimin e durimit.”

Tregon Sufjan bin Ujejneja (radijallahu anh): “Ali bin Ebi Talibi (radijallahu anhu), kur pati shkuar tek Esh’ath bin Kajsi për ngushëllim, meqë i kishte vdekur i biri, ai e pati ngushëlluar atë duke i thënë: “Nëse je mërzitur, kjo është më se normale, sepse ai ishte më i afërti yt; por, nëse bën durim, tek Allahu të pret një shpërblim shumë herë më i

⁵³. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/90, 189.

madh edhe se djali yt. Ç'të kesh të caktuar si kader, ajo do të vijë një ditë e nuk i shpëton dot. Nëse e duron, fiton shpërblimin dhe të mirat e pamasa të Allahut; nëse ankoresh, ti do t'i shtosh vetes gabimet e mëkatet.”⁵⁴

Fjala e Omerit (r.a.): “Fatkeqësi është çdo gjë që nuk i pëlqen besimtarit.”

Tregon Abdullah bin Halife: “Ishim në një varrim bashkë me Omerin (radijallahu anhu). Në një çast, sandales së Omerit (radijallahu anhu) iu këput rripi dhe u kthye e tha: *“In’na lil’labi ue in’na ilejhi baxhiin.”* E pyetën:

- “O Omer, a thuhet ky ajet edhe kur të këputet rripi i sandales?” Dhe ai u përgjigj:

- “Çdo gjë e pakëndshme që të ndodh është një fatkeqësi për ty.”⁵⁵

Ebu Talhaja dhe Ummu Sulejmi bëjnë durim për vdekjen e fëmijëve të tyre

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Ebu Talhaja kishte një djalë, i cili ishte i sëmurë. Një ditë Ebu Talhaja (radijallahu anhu) kishte dalë jashtë dhe fëmija kishte vdekur. Me t’u kthyer në shtëpi, pyetja e parë që bën është:

- “Si e kam djalin?” Nëna e fëmijës, Ummu Sulejmi (radijallahu anha), iu përgjigj:

- “Tani është shumë më qetë sesa më parë.”, – dhe i solli për të ngrënë darkë. Ebu Talhaja hëngri ushqimin, pastaj shkoi të flejë me të shoqen. Pastaj, Ummu Sulejmi e lajmëroi të shoqin për atë që i kishte gjetur, duke i thënë:

- “Hajde, shkoni ta varrosni fëmijën.” Në të gdhirë, Ebu Talhaja (radijallahu anhu) shkoi drejt e te Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që ta njoftonte për çfarë kishte ndodhur. Resulullahu e pyeti:

- “*A shkua me njëri-tjetrin mbrëmë?*”

⁵⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 15/1149 (42959).

⁵⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1293 (8649).

- “Po!”, – u përgjigj Ebu Talhaja. Atëherë, i Dërguari i Allahut iu lut Zotit me fjalët:

- “O Zot, bekoje këtë natë të tyren.”

Nga ajo natë, Umu Sulejmi solli në jetë një djalë. Ebu Talhaja më tha mua:

- “Merre fëmijën dhe çoja Resulullahut.”, – duke më dhënë me vete edhe ca hurma, që t’ia shpija të Dërguarit të Allahut. E çova dhe Profeti (alejhis’selam) më tha:

- “A ka fëmija ndonjë gjë me vete?”

- “Po, kam sjellë ca hurma.”, – iu përgjigja unë. Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) i mori hurmat, i përtypi dhe të bluara i nxori nga goja e i vuri në gojën e foshnjës, i fërkoj pak qiellzën dhe e quajti djalën Abdullah.”⁵⁶

Ndërsa, në një transmetim tjetër Buhariu na njofton se Sufjan ibni Ujejneja (radijallahu anhu) ka thënë kështu: “Dikush nga ensarët më pati treguar se ‘Umu Sulejmi, nga një natë për të cilën u lut i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) solli në jetë një fëmijë, të cilit Profeti ynë (alejhis’selam) ia vuri emrin Abdullah. Shih ç’begati; kam njohur nëntë djem të Abdullahut dhe secili prej tyre ishte këndues i Kur’anit.”⁵⁷

13. FALËNDERIMI I ZOTIT NGA I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ

**I Dërguari i Allahut: “A të mos jem unë një rob
që e falënderon Zotin?”**

Mugire bin Shu’beja tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) falte namaz aq sa këmbët nisin e i ënjteshin. Po t’i thoshte dikush, “O i Dërguari i Allahut, po a nuk t’i ka falur ty Allahu të gjitha mëkatet e shkuara dhe të ardhshme?”, Resulullahu i përgjigjej:

- “Pse, a të mos jem unë një rob që e falënderon Zotin?”⁵⁸

⁵⁶. Buhari, *Sahih*, 5/2082 (5153).

⁵⁷. Buhari, *Sahih*, 1/437 (1239).

⁵⁸. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/58; Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/284.

I Dërguari i Allahut ulej gjatë-gjatë në sexhde, për të falënderuar Allahun

Tregon Muadh bin Xhebeli (radijallahu anh): “Pata shkuar njëherë tek i Dërguari i Allahut. (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Resulullahu ishte duke falur namaz; deri në agim qëndroi ashtu, sa në kijam, në sexhde. Aq gjatë qëndroi në sexhde, sa që për një çast pandeha se mos mbeti ashtu, i pajetë.

- “*A e di ti se pse e bëra atë?*”, – më pyeti mua i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).

- “Nuk e di, Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më të drejtën e të vërtetën e çdo gjëje.”, – iu përgjigja unë. Ma përsëriti tri a katër herë atë pyetje, derisa, në fund, më tha:

- “*Unë fala namazin që Allahu ma ka shpallur mua detyrim. Në fund të namazit, erdhi lajmëtari i Allahut (Xhibrili Besnik) dhe më tha: ‘Çfarë do prej meje, që ta bëj për të gjithë umetin tënd?’ ‘Zoti e di më të mirën.’, – i thashë unë. Pastaj edhe ai ma përsëriti mua tri a katër herë pyetjen e tij. E, kur edhe unë i thashë se ‘Zoti e di më të mirën.’ lajmëtari i Allahut, Xhibrili (alejhis’selam), më njoftoi se Zoti i Madhërisëm tha: ‘Unë Ty nuk do të të mërzis e nuk do të të hidbëroj për bashkësinë e besimtarëve të tu.’ Atëherë, unë rashë menjëherë në sexhde, sepse Zoti ua jep shpërblimin atyre që janë falënderues, sepse Ai i do shumë ata që falënderojnë.’”⁵⁹*

Profeti ynë bie në sexhde falënderimi kur sheh një burrë të paralizuar

Tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): “Të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i kaloi pranë një burrë që nuk ecte dot. Kur e pa atë njeri në atë gjendje, zbriti nga kafsha e rrugës dhe u ul në sexhde. Ebu Bekri (radijallahu anhu) kaloi pranë atij njeriu, edhe ai u ul në sexhde për ta falënderuar Allahun. Pastaj, më vonë, aty kaloi edhe Omeri (radijallahu anhu) e edhe ai u ul në sexhde që të falënderonte Allahun.”⁶⁰

⁵⁹. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 20/102 (199).

⁶⁰. Hejthemî, *Mexhmu’u’l-Zenaid*, 2/582 (3723).

Omeri (r.a.) bënte gjithmonë krahasime me të këqijat, për të theksuar rëndësinë e falënderimit

Tregon Ikrimeja (radijallahu anhu): “Omeri (radijallahu anh) kaloi pranë një burri që as nuk dëgjonte, as nuk fliste dot. Të pranishmëve ai u bëri këtë pyetje:

- “A shihni ju ndonjë prej të mirave të Allahut te ky njeri?” Ata që ishin aty iu përgjigjën:

- “Jo!” Omeri (radijallahu anhu) e dëgjoi përgjigjen e tyre dhe shtoi:

- “A nuk e shikoni se sa lehtë urinon ky njeri. Po sikur ta kishte të vështirë ta bënte edhe këtë? Me pak fjalë, ja, kjo është një prej të mirave që Allahu i ka falur këtij njeriu.”⁶¹

Një tjetër këshillë e Omerit (r.a.) në lidhje me falënderimin e Zotit

Hasan Basriu (radijallahu anhu) tregon: “Omeri (radijallahu anhu) i pati shkruar një letër Ebu Musa el-Esh’ariut, në të cilën i thoshte kështu: “Mjaftohu me ato të mira që të ka dërguar Allahu, që ti të ushqehesh, sepse Zoti ynë është Mëshirëplotë dhe prandaj i ka bërë robt e Tij të ndryshëm për sa u përket pasurive që u ka falur, që t’i sprovtojë ata të gjithë ndryshe nga njëri-tjetri. Robin që i jep pasuri dhe kamje të pamasë Ai e sprovon duke parë se si do ta falënderojë ai. Dhe falënderimi ndaj Allahut bëhet vetëm duke i shpenzuar, si kamjen, ashtu edhe të mirat e tjera, që mund të na ketë dhënë, në atë rrugë që Ai do që ne t’i shpenzojmë.”⁶²

Osmani (r.a.) falënderon Allahun, meqë nuk i ka kapur dot disa fajtorë të zënë në faj e sipër

Tregon Sulejman bin Musai: “Një ditë thanë se Prijësi i Besimtarëve, Osmani (radijallahu anhu) kishte marrë vesh për disa njerëz që bënë një punë të keqe dhe se do t’i kapte ata në faj e sipër. Osmani (radijallahu anhu) u nis të shkonte e t’i gjente ata njerëz. Kur mbërriti

⁶¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1295 (8654).

⁶². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1280 (8614).

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

në vendin e fajtorëve, pa se ata ishin shpërndarë dhe aty kishin lënë disa shenja të asaj pune të pahijshme që kishin bërë. Osmani (radijallahu anh) lëvdoi Zotin që nuk e përballi me ata fajtorë dhe madje, për këtë liroi edhe një skllav në shenjë falënderimi ndaj Tij.”⁶³

14. DËSHIRA E ZJARRTË DHE VENDOSMËRIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ PËR TË FITUAR SHPËRBLIMIN E ALLAHUT

Dëshira e ethshme e të Dërguarit të Allahut për të fituar shpërblimin e Allahut

Tregon Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu): “Në luftën e Bedrit, ne na binte një deve për tre vetë. Me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte Ebu Lubabeja dhe Aliu (radijallahu anhuma). Në kohën që radha për të ecur i binte të Dërguarit të Allahut, ata i thanë:

- “O i Dërguari i Zotit, të ecim ne, ti mos zbrit.” Kurse i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u përgjigj:

- “*Ju nuk jeni as më të fortë, as më të fuqishëm, se unë. Jo vetëm kaq, por as unë nuk është se kam më pak nevojë se ju për të fituar shpërblimin e Zotit.*”⁶⁴

Dëshira e sahabëve për të fituar shpërblimet e Zotit

Abdullah bin Amr bin Asi (radijallahu anh) tregon se: “Kur erdhën në Medinë Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe sahabët e tij (radijallahu anhuma), muhaxhirët e Mekës i zuri malaria dhe asnjëri nuk qe në gjendje të punonte. Profetin e ruajti Allahu i Madhërishëm; Profetin tonë nuk e zuri ajo sëmundje. Sahabët fshnikë nisën ta falnin namazin të ulur. Një ditë, Resulullahu doli nga shtëpia, për të shkuar në xhami. Bashkësia e besimtarëve e falnin ende të ulur namazin. I Dërguari i Allahut u tha atyre këto fjalë:

- “*Ta dini, se shpërblimi i namazit të falur ulur është sa gjysma e shpërblimit për namazin e falur në këmbë.*” Atëherë, sahabët, megjithëse ishin të

⁶³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/60.

⁶⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/261.

sëmurë e të pafuqishëm, u çuan në këmbë dhe vetëm e vetëm që të fitonin më shumë prej shpërblimeve të Allahut, u munduan që të mos uleshin më, por ta falnin namazin në këmbë.”⁶⁵

Dëshira e ethshme e Rabia bin Ka’bit për të fituar shpërblimin e Zotit

Tregon vetë Rabia bin Ka’bi (radijallahu anhu): “Unë të gjithë ditën e kaloja duke i shërbyer Profetit tonë të dashur (paqja e Zotit qoftë mbi të). Aq sa, kur i Dërguari i Allahut mbaronte së faluri namazin e jacisë dhe shkonte hynte në banesën e tij, unë qëndroja edhe për ca kohë përpara derës së të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), se ‘mos Resulullahut i del ndonjë punë, ndaj do të ishte më mirë të gjendesha aty, për t’i ardhur në ndihmë në çdo gjë.’ E dëgjoja të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), i cili thoshte vazhdimisht: “Subhanallahi ue bihamdih”. Në fund, ose bezdisesha duke qëndruar në vend dhe kthehesha pas, ose qëllonte që të më zinte gjumi aty ku isha dhe flija atje. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), në dijeni të shërbimeve të mia, erdhi një ditë dhe më tha:

- “*O Rabia bin Ka’bi! Më kërko ç’të duash, sepse do të të jap ç’të më kërkos.*” Unë i thashë:

- “O Resulullah, të mendohem njëherë, pastaj ta them.” Thashë me vete, të mirat e kësaj bote janë kalimtare, sot i ke, nesër nuk të nevojiten më, mendova me vete që të mirat që zotëroja më mjaftonin, kështu që thashë me vete, ‘më mirë t’i kërkoj të Dërguarit të Allahut diçka për jetën e përtejme, sepse ai ka një gradë të veçantë përpara Allahut.” Renda për tek i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe kur më pa, më pyeti:

- “*Çfarë bëre, Rabia; vendose se çfarë do të më kërkos?*”

- “Po, o Resulullah. A do të ndërmjetësosh për mua tek Allahu i Madhërisëm, që të më falë mua e të mos më hedhë në Xhehenem?”, – i thashë unë.

- “O Rabia, kush ta mësoi ty këtë?”, – më pyeti.

⁶⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/224.

- “Unë i betohem Zotit që të dërgoi ty me fenë e së drejtës dhe së vërtetës, o i Dërguari i Tij, se nuk ma mësoi asnjëri këtë që të thashë. Po ti qëndron në një shkallë aq të Lartë për Allahun, e kur më the, ‘kërkomë ç’të duash’, gjykova më mirë se, ‘kjo jetë në këtë botë është kalimtare, e të atilla i ka edhe të mirat’; pastaj unë kam të ardhura të mjaftueshme. Andaj, vendosa që ‘më mirë t’i kërkoj Resulullahut të më ndihmojë për ahiretin’.”

Pasi dëgjoi përgjigjen time, Profeti ynë i nderuar (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) heshti për një kohë të gjatë, pastaj më tha mua:

- “Mirë, do ta bëj! Por do ta ndihmosh edhe ti pak veten tënde, duke u ulur sa më shumë në sexhde.”⁶⁶

Çfarë tha Amar bin Jasiri gjatë rrugës për në luftën e Sifinit

Tregon Abdurrahman bin Ebzij (radijallahu anhu): “Amar bin Jasiri (radijallahu anhu) ishte nisur për në luftën e Sifinit dhe po ecte ndanë Eufratit, kur tha:

- “O Zot, sikur ta di se po ta lëshoj veten teposhtë atij mali, kjo do të bëhet shkak që unë të fitoj pëlqimin Tënd, unë do ta bëja këtë menjëherë. Nëse do ta dija se po të hidhesha në zjarr, Ti do të ishe i kënaqur prej meje, unë nuk do të mendohesha dy herë, por do ta bëja sa hap e mbyll sytë. O Zot, sikur të dija se po të hidhesha në ujëra të thella, e mbytja ime të bëhej shkak që unë të merrja pëlqimin Tënd, e bëj që tani, në çast. O Zot, unë nuk dua asgjë tjetër, vetëm se kënaqësinë e pëlqimin Tënd; unë edhe në luftë për hir të kënaqësisë Sate po shkoj. Të lutem që të mos më nxjerrësh mua prej njerëzve të humbur, prej atyre që do të pësojnë disfatën e madhe; o Zot, unë vetëm Ty të dua.”⁶⁷

15. NDËRMJETËSIMI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte më i bukur, më bujar, më fisniku dhe më trimi ndër mbarë njerëzinë. Një natë, populli i Medinës u kaplua nga paniku

⁶⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 5/335.

⁶⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/258; Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/143.

dhe u trembën jashtë çdo mase. Tërë njerëzit vraponin andej nga vinte zëri. Kur u kthyen për të parë andej nga vinte zhurma, i Dërguari i Allahut kishte hipur në pelën e Ebu Talhasë, kishte përgatitur edhe shpatën. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të):

- “*Mos u trembni, mos u trembni.*” Ajo pelë e rëndë e Ebu Talhasë (radijallahu anhu), e cila zakonisht ecte me vështirësi, tani që sipër saj kishte të Dërguarin e Allahut dukej sikur vraponte me të katër thundrat njëherësh.”⁶⁸

Aliu (radijallahu anhu) tha: “Kur përleshjet e luftës përndizeshin, ne shkonim të fshiheshim të mbroheshim pas të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe merrnim trimëri nga e tija, sepse ai ishte më trimi e më guximtari ndër të gjithë njerëzit.”⁶⁹

Guximi i të Dërguarit të Allahut gjatë luftës së Hunejnit

Sipas përcjelljes së një transmetimi nga ana e Bera bin Azibit (radijallahu anh), tek ai kishte ardhur dikush nga fisi i Kajsit, dhe e kishte pyetur:

- “A ia mbathët vërtet e kërkuat të ndiheshit më të sigurt pas Resulullahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) gjatë luftës së Hunejnit?” Dhe ai i qe përgjigjur:

- “Po, ne ia mbathëm, por Resulullahu nuk lëvizi asnjëherë nga vendi. Armiqtë tanë kishin ca shigjetarë shumë të zotë nga Heuadini. Ne i sulmuam ata pak më ashpër dhe ata u shpërndanë. Kjo i bëri ata të kaploheshin nga paniku, e kështu ne patëm mundësi të përparonim në drejtim të fitores. Fisi i Heuadinit na u lëshuan me një breshër shigjetash; ne ia mbathëm. Uallahi, pashë të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) qëndronte i palëvizur mbi mushkën e tij të bardheme. Aty ishte edhe Ebu Sufjani që e mbante mushkën nga frerët. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) thoshte:

- “*Unë jam një profet, kejo nuk është gënjeshtëri! Jam unë, nipi i Abdulmutalibit.*”⁷⁰

⁶⁸. Muslim, *Sabih*, 3/1802 (2307).

⁶⁹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/328.

⁷⁰. Buhari, *Sabih*, 3/1051 (2709).

16. DEVOTSHMËRIA E MADHE E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ (QËNDRIMI LARG GJËRAVE TË DYSHIMTA)

I Dërguari i Allahut u qëndronte edhe gjërave të dyshimta larg

Ja se si e përcjell Amr bin Shuajbi (radijallahu anhu) këtë cilësi të pashoqe të të Dërguarit të Allahut: “Një natë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pati gjetur një hurmë dhe e pati ngrënë. Mirëpo, pasi e hëngri atë hurmë, u shtri, por nuk vuri dot gjumë në sy. E pyeti njëra nga bashkëshortet e tij:

- “O Resulullah! Sonte nuk fjetët dot fare, cili është shkaku, a urtësia e kësaj?” Dhe ai iu përgjigj duke i thënë:

- “*Pata ngrënë një hurmë që e gjeta nën vete. Ne në shtëpi kemi edhe ato burmat që na janë dhënë për t’i shpërndarë si lëmoshë. Jam i shqetësuar, mos edhe ajo hurmë ishte prej tyre, ja, prandaj nuk fjeta dot fare gjatë gjithë natës.*”⁷¹

Si u shmangej Ebu Bekri (r.a.) gjërave të dyshimta

Tregon Muhamed bin Sirini (radijallahu anhu): “Përveç Ebu Bekrit (radijallahu anhu) unë nuk kam parë ndonjëherë njeri tjetër që ta nxjerrë të gjithë ushqimin e ngrënë.

Një ditë, Ebu Bekrit (radijallahu anhu) i sollën për të ngrënë. Pasi hëngri, i thanë:

- “Këtë ushqim e solli Numani.” Sapo dëgjoi fjalët që iu thanë Ebu Bekrit (radijallahu anhu), ai tha:

- “E çfarë më dhatë ju mua të ha, ushqimin e blerë me paratë që ka fituar Numani gjatë kohës së inyorancës, kur punonte si falltar e parashikues i së ardhmes!”, – dhe e nxori jashtë të gjithë sa kishte ngrënë.”⁷²

Si u shmangej Omeri (r.a.) gjërave të dyshimta

E tregon Zejd bin Eslemi (radijallahu anhu): “Omeri (radijallahu

⁷¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/59.

⁷². Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/31.

anhu) kishte pirë qumësht dhe ai qumësht i pati pëlqyer shumë. Ndaj, atij që i solli qumështin i tha:

- “Po ty nga të erdhi ky qumësht kaq i mirë?” Ai i tregoi se kishte shkuar për të marrë ujë dhe ata që ishin atje molën prej kafshëve të zekatit dhe i dhanë edhe atij. Ja, ky qumësht ishte qumësht i kafshëve të zekatit. Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) futi gishtat në grykë dhe e nxori të gjithë qumështin që kishte pirë.”⁷³

17. MBËSHTETJA E PLOTË TE ZOTI E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ

Mbështetja e plotë e të Dërguarit të Allahut

Këtë e tregon Xhabiri (radijallahu anhu), i cili ka qenë bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në luftën e Nexhdit: “Të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) iu duk më e arsyeshme, që kur iu afruam një lugine të mbuluar me bimë gjembaçësh, të qëndronim aty për të bërë pak nga gjumi i drekës. Të gjithë ishin shpërndarë dhe ai po qetësohej nën hijen e një peme. Shpatën e kishte varur mbi një degë të pemës dhe e kishte zënë gjumi. Ne sapo na kishte zënë gjumi, kur pamë të Dërguarin e Allahut që po na fliste. U ngritëm dhe vrapuam për te Resulullahu. Tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte ulur edhe një beduin. Ai na tha:

- “*Ky burrë më kishte marrë shpatën kur unë flija; u zgjova dhe e gjeta më kishte drejtuar shpatën dhe më rrinte te koka.*” Ai më tha:

- “Po tani, kush mund të të shpëtojë ty nga dora ime?” Dhe unë i thashë:

- “*Allahu!*”, – nuk kaloi as një çast, e atij i ra shpata nga dora dhe u ul këtu me mua.

Ai beduin kishte dashur ta vriste të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Megjithatë Resulullahu e fali dhe nuk e dënoi beduinin.”⁷⁴

⁷³. Bejheki, *Sunen*, 7/14 (12943).

⁷⁴. Buhari, *Sabih*, 3/1065 (2753).

Kjo histori tregohet edhe në një tjetër transmetim dhe thuhet se emri i atij beduini ishte Gaureth bin Harith. Gaurethin e ka falur i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Gaurethi i tha të Dërguarit të Allahut:

- “Mysliman nuk bëhem, ama të jap fjalën se nuk do të të luftoj, as nuk do të luftoj krah për krah me kundërshtarët e tu.” Por, kur pati shkuar pranë njerëzve të tij, Gaurethi u pati thënë atyre:

- “Unë tani po vij nga njeriu më i mirë dhe më i mbarë i tërë njerëzisë.”⁷⁵

Mbështetja e plotë tek Allahu e Prijësit të Besimtarëve, Aliut (r.a.)

Tregon Ebu Mixhlezi: “Një njeri nga fisi i Muradit, erdhi për tek Aliu (radijallahu anhu), i cili në atë kohë ishte duke falur namazin në xhami. Ai i tha atij:

- “Ruaj veten! Një grup njerëzish nga fisi ynë duan të të vrasin!” Aliu (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- “Çdo njeri ka me vete dy engjëj, të cilët e ruajnë atë prej gjërave që ai nuk i ka të shkruara në paracaktimin e fatit të vet. Dhe, kur të vijë çasti i përplotësimit të asaj që ishte e shkruar në kaderin e tij, ata dy engjëj mbrojtës tërhiqen dhe e lënë njeriun ballë për ballë me fatin e vet. Nuk ka pikë dyshimi, se nuk ka mburojë më të fortë sesa exheli.”⁷⁶

Mbështetja e plotë e Abdullah bin Mesudit te Zoti

Tregon Ebu Dhabjeja: “Osman bin Afani (radijallahu anhu) pati ardhur tek Abdullah bin Mesudi në kohën kur ky ishte sëmure me atë sëmundje që u bë shkak edhe për vdekjen e tij dhe e pyeti:

- “Çfarë të shqetëson? Çfarë ke?” Ibni Mesudi iu përgjigj:

- “Mëkatet, ato më shqetësojnë.”

- “Çfarë të ka ënda?”, – e pyeti Osmani (radijallahu anhu).

- “Dua mëshirën e Zotit.”

- “A do që të të caktoj ndonjë mjek, që të kujdeset vetëm për ty?”,

⁷⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/84.

⁷⁶. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/75.

– e pyeti Osmani (radijallahu anhu).

- “Jo, doktori më sëmuri mual”, – u përgjigj ai.

- “Atëherë, më lër të të caktoj një pagë.”, – propozoi Osmani (radijallahu anhu).

- “Nuk kam nevojë për të.”, – ishte përgjigjja e Abdullah bin Mesudit (radijallahu anhu).

- “Po mirë, nuk ke nevojë ti, po të jetë për vajzat e tua, t’u kalojë atyre më vonë.”

- “Po ti, çfarë ke frikë, se mos mbeten të varfra vajzat e mia, kjo të shqetëson? Mos ki frikë, unë u kam urdhëruar atyre që çdo natë të lexojnë suren “Uakia”, sepse unë kam dëgjuar Resulullahun (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) të thotë: *“Nuk ka për të pasur kurrë vështirësi ekonomike ai që e lexon suren “Uakia” çdo natë.”*⁷⁷

18. PRANIMI I RRJEDHAVE TË KADASË-CAKTIMIT TË ALLAHUT

Omeri (radijallahu anhu) thotë se: “Nuk më bën përshtypje, nëse do të dal në mëngjes me ndonjë gjendje të mirë a me ndonjë gjendje jo të mirë, sepse unë nuk e di se ku fshihet ajo që është më e mbarë për mua, tek ato gjëra që unë i dua shumë, apo tek ato që nuk i dua fare.”⁷⁸

Hasani (radijallahu anhu) tregon: “I thanë babait tim, Aliut (radijallahu anhu):

- “Ebu Dherri thotë: ‘Mes varfërisë dhe pasurisë zgjedh varfërinë, mes sëmundjes dhe shëndetit zgjedh sëmundjen!’, – ç’mendim ke ti për këtë?” Aliu (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Allahu i dhëntë veçse të mira Ebu Dherrit, por unë nuk jam dakord me mendimin e tij. Unë them kështu: “Ai njeri që mbështetet te vullneti i Allahut dhe caktimi aq i mirë i Tij, as nuk e çon nëpër mend, madje as për të imagjinuar nuk e imagjinon, që të ketë një gjendje ndryshe nga ajo që Allahu ka përcaktuar në natyrën e krijuar të gjërave. Ja pra, ky është njëherazi e fshehta dhe kufiri i të pranuarit dhe i të qenët i kënaqur me atë që të është përcaktuar në rrjedhën e fatit!”⁷⁹

⁷⁷. Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/281.

⁷⁸. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1202 (8537).

⁷⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1203 (8538).

19. DEVOTSHMËRIA DHE FRIKA NDAJ ALLAHUT TE PROFETI DHE SAHABËT E TIJ

Gjëja që e plaku të Dërguarin e Allahut

E transmeton Ibni Abasi (radijallahu anhu): “Një ditë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) i tha të Dërguarit Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O i Dërguari i Allahut, të shoh shumë të moshuar.” Dhe, i Dërguari i Allahut iu përgjigj duke i thënë:

- “*Mua më plakën suret ‘Hud’, ‘Uakia’, ‘Murselat’, ‘Nebe’ dhe ‘Tekuir’.*”⁸⁰

Djaloshi të cilit iu ça mëlçia nga frika ndaj Zotit

Tregon Sehl bin Sa’di: “Zemrën e një djaloshi të ri nga ensarët e pati kapluar droja dhe respekti për Allahun (xhel’le xhelaluhu). Sa të kujtonte pak Xhehenemin dhe atij i mbusheshin sytë me lot e zinte e qante me ngashërim. Ishte kjo frikë dhe kjo drojë karshi Allahut që e izoloj në shtëpi atë djalë të ri. I treguan edhe të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) për të. Dhe Resulullahu u ngrit menjëherë dhe shkoi ta vizitonte në shtëpinë e tij. Kur e pa atë djalë të ri, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) e puhstroi në kraharor, e ledhatoi, por djaloshi ra në tokë i pajetë. Profeti ynë i dashur tha:

- “*Bëjeni gati shokun tuaj dhe bëni të gjitha përgatitjet e nevojshme për varrimin e tij; frika e Zotit ia ka copëtuar atij fare mëlçinë!*”⁸¹

“Po të dinit edhe ju atë që di unë...”

Ebu Dherri (radijallahu anhu) ka thënë: “Unë i betohem Allahut, se nëse ju do të dinit atë që di unë, as nuk do t’u afroheshit grave tuaja, as nuk do të binit dot në shtrat për të pushuar. Ah sikur Zoti të më kishte krijuar më mirë si një pemë, e cila të mund të pritej a t’i haheshin frutat, e të mos e kisha mbi vete këtë përgjegjësinë e rëndë

⁸⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/59.

⁸¹. El-Hakim, *Mustedrek*, 2/535 (3828).

të të qenët njeri!”⁸²

Ebu Derdaja (radijallahu anhu) ka thënë kështu: “Sikur ju të dinit ato që do të shohim pas vdekjes as nuk do të hanit, duke e shijuar atë që hani, as nuk do t’ju shkonte në mendje të pinit gjë prej gjëje. As në shtëpi nuk hynit për të pushuar. Do të dilnit të gjithë në mes të grumbujve me njerëz dhe do të vajtonit duke gjuajtur veten nga hidhërimi. Ah sikur Allahu të më kishte krijuar mua më mirë si një pemë, e cila pritet, apo frutat e saj hahen me shije!”⁸³

Fjalët e Aliut (r.a.) në lidhje me devotshmërinë

Tregon Kumejl bin Zijadi: “Një ditë, ne dolëm të shëtitnim me Aliun (radijallahu anhu). Mbërritëm në një vend ku kishte një varrezë dhe Aliu (radijallahu anhu) u drejtua kah varreza dhe tha:

- “O ju që jeni në këto varre! O njerëz tashmë të tretur! O njerëz të vetmuar! Ç’lajme keni ju për ne? Lajmet tona janë këto: “Pasuria juaj u nda e u shpërnda, fëmijët tuaj mbetën jetimë, gratë shkuan te burra të tjerë, kurse burrat u martuan me gra të tjera! Këto janë lajmet tona për ju, po ju çfarë lajmesh keni për ne?” Mandej, u kthye nga unë dhe më tha:

- “Nëse atyre do t’u jepej leje që të na përgjigjeshin, ata do të na thoshin: “Ushqimi më i mirë për rrugën e jetës është devotshmëria.”, – dhe nuk duroi dot e filloi të qajë. Pastaj na tha:

- “O Kumejl! Varri është kutia e veprave të njeriut, kur të vdesësh, do ta shohësh se ç’fshihet brenda në të!”⁸⁴

20. TË DERDHËSH LOT PREJ RESPEKTIT NDAJ ALLAHUT TË MADHËRISHËM

E qara e të Dërguarit të Allahut

Tregon Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu): “Njëherë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u kthye nga unë dhe më tha:

⁸². Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/164.

⁸³. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/216.

⁸⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1234 (8495).

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

- “*Lexomë pak Kur’an.*” Unë i thashë:

- “O i Dërguari i Allahut! E si të të lexoj unë ty Kur’an, kur Kur’ani të është zbritur ty?”, – por ai ma priti me fjalët:

- “*Mua më pëlqen kur e dëgjoj atë nga goja e të tjerëve.*” Nisa të këndoja suren “Nisa”. Kur arrita tek ajeti: “**Vërtet, Allahu nuk dëmton askënd asnjë grimë, por, nëse (dikush) bën të mira, Allahu ia shumëfishon ato dhe i jep shpërblim të madh.**” (Nisa, 4/41) – Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) më tha:

- “*Mjafton.*”, – dhe fytyrën e ktheu në anën tjetër. E pashë, nga sytë po i rridhnin lot që ngjanin me perla të bardha.”⁸⁵

Të qarët e sahabëve

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Kur u zbritën ajetet kur’anore: “**Vallë, prej kësaj fjale po çuditeni dhe po qeshni e nuk po qani?**”, sahabët e Sufes nisën të qanin; i dalloje lehtë lotët e tyre, teksa u rridhnin nëpër faqet e bardha. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e kuptoi që këto ajete i prekën shumë, u prek edhe vetë dhe qau edhe ai. Kur pamë të Dërguarin Fisnik të qante, qamë edhe ne. Atëherë, Profeti ynë na tha:

- “*Nuk hyn në sjiarr ai që qan nga frika e Allahut. Ashtu siç nuk hyn dot në Xhenet ai që ngul këmbë në mëkatin e vet. Por e vërteta është, se, nëse ju nuk do të bënit asnjë gabim, atëherë Allahu do të dërgonte një bashkësi tjetër; ata do të bënin mëkate dhe Ai do t’i falte.*”⁸⁶

E qara e Omerit (r.a.)

Këtë e tregon Abdullah bin Shedad bin Hadi: “Omeri (radijallahu anhu) po u falte besimtarëve namazin e sabahut. Unë isha në rreshtin e fundit fare. Ai po këndonte suren “Jusuf” dhe kuptova që vetë po qante pa zë. Kur arriti në ajetin me kuptim: “(Jakubi) **tha: ‘Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut e nga**

⁸⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/59.

⁸⁶. Bejheki, *Shuabu’l-Iman*, 1/489 (789).

Allahu di atë që nuk e dini ju.” (Jusuf, 12/86) – të sures “Jusuf”, nuk vazhdoi dot më tutje, kështu që u ul në ruku.”⁸⁷

E qara e Osmanit (r.a.)

E tregon skllavi i liruar i Osman bin Afanit (radijallahu anhu), Haniu: “Osmani (radijallahu anhu), kur shkonte te koka e ndonjë varri, qante; aq shumë qante, saqë mjekra i lagej e tëra në lot. E pyesnin:

- “Po ti, nuk qan kur kujtohet Xheneti dhe Xhehenemi dhe qan kur të kujtohet varri?” E ai u përgjigjej:

- “Unë kam dëgjuar se Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë: *“Varri është vendmbërritja e parë e jetës së përtejme. Për atë që kalon nga ky vendbanim i parë dhe shpëton, pjesa tjetër është më e lehtë. Kurse për atë që nuk shpëton dot aty, tërë vendet e tjera janë shumë të vështirë e plot e përplot me mundime.”*⁸⁸

E qara e Abdullah bin Omerit

Ja se si e transmeton këtë cilësi të Abdullah bin Omerit (radijallahu anhu) Kasim bin Ebi Bezeja: “Një burrë që e kishte dëgjuar Ibni Omerin (radijallahu anhu) duke kënduar Kur’an, më pati thënë mua:

- “Një ditë, Abdullah bin Omeri nisi të lexojë suren “Mutaf’fifin”, lexoi ajetin: **“Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?”** (Mutaf’fifin, 83/6) – qau dhe u ul në sexhde për një kohë të gjatë e nuk vazhdoi më më tej.”⁸⁹

Nafiu (radijallahu anhu) tregon se: “Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu), çdoherë që do të lexonte ajetin kur’anor me domethënie: **“Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Edhe nëse e tregoni apo e fshihni çfarë keni në shpirtin tuaj, Allahu do t’ju kërkojë llogari për të. Kështu, Ai do të falë kë të dojë dhe do të dënojë kë të dojë. Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”** (Bekare, 2/284) – do të fillonte të qante dhe thoshte: “Kjo zbardhja e gjithë

⁸⁷. El-Hindi, *Kenẓul-Ummal*, 12/797 (35795).

⁸⁸. Ibn Maxhe, *Sünen*, 2/1426 (4267).

⁸⁹. Ebu Nu’ajm, *Hiŧje*, 1/305.

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij veprave e sjelljeve sheshit nuk ka dyshim që paskësh për të kaluar shumë ashpër.”⁹⁰

21. LLOGARIA ME VETEN

Tregon Thabit bin Haxhaxhi: “Omeri (radijallahu anhu) njëherë ka thënë:

- “Peshojini punët tuaja para se ato të peshohen atje, e kërkojini llogari vetes suaj, para se t’ju kërkohet llogari atje. Ta vësh veten përpara llogarisë këtu është shumë më e lehtë sesa llogaridhënia atje. Përgatituni për atë ditë të madhe me devotshmëri e me sa më shumë punë të mira. Po, po, sepse ajo është një ditë e atillë, për të cilën Allahu thotë kështu: **“Atë Ditë do të mbeteni të zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur.”** (Hak’ka, 69/18)⁹¹

22. KONTROLLIMI I GJUHËS DHE HESHTJA

Heshtja e të Dërguarit të Allahut

Tregon Ebu Malik el-Eshxheiu: “Kur ishim fëmijë, ne uleshim pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Kurrë nuk kam parë ndonjëherë njeri që të fliste më pak sesa ai. Madje, edhe kur ndodhte që sahabët e tij të flisnin e ta zgjatnin shumë fjalën e tyre, Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) vetëm buzëqeshte.”⁹²

Ose fol për mbarë, ose hesht

Tregon Ubade bin Samiti: “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i hipi devesë dhe bashkë me sahabët e tij dolën për rrugë. Asnjë nga sahabët nuk ia lejonte vetes që të kalonte përpara tij. Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) tha:

- “O i Dërguari i Allahut! Unë lus Zotin që ne të na e marrë jetën përpara teje. Qoftë sa më larg ajo ditë, por ne çfarë adhurimesh do

⁹⁰. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/305.

⁹¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/52.

⁹². Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/372.

të bëjmë, nëse vdes ti? Bie fjala, çfarë të bëjmë ne, të luftojmë e të përpiqemi në rrugën e Allahut?”

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- “*Të luftuarit dhe të përpjekurit në rrugën e Allahut është një punë shumë e mirë, mirëpo, ka edhe diçka tjetër, e cila është edhe më e bukur e më e mirë për njerëzit!*” Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) e pyeti:

- “Cila është ajo, o i Dërguari i Allahut, agjërimi dhe sadakaja?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) iu përgjigj:

- “*Edhe agjërimi me lëmoshën janë punë shumë të mira e të virtyshme; vetëm se ka diçka që është edhe më e virtyshme se këto të dyja.*” Muadhi e dëgjoi dhe filloi të numërojë gjithë punët e mira që dinte vetë. I Dërguari i Allahut i përgjigjej duke i thënë se kishte diçka që ishte edhe më e epërme se ajo. Gjersa, më në fund, Muadhi pyeti:

- “O i Dërguari i Allahut! E çfarë mund të jetë tjetër, që të jetë më e hairit për njerëzit?” I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i bëri me shenjë te goja dhe i foli:

- “*Të beshtësh dhe kur të flasësh, të mos thuash asgjë veç të mirës.*” Muadhi tha:

- “O i Dërguari i Allahut, po pse edhe për atë çfarë na flet goja jemi përgjegjës ne?”

Profeti ynë i dashur e rrahu me pëllëmbë te gjuri dhe i tha:

- “*Të dhëntë Zoti të mira!*”, – dhe, ndër të tjera, i tha Muadhit, – “*A ka ndonjë gjë që i hedh më së shumti njerëzit buzëehundë në zjarr të Xhehenemit sesa gjuha e tyre. Kushdo që i beson Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ose të flasë për mbarë për të mirën, ose të beshtë. Flisni gjëra të mira e të mbara, që t'ia shihni të mirën gjuhës suaj, e që të mund t'u qëndroni sa më larg e të jeni të sigurt e të mbrojtur prej të këqijave.*”⁹³

23. SI FLISTE I DËRGUARI I ALLAHUT?

Tregon Aishja (radijallahu anha): “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) fliste duke i thënë fjalët një e nga një e me ngadalë. Nëse do të ngrihej ndokush, për t'i numëruar ato që thoshte ai, ai do

⁹³. El-Hakim, *Mustedrek*, 4/319 (7774).

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

ta kishte të lehtë të numëronte madje edhe shkronjat e fjalëve të tij. Ai nuk fliste kurrë shpejt dhe duke u ngutur.”⁹⁴

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, i cili ka thënë:

- “Unë u dërgova me Fjalën e thukët. Unë jam i privilegjuar nga e mira e të shkaktuarit frikë që së largu tek armiku im. Dhe, teksa flija, mua m'u dhanë në duart çelësat e gjithë thesareve të mbarë botës.”⁹⁵

I Dërguari i Allahut buzëqeshte gjithnjë

E tregon Aishja (radijallahu anha): “Unë nuk e kam parë kurrë të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) të qeshë me të madhe, sa t'i duken mishrat e dhëmbëve. Ai vetëm buzëqeshte gjithnjë.”⁹⁶

Tregon Amreja (radijallahu anha): “E pyeta Aishen (radijallahu anha), se si sillej i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kur qëndronte vetëm për vetëm me gratë e tij. Aishja (radijallahu anha) më tha:

- “Ai sillej njësoj siç sillen edhe burrat tuaj me ju. Vetëm se ai ishte njeriu më i dashur e më bujar në mbarë njerëzimin. Ai rrinte gjithnjë i buzëqeshur dhe kurrë nuk e shihje të mos i qeshte fytyra.”⁹⁷

Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) tregon se: “I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) na tha:

- “Unë i njoh ata që do të dalin të fundit fare prej Xhebenemit. Atij që do të dalë i fundit së andejmi duke u zvarritur do t'i thuhet: 'Eja, hyr në Xhenet!' dhe ai njeri do të bëjë përpara zvarrë. Kur i sheh banorët e Xhenetit, të gjithë nëpër vendet e veta, kthehet pas dhe thotë: 'Po njerëzit e paskan mbushur vendin në Xhenet dhe nuk paska fare vend për mua.' Atë e pyesin: 'A të kujtohet se si jetoje ti në jetën e asaj bote?' 'Po!', – përgjigjet ai. 'Atëherë, kërko ç'të duash, sa të duash, kërko.' Dhe ai fillon të kërkojë ato që do. Në fund atij i thuhet: 'Të është dhënë dhjetëfishi i asaj që kërkoje ti.' Por, ai nuk e beson dhe plot dyshim thotë: 'Ç'bëni, po talleni me mua, po pse tallat me njeriun Ai që është Mbreti i botëve?'

⁹⁴. Buhari, *Sahib*, 3/1307 (3374).

⁹⁵. Buhari, *Sahib*, 3/1087 (2815).

⁹⁶. Muslim, *Sahib*, 2/616 (899).

⁹⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/44; Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 1/91.

Kur e tregoi këtë i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), qeshi; ishte hera e parë që e shihja teksa qeshte aq sa t'i dukeshin dhëmballët.”⁹⁸

I Dërguari i Allahut qesh me sjelljen e një burri të varfër

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Erdhi një burrë te Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i tha:

- “O i Dërguari i Allahut, unë mora fund! Unë pata marrëdhënie me gruan time gjatë muajit të Ramazanit.”

- “*Tani ti duhet të lirosb një skllav.*”, – iu përgjigj i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).

- “Po unë nuk kam mundësi të paguaj për një skllav.”, – u përgjigj ai burrë.

- “*Atëherë do të agjërosh për dy muaj me radhë, pa ndërprerje!*”, – foli i Dërguari i Allahut.

- “Po unë as për këtë nuk kam fuqi, o i Dërguari i Allahut!” E dëgjoi i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe kësaj here e këshilloi:

- “*Mirë, atëherë, do t’u japësh gjashtëdhjetë vetëve për të ngrënë.*”

- “Po unë as kësaj nuk ia dal dot, o Resulullah!”, – u përgjigj ai. Të Dërguarit të Allahut i sollën një shportë me hurma të thata.

- “*Ku është ai burrë që erdhi për të më pyetur?*”, – pyeti i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), – dhe i tha atij:

- “*Merri këto hurma dhe shpërndaji si lëmoshë për të varfrit.*”

- “Po a ka në Medinë njeri më të varfër se unë; gjithë ç’ka midis këtyre dy maleve shkëmborë, shtëpi më të varfër se e imja nuk ka!” I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), në fund, kur dëgjoi edhe këtë përgjigje nga ai burrë, qeshi, aq sa iu dukën paksa dhëmballët. Në fund fare, Resulullahu atij njeriu it ha:

- “*Mirë atëherë, t’i hani ju vetë ato hurma.*”⁹⁹

⁹⁸. Muslim, *Sahib*, 1/173 (309).

⁹⁹. Buhari, *Sahib*, 5/2260 (5737).

24. MADHËSHTIA

Madhështia e të Dërguarit Fisnik të Allahut

E përshkruan Harixhe bin Zejdi (radijallahu anh): “I Dërguari i Allahut ishte njeriu më fisnik mes të gjithë atyre që gjendeshin në ndonjë kuvend me të. Ai ruhej që të mos i shfaqej asnjë pjesë e trupit që nuk duhej të shfaqej. Ai përpiquej që të ishte gjithmonë sa më serioz dhe krenar përpara njerëzve.”¹⁰⁰

Fisnikëria e Muadh bin Xhebelit

E tregon Ebu Muslim el-Haulanij: “Një ditë hyra në xhaminë e Humusit, kur brenda pashë të ulur rreth tridhjetë burra të moshuar, të cilët ishin nga sahabët e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Në mes tyre ishte edhe një djalë i ri; sytë i kishte të lyer, kurse dhëmbët i shkëlqenin. Nuk fliste, por vetëm qëndronte ashtu i heshtur. Bashkësia, kur kishte ndonjë gjë të dyshimtë, së cilës i druhej, atë pyesnin. Pyeta dikë që ishte pranë meje:

- “Po ky djalë i ri, kush është?”

- “Ai është Muadh bin Xhebeli.”, – më tha ai. Në atë kohë, aq shumë m’u ngroh zemra ndaj atij njeriu, sa që nuk u ndava prej aty, derisa ata u shpërndanë.”¹⁰¹

25. TË QENËT XHELOZ PËR HIR TË ALLAHUT

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: “Sa’d bin Ubadeja (radijallahu anhu) pati thënë kështu:

- “Nëse gjej ndonjë burrë pranë gruas sime, nuk e prek dot unë atë burrë me dorë pa sjellë më parë katër dëshmitarë?”

- “*Nuk e prek dot!*”, – u përgjigj i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).

- “Po unë nuk e duroj dot diçka të atillë. Unë i betohem Allahut, që të ka dërguar ty me fenë e së drejtës dhe të së vërtetës, se unë e vras atë

¹⁰⁰. Kadi Ijad, *Shifa*, 1/110.

¹⁰¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/231.

njeri pa pritur që të gjej edhe katër dëshmitarë.” I Dërguari i Allahut, duke pasur parasysh Sa’din, tha:

- “*Dëgjojeni këtë që ju thotë prijësi juaj. Unë jam më xheloz se Sa’di dhe Allahu është edhe më xheloz se sa unë...*”¹⁰²

Aishja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), një natë, u largua nga unë dhe unë u bëra shumë xheloze për të. Kur u kthye sërish, e kuptoi atë që po ndieja unë dhe më tha:

- “*Ç’të ka gjetur kështu, moj Aishe, u bëre xhelozë?*”

- “Po, natyrisht, o i Dërguari i Allahut! Pse, a nuk bëhet një si unë xheloze për një si ti!”

- “*Ty të paska ardhur sërish djalli.*”

- “Çfarë është kjo, pse paskam edhe unë djall, o i Dërguari i Allahut?”

- “*Po!*”, – m’u përgjigj i Dërguari i Allahut.

- “Po ti, a ke shejtan?”, – e pyeta dhe ai m’u përgjigj duke më thënë:

- “*Po, kam pasur, por mua më ndihmoi Allahu dhe më në fund, ai u dorëzua para meje.*”¹⁰³

26. TË URDHËROSH PËR MIRË DHE TË BËHESH PENGESË PËR TË KEQEN

**Shkalla në Xhenet e atyre që kryejnë detyrën e
të urdhëruarit për mirë dhe të të qenët pengesë për të keqen**

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha kështu: “*A doni tu flas për ata njerëz, të cilët, megjithëse nuk janë as profetë e as dëshmorë, ditën e Kiametit do të ulen mbi minberë drite dhe për shkallën e tyre tek Allahu do t’i admirojnë edhe profetët dhe dëshmorët?*”

- “Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut?”, – e pyetën. I Dërguari i Allahut foli:

¹⁰². Muslim, *Sabih*, 2/1136 (1499).

¹⁰³. Muslim, *Sabih*, 4/2168 (2815).

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

- “Janë ata që ia bëjnë Zotin të dashur njerëzve dhe njerëzit të dashur për Zotin. Ata lëvizin nëpër botë, për t’i këshilluar njerëzit dhe për të bërë mirë për ta.” I thanë të Dërguarit të Allahut:

- “O i Dërguar! E kuptuam, që ata ua bëjnë njerëzve Zotin të dashur, por kjo, që t’i bësh Zotit të dashur njerëzit, si ndodh kjo, a mund të na e shpjegosh?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “Ata i urdhërojnë njerëzit që të bëjnë ato gjëra që i do më së shumti Allahu, si dhe u bëhen atyre pengesë dhe ua ndalojnë kryerjen e atyre gjërave që nuk i do Allahu. Dhe, kur ata njerëz u binden dhe i ndjekin me përpikëri gjërat e predikuara prej tyre, Allahu i do ata.”¹⁰⁴

I Dërguari i Allahut i paralajmëron të gjithë, që të mos tregohen të dobët në urdhërimin e së mirës dhe në pengimin e së keqes

Sipas një transmetimi të Muadh bin Xhebelit (radijallahu anhu), Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ka thënë:

- “Për sa kohë që në mesin tuaj nuk shfaqen dy dehjet; dehja nga injoranca dhe dehja nga dashuria për jetën e kësaj bote, ju do të vazhdoni të jeni pjesë e fesë që ju vjen prej Zotit tuaj, sepse, për sa kohë që do të jeni të këtillë, ju do t’i urdhëroni njerëzit për mirë, do t’i pengoni ata nga rënie tek e keqja dhe do të luftoni në rrugën e Allahut. Por, nëse ndodh e në mesin tuaj zë të lindë dashuria për jetën e kësaj bote, atëherë, ju as nuk do të urdhëroni më për të mirën, e as nuk do të bëheni më pengesë për të keqen, e aq më pak do të luftoni në rrugën e Allahut. Ja pra, ata që do të përfaqësojnë Kur’anin dhe Sunetin atë ditë do të jenë njësoj si muhaxhirët dhe ensarët e parë, të cilët garonin me njëri-tjetrin se kush do të bënte më shumë të mira.”¹⁰⁵

Po i njëjti paralajmërim edhe nga ana e Ebu Bekrit (r.a.)

Tregon Kajs bin Ebi Hazimi: “Ebu Bekri (radijallahu anhu), atë

¹⁰⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/155 (5565).

¹⁰⁵. Hejthemî, *Mexbmen’-Zeuaid*, 7/533 (12159).

ditë që mori titullin e të qenët ‘kalifi i të Dërguarit të Allahut’, u ngjit në minber dhe pasi lëvdoi Allahun, tha këto fjalë:

- “O njerëz! Ju e lexoni ajetin kur’anor: **“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmërojë për atë që keni punuar.”** (Maide, 5/105); por ju nuk e kuptoni atë duke e përthithur tërë domethënien e qëllimit për të cilin u zbrit, sepse unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), i cili tha:

- *“Në kohën që njerëzit nuk do të bëhen pengesë e së keqes e do të mbyllin njërin sy ndaj të këqijave, ajo do të thotë se është shumë e afërme koha kur Allahu do t’i ndëshkojë të tërë njerëzit.”*¹⁰⁶

Kur do ta braktisë umeti i Muhamedit detyrën e urdhërimit për të mirën dhe të pengimit të së keqes?

E tregon Hudhejfeja (radijallahu anhu): “Njëherë unë e pyeta Profetin tonë të dashur (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Resulullah! Kur do të braktiset ajo që është detyra më e parë e besimtarëve që janë të devotshëm, urdhërimit të së mirës dhe pengimin e të këqijave? Profeti ynë m’u përgjigj:

- *“Atëherë kur të ndodhë edhe me ju ajo që u ndodhi hebrenjve.”*

- “O Resulullah! Po pse, çfarë u ndodhi hebrenjve?”, – e pyeta unë sërish të Dërguarin e Allahut dhe ai m’u përgjigj duke më thënë:

- *“Kur ata që janë më të mirët ndër ju fillojnë të sillen si dallkaukë me ata që janë të prishur e të këqij; kur dija e fesë të bjerë në duart e njerëzve qëllimkëqij; kur shteti dhe udhëheqja juaj të mbetet në duart e më të vegjëlve, ja, në atë kohë ju do t’ju rrethojnë anekënd ngatërresat dhe mosmarrëveshjet. Ju do të sulmoni anën matanë, e do t’ju kthebet përgjigje po duke ju sulmuar.”*¹⁰⁷

¹⁰⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1215 (8443).

¹⁰⁷. Hejthemî, *Mexbheu’Zenaid*, 7/560 (12238).

27. RRUGA E NDJEKUR NGA I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ DREJT MARTESËS

Martesa e Profetit tonë të dashur me Hatixhen (r.a.)

E tregon Nefijseja: “Hatixheja, e bija e Huejlidit, jo vetëm ishte shumë e pasur, por ishte edhe një grua serioze, krenare, e bukur dhe fisnike. I përkiste njërës prej familjeve më të fisme e më të pasura të kurejshëve. Gjithë meshkujt e atij populli ëndërronin të martoheshin me të; madje, ata ishin të gatshëm ta falnin tërë pasurinë e tyre, vetëm e vetëm për të lidhur një martesë të tillë. Kurse Muhamedi (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) asokohe merrej me tregti. Edhe Hatixheja kishte dërguar karvanin e saj drejt Sirisë. Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u kthye nga Siria dhe Hatixheja më dërgoi mua fshehtazi që ta njoftoja atë për ca lajme të reja. Shkova dhe i thashë:

- “O Muhamed, po pse nuk martohesh?”

- “*Po unë nuk kam asgjë, me çfarë të martohem?*”, – u përgjigj ai.

- “Po nëse unë do të të thosha se një grua shumë e bukur, me pasuri e plaçkë të shumtë, gjithashtu edhe e fisme dhe e dashur po sa edhe ti, do të donte të martohesh me ty, pa të kërkuar gjë prej gjëje, a do të pranoje të martohesh?”

- “*E kush qenka kjo grua?*”, – m’u përgjigj ai duke më pyetur.

- “Hatixheja!”, – iu përgjigja unë.

- “*Po si do të bëhet kjo punë?*”, – pyeti ai dhe unë ia ktheva, duke i thënë:

- “Ma lër mua në dorë.”, – çka e bëri të pranojë. Sakaq, unë u shkova e njoftova menjëherë Hatixhen. Edhe Hatixheja i dërgoi fjalë xhaxhait të saj dhe të të Dërguarit të Allahut, Amr bin Esedit, që ‘në filan orë të ishte në filan vend.’ Palët u përgatitën dhe në kohën e vendin e caktuar ishin të gjithë atje. Muhamedi (pajja e Zotit qoftë mbi të) erdhi bashkë me xhaxhallarët. Si krushk ishte vetëm njëri prej tyre. Xhaxhai i Hatixhes, Amri, tha:

- “Ky djalosh është më i përshtatshmi për vajzën tonë; është një djalë që nuk mund të mos e pranosh.” Në kohën që Resulullahu

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u martua me Hatixhen (radijallahu anha), ai ishte njëzet e pesë vjeç, kurse Hatixheja ishte dyzet vjeçe; Hatixheja kishte lindur pesëmbëdhjetë vjet para Ndodhisë së Elefantit.”¹⁰⁸

Martesa e Profetit tonë me Aishen (r.a.)

Tregon Aishja (radijallahu anha): “Ne erdhëm nga Meka në Medinë. Aty u strehuam në një prej shtëpive të fisit të bijve të Harith bin el-Hazrexhit në Sunuh. Një ditë në shtëpinë tonë erdhi Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Po në atë kohë, nëna ishte duke më lëkundur mua në një kolovajzë që e kishim sajuar me dy litarë të varur në degët e dy pemëve të hurmave. Kur hyri në shtëpi i Dërguari i Allahut, nëna më zbriti mua nga kolovajza, më rregulloi flokët, të cilat më derdheshin supeve, ma pastroi fytyrën me pak ujë, pastaj më kapi përdore dhe më çoi deri te dera. Ngaqë isha e lodhur me zor merrja frymë. U qetësova pak, pastaj erdhi nëna, më mori dhe më futi brenda. Ç'të shihja! Brenda ishte Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë me të), ishte ulur mbi një nim. Rreth Profetit tonë të dashur qëndronin të ulur burra dhe gra të ensarëve. Nëna më futi mua menjëherë në një dhomë tjetër dhe më tha:

- “Këta janë të afërmit dhe kushërinjtë e tu. Zoti ju bëftë të bekuar, ty për ta dhe ata për ty.”

Miqte nuk qëndruan gjatë, por u ngritën dhe u larguan shpejt. Në dasmën time nuk u ther as deve, as dele. Vetëm një nga të mëdhenjtë e ensarëve, Sa'd bin Ubadeja (radijallahu anhu), pati dërguar një enë të madhe me ushqim. Sa'd bin Ubadeja (radijallahu anhu) e kishte kthyer në zakon, që t'u çonte vazhdimisht ushqim edhe grave të tjera të Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Atë ditë që u martova me të Dërguarin e Allahut unë isha një vajzë nëntëvjeçare.”¹⁰⁹

Në transmetimin e Ahmed bin Hanbelit thuhet se dorën e Aishes (radijallahu anha) e kishin kërkuar më parë edhe për djalin e Mut'im bin Adijit, por kur nisi të bëhej fjalë për Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), pra, fakti që nëna e saj Umu Rumani e pati prishur fjalën,

¹⁰⁸. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 1/131.

¹⁰⁹. Hejthemî, *Mexhmu'at-Zenaid*, 9/363 (15286).

duke shprehur frikën se djali i Mut'imit ishte një idhujtar tregon se në atë kohë mosha e Aishes (radijallahu anha) nuk ishte më e vogël se nëntë vjeçe, apo që ajo e kishte arritur moshën për t'u martuar.¹¹⁰ Veç kësaj, duhet të theksojmë se në Gadishullin Arabik, mosha e martesës është shumë më e hershme sesa mund të jetë në vende të tjera, të cilat kanë një klimë më të ftohtë.

Martesa e Xhulejbibit, një prej sahabëve

Ebu Berzete'l-Eslemiu (radijallahu anhu) tregon: "Ishte dikush, të cilin e quanin Xhulejbib; shkonte te gratë dhe bënte shaka me to. I thashë gruas sime:

- "Nuk do ta pranosh më Xhulejbibin që t'ju afrohet. Nëse e shoh edhe njëherë afër jush, ta dini se do të bëj njërën." Asnjë nga ensarët nuk i martonte vajzat që kishin arritur moshën e martesës, pa u këshilluar njëherë me Resulullahun. Një ditë, Profeti ynë i tha njërit prej ensarëve:

- "*Ma jep mua vajzën tënde.*"

- "Në rregull, o Resulullah. Ky është një nder shumë i madh për mua", – u përgjigj ai menjëherë, por Resulullahu shtoi:

- "*Po unë nuk e dua atë për vete.*"

- "Po për kë, o i Dërguari i Allahut?", – pyeti ai. Resulullahu i tha:

- "*E dua për Xhulejbibin.*"

- "Epo, të këshillohem njëherë me nënën e vajzës.", – tha ai burrë dhe u largua.

E shoqja, kur po dëgjonte fjalët e të Dërguarit të Allahut, që po i transmetonte i shoqi, i tha atij:

- "Po, patjetër, e ku ka nder më të madh se ky!"

- "Po nuk e do për vete! Do të hyjë si krushk për Xhulejbibin.", – e sqaroi ai të shoqen.

- "Për Xhulejbibin? Për Xhulejbibin? Jo, për Zotin, unë nuk ia jap vajzën atij njeriu."

¹¹⁰. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/210 (25810).

Në kohën që ai ensar u ngrit të shkonte tek i Dërguari i Allahut, për t'i bërë të ditur qëndrimin e së shoqes, vajza e tyre u tha:

- “Kush ka hyrë krushk tek ju, për të më martuar mua?” Dhe e ëma ia tregoi se si qëndronte puna, por vajza vazhdoi të thoshte:

- “E çfarë po bëni ju, nuk po pranoni fjalën e Resulullahut? Ju më lini më mirë në dorë të Resulullahut, ai nuk lejon që unë të poshtërohem.” Atëherë, babai i vajzës shkoi te Resulullahu; i bëri të ditur përgjigjen e vetë vajzës, duke i thënë:

- “Vajza ime jua la juve në dorë, që të vendosni për të.” Kësisoj, i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e martoi atë vajzë me Xhulejbibin. Pas njëfarë kohe, Resulullahu u nis në një luftë. Në këtë luftë që u mbyll me fitoren e myslimanëve, Allahu i fali shumë plaçkë e pasuri të luftës Profetit të Tij. Teksa do të ktheheshin, ai i pyeti sahabët:

- “*A vëreni që ju mungon ndonjë prej shokëve tuaj?*”

- “Jo!”, – iu përgjigjën ata.

- “*Mirë, po unë nuk po e shoh Xhulejbibin gjëkund, dilni e kërkojeni.*” Sahabët dolën menjëherë të kërkonin. Xhulejbibin e gjetën, kishte rënë dëshmor në mes të shtatë idhujtarëve të vrarë. Shkuan tek i Dërguari i Allahut dhe i thanë:

- “O Resulallah! Ja tek është, ka vrarë shtatë vetë dhe vetë ka rënë dëshmor.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u afrua dhe tha:

- “Ka vrarë shtatë vetë dhe është vrarë edhe vetë prej tyre! Xhulejbibi është i imi dhe unë jam i Xhulejbibit.”, – dhe, pasi e përsëriti dy a tri herë këtë fjalinë e fundit, dha urdhër që të hapnin një varr. Kur u hap gropa e varrit, ai e mori trupin e pjetë të Xhulejbibit dhe e uli vetë në tokë.

Is'hak bin Abdullahu thotë se: “Unë e pyeta Thabit el-Bunaniun:

- “A e di ti se si u lut i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) për gruan e Xhulejbibit?”

- “Po, ‘O Zot! Lëshoje me rrebeshe të mirën dhe begatinë Tënde mbi këtë grua, e mbaji larg vështirësitë prej jetës së saj.’, – ja kështu u

lut.” – tha ai. Dhe vërtet, grua të ve që punët t’i kenë shkuar aq mirë e mbarë sa ç’i shkoi jeta asaj gruaje, askush nuk ka parë në mesin e ensarëve.”¹¹¹

**Omeri (r.a.) e ndalon dhënien e mehrit me tepri ndaj grave,
por më vonë e anulon sërish urdhrin e tij, kur një grua ankohet**

Tregon Mesruku: “Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) u ngjit mbi minber dhe tha:

- “O njerëz, këtej e tutje të mos dëgjoj më për njeri, që të japë mehr më të madh se katërqind dërhëmë, sepse as Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), as sahabët e tij nuk kanë dhënë ndonjëherë mehr më të madh sesa katërqind dërhëmë. Po të kishte ndonjë kriter devotshmërie dhe virtyti në dhënien e mehrit para martese, nuk ka dyshim se ju kurrresi nuk do t’ia arrinit dot atyre.” – dhe zbriti nga minberi. Një grua nga fisi i kurejshëve e pati dëgjuar fjalën e Omerit (radijallahu anhu) dhe me të parë se Omeri (radijallahu anhu) përfundoi fjalën e tij, u hodh dhe e kundërshtoi:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Ti ua ndalove burrave që të japin mehr prej katërqind dërhëmësh për gratë e tyre, apo jo?”

- “Po!”, – tha Omeri (radijallahu anhu).

- “Po mirë, ti nuk e ke lexuar që në librin e Tij Allahu thotë: **“Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua, duke e lëshuar njërën për të marrë një tjetër, asaj që i keni dhënë pasuri, mos i merrni nga ajo (pasuri) asgjë. A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjynah të qartë?!?”** (Nisa, 4/20)

- “O Zot, më fal.” – tha menjëherë Omeri (radijallahu anhu), një të dëgjuar kundërshtimin e asaj gruaje, – “Të gjithë e dinë fenë më mirë se Omeri!”, – dhe u kthye pas, për t’u ngjitur edhe njëherë në minber, që t’u thoshte atyre:

- “Besimtarë! Unë jua ndalova që të jepni mehr më të madhe se katërqind dërhëmë; sapo kuptova se ky vendim nuk është i drejtë. Andaj, kushdo mund të japë mehr sa të dojë.”¹¹²

¹¹¹. Hejthemi, *Mexhmu’-Zeuaid*, 9/913 (15977).

¹¹². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/761 (45798).

28. I DËRGUARI I ALLAHUT DHE BURRAT E FAMILJES SË BEKUAR IA KALONIN SHUMË MIRË ME GRATË DHE FËMIJËT E TYRE

Marrëdhënia shumë e mirë që kishte i Dërguari i Allahut me Aishen (r.a.)

Tregon vetë Aishja (radijallahu anha): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) po qëndronte ulur, kur dëgjoi një zhurmë. Pa njëherë se çfarë kishte ndodhur, kur pa abisinasit, të cilët po kërcenin; rreth tyre ishin mbledhur njerëzia, për të ndjekur vallen e tyre. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i tha Aishes:

- “*O Aishe, eja edhe ti, të shikosh, po deshe.*” Unë vura faqen mbi supin e Resulullahut; nga supet u përpoqa të shihja kokën e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). I Dërguari Fisnik më pyeti:

- “*Ende nuk u ngope?*”, – dhe unë, për të kuptuar se sa vlerë kisha unë për të, i thashë:

- “Jo!” Atëherë pashë, që, me sa dukej i ishin lodhur këmbët teksa shikonte njerëzit që po hidhnin valle, sepse ndërroi këmbët. Kur, sa hap e mbyll sytë ia behu Omeri dhe të gjithë u shpërndanë; fëmijët të parët. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Pashë shumë djaj njerëzorë edhe prej xhindeve, që ia mbathën prej Omerit.*”¹¹³

Një ngjarje e Profetit tonë me gratë e tij, në lidhje me ndarjen prej tyre

Xhabiri (radijallahu anh) tregon: “Sahabët po qëndronin të ulur pranë portës së të Dërguarit të Allahut, kur aty erdhi Ebu Bekri (radijallahu anhu). Kërkoi leje për t’u takuar me të Dërguarin Fisnik. Nuk i dhanë leje. Pastaj erdhi Omeri (radijallahu anhu), i cili kërkoi leje, por as atij nuk iu lejua që të hynte. Mandej, kur iu dha leje të dyve dhe u pranuan brenda. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk fliste fare, kurse gratë i qëndronin përreth. Omeri (radijallahu

¹¹³. Tirmidhi, *Sunen*, 5/621 (3691).

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

anhu), duke dashur që ta gëzonte pak të Dërguarin e Allahut, e filloi kështu fjalën:

- “O Resulullah! (Duke pasur parasysh gruan e tij) Ta kishe parë njëherë vajzën e Zejdit! Më kërkoj para dhe unë një të goditur i dhashë!” I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) qeshi sa iu dukën edhe dhëmbët dhe foli:

- “Edhe këto gratë këtu rreth meje duan të njëjtën gjë nga unë.” Atëherë Ebu Bekri me Omerin (radijallahu anhum) një të vërsulur bënë, që të qëllonin secili vajzën e vet, Aishen dhe Hafsanë (radijallahu anhum). Të dy thanë të njëjtat fjalë:

- “Domethënë ju doni prej Resulullahut ato gjëra që s’i ka, hë?”

I pengoi i Dërguari i Allahut. Pas kësaj, gratë thanë kështu:

- “Uallahi, këndeje e tutje ne të Dërguarit të Allahut nuk do t’i kërkojmë më asgjë, mundësitë e së cilës ai nuk i ka!”

Më vonë, Allahu zbriti ajetet lidhur me ndarjen dhe qëndrimin e grave të Profetit. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kumtimit të atyre ajeteve ia nisi prej Aishes (radijallahu anha):

- “O Aishe! Unë do të të bëj një propozim; por mos vendos pa u këshilluar njëherë me nënën dhe babanë tënd.”

- “E ç’është ky propozim?”, – pyeti Aishja (radijallahu anhu). Atëherë, i Dërguari i Allahut i këndoi asaj ajetin: - **“O i Dërguar! Thuaju grave tuaja: ‘Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t’ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t’ju lëshoj si është më mirë.’”** (Ahzab, 33/28)

Aishja (radijallahu anhu) iu përgjigj me fjalët:

- “Me një fjalë unë do të këshillohen me nënën dhe babanë për t’u ndarë prej teje? Jo, kurrën e kurrës, unë zgjedh Allahun dhe të Dërguarin e Tij. E vetmja kërkesë që kam prej teje, është që të mos u flasësh grave të tjera për zgjedhjen që bëra unë.”

I Dërguari i Allahut e dëgjoi Aishen (radijallahu anhu) me vëmendje, pastaj i tha:

- “*Allahu nuk më dërgoi mua si të ashpër e fyes për njerëzit, por si një njeri që i edukon dhe ua lehtëson njerëzve gjërat. Mos më kërko mua që ta fsheh zgjedhjen tënde. Nëse ato më pyesin mua se farë zgjodhe ti, unë patjetër që do t’ua tregoj.*”
Aishja (radijallahu anhu) thotë se:

- “I Dërguari i Allahut, të njëjtin propozim shkoi dhe ua bëri edhe grave të tjera një e nga një. Dhe secila prej tyre i dha po atë përgjigje që i kisha dhënë edhe unë.”¹¹⁴

29. QËNDRIMI QË MBANTE I DËRGUARI I ALLAHUT ME FËMIJËT

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Unë nuk kam parë ndonjëherë njeri më të dhembshur me fëmijët se i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Në njërën prej lagjeve të sipërme të Medinës banonte një prej mëndeshave të Ibrahimit, djalit të të Dërguarit të Allahut. Shkonte bashkë me të atje, hynte në shtëpinë e saj dhe i ndizte vatrën. Burri i mëndeshës ishte hekurpunues. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) përqafonte Ibrahimin, e puthte, pastaj ktheheshim pas.”¹¹⁵

Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Kur i pashë Hasanin dhe Husejnin të hipur mbi supet e të Dërguarit të Allahut, u thashë atyre:

- “Mbi ç’shpinë të mirë që paskeni hipur kështu!” Kurse i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) më dha këtë përgjigje:

- “*Po shumë të bukur janë edhe ata që kanë hipur!*”¹¹⁶

30. INTERESIMI I PROFETIT NDAJ PROBLEMEVE TË BASHKËSHORTEVE TË SAHABËVE

Tregon Abdullah bin Amri: “Babai më martoi mua me dikë nga kurejshët. Kur hyri nusja në shtëpi, duke qenë se unë isha shumë i dhënë pas adhurimeve dhe agjërimit, nuk gjeja dot shumë mundësi për t’u kujdesur për gruan e re. Amr bin Asi (radijallahu anhu) erdhi

¹¹⁴. Ibn Kethir, *Tefsir*, 3/481.

¹¹⁵. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/112 (12123).

¹¹⁶. Hejthemi, *Meaxhmu’-Zenaid*, 9/291 (15078).

te nusja e re dhe e pyeti:

- “Si i ke marrëdhëniet me burrin?”

- “Është njeri shumë i mirë; po që kur kam ardhur, ai nuk më ka prekur asnjëherë me dorë.”, – iu përgjigj ajo. Atëherë, babai më foli mua rëndë:

- “Po babai të martoi ty me një njeri të fisëm. Ti shih se ç'bërë!” Pastaj shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe iu ankua për mua. I Dërguari i Allahut dërgoi fjalë të shkoja tek ai. Vajta te Resulullahu dhe ai më tha:

- “*A agjëron gjatë ditës?*”

- “Po, agjëroj.”, – iu përgjigja unë.

- “*Po netët, i kalon duke adhuruar Zotin?*”

- “Po!”, – iu përgjigja prapë unë. I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) më tha mua:

- “*Unë nganjëherë agjëroj, nganjëherë jo. Fal namaz, por edhe fle; nuk i lë pas dore as gratë. Kushdo që braktis Sunetin tim, nuk është më me mua!*” Mandej më tha:

- “*Lexoje Kur'anin të plotë një herë në muaj.*”

- “Po unë mund të lexoj më shumë.”, – iu ankova unë.

- “*Lexoje të plotë një herë në dhjetë ditë.*”, – më tha atëherë.

- “Po unë mund të lexoj më tepër.”, – përsërita unë.

- “*Atëherë lexoje një herë në tri ditë Kur'anin të plotë*”, – tha ai. – “*dhe çdo muaj agjëro vetëm tri ditë.*”

- “Po unë mund të agjëroj më shumë.”, – i thashë unë. Derisa, në fund fare, më tha:

- “*Agjëro një ditë po e një ditë jo. Më i miri agjërim është agjërimi i vëllait tim Daudit.*”

Muxhahidi (radijallahu anhu) thotë se: “Në pleqëri Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) agjëronte disa ditë rresht, pastaj, për të fituar fuqinë e humbur nuk agjëronte për disa ditë të tjera. Edhe Kur'an, herë lexonte shumë, herë lexonte pak; por e lexonte të tërin të paktën një herë në tri a shtatë ditë. Abdullah bin Amri thoshte:

- “Ah sikur të mund të bëja atë që na pati lejuar i Dërguari i Allahut!

Ndoshta ajo do të ishte më e mirë për mua. Por unë nuk dua që ta shkel fjalën që i kam dhënë.”¹¹⁷

31. EDUKATA NË TË NGRËNË E NË TË PIRË E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ

Ebu Hurejreja tregon: “I Dërguari i Allahut nuk shprehte pakënaqësi për asnjë ushqim që i shtrohej në sofër. Nëse kishte uri e hante, nëse nuk kishte, atëherë nuk e hante atë.”¹¹⁸

Omer bin Ebi Selemi tregon: “Një ditë unë hëngra me të Dërguarin e Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të). Sa kisha filluar të haja prej mishit që ishte në anë të enës, kur ai më qortoi:

- “*Duhet të hash prej asaj që ke përpara.*”¹¹⁹

Tregon Umeje bin Ebi Mahshaja: “I Dërguari i Allahut pa që një burrë filloi të hante pa thënë ‘Bismil’lah’. Ai njeri vazhdoi të hajë, kur, në fund, kishte mbetur vetëm një kafshatë për t’u ngrënë dhe teksa po e fuste në gojë, tha: ‘Bismil’lahi euuelehu ue ahirehu’. I Dërguari i Allahut qeshi dhe tha:

- “*Për Zotin, djalli vazhdoi të hante tok me të. Por, kur tha ‘Bismil’lah’-in, gjithë ç’kishte në bark i nxori.*”¹²⁰

Këshilla e Aliut (r.a.) ndaj dikujt në lidhje me edukatën në të ngrënë e në të pirë

Ibn A’bedi tregon: “Aliu (radijallahu anhu) më pati thënë:

- “O Ibni A’bed, a e di ti se ç’është e drejta e ushqimit?”

- “Jo, ç’është kjo e drejtë?”, – e pyeta unë.

- “Të thuash ‘Bismil’lah’ dhe t’i lutesh Zotit duke thënë: “O Zot begatoji këto të mira që na ke falur!” Pastaj bëri këtë pyetje:

- “Po falënderimi për ushqimin, si bëhet?”

¹¹⁷. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/285.

¹¹⁸. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/40.

¹¹⁹. Muslim, *Sabih*, 3/1599 (2022).

¹²⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 15/686 (41686).

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

- “Si bëhet?”, – e pyeta unë. Do të thuash:

- “Falënderimet i takojnë Allahut që na jep ne për të ngrënë e për të pirë.”, – më tha ai.¹²¹

Fjala e Selmanit (r.a.) në lidhje me rrëskun e Zotit

E tregon Salimi, skllavi i liruar i Zejd bin Sauhanit: “Ne ishim në pazar, bashkë me zotërinë tim, Zejdin. Atje u takuam me Selman Farisiun. Kishte blerë dyqind a treqind kilogramë grurë. Zejdi i tha atij:

- “O Ebu Abdullah! Edhe ti e bën këtë? Po ti je nga sahabët e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem)?” E Selmani i dha atij këtë përgjigje:

- “Njeriu sikur gjen qetësi kur e siguron ushqimin e tij, shkon më me dashuri për ta adhuruar Zotin dhe i largohen gjithë ngacmimet e djallit.”¹²²

32. VESHJA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ

Abdurrahman bin Ebi Lejla tregon: “Isha bashkë me Omerin (radijallahu anhu); ai më tha mua:

- “E pashë Ebu’l-Kasemin (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kishte veshur një xhube siriane me thekë të ngushtë.”¹²³

Tregon Seleme bin Eku’ja: “Osman bin Afani vishte një pelerinë të gjatë deri te fundi i gjunjëve dhe thoshte:

- “Ja, të këtitllë e kishte pelerinën që vishte edhe më i Dashuri im, Profeti im.”¹²⁴

Xhabiri tregon: “Ditën që u ngadhënjye mbi Mekën, i Dërguari i Allahut doli në qytet me një çallmë të zezë në kokë.”¹²⁵

¹²¹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/153 (1312).

¹²². Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/200.

¹²³. Muslim, *Sahib*, 1/228 (274).

¹²⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 15/743 (41835).

¹²⁵. Muslim, *Sahib*, 2/990 (1358).

Tregon Ummu Selemeja: “Veshja më e dashur e të Dërguarit të Allahut ishte këmisha.”¹²⁶

Fjalët që thoshte i Dërguari i Allahut kur vishte ndonjë rrobë të re

Tregon Omeri (radijallahu anhu): “Kur vishte ndonjë rrobë të re i Dërguari i Allahut, e ajo rrobë i vinte deri te gjoksi, e kam parë vetë, që është lutur:

- “*Lëvdunar qoftë Allahu që ma fali dhe ma veshi mua këtë rrobë, me të cilën unë mbuloj pjesët intime të trupit dhe dukem më i bukur. I betohem Allahut, se myslimanët që veshin diçka të re dhe thonë këto që po them unë, duke ua dhënë të varfërve të vjetruarat, që t’i veshin ata, për sa kohë që të qëndrojnë mbi trupin e tyre qoftë edhe një fije e vetme e atyre teshave, jeton akoma, apo nuk jeton, ai njeri do të jetë në mbrojtjen dhe pranë Allahut.*”¹²⁷

33. SHTRATI KU FLINTE I DËRGUARI I ALLAHUT

Njëherë e pyetën Aishen (radijallahu anha), se si ishte shtrati në të cilin binte të flinte i Dërguari i Allahut dhe Aishja (radijallahu anha) u përgjigj:

- “Ai kishte një shtrat prej lëkure, që ishte mbushur me lëkurë nga ajo e hurmave.”¹²⁸

Kur Hafsanë (radijallahu anha) e kanë pyetur, se si ishte shtrati ku flinte i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), ajo u është përgjigjur duke u thënë:

- “Shtratin e kishte të bërë me një pëlhurë të trashë. Ne e palosnim atë më dysh dhe atje flinte ai. Një ditë mendova se po ta palosja më katërsh, ai do të flinte më rehat, ndaj ashtu bëra. Në të gdhirë, i Dërguari i Allahut më pyeti:

- “*Çfarë më kishe shtruar kështu sonte?*”

- “Atë që kam shtruar gjithnjë.” – i thashë unë. – “Por kësaj here e

¹²⁶. Tirmidhi, *Sunen*, 4/237 (1762).

¹²⁷. Tirmidhi, *Sunen*, 5/558 (3560).

¹²⁸. Muslim, *Sabih*, 3/1650 (2082).

Morali dhe pamja e jashtme e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij

kisha palosur më katërsh.” Një ta dëgjuar, më porositi:

- “*Palose si herët e tjera këtej e tutje; sepse butësia e shtratit më bëri që të çobesha vonë për të falur tebe xhudin (namazin e natës).*”¹²⁹

¹²⁹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/53; Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/465.

BESIMI I SAHABËVE TE BOTA E PADUKSHME



Si besonin sahabët te bota e panjohur? Si arrinin ata t'i braktisnin të gjitha, kënaqësitë dhe shijet kalimtare të kësaj bote, dëshirat njerëzore, ndjenjën e tyre për kohën dhe të gjitha kursimet e tyre, kur dëgjonin lajmet e prura prej Profetit tonë të dashur (paqja e Zotit qoftë mbi të)? Ata ishin sikur ta kishin parë vetë, me sytë e tyre, botën e panjohur; ato që kishin përpara syve dukej sikur i mohonin, sikur i cilësonin një hiçmosgjë, tërësej!

1. PËRMASAT E MËDHA TË BESIMIT

I Dërguari i Allahut i përgëzonte me Xhenet të gjithë ata që thoshin 'La ilahe il'lallah' me plot zemër

Tregon Rifaatu'l-Xhuheniu: "Ne patëm shkuar në vendin e quajtur Kadid bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Aty, disa i kërkuan leje të Dërguarit të Allahut, që të ktheheshin pranë familjeve të tyre. Atëherë, Profeti ynë u ngrit në këmbë dhe pasi lëvdoi

Allahun, tha këto fjalë:

- “Ç’është kjo? Mos kemi mes nesh të atillë që duan ta lënë vetëm Profetin e Allahut dhe të kalojnë në anën tjetër?”

Nuk mbeti asnjë pa qarë nga ato fjalë. Doli njëri dhe tha:

- “Ai njeri që i kërkon leje të Dërguarit të Allahut, pavarësisht se dëgjoi këto fjalë, duhet të jetë një i çmendur!” Atëherë, Profeti ynë tha kështu:

“Dëshmoj përpara Allahut se, nuk vdes një rob, i cili dëshmon se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Tij, me singeritet nga zemra, dhe pastaj i përmbahet kësaj, veçse futet në Xhenet. Mua Allahu më premtoi se shtatëdhjetë mijë vetë nga umeti im do të hyjnë në Xhenet pa kaluar në llogari dhe pa u dënuar. Unë kam shpresë se mes atyre që do të hyjnë në Xhenet do të jenë edhe baballarët tuaj të mirë, bashkëshortët/et dhe brezat tuaj të ardhshëm. Të jenë ata banorët e atyre viseve të Xhenetit.”¹

Një sihariq për ata që do të dalin nga Xhehenemi, sepse kanë thënë fjalën e dëshmisë

Tregon Ebu Musai: “I Dërguari i Allahut thotë:

- “Kur banorët e përbershëm të Xhehenemit dhe disa nga myslimanët të mbledhen bashkë, mohuesit do t’i pyesin myslimanët: - Po ju, a nuk ishit myslimanë? – e myslimanët do t’u përgjigjen: - Po! Atëherë, mohuesit do të vazhdojnë t’i pyesin ata: - Po si, a nuk qe e mjaftueshme që ju ishit myslimanë për t’ju shpëtuar ju prej zjarrit, që erdhët këtu, në Xhehenem, bashkë me ne?! Myslimanët u përgjigjen: - Ne kemi ca mëkate; këtu kemi ardhur të vuajmë dënimin e grynaveve që i ngarkuam vetes në atë jetë.”

Allahu e dëgjon këtë bisedë mes tyre dhe urdhëron që myslimanët e Xhehenemit të nxirren që andej. E, kur mohuesit e atjeshëm ta shohin edhe këtë, do të thonë:

- “Ah, të ishim bërë edhe ne myslimanë, e të dilnim edhe ne, siç dolën ata, prej Xhehenemit!”

Mandej, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) këndoi këtë ajet: **“Elif Lam Ra. Këto janë vargjet e Librit, të Kur’anit të qartë!**

¹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/16 (16260).

Do të vijë dita (e Kiametit), kur mohuesit do të dëshirojnë që të ishin myslimanë.” (Hixhr, 15/1-2)²

2. KUVENDET E BESIMIT

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: “Kur takohej me ndonjë prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), Abdullah bin Reuahaja (radijallahu anhu) thoshte kështu:

- “Eja, eja, ulu pak këtu. Eja t’i besojmë një orë Zotit!”

Një ditë prej ditësh, një burrë ishte nxehur me Ibni Reuahanë, ndaj e mbajti frymën drejt e tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe iu ankua për Ibni Reuahanë, duke i thënë:

- “O i Dërguari i Allahut! Ky Ibni Reuahaja i shmanget besimit tënd dhe guxon e u thotë njerëzve ‘ejani t’i besojmë një orë Zotit’.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) e dëgjoi dhe tha:

- “*Zoti e mëshiroftë ibni Reuahanë. Atij i pëlqejnë shumë kувendet e besimit, të cilat i kanë çili edhe engjëjt dhe i përmendin gjithmonë me admirim.*”³

3. RIFRESKIMI I BESIMIT

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha kështu:

- “*Rifreskojeni besimin tuaj.*” I thanë:

- “Po si do ta rifreskojmë ne besimin?” Dhe na u përgjigj:

- “*Duke e thënë sa më shumë fjalën ‘La ilahe illallah’.*”⁴

4. BESIMI ËSHTË BURIMI I TRIMËRISË DHE I SHPRESËS

Sehm bin Minxhabi tregon: “Ne patëm marrë pjesë në luftë bashkë me Ala ibnu’l-Hadramiun. Deri në vendin e quajtur Darin (një vend bregdetar në Bahrejn) e bëmë në këmbë. Tanimë, mes nesh dhe armikut ishte vetëm deti. Ala ibnu’l-Hadramiu hapi duart dhe filloi të lutej kështu:

². Ibn Kethir, *Tefsir*, 2/546.

³. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/265 (13822).

⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2/359 (8695).

- “O i Gjithëditur që di çdo gjë, e Ti që megjithëse je i Gjithëfuqishëm për të ndëshkuar çdokënd, prapëseprapë, nuk ndëshkon, por na lë kohë, o i Butë! O Ti që je më i Larti! O Ti, që je më Madhështori e kapërcen çdo horizont tonin! Ne jemi robërit dhe skllevërit e Tu. Andaj kemi dalë të përleshemi me armiqtë, për Ty. O Zot, tregona ne një rrugë se si të shkojmë tek ata.”

Mandej, Ai na urdhëroi ne që t’u grahnim kuajve në drejtim të detit dhe ashtu bëmë edhe ne. Uji nuk arrinte as deri te jelet e kalit, derisa, më në fund, e gjetëm vendin në tokë, ballë për ballë me armikun.”⁵

Sihariqi i Profetit tonë për të ardhmen gjatë hapjes së hendekut

Tregon ibni Abasi: “Teksa ishim duke gërmuar, për të hapur hendekun, në punë e sipër para na doli një shkëmb. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Lëreni të godas unë i pari.*”, – dhe e mori kazmën në dorë dhe e goditi tokën duke thënë ‘*Bismillab*’. Një e treta e atij shkëmbi u thyë. I Dërguari i Allahut tha:

- “*Allahu Ekber! Për Zotin, unë i pashë kështjellat dhe pallatet e Bizantit?*”, – e kur goditi për herë të dytë, ai shkëmb u thyë i tëri në copa. Atëherë, ai tha:

- “*Allahu Ekber! Për Zotin, i pashë edhe sarajet e Persisë!*” Disa që njiheshin se ishin hipokritë thanë:

- “Ne jemi këtu, duke gërmuar këtë hendek, si e si të shpëtojmë kokën, ai na flet për ngadhënjim mbi Bizantin dhe Persët!”⁶

5. E VËRTETA DHE PËRSOSJA E BESIMIT

Pyetja e të Dërguarit të Allahut për Harith bin Malikun dhe përgjigja që mori prej tij

E tregon Enesi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) hyri në xhami dhe e gjeti Harith bin Malikun të shtrirë përdhe. I Dërguari i Allahut e ngacmoi me këmbë dhe i tha:

⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/7.

⁶. Hejthemi, *Mexbmen Zenuid*, 6/190 (10140).

- “Ngrije kokën.” Harithi e ngriti kokën dhe i tha:
- “T’u bëfshin kurban ty nëna dhe babai im, o i Dërguari i Allahut.”
- “*Si e kalove natën sonte, o Harith?*”, – e pyeti atë i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të). Harithi iu përgjigj:
- “*Sot u gdhiva si një besimtar i vërtetë, o Resulallah!*”
- “*Çdo fjalë e ka të vërtetën e vet, po e vërteta e fjalës sate cila është?*”, – e pyeti atë i Dërguari i Allahut.
- “Nuk më rri më syri pas kësaj bote”, – tha Harithi, – “aq sa mund ta kaloj ditën i etur e netët pa gjumë. Herë-herë më bëhet sikur shoh Fronin e Lartësuar të Zotit tim. Më duket sikur nga njëra anë sytë më shohin të dashuruarit e Xhenetit, ndërsa në anën tjetër vajturesit e flakëve të Xhehenemit!”

Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) e dëgjoi atë me vëmendje, pastaj i tha:

- “*Ti me të vërtetë je një njeri, që zemrën ta ka ndriçuar Allahu. Njohjes që ke arritur, përmbaju.*”⁷

Një pyetje e të Dërguarit të Allahut për Muadh bin Xhebelin dhe përgjigja e ardhur prej tij

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Njëherë, tek i Dërguari i Allahut hyri Muadh bin Xhebeli dhe i Dërguari i Allahut i tha atij:

- “*Si u gdhive sot, o Muadh?*” Muadhi i tha:
- “Sot u gdhiva si një njeri që i ka besuar Allahut plotësisht.”
- “*Çdo fjalë është e bazuar mbi një të vërtetë; mbi cilën të vërtetë është e bazuar kjo që thua ti?*”, – e pyeti atë i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).
- “O Resulullah, nuk ka ndodhur që të zgjohem ndonjë mëngjes përveçse pandehja se nuk do të ngrysesha. Dhe nuk jam ngrysur ndonjëherë përveçse duke pandehur se nuk do të gdhihesha. Dhe nuk kam hedhur asnjë hap përveçse pandehja se nuk do të hidhja një tjetër pas tij. Më duket vetja sikur tani para syve të mi shoh të gjitha popujt

⁷. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenuid*, 1/221.

që thërriten për te libri i tyre, përkrah kanë edhe profetët e tyre, dhe shoqërohen edhe nga idhujt që adhuronin përveç Allahut; ashtu më duket sikur shoh ndëshkimin e banorëve të zjarrit dhe shpërblimin e banorëve të Xhenetit.” Atëherë, i Dërguari i Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem) më tha:

- “*Njohjes që ke arritur, përmbaju.*”⁸

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Thanë: ‘O i Dërguari i Allahut! Kur jemi pranë teje, ne ndihemi aq mirë, saqë nuk mund ta përshkruajmë dot me fjalë se sa mirë ndihemi. Por, sapo largohemi prej teje, e kemi shumë të vështirë ta ruajmë atë gjendje dhe ngjan sikur bëhemi njerëz të tjerë.’ I Dërguari i Allahut i dëgjoi dhe tha:

- “*Po lidhja që keni me Zotin si është, çfarë ndieni?*”

- “Ai është Zoti ynë, si kur veprojmë haptas, si brenda nesh në fshehtësi.” – thanë ata.

- “*Epo kjo nuk qubet hipokrizi.*”, – foli i Dërguari i Allahut.”⁹

6. BESIMI TEK ENGJËJT

Aliu (radijallahu anhu) thotë: “Veç përmytjes së Nuhut, çdo pikë shiu që zbret në tokë është zbritur nga një engjëll i vetëm, me një masë të caktuar, sepse gjatë Tufanit të Nuhut, Allahu i Madhërishëm e lëshoi shiun me rrebeshe të mëdha e të pakontrolluar, ku nuk kishte nevojë për kontrollin e engjëjve. Zaten siç përshkruhet edhe në ajetin Kur’anor: “... **Kur vërshoi uji i madh, Ne ju ngarkuam ju në një anije të sigurt...**” (Hakka, 69/11). Po në të njëjtën mënyrë, pos stuhisë së popullit të Adit, asnjë vrundull ere nuk ka fryrë kurrë e pakontrolluar nga një engjëll i caktuar. Edhe atëherë, erës iu qe lejuar dhe era ka fryrë jashtë kontrollit të engjëjve. Ja, për këtë ka dëshmuar edhe ajeti: “... **kurse fisi Ad u shkatërrua nga një furtunë shungulluese e rreptë...**” (Hakka, 69/6)¹⁰

⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/242.

⁹. Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/397.

¹⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/640 (4679).

7. BESIMI TE KADERI

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e patën thirrur në xhenazen e një foshnjeje. Unë i thashë të Dërguarit të Allahut:

- “O Resulallah! Sa i lumtur duhet të jetë ai foshnje, apo jo? Ai duhet të jetë bërë një prej zogjve të parajsës. Ai nuk ka rënë kurrë në mëkat. Madje as se ç’është e keqja nuk ka pasur kohë të mësojë.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u përgjigj:

- “*E ç’kujtove ti, o Aishe! Allahu Xhenetin dhe banorët e Xhenetit i ka krijuar që kur ata kanë qenë në shtyllën kurriçore të të atit.*”¹¹

Ubade bin Samit e këshillon të birin të besojë te kaderi

E rrëfen Uelid bin Ubadeja: “Babai im, Ubadeja (radijallahu anhu) ishte i sëmurë; me gjasa ai do të vdiste. Hyra tek ai dhe i thashë:

- “Më jep ndonjë këshillë; më thuaj diçka që do të jetë me dobi për mua.”

- “Më ngrini, dua të qëndroj drejt.”, – tha ai. Ata që i shërbenin u afruan dhe e ulën të ndenjur, kur ai më tha:

- “Shiko o biri im i mirë, po nuk i besove kaderit ashtu siç duhet as Zotin nuk e njeh siç duhet, as besimit nuk mund të thuhet se ia ndien shijen e vërtetë.”

- “Babai im i dashur, e nga mund ta di unë se ç’është e mirë dhe ç’është e keqe në kaderin tim?”, – e pyeta unë dhe babai më tha:

- “Do të të them diçka, por mbaje mend mirë: Ty nuk do të të ndodhë kurrë asgjë që nuk e ke pjesë të asaj që të është paracaktuar; ti nuk mund t’i shpëtosh dot kaderit tënd. Biri im, unë e kam dëgjuar vetë Resulullahun (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kur na tha:

- “*Krijesa e parë e Allahut është pena. Ai i tha asaj: ‘Shkruaj!’ e ajo shkroi gjithçka që ka ndodhur e që do të ndodhë, nga fillimi e deri në Ditën e Kiametit.*” Ja pra, nëse vdes pa e besuar këtë ti do të hysh në Xhehenem.”¹²

¹¹. Ibn Kethir, *Tefsir*, 2/268.

¹². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/268.

Fjalët e Aliut (r.a.) në lidhje me këtë temë

Tregon Nezal bin Sebreja: “Aliut (radijallahu anhu) iu tha:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Ka disa që pretendojnë se ‘Allahu nuk e di një gjë para se ajo të ndodhë’.”

Aliu (radijallahu anhu) tha:

- “Allahu i shkatërroftë e i poshtëroftë ata njerëz! E ku bazohen, që e thonë diçka të këtillë? Ata që ishin të pranishëm thanë:

- “Ata bazohen te një interpretim i ajetit, **“Ne do t’ju vëmë në provë ju, derisa t’i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhet për veprat tuaja.”** (Muhamed, 47/31) Kësodore, Aliu (radijallahu anhu) u tha atyre:

- “Injoranca e ha njeriun, e bën të marrë fund.”, – dhe, duke u ngjitur në minber, lëvdoi dhe përgëzoi emrat dhe cilësitë e Allahut dhe tha këto:

“O njerëz, mësoni e bëhuni të ditur, bëhuni njerëz të ditur me dijet e përfutuara dhe mësojuani ato edhe të tjerëve. Kushdo që lexon prej Kur’anit dhe nuk e kupton ndonjë çështje, le të vijë e të më pyesë mua. Dëgjova se disa thonë se ‘Allahu nuk mund t’i dijë gjërat para se të ndodhin’ e këtë e thonë duke u bazuar në ajetin që thotë **‘Ne do t’ju vëmë në provë ju, derisa t’i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhet për veprat tuaja.’**, por, fraza ‘derisa t’i njohim’ që gjendet në këtë ajet është thënë me kuptimin, që ‘ta shohim të gjithë bashkë, derisa ata, të cilëve u është bërë detyrim të luftuarit dhe bërja e durimit, të bëjnë durim ndaj gjërave që u ndodhin dhe të vazhdojnë të luftojnë në rrugën e Allahut’.”¹³

8. BESIMI TE SHENJAT E KIAMETIT

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Kur u zbritën ajetet kur’anore: **‘... se, kur të fryhet në Sur, ajo do të jetë një ditë shumë e rëndë.’** (Mud’deh’thir, 74/8-9), i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue

¹³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/609 (4602).

sel'lem) tha:

- “E si të përpigem unë të luftoj për të marrë gjithëka mundem prej kësaj bote, kur Israfilë e ka vënë në gojë surin e tij e është bërë gati, në pritje të urdhrit për t'i fryrë atij?!” Atëherë, sahabët e pyetën Resulullahun (paqja e Zotit qoftë mbi të):

- “Çfarë na këshillon që të themi?” I Dërguari Fisnik tha:

- “Ju thonë: ‘Allahu ne na mjafton, Ai është Vëzhguesi më i Mirë. Ne i besuam Allahut dhe tek Ai jemi mbështetur’.”¹⁴

Jahja bin Ebi Reshidi (radijallahu anhu) tregon:

- “Omeri (radijallahu anhu) në shtratin e vdekjes i thotë të birit kështu:

“Biri im, kur të jap shpirt, kthema trupin. Mbështetu me të dy gjunjët mbi shpinën time dhe dorën e djathtë vërma në ballë, kurse të majtën në mjekër. E kur ta kem dorëzuar shpirtin, të m'i mbyllësh sytë. Të mos shpenzoni në asnjë mënyrë me tepri për qefinin tim, se unë, nëse kam ndonjë punë të mirë për Allahun, ajo vepër do të më shpjerë mua te diçka më e mirë se çdo qefin. E, nëse nuk kam asnjë vepër të mirë, atëherë Allahu do të ma marrë shumë shpejt edhe atë që kam përsipër. Edhe për varrin të mos bëni shpenzime të tepruara. Nëse unë kam ndonjë punë të mirë për Allahun, ajo do të ma zmadhojë e do të ma stolisë mua varrin. Në të kundërt, Ai do të ma ngushtojë mua gropën e varrit, sa që brinjët të më hyjnë mes njëra-tjetrës. Në varrimin tim të mos marrë pjesë asnjë grua. Dhe se mos guxoni të më përmendni me cilësi që nuk i kam pasur, duke u përpjekur që të më nxirrni sa më të pastër e të patëmetë, sepse Allahu më njeh mua mjaft mirë dhe më mirë se kushdo. Në kohën që do ta nxirrni nga shtëpia trupin tim, nxitoni. Nëse do të kem bërë ndonjë punë të mirë për Allahun, ju do të më bëni sakaq mua një të mirë shumë të madhe, duke më çuar tek e mira e gjithë të mirave. Nëse nuk kam asnjë punë të mirë, për të çuar përpara Allahut, ju do të shpëtoni një çast e më parë nga bartja mbi shpatulla e trupit të një mëkatari.”¹⁵

¹⁴. El-Hakim, *Mustedrek*, 4/603 (8678).

¹⁵. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 3/358.

9. BESIMI NË JETËN E PËRTEJME

Përshkrimi i të Dërguarit të Allahut për Xhenetin

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Ne i thamë të Dërguarit të Allahut:

- “O Resulallah! Ne, kur të shohim ty, zemrat zënë e na zbuten, na bëhen më të ndjeshme e më delikate. Por, në momentin që largohemi prej teje, bota nis të na duket më tërheqëse; duam të kemi më shumë gra e më shumë fëmijë.” I dëgjo i Dërguari Fisnik dhe u tha:

- “*Sikur ju të vazhdonit të ruanit të njëjtën gjendje që ndieni kur jeni pranë meje edhe kur largoheni nga unë, engjëjt do t’ju shtrëngonin duart e nuk do të kishin gjë më të dashur, sesa të vinin për vizitë nëpër shtëpitë tuaja. Nëse ju nuk do të bënit asnjë mëkat, atëherë Allahu do të krijonte një bashkësi njerëzore që bie në mëkat dhe pendohet dhe i kërkon Allahut që ta falë.*”

- “O i Dërguari i Allahut! A do të na flasësh neve për Xhenetin dhe ç’ka në të?”, – e pyetën dhe i Dërguari i Allahut nisi t’i përshkruajë me fjalët:

- “*Shtëpitë në Xhenet janë të gjitha të bëra me qerpiç ari dhe argjendi; të erëmuara me aromat më të mira, si ajo e miskut. Rëra dhe gurët janë prej perlash dhe smeraldi. Toka është e gjitha shafra. Kush hyn atje mbulohet nga të mirat dhe nuk mërzhitet kurrë. Arrijnë përjetësinë dhe nuk kanë më nevojë për asgjë tjetër, e atje ata nuk do të vdesin më kurrë. As rrobat nuk u vjetrohen. As rinia nuk u humbet. Tre janë njerëzit, lutja e të cilëve nuk kthehet kurrë mbrapsht e pranohet gjithnjë: Prijësi i shtetit që është i drejtë, agjëruesi dhe njeriu, të cilit i është bërë padrejtësi. Aq sa, lutja e atij që i është bërë padrejtësi ngjitet gjer mbi re. Lutja e tij çel portat e qiejve dhe Allahu i Madhbërshëm i thotë atij: ‘Të betohem në Krenarinë dhe Fuqinë Time, nuk ka dyshim se ty do të të vij në ndihmë Unë.’”¹⁶*

10. BESIMI I SAHABËVE TE NGJARJET QË DO TË NDODHIN NË DITËN E KIAMETIT

**Omeri (r.a.): “Në Ditën e Kiametit edhe
për këtë do të më kërkohet mua llogari!”**

Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu) i kërkoi Omerit (radijallahu anhu) katërmijë dirhemë hua. Dhe personin që dërgoi e

¹⁶. Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/49.

porositi që t'i thoshte se i kërkonte nga thesari dhe se ai do t'i kthente sërish më vonë. Kur ai njeri erdhi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i tregoi se si qëndronte puna, kalifi Omer u mërztit dhe frymën e mbajti drejt e tek Abdurrahman bin Aufi, të cilit i tha këto fjalë, duke reaguar mjaft ashpër:

- “I kishe thënë dikujt që doje që paratë të t’i jepja nga thesari i shtetit. Po sikur ti të vdesësh para se t’i kthesh ato para, atëherë të gjithë do të thoshin: “Paratë i mori Omeri!” Në Ditën e Kiametit edhe për këtë do të më kërkohet mua llogari!”

11. BESIMI I SAHABËVE SE NDËRMJETËSIMI I TË DËRGUARIT ËSHTË I VËRTETË

Tregon Aliu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha kështu:

- “Unë do të ndërmjetësoj për umetin tim gjersa Zoti do të më drejtohet mua me fjalët: ‘A u kënaqe, o Muhamed!’ – e unë do t’i përgjigjem: ‘Po, u kënaqa dhe tani jam i lumtur.’” Aty, Aliu (radijallahu anhu) tha:

- “O njerëz të Irakut, ju thoni se ajeti më shpresëdhënës është ajeti: **“Thuaj: ‘O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i Madh dhe Mëshirëploti.’”** (Zumer, 39/53) – “Po, ne kështu mendojmë, ky është ajeti më shpresëdhënës.”, – u përgjigjën ata. Atëherë, si përgjigje, Aliu (radijallahu anhu) foli e tha:

- “Kurse ne të familjes së bekuar themi se ajeti më shpresëplotë është ajeti: **“... e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.”** dhe këtu bëhet fjalë për ndërmjetësimin.”¹⁷

Jezid el-Fakiri tregon: “Unë pata shkuar për vizitë te Xhabir bin Abdullahu. Teksa na fliste për disa çështje të ndryshme, na tha se një grup njerëzish do të dilte nga Xhehenemi. Kjo më nxehu shumë, sepse deri atë ditë, kurrë nuk e kisha pranuar se do të ndodhte diçka e

¹⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 14/715 (39758).

këto. U ngrita e thashë:

- “Mua nuk më intereson se çfarë thonë njerëzit, por ajo që më habit më shumë është se si ju, sahabët e të Dërguarit të Allahut, arrini e thoni se disa njerëz Allahu do t’i nxjerrë prej Xhehenemit! Ju e dini fare mirë, se Allahu ka shpallur se: **“Ata do të dëshirojnë të dalin nga zjarri, por s’do të mund të dalin dot. Ata i pret dënimi i përhershëm.”** (Maide, 5/37)

Edhe pse shokët e Xhabirit (radijallahu anh) u ngritën për të më kundërshtuar, Xhabiri, pa e prishur qetësinë, tha:

- “Mos e ngacmoni; ky ajet është për mohuesit.” – dhe lexoi këtë ajet Kur’anor: **“Me të vërtetë, sikur të kenë jobesimtarët tërë pasurinë që gjendet në tokë, madje edhe njëherë aq, e ta sakrifikojnë për të shpëtuar nga dënimi i Ditës së Kiametit, nuk do të pranohet prej tyre dhe për ata do të ketë dënim pikëllues. Ata do të dëshirojnë të dalin nga zjarri, por s’do të mund të dalin dot. Ata i pret dënimi i përhershëm.”** (Maide, 5/36-37)

Mandej mu drejtua mua dhe më pyeti:

- “Po ti, nuk e lexon fare Kur’anin?”

- “E lexoj, madje e lexoj të gjithë Kur’anin.” – iu gjegja unë. Kësaj here, ai më tha:

- “Po pse, a nuk thotë Allahu, që: **“Kaloje një pjesë të natës, si falje shtesë për ty (Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.”** (Isra, 17/79) E, ja pra, kjo që trajtohet këtu është pikërisht rreth gradës së ndërmjetësimit të të Dërguarit të Allahut. Allahu do t’i mbajë ata në Xhehenem për aq sa të shlyejnë dënimin e mëkateve dhe gabimeve që kanë bërë dhe nuk do të flasë me ta. Dhe, kur të dojë që t’i nxjerrë, do t’i nxjerrë së andejmi.” Që prej asaj dite unë nuk e mohova më kurrë çështjen e ndërmjetësimit të Profeti tonë të dashur (paqja e Zotit qoftë mbi të).”¹⁸

¹⁸. Ibn Kethir, *Tefsir*, 2/54.

12. BESIMI I SAHABËVE TEK EKZISTENCA E XHENETIT DHE XHEHENEMIT

**Pyetjet që i drejton të Dërguarit të Allahut
një burrë nga Abisinia dhe përgjigjet e tij**

Tregon ibni Omeri (radijallahu anhu): “Tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pati ardhur një burrë nga Abisinia. I Dërguari i Allahut i tha atij që t’i bënte ç’pyetje të donte e të mësonte gjithë ç’donte të mësonte prej tij. Burri nga Abisinia i bëri këtë pyetje në fillim:

- “O Profeti i Allahut! Ju u zgjodhët, si për nga ngjyra, si për nga forma, ashtu edhe për nga mirësia e profetësisë. Po sikur t’u besoj edhe unë gjërave që u besoni ju dhe bëj po ato gjëra që bëni edhe ju, a do të mund të hyj edhe unë bashkë me ju në Xhenetin e amshuar?”

I Dërguari i Allahut e dëgjoi dhe u përgjigj duke thënë:

- “*Po, unë i betohem Allahut, se i bardhi dhe i zi do ta shohin njëri-tjetrin nga njëmijë vite distancë. Kush thotë ‘La ilahe illallah’, për të Allahu ka bërë një premtim shumë të madh. E kushdo që thotë: ‘O Zot, unë të shoh Ty të pastër nga çdo e metë, ndaj edhe të lëvdoj.’ – për të do të shkruhen menjëherë njëqind e njëzetekatërmijë sevape.*”

Ai burrë pyeti sërish:

- “Këtej e tutje, a ka më ndonjë rrezik për ne, o i Dërguari i Allahut?” Dhe i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u përgjigj:

- “*Në Ditën e Kiametit njerëzit sillen aty bashkë me punët e bëmat e tyre. Nëse i vendosin ato mbi kreshtën e një mali, ato peshojnë aq shumë, sa që kanë fuqi që ta thërrmojnë malin. Mirëpo, është mëshira e Allahut, se po të mos ishte ajo, as e mira më e vogël e Zotit nuk do të mund të shpërblehej dot.*” Kur aty u zbritën ajetet kur’anore:

“Vallë, a nuk ka kaluar një periudhë kohore, kur njeriu nuk ka qenë qenie e denjë për t’u përmendur?! Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë. Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës. Pa dyshim, Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zinxhirë, pranga dhe zjarr flakërues. Sigurisht, të

ndershmit besimtarë do të pinë (në Xhenet) kupa me pije të përzier me Kafur, nga burimi që vetëm robtë e Allahut pinë dhe të cilin mund ta çojnë nga të duan. Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit), tmerri i së cilës përhapet gjithkund. Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: ‘Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.’ Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim dhe, për durimin e tyre, Ai do t’i shpërblejë me Xhenet dhe petka të mëndafshita. Të mbështetur në divane, ata nuk do të kenë as vapë dhe as të ftohtë. Hija e pemëve të tij (Xhenetit) është afër mbi kokat e tyre, ndërsa frutat e tyre do t’i kenë afër sa t’i arrijnë me dorë. Aty do t’u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali, kupa të tejdukshme argjendi, madhësinë e të cilave (do ta zgjedhin) sipas dëshirës. Aty do të pinë gota me pije të përzier me xhenxhefil, prej një burimi të quajtur Selsebil. Atyre do t’u shërbejnë djem përherë të rinj, që, kur i shikon të duken si margaritarë të shpërndarë. Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe.” (Insan, 76/1-20)

Në fund, pasi i dëgjoi gjithë këto ajete Kur’anore, burri nga Abisinia tha:

- “Por, a do t’i shoh edhe unë në Xhenet këto që do të shohësh ti?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha:

- “Po!” Burri filloi të qajë, u ngashërye aq shumë, saqë dha shpirt aty, mu në vend, duke ia dorëzuar Zotit shpirtin e tij. Ibni Omeri (radijallahu anhu) thotë se: “Unë e kam parë me sytë e mi, se si i Dërguari i Allahut e ka zbritur vetë me duart e veta në varr atë njeri.”¹⁹

Llogaridhënia me veten e Amr bin Asit pak para se të ndahej nga jeta

Këtë e tregon ibni Shemase el-Mehriu: “Ne shkuaam tek Amr bin Asi, pasi ai kishte rënë në shtratin e vdekjes. E ktheu kokën nga muri dhe filloi të qante me ngashërim. I biri e pyeti:

¹⁹. Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/457.

- “Po pse qan, o baba? A nuk të pati përgëzuar ty i Dërguari i Allahut me sa e sa të mira e shpërblime të veçanta?” Atëherë siç ishte me kokën të kthyer nga muri, drejtoi fytyrën nga ne dhe na tha:

- “Jo, unë nuk kam frikë nga vdekja, por nga jeta që do të nisë pas vdekjes. Puna më e mirë që kam bërë në këtë jetë, ka qenë që kam dëshmuar se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Mirëpo, unë kam kaluar tri periudha gjatë jetës sime: Në mendje më vijnë ato ditë kur ndieja urrejtje për të Dërguarin e Allahut dhe ngrija kurthe njëri pas tjetrit, pasi doja që ta vrisja. Po të kisha vdekur në ndonjë prej atyre ditëve, nuk ka dyshim, që unë do të isha një prej banorëve të ferrit. Mandej, u bëra mysliman. Shkova tek i Dërguari i Allahut dhe i thashë:

- “Zgjatma dorën, ta lidh edhe unë besën me ty, o Profet i Zotit!” Dhe ai ma zgjati dorën. Ia shtrëngova duart fort.

- “*Ke ndonjë gjë për të më thënë, o Amr?*”, – më pyeti ai.

- “Unë do ta lidh besën me ty, por vetëm me një kusht; që të më falësh ti.”, – iu përgjigja. I Dërguari i Allahut mu përgjigj duke më thënë:

- “*O Amr! Po a nuk e di ti se Islami e fshin krejt të shkuarën, mërgimi nuk lë më asnjë prej mëkateve e gabimeve të shkuara dhe që baxhi i pastron e i zhbën të tëra mëkatet e rëna përpara tij?*” Që prej asaj dite, unë nuk kam dashur kurrë më asnjëri sa ç’kam dashur të Dërguarin e Allahut. Nuk di ta përshekruaj, nëse do të më thoshte ndokush, ‘ma përshekruaj pak Resulullahun’, sepse unë kurrë nuk e pashë dot gjersa të ngopesha me fytyrën e tij të bukur. Po të kisha vdekur atë ditë, do të shpresoja se do të isha një prej banorëve të Xhenetit!

Edhe më vonë, qëlloi që u ngatërruam në disa punë. E ja, që prej asaj dite unë jam i shqetësuar, e nuk e di si do të vejë fundi im. Kur të vdes, askush të mos qajë për mua. As zjarr mos ndizni. Kur të më varrosni, përsipër varrit më hidhni nga pak dhe. Qëndroni te kryet e varrit tim, gjersa të theret një deve e mishi t’u ndahet njerëzve. Që të mos rri vetëm për pak e të di se si t’u përgjigjem lajmëtarëve të Zotit, që do të vijnë për të më pyetur.”²⁰

²⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/258.

**Aishja (r.a.): “Vallë, në Ditën e Kiametit,
a do të të kujtohet ty familja jote?”**

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Një ditë, unë kujtova Xhehenemin dhe nisa të qaja. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më pyeti:

- “Çfarë paske kështu, oj Aishe?” E unë iu përgjigja:

- “Seç m’u kujtua Xhehenemi, ndaj fillova të qaj. Vallë, në Ditën e Kiametit, a do të të kujtohet ty familja jote?”

Ja se cila ishte përgjigja që më dha mua i Dërguari i Allahut:

- “Tri janë çastet kur askush nuk kujtohet për askënd: I pari, në kohën kur do të shihet se çfarë i peshojnë atij më shumë në peshore, të mirat, apo të këqijat? I dyti, kur t’u thubet: ‘Merrini tani librat tuaj të jetës e të bëmave!’ dhe të gjithë të jenë të shqetësuar, a do t’u jepet nga e majta, apo do t’u jepet nga e djathta. Kurse i treti, ai fragment i kohës kur personi të kalojë mbi urën e Siratit, që Allahu e ka ngritur mbi Xhehenem dhe e ka mbështjellë me gjithfarë çengelash e gjembash të fortë, e që mund ta rrëzojë robin e Tij kur të dojë, e ai është i shqetësuar, nëse do ta kalojë, apo nuk do ta kalojë dot atë.”²¹

Shedad bin Eusi: “O Zot, frika prej Xhehenemit më prishi gjumin!”

Shedad bin Eusi, gjatë natës, përpëlitej sa në një anë në tjetrën e thoshte:

- “O Zot, frika prej xhehenemit më prishi gjumin.”, – pastaj çohet dhe falte namaz gjër në të gdhirë.”²²

**Abdullah bin Reuahaja: “Mua nuk më interesojnë
as dashuria për këtë botë, as miqësia me ju!”**

Abdullah bin Reuahaja (radijallahu anhu), gjatë luftës së Mu’tes nisi të qajë dhe tha:

- “Për Zotin, mua nuk më interesojnë as dashuria për këtë botë, as miqësia me ju. Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, kur ka

²¹. El-Hakim, *Mustedrek*, 4/622 (8722).

²². Ebu Nu’ajmi, *Hilje*, 1/264.

kënduar ajetin Kur'anor, **“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehenemi). Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt.”** (Merjem, 19/71). Edhe pasi të hyj atje, nuk e di a do të dal, apo nuk do të dal dot prej andej?”²³

13. TU BESOSH PREMTIMEVE TË ALLAHUT PËR TË ARDHMEN ME BINDJE TË PLOTË

Ebu Bekri (r.a.) vë bast me idhujtarët

E tregon Nijar bin Mukremi: “Atëherë kur u zbritën ajetet Kur'anore: **“Elif, Lam, Mim. U mundën bizantinët, në afërsi të tokës (arabe), por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë brenda disa vjetëve. Me të vërtetë, është vendimi i Allahut, si për të parën dhe për të dytën. Dhe, atë ditë, do të gëzohen besimtarët...”** (Rum, 30/1-4), bizantinët patën pësuar një disfatë të rëndë prej persëve. Kurse myslimanët donin që të ishin bizantinët ata që do të dilnin fitimtarë kundër persëve, sepse ata ishin *njerëz të librit*. Dhe, për ta theksuar edhe këtë çështje, Allahu i Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu) zbriti ajetet: **“... brenda disa vjetëve. Me të vërtetë, është vendimi i Allahut, si për të parën dhe për të dytën. Dhe, atë ditë, do të gëzohen besimtarët për ndihmën e Allahut; Ai ndihmon kë të dojë dhe është i Plotfuqishëm e Mëshirëplotë.”** (Rum, 30/4-5)

Fisi i kurejshëve u kënaqën shumë që persët dolën fitimtarë me bizantinët, sepse edhe persët ishin njësoj si kurejshët, nuk ishin njerëz të librit, dhe nuk besonin te jeta e përtejme.

Ja pra, me të zbritur këto ajete, Ebu Bekri (radijallahu anhu) doli nëpër rrugicat e Mekës dhe filloi të recitojë me zë të lartë ajetet: **“Elif, Lam, Mim. U mundën bizantinët, në afërsi të tokës (arabe), por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë brenda disa vjetëve...”** Kurejshët e dëgjuan dhe i thanë atij:

- “Ju jeni me bizantinët, kurse ne mbajmë anën e persëve. I madhi

²³. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/241.

juaj (Muhamedi) pretendon se bizantinët do t'i mundin persët brenda disa vjetëve. A vëmë bast për këtë, që nuk do të ndodhë kështu?" Ebu Bekri (radijallahu anhu) u tha atyre:

- "Po!" Në atë kohë vënia e bastit ende nuk ishte e ndaluar. Kësisoj, Ebu Bekri vuri bast me idhujtarët. Idhujtarët i thanë Ebu Bekrit:

- "Zgjidh cilin numër vitesh të duash mes tri apo nëntë vjetëve. Atë le të caktojmë si kohë. Atëherë le të përfundojë edhe afati për bastin tonë." Ai zgjodhi numrin gjashtë. Por, megjithëse kaluan gjashtë vite, bizantinët nuk dolën fitimtarë kundër persëve, idhujtarët shkuan tek Ebu Bekri dhe morën atë që u takonte nga basti i vënë. Mirëpo, në vitin e shtatë bizantinët dolën fitimtarë ndaj persëve dhe myslimanët e gjykuan Ebu Bekrin, pse kishte zgjedhur një afat gjashtëvjeçar. E Ebu Bekri u tha atyre, se 'Allahu kishte thënë brenda disa vjetëve'.

- "Qëllimi im ishte të dilte e vërtetë fjala e të Dërguarit të Allahut.", – u pati thënë ai. Kësodore, i Dërguari i Allahut foli dhe tha:

- *"Shko dhe vër sërish bast me ta. Kësaj here rrite edhe më shumë masën e shpërblimit, duke e zgjatur edhe për ca vjet të tjerë afatin."*

Ebu Bekri (radijallahu anhu) shkoi sërish tek ata dhe u tha:

- "A jeni edhe për një bast tjetër, kjo do të ishte një mundësi edhe më e mirë!"

- "Po, gati jemi," – u përgjigjën ata. Ende pa u mbushur mirë afati i përcaktuar në bastin e dytë, kur bizantinët u shkaktuan disfatën e radhës persëve, duke u marrë atyre Medainin e duke e bërë atë pjesë të territoreve të Perandorisë Romake. Atëherë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) erdhi tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe u tha:

- "Pasuria e marrë nga dora e idhujtarëve është e ndaluar." Mirëpo, i Dërguari i Allahut i tha atij:

- *"Merre dhe shpërndajua njerëzve si lëmoshë."*²⁴

²⁴. Ibn Kethir, *Tefsir*, 3/423.

14. TË BESUARIT PLOTËSISHT TE LAJMET E DHËNA PREJ TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Kur Ebu Bekrit i vihet epiteti “Besniku”

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Mëngjesin e asaj nate që Resulullahu u mor dhe u çua në Mesxhid’ul Aksa (Xhaminë Aksa), ai erdhi dhe ua tregoi atë njerëzve. Edhe në mesin e atyre që i kishin besuar pati nga ata që nuk e pranonin dot diçka të këtillë. Ndaj, ata ia bënë të ditur edhe Ebu Bekrit çështjen:

- “Çfarë mendimi ke ti për ato që po thotë shoku yt, ai pretendon se është çuar brenda natës në Xhaminë Aksa?”

- “A e ka thënë ai këtë gjë?”, – pyeti Ebu Bekri dhe ata iu përgjigjën:

- “Po!”

- “Epo, nëse e ka thënë ai këtë gjë, atëherë kjo është medoemos e vërtetë.”, – u tha atyre Ebu Bekri.

- “Si, edhe ti po e pranon e po na thua se ai ka shkuar në mbrëmje në Xhaminë Aksa dhe është kthyer në shtëpi ende pa zbardhur dita?”, – pyetën ata të habitur.

- “Po, unë pranoj dhe aprovoj edhe shumë e shumë fjalë të tjera të dyshimta që mund të thotë ai. Unë ia pranoj atij çdo fjalë e lajm që ai sjell në mëngjes dhe në darkë.”

Ja, pikërisht për këtë arsye Ebu Bekrit (radijallahu anhu) iu ngjit epiteti “Besniku”.²⁵

15. TË BESOSH PRERAZI, SE ÇDO VEPËR DO TË KETË SHPËRBLIMIN E SAJ

Besimi i plotë e i prerë i Ebu Bekrit (r.a.) tek i Dërguari i Allahut

Tregon Ebu Esmaja: “Një ditë Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte duke ngrënë drekë me Profetin (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur u zbritën ajetet: “... kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë,

²⁵. Ibn Kethir, *Tefsir*, 3/423.

do ta shohë atë.” (Zilzal, 99/7-8) Ebu Bekri (radijallahu anhu) u tërhoq menjëherë dhe e la të ngrënët dhe i tha Resulullahut:

- “O Resulullah! A do ta shohim ne në ahiret shpërblimin me dënim të çdo veprë të keqe që bëjmë në këtë jetë?”

- “*Çdo ngjarje që na mërëzitet në këtë jetë është një përgjigje ndaj të këqijave që kemi bërë. Kurse shpërblimi i të mirave lihet për në amshim.*”, – u përgjigj i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi Të).²⁶

Ebu Bekri (radijallahu anhu) tregon madje se: “Një ditë, unë isha tek i Dërguari i Allahut. Një t’u zbritur ajeti Kur’anor, **“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.”** (Shura, 42/30), i Dërguari i Allahut më tha mua:

- “*Ebu Bekr, a do që të ta këndoj ajetin që m’u zbrit?*”

- “Këndoma, o i Dërguari i Allahut.”, – ia ktheva unë. Dhe, pasi e këndoi, mua më ra të fikët dhe u rrëzova përtokë. I Dërguari i Allahut më pyeti:

- “*Çfarë pate, o Ebu Bekr?*”

- “O i Dërguari i Allahut, po kush nga ne nuk ka bërë asnjë të keqe? Ne medoemos do ta marrim atë që meritojmë për çdo gjë që kemi bërë!”, – i thashë unë.

- “*O Ebu Bekr! Ti dhe besimtarët do të vuani dënimin sot e deri ditën që do të largoheni nga kjo botë, për t’u kthyer te Zoti juaj. Kësisoj, juve nuk do t’ju mbetet asgjë për të shlyer në jetën e përtejme. Kurse mohuesit po, ata kanë për t’i dhënë llogari Allahut në Ditën e Gjykimit.*”, – më tha i Dërguari i Allahut.”²⁷

Besimi i plotë i Omerit (r.a.) se do t’i shlyejë një ditë të gjitha çfarë ka bërë

Tregon Muhamed bin Munteshiri: “Erdhi një burrë dhe i tha Omer bin Hatabit: “Unë di ajetin më rrëqethës e frikësues në librin e Allahut.” Omeri (radijallahu anhu) e qëllloi me kamxhik atë burrë dhe i tha:

²⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/656 (4709).

²⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/500 (4310).

- “Po pse u mendove kaq shumë mbi ajetet e Kur’anit dhe arrite në këtë mendim?”, – dhe u largua së andejmi. Ditën tjetër, Omeri (radijallahu anhu) i tha atij burri:

- “Kush është ajeti, për të cilin më fole dje?” Ai burrë u përgjigj duke i kënduar ajetin: “(Shpëtimi në jetën tjetër) **nuk do të jetë sipas dëshirës suaj** (o myslimanë), **as sipas dëshirës së ithtarëve të Librit. Por kushdo që bën një të keqe, do të ndëshkohet për atë dhe nuk do të gjejë as mbrojtës, as mbështetës tjetër në vend të Allahut.**” (Nisa, 4/123), duke thënë: “Me një fjalë, secili prej nesh do ta vuajë një ditë dënimin e merituar për bëmat e veta.”

Omeri (radijallahu anhu) e dëgjoi, pastaj foli:

- “Kur u zbrit ky ajet ne u mërzitëm jashtëzakonisht shumë, nuk na shijonte më as ushqimi që hanim, as uji që pinim. Por Allahu i Madhërishëm na tregoi ne portën e shpëtimit, duke na zbritur ajetin: “**Kush punon vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.**” (Nisa, 4/110)²⁸

16. FORCA E BESIMIT TË SAHABËVE

Qëndrimi i sahabëve ndaj ajetit kur’anor,

“... Edhe nëse e tregoni apo e fshihni çfarë keni në shpirtin tuaj,
Allahu do t’ju kërkojë llogari për të...”

Tregon Ebu Hurejreja: “Në kohën kur u zbrit ajeti kur’anor: ‘Gjithë ç’ka në Tokë e ç’ka në Qiej është e Allahut. Edhe nëse e tregoni apo e fshihni çfarë keni në shpirtin tuaj, Allahu do t’ju kërkojë llogari për të. Kështu, Ai do të falë kë të dojë dhe do të dënojë kë të dojë. Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.’ (Bekare, 2/284), sahabët fisnikë qenë prekur shumë nga domethënia e tij. Shkuan drejt e tek i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), u ulën në gjunjë dhe i thanë kështu:

- “O i Dërguari i Allahut! Ne u ngarkuam me faljen e namazit, të

²⁸. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/501 (4315).

agiëruarit, luftën në rrugën e Allahut dhe zekatin, për të cilat edhe na mjaftojnë fuqitë. Por ne nuk kemi fuqi e nuk e përballojmë dot atë që na thotë ky ajet që u zbrit.”

- “*Si, edhe ju doni të thoni ashtu siç thanë ata që erdhën përpara jush: ‘Dëgjuam dhe ngritëm krye!’ Mos thoni ashtu, por thoni, ‘Ne dëgjuam dhe u bindëm; falna ne, o Zot; se ne tek Ti e kemi kthimin’.*” – Dhe, kur myslimanët u qetësuan disi dhe e pranuan domethënien e atij ajeti, Allahu i Madhërishëm pati zbritur edhe ajetet: **“I Dërguari beson në atë (Kur’anin) që i është shpallur nga Zoti i Tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): ‘Ne nuk bëjmë dalim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij’.** Ata thonë: **‘Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti ynë dhe te Ti do të kthehemi!’**” (Bekare, 2/285)

Edhe më vonë, Allahu i Madhërishëm ua shpjegoi ajetin e mëparshëm, i cili myslimanëve iu duk shumë i rëndë, duke thënë: **“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu siç i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”** (Bekare, 2/286)²⁹

Sahabët shqetësohen nga një prej ajeteve të zbritura

Abdullahu (radijallahu anhu) tregon: “Sahabët u shqetësuan shumë kur u zbrit ajeti: **“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.”** (En’am, 6/82), ndaj ata shkuan dhe i thanë Resulullahut:

- “E kush nuk e ka molepsur besimin e vet me padrejtësi?!” Ai i dëgjoi dhe u tha:

- “*Përmbajtja e këtij ajeti nuk është ashtu si e mendoni ju! Padrejtësia këtu është padrejtësia që përmendet në këshillën e Lukmanit për të birin, i cili i pati*

²⁹. Muslim, *Sahih*, 1/115 (199).

thënë atij: “(Kujtoje) **kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: ‘O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.’**” (Lukman, 31/13)³⁰

“Sapo u zbrit ajeti në lidhje me poetët...”

E tregon Ebu’l-Haseni (radijallahu anhu): “Sapo u zbrit ajeti kur’anor, **“Poetët ndiqen nga njerëzit e humbur (e harbuar).”** (Shuara, 26/224), Hasan bin Thabiti, Abdullah bin Reuahaja dhe Ka’b bin Maliku (radijallahu anhum) shkuan tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) duke qarë dhe i thanë:

- “Allahu e di, që kur u zbrit ky ajet edhe ne ishim poetë.” Kësisoj, Resulullahu u tha atyre:

- “*Në atë sure thuhet edhe ‘përveç atyre që besuan dhe bënë punë të mira, ata përbëjnë përjashtim’, e ky është grupi ku bëni pjesë edhe ju. Në të thuhet edhe, se ‘ata e përmendin shumë herë Allahun’; edhe këtu bëhet fjalë për ju.*” I Dërguari i Allahut u këndoi atyre edhe pjesën, që thotë: **‘përjashtim bëjnë ata që arrijnë të vënë në vend atë që është e drejta, kur dikush ngrihet e u bën diçka të padrejtë.’**, – e u tha:

- “*Edhe këta jeni po ju.*”³¹

Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe ajeti:

“Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit)...”

E tregon Abdullah bin Amr bin Asî: “Në kohën kur u zbrit sureja që nis me ajetin, **“Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit)...”** (Zilzal, 99/1), Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte aty bashkë me të Dërguarin e Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të), po qëndronin ulur. Ebu Bekri (radijallahu anhu), një ta dëgjuar atë ajet, zuri të qajë me të madhe. I Dërguari i Allahut e pyeti:

- “*Çfarë të bëri për të qarë, o Ebu Bekr?*”

- “Kjo sure, më bëri për të qarë.”, – u përgjigj ai, e i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i tha:

³⁰. Buhari, *Sahib*, 2/2541 (6538).

³¹. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, 5/277 (26051).

- “Nëse ju nuk do të bënit gabime e mëkate, e të mos bëhet shkak që falja e Allahut të pasqyrohet nëpërmjet jush, Allahu do të kishte krijuar një bashkësi tjetër, që gabon dhe mëkaton, në mënyrë që t’u tregonte atyre faljen e Tij.”³²

³². Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/540.

NDJESHMËRIA DHE KUJDESI PËR NAMAZIN TEK I DËRGUARI FISNIK DHE TE SAHABËT E TIJ



1. I DËRGUARI FISNIK I NXIT NJERËZIT PËR TË FALUR NAMAZ

Një hadith prej Osmanit (r.a.) në lidhje me këtë çështje

E tregon skllavi i Osmanit (radijallahu anhu), Harithi: Një ditë, ne ishim ulur dhe po rrinim bashkë me Osmanin (radijallahu anhu). Osmani (radijallahu anhu) më kërkoi që t'i çoja një enë me ujë. Mori abdes, pastaj më tha këto fjalë:

- Unë e kam parë vetë Resulullahun, që merrte abdes njësoj siç po marr unë dhe pasi kishte mbaruar së marri abdes, thoshte:

- *“Kush e merr abdesin si unë dhe fal namazin e drekës, Allahu ia fal atij njeriu të gjitha mëkatet që mund të ketë bërë mes sabahut dhe vaktit të drekës. Pastaj, nëse fal namazin e ikindisë, atij i fshihen të gjitha mëkatet që mund të*

ketë bërë mes drekës dhe ikindisë. Pastaj, nëse fal namazin e akshamit, atij i fshihen dhe i falen të tëra gabimet e mëkatet që mund të ketë bërë mes ikindisë dhe akshamit. E, nëse fal namazin e jacisë, atij i falen gjithë mëkatet mes akshamit dhe jacisë. Ai njeri mund të bëjë mëkate edhe gjatë natës, por, nëse merr abdes dhe fal namazin e sababut, Allahu ia fal atij çdo mëkat që mund të ketë bërë mes namazit të jacisë dhe atij të sababut.”

Ata që gjendeshin aty e pyetën atë:

- “Ne e kuptuam se çfarë vjen nga e mira, po punët e tjera të mira, cilat janë, o Osman?”

- “Të thuash: *La ilahe il'lallah, Subhanallah, Elhamdulil'lah, Allahu Ekber, Ue la haule ue la kuunte il'la bill'lah*,” – u përgjigj ai.”¹

Resulullahu i thotë dikujt: “Namazi i shlyen mëkatet.”

E tregon Aliu (radijallahu anhu): “Tshim me të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe po prisnim të hynte koha e namazit e ta falnim. Kur, papritur, njëri nga ne u ngrit dhe tha:

- “Unë bëra një mëkat.” I Dërguari i Allahut nuk u mor me të. Pas namazit, ai e tha edhe njëherë atë që kishte thënë njëherë më parë, e atëherë i Dërguari i Allahut i tha atij:

- “*Po ti a nuk more abdes dhe fale namazin pak më parë?*”

- “Po, e fala”, – u përgjigj ai njeri. Kësaj here, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- “*Ja pra, namazi që ti fale është shlyerje për mëkatin që ti the pak më parë se e ke kryer.*”²

Resulullahu, edhe para se të ndahej nga kjo jetë, e pati lënë namazin amanet

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Ja se cili ishte fjalë për fjalë amaneti që la Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pak para se të vdiste:

¹. Hejthemi, *Me'xhmen'z-Zenaid*, 2/30 (1649).

². Taberani, *Mu'xhemul-Ensat*, 7/301 (7560).

- “*Lidhuni fort me namazin! Dhe tregohuni sa më të drejtë me njerëzit, për të cilët jeni përgjegjës (skllëvërit, shërbyesit/et dhe ndihmësit tuaj!)*” Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) e pati përsëritur këtë fjali deri në çastin që shpirti i ishte afruar daljes e mund t’i fliste gjuha.”³

I Dërguari i Allahut ishte shumë i lidhur me namazin

Sipas një transmetimi që vjen prej Enes bin Malikut (radijallahu anhu), Profeti i profetëve (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ka thënë: “Më janë bërë të dashura për mua nga kjo botë aroma e mirë dhe gruaja, ndërsa namazin e kam si dritën e syve.”⁴

2. KUR SAHABËT I NXITIN MYSLIMANËT KAH NAMAZI

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) thotë se: “Nuk ka asnjë mysliman që ngjitet mbi një copë toke të ngritur, apo që të shkojë në një xhami të ndërtuar me gurët e tij e të falë namazin, e ai vend të mos i thotë: ‘Për Allahun ti fale namaz mbi tokën e Tij; në Ditën e Kiametit, kur të dal përpara Tij, unë do të dëshmoj në të mirën tënde.’”⁵

Tarik bin Shihabi tregon se: “Një natë qëndruam te Selman Farisiu (radijallahu anhu); doja të shihja se si e kalonte natën duke adhuruar Allahun e Madhërishëm. Aty drejt fundit të natës u ngrit dhe vetëm fali namaz. Megenëse, të them të drejtën kjo nuk është se më pëlqeu edhe aq shumë, ia bëra atij të ditur qëllimin se pse kisha qëndruar në shtëpinë e tij. Ai më ktheu këtë përgjigje:

- “Falini me xhemat të pesë kohët e namazit. Nëse dikush nuk përfshihet në hapësirën e ndonjë prej mëkateve vrastare, këto namaze janë shlyerja e tërë mëkateve të vogla. Në kohën që bie muzgu, njerëzit ndahen në tri kategori: ata që e kalojnë natën plotësisht në të mirën e tyre, ata që nata kalon e tëra në të keqen e tyre dhe ata që nuk u kalon as në të mirë, as në dëm të tyre. Ja se si, nëse njeriu përfiton nga rasti i rënies së errësirës, kur të gjithë bien të flenë, dhe çohet të falë namaz gjer në mëngjes, e tërë nata kthehet në natë përfitimesh për të. Por ka

³. Bejheki, *Shuabul-Iman*, 6/369 (8552).

⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/128 (12315).

⁵. El-Hindi, *Kenzul-Ummal*, 8/10 (21638).

edhe njerëz, të cilët përfitojnë nga errësira dhe nga fakti që të gjithë janë në gjumë dhe zhyten në mëkat. Ja, kjo natë është e tëra kohë humbjeje. Por ka edhe ca të tjerë, që, me të falur namazin e jacisë, bien të flenë. Kësisoj, për të tillët, nata nuk është as në dobinë, as në dëmin e tyre.

O Tarik! Qëndro larg ecjeve të lodhshme, zgjidh rrugën e mesme; ec, por ec pa ndërprerje!..”⁶

3. DISA FJALË DHE DISA VEPRIME TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT PËR TË TREGUAR RËNDËSINË E VEÇANTË TË NAMAZIT

Tregon Ebu Dherri (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) çohet gjatë natës dhe e kalonte të gjithë natën duke falur namaz. Gjatë namazit ai do të këndonte medoemos këtë ajet: **“Nëse Ti i dënon ata – nuk ka dyshim, që ata robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.”** (Maide, 5/118)⁷

Esuedi (radijallahu anhu) tregon: “Ne ishim pranë Aishes (radijallahu anha). Bisedën e ktheu te namazi i pandërprerë dhe te lidhja e fortë me namazin. Aishja (radijallahu anha) na tregoi: “I Dërguari i Allahut u sëmur për herë të fundit. Erdhi koha e namazit dhe u thirr ezani. I Dërguari i Allahut u ngrit dhe tha:

- “*Thojini Ebu Bekrit, t’ua falë ai namazin besimtarëve.*” Ata që ishin aty të pranishëm thanë:

- “Ebu Bekri është shumë i butë e i ndjeshëm, kur të kalojë në vendin tënd, në atë të imamit, për t’u prirë besimtarëve në namaz, nuk do ta përballojë dot e do të qajë.” Por, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) përsëriti të njëjtat fjalë. Edhe ata që qëndronin pranë tij i dhanë të njëjtën përgjigje.

Derisa, herën e tretë i Dërguari i Allahut tha:

- “*Edhe ju do të ndërhyjnë në çdo gjë, siç bënin gratë e kobës së Jusufit! Thojini*

⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/10 (21636).

⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/58.

*Ebu Bekrit, të dalë ai t'ua falë besimtarëve namazin!*⁸

Ebu Bekri (radijallahu anhu) sapo kishte nisur të falte namazin, kur i Dërguari i Allahut sikur u ndie pak më mirë dhe hyri në krahët e dy vetëve dhe shkoi edhe ai në xhami. Edhe tani më ngjan sikur i kam përpara syve këmbët e tij, të cilat me zor i tërhiqte mbi tokë nga dhimbjet. Kur hyri i Dërguari i Allahut në xhami, Ebu Bekri (radijallahu anhu) deshë të tërhiqej pas. Por i Dërguari i Allahut i bëri me shenjë që të vazhdonte. E çuan pranë Ebu Bekrit (radijallahu anhu) dhe u ul aty.”⁸

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “Resulullahu, tre ditë nuk erdhi në xhami. Ditën e tretë, kur u thirr ikameti dhe Ebu Bekri (radijallahu anhu) u bë gati të dilte para besimtarëve, Resulullahu tha:

- “*Hapeni perden!*” E hapën. Neve nuk na kujtohej asnjë ditë tjetër, kur fytyra e Resulullahut të jetë dukur aq e ëmbël sa dukej atë ditë. I bëri me shenjë Ebu Bekrit, që të dilte imam dhe tërhoqi perden. Ne nuk e patëm më fatin që të na e falte ai namazin derisa ia dorëzoi Zotit shpirtin.”⁹

4. RËNDËSIA QË KISHTE NAMAZI PËR SAHABËT FISNIKË

Tregon Misuer bin Mahremeja: “Pas plagosjes me kamë të Omerit (radijallahu anhu), unë shkova tek ai. I pyeta ata që ishin atje:

- “Si është?”

- “Siç e sheh.”, – mu përgjigjën ata. Unë u thashë atyre:

- “Nëse doni që të zgjohet, thirrreni për të falur namazin. Atë nuk e zgjoni dot me asgjë tjetër, veç namazit, edhe pse mund të duket më e rëndësishme!” Paskëtaj, ata thanë:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Erdhi koha për t’u falur.”

- “Hë, bëtë mirë që më folët, të çohem”, – tha, – “të falim namazin.” Mesa duket iu kujtua gjendja e atij që braktis namazin në Islam, e u çua dhe e fali namazin duke i rrjedhur gjak nga plaga.”¹⁰

⁸. Buhari, *Sahih*, 2/236 (633).

⁹. Buhari, *Sahih*, 1/240 (648).

¹⁰. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 2/27 (1636).

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Nuk shihja më nga sytë. Më këshilluan:

- “Sikur ta lësh namazin për disa ditë, të të mjekojmë e të të shërohen sytë.” Dhe unë iu përgjigja:

- “Jo, namazin nuk mund ta le dot, sepse i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na pati thënë:

- “*Nëse ndokush vdes pasi të ketë braktisur namazin, ai njeri do të përballët me ndëshkimin e rëndë të Allahut.*”¹¹

5. NDËRTIMI I XHAMIVE

Tregon Mutalib bin Abdullahu (radijallahu anhu): “Në vitin e njëzet e katërt të mërgimit, kur u bë kalif Osmani (radijallahu anhu), njerëzit shkuan tek ai dhe i kërkuan që të zgjeronte xhamitë, duke u ankuar se hapësirat e xhamive ishin tashmë të pamjaftueshme për xhematin, sidomos gjatë ditëve të premte. Prandaj, njerëzit kërkuan ndërtimin e një xhamie më të madhe, ku të mund ta falnin namazin në mënyrë më rehatshme. Osmani (radijallahu anhu) u këshillua edhe me sahabët e tjerë të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Edhe ata, të të njëjtit mendim ishin, që të rrëzohej xhamia ekzistuese dhe mbi të të ndërtohej një e re, më e bollshme. Osmani (radijallahu anhu) u fali atyre namazin e drekës, pastaj u ngjit në minber dhe pasi lëvdoi Allahun, tha:

- “O njerëz! Unë vendosa që ta prish xhaminë e të Dërguarit të Allahut dhe ta zgjeroj atë. E kam dëgjuar vetë kur i Dërguari i Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë: “*Kush ndërton një xhami në Tokë, Allahu ndërton për të një shtëpi në Xhenet.*” Paraardhësi im ishte Omer ibnu'l-Hatabi (radijallahu anhu). Edhe Omeri (radijallahu anhu) e pati zgjeruar atë njëherë më parë. Jam këshilluar edhe me parinë e sahabëve. Edhe ata janë të të njëjtit mendim, që ta prishim xhaminë ekzistuese dhe ta zgjerojmë atë.”¹²

¹¹. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/629 (6319).

¹². Muhamed Rida, *Uthman bin Affan*, 1/30.

6. MBAJTJA PASTËR E XHAMIVE

Urue bin Zubejri tregon: “I Dërguari i Allahut na ka urdhëruar neve që të caktojmë një vend për t’u falur edhe në shtëpitë tona, të tregojmë kujdes për ato hapësira dhe që t’i mbajmë pastër.”¹³

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Për pastërtinë e xhamisë kujdesej një grua, të cilën e quanin Harkau’s-Seuda. Një ditë ajo grua vdiq, por Profetin tonë nuk e patën lajmëruar se ajo kish vdekur. Kur e mori vesh i Dërguari i Allahut, tha:

- “*Më lajmëroni gjithmonë, kur të vdesë ndonjëri prej jush.*” Fali një namaz në emër të asaj gruaje dhe tha:

- “*Tani më bëhet sikur po e shoh teksa po fshin xhaminë e Xbenetit.*”¹⁴

7. MIRËSIA E SHKUARJES NË XHAMI DUKE ECUR

Tregon Zejd bin Thabiti (radijallahu anhu): “Ne po shkonim në xhami bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). I Dërguari i Allahut po ecte me hapa shumë të shpeshtë.

- “*E dini pse jam duke i hedhur hapat kaq të vegjël?*”, – na pyeti ai.

- “Allahu dhe i Dërguari i Allahut e dinë më mirë arsyen e vërtetë.”, – i thashë unë. I Dërguari i Allahut tha:

- “*Myslimani pranohet se është në namaz përgjatë gjithë kohës që do të jetë duke falur namaz. Prandaj unë po hedh sa më shumë hapa, për të shkuar te namazi.*”¹⁵

8. URTËSITË DHE FUNKSIONET E XHAMIVE

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Ne ishim ulur në xhami me të Dërguarin e Allahut, kur aty u shfaq papritur një beduin, që filloi të kryente ujët e hollë. Sahabët një ta parë, iu hodhën që t’i thoshin se ç’bënte ashtu. Mirëpo, i Dërguari i Allahut u tha atyre:

- “Ndalni, mos e prekni atë njeri; të mbarojë punë.” Sahabët nuk

¹³. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 2/117 (1963).

¹⁴. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 2/115 (1957).

¹⁵. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 2/151 (2092).

e ngacmuan atë njeri derisa përfundoi së kryeri nevojat. Mandej, i Dërguari i Allahut e thirri atë njeri pranë vetes dhe i tha:

- “*Ndotja e xhamive nuk është kurrsesi një sjellje e denjë. Faltoret ndërtohen për të përmendur Allahun, për të falur namaz dhe për të lexuar Kur’anin Famëlaritë.*” I kërkoi dikujt që të sillte një kovë me ujë dhe e derdhi ujin mbi vendin që kishte ndotur ai beduin.”¹⁶

Jezid bin Abdullah tregon: “Sahabët e Suffes ishin prej atyre sahabëve të të Dërguarit të Allahut që nuk kishin shtëpi ku të banonin. Këta njerëz, kur ishte gjallë i Dërguari i Allahut, jetonin e flinin në xhami. Edhe gjatë ditës, po t’i kërkoje, atje do t’i gjeje, sepse ata nuk kishin asnjë vend tjetër ku të strehoheshin. Në mbrëmje, i Dërguari i Allahut i thërriste banorët e Sufes. Disa prej tyre ai i dërgonte nëpër shtëpitë e sahabëve të tjerë, që të hanin a të kryenin ndonjë nevojë që mund të kishin; ndërsa një pjesë i mbante aty, me vete. Kështu vazhdoi edhe për ca kohë, derisa Allahu u fali myslimanëve më shumë pasuri e më shumë mundësi për të jetuar më mirë.”¹⁷

Tregon Esmâ binti Jezidi: “Ebu Dherr el-Gifari i shërbente të Dërguarit të Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem). Kur mbaronte punën, ai kthehej në xhami dhe atje flinte. E kishte si shtëpinë e tij xhaminë. Një ditë, i Dërguari i Allahut e gjeti atë të shtrirë, duke fjetur, në xhami dhe e zgjoi duke e ngacmuar me këmbë. Ebu Dherri drejtoi trupin dhe u ngrit. Ai i tha atij:

- “*Edhe ti fle këtu, o Ebu Dherr?*”

- “E ku të fle, o i Dërguari i Allahut; unë nuk kam shtëpi tjetër ku të fle!”, – u përgjigj Ebu Dherri.”¹⁸

Thirrja e Ebu Hurejres për shitësit në pazar

Një ditë, Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) doli në pazarin e Medinës; u ndal në një vend ku mund ta shihte e ta kishte në kontroll të gjithë tregun dhe thirri:

- “O shitës të pazarit! Ju jeni shumë të paafët!”

¹⁶. Muslim, *Sahih*, 1/236 (285).

¹⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 2/20.

¹⁸. Ahmed bin Hanbel, *Sunen*, 6/457 (27629).

- “E pse qenkemi të paaftë?”, – e pyetën ata njëzëri.

- “Atje është duke u ndarë trashëgimia e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe ju qëndroni akoma këtu. Nuk do të shkoni atje, të merrni edhe ju pjesën që ju takon?”, – u tha ai atyre.

- “Ku është duke u shpërndarë?”, – pyetën ata.

- “Në xhami.”, – tha Ebu Hurejreja.

Të gjithë sa ishin në pazar ngarendën drejt xhamisë. Ebu Hurejreja i priti atje. Tërë ata burra u kthyen ashtu siç kishin ikur, pa asgjë në duar. Ebu Hurejreja i pyeti:

- “Pse u kthyet?”

- “Ne shkuam në xhami, hymë brenda, por atje nuk po ndahej asnjë gjë! Ç’është e vërteta as nuk pamë të kishte ndonjë gjë për t’u ndarë!”, – thanë ata.

- “Po në xhami nuk gjetët askënd?”, – vazhdoi t’i pyesë Ebu Hurejreja (radijallahu anhu).

- “Po, pamë. Kishte ca njerëz që po falnin namaz, ca të tjerë që lexonin Kur’an, kurse disa të tjerë bisedonin me njëri-tjetrin për të lejuarën dhe të ndaluarën.”, – thanë ata dhe Ebu Hurejreja ua ktheu me fjalët:

- “T’ju vijë turp! Ja pra, ajo është trashëgimia e Muhamedit; dija!”¹⁹

9. SJELLJET QË JANË TË PAHIJSHME PËR T’U BËRË NË XHAMI

Të shkosh në xhami pasi ke ngrënë hudhra

Tregon Ebu Bekri (radijallahu anhu): “Pasi i Dërguari i Allahut ngadhënjeu në Hajber, njerëzit gjetën atje hudhra me shumicë, ndaj u mësuan shumë me ngrënien e saj. Në këtë situatë ndërhyri i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “*Të mos i afrohet xhamisë sonë ai që do të ketë ngrënë nga ajo bimë me erë të shpifur!*”²⁰

¹⁹. Taberani, *Muxhemul-Eusat*, 2/114 (1429).

²⁰. Ebu Daud, *Sunen*, 2/388 (3824).

Të kërkosh gjënë e humbur në xhami

Tregon Ibni Sirini (radijallahu anhu): “Ibni Mesudi dëgjoi zërin e dikujt që bërtiste për të lajmëruar se i kishte humbur diçka në xhami. Ibni Mesudi e qortoi atë burrë, duke i thënë:

- “Neve na është ndaluar që ta përdorim xhaminë për të lajmëruar për sendet e humbura.”²¹

E folura duke bërtitur në xhami

Saib bin Jezidi tregon: “Një ditë unë isha duke fjetur në xhami. Dikush më hodhi mua një guralec dhe më zgjoi. Kur pashë, ishte Omeri (radijallahu anhu), i cili më tha:

- “Ngrihu dhe më sill këtu ata dy persona.” I solla. Omeri (radijallahu anhu) u tha atyre:

- “Prej nga jeni ju?”

- “Nga Taifi.” – u përgjigjën ata. Omeri (radijallahu anhu) u foli atyre qortueshëm:

- “Po të kishit qenë vendas do t’jua kisha treguar unë qejfin. Ku keni parë ju, punë që bëhet është, të bërtasësh e të ulërish në xhaminë e të Dërguarit të Allahut?”²²

10. I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ FISNIKË I JEPNIN SHUMË RËNDËSI EZANIT

Abdullah bin Zejdi tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) po kërkonte një arsye që si e si t’i ftonte myslimanët në xhami. Me të ardhur koha e faljes së namazit, ai nxirrte dikë në një vend më të ngritur; e ai i lajmëronte besimtarët duke u bërë shenja me duar. Ata që shihnin shenjën vinin në namaz, kurse ata që nuk e shihnin nuk e kuptonin dot që kish ardhur koha për të falur namazin. Kjo ishte një çështje që e fuste në mendime shumë të thella të Dërguarin Fisnik

²¹. Hejthemi, *Mexbmen’-Zeuaid*, 2/139 (2045).

²². Buhari, *Sabih*, 1/179 (458).

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Disa i patën propozuar atij:

- “Po sikur të përdorësh një kambanë, o Resulullah!” I Dërguari i Allahut i pyeti:

- “*Siç bëjnë të krishterët? Jo, nuk bëhet!*”, – tha ai. Një grup tjetër nga besimtarët thanë:

- “Po sikur të përdorësh një buri?!” I Dërguari i Allahut këtë e kundërshtoi, duke arsyetuar se kjo do të ishte një ngjasim me hebrenjtë.

Pas kësaj bisede unë u ktheva në shtëpi. Fakti që i Dërguari i Allahut po lodhej aq shumë për të gjetur një zgjidhje më futi edhe mua në të thella, se mos gjeja ndonjë zgjidhje, për t'i ardhur në ndihmë Resulullahut. Atë natë, deri kur filloi të binte perdja e errësirës e të zbardhte, atë sikur e mbuloi një mjegull tymi. Sipër pashë një njeri që kishte veshur dy palë tesha të gjelbra njëra mbi tjetrën. Isha në një gjendje mes zgjimit dhe gjumit. Ai njeri u ngjiti në majë të xhamisë, vuri gishtat mbi veshët dhe filloi të këndojë ezanin që këndohet edhe sot e kësaj dite.”²³

Një gjykim dhe interpretim i Aishes (r.a.) rreth rëndësisë së veçantë të ezanit

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Ajeti: **‘E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam mysliman.’**” (Fussilet, 41/33) është zbritur enkas për myezinët. Ata, për të cilët bëhet fjalë në këtë ajet janë myezinët. Kur myezini thotë: *‘haj’jeales’salah - ejani në namaż*, është ai që po i fton myslimanët në rrugën e Allahut. Edhe kur fal namazin ai është duke kryer një punë shumë të mirë e të bekuar. Dhe kur thotë, ‘Esh’hedu en la ilahe il’lallah’ – ai bëhet mysliman edhe njëherë.”²⁴

Rëndësia që kishte ezani për Omerin (r.a.)

Tregon Ebu Ma’sheri: “E kam dëgjuar vetë Omerin (radijallahu

²³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/551 (23143).

²⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/557 (23158).

anhu), kur ka thënë:

- “Nëse do të kisha qenë myezin, nuk do të isha mërztur edhe sikur të mos kisha bërë asnjë haxh tjetër, veç atij që është detyrim. Nëse engjëjt do të jetonin në Tokë, ata nuk do t’ia kishin lënë tjetërkujt detyrën e veçantë të këndimit të ezanit.”²⁵

11. I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ PRISNIN HYRJEN E KOHËS SË NAMAZIT DHE GRUMBULLIMIN E XHEMATIT

Abdullah bin Ebi Eufa (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) për sa kohë që dëgjonte zhurma takash të shapkave dhe sandaleve të besimtarëve, nuk e niste faljen e namazit.”²⁶

Tregon Abdullah bin Amri: “Resulullahu na fali neve namazin e akshamit. Disa prej besimtarëve u kthyen në shtëpi. Një pjesë tjetër qëndroi në xhami. Pas pak, erdhi i Dërguari i Allahut dhe na tha:

- “Zoti na hapi një prej portave të qiejve. Ai po u krenohet engjëjve me ju, ja se si po ua shpreh Ai atyre krenarinë për ju: ‘Robt e mi e falën namazin në kohën e vet, e tani po presin që të hyjë koha e namazit tjetër.’”²⁷

Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na tha:

- “A doni që t’ju tregoj ato punë e sjellje që do të bëhen shkak që t’ju fshihen mëkatet e t’ju rriten gradët pranë Allahut?”

- “Na i trego, o i Dërguari i Allahut!”, – i thamë ne, kur i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) numëroi:

- “Marrja e abdesit plotësisht dhe pa asnjë të metë, bedhja e sa më shumë hapave dhe shpejt gjatë rrugës për në xhami dhe të rrish në pritje të hyrjes së kohës tjetër të namazit, pasi e ke falur namazin e radhës. Ja pra, këto janë pikat, përmes të cilave ju mund të lidheni më së forti me Zotin tuaj.”²⁸

²⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/556 (23157).

²⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/444 (22851).

²⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/434 (22824).

²⁸. Muslim, *Sahih*, 1/219 (251).

12. RËNDËSIA E TË FALURIT ME XHEMAT E TË PESË KOHËVE TË NAMAZIT

Amr bin Ummu Mektumi tregon: “Unë i thashë të Dërguarit të Allahut:

- O Profeti i Zotit! Unë jam një njeri që nuk sheh nga asnjë prej syve. E shtëpinë e kam shumë larg prej xhamisë. E, për më tepër, as nuk kam njeri që të më sjellë në xhami e nuk kam kurrfarë mundësie që të mund të vij i vetëm. Jo gjithmonë arrij që të gjej ndokënd që të më shoqërojë gjer këtu. Vallë, a mund të më lejosh mua që ta fal namazin në shtëpinë time?” Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më pyeti:

- “*A e dëgjon ezanin nga shtëpia?*”

- “Po!”, - iu përgjigja unë.

- “*Atëherë, unë nuk mund të të jap leje që të mos vish e ta falësh namazin në xhami.*”, – më tha i Dërguari i Allahut.”²⁹

Anbese bin Ez’heri e tregon: “Harith bin Hassani sapo qe martuar. (Harithi ishte një nga sahabët e të Dërguarit të Allahut). Asokohe, djemtë e sapomartuar mbylleshin në shtëpi dhe shumë herë e kishin të pamundur që të vinin në xhami, për të falur namazin e sabahut. Harithi, të nesërmen e martesës shkoj në xhami, të falte namazin e sabahut. Shokët iu afruan dhe e pyetën:

- “Po ti mbrëmë u martove, pse dole edhe sot për namazin e sabahut?”

- “Për Zotin,” – u përgjigj Harithi, – “ajo grua që më privon mua nga falja e namazit me xhemat është grua e keqe.”³⁰

13. LIDHJA E RADHËVE FORT DHE TË RREGULLTA GJATË NAMAZIT

Numan bin Beshiri (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na i rregullonte neve radhët kur bëheshim

²⁹. Mundhiri, *et-Tergih*, 1/167 (623).

³⁰. Hejthemî, *Mexhmeu’z-Zeuaid*, 2/167 (2158).

gati për të falur namazin, sikur të ishte duke vënë me kujdes shigjetat në trastën e tyre. Derisa edhe ne u mësuaam dhe filluam të kujdeseshim vetë, që të radhiteshim ashtu siç na e kishte mësuar i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Një ditë, sapo u bë gati për të thirrur tekbinin, kur pa që kraharori i dikujt doli pak më para se trupat e gjithë të tjerëve. Ndërhyri menjëherë, duke thënë:

- “O robt e Zotit, rregullojini mirë radhët tuaja; në të kundërt, ju do t’ju prishet bashkimi, e nuk do të jetoni për njëri-tjetrin.”³¹

Numan bin Beshiri (radijallahu anhu) thotë se: “Unë pashë një njeri, supi i të cilit u bashkua me supin e atij që kishte ndanë; kurse thembrat iu bashkuan me thembrat e tij.”³²

14. IMAMI KUJDESET PËR NEVOJAT E NDRYSHME TË XHEMATIT

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte njeri shumë i dhembshur. Sa herë që ndokush prej bashkësisë së tij i kërkonte ndonjë gjë, apo kishte nevojë për diçka, ai, po të kishte mundësi, do t’ia përmbushte medoemos. Nëse nuk do të kishte mundësi, ai do t’i jepte fjalën se do t’ia gjente. Një ditë u thirr ikameti për të falur namazin. Erdhi një beduin dhe e kapi atë nga rroba e i tha:

- “Unë kisha një nevojë, e kam shumë frikë se mos e harroj.” I Dërguari i Allahut u largua menjëherë, ia përmbushi atij njeriu nevojën, pastaj u fali besimtarëve namazin.”³³

15. TË BËHESH IMAM DHE NDJEKJA E IMAMIT ME PËRPIKËRI

Abdullah bin Handhale (radijallahu anhu) tregon: “Ne ishim në shtëpinë e Kajs bin Sa’d bin Ubades. Aty ishin edhe një grup nga sahabët e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ne i thamë Kajsit:

- “Eja, dil ti imam e na e fal ti këtë namaz!”

³¹. Muslim, *Sahih*, 1/324 (436).

³². Ebu Daud, *Sunen*, 1/234 (662).

³³. Buhari, *Edebu'l-Mufred*, 1/105 (278).

- “Punë që s’bëhet.”, – u përgjigj ai. Por unë thashë: Ka thënë i Dërguari i Allahut:

- “*Më e mira është që çdokush të flejë atje ku ka krevatin e vet, t’i hipë kafshës së vet të rrugës dhe të bëhet imam në shtëpinë e tij, sepse kjo është më e përshtatshme.*” Atëherë, Kajsi nxori si imam skllavin e tij të liruar dhe ai na e fali neve atë namaz.”³⁴

Talha bin Ubejdullahu (radijallahu anhu) tregon: “Unë i pata falur namazin një xhemati. Pasi u priva atyre në namaz, unë u ktheva kah ata për t’u thënë:

- “Para se të dilja imam unë harrova që t’ju kërkoja leje juve më parë, që të na printe dikush nga ju në namaz. Vërtet e kam, a jeni të kënaqur me namazin tim?”

- “E si të mos na pëlqejë neve dalja jote si imam! A ka njeri që të mos i pëlqejë kur imam i del një nga shokët më të rrallë e më të zgjedhur të të Dërguarit të Allahut!”, – u përgjigjën ata. E unë u thashë atyre:

- “Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur ka thënë: *‘Nëse dikush del imam përpara një bashkësie që nuk e do atë si imam, atëherë dalja e tij si imam është e papranuar.’*”³⁵

16. KUR I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ QANIN GJATË FALJES SË NAMAZIT

Ubejd bin Umejri (radijallahu anhu) e pyeti njëherë Aishen (radijallahu anha):

- “A mund të më tregosh se cila ka qenë sjellja më interesante që ke parë ndonjëherë tek i Dërguari i Allahut?” Aishja (radijallahu anha) heshti për një çast, pastaj më tha:

- “Një natë, i Dërguari i Allahut më tha mua:

- “*O Aishe! Sonte dua që të më lësh vetëm. Dua të adburtoj Zotin.*”

- “Për Zotin”, – iu përgjigja, – “vërtet dua që të të kem pranë, por unë e dua shumë edhe atë që do ti më së shumti.” I Dërguari i

³⁴. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 2/208 (2332).

³⁵. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 2/212 (2344).

Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u ngrit, mori abdes dhe filloi të falë namaz. Ishte i ulur, kur filloi të qajë, aq sa mjekra iu bë e tëra qull në lot. Madje, aq shumë qau, saqë edhe vendi u lag nga lotët e derdhur. Bilali, kur e pa se si po qante Resulullahu, tha:

- “O Resulullah! Po Zoti ty t’i ka falur të tëra mëkatet e shkuara dhe ato të ardhme, pse vazhdon ti të qash kështu akoma?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) iu përgjigj atij e i tha:

- “Po pse, të mos jem unë një rob që e falënderon Zotin? Sonte mua m’u zbrit një ajet kur’anor. Më vjen keq dhe turp për ata që e lexojnë atë ajet, pa e kuptuar e pa medituar për të! Ajeti ishte ky: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja dhe mësim për mendarët.”** (Al Imran, 3/190)³⁶

17. PËRULJA NË NAMAZ

Tregon Ummu Rumani: “Njëherë, kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) më kishte parë mua në namaz duke parë njëherë majtas e njëherë djathtas, më pati qortuar aq ashpër, saqë për një çast mu duk sikur do të më prishej namazi. Pasi përfundova namazin, u kthye nga unë dhe më tha kështu:

- “Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), që ka thënë: *‘Kur të bëheni gati për të falur namazin, shkëputini tërësisht marrëdhënien me ato çfarë keni përreth; mos u ktheni sa majtas djathtas siç bëjnë hebrenjtë, sepse edhe shkëputja e marrëdhënies me ambientin përreth është një pjesë e namazit.’*”³⁷

18. KUJDESI I VEÇANTË QË TREGONTE I DËRGUARI I ALLAHUT PËR SUNETET

Aishja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u jepte më shumë rëndësi dhe tregonte një kujdes më të veçantë për sunetet e namazit të sabahut më shumë sesa të çdo namazi tjetër.”³⁸

³⁶. Ibn Hibban, *Sahib*, 2/386 (620).

³⁷. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 9/304.

³⁸. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 3/276.

Abdullah bin es-Saibi (radijallahu anhu) tregon: “Pasi dielli kalonte kulmin e qiellit, para se të falte namazin e drekës, i Dërguari i Allahut falte katër rekate sunet dhe thoshte: *‘Dua që punët e mia të mira të shkojnë tek Allahu në këto orë kur dyert e qiejve hapen e gjithçka çohet përpara Allahut.’*”³⁹

Aliu (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) falte katër rekate namaz sunet para farzit të namazit të drekës, ndërsa pas farzit falte edhe dy rekate të tjera sunet.”

Aishja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari i Allahut, kur nuk i falte dot katër rekartet e sunetit të namazit të drekës, ai i falte ato pas farzit.”⁴⁰

Aliu (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut, para se të falte detyrimin e namazit të ikindisë, falte njëherë katër rekate namaz sunet; këto katër rekate ai i falte dy e nga dy, duke përshëndetur engjëjt më të afërt me Allahun dhe mbarë besimtarët që i ndjekin ata.”⁴¹

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), pas detyrimit të namazit të akshamit falte edhe dy rekate namaz sunet. Gjatë këtyre dy rekateve ai këndonte pjesë të gjata të Kur’anit, aq sa kur *jepte selam*, ishte shpërndarë pothuajse i tërë xhemati.”⁴²

Aliu (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më pati këshilluar mua që tri gjëra të vazhdoja t’i bëja e të mos i braktisja asnjëherë për sa të kisha jetë. Njëra prej tyre ishte edhe falja e katër rekateve namaz të sunetit të ikindisë para farzit. Dhe unë, sa të kem jetë, nuk do ta braktis asnjëherë faljen e tyre.”⁴³

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Ai njeri që fal katër rekate të tjera pas namazit të akshamit, është sikur të marrë pjesë edhe në një luftë tjetër në rrugën e Allahut kur sapo është kthyer nga lufta në rrugën e Allahut.”⁴⁴

³⁹. Tirmidhi, *Sunen*, 2/342 (478).

⁴⁰. Tirmidhi, *Sunen*, 2/291 (426).

⁴¹. Tirmidhi, *Sunen*, 2/293 (429).

⁴². Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 2/483 (3381).

⁴³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/70 (21801).

⁴⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/82 (21837).

19. RËNDËSIA E NAMAZIT TË NATËS PËR TË DËRGUARIN E ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ

Abdullah bin Kajsi (radijallahu anhu) tregon: “Aishja (radijallahu anha) ka thënë: “Mos e braktis kurrë namazin e natës, sepse i Dërguari i Allahut nuk rrinte asnjë natë pa falur namaz. Edhe kur ishte i sëmurë, apo ishte shumë i lodhur, ai do të falte namaz gjatë natës, qoftë edhe i ulur.”⁴⁵

Xhabiri (radijallahu anhu) tregon: “Në kohën kur u zbritën ajetet: **“O ti i mbuluar (o Muhamed)! Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo dhe lexoje Kur’anin ngadalë dhe qartë...”** (Muzzemmil, 73/1-4), falja e namazit të natës qe bërë detyrim edhe për ne sahabët. Erdhi kjo urdhëresë nga ana e Zotit dhe ne nisëm të faleshim derisa këmbët zinin të na ënjteshin. Por, më vonë, u zbrit edhe ajeti:

“Natyrisht, Zoti yt e di se ti (o Muhamed) falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një të tretën e saj, si edhe disa prej atyre që janë me ty. Allahu e përcakton gjatësinë e ditës dhe të natës dhe e di se ju nuk mund ta llogarisni atë saktësisht, prandaj kthehet tek ju me mëshirë. Kështu që lexoni Kur’an aq sa mundeni! Ai e di se disa prej jush do të jenë të sëmurë, disa do të udhëtojnë nëpër botë, duke kërkuar mirësitë e Tij (për jetesë) dhe disa të tjerë do të jenë duke luftuar në rrugën e Tij, prandaj lexoni sa keni mundësi nga Kur’ani! Faleni namazin, jepeni zekatin dhe jepini Allahut një hua të mirë (që Ai t’ju kthejë shumëfish). Çfarëdo mirësie që bëni për shpirtin tuaj, me siguri që do ta gjeni tek Allahu. Ajo do të jetë më e mirë dhe më e shpërblyer. Kërkoni faljen e Allahut, sepse Allahu është vërtet Falës i madh dhe Mëshirëplotë.” (Muzzemil, 73/20)⁴⁶

Omeri (r.a.) dhe namazi i natës

Eslemi tregon: “Omeri (radijallahu anhu) sa të kishte mundësi natën do ta kalonte duke falur tehexhud (namaz nate); mandej gjysmën tjetër

⁴⁵. Ebu Daud, *Sunen*, 1/417 (1307).

⁴⁶. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zeuaid*, 2/519 (3517).

Ndjeshmëria dhe kujdesi për namazin tek i Dërguari Fisnik dhe te sahabët e tij

të natës ai i zgjonte edhe pjesëtarët e tjerë të familjes, duke u thënë:

- “Namazil..” Veç kësaj, ai u këndonte atyre edhe ajetin: **“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut.”** (Taha, 20/132)⁴⁷

Ibni Omeri dhe namazi i natës

Tregon Nafiu: “Ibni Omeri i jepte jetë natës duke falur namaz, pastaj thërriste:

- “O Nafi, a ka hyrë koha për namazin e sabahut?” Dhe, kur unë i thosha:

- “Jo, ende nuk ka hyrë.”, – ai vazhdonte të falte namaz. Pas njëfarë kohe, ai pyeste sërish:

- “Nafi, a ka hyrë koha për namazin e sabahut?” E, kur unë i thosha:

- “Po!”, – ai ulej derisa të zbardhte mirë dhe i lutej Allahut e i kërkonte që ta falte.”⁴⁸

Ebu Galibi (radijallahu anhu) tregon: “Ibni Omeri pati ardhur në Mekë dhe mysafir pati qëndruar tek ne. Çohej natën dhe falte namaz tehexhudi. Një natë, aty gati në të ardhur të agimit, tha:

- “O Ebu Galib, po ti nuk do të çohesh për të falur namaz? Të paktën deri tani do të kishe kënduar një të tretën e Kur’anit!” Unë i thashë:

- “Por edhe pak e do të agojë, e si ta lexoj unë një të tretën e Kur’anit në kaq pak kohë sa ka mbetur?” Ai më tha mua:

- “Sureja e “Ihlasit”, ajo më vete është sa një e treta e Kur’anit Famëlartë.”⁴⁹

20. RËNDËSIA QË I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ I JEPNIN NAMAZIT NAFILË

E tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut

⁴⁷. Bejheki, *Shuabu'l-Iman*, 3/127 (3086).

⁴⁸. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/303; Ibn Haxher, *el-Isabe*, 1/349.

⁴⁹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/304.

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati dërguar diku një ekspeditë. Ushtarët u kthyen pas shumë shpejt dhe për më tepër, patën marrë edhe shumë plaçkë. Ishte kjo arritje, që dikush erdhi e tha:

- “O Resulullah! Deri më sot ne nuk kemi parë ndonjëherë trupë luftarake që të shkojë e të kthehet kaq shpejt e me kaq shumë plaçkë nga lufta.” I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha atyre:

- “*A doni që t’ju tregoj unë dikë, i cili ka shkruar në luftë dhe jo vetëm që është shkruar më shpejt, por edhe me më shumë plaçkë të fituar? Ai është ai që merr abdes siç duhet, shkon në xhami dhe pasi fal namazin e sababut me besimtarët, pret dhe fal edhe namazin e Dubasë.*”⁵⁰

Aishe binti Sa’di (radijallahu anha) tregon: “Sa’d bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) namazin e Duhasë e falte me tetë rekate.”⁵¹

Muhamed bin Amar bin Jasiri (radijallahu anhu) tregon se: “Unë kam parë Amar bin Jasirin (radijallahu anhu), që, pasi falte namazin e akshamit, falte edhe gjashtë rekate namaz të tjera. Ai më ka thënë mua:

- “Fort i Dashuri im, i Dërguari Fisnik, pasi falte namazin e akshamit, falte edhe gjashtë rekate namaz nafie shtesë. Kam qenë vetë aty, kur ka thënë: “*Atij që fal namazin e akshamit, pastaj fal edhe gjashtë rekate namaz të tjera, i falen të gjitha mëkatet, edhe sikur t’i ketë sa shkuma e detit.*”⁵²

21. NAMAZI I TERAUISË DHE SAHABËT

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: “Ishte gjatë muajit të Ramazanit, kur, një ditë, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pa myslimanët teksa faleshin në njërën anë të xhamisë. Ai pyeti se çfarë po bënin ata ashtu. Myslimanët që gjendeshin aty iu përgjigjën:

- “Këta, duke qenë se nuk dinë shumë pjesë përmendësh nga Kur’ani, vënë Ubej bin Ka’bin që t’u prijë për të falur namazin.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i përgëzoi ata të gjithë duke thënë:

⁵⁰. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 2/491 (3406).

⁵¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/667 (23462).

⁵². Taberani, *Mu’xhemu’l-Eusat*, 7/191 (7245).

- “*Sa mirë po bëjnë, kjo është diçka shumë me vend!*”⁵³

Tregon Urueja (radijallahu anhu): “Omeri (radijallahu anhu) i mblodhi myslimanët, që të organizoheshin dhe t’i jepnin më shumë jetë muajit të Ramazanit dhe u tha:

- “Burrat ta falin namazin me imam Ubej bin Ka’bin, kurse gratë me Sulejman bin Ebu Hathmen.”⁵⁴

Ja se si tregon Omer bin Abdullah el-Ansiu: “Ubej bin Ka’bi dhe Temim Dariu kalonin në vendin e të Dërguarit të Allahut dhe u falnin besimtarëve burra namazin e terauisë. Kurse, në një pjesë tjetër të xhamisë imam dilte Sulejman bin Ebu Hathmeja, i cili u falte namazin e terauisë grave. Kur në krye të kalifatit u vendos Osmani (radijallahu anhu), ai kërkoi që në namaz të printe vetëm Sulejman bin Ebu Hathmeja, për të gjithë, burra e gra. Ai u kërkoi grave që të mos largoheshin, por të prisnin gjersa nga xhamia të largoheshin burrat.”⁵⁵

22. NAMAZI I NEVOJËS

E tregon Aliu (radijallahu anhu): “Seç kisha një dhimbje të fortë në trup, që vështirë t’jua përshkruaj. Shkova tek i Dërguari i Allahut. I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më uli mua në vendin e tij dhe u ngrit për të falur namaz. Një pjesë të veshjes së tij ma hodhi mua në trup. Pasi mbaroi së faluri namazin, u kthye nga unë e më tha:

- “*Nuk ke asgjë, o i biri i Ebu Talibit! Unë i kërkova Zotit për ty atë që i kërkova edhe për veten time. Dhe Allahu më ka falur mua çdo të mirë që unë i kam kërkuar; por mua më është thënë se, ‘pas teje nuk do të vijë më profet tjetër’.*”

Aliu (radijallahu anhu) thotë:

- “Kur u çova, nuk e kisha më atë dhimbje që më kishte çuar të ankohesha tek i Dërguari i Allahut!”⁵⁶

Historia e Ebu Mual’lekut

E tregon Enes bin Maliku (radijallahu anh): “Mes sahabëve të

⁵³. Bejheki, *Sunen*, 2/495 (4388).

⁵⁴. Bejheki, *Sunen*, 2/493 (4380).

⁵⁵. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 5/26.

⁵⁶. Bejheki, *Sunen*, 5/151 (8533).

të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte edhe një besimtar me emrin Ebu Mual'lek. Ebu Mual'leku (radijallahu anhu) ishte një tregtar i zoti për të realizuar marrëveshje të mira, i drejtë dhe shumë i devotshëm karshi Zotit. Një ditë ai kishte dalë për rrugë, kur përpara i kishte dalë një hajdut, që i kishte prerë rrugën. Hajduti i kishte thënë atij:

- “Nxirri të gjitha ç’ke me vete, se do të të vras!” Ebu Mual'leku i tha atij:

- “Merri të gjitha ç’të duhen, mall e plaçkë e paral!” Kësaj here hajduti i tha:

- “Jo, unë nuk dua asgjë veç jetës tënde!” Atëherë Ebu Mual'leku i tha atij:

- “Epo mirë, më jep të paktën pak kohë sa të fal namaz.”

- “Po,” – iu përgjigj hajduti, – “namaz mund të falësh sa të duash!” Ebu Mual'leku, pasi fali namazin, iu drejtua Allahut në lutje, duke iu përgjyruar me fjalët:

- “O Ti që je më i Dashuri dhe i Dashuruari i zemrave, Zotëruesi i Fronit më Madhështor, Zoti im që nuk ka gjë që të mos e realizojë dot! Unë të përgjyrohëm, për hir të atij Nurit Tënd që ka mbështjellë tërë gjithësinë, për hir të atij Sulltanati të pashoq dhe të Krenarisë e Shenjtërisë Sate, shpëtomë mua prej së keqes së këtij hajduti e keqbërësi. O Zoti im që i shkon në ndihmë kujtdo që mbetet ngushtë e në nevojë për ndihmesën Tënde, ndihmomë edhe mua, o Zoti!”

Sapo e mbaroi lutjen Ebu Mual'leku, aty ia behu fare papritur, e s’u pa se nga erdhi, një kalorës me një heshtë të mprehtë në dorë, të cilën e mbante në lartësinë e veshit. Kalorësi e kapi atë hajdut dhe e vrau, pastaj u kthye nga Ebu Mual'leku.

- “Po ti kush je, kush je ti?”, – e pyeti atë Ebu Mual'laku. “Apo, vallë, mos je ti që të dërgoi Zoti për të më shpëtuar mua nga e keqja e këtij hajduti?” Kalorësi iu përgjigj atij me fjalët:

- “Unë vij nga qielli i katërt. Kur ti bërë lutjen e parë, unë dëgjova se si kërcitën portat e qiejve. Kur bërë lutjen e dytë, dëgjova gumëzhimën e banorëve të qiellit. Ndërsa, kur bërë lutjen e tretë, në qiej u tha: ‘Po

lutet dikush që ka nevojë për ndihmë.’ Paskëtaj iu luta edhe unë Zotit, që të më dërgonte mua për ta vrarë atë njeri. Dhe Allahu i Lartësuar ma pranoi kërkesën, duke më thënë: “Ta dish, Unë i vij në ndihmë atij që merr abdes dhe fal katër rekate namaz, duke bërë edhe këtë lutje, nëse ai është zënë ngushtë e ka nevojë për ndihmën Time.”⁵⁷

⁵⁷. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 4/182.

DASHURIA E PROFETIT DHE E SAHABËVE PËR DIJEN DHE NXITJA DREJT SAJ



1. SI I NXISTE I DËRGUARI I ALLAHUT NJERËZIT DREJT DIJES

Safuan bin Asali (radijallahu anhu) tregon: “Shkova në xhami për tek i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe e gjeta atë atje të ulur, kishte veshur një rrobë të kuqe. Unë i thashë atij:

- “Kam ardhur tek ti, sepse dua të mësoj dhe të di më shumë.” Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më priti mua me fjalët:

- “*Mirë se erdhe o njeri kureshtar për dijen! Engjëjt, ngase i duan shumë ata që e kërkojnë dijen, mbledhen të gjithë rreth tij dhe i rrabin flatrat aq shpejt, sa që lartësohen deri në qiej, duke krijuar një hallkë të përsosur.*”¹

Ebu Uname el-Bahili (radijallahu anhu) tregon: “Të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) iu fol rreth dy llojeve njerëzish, njëri ishte i ditur, ndërsa tjetri ishte adhures shumë i mirë i Allahut (xhel’le xhelaluhu). Resulullahu na tha:

¹. Mundhiri, *et-Tergib*, 1/52 (108).

- “*Epërsia e të diturit (atij që i përkushtohet dijes) ndaj adhuruesit është si epërsia ime me ata prej jush që janë në nivelin më të ulët. Allahu, engjëjt, banorët e lartësive më të epërme, madje edhe milingona në tokë e peshqit në det, luten dhe kërkojnë falje për ata që u mësojnë njerëzve mirësinë.*”, – dhe në vijim këndoi ajetin kur’anor: **“Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”** (Fatir, 35/28)²

2. ALIU (r.a.) I NXIT NJERËZIT DREJT DIJES

Tregon Kumejl bin Zijadi: Aliu (radijallahu anhu) më kapi për dore dhe më nxori nëpër shkretëtirë. U ulëm në një vend. Pasi u çlodhëm për pak çaste, Ai më tha mua këto fjalë:

- “Shiko, Kumejl! Zemrat u ngjajnë enëve. Kurse zemra më e mirë është ajo që ka aftësinë më të fortë për të kuptuar. Tani dëgjomi me kujdes këto fjalë që po të them: njerëzit janë tre llojesh. Në grupin e parë bëjnë pjesë dijetarët që u janë falur aftësi të veçanta prej hyjnore. Të dytët janë nxënësit e dijes, të cilët bëjnë përpara në rrugën e shpëtimit. Kurse, për sa u përket njerëzve të tretë, janë ata që përbëjnë turmat e paditura. Këto masa vërtiten e vërviten andej nga fryn era, pasi ata nuk janë ndriçuar nga drita e dijes. E ata as nuk kanë ndonjë pikë të fortë mbështetëse referimi.

Dija është më e mirë e më e mbarë sesa pasuria. Dija të mbron; kurse pasurinë duhet ta ruash e ta mbrosh ti. Dija, kur vihet në veprim, shtohet; kurse pasuria pakësohet duke e shpenzuar. Të duash njeriun e ditur është një përgjegjësi, e cila bie mbi të gjithë për ta kryer. Dija e bën njeriun e ditur të dashur, të nderuar e të respektuar përgjatë gjithë jetës; ajo bën të mundur që njeriun e ditur ta kujtojnë për gjatë kohës edhe pasi ai të ketë vdekur. Kurse pozita që të mundëson pasuria humb bashkë me humbjen e saj. Sa e sa njerëz të pasur, të cilët, edhe pse janë ende gjallë, janë si të vdekur. Por dijetarët nuk janë ashtu, ata do të jetojnë për aq sa të ekzistojë edhe bota. Edhe nëse vdesin ata

² Tirmidhi, *Sunen*, 5/50 (2685).

vetë, veprat, emri dhe fama e tyre do të jetojnë si një kujtim i mirë në zemrat e njerëzve.

(Tregoi kraharorin e tij me dorë dhe tha) Ah, ah, sikur të mund të gjeja njerëz të denjë, të cilëve të mund t'u përcillja gjërat që di unë! Kam gjetur disa veta, por ata nuk më japin siguri. Edhe dijen që u është dhënë për të kuptuar fenë e Allahut ata e përdorin për interesa të kësaj bote. Argumentet e shpallura nga Allahu i përdorin kundër librit të Tij; ndërsa mirësitë që u ka falur Allahu ata i përdorin kundër robve të Tij. Disa, edhe pse mbajnë anën e njerëzve të së drejtës dhe të së vërtetës, nuk kanë aspak largpamësi në lidhje me jetësimin e urdhëresës së Atij që është më i Drejti. Bien në dyshime e lëkunden që në hapat e para. Të dy këta grupe nuk bëjnë dobi. Por ka edhe një grup, që vullnetin ua kanë marrë peng dëshirat dhe epsheet. Disa të tjerë janë të zënë duke vënë pasuri më shumë. Asnjë nga këta nuk mund të bëhen lajmëtarë që ftojnë njerëzit në fe. Këta njerëz u ngjajnë më tepër gjedhëve që kullotin nëpër kullota.

Me vdekjen e dijetarëve të vërtetë vdes njëfarësoj edhe vetë dija. Jo, o Zot! Nuk dua të ndodhë diçka e tillë! Të mos mbesë pa njerëz të ditur kjo botë, o Zot, e të shkojnë dëm gjithë ato argumente e tërë ato ajete aq të qarta, që provojnë ekzistencën Tënde! Këta janë shumë pak, por vlera e tyre pranë Allahut është shumë e lartë. Me këta e mbron Allahu i Madhërishtëm fenë e Tij. Janë pikërisht këta njerëz të ditur, që e përcjellin amanetin e marrë prej Zotit tek ata që janë më të denjë për ta transmetuar. Mes tërë atyre njerëzve të zhytur në kënaqësitë e lezetin e kësaj bote, ata janë aq të butë. Dija për ta është shoku e mikun më i mirë e më i sigurtë, atë dije që injorantët nuk e duan. Dija u fal atyre një dashuri, një dëshirë e një pasion të atillë, që, edhe pse trupin mund ta kenë në këtë botë, shpirtrat e tyre jetojnë në botën e domethënies. Ja pra, këta janë trashëgimtarët (kalifët) e Tokës dhe lajmëtarët e ftuesit e mirëfilltë të Islamit në të! Ah sikur të mund të kisha parë unë prej njerëzve të tillë! Unë i përgjerohem Allahut, që të na falë, si mua, ashtu edhe ty. Po deshe mund të ngrihem tani.”³

³. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/79.

3. NXITJA E EBU'D-DERDASË PËR DIJEN

Është transmetuar prej Hasan Basriut (radijallahu anhu) se Ebu'd-Derdaja (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Ose bëhu njeri i ditur, ose nxënës, ose njeri që e do dijen, ose njeri që i bindet asaj. Por i pesti i këtyre mos u bëj. Në të kundërt, je i marrë fund.”⁴

4. NXITJA E EBU DHERRIT DHE E EBU HUREJRES PËR DIJEN

Si Ebu Dherri (radijallahu anhu), ashtu edhe Ebu Hurejreja (radijallahu anhu), kanë thënë:

- “Nëse një njeri mëson një çështje diturie (shkencore), kjo është më mirë sesa nëse do të kishte falur njëmijë rekate namaz shtesë; më e dashur, sepse, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë: *“Ai njeri që vdes duke mësuar dije është dëshmor.”*⁵

5. EBU HUREJREJA REND PAS DITURISË

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) thotë:

- “Thonë se Ebu Hurejreja ka përcjellë shumë transmetime hadithesh e ndodhish nga jeta e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Nesër unë do të dal përpara Allahut. Nëse unë gënjej, atëherë Allahu ka për të më kërkuar llogari për çdo fjalë të thënë nga goja ime. Po ende thonë se: Muhaxhirët dhe ensarët duhet të transmetojnë më shumë sesa Ebu Hurejreja?! Meqenëse vëllezërit e mi muhaxhirë qëndronin gjatë gjithë ditës në pazar, duke u marrë me tregti; ensarët duke u marrë me kopshtet e bahçet e tyre, e unë isha një njeri i varfër, nuk kisha se ç'të bëja, ndaj e ndoqa të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) me sa të mundja, se unë kam qëndruar shumë me të, nuk jam ndarë kurrë nga ai. Kur të tjerët merreshin me punët e tyre, unë isha gjithmonë me të. Edhe ato që i harronin ata unë i mbaja mend. Një ditë, i Dërguari Fisnik (paqja e

⁴. Ibnu'l-Xheuzi, *Sifetu's-Safue*, 1/629.

⁵. Mundhiri, *et-Tergib*, 1/54 (115).

Zotit qoftë mbi të) foli dhe tha:

“Kushdo prej jush që e shtron veshjen e tij në tokë, derisa unë të mbaroj fjalën, pastaj e vesh shpejt e shpejt, nuk i harron kurrësi ato që do të them unë.”

Unë e hoqa menjëherë jelekun që kisha veshur përsipër dhe e shtrova përdhe. Sapo mbaroi fjalën Profeti ynë (paqja e Zotit qoftë mbi të), e mora menjëherë jelekun dhe e vasha. Unë i betohem Allahut që e dërgoi atë me të vërtetën, se deri sot e kësaj dite unë nuk e kam harruar asnjë fjalë që kam dëgjuar nga ai. Për Zotin, sikur të mos ishin këto dy ajete në Kur'an, unë nuk do të kisha transmetuar e përcjellë as edhe një hadith të vetëm:

“Me të vërtetë, ata që fshehin shpalljet Tona të qarta, pasi ua kemi shpjeguar njerëzve në Libër (Teurat), do të mallkohen nga Allahu dhe do të mallkohen nga ata (engjëj e njerëz) që janë ngarkuar të mallkojnë. Mirëpo atyre që pendohen, përmirësohen dhe tregojnë atë që kishin fshehur, Unë ua pranoj pendimin, sepse Unë jam Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti.” (Bekare, 2/159-160)⁶

Në një tjetër transmetim ekziston edhe kjo pjesë shitesë: “... nga uria më dukej sikur barku më bashkohej me shpinën. Ka pasur edhe njerëz që u kam mësuar një ajet kur'anor, gjersa ua kam ngulitur në mendje, që të më merrnin në shtëpinë e tyre e të më jepnin diçka për të vënë në bark. Më mirë nga të gjithë me të varfrit sillej Xhafer bin Ebi Talibi (radijallahu anhu). Na çonte në shtëpinë e tij dhe na gostiste me ç't'i gjendej në shtëpi në atë çast. Madje nganjëherë na sillte edhe një rrjetë lëkure e na e vinte përpara me gjithë ç'kishte mjalte, gjalpë, e ne lëpinim derisa të qetësonim disi urinë.”⁷

6. CILA ËSHTË VËRTETËSIA E DIJES?

E tregon Ebu Musai (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- *“Dija dhe udhëzimi, me të cilin më ka dërguar Allahu mua, është si shiu i dendur dhe i begatë që bie mbi krabrorin e Tokës. Ka ca vende, toka e të cilave është shumë pjellore. E thith ujin përnjëherë dhe barërat mbijnë menjëherë. Por ka*

⁶. Buhari, *Sabih*, 1/55 (118).

⁷. Buhari, *Sabih*, 3/1359 (3505).

edhe toka të atilla, që e mbajnë ujin përsipër dhe nga ai ujë përfitojnë si njerëzit, ashtu edhe bimët. Me të i ujitin arat dhe prej tij u japin kafshëve të tyre të pinë. Por ka edhe disa fusha të atilla, të cilat janë shkretëtirë. As nuk e mbajnë ujin përsipër, as nuk bëjnë të çelë ndonjë bimë. Ja pra, këtij shembulli i ngjajnë ata që e kuptojnë fenë e Allahut, e mësojnë dhe ua mësojnë atë edhe të tjerëve, me ata që janë krejtësisht të çinteresuar ndaj kësaj feje, e nuk e pranojnë udhëzimin që të fal ajo.”⁸

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) e tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

“Secili nga profetët, që ka dërguar Allahu përpara meje, ka pasur dishepujt e tij, të cilët e kanë ndjekur atë në çdo gjurmë dhe i kanë ardhur atij në ndihmë. Megjithatë, ka kaluar koha dhe prej tyre kanë ardhur disa breza të atillë, që kanë thënë gjëra që ata nuk i kanë thënë, duke mos thënë gjërat që ata i kanë thënë, dhe kanë bërë ato gjëra, për të cilat nuk ishin urdhëruar e lejuar që t’i bënin. Ai që përballet ashtu siç duhet me të tillët është besimtar i vërtetë; edhe nëse përballet me gjuhë është besimtar; edhe nëse mban qëndrim me zemër, prapë besimtar është. Kurse ai që nuk bën as kaq, nuk e ka arritur dot besimin as sa një farë sinapi.”⁹

7. TË MJAFTUARIT VETËM ME ATË QË KA SJELLË RESULULLAHU

E tregon Abdullah bin Thabiti: “Një ditë, tek i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi Omeri (radijallahu anhu) dhe e pyeti:

- “O Resulullah! Unë pata shkuar te një nga vëllezërit e mi nga Beni Kurejdha. Ai më shkroi mua menjëherë ca fjali nga Teurati. A doni t’i shikoni?” Ngjyra e fytyrës së të Dërguarit të Allahut ndryshoi përnjëherë. Unë i thashë Omerit:

- “Nuk e sheh fytyrën e Resulullahut?” Aty Omeri e mblodhi veten sa hap e mbyll sytë dhe tha:

- “Ne jemi të kënaqur prej Allahut si Zot, prej Islamit si fe dhe prej Muhamedit si Profeti i Tij!” Vetëm atëherë në fytyrën e të Dërguarit Fisnik u duk sikur nisën të çelnin lule, pasi ai na tha:

- “Unë i betohem Allahut, në dorën e fuqisë së të Cilit është jeta ime, se po

⁸. Buhari, *Sahib*, 1/42 (79).

⁹. Muslim, *Sahib*, 1/69 (80).

të ishte Musai tani këtu, në mesin tuaj, e ju të më linit mua, për të ndjekur atë, ju do të kishit rënë në humbje. Ju jeni umeti im, më takoni mua dhe unë jam një profet, i cili është fati juaj.”¹⁰

Ndërsa, në një tjetër përcjellje thuhet se është ruajtur edhe kjo e thënë: “Nëse do të ishte Musai gjallë, ai nuk ka dyshim se do të më ndiqte mua.”

8. QËNDRIMI I SAHABËVE KARSHI NJOFTIMEVE TË ALLAHUT DHE TË TË DËRGUARIT TË TIJ

Tregon Shufeje el-Asbahij: “Kur hyra në Medinë, pashë se njerëzit ishin mbledhur të tërë rreth një njeriu, ndaj pyeta menjëherë se kush ishte ai njeri. Ata më thanë mua se ai ishte Ebu Hurejreja. Iu afrova dhe u ula në gjunjë afër tij. Ai diç po u tregonte njerëzve. Sapo mbaroi fjalën, unë i thashë atij:

- “Dua të të kërkoj diçka. Si thua, sikur të na flasësh për ndonjë gjë që e ke dëgjuar, mësuar, apo kuptuar, nga vetë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).” Ebu Hurejreja m’u përgjigj:

- “Patjetër, më lër të të tregoj një hadith që i Dërguari i Allahut ma ka thënë mua, të cilin unë e kam kuptuar.” Me të thënë këtë fjalë, Ebu Hurejres i ra të fikët; pritëm për pak, derisa erdhi në vete dhe u bë më mirë, e pastaj më tha:

- “Më lejo të të tregoj një hadith, të cilin ma ka treguar vetë i Dërguari i Allahut, njëherë, kur ne ishim vetëm për vetëm në këtë shtëpi.” – e iku sërish, ra pa ndjenja. Kur erdhi në vete, fshiu fytyrën.

- “Mirë, pra, do të të tregoj një hadith, të cilin ma ka treguar i Dërguari Fisnik njëherë kur ishim vetëm për vetëm.” Ebu Hurejres i ra të fikët edhe disa herë, aq sa herën e fundit ra përdhe. U detyrova që ta mbaja ashtu për një kohë të gjatë. Pastaj erdhi në vete sërish dhe më përcollti se i Dërguari i Allahut i kishte thënë atij:

- “Në ditën e Kiametit, në një çast kur të gjithë popujt bien në gjunjë, Allahu u drejtohet robve të Tij për të shpallur vendimin. Të parët që thirren përpara Allahut janë hafëzët e Kur’anit, dëshmorët dhe të pasurit. E pyet hafëzin Allahu i Madhërisë:”

¹⁰. Hejthemi, *Meçhmen’z-Zenaid*, 1/420 (808).

- ‘A nuk të dërgova Unë ty profetin, i cili të mësoi Kur’anin?’ Hafëzi i Kur’anit përgjigjet:

- ‘Po o Zot, ma mësove.’

- ‘Po mirë, a i zbatove ti ato që mësove?’, – e pyet Allahu.

- ‘Ditë e natë unë fala namaz,’ – thotë hafëzi. Dhe engjëjt thonë:

- ‘Gënjeve.’ Allahu thotë:

- ‘Përkundrazi, ti e mësove dhe e lexoje Kur’anin që njerëzit të thoshin, ‘Sa mirë e lexon Kur’anin filani!’, – dhe njerëzit, vërtet, ashtu thanë.

Mandej para Allahut sjellin një burrë të pasur. Allahu i thotë kështu të kamurit:

- ‘Unë ty të dhashë pasuri, a nuk të shpëtova Unë ty, që ti të mos kishe nevojë për të tjerët?’ Burri i pasuri i përgjigjet:

- ‘Po, o Zot.’ Zoti e pyet:

- ‘Po ti ku e shpenzove pasurinë që të dhashë Unë?’

- ‘U dhashë lëmoshë të afërmeve dhe njerëzve nevojtarë,’ – përgjigjet i pasuri.

- ‘Po gënjen,’ – ia kthen Allahu; edhe engjëjt thonë të njëjtën gjë. Atëherë, Allahu i Madhbërishëm thotë:

- ‘Përkundrazi, të gjitha ti i bërë që njerëzit të thoshin: ‘Sa bujar që është ai njeri!’, – dhe ashtu ndodhi vërtet, ashtu thanë.

Më në fund, përpara Allahut sjellin dëshmorin. Atë Allahu e pyet:

- ‘Pse u vrave ti?’

- ‘Duke luftuar në rrugën Tënde, o Allah; kështu më thanë të bëja dhe unë luftova gjersa më vranë e rashë dëshmor.’ Zoti do t’ia kthejë:

- ‘Gënjen!’ Edhe engjëjt i thonë:

- ‘Po gënjen!’ Atëherë, Allahu i thotë atij:

- ‘Përkundrazi, ti deshe që njerëzit të thoshin: ‘Sa trim është aksh njeri!’, – dhe, vërtet, ashtu thanë.

Pasi tregoi këto tre shembuj, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) rrahu gjunjët dhe tha:

- “E shikon, o Ebu Hurejre! Këto tri grupe do të jenë të parat që do të hyjnë në Xhehenem.”¹¹

¹¹. Tirmidhi, *Sunen*, 4/591 (2382).

Ebu Seleme bin Abdurrahman bin Aufo tregon: “Abdullah bin Amri u takua me Abdullah bin Omerin (radijallahu anhu) në Merue dhe filluan të bisedonin me njëri-tjetrin. Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) vazhdoi rrugën; kurse Ibni Omeri mbeti në vend duke qarë. Një nga shokët që kishte me vete, e pyeti:

- “Po pse po qan, o Ebu Abdurrahman?” Ibni Omeri (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- “Abdullah bin Amri më përcolli mua një hadith të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që thotë: *“Kush bart qoftë edhe një grimë mendjemadhësie në zemrën e tij, Allahu do ta hedhë atë përmbys në Xhehenem.”*¹²

Një amanet i Muadh bin Xhebelit pak para se të ndahej nga kjo botë

E tregon Harith bin Umejre: “Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) ishte në shtratin e vdekjes, ndërsa të afërmit i rrinin rreth kokës dhe qanin. Muadhi (radijallahu anhu) i pyeti:

- “Pse qani kështu?” E ata iu përgjigjën:

- “Ne po qajmë për gjithë atë dije që do të vdesë e do të humbasë bashkë me ty.” Atëherë, Muadhi (radijallahu anhu) u tha atyre:

- “Dija dhe besimi do të jenë këtu deri në ditën e Kiametit; nuk humbet kurrë. Kush është kureshtar dhe kërkon, mund t’i sigurojë si besimin, ashtu edhe dijen. E ato janë Libri i Allahut, Kur’ani, dhe Suneti i Resulullahut. Nuk ka dije tjetër që nuk buron prej tij. Shikoni Omerin, Osmanin dhe Aliun. Nëse i humbni edhe ata, atëherë keni Ebu Derdanë, Ibni Mesudin, Selman Farisiun dhe Abdullah bin Selamin, i cili ishte hebre, por pranoi Islamin dhe u bë mysliman. Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), i cili ka thënë për Ibni Selamin: *“Ai është i dhjetë i atyre që janë nga banorët e Xhenetit.”* Ju shqetësohuni për gabimet/lajthitjet e njeriut të ditur. Atë që është e drejtë dhe e vërtetë, pranojeni, kushdo qoftë ai që jua sjell. E të rremen përplasjani në fytyrë, kushdo qoftë ai që e thotë.”¹³

¹². Bejheki, *Shuabu’l-Iman*, 6/280 (8154).

¹³. El-Hakim, *Mustedreke*, 4/513 (8440).

9. TËRËSIA BESIM-DIJE-VEPRIM TE SAHABËT

Tregon Xhundub bin Abdullahu: “Kur ishim të rinj, ne uleshim e rrinim me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). I Dërguari i Allahut, para se të na mësonte Kur’anin, na bindi ne në besim dhe ne mësuam se si duhet të besonim. Mandej mësuam Kur’anin, i cili na e përforcoi e na e bëri edhe më të fortë besimin.”¹⁴

Tregon Aliu (radijallahu anhu): “Kur ishte ende në jetë i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), Allahu i zbriti atij disa ajete kur’anore, të cilat ua përforcuan edhe më shumë besimin besimtarëve dhe ua shtoi edhe më shumë respektin e devotshmërinë që ata kishin ndaj Allahut, aq sa kur ndonjë ajet e ndalonte një veprim, besimtarët e braktisnin atë menjëherë, një të dëgjuar ajetin e zbritur.”¹⁵

**Sahabët fisnikë nuk ua mësonin të tjerëve një ajet,
pa e jetësuar atë njëherë në jetën e tyre**

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) tregon: “Ne, qëllonte që të mësonim prej të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhjetë ajete kur’anore njëherësh, por pa i mësuar ata njëherë përmendësh me mendje e me zemër, duke i kthyer ata në ligje të jetës sonë, nuk kalonim kurrë te dhjetë ajetet e tjera.”¹⁶

10. MËSIMI I DETYRIMEVE TË FESË ISLAME

I Dërguari Fisnik u mëson fenë beduinëve

Tregon Xheriri (radijallahu anhu): “Tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi një beduin dhe i tha:

- “Mësomë Islamin!” I Dërguari i Allahut i foli atij njeriu me këto fjalë:

- “*Islami është të dëshmosh se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij, të falësh namazin ashtu siç duhet, të japësh pjesën e zekatit nga pasuria jote, të mbash agjërimin gjatë muajit të Ramazanit, të shkoh*

¹⁴. Ibn Maxhe, *Sunen*, 1/23 (61).

¹⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/466 (4216).

¹⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/465 (4213).

në haxh, të duash edhe për të tjerët atë që do për veten tënde dhe atë që nuk e do për veten të mos e duash as për të tjerët.”¹⁷

Kur sahabët mësojnë fenë

Hasan Basriu (radijallahu anhu) e tregon: “Erdhi një burrë tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Unë jam një njeri që jetoj në shkretëtirë. Dhe punët e ditës i kam jashtë mase të shumta. Mësomë mua diçka, që do të më mbështesë shpirtërisht, por edhe që mund t’ua këshilloj edhe të tjerëve.”

Omeri (radijallahu anhu) e dëgjoi dhe iu përgjigj:

- “Zgjatma dorën dhe mbaj mend mirë ato fjalë që do të të them: Ti do të adhurosh Allahun, do të falësh namazin, do të japësh zekatin nga pasuria jote, do të përmbushësh adhurimet e haxhit dhe të umres, si dhe do t’u bindesh prijësve të tu. Ji i hapur, bujar dhe dashamirës, mos rend pas punëve të fshehta. Bëj ato punë që kur t’i mësojnë njerëzit, ti të mos ndihesh i zënë në turp. E në asnjë mënyrë mos i hyr asnjë pune që do të të bëjë të të vijë turp përpara njerëzve e që do të të rrëzojë në poshtërim!” Ai burrë ia ktheu:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Unë do t’i bëj të gjitha këto sa më porosite dhe kur të shkoj përpara Zotit në atë ditë, unë do të them: ‘Bëra ato që më tha Omer bin Hatabi që të bëja.’”

- “Ti bëji njëherë ato që të thashë unë, pastaj çfarëdo që t’i thuash ti Zotit nuk do t’i bësh dëm as vetes, as mua.”¹⁸

11. I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT U MËSOJNË NJERËZVE NAMAZIN

Përcjell Ebu Malik el-Eshxheij, nga babai i tij, dhe na tregon: “Kur dikush bëhej mysliman, gjëja e parë që i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i mësonte atij ishte se si falej namazi ose i drejtohej ndonjërit prej sahabëve të tij, duke i thënë:

¹⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/327.

¹⁸. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 1/477 (1366).

- “*Mësoji namazin këtij njeriu.*”, – dhe ia caktonte atij këtë si detyrë.”¹⁹

Ibni Abasi tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na mësonte neve ndonjë sure nga Kur’ani, pastaj na mësonte edhe lutjen e *tehiyatit*.”²⁰

Hudhejfeja i mëson dikujt rukunë dhe sexhden, të cilat ende nuk po i bënte dot mirë

Tregon Zejd bin Uehbi: “Në xhami hyri Hudhejfeja (radijallahu anhu) dhe aty ishte dikush që po falej; mirëpo rukunë dhe sexhden nuk po i bënte ashtu siç duhet. Kur e mbaroi së faluri namazin ai njeri, Hudhejfeja i tha atij:

- “Sa vjet ke që e fal namazin kështu?”

- “Dyzet vjet.”, – iu përgjigj ai. Atëherë, Hudhejfeja i tha atij:

- “Të gjitha ato namaze që ti ke falur për dyzet vjet me radhë nuk janë të plota. Nëse do të vdesësh, duke e falur namazin në këtë mënyrë, atëherë ti nuk do të kesh vdekur me fenë që solli Muhamedi (sal’lallahu alejhi ue sel’lem)!” I mësoi atij njeriu se si duhet ta falte namazin dhe i tha:

- “Njeriu mund ta kryejë lehtë namazin, me pak fjalë, mund ta falë shpejt; por vetëm me kushtin që rukunë dhe sexhden t’i bëjë të plota!”²¹

12. I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT U MËSOJNË NJERËZVE LUTJEN DHE SI TA PËRMENDIN ALLAHUN

Aliu (radijallahu anhu) tregon: I Dërguari i Allahut më pati thënë mua:

- “*Çfarë do që të të jap: pesë mijë dele, apo të të mësoj pesë fjali, të cilat do të të bëjnë shumë dobi, si për besimin, ashtu edhe për jetën tënde në këtë botë?*” Unë i thashë:

- “O Resulullah! Edhe pse pesë mijë dele janë një pasuri e madhe, ti mua mëson më mirë pesë fjali të atilla.” Atëherë, i Dërguari i Allahut

¹⁹. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 2/22 (1618).

²⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/257 (22336).

²¹. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 4/174.

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më pati thënë:

- “O Zot, *falmi mua mëkatet e mia. Falmë mua një ndërgjegje të gjerë. Bëmë mua të fitoj prej asaj që është e lejuar. Bëmë mua që të di si të mjaftohem me të mirat që Ti më fal. E ruamë zemrën, që ajo të mos më rrëshqasë kah gjërat që Ti m'i ke ndaluar.*”²²

Abdullah bin Xhaferi (radijallahu anhu) tregon: “Aliu (radijallahu anhu) mua më pati treguar:

- “Nipi im, unë do të të mësoj ty një lutje që ma ka mësuar vetë i Dërguari i Allahut. Kush e lexon këtë lutje para se të vdesë, ai meriton të hyjë në Xhenet: *‘La ilahe il'lallahu'l-Halimu'l-Kerim’* (tri herë), *Elhamdu lil'lahi Rabbi'l-Alemin’* (tri herë), *‘Tebarekel'ledhi bijedihi'l-mulk jubji ue jumit ue huc ala kul'li shejin kadir.’*”²³

Tregon Sa'di: “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na pati mësuar një lutje, njësoj siç i mëson mësuesi nxënësve të tij që të shkruajnë: “O Zot! Unë prej Teje kërkoj ndihmë nga koprracia, nga të qenët frikacak, nga plakja gjersa të mos kem fuqi të lëviz duar e këmbë, nga ngatërresat e kësaj bote dhe nga vuajtjet e varrit.”²⁴

13. MËSIMI I NJOHURIVE TË FESË PËR MIQTË BUJTËS NË MEDINËN E NDRITUR

Ebu Said Hudriu (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë ne ishim duke ndenjur me Profetin tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Profeti ynë na tha:

- “*Erdhi delegacioni i Abdulkajsit.*” Pamë njëherë përreth, po nuk na zunë sytë askënd. Pritëm njëfarë kohe, kur ai grup erdhi dhe pjesëtarët e tij i dhanë selam të Dërguarit të Allahut. Profeti ynë i pyeti ata:

- “*A ju ka mbetur ndonjë hurmë nga hurmat e rrugës, që kishit me vete?*”

- “Po!”, – iu përgjigjën ata. I Dërguari Fisnik na kërkoi neve që të shtronim një mbulesë përdhe. E shtruam dhe miqtë i sollën hurmat, i zbrazën mbi mbulesë. Paskëtaj, Profeti ynë i bëri bashkë sahabët; u

²². El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 2/332 (3834).

²³. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 2/762 (4993).

²⁴. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 2/798 (5095).

tregoi atyre hurmat, duke i ndarë sipas ngjyrës:

- “*Ju këto hurma i quani ‘berni’, këto të tjerat kështu, ato të tjerat ashtu, apo jo?*”

- “Po!”, – iu përgjigjën ata.

Pak më vonë, Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të), secilin prej miqve ia caktoi një myslimani vendas. Veç kësaj ai i porosi myslimanët që t’i merrnin miqtë nëpër shtëpitë e tyre, t’i gostitnin, t’u këndonin Kur’an dhe t’ua mësonin, si dhe që të falnin namaz dhe t’ua mësonin edhe atyre namazin. Kështu, të gjithë pjesëtarët e atij grupi qëndruan nëpër shtëpitë e myslimanëve për një javë me radhë. Ata ndenjën bashkë me myslimanët vendës në shtëpitë e tyre. Pas një jave, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i thirri mysafirët dhe i pyeti për ato që kishin mësuar deri në atë ditë. Edhe pse kuptoi se i kishin kuptuar disa gjëra, ai u tha atyre se nuk kishin mësuar mjaftueshëm, ndaj ua ngarkoi ata disa sahabëve të tjerë, duke u kërkuar që të qëndronin edhe një javë tjetër me sahabët. Në fund, bëri të njëjtën gjë, i thirri pranë vetes dhe kontrolloi se çfarë kishin mësuar. Kësaj here pa se ata kishin mësuar të gjithë të lexonin e të kuptonin Kur’anin.

Mysafirët i thanë atij:

- “O Resulullah! Na mori malli për tokat tona. Allahu na i mësoi ne të mirën dhe të keqen; na ndihmoi që ta kuptojmë fenë tonë më së miri.” Dhe Resulullahu u tha:

- “*Tani ju mund të ktheheni pranë familjeve tuaja!*”²⁵

14. SAHABËT LUFTONIN, POR AS DIJEN NUK E LININ PAS DORE

Ebu Said Hudriu (radijallahu anhu) na tregon: “Ne, sa herë që shkonim për të luftuar, një ose dy vetë i linim me detyrë që të mësonin dhe të ruanin në kujtesë mirë çdo fjalë e çdo hadith të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), e kur ne të ktheheshim nga lufta, të na i mësonin edhe neve. Kësisoj, kishim edhe ne mundësi për t’i përcjellë ato hadithe, duke thënë: ‘I Dërguari i Allahut ka thënë kështu.’”²⁶

²⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 5/756 (13841).

²⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 5/240.

15. SAHABËT MERRESHIN ME TREGTI, POR AS DIJEN NUK E BRAKTISNIN

Këtë e tregon Thabit el-Bunani: “Tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi një grup njerëzish, të cilët i thanë atij:

- “Sikur të na japësh ndonjë grup me vete, e ata të na mësojnë neve Kur’anin dhe Sunetin tënd.” Dhe i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) dërgoi me ta një grup besimtarësh prej shtatëdhjetë vetash, të cilët u quajtën edhe si ‘kurra’. Mes tyre ishte edhe Harami, daja im. Ata që ishin pjesë e këtij grupi natën e kalonin duke lexuar Kur’an dhe duke mësuar njohuri të reja; kurse dita u shkonte duke transportuar ujë ose dru, ose duke shitur gjëra të ndryshme në avllinë e xhamisë. Ndërsa paratë që fitonin ata i shpenzonin për të skamurit dhe njerëzit pa njeri të Sufes.

I Dërguari i Allahut i nisi ata për rrugë dhe ata ikën. Gjatë rrugës, idhujtarët u ngritën atyre pritë dhe i vranë të gjithë ata myslimanë. Ranë dëshmorë të gjithë. Disa prej tyre, pak para se të jepnin shpirt u lutën me këto fjalë:

- “O Zot! Dërgoji Ti Profetit tonë lajmin se ne u kthym tek Ti dhe ne jemi të kënaqur prej Teje, e edhe Ti je i kënaqur me ne.”

Gjatë përleshjes, një nga idhujtarët i doli nga pas dajës tim, Haramit, dhe ia kishte ngulur heshtën mu në mes të shpinës. Teksa pinte shurupin e ëmbël të të qenët dëshmor i Allahut, daja im kish thënë:

- “Për Zotin e Qabes, shpëtova!” Fill pasi ndodhi kjo ngjarje e kobshme, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u kish thënë sahabëve të tij:

- “*Vëllezërit tanë ranë dëshmorë. Dhe, teksa ia dorëzonin shpirtat e tyre Allahut, thanë: ‘O Zot! Dërgoji Ti Profetit tonë lajmin se ne u kthym tek Ti dhe ne jemi të kënaqur prej Teje, e edhe Ti je i kënaqur me ne.’*”²⁷

²⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/514.

16. I DËRGUARI I ALLAHUT U KËRKON BESIMTARËVE QË T’UA MËSOJNË EDHE FËMIJËVE TË TYRE FENË

Malik bin Huejrithi (radijallahu anh) tregon: “Ne si shokë, ishim një grup të rinjsh asokohe, shkuam tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe qëndruam pranë tij për thuajse njëzet ditë. I Dërguari i Allahut na pyeti se kë kishim lënë pas, për të shkuar tek ai, duke menduar për gratë dhe fëmijët tanë. Dhe ne i treguam se si qëndronte puna. Ai ishte njeri i dhembshurisë dhe mëshirës. Ai na tha:

- “*Tani kthehuni pas familjeve tuaja. Mësojuani edhe atyre ato që mësuat këtu, e sigurohuni që t’i ndjekin edhe ata me përpikëri kësbillat që ju dhashë unë. Me të hyrë koha e namazit, njëri të këndojë ezanin, kurse ai që është më i madhi të dalë e t’ju prijë në namaz.*”²⁸

17. I DËRGUARI I ALLAHUT U MËSON SAHABËVE TË MËSOJNË GJUHËN E RIVALËVE TË TYRE

Tregon Zejd bin Thabiti: “Kur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi në Medinë, më morën dhe më çuan pranë tij. I thanë atij:

- “O Resulullah! Ky fëmijë është nga fisi i bijve të Nexharit. Deri më tani ai ka mësuar përmendësh shtatëmbëdhjetë sure të Kur’anit.” Dhe unë i këndova para të Dërguarit të Allahut të gjitha sa kisha mësuar dhe atij i pëlqeu shumë, pasi më tha:

- “*Shiko, Zejd, tani të mësosh të shkruash dhe të flasësh edhe gjubën e hebrenjve; kjo është e domosdoshme për ne. Uallahi, unë nuk u kam shumë besë letrave që u kam kërkuar të tjerëve t’ua shkruajnë hebrenjve për mua.*”

Dhe unë iu vura punës të mësoja sa më shpejt hebraishten; nuk kaluan as plot pesëmbëdhjetë ditë dhe unë e mësova tërësej atë gjuhë. Që nga ajo ditë letrat e të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) për hebrenjtë i shkruaja unë dhe i lexoja atij letrat e kthyera nga ta.”²⁹

Kurse, sipas një tjetër transmetimi, Resulullahut (sal’lallahu alejhi

²⁸. Buhari, *Sabih*, 1/226 (605).

²⁹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/186 (21658).

ue sel'lem) i vinin letra në gjuhën e asirëve, ndaj ai pati pyetur Zejd bin Thabitin, nëse e njihnte mirë gjuhën e asirëve dhe kur Zejdi iu qe përgjigjur se nuk e dinte, ai e pati këshilluar:

- “*Atëherë ta mësosh ti gjuhën e asirëve.*” Zejdi thotë se: “Unë e mësova gjuhën e asirëve për shtatëmbëdhjetë ditë.”³⁰

Kur largohet imami, ai cakton dikë që t'i mësojë fenë xhematit

Urueja (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) do të shkonte në luftën e Hunejnit, ndaj caktoi Muadh bin Xhebelin si mëkëmbës, që të qëndronte në Mekë dhe të kujdesej për besimtarët. Ai i kërkoi atij që t'u mësonte njerëzve Kur'anin dhe t'u shpjegonte parimet e fesë. Mandej, edhe kur do të ikte për në Medinë, ai pati lënë po Muadhin si mëkëmbës në Mekë.”³¹

18. NË RAST NEVOJE, KALIFI DETYROHEJ QË T'I MBANTE NJERËZIT E DITUR PRANË VETES NË QENDËR

Kasimi tregon: “Omeri (radijallahu anhu), sa herë që do të nisej për rrugë, si mëkëmbës të vetin caktonte Zejd bin Thabitin (radijallahu anhu): Disa i dërgonte nëpër vendet fqinje, duke i ngarkuar me detyra të posaçme. Ndonjëherë atij i kërkonin veçanërisht dikë që t'ua caktonte si prijës. Për shembull, njëherë, kur i patën thënë: - “Pse nuk e cakton Zejd bin Thabitin si prijës të ndonjë vendi?”, – ai iu qe përgjigjur:

- “Edhe unë e di shumë mirë vlerën e Zejdrit. Por edhe këtu ka shumë njerëz, të cilët, për çdo çështje që nuk i gjejnë dot zgjidhje shkojnë t'i kërkojnë ndihmë Zejdrit.”³²

19. SAHABËT SHPËRNDAHEN NËPËR VENDE TË NDRYSHME, QË T'U MËSOJNË NJERËZVE ISLAMIN

Ibni Katadeja (Asim bin Omeri) tregon: “Pas luftës së Uhudit tek i

³⁰. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/182 (21627).

³¹. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/303 (5181); Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/164.

³². El-Hakim, *Mustedrek*, 3/245 (4979).

Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhën disa njerëz nga degët e familjes së Udalit dhe Kares, të cilët i thanë:

- “Tek ne ka shumë myslimanë. Sikur të na dërgosh ndonjë grup sahabësh, që të na mësojnë si të lexojmë Kur'anin dhe parimet e fesë.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) dërgoi tek ata një grup sahabësh të përbërë prej gjashtë vetash. Mes tyre ishte edhe Merthedi bin Ebi Merthedi, garanti i Hamzait (radijallahu anhu), i cili u caktua edhe imam i grupit.”³³

Tregon Muhamed bin Ka'b el-Kuradhi: “Në kohën që kalif ishte Omeri (radijallahu anhu), Zejd bin Ebi Sufjani i shkroi atij një letër, në të cilën i shkruante:

- “O i Pari i Besimtarëve, popullsia e Sirisë është shtuar shumë dhe shoqëria ka filluar të bëhet edhe më kozmopolite. Për këtë arsye, kemi shumë nevojë për mësues, të cilët do të mund t'u mësojnë njerëzve Kur'anin dhe njohuritë e qenësishme të fesë. Dua që të më ndihmosh.”

Me të marrë letrën, Omeri (radijallahu anhu) thirri Muadh bin Xhebelin, Ubade bin Samitin, Ubej bin Ka'bin, Ebu Ejubin dhe Ebu Derdanë (radijallahu anhum) dhe u tha:

- “Vëllezërit tuaj në Siri duan që unë t'u dërgoj atyre mësues, që t'u mësojnë Kur'anin dhe t'i pajisin me njohuritë më të rëndësishme rreth fesë. Kurrë mos reshttë mëshira e Zotit mbi ju, dua që të më ndihmoni ju të tre. Po deshët mund ta bëni edhe me short ose të shkoni të tre njëherësh.”

Ata u përgjigjën:

- “Nuk kemi pse të hedhim short. Ebu Ejubi është i moshuar, kurse Ubej bin Ka'bin e dimë, është i sëmurë.” Përpara u hodhën tre vetë: Muadh bin Xhebeli, Ubadeja dhe Ebu Derdaja (radijallahu anhum) dolën vullnetarë. Omeri (radijallahu anhu) i porosi ata:

- “Shkoni njëherë në Humus. Atje do të takoheni me shumë njerëz. Pa dyshim, mes tyre ka edhe njerëz të zgjuar. Nëse gjeni njerëz të

³³. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/174.

zgjuar e që i kuptojnë gjërat shpejt, përgatitini ata sa më shpejt dhe një pjesë të njerëzve caktojuani atyre, që t'i mësojnë ata. Nëse ju pëlqejnë njerëzit e Humusit, njëri prej jush le të qëndrojë në Humus. Pastaj një prej tyre të shkojë në Siri, kurse tjetri në Palestinë.”

Këta tre sahabë shkuan në Humus. Për njëfarë kohe qëndruan atje. Kur panë se sjelljet dhe qëndrimet e atij populli u pëlqyen, ata vendosën që aty të qëndronte Ubadeja. Ebu Derdaja shkoi në Siri, kurse Muadhi në Palestinë. Muadhi vdiq gjatë epidemisë së kolerës, që ra në Amuas. Ubadeja shkoi në Palestinë dhe prej atje u rikthye pranë Zotit. Kurse Ebu Derdaja banoi në Siri, gjersa erdhi dita për t'u ndarë nga kjo jetë.”³⁴

20. UDHËTIMI PËR HIR TË DIJES

E tregon Mesleme bin Muhal'ledi: “Kur isha në Egjipt, më erdhi një shërbyes e më tha:

- “Jashtë është një burrë që pret mbi deve; do të takohet me ty.” Dola jashtë menjëherë dhe e pyeta atë njeri se kush ishte.

- “Xhabir bin Abdullah el-Ensari jam.”, – më tha.

- “Ejani brenda, apo të vij unë aty pranë jush; pse nuk vini ju sipër?” – i thashë unë dhe ai ma ktheu:

- “As unë nuk po vij, as ti nuk ke pse zbret poshtë. Unë kam ardhur deri këtu me qëllimin që të më tregosh atë hadithin e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në lidhje me mbulimin e të metave të besimtarit.”

- “Po, e kam dëgjuar nga i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem); ka thënë: “*Për këdo që mbulon një të metë të një besimtari, kejo është si të kish rikthyer në jetë vajzën që ka varrosur për së gjalli.*”, – i thashë unë. Pasi e dëgjoi me vëmendje hadithin, ai burrë ktheu devenë dhe u largua për andej nga kishte ardhur.”³⁵

³⁴. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/172.

³⁵. Taberani, *Mu'xhemu'l-Eusat*, 8/114 (8133).

21. DIJEN TA MARRËSH NGA NJERËZIT E DUHUR

**Ta kërkosh dijen nga njerëzit e paditur
është parë si një nga shenjat e fundit të botës**

E tregon Enesi (radijallahu anhu): E pyeta të Dërguarin e Allahut:

- “O Resulullah! Kur do ta braktisin myslimanët detyrën e urdhërimit për të mirën dhe të ndalimit të së keqes?”

- “*Kur mes jush të shfaqet i njëjti problem që u shfaq edhe në mesin e hebreujve.*”, – mu përgjigj ai.

- “E cili ka qenë ky problem, o Resulullah?”, – pyeta unë i habitur. E ai më tha:

- “*Kur mes të mirëve tuaj të përhapet gënjeshtria dhe sjellja prej dallkauku dhe mes të këqijve tuaj të përhapet imoraliteti; kur punët e drejtimit të liben në dorën e më të vegjëleve; kur dija të bjerë në duart e njerëzve pa karakter!*”³⁶

**Të mos ua vini veshin atyre që e interpretojnë Kur’anin
sipas dëshirave dhe interesave të veta**

Omeri bin Hatabi (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Unë nuk shqetësohem e nuk kam aspak frikë për besimtarin, të cilin besimi e ruan nga e keqja, apo për të devijuarin që i bën haptazi mëkatet. Ajo që më shqetëson më së shumti janë ata që e lexojnë Kur’anin, por e interpretojnë atë sipas dëshirave të veta, pa i bazuar askund qëndrimet e veta.”³⁷

Ukbe bin Amiri, kur kishte rënë në shtratin e vdekjes dhe po jetonte ditët e fundit të jetës, u pati lënë fëmijëve të tij këtë amanet:

- “Bijtë e mi, unë ju këshilloj se tri janë gjërat nga të cilat duhet të ruheni e të bëni shumë kujdes, ndaj kurrë mos i harroni; fjalët e të Dërguarit të Allahut pranojini vetëm nga ata që janë të besueshëm. Edhe sikur të visheni vetëm me arna, përpiquini që të mos hyni në borxh. E mos shkruani poezi, aq sa ato t’ju largojnë juve nga Kur’ani.”³⁸

³⁶. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 5/185.

³⁷. Ibn Abdil-Berr, *Xhamiu Bejani’l-Ilm*, 2/194.

³⁸. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zeuaid*, 1/358 (599).

22. PËRGËZIMI DHE NXITJET E SAHABËVE PËR ATA QË KËRKOJNË DIJEN

E tregon Ebu Haruni: Ne shkonim shpesh pranë Ebu Saidit dhe ai na thoshte:

- “Mirë se erdhët, o miqtë për të cilët neve na pati lajmëruar vetë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem)! I Dërguari Fisnik na thoshte shpesh: *“Populli do t’ju ndjekë ju dhe tek ju do të vijnë njerëz nga çdo anë e botës. Ata do t’ju kërkojnë juve që t’u mësoni Islamin. Kur të vijnë ata njerëz, me ta të silleni sa më mirë; jepuni atyre këshillat më të mira.”*³⁹

Ebu Hurejreja i përgëzon ata që duan të dinë e të mësojnë

Tregon Ismaili: “Ne shkuam për vizitë te Hasan Basriu, i cili ishte i sëmurë e kishte zënë shtratin, nga i cili nuk u çua më. Shtëpinë e kishte plot e përplot. Mblodhi pak këmbët dhe tha:

- “Edhe ne patëm shkuar tek Ebu Hurejreja (radijallahu anhu), kur ai ishte i sëmurë; e patëm mbushur shtëpinë plot e përplot, ndaj ai pati mbledhur këmbët dhe na pati transmetuar këto fjalë: “Patëm shkuar tek i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e patëm mbushur të gjithë shtëpinë e tij. Vetë ishte shtrirë brinjas. Kur na pa, i mblodhi këmbët dhe na tha:

- “*Pas meje do të vijnë ca njerëz, të cilët do të duan të dinë sa më shumë, ndaj do të vijnë tek ju. Thojuni atyre: ‘Mirë se erdhët!’, - përshëndetini ata dhe mësojuani edhe atyre çdo gjë që dini.”*

Hasan Basriu thotë se: “Për Zotin, ne shkuam te njerëz të atillë, që as mirëserdhët nuk na thanë, as nuk na përshëndetën, as nuk na mësuan asgjë. Kur shkuam tek ata, ata silleshin me shumë ashpërsi ndaj nesh!”⁴⁰

³⁹. Tirmidhi, *Sunen*, 5/30 (2650).

⁴⁰. Ibn Maxhe, *Sunen*, 1/91 (248).

I Dërguari i Allahut i nxit njerëzit që të marrin pjesë në kuvendimet e njerëzve të ditur

Abdullah bin Amri tregon: “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi pranë dy grupeve që ishin në xhami. Një prej atyre grupeve po i luteshin Allahut, pra ishin të zënë duke përmendur Allahun me Emrat e Tij të bukur e po i drejtoheshin Atij me lutjet më të bukura; grupi tjetër, ata po diskutonin për çështje të së drejtës dhe shumë rregulla të tjerë të besimit.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit goftë mbi të) tha:

- *“Të dyja grupet janë duke u marrë me diçka shumë të mirë. Vetëm se njëri është më i virtytshëm e qëndron më lart se tjetri. Të parët po i luten Allahut, për t’i kërkuar ndihmë. Allahu, po deshi u jep, po nuk deshi nuk u jep. Kurse të tjerët edhe po mësojnë vetë, edhe po u mësojnë atyre që nuk dinë, sepse, në fund të fundit, edhe unë si mësues u dërgova në këtë botë.”* Pastaj iku dhe u ul me ata që po diskutonin çështje të *fikh*-ut.”⁴¹

23. RËNDËSIA QË I JEPNIN KUVENDEVE TË DIJES I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ

**Resulullahu i shtyn të gjithë të marrin pjesë
në ato vende ku kuvendohet për dijen**

Abdullah bin Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, ne e pyetëm Profetin tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Resulullah, kush është më i miri prej nesh që jemi ulur këtu?”

- *“Më i miri i të gjithëve është ai që kur e sheh, të kujton Allahun, kur flet ai, të shtohen dijet dhe sjelljet e qëndrimet e të cilit të bëjnë të mendosh për jetën e përtejme.”*, – na u përgjigj Krenaria e Njerëzimit.”⁴²

24. RESPEKTI QË DUHET TREGUAR NË KUVENDET E DIJES

Në një transmetim prej Sehli, Ebu Hazim tregon: “Sehli ishte ulur mes të afërmve dhe fisit të tij; po u fliste atyre për të Dërguarin e

⁴¹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/301 (28873).

⁴². Bejheki, *Shuabu’l-Iman*, 7/57 (9446).

Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Teksa fliste, disa nga ata që ishin të pranishëm në atë hallkë kishin filluar të flisnin me njëri-tjetrin e kjo e nervozoi tej mase Sehlin, e ai nuk duroi dot më dhe tha:

- “Shikoji pak ata njerëz. Unë jam ulur këtu dhe po ju flas për ngjarje që kanë ndodhur e që unë i kam dëgjuar me veshët e mil.. Po ta dini, se këtej e tutje unë nuk vij më të ulem këtu mes jush!” Unë e pyeta se ku do të shkonte.

- “Do të shkoj të luftoj në rrugën e Allahut.”, – mu përgjigj ai. E unë i thashë aty për aty:

- “Po ti nuk mund të luftosh dot më, tanimë ti as shpatën nuk e mban dot, as heshtë nuk lëshon dot; sepse tanimë je i moshuar. Më pa njëherë, u kthye i tëri nga unë dhe më tha:

- “Ebu Hazim! Edhe nëse nuk bëj dot asgjë, marr pjesë bashkë me ushtrinë. Ku i dihet, vjen ndonjë shigjetë qorre a gur a ku di unë dhe unë bie dëshmor.”⁴³

25. ETIKA E DIJETARIT DHE E NXËNËSIT

Logjika dhe zgjuarsia e veçantë e të Dërguarit të Allahut kur u përgjigjej pyetjeve të të tjerëve

Ebu Uameja (radijallahu anhu) tregon: “Erdhi një djalosh i kurejshëve dhe i tha të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem):

- “O Resulullah! A do të më japësh leje që të bëj zina!” Sahabët e dëgjuan dhe iu vërsulën menjëherë atij djaloshi të ri, por i Dërguari Fisnik u bëri atyre me shenjë që të mos e ngacmonin djalën. Atij i tha:

- “*Eja, afrohu këtu tek unë!*” – Pasi u afrua ai djalë, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha atij:

- “*A të pëlqen që dikush të bëjë imoralitet me nënën tënde?*”

- “Jo, uallahi, nuk dua, o Resulullah!”, – u përgjigj djaloshi.

- “*Atëherë, as njerëzit e tjerë nuk duan që dikush të bëjë imoralitet me nënat e tyre.*”, – i tha atij i Dërguari i Allahut.

- “*Po me vajzën tënde, a do të doje që dikush ta bënte atë punë?*”

⁴³. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir*, 6/108 (5656).

- “Jo.”, – tha djaloshi, – “kurrën e kurrës.”

- “*Epo, as të tjerët nuk duan që ajo paturpësi t’u bëhet vajzave të tyre.*”

Dhe kështu vazhdoi i Dërguari i Allahut ta pyeste me radhë:

- “*A do të doje që të bëhej me motrën tënde?*”; “*A do të doje që të bëhej me ballën tënde?*”; “*A do të doje që të bëhej me tezen tënde?*” E, kur pa se mori të njëjtën përgjigje nga ai djalosh, ia vuri dorën mbi sup dhe u lut për atë djalosh me këto fjalë:

- “*O Zot, falja atij mëkatin, pastroja zemrën dhe bëje të ndershëm.*” Që nga ajo ndodhi, ai djalosh u bë një nga njerëzit më të ndershëm, aq sa i vinte turp edhe kur i shikonte njerëzit në sy.”⁴⁴

26. ETIKA E SAHABËVE KUR U PËRÇONIN DIJEN TË TJERËVE

Tregon Shakik bin Selemeja: “Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) erdhi tek ne dhe na tha këto fjalë:

- “E kam marrë vesh se jeni mbledhur e keni ardhur deri këtu. Por, ajo që më pengon për të biseduar më shumë me ju është shqetësimi që kam përbrenda se mos ju bezdis, sepse i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u fliste njerëzve me një plan se sa gjatë do t’ju fliste, në mënyrë që ata të mos bezdiseshin nga kohëzgjatja e bisedës.”⁴⁵

Aliu (radijallahu anhu) ka thënë: “A doni që t’ju tregoj se kush është njeriu vërtet i ditur i fesë? Ai që nuk ua vështirëson fenë besimtarëve aq sa ata ta humbasin shpresën të mëshira e Allahut, që nuk ua lehtëson atyre fenë sa që t’ua bëjë të lehtë kryerjen e mëkateve, ai që i shqetëson njerëzit për dënimin e Allahut që mund t’i presë në Ditën e Gjykimit dhe ai që nuk braktis Kur’anin për t’u prirë nga burime të tjera, sepse, ashtu siç nuk mund të presësh shumë mbarësi nga adhurimi i atij që nuk e njeh mirë dimensionin juridik të fesë, po ashtu nuk mund të presësh ndonjë të mirë a mbarësi nga jurisprudenca e pa kuptuar, apo e kuptuar keq. Prandaj, as leximi i Kur’anit pa medituari mbi të nuk

⁴⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/256 (22265).

⁴⁵. Buhari, *Sahih*, 5/2355 (6048).

mund të sjellë shumë të mira.”⁴⁶

Ndërsa Omeri (radijallahu anhu) thotë: “Mësoni dije dhe mësojuani ato edhe të tjerëve. Me dijen të bëheni njerëz kryelartë dhe të thjeshtë. Ndaj mësuesve që ju mësojnë dhe ndaj nxënësve që u mësoni të jeni përherë të thjeshtë e modestë. Mos u bëni nga ata dijetarë despotikë, në mënyrë që kjo sjellje të mos ia ulë dijes suaj vlerën.”⁴⁷

Sahabët kishin edhe virtytin sa të thoshin ‘nuk e di’

Këtë e tregon Osman bin Abdullah bin Meuhebi: “Pranë buzës së ujit erdhi Xhubejr bin Mut’imi. Ata që gjendeshin aty e pyetën Xhubejrin në lidhje me një çështje rreth trashëgimisë. Xhubejri u tha atyre:

- “Nuk e di; por ju mund të më jepni dikë me vete, të pyes e ta mësoj se si qëndron e vërteta e çështjes që ju më pyetët.” Pastaj, kur u kthye, shkoi drejt e tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i bëri të njëjtën pyetje. Omeri (radijallahu anhu) i tha atij:

- “Kush do që të bëhet dijetar i vërtetë i fesë, të bëjë siç bëri Xhubejr bin Mut’imi.” Xhubejri i bëri Omerit (radijallahu anhu) të njëjtën pyetje që i patën bërë ata njerëz dhe nga ai mori përgjigje veç fjalët: “Zoti e di.”⁴⁸

Muhamed bin Ka’b el-Kuradhij (radijallahu anhu) tregon: “Erdhi një burrë tek Aliu (radijallahu anhu) dhe i bëri një pyetje. Dhe Aliu (radijallahu anhu) i ktheu atij përgjigje; mirëpo atij nuk i pëlqeu përgjigjja, ndaj i tha Aliut:

- “O Prijësi i Besimtarëve, po kjo çështje nuk është kështu, është kështu siç e di unë.” Atëherë, Aliu (radijallahu anhu) iu përgjigj atij:

- “Ti ke të drejtë, ndërsa unë gabova”, – duke recituar vargun Kur’anor: “... **Ne e ngremë lart atë që duam, e mbi çdo të ditur është një i Gjithëdijshëm.**” (Jusuf, 12/76)⁴⁹

⁴⁶. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/77.

⁴⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/463 (29348).

⁴⁸. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/519 (29508).

⁴⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/522 (29517).

Këshillat e Aliut (r.a.) në lidhje me etikën e nxënësit

Aliu (radijallahu anhu) ka thënë: “Disa nga të drejtat e mësuesit, nga dija e të cilit ti përfiton, janë këto: Nuk do t’i drejtosh atij shumë pyetje tejet të vështira. Kur ai nuk do që të të kthejë përgjigje, ti nuk do ta detyrosh të të përgjigjet me zor. Kur ai të shfaqet i ndrojtur, nuk do t’i kapesh pas rrobave, duke këmbëngulur që të të mësojë çdo gjë. Nuk do t’i bësh atij shenja me sy, me duar a fytyrë. Nuk do t’i bësh atij pyetje para një kuvendi me shumë njerëz. Edhe nëse ai gabon, ti nuk do ta dëshirosh të gabuarit e tij; në raste të tilla do të tregohesh i duruar dhe do të presësh që ai të kthejë nga gabimi i bërë. Nuk duhet t’i thuash atij: ‘Po aksh njeri thotë krejt të kundërtën!’ Nuk do t’ia zbulosh para të tjerëve të fshehtat. Nuk duhet të ngacmosh askënd në praninë e tij, duke u përpjekur që t’i provokosh ata me njëri-tjetrin dhe si në praninë e tij, si në distancë, do të jesh ti që do t’i dalësh atij në mbrojtje. Sa herë që të hysh në ndonjë kuvend me njerëz, xhematin do ta përshëndetësh me një përshëndetje të përgjithshme, ndërsa atë veçanërisht. Do të ulesh përpara tij dhe në çdo nevojë të tij të jesh ti që të çohesh e t’i shërbesh. Ti nuk duhet të bezdisesh nga bisedat e tij të gjata, sepse dijetari i ngjan një peme me kokrra frutash të mira; do të presësh me durim, që nga goja e tij të dalë ndonjë fjalë e dobishme, njësoj siç pret që të bjerë ndonjë hurmë e pjekur nga pema e hurmave! Kjo sepse dijetari është porsi një luftëtar që lufton në rrugën e Allahut në agjërim e sipër. Kur vdes një njeri i ditur, në kështjellën e Islamit hapet një e çarë e atillë, riparimi i së cilës është i pamundur deri në ditën e Kiametit. Kur vdes një nxënës i dijes, në xhenazën e tij marrin pjesë prej qiejve edhe shtatëdhjetë mijë engjëj ‘nga më të afërmit.’”⁵⁰

Sahabët i shtonin njohuritë dhe dijen e tyre duke bashkëbiseduar dhe duke e ballafaquar me njëri-tjetrin çdo gjë që dinin

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Ne ishim ulur bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ishim diku te gjashtëdhjetë vetë. I Dërguari Fisnik na thoshte neve një hadith, e kur çohëj për të kryer ndonjë punë në banesën e tij, ne fillonim të

⁵⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/523 (29520).

bashkëbisedonim me njëri-tjetrin rreth tij, derisa ai ngulitej më së miri në kujtesën e të gjithëve. Vetëm pastaj largoheshim edhe ne.”⁵¹

Kur Omeri (r.a.) u pyet sahabëve domethënien e një ajeti dhe pëlqen jashtë mase përgjigjen e dhënë prej Ibni Abasit

E tregon vetë Ibni Abasi (radijallahu anhu): “Omeri (radijallahu anhu) më merrte mua me vete kur shkonte në kuvendet e sahabëve të mëdhenj që kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit. Një ditë, Abdurrahman bin Afi (radijallahu anhu) i tha atij:

- “Po pse e merr këtë djalë dhe e ul këtu me ne? Ne kemi fëmijët në moshën e tij, por nuk i marrim me vete!” Dhe Omeri (radijallahu anhu) i pati thënë:

- “Atë e njihni mjaft mirë edhe ju.”

Po kështu, edhe një ditë tjetër, Omeri (radijallahu anhu) na ftoi mua dhe disa nga sahabët më të rëndësishëm. E pata kuptuar që atë ditë Omeri (radijallahu anhu) mua më pati ftuar që të më vlerësonte përpara të tjerëve. Omeri (radijallahu anhu) tha:

- “Çfarë mendimi keni në lidhje me domethënien e ajeteve të Kur’anit Famëllartë, të cilat thonë: **“Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës) dhe t’i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.”** (Nasr, 110/1-3) Disa nga sahabët u përgjigjën se ‘ato ajete na urdhërojnë se ne duhet të lëvdojmë Allahun, kur tek ne të vijë ndihma dhe fitorja e Tij, si dhe t’i lutemi Atij që të na falë.’ Një pjesë tjetër thanë, ‘nuk e dimë’. Në fund, Omeri (radijallahu anhu) u kthye nga unë dhe më pyeti:

- “Po ti, o i biri i Abasit, edhe ti këtë mendim ke?” E unë iu përgjigja:

- “Me këto ajete Allahu e lajmëron të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) se i është afruar fundi i jetës. Ndhma dhe fitorja e Allahut nënkuptojnë ngadhënjimin mbi Mekën, sepse edhe ngadhënjimi mbi Mekën është një nga shenjat e exhelit të të Dërguarit të Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të). Andaj edhe këto

⁵¹. Hejthem, *Mexhmen’u-Zenaid*, 1/397 (734).

ajete përmbyllen me ajetin, “atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.”

Në përmbyllje të fjalës sime, Omeri (radijallahu anhu) më tha:

- “Edhe unë kështu i kuptoj, njësoj si ti.”⁵²

Sahabët bënë shumë pak pyetje

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Unë nuk kam parë shoqëri më të mbarë sesa ajo e sahabëve të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Gjatë gjithë jetës, ata nuk e pyetën ndonjëherë të Dërguarin Fisnik përveç këtyre trembëdhjetë pyetjeve: “Na pyesin për muajt e ndaluar”, “Na pyesin për pijen dhe kumarin”, “Na pyesin në lidhje me jetimët”, “Na pyesin në lidhje me pasurinë që të është lënë ty si trashëgimi”, “Na pyesin në lidhje me plaçkën e luftës”, “Na pyesin se çfarë duhet të japin e të ndajnë në rrugën e Allahut”...

Ata pyesnin vetëm për ato gjëra që do të ishin vërtet të vyera e të dobishme për ta.”⁵³

Gratë ensare nuk druheshin nga bërja e pyetjeve

E tregon Aishja (radijallahu anha): “Sa njerëz të mirë ishin gratë ensare! Droja dhe ndjesia e zorit nuk i pengonte ato aspak që të bënë çdo lloj pyetjeje në lidhje me fenë, në mënyrë që të thelloheshin sa më shumë në njohjen e saj.”⁵⁴

Nëna e Enesit (radijallahu anhu), Umu Sulejmi (radijallahu anha), tregon se: “Unë isha fqinje me njërën nga bashkëshortet e bekuara të Profetit tonë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), Umu Selemen (radijallahu anha). Një ditë shkova tek i Dërguari i Allahut dhe e pyeta:

- “O Resulullah! Nëse një grua sheh në ëndërr se po kryen marrëdhënie me burrin e saj, a është e domosdoshme që ajo grua të lahet e të marrë gusul?” Umu Selemeja iu përgjigj kështu pyetjes sime:

⁵². Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/317.

⁵³. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 1/393 (723).

⁵⁴. Muslim, *Sahih*, 1/260 (332).

- “Umu Sulejm, të dhëntë Zoti të mirën! U nxore bojën gjithë grave para Resulullahut!”

- “Allahu nuk i druhet asgjëje për ta shfaqur të vërtetën në mënyrën më të hapur. Më mirë ta pyesim Profetin tonë për çdo problem që kemi, sesa të mbetemi të paditura.”, – ia ktheva unë. Resulullahu më kishte dëgjuar dhe m’u përgjigj:

- “*Të dhëntë Zoti të mirën, o Umu Sulejm! Po, nëse kur të zgjohesh do t’i shobësh teshat të ndotura, atëherë gruaja dubet të labet.*”

Ndërsa, e shoqja, Umu Selemeja (radijallahu anha) e pyeti atë:

- “O Resulullah, po pse a ka edhe gruaja lëngje që ia prishin gusulin?”

- “*Po, po të mos kishte gruaja lëngje, si do të mund të ngjante fëmija me të? Edhe gratë janë një pjesë e burrave, janë të ngjashmet e tyre.*”⁵⁵

27. NXËNIA E KUR’ANIT, MËSIMI I TIJ TË TJERËVE DHE LEXIMI PARA BASHKËSISË

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Ebu Talhaja (radijallahu anhu) pati ardhur një ditë tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e gjeti atë që kishte lidhur një gur fort pas barkut, për të duruar urinë dhe po u mësonte Kur’an sahabëve të Sufes.”⁵⁶

Tregon po Enesi (radijallahu anhu): “Ebu Musa el-Eshari ishte ulur në shtëpi dhe nisi të lexojë Kur’an. Në atë kohë tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi dikush dhe i tha:

- “O Resulullah! Ebu Musa është ulur në shtëpi dhe kur i erdhën njerëz, ai filloi t’u lexojë atyre Kur’an.” I Dërguari i Allahut iu përgjigj atij njeriu duke i thënë:

- “*A mund të më çosh e të më ulësh mua në një vend ku nuk do të mund të më shohë dot asnjë prej xhematit?*”

- “Po.”, – iu përgjigj ai njeri dhe i Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) shkoi bashkë me të për në shtëpinë e Ebu Musait. Profeti ynë u ul në një vend ku nuk e shihte askush. Sapo dëgjoji zërin e Ebu

⁵⁵. Hejthemî, *Mexhmu’u-Zenaid*, 1/404 (754).

⁵⁶. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 25/114 (284).

Musait, i Dërguari Fisnik tha:

- “*Ai po e lexon Kur’anin njësoj siç u lexonte Daudi i nderuar njerëzve që kishte më afër vetes.*”⁵⁷

Kur’ani është “Sofra e Allahut”

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë: “Mësojeni Kur’anin, sepse Kur’ani është “Sofra e Allahut”. Kushdo të shohë se ç’mund të marrë sa më shumë prej atyre që janë të shtruar në atë sofër, sepse një shtëpi e privuar nga e mira është një shtëpi që nuk ka përfutur asgjë prej librit të Allahut. Dhe ajo shtëpi që nuk ka përfutur asgjë prej librit të Allahut, është si një muranë e braktisur nga çdo lloj kujdesi. Djalli nuk qëndron dot në atë shtëpi ku lexohet sureja “Bekare”, ia mbath, ikën.”⁵⁸

Sa duhet të dijë përmendësh prej Kur’anit një mysliman?

Omeri (radijallahu anhu) ka thënë: “Një mysliman duhet të dijë përmendësh të paktën gjashtë sure të Kur’anit Famëlartë. Dy për namazin e mëngjesit, dy për namazin e akshamit dhe dy për namazin e jaciesë.”⁵⁹

Omeri (radijallahu anhu) ka thënë: “Mësojini suret ‘Bekare’, ‘Nisa’, ‘Maide’, ‘Haxh’ dhe ‘Nur’, sepse gjykimet e Kur’anit gjenden në këto sure.”

Po ashtu Omeri (radijallahu anhu) thotë edhe: “Mësojeni suren ‘Teube’. Ndërsa grave tuaja mësojuni suren ‘Nur’ dhe vëruni atyre stoli argjendi.”⁶⁰

Çfarë duhet të bëjnë ata që kanë vështirësi në mësimin e Kur’anit përmendësh, apo që i harrojnë shumë shpejt ato që kanë mësuar?

Ja se si tregon Ebu Rejhaneja (radijallahu anhu) në lidhje me këtë:

⁵⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/581 (37561).

⁵⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/130.

⁵⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/397 (4016).

⁶⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/426 (4096).

“Shkova tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i thashë se kisha vështirësi në mësimin përmendësh të Kur’anit, pasi i harroja shpejt ato që mësoja.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) mu përgjigj duke më këshilluar:

- “*Mos e mundo veten sa të kërkesësh të kapërcesh fuqitë e tua. Përpiqu të bësh sa më shumë sexhde.*”⁶¹

Të preferosh Kur’anin në vend që të merresh me gjëra të tjera

Karadha bin Ka’bi (radijallahu anhu) na tregon: “Ishim nisur të shkonim për në Irak. Omeri (radijallahu anhu) na shoqëroi deri në vendin e quajtur Sirar, i cili gjendet diku te pesë kilometra larg Medinës. Mori abdes dhe na tha:

- “A e dini ju se pse erdha me ju deri këtu duke ecur?” Ata i thanë:

- “Po, ti na shoqërove deri këtu ngaqë ne jemi sahabë të Resulullahut.” Omeri (radijallahu anhu) i dëgjoi dhe shtoi:

- “Ju do të shkoni pranë një shoqërie që më të shumtën e kohës e kalon duke u marrë me Kur’anin, porsi ato bletët që zukasin përreth koshereve. Mos u flisni atyre shumë për hadithet, në mënyrë që të mos largohen nga Kur’ani. Edhe ju zgjidhni Kur’anin para çdo gjëje tjetër. Transmetoni më pak prej të Dërguarit të Allahut. Vazhdoni rrugën tuaj, e mua shpirtërisht do të më keni përherë në mbështetje.”

Kur mbërritën, vendasit i kërkuar Karadha bin Ka’bit që t’u mësonte e transmetonte sa më shumë hadithe prej të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të), por ai u tha atyre:

- “Jo, këtë ma ka ndaluar Omeri (radijallahu anhu).”⁶²

28. NË KOHËN KUR PAGESA PËR MËSIMDHËNIEN E KUR’ANIT NUK SHIHET ME SY TË MIRË

Rrëfen Ubej bin Ka’bi (radijallahu anhu): “Unë i pata mësuar dikujt një sure nga Kur’ani. Dhe ai, si shpërblim për atë që i pata mësuar,

⁶¹. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 2/156.

⁶². El-Hakim, *Mustedrek*, 1/183 (347).

erdhi e më solli dhuratë një veshje të bukur. Shkova tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tregova se çfarë kishte ndodhur. I Dërguari Fisnik më tha:

- “Nëse e pranon, ti do të bedbësh mbi shpinë një rrobë prej zjarri.”⁶³

Auf bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: “I pata mësuar një burri diçka nga Kur’ani dhe ai më dhuroi mua një hark shumë të mirë. Kur i tregova të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ai më këshilloi duke më thënë:

- “Shiko, o Auf, ti do që të takobesh me Allahun duke mbajtur midis dy shpatullave një copë nga zjarri i Xhehenemit?”⁶⁴

29. KËSHILLA E SAHABËVE PËR ATA QË LEXOJNË KUR’AN

Ja se si na e tregon Ebu Kinaneja: “Ebu Musai i mblodhi njëherë të gjithë ata që lexonin Kur’an. Bëheshin diku te treqind vetë. Pasi e puthi Kur’anin dhe tregoi gjithë respektin ndaj Kur’anit Famëlartë, Ebu Musai tha:

- “Ky Kur’an është edhe një burim shpërblimi, edhe një shkak për një barrë shumë të rëndë për ju. Ju mos bëni asgjë tjetër, veçse binduni e përshtatuni Kur’anit; mos e identifikoni atë me veten tuaj. Kushdo që ndjek gjurmët e Kur’anit, Kur’ani atë ka për ta çuar në kopshtet e Xhenetit. E ai që identifikon Kur’anin me veten, duke e përshtatur atë sipas vetes, Kur’ani atë e hedh kokëposhtë në humnerat e Xhehenemit.”⁶⁵

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) thotë: “Një njeri që ndjek Kur’anin duhet të jetë i zgjuar, kur të tjerët flenë gjatë natës; kur të tjerët ulen e hanë gjatë ditës, ai duhet të jetë duke agjëruar; ai duhet të jetë kryelartë e serioz, kur të tjerët qeshin e argëtohen me njëri-tjetrin. Njerëzit e Kur’anit duhet të jenë të trishtuar e sytë duhet t’i kenë me lot. Duhet të jenë njerëz të urtë, të ditur e të butë dhe duhet të flasin sa më pak. Ata nuk duhet të jenë kurrsesi njerëz të ashpër, të përhumbur, që ulërijnë e këlthasin dhe nxehen e nevrikosen menjëherë.”⁶⁶

⁶³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/459 (4194).

⁶⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/466 (4214).

⁶⁵. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/257.

⁶⁶. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/130.

30. CILËSITË QË DUHET TË KENË ATA QË MERREN ME HADITHIN

Eslemi (radijallahu anhu) tregon: “Ne i thoshim Omerit (radijallahu anhu):

- “A do të na flasësh për hadithet e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem)?” Por ai na përgjigjej gjithmonë duke na thënë:

- “Unë kam shumë frikë, se mos jua tregoj dhe gjatë tregimit shtoj apo heq ndonjë shkronjë nga fjalët e tij, sepse i Dërguari i Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë kështu: *“Kush gënjen në emrin tim, me qëllim, e ka vendin në Xhebenem.”*⁶⁷

Amr bin Mejmuni (radijallahu anhu) tregon se: “Po ta pyesje Abdullah bin Mesudin (radijallahu anhu) në lidhje me sunetin e të Dërguarit Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), ai nuk të përcillte asgjë. Një ditë ai po transmetonte një hadith që e kishte dëgjuar nga vetë i Dërguari i Allahut. Ende pa e nisur mirë fjalën, atë e mbërtheu një siklet; fytyra iu mbulua nga djärsët. Por, Ibni Mesudi, kur tregonte për ndonjë gjë që kishte dëgjuar nga i Dërguari i Allahut, do të thoshte gjithmonë: ‘I Dërguari i Allahut tha diçka të ngjashme me këtë, apo ‘pak a shumë’ këtë...’⁶⁸

31. SAHABËT, MË SHUMË SESA DIJES SË THATË, I JEPNIN RËNDËSI VEPRIMIT

Ja se çfarë thotë Enesi (radijallahu anhu): “Ju mësoni ç’dije të doni. Por ta dini mirë, se, nëse nuk i vini në veprim ato që dini, ju nuk përfitonit dot shpërblim prej saj...”⁶⁹

Aliu (radijallahu anhu) thotë: “O njerëz të ditur, vëreni në praktikë dijen tuaj. Njeri i ditur është ai dija e të cilit reflektohet edhe në jetën e tij dhe që nuk i bien ndesh ato që di me ato që bën. Në një të ardhme të afërt ju do të shihni njerëz, të cilëve dija nuk u kalon poshtë gurmazit. Ata botën e brendshme e kanë krejt të kundërt nga bota që shfaqin

⁶⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/510 (29481).

⁶⁸. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/355 (5374).

⁶⁹. Munau, *Fejdu’l-kadij*, 3/253 (3323).

jashtë. Kur mblidhen me njëri-tjetrin, ata nuk kanë qëllim vetëm se t'i mburren njëri-tjetrit. Madje ka disa prej tyre, të cilët mërzhiten dhe nervozohen që ndonjë nga shokët e tyre t'ia braktisin kuvendin, e t'i bashkohen hallkës së kuvendimit të ndonjë tjetri. Asgjë nga ajo që ata bëjnë nëpër këto kuvende nuk mbërrin tek Allahu; Ai nuk e pranon atë.”⁷⁰

Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) thotë: “Ju mësoni ç’të doni, por për sa kohë që nuk do të veproni sipas asaj që dini, Allahu nuk ka për t’ju hapur juve portat e thesarit të dijes.”⁷¹

32. TË NDJEKURIT E SUNETIT TË ÇMUAR, TË ECURIT NË RRUGËN E TË PARËVE TË MIRË DHE BRAKTISJA E STISJES SË GJËRAVE TË PAQENA NË FE

E tregon vetë Ibni Mesudi (radijallahu anhu): “Ditëve të enjte unë dilja përpara bashkësisë dhe u flisja për çështje të ndryshme. Unë u thosha atyre: ‘Në jetë ka dy gjëra, të cilat janë shumë të rëndësishme: njëra është udhëzimi, tjetra është fjala. Fjala më e drejtë është Fjala e Allahut, Kur’ani Famëlartë. E rruga e udhëzimi më i drejtë është rruga nëpër të cilën ka ecur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Nuk ka gjë më të keqe e më të shëmtuar sesa stisja e gjërave të paqena në fe, që përpiqen t’i bëjnë pjesë të fesë. Çdo sagesë është një devijim nga feja. Nëse zhyteni shumë thellë në jetën e kësaj bote, zemra do t’ju ngurtësohet. Si dhe të mos ju gënjejë kurrësi ndjesia se do të qëndroni përjetësisht në këtë botë...”⁷²

Po ashtu Ibni Mesudi (radijallahu anhu), njëherë tjetër, ka thënë kështu: “Ju do të gjeni dikë e do ta merrni si shembull, ndaj, kur ta bëni këtë, si shembull për veten zgjidhni sahabët e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), sepse ata janë më të sinqertët e këtij umeti dhe ata e kanë edhe dijen më të thellë. Ata i kanë qëndruar larg teprimrit dhe do të shihni se ata sillen tejet natyrshëm me çdokënd. Ata

⁷⁰. Darimi, *Sunen*, 1/118 (382).

⁷¹. Ebu Nu’ajm, *Hiçe*, 1/214.

⁷². Ibnu’l-Xheuzi, *Sifetu’s-Safue*, 1/409.

jo vetëm janë në më të drejtën e rrugëve, që mund të ndjekë një njeri, por janë po ata që kanë arritur gjendjen më të mirë njerëzore. Secili prej tyre është një personalitet i veçantë, që Allahu e ka zgjedhur për të mëkëmbur fenë, si edhe për t'i bërë shoqëri Profetit të Tij. Ja, me këto cilësi të arrira e të epërme t'i njihni ata dhe mos ngurroni që t'i ndiqni me përpikëri, sepse ata janë në më të drejtën rrugë.”⁷³

33. SAHABËT RUHEN NGA NDJEKJA E PIKËPAMJEVE TË PABAZA

E transmeton Ibni Shihabi, duke thënë: “Omeri (radijallahu anhu) ishte ngjitur mbi minber dhe po u fliste njerëzve:

- “O njerëz! Pikëpamja personale është diçka që vetëm i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) mund ta kishte; sepse atij ia mësonte dhe ia tregonte të vërtetat vetë Allahu. Ndërsa pikëpamjet tona nuk janë vetëm se pandehma dhe stisje.”⁷⁴

Tregon Sadaka bin Ebu Abdullahu: “Omeri (radijallahu anhu) gjithmonë na thoshte:

- “Ata që shprehin pikëpamjet e tyre të pabaza, që nuk i mbështetin ato në një burim, janë, në fakt, kundërshtarë të sunetit. Ata nuk e kanë kuptuar e nuk e kanë përvetësuar dot Sunetin e Resulullahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), duke humbur një mundësi të rrallë. Jo vetëm kaq, por, po t’i pyesësh këta njerëz në lidhje me ndonjë çështje, atyre u vjen turp që të thonë: ‘Jo, nuk e dimë këtë.’ Ata duan të përballen me sunetin me pikëpamjet e tyre personale. Aman, kini kujdes nga të tillë njerëz.”⁷⁵

Ibni Abasi (radijallahu anhu) ka thënë: “Rruga jonë e mirëfilltë janë Libri i Allahut të Madhërishëm, Kur’ani, dhe Suneti i Profetit tonë (paqja e Zotit qoftë mbi të). Unë nuk e di se çfarë do të fitojnë disa njerëz nga pikëpamjet e tyre personale, shpërblime apo mëkate, kur ne kemi fare mirë Kur’anin dhe Sunetin.”⁷⁶

⁷³. Ebu Nu’ajm, *Hijje*, 1/305.

⁷⁴. Ebu Daud, *Sunen*, 2/326 (3586).

⁷⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/482 (29406).

⁷⁶. Ibn Abdi’l-Berr, *el-Istiaab*, 2/136.

34. GJYKIMET E SAHABËVE

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë: “Nëse ju pyet ndokush, për t’ju kërkuar që të jepni gjykimin tuaj lidhur me ndonjë çështje, atëherë gjykoni sipas librit të Allahut. Nëse përgjigjja e asaj pyetjeje nuk ju shfaqet në Kur’an, atëherë gjykoni sipas Sunetit të të Dërguarit të Allahut. Nëse ajo është një çështje, përgjigjja e së cilës nuk është as në Kur’an, as në Sunet, atëherë kërkojuni mendim njerëzve të mirë. Por, nëse edhe prej tyre nuk gjeni një përgjigje, atëherë gjykoni vetë; mos u druani ta bëni këtë gjë.”⁷⁷

Abdurrahman bin Ebi Lejla tregon: “Unë jam takuar me thuasë njëqind sahabë të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Secili prej tyre, kur transmetohej ndonjë hadith, u kërkonte mendim edhe sahabëve të tjerë për ta aprovuar; kur kishte nevojë për t’u dhënë ndonjë gjykim, kërkonte mendimin edhe të sahabëve të tjerë, nëse do t’ia pranonin atë gjykim, apo jo.”⁷⁸

35. SHKALLËT E NDRYSHME TË DIJES TE SAHABË TË NDRYSHËM

Tregon Mesruku: “Unë kam ndenjur shumë me sahabët e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem); kam biseduar gjerë e gjatë me ta. E kam parë vetë me sytë e mi dhe e kam dëgjuar me veshët e mi, vërtet, ata ishin të gjithë të thellë porsiq oceanet. Kishte prej tyre që ishin aq të ditur, saqë mund të përmbushnin nevojën e çdokujt për dije. Kishte prej tyre të atillë që mund të jetësonin, njëri dhjetë, njëri njëqind njerëz, madje kishte syresh që do të mjaftonin më vete për t’i dhënë jetë me dije mbarë njerëzimit. Ja pra, një nga këta ishte edhe Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu).”⁷⁹

⁷⁷. Nesai, *Sunen*, 8/230 (5398).

⁷⁸. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 6/110.

⁷⁹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/159.

36. DIJETARËT ME FRYMËZIME PREJ ALLAHUT DHE DIJETARËT E KËQIJ NË SYRIN E SAHABËVE

Tregojnë se Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) u thoshte nxënësve të tij kështu: “Bëhuni burime të dijes; shndërrojeni veten në kandila të udhës e udhëzimit të drejtë; të mbani disa shtëpi; përhapni dritë përreth, njësoj siç bëjnë edhe kandilat e ndezur. Vërtet, teshat mund t’i keni të vjetruara, por kjo nuk ka as më të voglën rëndësi. E rëndësishme është që ju t’i keni zemrat të pastra, të kulluara dhe të qashtra. Edhe nëse nuk do t’ju njohë askush në këtë botë, banorët e qiejve ju njohin mjaft mirë dhe të mos keni dyshim që kanë për t’ju dhënë vlerën që meritoni.”⁸⁰

Sufjan bin Ujejeja thotë: “Ne na u përcoll se Ibni Abasi (radijallahu anhu) kishte thënë kështu: Ne na është treguar se Ibni Abasi (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Nëse njerëzit do ta përvetësonin dijen në mënyrën e duhur dhe do të vepronin sipas saj; Allahu, engjëjt dhe robërit e mirë të Tij i duan njerëzit e ditur, madje edhe populli i respekton ata. Por, fatkeqësisht, duke qenë se ata e mësojnë dijen për të fituar më shumë të mira prej kësaj bote, meritojnë edhe përbuzjen e Allahut, edhe fyerjet e njerëzve.”⁸¹

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Kur të vijë koha që njerëzit e vegjël të bëhen mendjemëdhenj e të shiten për të madh dhe të mëdhenjtë të moshohen e të mos kenë më ndikim, gjendja juaj do të jetë për të ardhur keq! Për të ardhur keq do të jeni edhe kur të braktiset Suneti e të dynden sajaset në fe, e sapo të përmendet Suneti i vërtetë të thuhet: ‘Nuk mund të ketë diçka të tillë, është e papranueshme!’...” E pyetën:

- “Kur do të ndodhin këto që po na thoni?”, – dhe Ibni Mesudi (radijallahu anhu) dha këtë përgjigje:

- “Kur të pakësohen njerëzit e besueshëm, të shtohen drejtuesit, të pakësohen njerëzit e mirëfilltë të fesë, por të shtohet numri i atyre që

⁸⁰. Ebu Nu’ajm, *Hijje*, 1/77.

⁸¹. Ibn Maxhe, *Sunen*, 1/95 (257).

lexojnë dhe e mësojnë përmendësh Kur'anin dhe feja të mësohet jo me qëllimin për t'i shërbyer asaj, por për gjithfarë qëllimesh të tjera.”

Në një transmetim tjetër do të gjejmë edhe diçka më shumë, ku thuhet edhe: “Kur populli t'i pranojë sajaset e reja në fe si Sunet dhe një të tentuar dikush për t'i zhdukur ato sajasa, njerëzit të ulërijnë e të ankohen: ‘Aman, po na humbet Suneti!’”⁸²

Ebu Osman En-Nehdi tregon: “Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) po na fliste nga minberi e po na thoshte:

- “Bëni kujdes nga hipokritët e ditur!” Të habitur, besimtarët e pyetën:

- “Si mund të jetë i ditur një hipokrit?” Dhe Omeri (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Ndodh, thotë të vërtetën, por vetë bën të kundërtën.”⁸³

37. ZHDUKJA DHE HARRESA E DIJES

Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) pyeti:

- “A e dini ju se si do të dobësohet Islami?”

- “Njëloj siç zbehet ngjyra e stofit të veshjeve, njësoj siç humbet gjurma e devesë, ose njësoj siç fshihen shkrimet e ngulitura mbi para prej kalimit dorë më dorë.” – u përgjigjën ata. Ibni Mesudi i përgëzoi dhe u tha:

- “E drejtë, por e dini cila është më e rëndësishmja: vdekja e dijetarëve.”⁸⁴

Refen Amar bin Ebu Amari (radijallahu anhu): “Në kohën kur vdiq Zejd bin Thabiti (radijallahu anhu) ne shkuam tek Ibni Abasi (radijallahu anhu), i cili ishte ulur në hijen e një ndërtese. Ibni Abasi na foli:

- “Ja, kështu humbet dija dhe fillon dalëngadalë të humbasë. Kushedi se sa dije u varros sot bashkë me trupin e tij.”⁸⁵

⁸². Bejheki, *Shuabul-Iman*, 5/361 (6951).

⁸³. El-Hindi, *Kenẓul-Ummal*, 10/479 (29395).

⁸⁴. Hejthemi, *Mexibmen'z-Zenaid*, 1/473 (990).

⁸⁵. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/177.

Nga Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) është përcjellë një transmetim, në të cilin thuhet: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) lutej:

- “O Zot, unë vetëm tek Ti mund të kërkoj ndihmë e mbrojtje nga katër gjëra: dija e padobishme, zemra që nuk drithërohet nga respekti për Allahun e Madhërishëm, nga egoja që nuk ka të ngopur dhe nga lutja e papranuar.”⁸⁶

⁸⁶. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/283 (14055).

DHIKRI



1. I DËRGUARI I ALLAHUT I NXIT BESIMTARËT QË TA PËRMENDIN ALLAHUN SA MË SHUMË

E tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Një ditë Krenaria e Gjithësisë po shkonte për në Mekë. Kur mbërritën pranë një mali, të cilin e kishin quajtur Xhumdan, ai ndaloi dhe tha:

- “*Kaloni Xhumdanin, sepse që këtej kanë kaluar edhe përmendësit para jush.*” E kur e pyetën: “E kush janë këta përmendësit, çfarë janë ata, o i Dërguari i Allahut?”, – ai u dha atyre përgjigjen:

- “*Ata që e përmendin shumë Allahun.*”

Ndërsa, në një transmetim tjetër thuhet se ai ka thënë: “*Janë ata që e kalojnë jetën duke e përmendur Allahun gjithë dashuri e pasion, përmendje që ka për t’ua lehtësuar barrën dhe në Ditën e Gjykimit do të dalin përpara Allahut fare të qetë e të çliruar.*”¹

¹. Muslim, *Sahih*, 4/2062 (2676).

* Dhikr (arab.), përmendja e Allahut të Madhërishëm. (shën. red.)

Muadh bin Enesi (radijallahu anhu) tregon se: “Një burrë i bëri të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) këtë pyetje:

- “Kush nga luftëtarët e ka shpërblimin më të madh e më të shumtë?” I Dërguari Fisnik i tha atij:

- “*Ata që e përmendin më së shumti Allahun.*” Kësaj here ai e pyeti sërish:

- “Kush nga robërit e mirë të Allahut e ka shpërblimin më të madh e më të shumtë?” I Dërguari i Allahut i dha atij prapë të njëjtën përgjigje:

- “*Ata që e përmendin më së shumti Allahun.*” Ai burrë të njëjtën pyetje e bëri edhe për ata që falin namaz, japin zekat dhe shkojnë në haxh, dhe për secilën nga pyetjet përgjigja e të Dërguarit Fisnik (pagja e Zotit qoftë mbi të) ishte po e njëjta:

- “*Ata që e përmendin më së shumti Allahun.*” Atëherë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) iu drejtua Omerit (radijallahu anhu):

- “O Eba Hafs! Të gjitha shpërblimet i morën ata që përmendin Allahun e për ne nuk mbeti asgjë.”, – dhe i Dërguari i Allahut pohoi:

- “*Po, ashtu është.*”²

Tregon edhe Abdullah bin Busri: “Erdhi një burrë tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha:

- “O Resulullah, unë nuk po i përmbush dot të gjitha detyrimet e fesë islame. Më jep një këshillë, diçka që unë mund ta bëj medoemos.” I Dërguari i Allahut iu përgjigj atij:

- “*Mos e lër kurrë pa e përmendur Allahun.*”³

Nuk bëhet fatkeq ai që rri me ata që e përmendin Allahun

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) po kalonte pranë Abdullah bin Reuahasë (radijallahu anhu), i cili po u jepte disa këshilla disa prej shokëve të tij dhe i tha atij:

². Hejthemi, *Mexhmen'z-Zenaid*, 10/71 (16748).

³. Tirmidhi, *Sunen*, 5/458 (3375).

- “Ju jeni një bashkësi, për të cilën Allahu mua më urdhëroi që bashkë me ju të bëjmë durim.” – mandej, vazhdoi të thoshte:

- “Më dëgjoni me kujdes! Sa vetë jeni ju këtu, po aq engjëj kanë ardhur e janë ulur dhe po rrinë bashkë me ju. Kur ju përmendni Allahun, e përmendin edhe ata; ju lëvdoni Allahun dhe pas jush Allahun e lëvdojnë edhe ata; ju tregoni respekt dhe e madhëroni Allahun, e po të njëjtën bëjnë edhe engjëjt, e madhërojnë Allahun duke thënë: ‘Allahu Ekber!’ Paskëtaj ata shkojnë pranë Allahut, e megjithëse Ai e di më mirë se engjëjt se çfarë ishin duke bërë robt e Tij, ata i thonë: ‘O Zot! Robt e Tu të përmendën, e bashkë me ta të përmendëm edhe ne. Ata të madhëruan duke thënë ‘Allahu Ekber’, thamë edhe ne të njëjtën gjë. Ata të lëvduan dhe bashkë me ta të lëvduam edhe ne.’ Atëherë, Zoti shpall: ‘Engjëjt e mi! Ja ku jeni ju dëshmitarë, Unë i fala ata.’ Engjëjt thonë: ‘Me ta ishte edhe aksh edhe aksh njeri, të cilët kanë kryer shumë mëkate.’ Allahu u thotë: ‘Po ata janë një bashkësi e atillë, që kushdo që rri me ta nuk është fatkeq!’”⁴

2. SAHABËT FISNIKË I NXITIN BESIMTARËT TA PËRMENDIN SA MË SHUMË ALLAHUN

Omeri (radijallahu anhu) thotë: “Përpiquuni që ta përmendni sa më shumë Allahun, sepse përmendja e Tij është ilaç. Dhe shmanguni prej thashethemeve për njerëzit, duke mos i hequr ata nga goja, sepse thashethemet janë një sëmundje.”⁵

Tregon Hubejb bin Ubejdi: “Kishte ardhur një burrë tek Ebu Derdaja, i cili i tha:

- “Më jep një këshillë.” Ebu Derdaja e këshilloi duke i thënë:

- “Përmende Zotin shumë kur je mirë dhe i qetë, në mënyrë që edhe Ai të të përmendë ty kur të jesh i zënë ngushtë dhe i shqetësuar në ditë të vështira. E kur të të vijë ndonjë e mirë e kësaj bote, mendo se ajo e mirë është kalimtare dhe do të ketë një fund.”⁶

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na tha:

- “Të rrisb bashkë me ata që e përmendin Allahun në kohën mes namazit të

⁴. Ibn Hibban, *Sahih*, 3/139 (857).

⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/362 (3922).

⁶. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/259.

sabahut dhe lindjes së plotë të diellit, për mua është më e virtytshme se sa të liroj katër skllever nga soji i Ismailit (alejhis'selam) duke paguar nga dymbëdhjetëmijë derhemë për secilin. Po ashtu, të jesh bashkë me një bashkësi që e përmend Allahun pasi fal namazin e ikindisë e deri në perëndimin e plotë të diellit, për mua është më e hairit sesa të liroj katër skllever nga soji i Ismailit duke paguar nga dymbëdhjetëmijë derhemë për secilin.”⁷

Tregon Enes bin Maliku (radijallahu anhu): “Ne ishim duke ecur bashkë me Ebu Musain (radijallahu anhu), po shkonim për diku. Me të dëgjuar që disa njerëz po flisnin me zë të lartë dhe me një ton bindës, Ebu Musai (radijallahu anhu) tha:

- “E ç’na duhet neve, o Enes, se çfarë flasin këta njerëz? Eja, ne më mirë të përmendim Allahun. Shikoje pak atë atje, edhe pak edhe do të shqyejë nofullën duke u përpjekur që të flasë sa më qartë!”⁸

3. BASHKËSITË DHE KUVENDET E BASHKËBISEDIMIT KU PËRMENDET EMRI I ALLAHUT

Xhabiri (radijallahu anhu) na tregon: “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi tek ne dhe na u drejtua me këto fjalë:

- “O njerëz! Mes engjëjve të Zotit ka grupe të atilla, të cilat zbresin në tokë nëpër kuvendet ku mbledhen njerëz dhe përmendin Allahun, për të marrë edhe ata pjesë në përmendjen e Allahut. Andaj, edhe ti atë bëj, shëtiti në shpatet magjepsëse të përmendjes së Allahut, njësoj si engjëjt.”

- “O Resulullah! Po ku janë këto kopshte të bukura të Xhenetit?”, – e pyetën Resulullahun dhe ai ktheu këtë përgjigje:

- “Ato janë në kuvendimet e bashkëbisedimit për Allahut. Nxitoni e përmendeni sa më shumë Allahun në mëngjes dhe në mbrëmje, mos e lini atë pas dore. Kujtojeni Atë sa më shumë vetes. Ai që do të kuptojë se ç’vend zë e ç’vlerë ka për Allahun, të shohë se ç’vend zë e ç’vlerë ka Zoti brenda tij, sepse vlera dhe shkalla që Allahu i jep robrit të Tij është në raport të drejtë me qëndrimin që mban robi karshti Allahut.”⁹

⁷. Ebu Daud, *Sunen*, 2/347 (3667).

⁸. Ebu Nu’ajm, *Hijje*, 1/259.

⁹. El-Hakim, *Mustedrek*, 1/671 (1820).

Frytet e kuvendeve të bashkëbisedimit

Ja se si i tregon Abdullah bin Amri (radijallahu anhu): “E pyeta njëherë të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Resulullah, çfarë të mire kanë kuvendet ku ne mbliidhemi për të bashkëbiseduar rreth Allahut?” I Dërguari Fisnik mu përgjigj duke më thënë:

- “*Xheneti është fryti dhe pasuria e fituar në kuvendet e bashkëbisedimit.*”¹⁰

Shlyerja e gabimeve gjatë pranisë në kuvendet e bashkëbisedimit

Tregon Ebu Berze el-Eslemi: “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), aty drejt fundit të jetës, mbante biseda mësimesh para grupesh të ndryshme me besimtarë dhe në fund thoshte:

- “*Subhanekellahum’me ue bihamdike Esh’bedu en la ilahe illa ente. Estagfiruke ue etubu ilejk - O Zot, i pa të meta je Ti, të falënderoj e lavdëroj Ty me cilësitë më të bukura. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Teje. Kërkoj prej Teje falje dhe pendohem tek Ti.*”

Dikush tha:

- “O Resulullah! Ti sapo the diçka që unë nuk të kam dëgjuar asnjëherë ta thuash më parë!” I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) iu përgjigj atij:

- “*Kjo është për të shlyer gabimet dhe mëkatet e bëra gjatë bisedës në këtë kuvend bashkëbisedimi.*” Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet se i Dërguari i Allahut ka thënë:

- “*Po, është e vërtetë, këtu erdhi Xhibrili dhe më tha: ‘Muhamed, këto fjalë i shlyejnë të gjitha gabimet e bëra gjatë kuvendimit me njerëzit për Allahun.*”¹¹

4. LEXIMI RREGULLISHT I KUR’ANIT FAMËLARTË

Për këtë na tregon Eus bin Hudhejfe eth-Thekafi (radijallahu anhu): “Ne patëm ardhur tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) si përfaqësues të popullit të Thekifit. Ne të Benu Sa’dit patëm bujtur

¹⁰. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2/177 (6651).

¹¹. Ebu Daud, *Sunen*, 2/681 (4859).

në shtëpinë e Mugire bin Shu'bes; ata të fisit të bijve të Malikut u pritën në çadrën e ngritur në xhaminë e të Dërguarit të Allahut. Gjatë atyre ditëve, Resulullahu vinte tek ne dhe pas namazit të jacisë na fliste për Allahun. Nganjëherë detyrohej të ndryshonte vendin e këmbëve, pasi ato i ënjteshin ngaqë rrinte shumë në këmbë. Një nga temat, për të cilat na fliste më së shumti ishin ankesat e tij për kurejshët:

- *“Kur ne ishim shumë të dobët në Mekë, ishim kreyt të pafuqishëm dhe ishim si një bashkësi e shtypur nga të gjithë. Por, pasi erdhëm në Medinë, ne ua morëm atyre hakun. Herë i mundëm ne, herë na mundën ata.”*

Një natë ai erdhi tek ne në një orë më të vonë seç vinte zakonisht, ndaj e pyetëm:

- “O Resulullah! Pse erdhët më vonë seç keni ardhur natë për natë?” I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na u përgjigj:

- *“Mu kujtua përnjëherësh se duhej të lexoja një pjesë nga Kur'ani për të përmendur Allahun. Nuk desha të dilja pa lexuar njëherë atë pjesë.”* Në agim ne shkuam e pyetëm sahabët më të afërt me të Dërguarin e Allahut, se si i kishin formuar përmendjet e Allahut nga Kur'ani dhe ata na thanë:

- “Ne e ndajmë Kur'anin në tri, pesë, shtatë, nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë dhe trembëdhjetë pjesë. Veç kësaj, pjesa pas sures “Huxhurat” është e gjitha një pjesë ku përmendet Allahu.”¹²

Ebu Selemeja tregon se: “Omeri (radijallahu anhu) i thoshte Ebu Musa el-Eshariut:

- “Na e kujto pak Zotin!” Dhe ai u lexonte atyre Kur'an. Ebu Musai e lexonte shumë bukur Kur'anin, meqenëse kishte një zë shumë të bukur.”¹³

Tregon edhe Hasan Basriu: “Osmani (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Nëse ne do t'i kishim zemrat të pastra, ne nuk do të ngopeshim dot së dëgjuari fjalën e Zotit. Unë nuk dua që të më shkojë asnjë ditë pa lexuar Kur'an.” Vërtet, kur gjetën lidhjen e Kur'anit të Osmanit (radijallahu anhu), pasi ai ishte ndarë nga jeta, panë se ai ishte shumë i konsumuar nga përdorimi, aq sa faqet i kishte kreytësisht të vjetruara.”¹⁴

¹². El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 2/467 (4217).

¹³. Ebu Nu'ajm, *Hiye*, 1/258; Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/109.

¹⁴. Bejheki, *Shuabu'l-Iman*, 2/409 (2223).

Ukbe bin Amiri (radijallahu anhu) tregon: “Njëherë, kur u takova me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), ai më pati thënë:

- “*Ti ruaji lidhjet, përpiku të lidhesh me atë që i pret marrëdhëniet me ty, jepi edhe atij që nuk të jep, e tregohu falës edhe ndaj atij që të bën të padrejtë.*” Pastaj, kur u takuam njëherë tjetër, ai kësaj here më tha:

- “*Shiko, Ukbe bin Amir, a do që unë të të mësoj ato sure që Allahu deri më sot nuk i ka zbritur as në Teurat, as në Ungjill, as në Zebur? Do të t’i tregoj, por t’i lexosh medoemos çdo natë. Ja, ato sure janë: ‘Ihlas’, ‘Felek’ dhe ‘Nas’.*”

Që nga ajo ditë, kur i Dërguari i Allahut më urdhëroi që t’i lexoja medoemos çdo natë ato sure, unë nuk i kam lënë kurrë pa i lexuar. Zaten as nuk i ka hije një njeriu si unë, që të mos i lexojë.”¹⁵

Aishja (radijallahu anha) thotë se: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk binte të flinte pa lexuar njëherë suret “Zumer” dhe “Isra”. ”¹⁶

Kurse Aliu (radijallahu anhu) tregon: “Kam qenë aty, kur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na foli nga minberi dhe na tha:

- “*Kushdo që lexon ‘Ajetin Kursij’ pas faljes së çdo namazi, për të nuk mund të ketë asnjë pengesë, që të hyjë në Xhenet. Dhe ai që e lexon ‘Ajetin Kursij’ kur shtrihet për të fjetur, Allahu krijon siguri dhe besim mes familjes, fqinjëve dhe njerëzve të tjerë përreth tij.*”¹⁷

Abdullah bin Busri (radijallahu anhu) tregon: “U nisa nga Humusi dhe natën qeshë i detyruar ta kaloja në Bakia. Një të rrethuar më bënë xhindet dhe unë lexova menjëherë këtë ajet të sures “A’raf”: “**Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (që mbisundon gjithësinë). Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrat të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!**” (A’raf, 7/54)

Një ta mbaruar së kënduari ajetin, xhindet thanë:

- “Ruajeni atë derisa të agojë dita e re!” Unë, një të zbardhur, i hipa

¹⁵. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/148 (17372).

¹⁶. Tirmidhi, *Sunen*, 4/475 (3405).

¹⁷. Bejheki, *Shuabu’l-Iman*, 2/458 (2395).

devesë dhe u nisa të vazhdoja rrugëtimin.”¹⁸

Abdullah bin Ubejd bin Umejri tregon: “Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu), sapo hynte në shtëpi lëvizte nëpër të dhe këndonte ‘Ajetin Kursij’ në çdo cep të saj.”¹⁹

5. VIRTYTI I PËRMENDJES VAZHDIMISHT TË FJALËS SË BUKUR “LA ILAHE IL’LALLAH”

E tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Unë i thashë Profetit tonë (paqja e Zotit qoftë mbi të), kush janë ata fatlumë që do të përfitojnë më së shumti prej ndërmjetësimit tënd në Ditën e Gjykimit?” Ai më tha mua:

- “Ebu Hurejre, ma merr mendja se këtë pyetje nuk ma ka bërë askush asnjëherë më parë, sepse unë e di shumë mirë dëshirën e zjarrit dhe varësinë tënde ndaj çdo fjale që them unë. Po, vërtet, ata që do të gëzojnë më shumë prej ndërmjetësimit tim do të jenë ata që thonë ‘La ilahe il’lallah’ me sinqeritet e ngaqë ashtu ua kërkon zemra e shpirti.”²⁰

Ebu Dherri (radijallahu anhu) tregon: “Unë i thashë Resulullahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O i Dërguari i Allahut, më jep ndonjë këshillë të mirë!” Ai më tha:

- “Sa herë që të bësh ndonjë të keqe bëj menjëherë një të mirë, sepse ajo do ta shlyjë gabimin a mëkatin që ke kryer.”

- “O Resulullah, po po të them ‘La ilahe il’lallah’, a quhet kjo një e mirë?”, – e pyeta unë.

- “Patjetër që po, të thuash atë fjalë është më e mira e të mirave.” – më tha i Dërguari i Allahut.”²¹

6. DISA PËRMENDJE TË ALLAHUT DHE VIRTYTET E TYRE

Përmendja e Allahut është një “e mirë e përjetshme”

E tregon Said Hudri: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue

¹⁸. Hejthemi, *Mexbmen’z-Zenaid*, 7/94 (11015).

¹⁹. Hejthemi, *Mexbmen’z-Zenaid*, 10/179 (17076).

²⁰. Buhari, *Sabih*, 1/49 (99).

²¹. Hejthemi, *Mexbmen’z-Zenaid*, 10/86 (16797).

sel'lem) tha:

- “Bëni sa më shumë punë që janë të mira të përjetshme (ato punë që do të jenë përjetësisht të dobishme për njeriun).”

- “E ç’janë të mirat e përjetshme, o Resulullah?” – e pyetën. Ai u përgjigj duke thënë:

- “E mirë e përjetshme është të thuash fjalët ‘Allahu Ekber’, ‘Subhanallah’, ‘Elhamdulil’lah’ dhe ‘La haule ue la kuunete il’la bil’lah’.”²²

Kopshtet e Xhenetit

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na tha:

- “Kur të hyjni në kopshtet e Xhenetit, përpikuni që të përfitoni sa më shumë prej tyre.”

- “O Resulullah, ç’janë këto kopshte të Xhenetit?” – e pyeta unë.

- “Xhamitë janë kopshte të Xhenetit.” – mu përgjigj i Dërguari i Allahut.

- “Po si mund të përfitojmë ne nga xhamitë?”

- “Përmes përmendjes së Allahut duke thënë sa më shpesh ‘Subhanallahi ue Elhamdulil’lahi ue La ilabe il’lallahu ue Allahu Ekber’.”²³

Fjala që i pëlqen më së shumti Allahut

E tregon Ebu Dherri (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “A doni që t’ju lajmëroj se cila është fjala që Allahu e do më së shumti?”

- “Po, patjetër.” – thashë unë. Profeti ynë tha:

- “Fjala që i pëlqen më së shumti Allahut është fjala ‘Subhanallahi ue bi hamdih’.”²⁴

Një fjalë sa tërë thesaret e Xhenetit

E tregon po Ebu Dherri (radijallahu anhu): “Unë po ecja pas të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ai më tha mua:

²². Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 2/75 (11731).

²³. Tirmidhi, *Sunen*, 5/532 (3509).

²⁴. Muslim, *Sabih*, 4/2093 (2731).

- “O Ebu Dherr, a do të të tregoj një nga thesaret e parajsës?”
- “Tregoma, o Resulallah.”, – thashë unë.
- “*La haule ue la kuuete il’la bil’lah.*”, – tha ai.”²⁵

Fidanët e Xhenetit

Ebu Ejub el-Ensari (radijallahu anhu) na tregon: “Në natën e Miraxhit, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pati shkuar pranë Ibrahimit (alejhis’selam). Ibrahim (alejhis’selam) pyeti Xhibrilin (alejhis’selam), se kush ishte ai që kishte prurë me vete. Engjëlli i Zotit iu përgjigj:

- “Ky është Muhamedi (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).” Atëherë, Ibrahim (alejhis’selam) tha këto fjalë:

- “O Muhamed! Thuaji umetit tënd, të mbjellin sa më shumë fidanë në Xhenet, sepse toka e parajsës është tejet pjellore dhe pa anë e pa fund.” Dhe, kur i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) e pyeti se çfarë ishin fidanët e Xhenetit, Ibrahim (alejhis’selam) iu përgjigj duke i thënë:

- “Përmendja e Zotit duke thënë: ‘*La haule ue la kuuete il’la bil’lah.*’”²⁶

Interpretimi që i bën Abdullah bin Mesudi (r.a.) ajetit:

“... fjalët e bukura ngjiten tek Ai.”

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë: “Unë, kur ju them ndonjë gjë, do t’ju sjell gjithmonë edhe një argument nga libri i Allahut, që i mbështet fjalët e mia. Kur një rob i Allahut thotë “Subhanallahi ue’l-hamdulil’lahi ue la ilahe il’lallahu uallahu ekberu ue tebarekallah”, një engjëll i fut këto fjalë nën flatra dhe fillon të ngjitet lartësive të qiejve. Çdo bashkësi engjëjsh, që has gjatë fluturimit, i kërkon Allahut falje për atë që robi ka thënë. Derisa, më në fund, engjëlli arrin dhe i çon ato fjalë pranë Mëshirëplotit, që është i kulluar e i pastër nga çdo lloj cilësie që bart mangësi.” Dhe, për ta argumentuar vërtetësinë e këtij interpretimi, na lexoi ajetin Kur’anor: **“Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut. Tek Ai ngjiten**

²⁵. Muslim, *Sahib*, 4/2076 (2704).

²⁶. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/418 (23598).

fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë. Sa u përket atyre që kurdisin të këqija, ata do të kenë dënim të rëndë dhe dredhitë e tyre do të dështojnë.” (Fatir, 35/10)²⁷

7. LUTJA DHE PËRMENDJA E ALLAHUT SHKURT E ME FJALË TË THUKËTA

Tregon Xhuejrija (radijallahu anha): “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u largua nga unë dhe u kthye sërish aty para dreke. Në atë kohë unë isha ulur e po rrija. Ai më tha mua:

- “*Ulur ke ndenjur qëkurse u largova unë?*”

- “Po.”, – i thashë unë. Atëherë, ai më tha mua:

- “*Qëkur u largova prej teje, unë kam thënë katër lutje nga tri herë secila. Nëse do të krabasobeshin ato me të gjitha sa e ke përmendur ti Allahun gjer më sot, ato peshojnë prapëseprapë më shumë. Ato fjalë janë: ‘Subhanallahi ue bi hamdih, adede halkihi ue rida nefsih ue zinet arshih ue midade kelimatih’.* (I pa të meta është Allahu, ndaj edhe e madhëroj Atë. Lëvduar qoftë Ai aq herë sa numri i krijesave të Tij, lavdërim që kënaq Atë, sa tërë boja e gjithë fjalëve dhe sa pesha e Fronit të Tij Hyjnor.)”²⁸

Dhikri të cilin engjëjt e kishin të pamundur ta regjistronin

Tregon Enesi (radijallahu anhu): “Një ditë, ne ishim ulur rreth Profetit tonë, kur aty ia behu një burrë. Ai na përshëndeti, Profetin (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe gjithë sa ishim aty, duke na thënë “Es’selamu alejkum ue rahmetullah”. Edhe ne i kthym përshëndetjen, kurse i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) ia ktheu përshëndetjen duke i thënë:

- “*Ue alejkumus’selam ue rahmetullahi ue berekatuh*”. Ai burrë u ul dhe tha:

- “*Elhamdulill’lah! Hamden kethiren tajjiben mubareken fih kema jubib’bu Rab’buna en jubmede ue jenbegij lehu*”. (Allahut i takojnë gjithë lëvdimet e madhërimet më të bekuara, më të shumta e më të bukura, ashtu siç ka dëshirë Ai të falënderohet dhe siç i kanë hije Lartësisë së Tij).

²⁷. Hejthemî, *Mexhmen’-Zenuid*, 10/105 (13858).

²⁸. Muslim, *Sabih*, 4/2090 (2726).

Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) e pyeti:

- “*Si e the?*”, – dhe ai burrë i përsëriti edhe njëherë ato që sapo tha. Atëherë, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) foli dhe na tregoi:

- “*Unë i betohem Allahut, se për t’i shkruar këto fjalë, rendën plot dhjetë engjëj, por duke qenë se nuk dinin si ta shkruanin, i morën ato dhe i çuan drejt e tek Allahu, Zotëruesi i Vetëm i Shenjtërisë dhe Madhërimit. Dhe Allahu i Madhërisëm tha: ‘Shkruajini ato njësoj siç i tha rob i im!’*”²⁹

8. LUTJET QË DUHEN THËNË PARA SE TË FLESH

Përmendja e Allahut që u mëson Profeti ynë sahabëve më të varfër

E tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “Muhaxhirët që ishin më dobët ekonomikisht, erdhën tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i thanë:

- “Të pasurit i morën të gjitha shpërblimet e Allahut dhe janë duke fituar gradët më të larta në Xhenet.” I Dërguari i Allahut i pyeti ata:

- “*Çfarë do të thotë kjo?*” Muhaxhirët thanë:

- “Edhe ata falin namaz dhe agjërojnë njësoj si ne. Por, kur vjen puna te lëmosha dhe zekati, ne nuk kemi të japim siç japin ata. Ata lirojnë skllëvër, e ne nuk kemi mundësi që ta bëjmë diçka të këtillë!” I Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) u tha atyre:

- “*A doni që unë t’ju mësoj juve diçka që ka për t’ju afruar menjëherë me ata të pasur për sa u përket shpërblimeve të Allahut? Nëse e bëni, atëherë ju do të kaloni këdo që nuk e bën atë. Vetëm se ata që mund ta bëjnë, atëherë po, ata mund të habën e të krahasohen me ju!*”

- “Na e mëso, o Resulullah!”, – thanë ata menjëherë dhe Krenaria e Njerëzimit u mësoi atyre:

- “*Pas çdo namazi thoni 33 herë ‘Subhanallah’, 33 herë ‘Elhamdulil’lah’ dhe 33 herë ‘Allahu Ekber’.*”

Paskëtaj, muhaxhirët erdhën edhe njëherë tjetër tek i Dërguari Fisnik dhe i thanë:

- “O i Dërguari i Allahut, atë që na mësove ti e mësuam edhe

²⁹. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 10/117 (16894).

vëllezërit tanë të pasur, edhe ata po e thonë njësoj si ne, në fund të çdo namazi.” Sakaq, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Pasuria është një mirësi e Allahut, Ai ia jep atë atij që Ai do.*”³⁰

**Përmendja që Profeti ynë u mëson Aliut dhe Fatimes,
për ta thënë çdo natë para se të binin të flinin**

E tregon Aliu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur po e martonte vajzën e tij, Fatimen, me Aliun, ai i pati përgatitur asaj si pajë, një copë stof të kadifenjtë, një mulli dore, një enë uji, një jastëk të mbushur me kashtë hurme dhe një enë me çomlek. Një ditë unë i thashë Fatimes:

- “Nxora ca ujë nga pusi e po më dhemb kraharori. Allahu i ka falur shumë sklevër babait tënd. Sikur të shkosh e t’i thuash njëherë, se mos na jep edhe neve ndonjë shërbyes.” Fatimja iu përgjigj:

- “Ke të drejtë, edhe unë, bluaj e bluaj me mullirin e dorës, më kanë zënë duart kallo.” – ndaj shkoi drejt e tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ai e pyeti se çfarë e kishte çuar tek i ati. Fatimes i erdhi rëndë, ndaj e nisi fjalën duke i thënë:

- “Erdha të të shoh e të të pyes, a je mirë, o baba.” – dhe u kthye pas pa i thënë asgjë. E pyeta Fatimen, kur erdhi:

- “Çfarë bëre?”

- “Më erdhi zor t’i kërkoja të më jepte një shërbyese.” – u përgjigj Fatimja. Sakaq, vendosëm të shkonim të dy bashkë te Krenaria e Gjithësisë dhe shkuam. I pari fola unë, duke i thënë të Dërguarit të Allahut:

- “O Resulullah! Ka filluar të më dhembë kraharori nga uji që tërheq nga pusi.” Aty ndërhyri edhe Fatimja:

- “Edhe mua më kanë zënë kallo duart duke bluar me mullirin e dorës. Sikur të më jepje ndonjë prej robërve të luftës si shërbyes, që ta kemi të na ndihmojë në shtëpinë tonë.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) na kishte dëgjuar dhe na tha:

- “*Si thoni ju, të lë të uritur sahabët e Suffes dhe t’ju jap juve një shërbyes?*

³⁰. Muslim, *Sabih*, 1/416 (595).

Nuk e bëj dot. Unë as mundësi për t'u plotësuar atyre nevojat nuk kam. Kështu që robërit më duhet t'i shes, që të mund t'u përmbush nevojat sahabëve të Suffes." Kësisoj, ne u kthyem duarbosh në shtëpi. Më vonë, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) erdhi në shtëpi. Në atë kohë ne ishim shtrirë dhe ishim mbuluar me copën e stofit të kadifenjtë, që babai na e kishte dhuruar si pajë për Fatimen. Kishim mbuluar kokën dhe kur mbulonim kokën, ne na zbuloheshin këmbët dhe kur mbulonim këmbët, na zbuloheshin koka. U çuam në këmbë, me të parë të Dërguarin Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ai na e preu duke na thënë:

- *"Mos u ngrini, unë kam ardhur t'ju jap diçka më të mirë e më të mbarë sesa ajo që më kërkuat ju, e doni?"*

- "Na e thuaj, o Resulullah, ç'është ajo?", – i thamë ne. Atëherë, Profeti ynë na tha:

- *"Këto që do t'ju them mua m'i ka mësuar Xhibrili: Pas çdo namazi të thoni dhjetë herë 'Subhanallah', dhjetë herë 'Elhamdulillah', dhjetë herë 'Allahu Ekber'. Edhe kur të hyni në shtrat, të thoni tridhjetë e tri herë 'Subhanallah', tridhjetë e tri herë 'Elhamdulillah' dhe tridhjetë e katër herë 'Allahu Ekber'."* Që nga ajo ditë, unë nuk i kam lënë kurrë pa i thënë ato që na mësoi të thoshim i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

Ibnu'l-Keuaja e pyeti Aliun (radijallahu anhu):

- "As gjatë Siffinit nuk i ke braktisur, o Ali?"

- "Jo, as atëherë nuk i kam lënë pa i thënë.", – u përgjigj Aliu (radijallahu anhu)."³¹

Përmendje për t'u lexuar në mëngjes dhe në mbrëmje

E tregon Ebu'd-Derdaja (radijallahu anhu): "Kushdo që arrin agimin dhe mbrëmjen, dhe thotë shtatë herë, duke e ndierë, apo pa e ndierë që duhet ta thotë: *"Hasbijallahu la ilahe illa hu. Alejbi tenek'kelu ne bue Rab'bu'l-Arshi'l-Adhim"* (Mua më mjafton Allahu, nuk ka zot tjetër përveç Tij. Unë i jam dorëzuar Atij plotësisht, Ai është Zotëruesi i Fronit të Madh) Allahu ia heq atij të gjitha vështirësitë."³²

³¹. Buhari, *Sabih*, 5/2051 (5047).

³². Ebu Daud, *Sunen*, 2/742 (5081).

9. TË PËRMENDËSH ALLAHUN NË KOHËT KUR TË GJITHË BIEN NË PËRHUMBJE

Tregon Ebu Idris el-Haulani: “Unë e kam dëgjuar nga Muadhi se ka thënë:

- “Kur të ulesh me ndonjë grup njerëzish, ata do të zhyten në bisedë. Kur të bëhesh dëshmitar, që ata e harruan Allahut, ti drejtoju Atij duke e përmendur.”

Uelidi thotë: “Sa herë që ia përmendte ndokush Abdurrahman bin Jezid bin Xhabirit (radijallahu anhu) këto fjalë të Muadhit, ai thoshte:

- “Vërtet, të njëjtën gjë më kanë treguar edhe Ebu Talhaja me Hakim bin Dinarin. Kur të shohësh që ndonjëri prej tyre zhytet në përhumbe, ti drejtoju Zotit duke e përmendur, sepse kjo është një shenjë që të pranohet lutja.”³³

10. PËRMENDJA E ALLAHUT GJATË UDHËTIMIT

Ebu'l-Melih bin Usameja (radijallahu anhu) përcjell nga babai i tij: “Ne ishim në një udhëtim bashkë me të Dërguarin Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe unë po ecja pas vetë të Dërguarit të Allahut. Papritur, deveja u pengua.

- “U qorrofsh shejtan!”, – më doli mua nga goja. I Dërguari i Allahut tha:

- “*Mos i thuaj asaj u qorrofsh shejtan, sepse atëherë djallit i rritet mendja, fryhet, bëhet sa një shtëpi e madhe dhe thotë: ‘Kjo është fryt i forcës simel!’ Por, nëse ti thua ‘Bismill’ah’, ai fillon ta ndiejë veten më të vogël edhe se një mizë e vetja i duket i poshtër.*”³⁴

Aufi (radijallahu anhu) tregon se: “Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu), kur dilte nga shtëpia, thoshte:

- “Bismil’lahi teuek’keltu alallah. La haule ue la kuuete il’la bil’lah” (Me emrin e Allahut, u mbështeta tek Allahu. Vetëm e Allahut është e gjithë forca dhe fuqia).”³⁵

³³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/236.

³⁴. El-Hakim, *Mustedrek*, 4/325 (7793).

³⁵. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 9/180 (8889).

11. SALAVATET PËR TË DËRGUARIN FISNIK

Tregon Ubej bin Ka'bi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), pasi kalonte dy e treta e natës, ngrihej dhe thoshte:

- “*O njerëz, përmendeni Allahun, përmendeni Allahun; in fry surit të parë, e fill pas tij do t'i frybet edhe surit të dytë. Do të vijë edhe çasti i vdekjes bashkë me çastin kur do të bëhet gjyrimi e juve do t'ju dorëzohet libri.*”

Unë i thashë:

- “O Resulullah! Unë them shumë salavate e përshëndetje për ty; sa më shumë të them, aq më mirë është, apo jo?”

- “*Thuaj sa të duash.*”, – mu përgjigj ai.

- “Po nëse unë një të katërtën e lutjeve të mia ta veçoj vetëm për të të dërguar ty salavate, o i Dërguari i Allahut?”, – vazhdova unë ta pyesja.

- “*Ti e di, por nëse bën më shumë, akoma edhe më mirë ka për të qenë për ty.*”, – më tha ai.

- “Unë dua që të gjithë kohën e lutjeve ta ndaj vetëm për të të dërguar ty salavate dhe përshëndetje.”, – thashë unë. Atëherë i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) më tha mua:

- “*Atëherë të gjitha vështirësitë e tua do të marrin fund dhe do të të falet çdo mëkat.*”³⁶

Njeriu më dorështrënguar

Tregon Ebu Dherri (radijallahu anhu): “Një ditë, dola nga shtëpia dhe shkova pranë grupit të besimtarëve që ishin me të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ai na pyeti neve:

- “*A doni që t'ju tregoj se kush është njeriu më dorështrënguar?*”

- “Na e thoni, o i Dërguari i Allahut!”, – thanë besimtarët njëzëri.

- “*Njeriu më koprrac është ai njeri që përmendet emri im dhe ai nuk më dërgon mua salavat.*”, – tha i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).³⁷

³⁶. Tirmidhi, *Sunen*, 4/636 (2457).

³⁷. Mundhiri, *et-Tergib*, 2/332 (2601).

Ka'b bin Uxhreja (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Ejani, afrohuni pranë minberit.*” Dhe ne u afruam. U ngjit një shkallë dhe tha “*Amin*”. Edhe kur ngjiti shkallën e dytë, tha “*Amin*”. Të njëjtën bëri edhe kur u ngjit në shkallën e tretë, tha “*Amin*”. Kur zbriti nga minberi, ne i thamë:

- “O Resulullah! Sot ne dëguam nga goja jote diçka që nuk e kemi dëgjuar kurrë më parë!” Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) u përgjigj:

- “*Erdhi Xhibrili i Besueshëm dhe më tha: ‘Larg Xhenetit kushdo që e arrin muajin e Ramazanit dhe kalon pa iu falur mëkatet!’ - dhe unë i thashë ‘Amin’, kur u ngjita në shkallën e dytë Xhibrili më tha: ‘Larg prej Xhenetit kushdo, që përmendet emri yt dhe ai nuk të dërgon ty salavate!’ Dhe unë thashë prapë ‘Amin’. Në shkallën e tretë Xhibrili më tha: ‘Larg Xhenetit kushdo që nëna dhe babai të dy, ose njëri syresh, plaken dhe nuk arrin të fitojë kënaqësinë e tij/ tyre!’ Andaj unë përsëri thashë ‘Amin’.*”³⁸

Nga se varet pranimi i lutjeve?

Omeri (radijallahu anhu) thotë: “Asnjë lutje që bëhet pa iu dërguar njëherë salavate të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk arrin tek Allahu i Madhërishëm; ajo lutje arrin tek Allahu vetëm pasi t’i jetë dërguar salavat të Dërguarit të Tij.”³⁹

12. NJË TJETËR DIMENSION I PËRMENDJES SË ALLAHUT: KËRKIMI I FALJES ME PENDESË

Ibni Omeri (radijallahu anhu) thotë: “Ne rrinim me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e dëgjonim të thoshte njëqind herë: “O Zot, falmë mua, pranoma pendesën; nuk ka dyshim, që Ti e pranon pendimin dhe përveç mëshirës Sate, nuk ka tjetër mëshirë që mund të na mëshirojë.”⁴⁰

³⁸. El-Hakim, *Mustedrek*, 4/170 (7256).

³⁹. Tirmidhi, *Sunen*, 2/356 (486).

⁴⁰. Ebu Daud, *Sunen*, 1/475 (1516).

I Dërguari i Allahut na mësonte se si të pendoheshim e t'i kërkonim Allahut falje

Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu): “Tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi një burrë dhe iu ankua se kishte bërë shumë mëkate, duke i thënë dy a tri herë:

- “Mjerë unë për mëkatet e mia!..” I Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha atij:

- “*Thuaj: O Zot, mëshira dhe falja Jote është shumë më e madhe sesa gabimet e mëkatet e mia dhe kur mendoj për mëshirën Tënde kur më kujtohen mëkatet e mia, kuptoj se ajo është shumë herë më e madhe dhe kjo më fal shpresë.*”

Ai burrë e përsëriti atë fjalë për fjalë. Profeti ynë i tha atij që atë fjali ta përsëriste edhe njëherë dhe ai e përsëriti. Profeti ynë i kërkoj atij që ta përsëriste sërish dhe ai burrë e përsëriti. Pastaj Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha atij:

- “*Çobu, se Allahu t'i fali të gjitha mëkatet.*”⁴¹

Gjendja e atij që kreu një mëkat dhe thoshte:

“Allahu nuk më fal mua!”

Tregon Bera bin Azibi (radijallahu anhu): “Një burrë më tha:

- “Ebu Umare, çfarë ka parasysh ajeti: “**Shpenzojeni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.**” (Bekare, 2/195) – a ka parasysh edhe atë që përleshet me armikun derisa vritet?” Unë i thashë:

- “Jo, në të flitet për atë që kryen një mëkat dhe thotë: ‘Allahu nuk ma fal mua atë mëkat!’”⁴²

13. PËRMBAJTJA E DHIKRIT DHE KORNIZA E TIJ

Ebu'd-Derdaja (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) thotë:

- “*Në ditën e Kiametit Allahu i Madhërishtëm disa bashkësi do t'i ringjallë të*

⁴¹. El-Hakim, *Mustedrek*, 1/728 (1994).

⁴². Mundhiri, *et-Tergib*, 2/311 (2513).

ngjitur mbi minbere të stolisura me gurë perle dhe me fytyrën plot shkëlqim drite. Të gjithë do t'i shobin ata me admirim. Dhe ata nuk kanë qenë as profetë, as dëshmorë.”

Kur e dëgjoi një beduin këtë hadith, u ngrit në gjunjë dhe tha:

- “O Resulullah! Na i trego se kush janë dhe cilat cilësi bartin, që t’i njohim më mirë edhe ne.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Ata janë njerëzit që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut. Megjithëse vijnë nga fise e shtete të ndryshme, ata i bashkon përmendja e Allahut, sepse ata përmendin Allahun.*”⁴³

Shenjat treguese të dhikrit dhe e vërteta e tij

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Dikush e pyeti të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Resulullah! Kush janë miqtë (evliatë) e Allahut?” I Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) iu përgjigj:

- “*Janë ata, që kur i sheh, të kujtojnë menjëherë Allahun.*”⁴⁴

Përmendja e Allahut në fshehtësi është më e virtytshme

Këtë e tregon Aishja (radijallahu anha): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e lartësonte namazin e falur pas përdorimit të misvakut shtatëdhjetë herë më shumë sesa namazin e falur pa e përdorur atë. Edhe për dhikrin ai thoshte:

- “*Përmendja e Allahut në fshehtësi është shtatëdhjetë herë më e virtytshme.*” I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha përsëri:

- “*Në ditën e Kiametit, kur Allahu t’i mbledhë të gjitha krijesat, që ato të japin llogari për ato që kanë bërë në këtë botë, engjëjt do të sjellin punët që kanë regjistruar e shkruar. Allahu i Lartësuar do t’u thotë atyre engjëjve: ‘Shikoni njëherë, a i ka ngelur ndonjë punë e paregjistruar?’ – Engjëjt i thonë: Jo, o Zot, këtu janë të gjitha ato që ne dimë e që kemi shkruar; nuk kemi lënë asgjë pa shkruar.’ Allahu i Madhërisëm, atëherë, i thotë atij robi: ‘Ti ke disa punë, të*

⁴³. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenaid*, 10/77 (16770).

⁴⁴. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenaid*, 8/175 (13138).

cilat nuk i di as ti vetë, dhe Unë do të ta jap ty edhe shpërblimin e tyre. Janë punët e tua që i ke bërë në fshehtësi, kur ti më ke përmendur mua në fshehtësi.”⁴⁵

14. KUR KA FILLUAR BËRJA E TESBIHUT?

Na e tregon Nëna jonë, Safija (radijallahu anha): “Një ditë, Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pati ardhur në dhomën time. Në atë çast përpara meje ishin katërmijë bërthama hurme, të cilat unë po i përdorja për të bërë *tesbih* Allahut. Ai më pati thënë mua:

- “A do që të të mësoj unë një mënyrë të të bërit *tesbih*, që është më e virtytshme se kjo që po përdor ti?”

- “Mësoma!”, – iu përgjigja unë.

- “Thuaj: Unë të bëj Ty *tesbih* sa tërë numri i krijesave të Tua, o Allah!”, – më qe përgjigjur ai.”⁴⁶

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: “Unë kisha një litar me dymijë nyje. Nuk më zinte gjumi pa e kaluar njëherë të gjithin, nga fillimi në fund, duke i bërë *tesbih* Allahut.”⁴⁷

⁴⁵. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 10/86 (16796).

⁴⁶. Mundhiri, *et-Tergih*, 2/286 (2425).

⁴⁷. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/383.

SAHABËT DHE LUTJA



Si e rregullonin zërin Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe sahabët e tij gjatë lutjes? Çfarë kërkonin ata kur luteshin dhe çfarë kohe zgjidhnin ata kryesisht për t’iu lutur Allahut të Madhërishëm?

1. ÇFARË DUHET KËRKUAR GJATË NJË LUTJEJE DHE ÇFARË JO? “ETIKA E DUASË”

Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) tregon: “Një person lutej kështu: “O Zot, unë dua prej Teje që të më japësh durim.” I Dërguari i Allahut i shkoi pranë dhe i tha:

- “*Sapo i kërkove Allahut të të sjellë vështirësi dhe fatkeqësi. Ti kërkoji Atij shëndet e që të jesh mirë!*”

Por edhe një ditë tjetër, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) gjeti një njeri, i cili po lutej e gjatë lutjes thoshte: - “O Zot! Të lutem, më jep mua gjithë të mirat!”, – ndaj ai i tha:

- “*O i biri i Ademit! A e di ti se ç’janë të gjitha të mirat?*” Ai burrë i tha:

- “O Resulullah! Qëllimi im me mirësitë ishte të kërkoja prej Tij

mbarësi materiale dhe shpirtërore.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit goftë mbi të) tha:

- “*Edhe hyrja në Xhenet, apo shpëtimi nga dënimi i Xhehenemit janë secila një mirësi shumë e madhe.*”

Krenaria e Gjithësisë, Profeti ynë gjeti dikë që po i përgjérohej Allahut duke i thënë: “O Zot i Madhërishëm, o Zoti im që shumë të madhe e ke bujarinë!”, – dhe i tha atij:

- “*Vazhdo të kërkosh, sepse Allahu do të ta pranojë lutjen.*”¹

Beshir bin Hasasija tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Unë lëndoj Allahun që të mori ty nga Rabiati’l-Kash’am dhe të solli para të Dërguarit të Allahut dhe të nderoi duke të bërë mysliman.*” Dhe unë i thashë:

- “O Resulallah, lutju Allahut e të ma marrë mua shpirtin përpara sesa të ta marrë ty!”, – por i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit goftë mbi të) ia ktheu:

- “*Unë nuk e bëj për askënd atë lutje.*”²

Ngritja dhe hapja e duarve gjatë lutjes dhe fërkimi i fytyrës në përfundim të saj

Omeri (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur lutej i ngrinte duart lart; kur e përfundonte lutjen, me duart fërkonte fytyrën.”³

Aishja (radijallahu anha) thotë: “I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit goftë mbi të), kur lutej, i ngrinte duart lart. Madje, ne na kaplonte një ndjesi e lehtë bezdie kur ai i mbante duart lart dhe nuk i ulte për një kohë të gjatë.”⁴

¹ Ibn Ebi Shejbe, *Musan’nef*, 6/46 (29356).

² El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/282 (36868).

³ El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/724 (4892).

⁴ Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/225 (25925).

2. LUTJA ME ZË TË LARTË NË MES TË BASHKËSISË DHE KUR BASHKËSIA I THOTË “AMIN” LUTJES SATE

Xhami bin Shedadi na përcjell nga një i afërm i tij, që i ka thënë: “Unë dëgjova Omerin (radijallahu anhu), i cili tha:

- “Unë do t’ju them juve tri fjali; sapo të mbaroj secilën syresh, ju thoni “Amin”; O Zot unë jam i dobët, jepmë mua forcë dhe fuqi. O Zot, unë jam i ashpër dhe i egër, zbutmë mua. O Zot unë jam një njeri koprrac, bëmë mua bujar.”⁵

Numan bin Mukarrini (radijallahu anhu) tregon: “Unë do të lutem tani dhe ju do t’i thoni medoemos të gjithë “Amin” kësaj lutjes sime: ‘O Zot, bëje sot Numanin dëshmor, që myslimanët të dalin fitimtarë dhe falu atyre ngadhënjimin!’”⁶

3. T’U KËRKOSH BESIMTARËVE TË MIRË QË TË LUTEN PËR TY

Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Unë i pata kërkuar leje të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që të më lejonte të shkoja në umre. Më dha leje dhe më tha:

- “*Vëllai im i dashur, mos na harro edhe ne, që të na përfsbish në lutjet e tua.*” Kjo ishte diçka aq e vyer, aq e çmuar, për mua, saqë sikur gjithë botën të ma jepnin atë ditë, unë nuk do të isha gëzuar aq shumë.”⁷

Burejdeja (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) po shkonte për diku bashkë me sahabët e Tij. Gjatë rrugës, ata gjetën një burrë që përpëlitej mbi rërën e nxehur. Burri thoshte me vete:

- “O egoja ime! Ditën e kalon duke ndenjur ulur si dembel, ndërsa natën duke fjetur, pret e shpreson edhe se do të hysh në Xhenet!” Pasi përfundoi atë sjellje, të cilën e bënte përditë, erdhi e na u drejtua neve. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u kthye nga ne dhe na porositi:

- “*Kërkojini këtij vëllait tuaj të lutet për ju.*” Ne e pritëm atë me fjalët:

⁵. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/275.

⁶. Hejthemi, *Mexhmu’u’l-Zenaid*, 6/318 (10379).

⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/290.

- “Zoti të mëshiroftë, o vëlla, lutju Allahut edhe për ne.” Ja se si u lut ai për ne:

- “O Zot, falu atyre udhëzimin e drejtpeshimin në çdo punë që do të bëjnë.” I kërkuam që të vazhdonte të lutej edhe pak më shumë.

- “O Zoti im, bëje devotshmërinë ushqimin e tyre më të mirë.”, – u lut ai. – “Nxirre, o Zot, fitimtar të Dërguarin Tënd e bëje Xhenet vendin ku do të shkojnë ata.”⁸

4. LUTJA PËR MËKATARËT QË DEVIJOJNË NGA RRUGA E DREJTË

Jezid bin Esami tregon: “Në Siri ishte një burrë që jetonte në kushte shumë të vështira ekonomike. Herë-herë ai shkonte vetë tek Omeri (radijallahu anhu). Ishte bërë kohë e gjatë që nuk kishte ardhur më dhe Omeri (radijallahu anhu) kishte filluar të shqetësohej për të, ndaj pyeti dikë:

- “Në ç’gjendje është filan njeri i biri i filan njeriu?”

- “O i Pari ynë, ai njeri e ka lëshuar veten te pija.”, – i thanë. Omeri (radijallahu anhu) thirri shkruesin dhe e urdhëroi:

- “Shkruaj! Letër e Omer bin Hatabin për filanin të birin e filanit. Selame për ty. Unë lëvdoj Allahun e Madhërishëm, veç të Cilit nuk ka zot tjetër, që i fal mëkatet, që pranon pendesën dhe që dënimin e ka shumë të ashpër. Nuk ka zot tjetër përveç Tij dhe vendi ku do të kthehem ne të gjithë është përpara Tij.”

Mandej, Omeri (radijallahu anhu) u kthye nga njerëzit që kishte pranë dhe u tha:

- “Lutuni për vëllanë tuaj, që zemra e tij të rikthehet kah Allahu dhe që Allahu t’ia pranojë pendesën.” Ai burrë, një të marrë letrën e ardhur nga vetë Omeri (radijallahu anhu), tha me vete: “Që i fal mëkatet, i pranon pendimet dhe ndëshkon me shumë ashpërsi...”, – pra, Omeri (radijallahu anhu) po më kanoset mua duke më përmendur ndëshkimin e Allahut dhe po më jep shpresë duke më kujtuar premtimin e Allahut, që i fal ata që pendohen.”

Omeri (radijallahu anhu), kur mësoi më vonë se ai burrë ishte

⁸. Hejthemi, *Mexbmen* ʔ-Zenaid, 10/297 (17440).

ndrequr dhe e kishte lënë pijen, tha:

- “Kështu të veproni edhe ju, kur të shikoni se një vëllai juaj mysliman devijon nga rruga e drejtë, lutuni për të. Kërkoni për rrugët që mund ta rikthejnë atë në rrugën e drejtë. Thuajini atij se Allahu do ta falë atë. Lutjuni Allahut për të, që të pendohet. Por, të kundërtën mos e bëni, mos e ndihmoni djallin, që gjendja e vëllait tuaj të përkeqësohet.”⁹

5. SI DUHET NISUR NJË LUTJE?

Këtë e tregon Selem bin Ekua el-Eslemi (radijallahu anhu): “Unë nuk e kam dëgjuar kurrë të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), që të fillojë të lutet pa thënë njëherë: ‘*Subhane Rab’bije’l-‘Alijje’l-‘Ala’l-Uehhab’*.”¹⁰

Fedale bin Ubejdi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte ulur, kur aty hyri një burrë që fali namazin. Në përfundim të namazit ai u lut duke thënë: “O Zot! Falmë dhe mëshiromë mua.”

Paskëtaj i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha atij burri:

- “*U ngute pak. Shiko, pasi të falësh namazin, fillimisht lëvdoje njëherë Allahun sa më bukur. Së dyti, duhet të më dërgosh mua salavate. Pastaj mund të vazhdoesh t’i lutesh Allahut si të duash.*”

Më vonë erdhi edhe një burrë tjetër dhe pas namazit, lëvdoi Allahun, i dërgoi salavate të Dërguarit Fisnik, dhe u bë gati të niste lutjen. I Dërguari i Allahut, i kthyer nga ai burrë, i tha atij:

- “*O ti që sapo u fale! Tani ti mund t’i kërkosh Allahut ç’të duash, sepse lutja jote pranohet.*”¹¹

6. LUTJA E UMETIT TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) na tregon: “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na lexoi neve fjalën e Ibrahimimit

⁹. Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/70.

¹⁰. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/54 (19596).

¹¹. Tirmidhi, *Sunen*, 5/516 (3476).

(alejhis'selam): **“O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz (nga rruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Ibrahim, 14/36) – dhe lutjen e Isait (alejhis'selam): **“Nëse Ti i dënon ata – robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.”** (Maide, 5/118) – pastaj ngriti duart të hapura dhe u lut me fjalët:

- *“O Zot, unë dua umetin tim. Dua umetin e Allahut. Umetin e Allahut dua unë!”*, – dhe sakaq nisi të qajë. Atëherë, Allahu i Madhërishëm tha:

- *“O Xhibrili! Shko te Muhamedi dhe pyete se pse po qan.”* Erdhi Xhibrili i Besueshëm dhe e pyeti Profetin tonë se pse po qante. Kur i Dërguari i Allahut i tregoi arsyen e vërtetë, Allahu i Gjithëfuqishëm i tha Xhibrilit (alejhis'selam):

- *“Shko te Muhamedi. Thuaji: Ne do ta kënaqim atë me umetin e tij dhe nuk do ta lëmë në vështirësi për këtë gjë.”*¹²

7. LUTJET E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT PËR KATËR KALIFËT

Habab bin Ereti (radijallahu anhu) na ka transmetuar se i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë: *“O Zot, përforcoje Islamin me atë që është më i dashur për Ty nga këta dy vetë: Omer bin Hatabi dhe Ebu Xhehl bin Hishami.”*¹³

Tregon edhe Ebu Saidi (radijallahu anhu): *“I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u lut për Osmanin (radijallahu anhu) me fjalët:*

- *“O Zoti im! Unë jam i kënaqur e më pëlqen Osmani; ji edhe Ti i kënaqur me të, duke i falur atij pëlqimin Tënd.”*¹⁴

Ibni Abasi (radijallahu anhu) na transmeton se i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) është lutur për Aliun (radijallahu anhu) duke thënë:

- *“O Zot! Ndihmoje Aliun. Dhe ndihmoje atë edhe nëpërmjet të tjerëve.*

¹². Ibn Kethir, *Tefsir*, 2/540.

¹³. Tirmidhi, *Sunen*, 5/617 (3681).

¹⁴. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 13/45 (36217).

Duaji edhe Ti ata që do ai dhe përbuzi të gjithë ata që e përbuzin atë. Ndihmoji Ti dhe bëhu mbështetje për këdo që e ndihmon atë dhe i bëhet mbështetje. Privoji nga ndihma jote të gjithë ata që e lënë atë vetëm.”¹⁵

8. LUTJA E KRENARISË SË GJITHËSISË PËR PJESETARËT E FAMILJES SË BEKUAR

Nëna jonë, Umu Selemeja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i tha Fatimes:

- “*Merri edhe burrin me dy djemtë dhe silli këtu tek unë.*” Fatimja shkoi i thirri dhe Profeti ynë mori një copë rrobe, të cilën ma kishte sjellë mua nga plaçka e luftës së Hajberit dhe ua zgjati atyre që të uleshin mbi të. Pastaj Ai tha:

- “*O Zot, këta janë familja e Mubamedit. Mos i privo ata nga mëshira dhe begatia Jote, ashtu siç nuk privove as Ibrahimin dhe familjen e tij. Ti je i denjë për çdo lavdërim dhe Ti je më i Epërmi i të epërme.*”¹⁶

Lutja që bëri Resulullahu për Hasanin (r.a.) dhe Husejnin (r.a.)

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u lut për Hasanin dhe Husejnin duke thënë:

- “*O Zot, unë i dua ata, andaj dua që t’i duash edhe Ti. Kush do ata më ka dashur mua.*”¹⁷

Lutja e Resulullahut për Abasin (r.a.) dhe fëmijët e tij

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon se i Dërguari Fisnik (alejhis’salatu ues’selam) është lutur me këto fjalë:

- “*O Zot! Falua mëkatet e fshehta dhe të hapura Abasit dhe fëmijëve të tij. O Zot, bëji të mirë e të mbarë edhe fëmijët e tij, ashtu siç është vetë ai.*”¹⁸

¹⁵. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/118 (950).

¹⁶. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/323 (26789).

¹⁷. Buhari, *Sabih*, 3/1369 (3537).

¹⁸. Tirmidhi, *Sunen*, 5/653 (3762).

Kurse lutja që bëri për Abdullah bin Abasin (radijallahu anhu), ishte:

- “O Zot mësoja atij librin. Bëje atë një prej njerëzve që e kuptojnë më thellësisht fenë Tënde (fakih).”¹⁹

9. LUTJET E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT PËR SAHABËT E TJERË

Lutja e të Dërguarit të Allahut për Sa’d bin Ebi Uekasin

Sa’d bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ka thënë:

- “O Zot, pranoji lutjet e Sa’dit sa herë që të të lutet ai.”²⁰

Lutja e Profetit tonë për ata që ranë dëshmor në Mute

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), sapo mori lajmin se Zejd bin Haritheja, Xhafer bin Ebi Talibi dhe Abdullah bin Reuaha (radijallahu anhum) kishin rënë dëshmorë në luftën e Mutes, u çua përnjëherësh në këmbë dhe na foli neve për gradët e arritura prej tyre. Fjalën e nisi me një lutje për Zejdin:

- “O Zot, fale Zejdin. O Zot, fale Zejdin. O Zot, fali edhe Xhaferin dhe Abdullah bin Reuahan.”²¹

Lutja e Resulullahut për familjen e Jasirit

Osmani (radijallahu anhu) ka transmetuar lutjen e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) për familjen e Jasirit:

- “O Zot, fale familjen e Jasirit, sepse Ti zëtatën e pate falur atë edhe njëherë më parë.”²²

¹⁹. Buhari, *Sabih*, 1/66 (143).

²⁰. Tirmidhi, *Sunen*, 5/649 (3751).

²¹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/46.

²². Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/62 (439).

Lutja e Resulullahut për Ebu Selemen

Umu Selemeja (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) qe lutur për Ebu Selemen (radijallahu anhu) duke thënë:

- “O Zoti im, fale Ti Ebu Selemen. Pranoje edhe atë mes robve të Tu më të afërt. Bëji brezat e ardhshëm të tij të denjë për të. O Zoti i Botëve, na fal ne dhe fali edhe ata. Zgjeroja dhe ndriçoja, o Zot, atij varrin.”²³

Profeti ynë lutet për Hakim bin Hizamin

Hakim bin Hizami (radijallahu anhu) e transmeton vetë, se i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) është lutur për të me fjalët:

- “O Zot! Bëja atij sa më të begatë tregtinë.”²⁴

Lutja e të Dërguarit të Allahut për Abdullah bin Busrin dhe familjen e tij

Abdullah bin Busri (radijallahu anhu) tregon: “Bashkë me babain ishim ulur te pragu i derës. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kaloi aty i hipur mbi një mushkë. Babai im i foli dhe i tha:

- “O Resulallah, pse nuk zbret të hamë bashkë, e pastaj të na bësh një lutje, që të jemi mirë?” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) zbriti nga mushka, hëngri bashkë me ne dhe pastaj iu lut Zotit me fjalët:

- “O Zot! Mëshiroji këta njerëz dhe falua atyre mëkatet e bëra. Jepu atyre ushqime të mira, të mbara e të begata.”

Ndërsa, në një transmetim tjetër gjendet edhe kjo e dhënë shtesë: “Që nga ajo kohë Allahu ne na fali të mira të bollshme e të begata.”²⁵

²³. Muslim, *Sahih*, 2/634 (920).

²⁴. Hejthemî, *Mexhmen’u-Zenaid*, 3/259 (4531).

²⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 13/458 (37275).

Resulullahu lutet për Ebu Kataden

Ebu Katadeja (radijallahu anhu) na tregon: “Ishim në një nga ekspeditat e luftës, kur unë isha bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ishte pa gjumë, e dukej sikur edhe pak e do të rrëzohej nga deveja. Iu mbyllën sytë, ndaj unë u zgjata dhe e mbajta ashtu, me dorë, gjersa iu hapën sytë. E zuri gjumi prapë. Po njësoj, pata frikë se mos rrëzohej, ndaj vazhdova ta mbaja me dorë, që të mos i rrëshqiste trupi e të binte. Kur u zgjua, ai iu lut Zotit për mua me këto fjalë:

- “O Allah, ruaje edhe Ti Ebu Kataden, ashtu siç më mbrojti ai mua.”
Pastaj më tha:

- “Të mundova shumë edhe ty.”²⁶

Lutja e Profetit tonë për atë që e thërrisnin Harmele

Këtë e tregon Ebu Derdaja (radijallahu anhu): “Tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi një person, të cilin e quanin Harmele. Ai i bëri Profetit tonë me shenjë duke i thënë:

- “Ja, këtu është besimi. (duke bërë me shenjë te gjuha). Kurse këtu është hipokrizia (duke treguar zemrën); sepse unë e përmend shumë pak Allahun.” Profeti ynë u lut kështu për atë njeri: “O Zot, *fali këtij robi Tëndit një gjuhë që të përmend dhe një zemër që të falënderon Ty sa më shumë. Jepi atij të mira të bollshme dhe bëje që të dojë ata që më duan mua. Shndërroje, o Zot, në mbarësi çdo punë të tijën.*”²⁷

Lutja e Resulullahut për sahabët e varfër që kishin mbetur në Mekë dhe për ata sahabë që ishin të dobët e të pafuqishëm

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dha selam në fund të namazit dhe e ngriti kokën lart. I drejtuar nga kibleja, ai filloi të lutej duke thënë:

- “O Zoti im! Ndihmoji Seleme bin Hisbamin, Ajash bin Ebi Rabian,

²⁶. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 3/239 (3272).

²⁷. Hejthemî, *Mexhmen’z-Zeuaid*, 9/669 (16108).

*Uelid bin Uelidin dhe të gjithë myslimanët e tjerë, që janë të dobët dhe kërkojnë një rrugëdalje; shpëtoji ata nga vështirësitë ekonomike dhe bëji ata të ndihen më lirshëm.”*²⁸

10. LUTJET QË BËNTE I DËRGUARI I ALLAHUT PAS NAMAZIT

I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e mori një ditë Muadh bin Xhebelin (radijallahu anhu) për dore dhe i tha:

- “*Shiko, Muadh, unë të dua ty.*”

- “Kurban t’u bëfshin ty nëna dhe babai im, o Resulullah, uallahi edhe unë të dua ty.” – ia ktheu atij Muadhi. Atëherë, i Dërguari i Allahut tha:

- “*Muadh! Mos e lër pa e thënë këtë lutje që do të të mësoj unë pas çdo namazi: ‘O Zot! Ndhimomë mua që të të falënderoj, të të përmend dhe të të robërohem; mos e mpak ndihmesën Tënde mbi mua.’*”²⁹

Tregon Ebu Bekrete (radijallahu anhu): “Pas namazeve Profeti ynë lutej kështu:

- “*O Zot, unë vetëm tek Ti e kërkoj mbrojtjen nga e keqja e mohimit, e varfërisë dhe e vuajtjeve të varrit.*”³⁰

Tregon Aliu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), pasi të jepte selam pas faljes së namazit, lutej gjithmonë duke thënë:

- “*O Zoti im! Falmi mua të gjitha mëkatet e shknuara dhe mëkatet e ardhme; mëkatet e fshehta dhe mëkatet e bëra hapur; fjalët e pamatura, sjelljet dhe të gjitha gabimet që kam bërë pa e ditur, por që Ti i di të gjitha.*”³¹

Aun bin Abdullah bin Utbeja (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, një burrë e kishte falur namazin pranë Abdullah bin Amr bin Asit (radijallahu anhu) dhe e pati dëgjuar teksa lutej duke thënë: “*Allahum’me ente’s-Selam ue minke’s-Selam, Tebarekte ja dhe’l-Xhelali ue’l-Ikram*” (O Zoti im! Ti që je vetë paqja, burimi i qetësisë shpirtërore dhe paqes, prej Teje vjen e tërë qetësia dhe paqja e shpirtit. O Zoti

²⁸. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 10/233 (17237).

²⁹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/244 (22172).

³⁰. Nesai, *Sunen*, 8/262 (5465).

³¹. Ebu Daud, *Sunen*, 1/260 (760).

im, Zoti i madhështisë dhe mirësisë! Sa i Lartë është Emri Yt!) Pastaj ai burrë pati falur namaz edhe pranë Abdullah bin Omerit (radijallahu anhu). Kur dëgjoi se edhe ai u lut duke thënë të njëjtat gjëra qeshi. Ibni Omeri (radijallahu anhu) e pyeti:

- “Pse qeshe?” Ai iu përgjigj:

- “Unë kam falur namaz edhe pranë Abdullah bin Amr bin Asit, e të njëjtën lutje e bënte edhe ai.”

- “Po, kështu thoshte edhe Resulullahu menjëherë pasi jepte selam në fund të namazit.”, – u përgjigj Ibni Omeri.³²

11. LUTJA QË BËNTE VAZHDIMISHT I DËRGUARI I ALLAHUT NË MËNGJES DHE NË MBRËMJE

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), në mëngjes dhe në mbrëmje, do të bënte gjithmonë këtë lutje dhe nuk e braktisi kurrë, deri në ditën që u nda nga jeta:

- “O Zot! Unë dua që të jem sa më mirë, si në këtë jetë, ashtu edhe në amshim. O Zot! Unë dua falje dhe të jem sa më mirë në fenë, botën, familjen dhe pasurinë time. O Zot! Mbulomi mua të metat, largomi frikët dhe bëmë mua të ndihem i sigurt. Mbromë mua ndaj çdo rreziku dhe e keqe që mund të më vijë nga para, apo nga pas; nga e djathta, apo nga e majta; apo nga lart. Dhe i mbështetem Madhështisë tënde për ndihmë ndaj çdo rreziku që mund të më vijë nga poshtë.”³³

12. LUTJET QË BËNTE I DËRGUARI I ALLAHUT, PARA SE TË BINTE PËR TË FJETUR DHE KUR ZGJOHEJ

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur shtrihej të binte për të fjetur, thoshte gjithmonë:

- “Lëvduar qoftë Allahu, që na jep për të ngrënë, për të pirë; që na ruan nga çdo lloj rreziku dhe na mban me më të mirat. Ka sa e sa njerëz që nuk kanë askënd as që të kujdeset për ta, as që t’i strehojë.”³⁴

³². Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 10/127 (16920).

³³. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir* 12/343, (13296).

³⁴. Muslim, *Sahih*, 4/2085 (2715).

Tregon Aliu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur do të shtrihej, në darkë, lutej gjithmonë duke thënë:

- “Unë veç prej Teje mund të kërkoj ndihmë e mbrojtje nga të gjitha krijesat, të cilat janë në xotërimin Tënd. O Zot, Ti je Ai që i lehtëson tërë vështirësitë. O Zot, vetëm ushtritë e Tua nuk dalin kurrë humbëse. E kurrë nuk ndodh që Ti ta shkelësh fjalën e dhënë. Në kohën dhe hapësirën ku sundon fuqia e forca Jote, as që mund të bëhet fjalë për forcë a fuqi tjetër. Unë të madhëroj Ty, sepse Ti nuk mund të kesh asnjë të metë; lëvdur qofsh, o Zoti im.”³⁵

Bera bin Azibi (radijallahu anhu) thotë: “Para se të shtrihej, i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) do të lutej:

- “O Zot, unë po ta dorëzoj Ty trupin tim. E nga Ti e kam të kthyer edhe fytyrën. Ty t’i kam lënë të gjitha punët e veprat e mia. I mbështetur jam tek Ti, me shpresën të mëshira Jote e pakufishme dhe i shqetësuar nga frika e ndëshkimit Tënd. Unë nuk di vend tjetër për të kërkuar ndihmë, veç Teje, as vend ku t’ia mbathësh. Unë e besoj librin që Ti më ke zbritur, ashtu siç e besoj edhe profetët Tënd.”³⁶

E tregon Hudhejfetu’l-Jemaniu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur shtrihej në shtrat, thoshte:

- “O Zot, unë veç me emrin Tënd jetoj dhe veç me emrin Tënd kam për të vdekur.”; kurse, kur zgjohej, në mëngjes, thoshte:

- “Lëvdur qoftë Allahu, i Cili, pasi vdiqëm (rënia në gjumë), na ngjalli sërish; të gjithë tek Ai do ta kemi kthimin.”³⁷

Tregon Aishja (radijallahu anha): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur zgjohej nga gjumi i natës, lutej me fjalët:

- “Nuk ka zot tjetër veç Teje. Unë të madhëroj Ty, sepse Ti nuk mund të kesh kurrfarë të mete. Lëvdur qofsh, o Zot. Unë të lutem që të m’i falësh mua mëkatet. Për mëshirë të lutem, të përgjërobem. Shtoma mua dijen, o Zot. E mos e lër zemrën time të devijojë pasi ka gjetur udhëzimin dhe falmë mua e jepma mëshirën Tënde. Nuk ka aspak dyshim, se Ti je Falësi më i begatë!”³⁸

³⁵. Ebu Daud, *Sunen*, 2/732 (5052).

³⁶. Buhari, *Sahib*, 5/2326 (5954).

³⁷. Nesai, *Sunen*, 6/187 (10584).

³⁸. Ebu Daud, *Sunen*, 2/735 (5061).

13. LUTJET E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT KUR HYNTE DHE DILTE NË XHAMI, NË SHTËPI, APO NË MESIN E NJERËZVE

**Lutja që bënte Resulullahu kur do të largohej
nga ndonjë kuvend me njerëz**

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Në atë kohë që Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) do të ngrihej, për t’u larguar nga ndonjë kuvend me besimtarë ku ishte i ulur, ai lutej për sahabët e tij me këto fjalë:

- “O Zot! Falna ne me mirësinë Tënde respekt dhe drojë, që ato të na pengojnë e ne të mos ngremë dot krye karshi Teje. Falna ne bindje, sepse vetëm ajo mund të na shpjerë ne në Xhenetin Tënd. Na jep ne një besim sa më të fuqishëm, që ne të përballemi denjësisht me të gjitha fatkeqësitë e kësaj bote. Bëna ne, sa të kemi jetë, të përfitojmë sa më shumë nga veshët, sytë dhe fuqia jonë. Na mundëso neve që ndjenjën e hakmarrjes ta përdorim vetëm kundër atyre që u bëjnë njerëzve padrejtësi. Mos na vër ne përballë sprovash të vështira, që duan të na e provojnë besimin, e mos na e bëj kurrë këtë botë shqetësimin dhe çështjen më të madhe të jetës. Kurrë mos qoftë jeta e kësaj bote qëllimi i dijes sonë. Dhe mos na lër ne vetëm për vetëm, o Zot, me asnjë prej atyre që nuk kanë aspak mëshirë për ne!”³⁹

E tregon nëna jonë, Umu Selemeja (radijallahu anha): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur do të dilte nga shtëpia, thoshte gjithmonë:

- “Bismill’ah, unë u dorëzoja krejtësisht tek Allahu. O Allah, vetëm Ti mund të më ndihmosh mua nga rrëshqitja e këmbës dhe largimi prej rrugës së drejtë; nga padrejtësia dhe nga rënia pre e padrejtësisë; nga sjellja e ashpër dhe prej të padituri dhe nga rënia pre e sjelljes së ashpër e të paditurve.”⁴⁰

Lutja që lexonte Resulullahu kur hynte në xhami

Abdullah bin Amr bin el-Asi (radijallahu anhu) tregon: “Profeti i profetëve, kur hynte në xhami, këndonte këtë lutje:

- “O Zot, vetëm tek Ti dhe te Fuqia e mbrojtja e kabershme e Jotja mund të kërkoj ndihmë kundër së keqes së djallit të larguar e të përçënë prej Teje.” Kur

³⁹. Tirmidhi, *Sunen*, 5/528 (3502).

⁴⁰. Tirmidhi, *Sunen*, 5/490 (3427).

i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) bënte këtë lutje, djalli thoshte:

- “Ai u ruajt nga e keqja ime për gjithë ditën.”⁴¹

Në transmetimin e Tirmidhiut, thuhet: “Kur hynte në xhami, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) thoshte kështu:

- “O Zot, *falmi mua mëkatet dhe mbaji të hapura për mua portat e Mëshirës Sate.*” Ndërsa, kur dilte, thoshte:

- “*Bismill'ah ue's-selamu ala Resulil'lah.*”⁴²

Lutja që bënte Profeti ynë para se të nisej në udhëtim

Aliu (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur do të nisej në ndonjë udhëtim, thoshte:

- “O Allah, *unë po i hip kësaj kafshe me ndihmesën dhe mbështetjen Tënde dhe po me ndihmën Tënde do ta bëj këtë udhëtim.*”⁴³

Kurse Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur nisej në udhëtim, hipte mbi kafshën e rrugës dhe një t'u bërë gati për t'u nisur, ai lëvdonte dhe madhëronte Allahun që nuk ka asnjë të metë, pastaj thoshte tri herë “Allahu Ekber” dhe bënte këtë lutje:

- “*Allahu që na i ka dhënë në shërbim të gjitha këto mundësi, është më i Larti i të lartëve dhe Ai është i kulluar e nuk ka asnjë të metë. ‘Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se vetë ne këto nuk do të mund t’i kontrollonim dot. Nuk ka dyshim, që, në fund, ne tek Ai do të kthehemi.’* (Zuhruf, 43/13-14). *Zoti ynë, ne Ty të lutemi që të na bësh të jemi të mirë e të devotshëm në këtë rrugëtim, e të bëjmë punë që Ti do të na i pëlqesh. O Zot, na lehtëso neve këtë rrugëtim dhe na e bëj sa më të shkurtër rrugën. O Zot, Ti je bashkudhëtar i ynë në këtë rrugë, e je po Ti që do t’i shobësh familjet tona, të cilat ne po i lëmë këtu, vetëm. O Zot, ne Ty të kërkojmë ndihmë për mundimet e udhëtimin, për ngjarjet që mund të na mërzhitin dhe për ndonjë dëm që mund t’u vijë familjeve, fëmijëve dhe plaçkës sonë.*”⁴⁴

⁴¹. Ebu Daud, *Sunen*, 1/180 (466).

⁴². Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 6/283 (26460).

⁴³. Hejthemî, *Mexhmenü’z-Zenaid*, 10/183 (17088).

⁴⁴. Muslim, *Sabih*, 2/978 (1342).

Lutja që bënte i Dërguari i Allahut kur ndahej me ndokënd

Tregon Kazea': "Mua më pati thënë Ibni Omeri (radijallahu anhu): "Do të vish të ndahemi me njëri-tjetrin, ashtu siç përshëndetëj i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) para se të ndahej nga dikush:

- "Unë po i lë në dorën dhe ndihmesën e Allahut, besimin, sigurinë e rrugës dhe punët e tua të fundme."⁴⁵

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Te Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi një burrë dhe i tha:

- "O Resulullah! Unë dua të nisem për rrugë, ndaj kam ardhur që të të kërkoj të më japësh diçka që të më shërbejë si ushqim shpirtëror përgjatë rrugëtimit." I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- "Zoti të dhëntë me vete devotshmëri." Ai burrë i tha:

- "Po sikur të më shtosh edhe diçka tjetër." Resulullahu i tha:

- "Zoti t'i faltë edhe mëkatet."

- "Kurban t'u bëfshin ty nëna dhe babai im! Shtoma edhe pak ushqimin e rrugës." E, atëherë, Resulullahu u lut:

- "Zoti të udhëheqtë ty lehtësisht kah e mbara, kudo që të jesh."⁴⁶

Lutjet që bënte i Dërguari i Allahut, kur hante ose pinte diçka dhe kur vishte një veshje të re

Tregon Ebu Uameja: "Kur ngrihej sofrë, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) lutej duke thënë këto fjalë:

- "Lëvduar qoftë pafundësisht Allahu. Sado që ta lëvdojmë ne Atë, do të jetë gjithsesi e pamjaftueshme për të gjitha këto mirësi që Ai na ka falur."⁴⁷

Ebu Saidi (radijallahu anhu) na tregon: "I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), sa herë që do të hante, apo do të pinte diçka, Ai do të thoshte gjithmonë:

⁴⁵. Ebu Daud, *Sunen*, 2/39 (2600).

⁴⁶. Tirmidhi, *Sunen*, 5/500 (3444).

⁴⁷. Buhari, *Sabih*, 5/2078 (5142).

- “*Lëvduar qoftë Allahu që na jep për të ngrënë, na jep për të pirë dhe na ka bërë ne myslimanë.*”⁴⁸

Tregon po ashtu Ebu Saidi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), çdoherë që vishte një veshje të re, thoshte kështu:

- “*Lëvduar qofsh përherë, o Zot. Ti je Ai që po ma vesh mua këtë rrobë. (Ai e përmendte gjithmonë me emër atë që do të vishte; këmishë, çallmë, apo rrobë tjetër). Unë të lutem Ty e të kërkoj që këtë veshje ta vesh vetëm për punë të mira e të mbara dhe që të ketë qenë po i mirë edhe qëllimi i përgatitjes së saj. Dhe vetëm mëshira Jote e thellë mund të më mbrojë mua nga të këqijat që mund të më vijnë prej saj, si dhe nga të këqijat që mund të vijnë prej përgatitjes së saj.*”⁴⁹

14. LUTJA QË BËNTE I DËRGUARI I ALLAHUT, SA HERË QË SHIhte HËNËN E PARË, KUR DËGJONTE BUBULLIMËN, APO KUR KISHTE ERË DHE RE

Tregon Talha bin Ubejdullahu (radjiallahu anh): “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), sa herë që do të shihte hënën e parë, Ai do të lutej duke thënë:

- “*Zoti im! Na fal begatinë me këtë hënë të re, e na jep qetësi e siguri bashkë me të. Allahun kemi Zot edhe ne, edhe ajo.*”⁵⁰

Lutja e të Dërguarit të Allahut kur dëgjonte bubullima

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Krenaria e Gjithësisë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur dëgjonte zhurmën e bubullimës a të vetëtimës, lutej e thoshte:

- “*O Zot! Mos na vrit e mos na shkatërro ne me ndëshkimin Tënd. E mbi të gjitha falna ne mirëqenie të trupit e të shpirtit.*”⁵¹

⁴⁸. Ebu Daud, *Sunen*, 2/394 (3850).

⁴⁹. Ibn Hibban, *Sahib*, 12/239 (5420).

⁵⁰. Tirmidhi, *Sunen*, 5/504 (3451).

⁵¹. Tirmidhi, *Sunen*, 5/503 (3450).

Lutja që bënte Resulullahu kur frynte erë e fortë

Tregon Aishja (radijallahu anha): “Sa herë që kishte furtunë e frynte erë e fortë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i lutej Zotit:

- “O Zot! Të lutem, qoftë e mbarë kjo erë dhe e mira e saj të bëhet shkak veçse për mbarësi. Dhe vetëm Ti mund të na mbrosh ne, o Zot, nga dëmet, të këqijat dhe fatkeqësitë natyrore që mund të sjellë ajo.”⁵²

Lutja e Resulullahut kur shihte se qiellin e kishin mbuluar re të dendura

Aishja (radijallahu anha) ka treguar: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), po të shihte se qiellin e mbulonin re të dendura, e linte punën; nëse do të ishte duke falur namaz, përfundonte namazin, pastaj thoshte:

- “O Zot, vetëm Ti mund të na mbrosh ne nga dëmet që mund të sjellin këto re.” Dhe, kur binte shi, ai i lutej Zotit, duke thënë:

- “O Zot, na dërgo shiun e të mirave dhe begatisë.”⁵³

15. LUTJE TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, TË CILAT NUK LIDHESHIN ME NJË KOHË A NDODHI TË CAKTUAR

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) tregon: “Profeti i profetëve (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ka thënë:

- “O Zot unë prej Teje nuk dua veçse *udhëzim*, *devotshmëri*, *nder* dhe *pasuri në zemër*.”⁵⁴

Nëna jonë, Umu Selemeja (radijallahu anha) na tregon: “Një nga lutjet që bënte më shpesh i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte kjo:

- “O Zoti im, që i ke në dorë gjithë zemrat tona dhe u jep atyre drejtim, mos e largo nga feja Jote zemrën time!”⁵⁵

⁵². Muslim, *Sahih*, 2/616 (899).

⁵³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/696 (23541).

⁵⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/796 (5089).

⁵⁵. Tirmidhi, *Sunen*, 5/538 (3522).

Aishja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) lutej:

- “O Zot, *zëbukuroma mua edhe moralin, ashtu siç më krijove edhe mua, të bukur.*”⁵⁶

Busr bin Ebu Erta’i (radijallahu anhu) tregon: “Të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) unë e kam dëgjuar të lutet:

- “O Zot, *na e bëj të mirë e të mbarë përfundimin e çdo pune që ne bëjmë. Na ruaj ne, që të mos jemi prej të poshtëruarve as në këtë botë, as në tjetrën.*”⁵⁷

Nëna jonë e dashur, Aishja (radijallahu anha), ka thënë: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) thoshte:

- “O Zot, *shtoma mua furnizimin Tënd me të mira kur të plakem e të jem duke i shkuar jetës në fund.*”⁵⁸

16. LUTJET GJITHËPËRFSHIRËSE TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Nëna jonë, Aishja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) mua më pati këshilluar që ta bëja gjithmonë këtë lutje:

- “O Zot, *prej Teje unë dua që të më japësh gjithë mirësitë e mbarësitë që i di, apo nuk i di unë, që janë tani, apo që do të vijnë në ardhmen. O Zot! Vetëm Ti mund të më mbrosh mua nga tërë të këqijat, që i di, apo nuk i di unë, të tanishme, apo që do të ndodhin në të ardhmen.*”⁵⁹

17. PROFETI YNË NUK KËRKONTE MBROJTJE PREJ ASKUJT TJETËR VEÇ ALLAHUT

Na e tregon Enesi (radijallahu anhu): “Ja se si lutej i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Zot! *Unë veç tek Ti kërkoj mbrojtje prej dobësisë, prej përtacisë, prej burracakërisë, prej koprracisë dhe prej pleqërisë. Nuk ka kush tjetër, veç Teje,*

⁵⁶. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/403 (3823).

⁵⁷. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/181 (17665).

⁵⁸. El-Hakim, *Mustedrek*, 1/726 (1987).

⁵⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/733 (4919).

që të më ruajë mua prej vuajtjeve të varrit, apo prej sprovave të kësaj jete dhe të vdekjes.”⁶⁰

Aishja (radijallahu anha) tregon: “Profeti i profetëve, kur lutej, gjatë lutjes thoshte:

- “O Zot, *kërkoj tek Ti strehë nga të këqijat që mund të më sjellin ato gjëra që i di dhe ato gjëra që nuk i di.”⁶¹*

Kutbe bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari Fisnik thoshte:

- “O Zot, *nuk kam se kujt tjetër t’i kërkoj ndihmë, veç Teje, nga çdo lloj morali dhe vesi i keq, nga çdo sjellje e keqe, ashtu si edhe nga ndjekja e dëshirave të trupit.”⁶²*

Ukbe bin Amiri (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) lutej:

- “O Zot, *vetëm tek Ti mund të kërkoj ndihmë nga dita që shkon keq, nga nata që shkon keq, nga ora që shkon keq, nga shoku që më nxit për keq dhe nga fqinji i keq në lagje.”⁶³*

**Strehimi i të Dërguarit të Allahut tek Allahu nga çdo e keqe
që mund të vijë prej xhindeve dhe lutja e tij për
një të sëmure që vuante nga goditja e xhindit**

Tregon Ubej bin Ka’bi (radijallahu anhu): “Isha ulur pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur aty erdhi një beduin dhe i tha Profetit tonë:

- “O Resulullah! Ky që kam sjellë me vete është vëllai im, ka shumë dhimbje të forta.” I Dërguari Fisnik e pyeti atë burrë:

- “*Ku i dhemb?*”, – dhe ai burrë i tha se atij i janë qepur dhe e kanë goditur xhindet. Profeti ynë i tha:

- “*Sillma këtu afër.*” Ashtu bënë, e morën të sëmurin dhe ia shpunë afër. Ai i këndoi atij njeriu, suren “Fatiha”, katër ajetet e para të sures

⁶⁰. Muslim, *Sabih*, 4/2079 (2706).

⁶¹. Muslim, *Sabih*, 4/2085 (2716).

⁶². Tirmidhi, *Sunen*, 5/575 (3591).

⁶³. Taberani, *Mu’xhemul-Kebir*, 17/294 (810).

“Bekare”: “Elif, Lam, Mim. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtë, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne...” (Bekare, 2/1-4), ajetin 163 të sures “Bekare”: “Zoti juaj është një Zot i vetëm! S’ka zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!” (Bekare, 2/163), Ajetin Kursij: “Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremetja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursiu (Ndenjësja në këmbët e Fronit të Allahut) i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (Bekare, 2/255), tri ajetet e fundit të sures “Bekare”: “Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Edhe nëse e tregoni apo e fshihni çfarë keni në shpirtin tuaj, Allahu do t’ju kërkojë llogari për të. Kështu, Ai do të falë kë të dojë dhe do të dënojë kë të dojë. Allahu është i fuqishëm për çdo gjë. I Dërguari beson në atë (Kur’anin) që i është shpallur nga Zoti i Tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): ‘Ne nuk bëjmë dalim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij.’ Ata thonë: ‘Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti ynë dhe te Ti do të kthehemi!’ Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu siç i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!” (Bekare, 2/284-286), ajetin 18 të sures “Al ‘Imran”: “Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka zot tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.” (Al ‘Imran, 3/18), ajetin 54 të sures “Araf”: “Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi

qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (që mbisundon gjithësinë). Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrin të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!” (A’raf, 7/54), ajetin 114 të sures “Muminun”: “Ai do të thotë: ‘Keni qëndruar shumë pak. Eh, sikur ta kishit ditur!’” (Muminun, 23/114), ajetin e dytë të sures “Xhin”: “(Ai) i cili udhëzon në rrugën e drejtë dhe kemi besuar në të, prandaj kurrësi më nuk do t’i shoqërojmë askënd Zotit tonë (në adhurim)!” (Xhin, 72/2), dhjetë ajetet e para të sures “Saf’fat”: “Betohem në ata (engjëj) që janë të radhitur dhe në ata që pengojnë (të keqen) dhe në ata që e lexojnë Kur’anin, se, në të vërtetë, Zoti juaj është Një, Zoti i qiejve dhe i Tokës dhe çfarë gjendet mes tyre dhe Zoti i lindjeve (të diellit)! Ne e kemi stolisur qiellin e kësaj bote me shkëlqimin e yjeve, mbrojtje nga djajtë kryeneçë. (Kështu që) ata nuk e përgojnë dot Grupin më të Lartë (engjëjt lart në qiej) dhe qëllohen (me meteorë) nga të gjitha anët. Pastaj, ashtu të përzënë do të kenë vuajtje të përhershme (në jetën tjetër). (Djajtë nuk përgojnë dot), veç atij që grabit diçka e që e ndjek një yll verbues.” (Saffat, 37/1-10), tri ajetet e fundit të sures “Hashr”: “Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim). Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)! Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që çdo gjëje i jep trajtë. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Hashr, 59/22-24); suren “Ihlas”, “Felek” dhe “Nas”. I sëmuri u ngrit në këmbë sikur të mos e kishte shqetësuar asgjë.”⁶⁴

Lutja që do të bëjnë ata që tremben në gjumë

Imam Maliku (radijallahu anhu) na transmeton: “Njëherë, Halid bin Uelidi (radijallahu anhu) shkoi tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu

⁶⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/128 (21212).

alejhi ue sel'lem) dhe i tha:

- “Unë trembem e frikësohem shumë gjatë gjumit, o i Dërguari i Allahut.” I Dërguari i Allahut i tha atij që të thoshte këtë lutje:

- “*Bismillab. Unë kërkoj strehë e mbrojtje vetëm tek Allahu, prej dënimit të Tij të ashpër, prej ndëshkimit të Tij, prej së keqes së robërve të Tij dhe prej cytjeve të djajve që prishin qetësinë e shpirtit.*”⁶⁵

Lutja që duhet bërë kur je i shqetësuar dhe i mërzitur

Këtë na e tregon Aliu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na mësoi këto tri fjalë, duke na porositur që t'i themi këto sa herë që jemi të shqetësuar, në vështirësi, apo të mërzitur:

- “*La ilahe illallahu'l Halimu'l-Kerim, Subhanallahi ue tebareke Rab'bu'l-Arshi'l-Adhim ue'l-Hamdu lil'lahi Rab'bi'l-Alemin*” (Nuk ka zot tjetër, përveç Allahut, i Cili është më i Buti dhe më Bujari. Ai Zot, Allahu, që është Zoti i Fronit të Madh, është i pastër nga çdo e metë a mangësi dhe Ai është më i Larti. Vetëm Allahu, që është Zoti i botëve është i denjë për t'u përlënduar.)”⁶⁶

18. LUTJA QË DUHET BËRË NGA FRIKA E UDHËHEQËSIT TË PADREJTË TË SHITETIT

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) na tregon: “Nëse ju vihet mbi krye një mbret, nga i cili jeni të shqetësuar se do t’ju bëjë padrejtësi dhe do t’ju ushtrojë trysni, dhe ju thoni: ‘O Allah, Ti je Zotëruesi i Fronit të Lartë dhe i shtatë kateve qiej! Më ruaj mua nga filan njeri dhe nga ndihmësit e tij, xhinde dhe njerëz, që ata të mos më bëjnë mua asnjë të padrejtë; mos më lër mua nën thundrën e tyre. Krenar e kryelartë është kushdo që është në mbrojtjen tënde. Ti meriton lavdërimet më të epërme, sepse nuk ka zot tjetër përveç Teje.’, – ai mbret juve nuk ju bën dot asnjë dëm.”⁶⁷

⁶⁵. Hejthemî, *Mexhmen'uz-Zenaid*, 10/176 (17067).

⁶⁶. Nesai, *Sunen*, 6/162 (10466).

⁶⁷. Buhari, *el-Edeb*, 1/247 (707).

19. LUTJA QË KËSHILLOHET TË BËJË AI QË KA HYRË NË BORXHE

Ebu Uaili (radijallahu anhu) tregon: “Tek Aliu (radijallahu anhu) vjen një skllav i liruar me kusht (liria e tij varej nga një pagesë që do të bënte skllavi ndaj të zotit sipas një kalendari të caktuar). Ai i thotë atij:

- “Tanimë nuk po i bëj dot më pagesat, nuk kam më mundësi, më ndihmo.” Aliu (radijallahu anhu) i tha atij:

- “A do që të të mësoj një lutje që mua ma ka mësuar vetë i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem)? Nëse e bën këtë lutje, edhe sikur sa malet t’i kesh borxhet, Allahu ty ka për të të ndihmuar. Lutu kështu:

- “O Zot, bëmë mua të mjaftohem me të lejuarën; bëmë mua që as nëpër mend të mos më shkojë hyrja në mëkat. Jepmë mua pasuri prej mirësisë e bujarisë Sate, e mos më lër mua t’i bëhem nevojtar tjetërkuajt përveç Teje.”⁶⁸

Ebu Said el-Hudri (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi një ditë në xhami dhe pa se aty po qëndronte i ulur ensari Ebu Uame! I Dërguari i Allahut i tha atij:

- “O Ebu Uame! Më bëri merak kjo, që ti je në xhami në një kohë që nuk është kohë namazi.”

Ebu Uameja iu përgjigj:

- “Kam ca probleme e kam edhe ca borxhe, o Resulullah!” I Dërguari i Allahut e këshilloi atë:

- “A do që të të mësoj unë disa fjalë, që po t’i thuash, Allahu ka për të të ndihmuar që t’i flakësh tutje problemet e të shpëtosh nga borxhet?”

- “Po, m’i mëso, o Resulullah!” – u përgjigj ai. – I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) shtoi:

- “Në agim dhe në mbrëmje do të thuash këtë lutje: ‘O Zot, vetëm Ti mund të më ndihmosh mua me vështirësitë e mërzinë që më ka kapluar. Vetëm Ti je Ai që mund të më ndihmosh mua nga dobësia dhe dembelizmi. Vetëm Ti je Ai që mund të më ndihmosh mua nga koprracia dhe burracakëria. Ndihmomë, o Zot, se vetëm tek Ti mund të kërkoj unë mbrojtje nga rënia në batakun e borxhit dhe

⁶⁸. Tirmidhi, *Sunen*, 5/560 (3563).

nga dyndja e huadhënësve në portën e shtëpisë sime.”

Ebu Uameja thotë më vonë: “Që atë ditë që nisa ta bëja atë lutje, unë, me ndihmesën e Allahut, shpëtova nga vështirësitë dhe nga borxhet.”⁶⁹

20. LUTJA QË DUHET BËRË PËR T’U BËRË HAFIZ I KUR’ANIT

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Ishim ulur me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur aty ia behu Aliu (radijallahu anhu) dhe tha:

- “Kurban t’u bëfshin ty nëna dhe babai im, o i Dërguari i Allahut, më iku nga kujtesa i tërë Kur’ani që pata mësuar përmendësh; e ndiej veten shumë të pafuqishëm në këtë gjë.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha atij:

- “O Ebu’l-Hasen! *A të të mësoj unë disa fjalë, që me lejen dhe ndihmesën e Allahut, do të të bëjnë shumë dobi, si ty vetë, ashtu edhe me ata njerëz, të cilëve përpigesh që t’u mësosh Kur’anin?*”

- “Mësoni, o Resulullah!”, – u përgjigj me një frymë Aliu (radijallahu anhu). Atëherë, i Dërguari i Allahut e porosi atë:

“Natën e së premtes, nëse do të kesh fuqi ta bësh, një të tretën e fundit të natës do të ngrihesh, sepse kjo pjesë kobe është koha kur engjëjt janë dëshmitarë të çdo gjëje dhe lutjet që bëhen në atë pjesë kobe pranohen. Edhe vëllai im Jakubi, kur thoshte: “Ai u përgjigj: ‘Do ta lus Zotin tim që t’ju falë. Pa dyshim që Ai është Falësi dhe Mëshirëploti.” (Jusuf, 12/98), natën e së premtes kishte parasysh. Nëse nuk ngrihesh dot në këtë pjesë të natës, atëherë ngrihu në një të tretën e dytë të natës. E nëse as kësaj nuk ia del dot, atëherë ngrihu gjatë një të tretës së parë të saj. Fal katër rekate namaz. Në rekatën e parë të lexosh suren “Fatiba” me suren “Jasin”, në rekatën e dytë suren “Fatiba” me suren “Duhan”, në rekatën e tretë suren “Fatiba” me suren “Sexhde”, ndërsa, në rekatën e fundit të lexosh suren “Fatiba” me suren “Mulk”. Kur ta përfundosh lutjen e “et-Tehijjatu”, lëvdoje dhe përgëzoje Allahun dhe na dërgo salavate e përshëndetje mua dhe profetëve të tjerë. Lutju Allahut, që Ai t’i falë të gjithë besimtarët që jetojnë, por edhe ata që kanë mërguar në botën tjetër me besim. Dhe, në fund, bëj këtë lutje:

⁶⁹. Ebu Daud, *Sunen*, 1/484 (1555).

“O Zot, sa të kem jetë mëshiromë mua duke më mbajtur larg nga çdo lloj ngritjeje krye. O Zot, të të vijë keq për mua, e mbamë larg nga çdo gjë e çdo punë e kotë dhe e padobishme. Drejtomë mua për në ato punë që të kënaqin Ty.

O Zoti im, që i ke krijuar rruzugullin tokësor dhe qiejt në një formë të pashembullt, Ti je Ai fuqia e të Cilit është e paarritshme dhe e pafundme është bujaria Jote! O Zot, o i Gjithëmëshirshëm! Thurma mua në mendjen dhe kujtesën time atë Kur'an që ne nuk e dinim e Ti na e mësove. Të lutem, jepmë mua mundësinë që të mund ta lexoj atë ashtu siç do të të pëlqente Ty ta lexonim.

O Zoti im, që i ke krijuar rruzugullin tokësor dhe qiejt në një formë të pashembullt, Ti je Ai fuqia e të Cilit është e paarritshme dhe e pafundme është bujaria Jote, o Allah, o Rahman! Për hir të asaj forcës e bukurisë Sate, ndriçoji sytë e mi me librin Tënd dhe pastroje trupin tim nëpërmjet tij. Askush tjetër, pos Teje, nuk më ndihmon dot mua. Askush tjetër nuk mund të ma japë mua një aftësi të tillë. Asgjë nuk ndodh pa qenë e pranishme forca dhe fuqia jote.”

- O Ebu'l-Hasen! Nëse e thua këtë që sapo të mësova për tri, pesë, apo shtatë të premte, me lejen e Allahut ajo lutje do të të pranohet. Unë i betohem Zotit që më dërgoi mua me të Drejtën dhe të Vërtetën, se Ai kurrsesi nuk e braktis besimtarin në gjysmë të rrugës.”, – e mbylli këshillën e tij Profeti ynë.”⁷⁰

21. LUTJET E SAHABËVE FISNIKË

Lutja e Ebu Bekrit (r.a.)

Tregon Ebu Jezid el-Medaini (radijallahu anhu): “Një nga lutjet që bënte shpesh Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte edhe kjo:

- “O Zot! Falmë mua një besim të palëkundur, bindje në besim, shëndet e mirëqenie të shpirtit dhe një qëllim të kulluar e të sinqertë.”⁷¹

Lutja e Omerit (r.a.)

Hasan Basriu (radijallahu anhu) na ka përcjellë se Omeri (radijallahu anhu) thoshte:

- “O Zot, bëje të mirë veprën time dhe bëmë mua që të veproj

⁷⁰. El-Hakim, *Mustedrek*, 1/461 (1190).

⁷¹. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 2/776 (5031).

me aq sinqeritet, sa që në punën time të mos ketë pjesë askush tjetër përveç Teje.”⁷²

Ebu’-Alijeja tregon: “Lutja që e kam dëgjuar Omerin (radijallahu anhu) të bëjë më së shumti ka qenë kjo:

- “O Zot! Jepna ne mirëqenie në trup e në shpirt, gjallëri në besim dhe rregull në jetë; na fal ne, o Zot.”⁷³

Zejd bin Eslemi (radijallahu anhu) ka përcjellë nga i ati, se: “Omeri (radijallahu anhu) lutej kështu:

- “O Allah! Mos ia mundëso vdekjen time asnjë njeriu që ka falur qoftë edhe një rekat namaz, apo që ka bërë qoftë edhe njëherë sexhde përpara teje gjatë jetës, në mënyrë që Ai të mos kacafytet me mua përpara Teje në ditën e Kiametit, duke u fshehur pas asaj sexhdeje apo pas atij rekati namaz.”⁷⁴

Lutja e Aliut (r.a.)

Tregon Sufjan bin Theurij (radijallahu anhu): “Unë pata dëgjuar njëherë Aliun (radijallahu anhu), i cili u lut duke thënë:

- “O Allah, mëkatet e mia nuk të bëjnë dot Ty asnjë dëm. Por edhe po u tregove i Mëshirshëm ndaj meje, aspak nuk pakësohet prej mëshirës Sate.”⁷⁵

Lutja e Abdurrahman bin Aufit (r.a.)

Tregon Ebu’l-Hejxh el-Esedi: “Isha duke i ardhur Qabes përqark, kur syri më zuri një burrë. Ai burrë lutej vazhdimisht duke thënë:

- “O Allah, më ruaj mua nga koprracia e egos.” Shkova dhe e pyeta se pse e bënte përherë këtë lutje dhe ai m’u përgjigj duke më thënë:

- “Sepse, po të jem i mbrojtur nga koprracia dhe babëzia e egos, atëherë mua as do të më duhet të vjedh, as të kryej imoralitet, apo

⁷². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/779 (5041).

⁷³. Ibn Ebi Shejbe, *Musan’nef*, 6/65 (29515).

⁷⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 12/856 (35964).

⁷⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 2/787 (5064).

ndonjë të keqe tjetër; he, nuk është kështu?” Më vonë mësova se ai burrë kish qenë Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu)!⁷⁶

Lutja e Abdullah bin Mesudit (r.a.)

Tregon Ebu Ubejdeja (radijallahu anhu) (i biri i Ibni Mesudit): “Kur e kanë pyetur Ibni Mesudin (radijallahu anhu):

- “Do të na tregosh, si ka qenë ajo lutje që pate bërë atë natë, kur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) të pati thënë: *‘Kërko, se gjithëka që të kërkojë Allahu do të ta japë.’*?” Ai është përgjigjur:

- “O Allah, unë prej Teje kërkoj që të më japësh një besim sa më të shëndoshë, që unë të mos i qasem kurrë territorit të kthimit nga feja jote, si dhe që të jem edhe unë një nga fqinjët e Krenarisë së Gjithësisë, atje, në shkallën më të lartë të Xhenetit, ku të mirat e bukuritë nuk kanë kurrë fund.”⁷⁷

Lutja e Muadh bin Xhebelit (r.a.)

Na tregon Theur bin Jezidi: “Muadhi (radijallahu anhu), kur zgjohej gjatë natës që të falte namazin e tehexhudit, ai do të lutej gjithmonë:

- “O Allah, gjithë sytë u mbyllën të flenë e yjet nuk shihen. Por Ti je Jetëdhënës, i Gjallë dhe i Patundur. O Allah, nga njëra anë të kërkoj që të më gëzosh me parajsën, e nga ana tjetër veprat e mia nuk janë të mira. Harroj e më duket sikur do të mund t’i shpëtoj dënimit të ashpër të zjarrit. O Allah, unë besoj se pranë Teje Ti mban një dhuratë shumë të madhe, që në Kiamet do t’ua japësh robërve të Tu më të dashur, sepse Ti nuk kthen kurrë nga fjala e dhënë.”⁷⁸

Lutja e Bilalit (r.a.)

Tregon gruaja e Bilalit, Hindi: “Kur Bilali (radijallahu anhu) binte në shtrat për të fjetur, lutej kështu:

⁷⁶. Ibn Kethiri, *Tefsir*, 4/339.

⁷⁷. El-Hakim, *Mustedrek*, 1/707 (1928).

⁷⁸. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/233.

- “O Allah! Falmi mua mëkatet dhe pranomi sëmundjet e trupit si justifikim.”⁷⁹

Lutja e Zejd bin Thabitit (r.a.)

Zejd bin Thabiti (radijallahu anhu), kur shtrihej në shtrat, thoshte këto fjalë:

- “O Allah! Të lutem e të përgjërohem, mos më bëj mua të jem nevojtari te njerëzit e mi të afërt. Dhe te mëshira Jote e thellë e kam shpresën, që të më ndihmosh nga mallkimi i ndonjë prej të afërmeve të mi, që i kam shkëputur lidhjet.”⁸⁰

Lutja e Ebu Derdasë (r.a.)

Tregon Bilal bin Sa’di (radijallahu anhu): “Ja se si lutej Ebu Derdaja (radijallahu anhu):

- “O Zot, vetëm Ti mund të më ndihmosh mua nga hallakatja e zemrës dhe shpirtit.” E patën pyetur Ebu Derdanë, se çfarë ishte “hallakatja e zemrës”? Ebu Derdaja u përgjigj duke thënë:

- “Hallakatja e zemrës është që të ketë kudo diçka që të përket ty.”⁸¹

Lutja e Abdullah bin Omerit (r.a.)

Nafiu tregon, se kur ishin në Safa, Ibni Omeri (radijallahu anhu) ishte lutur me këto fjalë:

- “O Allah, ruajmë mua në fenë Tëndë. Bëmë mua nga ata që të binden, Ty dhe të Dërguarit Tënd; pajismë edhe mua me këtë të mirë të madhe. Jepmë mua forcë, që t’u qëndroj larg gjërave të ndaluara. Bëmë mua një prej atyre që të duan Ty dhe prej atyre që i duan engjëjt, profetët dhe robt e Tu të dashur. O Zot, bë më mua të dashur për Ty, për engjëjt, për profetët dhe për robt e Tu të dashur. O Zot, lehtësoma mua rrugën që shkon drejt Xhenetit e mbyllma mua çdo rrugë që shkon kah Xhehenemi. Falmë mua, si në amshim, ashtu edhe në këtë

⁷⁹. Hejthemi, *Mexhmu’-Zenaid*, 10/173 (17058).

⁸⁰. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 5/131 (4849).

⁸¹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/614.

jetë. Bëmë mua prej më të devotshmëve. O Zot, Ti neve na thua: **“Lutmuni Mua, që Unë t’i përgjigjem lutjes suaj.”** (Muminun, 40/60) dhe unë e di se Ti kurrë nuk kthen nga premtimi i dhënë. O Zot, mos ma merr më mbrapsht këtë bukuri kaq të madhe, siç është Islami, që më ke dhënë. E më jep mua mundësinë që të mbetem mysliman deri në ditën që do të më kthesh tek Ti.”⁸²

Lutja e Abdullah bin Abasit (r.a.)

Tregon Said bin Xhubejri (radijallahu anhu): “Tbni Abasi (radijallahu anhu) lutej me këto fjalë:

- “O Zot, të lutem e të përgjërohem, për hir të dritës Sate, që ndriçon këtë rruzull e ata qiej, merrmë mua nën mbrojtjen Tënde të veçantë dhe bë më mua njërin prej atyre që për Ty janë më të afërtit.”⁸³

Lutja e Fedale bin Ubejdit (r.a.)

Tregon Ummu’d-Derdaja (radijallahu anhu): “Fedale bin Ubejdi (radijallahu anhu) thoshte kështu:

- “O Zot! Unë dua që Ti të më bësh mua të jem i kënaqur me kaderin dhe caktimin Tënd dhe të kem një jetë sa më të rehatshme pas vdekjes. Unë dua që ta ndiej sa më thellë bukurinë dhe dëshirën e takimit me Ty. Nuk kam ku të kërkoj mbështetje përveç se te ndihmesa Jote, ndaj vështirësive që mund të më shtyjnë kah kthimi i rrugës dhe ndaj sprovave që mund të më nxjerrin prej besimit tek Ti.”⁸⁴

⁸². Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/308.

⁸³. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 10/294 (17432).

⁸⁴. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 10/280 (17386).

FJALIMET E PROFETIT TË PROFETËVE DHE TË SAHABËVE TË TIJ



1. DISA NGA FJALËT DHE FJALIMET E MBAJTURA PREJ TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Fjala e parë që pati mbajtur i Dërguari i Allahut në Medinë

Tregon Ebu Seleme bin Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu):
“I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u ngrit në këmbë
dhe pasi lëvdoi e falënderoi Allahun, siç e lëvdon një i Dërguar Zotin,
na tha këto fjalë:

- “O njerëz, dërgoni sa më shumë punë të mira për veten në jetën e përtejme.
Ju betohem te Zoti, se nëse ndonjëri prej jush vdes duke bërë titull me të madhe, por
delet i të pa bari, pastaj Zoti i thotë atij, pa kurrfarë pengese e pa përkthyes në
mes: ‘A nuk erdhi ndonjë prej lajmëtarëve të Mi, që të të lajmëronte për mua? A
nuk të dhashë unë ty plaçkë e pasuri? A nuk të dhashë unë ty shumë të mira? Po
mirë, po ti çfarë më ke sjellë mua tani?’

Ai burrë sheh njëherë në të majtë, njëherë në të djathtë, por nuk gjen aty asgjë prej gjëje. Pastaj sheh para vetes dhe nuk sheh asgjë tjetër, pos zjarrit të Xhehenemit.

Andaj, o njerëz, kushdo që ka mundësi ta ruajë trupin e tij prej zjarrit, sikur edhe me një gjysmë hurme, të bëjë çmos e ta ruajë atë. Nëse as kaq nuk ka mundësi ta gjejë, atëherë le të thotë një fjalë të ëmbël, sepse çdo e mirë që bëhet ka për t'u shpërblyer me dhjetë, madje edhe deri me shtatëqindfishin e shpërblimit. Mëshira, begatia dhe paqja e Allahut qofshin mbi ju dhe të Dërguarin e Tij.”¹

Fjala që pati mbajtur i Dërguari i Allahut në fillim të njerit prej muajve të Ramazanit

Na e tregon Selman Farisiu (radijallahu anhu): “I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ditën e fundit të muajit Shaban na pati mbajtur një fjalë të këtillë:

- “O njerëz! Na erdhi ky fat e jemi fatlumë që mbi ne po afrohet hija e një muaji shumë të çmuar, i cili brenda vetes ka një natë sa njëmijë muaj. Muaji i Ramazanit është një pjesë kohe, kur Allahu na e ka shpallur detyrim ditët e tij t'i kalojmë duke agjëruar dhe netët t'i kalojmë duke falur namaze nafile. Të gjitha punët e mira dhe të mbara që kryhen gjatë këtij muaji janë si detyrimet e kryera gjatë muajve të tjerë. Ama, një farz i kryer gjatë këtij muaji është i barabartë me shtatëdhjetë farze të përmbushura gjatë muajve të tjerë. Muaji i Ramazanit është muaji i durimit. Dhe fryti i durimit është parajsa. Kush i shtron iftar një agjëruesi gjatë muajit të Ramazanit, atij i falen mëkatet dhe ai shpëton nga zjarri i ferrit. Atij që shtron iftar i shkruben edhe njëherë sa shpërblimi i atij që ka agjëruar, e agjëruesit nuk i pakësohet asnjë grimcë prej shpërblimit të agjërimit që ka mbajtur.”

- “O Resulullah! Po ne jo gjithmonë mund të gjejmë mundësi për të shtruar iftar me agjërues?” – e patën pyetur të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), – dhe ai u pati thënë:

- “Allahu i Madhërishtëm, këtë shpërblim ia jep si atij që shtron iftar vetëm me një hurmë, si atij që i mundëson ta çelë iftarin me një gllënjë ujë, si atij që ia çel iftarin me një gotë me dhallë. Muaji i Ramazanit fillimin e ka mëshirë, mesin

¹. El-Hindi, *Kenzul-Ummal*, 6/566 (16101).

e ka falje, kurse fundin shpëtim nga dënimet e Xhebenemit, prandaj, kujdesuni që gjatë muajit të Ramazanit t'i bëni medoemos këto katër gjëra: dy prej tyre e kënaqin shumë Zotin tuaj. Kurse dy të tjerat ju e dini edhe vetë që duhet t'i bëni. Dy punët që e kënaqin shumë Allahun janë dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe të kërkuarit prej Tij sa më shumë falje. Kurse dy gjërat që nuk mund të rrini pa i bërë, janë që vazhdimisht t'i kërkonit Allahut që Ai t'ju gëzojë ju me Xhenet, si dhe që t'i luteni e të strehoheni vetëm tek Ai, që t'ju mbrojë ju nga dënimi i ashpër i Xhebenemit. Kush i jep ujë për të pirë një njeriu që ka agjëruar edhe Allahu ka për t'i dhënë atij të pijë nga uji i burimit tim dhe ai që pi nga ai ujë nuk ndien më kurrë etje, gjersa të vijë çasti e të hyjë në Xhenet.”²

Kur i Dërguari i Allahut flet për rëndësinë e veçantë që ka namazi i xhumasë

E tregon Xhabiri (radijallahu anhu): “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na mbajti një hytbe, në të cilën na porositi:

- “O njerëz, pendobuni tek Allahu para se të vdisni. Përpiquni që të bëni sa më shumë vepra e punë të mira, para se të humbisni shëndetin e mirë që keni. Përmendeni sa më shumë Allahun, në mënyrë që të krijoni me Zotin tuaj një lidhje sa më të fortë. Jepni sa më shumë lëmoshë, baptas ose fshehtas, në mënyrë që Allahu t’ju shtojë atë që do t’ju japë; të merrni më shumë prej mirësive të Allahut dhe t’ju plotësohen të tëra mangësitë.

Ta dini mirë, se që në krye të këtij muaji të këtij viti, këtu dhe sot, Allahu jua ka shpallur juve detyrim faljen e namazin të xhumasë. Kushdo që e braktis namazin e xhumasë, duke e nënvlerësuar, apo duke mos i dhënë shumë rëndësi, ende sa jam unë në jetë, apo pasi të kem vdekur unë, qoftë njeri i drejtë, qoftë i padrejtë, për sa kohë që mbi krye të ketë një prijës të vendit, Allahu e bëftë që të mos e shohë me sy rehatinë e mirëqenien; mos i faltë as mbarësi, as begati asnjë prej punëve të tij.

Shikoni, më dëgjoni me kujdes! Atij që e ka braktisur namazin e xhumasë, për sa kohë që nuk pendohet, nuk ka për t’iu pranuar as namazi që fal, as agjërimi që mban, as zekati që jep e as udhëtimi i haxhit. E kushdo që pendohet, Allahu e pranon pendimin e robve të Tij. Shikoni, kurrë asnjë grua të mos dalë imam për burrat. E as beduinët të mos dalin imam për muhaxhirët. E asnjë

². Bejheki, *Shuabul-Iman*, 3/305 (3608).

mëkatar të mos guxojë të dalë imam për besimtarët, përveçse kur atij i kanosen me armë.”³

Fjala që mban i Dërguari i Allahut në Haxhin e Lamtumurës

Tregon Xhabiri (radijallahu anhu): “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi deri në Arafat. Ai u fut dhe qëndroi nën tendën e ngritur enkas për të, që të rrinte në hije e jo në diell. Aty kur dielli filloi të bjerë, ai na kërkoi që t’i sillnim aty devenë e tij të quajtur Kasua dhe sakaq hipi mbi deve dhe u nis. Kur mbërritën në mesin e luginës, ai iu drejtua njerëzve me këto fjalë:

- “Ashtu siç ky vend, ky muaj dhe kjo ditë është e shenjtë, po ashtu të shenjta dhe të paprekshme janë edhe gjaku dhe pasuria juaj. Ju duhet të dini se të gjitha zakonet e këqija, të mbetura nga koha e injorancës janë nën këmbët tona, ne i shlypëm ato. Të gjitha çështjet e gjakut dhe të hakmarrjes janë të zhbëra. I pari gjak që unë po e quaj të zhbërë është gjaku i Rabias, të birit të Harithit. Atë ia patën dbënë fisit të bijve të Sa’dit për ta ushqyer me gj, por Hudhejli e pati vvarë. Ndërsa fajdeja e parë që po zhbëj është fajdeja e Abas bin Abdulmutalibit. U zhbënë që të gjitha.

Për sa u përket grave, unë ju kërkoj që t’u bindeni me përpikëri të gjitha urdhëresave dhe ndalesave të Allahut, sepse secilën prej tyre Allahu ju ka lënë amanet. Me urdhrin dhe lejen e Allahut ju ngritët vatra familjare me to. E drejta juaj tek to është që ato të mos shtrojnë në shtrat askënd tjetër përveç jush, çka ju nuk e doni dhe nuk ju pëlqen. Nëse ato bëjnë diçka të këfillë, atëherë ju mund t’i rribni ato lehtë, pa i lënduar. Kurse e drejta e tyre tek ju është që ju t’u siguronit atyre ushqim dhe veshje si ato me të cilat ushqehet dhe vishet mesi i shoqërisë.

O njerëz! Zoti juaj është Një. Edhe baba një keni. Një arab nuk ka kurrfarë epërsie ndaj joarabit. E as joarabi nuk ka asnjë epërsi ndaj një arabi. Ai që është i zi nuk ka kurrfarë epërsie mbi atë që është i kuq, ashtu siç ai që është i kuq nuk ka kurrfarë epërsie ndaj atij që është i zi. Epërsia matet vetëm me devotshmërinë. Mes jush, më të lartët tek Allahu janë ata që janë më të devotshmit.

Unë do të shkoj te kryet e burimit më përpara dhe do të pres atje që të vini edhe ju. Unë atje do të krenohem me numrin tuaj. Ndaj, mos më lini mua që të

³. Ibn Maxhe, *Sunen*, 1/343 (1081).

turpërohem atje. Disa prej jush unë do t'i shpëtoj, ndërsa disa prej jush nuk do të m'i lënë, do të m'i marrin. Unë atje do të them: 'O Zot, ai është prej sahabëve të mi.', por mua do të më thubet: 'Po ti nuk e di se çfarë ngatërruan ata kur ike ti.' Unë ju kam lënë juve një amanet të veçantë, që nëse ju do të përqafoheni fort pas tij, ju kurrë nuk do të devijoni nga e drejta dhe e vërteta: ai është libri i Allahut, Kur'ani. Ju do t'ju pyesin në ahiret, nëse unë e krevea detyrën time, apo jo, çfarë do të thoni ju atje?'

Të gjithë sa ishin të pranishëm, u përgjigjën njëzëri:

- “Që ti e kumtove fenë e Allahut dhe do të dëshmojmë se ti e kreve pa asnjë të metë detyrën tënde të profetësisë.”

Kur mori këtë përgjigje, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) tha:

- “*Ji Ti dëshmitar o Zot, ji Dëshmitar, o Zot, ji dëshmitar, o Zot!*”⁴

Fjala e mbajtur prej të Dërguarit të Allahut në lidhje me Dexhalin

Këtë na e tregon Sefineja (radijallahu anhu): “I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na u drejtua dhe na foli me këto fjalë:

- “*Nuk ka ardhur para meje asnjë profet, që të mos e ketë paralajmëruar popullin e vet për rrezikun e së keqes së Dexhalit. Syri i tij i majtë është i verbër. Ndërsa në syrin e djathtë ai ka një copë mishi. Mes dy syve ai ka të shkruar se është “Kafir - mohues”. Me vete ai ka dy lugina: njëra është xheneti, ndërsa tjetra është xhebenemi. Në fakt, xheneti i tij është xhebenemi, kurse xhebenemi është xheneti. Bashkë me të janë edhe dy engjëj që u ngajnë profetëve. Kjo është një provë për njerëzit. Dexhali thotë:*

- “A nuk jam unë zoti juaj? Unë vras dhe ringjall.” Njëri nga engjëjt i drejtohet Dexhalit:

- “Gënjeve!”, – e këtë që thotë engjëlli nuk e dëgjon asnjëri nga njerëzit, përveç engjëllit tjetër, i cili i përgjigjet:

- “The të vërtetën!”, – e këtë fjalë e dëgjojnë të gjithë njerëzit. Njerëzit mendojnë se engjëlli e aprovon dhe e pranon Dexhalin.⁵ Edhe

⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 5/148.

⁵. E vërteta e kësaj thënie është ajo se engjëlli i dytë miraton përgënjeshttrimin e engjëllit të parë, ndërsa sprovë qëndron në atë se njerëzit dëgjojnë vetëm miratimin e engjëllit të dytë dhe e keqinterpretojnë si miratim ndaj pretendimit të Dexhalit. Ky është thelbi i vërtetë i sprovës, Allahu na ruajttë me mëshirën e Tij. (shën. red.)

kjo është një sprovë më vete. Pastaj Dexhali ecën deri në Medinë, por kur të mos i lejohej, ai thotë:

- “Ky është qyteti i atij njeriu (duke pasur parasysh Profetin tonë)”
- Pastaj ai shkon deri në Siri duke ecur. Atje, Allahu e shkatërron atë në fshatin e quajtur “Efik”.⁶

Kur i Dërguari i Allahut u flet besimtarëve në lidhje me Jexhuxhin dhe Mexhuxhin

Këtë e përcjell Halid bin Abdullah bin Harmejeja nga tezja e tij, e cila i ka treguar: “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kishte mbështjellë kokën, sepse ishte pickuar nga një akrep, kur na tha:

- *“Ju thoni që nuk ka armiq. Ju do të vazhdoni të luftoni deri kur të shfaqen Jexhuxhi me Mexhuxhin; me fytyrën e mbushur e topolake, sytë e vegjël dhe flokët bojëgështenjë. Ata do të vijnë nga çdo anë e rruzullit tokësor dhe fytyrat i kanë si mburoja; ata i kanë mollëzat të dala.”*⁷

I Dërguari Fisnik u flet besimtarëve për përgojimin

Beraja (radijallahu anhu) e tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na pati folur njëherë aq kumbueshëm, sa që e dëgjuan deri edhe gratë, të cilat ishin nëpër shtëpi. Ai na tha:

- *“O ju që keni besuar me gjuhë, por që me zemër nuk keni arritur dot të besoni! Mos i përgojoni myslimanët. Mos kërkon për turpet e të metat e tyre, sepse kush kërkon të gjejë ndonjë turp të vëllait të vet, Allahu i nxjerr atij në pah turpet e veta. E kujt do që Allahu ia zbulon turpet që ka bërë, ai poshtërohet dhe merr fund deri edhe mu në shtëpinë e tij.”*⁸

I Dërguari Fisnik paralajmëron besimtarët, që ata t’i qëndrojnë larg shoqërimit të Allahut shokë e ortakë

Ebu Musa el-Esh’ari (radijallahu anhu) tregon: “Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) na u drejtua neve me këto fjalë:

⁶. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenaïd*, 7/654 (12517).

⁷. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenaïd*, 8/13 (12570).

⁸. Hejthemi, *Mexhmen’-Zenaïd*, 8/176 (13141).

- “O njerëz, qëndroni sa më larg prej shoqërimit të shokëve a ortakëve në krijim dhe në adhurim Allahut, sepse ai (shirku - shoqërimi dhe ortakëria) është shumë i rrezikshëm dhe është më i fshehtë e më i heshtur edhe sesa zhurma që lëshon hapi i një milingone. Përgjërojeni Allahut, që t’ju ruajë prej rënies në mëkatën e shoqërimit shokë a ortakë ndaj Tij, duke thënë: ‘O Zot, veçse te mëshira jote mund të strehohemi ne e të kërkojmë mbrojtje nga rënia në shirk, me dijeni. Të lutemi, na fal ne kur e bëjmë ndonjëherë këtë mëkat pa e ditur e pa qenë të vetëdijshëm.’”⁹

Një fjalë e të Dërguarit Fisnik në lidhje me falënderimin e Zotit

Na e tregon Numan bin Beshiri (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte ngjitur mbi këtë minber dhe filloi të na fliste e të na thoshte:

- “Ai që nuk falënderon për pak, nuk falënderon as për atë që është shumë. Ata që nuk falënderojnë njerëzit, nuk e falënderojnë as Allahun. Ashtu siç përmendja e mirësive që të ka falur Allahu me mirësinë e Tij, siç edhe dubet, është një falënderim, të mos e bësh këtë do të thotë të tregosh mosmirënjohës. Bashkësia është mëshirë, kurse ndarja prej saj është vuajtje.”¹⁰

I Dërguari Fisnik u flet besimtarëve dhe i këshillon që duhet t’i kërkojnë vetes llogari

Husejn bin Aliu (radijallahu anhu) thotë se e ka parë Profetin (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe dëgjuar duke thënë:

- “O njerëz! Sikur vdekja të ishte e vërtetë vetëm për të tjerët, por jo për ne; sikur e drejta dhe e vërteta të kishte ardhur vetëm për të tjerët, e jo për ne... ne po hamë ato çfarë lanë pas ata që ikën, sikur edhe pak dhe ata që i dërguam në botën tjetër do të kthehen, e sikur ne vetë do të qëndrojmë përjetësisht në këtë botë. I kemi harruar të gjithë ata që na dhanë këshilla të mira dhe po sillemi sikur dikush të na kishte siguruar se ne nuk do të na prekë asnjë e keqe nga ato që kanë për të na ndodhur. Oh sa mirë për ata që nuk gjejnë dot kobë për t’u marrë me të tjerët, ngase janë të zënë duke u marrë me turpet dhe mangësitë e veta! Oh sa mirë

⁹. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 3/1375 (8849).

¹⁰. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/278 (18472).

e sa të lumtur janë të gjithë ata që e fitojnë jetën e tyre nëpërmjet rrugëve të lejuara! Ata që nuk largohen nga rruga e drejtpeshimit! Oh sa lumturi për të gjithë ata që janë të thjeshtë përpara Allahut dhe nuk bien në poshtërsi, që fitojnë në rrugë të lejuara dhe ndajnë prej saj në rrugën e Allahut, ata që janë bashkë me njerëzit e dijes! Oh sa mirë për të gjithë ata që sillen me dhembshuri me të dobëtët dhe të varfrit, që janë nevojtarë, ata që e japin në rrugën e Allahut atë që u tepron nga pasuria e tyre, ata që nuk e kalojnë cakun në të folur, ata që nuk dalin nga rrethi i sunetit të mirë dhe nuk devijojnë në sajesa të paqena.”¹¹

Një fjalë e të Dërguarit të Allahut për rëndësinë e të qenët pjesë e Familjes së Bekuar

Tregon Ebu Saidi: “Unë kam qenë vetë aty dhe e kam dëgjuar, kur i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) qe ngjitur në minber dhe filloi të na thoshte:

- “Çfarë kanë disa, që thonë: ‘Lidhja farefisnore që kemi me Resulullahun nuk ka për të na sjellë kurrfarë dobie në ditën e Kiametit.’ Uallahi, lidhjet farefisnore me mua do të ekzistojnë, si në këtë botë, ashtu edhe në jetën e përtejme. O njerëz! Në ditën e Kiametit unë do të qëndroj te kryet e burimit e do t’ju jap juve të pini prej ujit të tij. Disa do të thonë: ‘O Resulullah! Unë jam filan njeri, i biri i filan njeriu.’ Dhe unë do t’u përgjigjem atij, duke i thënë: ‘Unë e di shumë mirë prejardhjen tuaj. Por, ju, pasi ika unë, u larguat nga rruga ime, u kthyet në rrugën e vjetër.”¹²

Fjalët e të Dërguarit Fisnik që paralajmëronin nëpunësit e mbledhjes së zekatit

Ja se si na e tregon neve këtë Ebu Humejd es-Saidi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pati caktuar dikë si përgjegjës për mbledhjen e zekatit. Ai burrë e kreu detyrën që iu ngarkua dhe kur u kthye pranë Resulullahut, i tha atij:

- “O Resulullah! Këto janë për myslimanët, kurse këto të tjerat m’i dhuruan mua.” Atëherë, i Dërguari Fisnik e pyeti atë:

- “Po mirë, po të kishe ndenjur në shtëpinë e prindërve të tu, a do të t’i kishte

¹¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 3/202.

¹². Ibn Kethir, *Tefsir*, 3/256.

dhënë njeri ndonjërin prej këtyre dhuratave?”

Pas namazit të akshamit, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) lëvdoi dhe falënderoi Allahun dhe tha:

- “Si ka mundësi, që një njeri, të cilin ne e ngarkuam me detyrën e grumbullimit të zekatit të besimtarëve, vjen e na thotë: ‘Këto m’i dhuruan mua.’? Po të kishte ndenjur ulur në shtëpinë e nënës së tij dhe të priste, a do të shkonte kush për t’ia çuar ato dhurata, apo nuk do të shkonte askush? Unë i betohem Allahut, se nëse ndonjëri prej jush vepron në të njëjtën mënyrë, atëherë, në ditën e Kiametit ai do të sillet para të gjithëve me të gjitha gjërat e marra në këtë mënyrë të varura në qafë. Nëse fitimi i tij i padrejtë do të jetë një deve, deveja do të vijë aty duke lëshuar hungërima, nëse është lopë, do të vijë duke pëllitur, nëse është dele do të vijë duke blegëritur. Tani, a jua kumtova?”

Ebu Humejdi thotë se: “Pastaj i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i ngriti krahët të hapura, aq sa i dukeshin sqetullat. Këto që dëgjova unë, i dëgjoi edhe Zejd bin Thabiti (radijallahu anhu), sepse ishte bashkë me mua. Po të doni, mund ta pyesni edhe atë.”¹³

Fjalime të Profetit tonë për çështje të ndryshme

“Kujdesuni, që të mërgoni me besim drejt jetës së përtejme”

Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte mes nesh, kur u ngrit dhe na u drejtua me fjalët:

- “Kush dëshiron që të mbahet larg zjarrit të Xhehenemit dhe të futet në Xhenet, le ta presë vdekjen duke besuar tek Allahu dhe te Dita e Gjykimit. Le të sillet me të tjerët, ashtu siç do që të sillen edhe të tjerët me të.”¹⁴

“Sikur të dinit atë që di unë...”

Enesi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), na u drejtua njëherë dhe na foli siç nuk e kisha dëgjuar kurrë më parë të na fliste, në lidhje me një lajm që kishte ardhur nga sahabët, dhe tha:

¹³. Buhari, *Sahih*, 2/917 (2457).

¹⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 4/122.

- “*Mua m’u treguan, edhe Xheneti edhe Xhebenemi. Unë kurrë nuk kam përjetuar ndonjë ditë si kjo e sotmja për sa i përket së mirës dhe së keqes. Sikur ju të dinit ato që di unë, do të qanit shumë dhe do të qeshnit pak.*” Sahabët nuk kishin kaluar asnjëherë ndonjë ditë më të keqe sesa ajo. Vunë të gjithë duart në kokë dhe qanë me ngashërim.”¹⁵

Fjalë profetike në lidhje me shenjat e besimtarit dhe të mynafikut

E tregon Saib bin Mihxhani nga Damasku: “Kur hyri Omeri (radijallahu anhu) në Siri, fillimisht lëvdoi dhe falënderoi Allahun, pastaj na foli e na këshilloi ne duke na thënë:

- “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) qe ngritur po kështu, siç u ngrita unë dhe na pati mbajtur një fjalim. Pasi na e vuri theksin te ruajtja prej rënies në kundërshti me urdhëresat e Allahut, që ne nuk duhet t’i lëmë pas dore të afërmit tanë, por t’i vizitojmë ata rregullisht, si dhe te pajtimi i njerëzve të hidhëruar me njëri-tjetrin, na tha:

- “*Kurrë mos u ndani prej xhematit. Dëgjojeni atë dhe binduni, sepse mëshira e Allahut është me bashkësinë. Djalli qëndron pranë njeriut të vetëm dhe kur bëhen dy njerëz fillon të largohet. Nuk ndodh që një burrë dhe një grua (të palidhur me njëri-tjetrin me martesë) të jenë vetëm përveçse i treti i tyre është shëjtani. Nëse ju ju gëzoni e mira që bëni dhe ju hidhëron e gabuara, atëherë kjo është një shenjë se ju jeni besimtarë. Kur dikush as nuk mërëzitet nga e keqja që bën, as nuk gëzohet nga e mira që bën, kjo është shenjë e të qenët hipokrit. Mynafiku nuk pret shpërblim prej Allahut për të mirën që bën, e as nuk i frikësohet Allahut kur bën një të keqe. Pasurinë e kësaj bote kërkojeni me rrugë të mira, sepse Allahu është garanti juaj që ka për t’ju dhënë gjithmonë. Çdo punë e gjithsecilit nuk ka dyshim se një ditë do të mbarojë, ndaj ju, në çdo punë tuajën, mos harroni të kërkonti edhe ndihmesën e Allahut. Allahu fshin ç’të dojë dhe lë pa fshirë po ç’të dojë, sepse pranë Tij është Libri Gjithëkapërfshirës.*”

Salavatet, pagja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Profetin Muhamed (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe familjen e tij të bekuar. Es’selamu Alejkum.”¹⁶

¹⁵. Buhari, *Sabih*, 4/1689 (4345).

¹⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/183 (44188).

Fjalët e fundit të të Dërguarit të Allahut

Tregon Ebu Saidi (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u drejtua nga njerëzit dhe tha:

- *“Allahu i Lartësuar e la të lirë robin e Tij të zgjedhë mes Atij dhe kësaj bote. Ai rob zgjodhi të shkojë pranë Zotit.”*

Ebu Bekri (radijallahu anhu), një të dëgjuar këto fjalë, u mbytt në të qara. Ne u habitëm, se ç’kishte këtu që e bëri të qante aq shumë Ebu Bekrin. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kishte folur për zgjedhjen e robit, andaj edhe po qante Ebu Bekri. Vetëm më vonë e mësuam se ai rob kishte qenë vetë i Dërguari i Allahut.”

I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) na tha:

- *“Njeriu që unë i besoj më së shumti, kur vjen puna për te shoqërimi dhe te pasuria, është Ebu Bekri. Nëse do të më duhej të kishta një tjetër mik zemre, përveç Allahut, unë do të zgjidhja Ebu Bekrin. Por, megjithatë ka një miqësi dhe një dashuri si ajo që na urdhëron Islami. Le të mbyllen portat e xhamisë; vetëm porta e Ebu Bekrit të mos mbyllet, ajo le të qëndrojë e hapur.”¹⁷*

Ebu Hurejreja dhe Ibni Abasi (radijallahu anhuma) na tregojnë: “Në fjalën e fundit që u mbajt prej të Dërguarit të Allahut, ne dëgjuam që na tha:

- *“Ai që i fal pesë kohët e namazit me xhemat, do të jetë nga të parët që do ta kapërcejë urën e Siratit dhe atë do ta kalojë me shpejtësinë e vetëtimës. Allahu atë ka për ta ngjallur bashkë me rrethin e parë të brezit të parë që do të vijë fill pas sahabëve. Veç kësaj, çdo ditë e çdo natë për të shkruhet shpërblimi i njëmijë dëshmorëve të vrarë në rrugën e Allahut.”¹⁸*

Gjendja e të Dërguarit të Allahut kur fliste

Tregon Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur fliste, sytë i skuqeshin, ngrinte zërin dhe mbante një qëndrim aq serioz, sa që dukej sikur po lajmëronte një ushtri për rrezikun që i kanosej në mëngjes dhe në darkë. Pastaj, bashkonte gishtin e mesit me gishtin e dëshmisë (gishtin

¹⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 5/229.

¹⁸. Hejthemî, *Mexhmen’-Zenaid*, 2/163 (2143).

tregues) dhe thoshte:

- “Unë u dërgova në një kohë kaq të afërt me Kiametin!” Pastaj vijonte të na thoshte: “Më e bukura rrugë është rruga e Muhamedit; dhe më e keqja punë është të sajosh gjëra të reja në fe. Çdo sajësë është humbje. Kush vdes dhe pas vetes lë pasuri, ajo pasuri i përket familjes së tij. E kushdo që vdes e lë pas borxhe dhe jetimë, kontrollin dhe përgjegjësinë për ta e kam unë.”¹⁹

2. DISA NGA FJALËT DHE FJALIMET E EBU BEKRIT (r.a.)

Fjalimi i mbajtur prej Ebu Bekrit (r.a.) kur bëhet kalif

E tregon Urueja (radijallahu anhu): “Në kohën që në krye të kalifatit u vu Ebu Bekri (radijallahu anhu), ai doli para besimtarëve dhe mbajti një fjalë. Lëvdoi dhe falënderoi Allahun, pastaj tha:

- “O njerëz, në kryet tuaj u zgjodha unë, megjithëse unë nuk jam as më i miri, as më i mbari ndër ju. Mirëpo, Kur’ani është zbritur dhe i Dërguari i Allahut e ka jetësuar sunetin e tij. Ai na ka mësuar ne, se më i devotshmi është edhe më i zgjuari dhe ai që ngre krye ndaj Zotit është më i marri. Për mua më i fuqishmi nga ju është i dobëti që i është bërë padrejtësi, derisa unë t’i kthej atij të drejtën. E më i dobëti ndër ju është ai i fortë që i ka marrë dikujt të drejtën nga dora, prej të cilit unë duhet të marr hakun e të tjerëve.

O njerëz, unë nuk ndjek vetëm se të Dërguarin e Allahut. Ta dini se unë nuk kam për të zbuluar ndonjë rrugë të re. Nëse bëj të mira, më ndihmoni, e nëse ndodh të devijoj nga ajo që është e drejtë dhe e vërtetë, atëherë kujtomëni mua gjithmonë të drejtën e të vërtetën. Këto ishin gjithë sa desha t’ju thosha. Lus Allahun të na falë, si mua, edhe ju.”²⁰

Fjalimi i Ebu Bekrit (r.a.) rreth devotshmërisë dhe përgatitjes për jetën e përtejme

Abdullah bin Ukejmi (radijallahu anhu) tregon: “Ebu Bekri (radijallahu anhu) na mbajti një fjalim, në të cilin na tha:

¹⁹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/377.

²⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 5/839 (14073).

- “Unë ju këshilloj që t’i frikësoheni Allahut, ta lëvdoni Atë denjësisht dhe qëndrimi juaj të jetë diku mes shpresës dhe frikës, si dhe mos harroni që t’i luteni sa më shumë Allahut. Kërkojani Atij me këmbëngulje gjithçka që është në të mirën tuaj, sepse kjo është arsyeja, për të cilën Allahu i Madhërishëm e përgëzoi Zekerijan dhe familjen e tij: **“Ne iu përgjigjëm atij dhe i dhuruam Jahjain, duke ia bërë gruan të aftë (për lindje). Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh.”** (Enbija, 21/90)

Ka edhe diçka tjetër, që duhet ta dini sa më mirë, o rob të Allahut! Allahu jua ka marrë juve peng egot tuaja dhe për këtë ka marrë edhe fjalën tuaj. Dhe, në këmbim të përjetësisë, Ai ju ka kërkuar që t’ju blejë atë që është kalimtare dhe e kufizuar. Kurrë nuk mbaron interpretimi i Kur’anit që ju mbani në duar, e kurrë nuk shuhet drita e tij. Aprovojeni çdo fjalë të tij dhe binduni ndaj urdhëresave të shkruara në të. Përfitoni prej dritës së tij ende sa pa rënë mbi ju errësira e ditëve të errëta. Allahu nuk ju ka krijuar vetëm se për ta adhuruar Atë. E, që të ruajnë çdo bëmë e çdo punë tuajën, Ai ka caktuar edhe dy engjëj shkrues, të cilët shkruajnë gjithçka që ju bëni e veproni.

O robt e Allahut! Ta dini, se ju vazhdimisht jeni nën ndjekjen e pareshtur të exhelit, të cilin ju nuk e dini se kur do t’ju vijë nga mëngjesi deri në mbrëmje...”²¹

Nuajm bin Nemhaja (radijallahu anhu) tregon: “Ebu Bekri (radijallahu anhu), gjatë një fjale të mbajtur para besimtarëve, pati thënë:

- “Nuk ka mbarësi në atë fjalë që nuk thuhet për hir të kënaqësisë së Allahut dhe nuk ka mbarësi në atë pasuri që nuk shpenzohet në rrugën e Allahut. Kurrfarë e mire dhe mbarësie nuk vjen prej atij që krenohet duke thënë se është i ditur. E kurrfarë hairi nuk vjen as prej atij që ka frikë se mos e gjykojnë njerëzit për ato punë që ai i bën për hir të Allahut.”²²

Ebu Bekr bin Muhamed bin Amr bin Hazm (radijallahu anhu)

²¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/35.

²². Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/36.

tregon: “Ebu Bekri (radijallahu anhu) pati folur njëherë para besimtarëve dhe pati thënë: “Profeti i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ka thënë:

- “*Kërkoni ndihmë prej Allahut nga hipokrizia e shfaqjes me përvujtëri.*” Besimtarët, të habitur, e pyetën:

- “E ç’është hipokrizia e të shfaqurit me përvujtëri, o Resulullah?” Dhe, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u tha atyre:

- “*Ai që është i thjeshtë dhe i respektueshëm me trup, por zemrën e ka të mbuluar prej hipokrizisë.*”²³

3. FJALIMET E PRIJËSIT TË BESIMTARËVE, OMERIT (r.a.)

Neve na tregon Sha’biu, se Omeri (radijallahu anhu), pasi u vu në krye të kalifatit, u ngjit në minber dhe u tha besimtarëve:

- “O Zot, zemra ime nuk pranon të rrijë në këtë vend ku deri më tani ka qëndruar Ebu Bekri.” Pastaj zbriti një shkallë më poshtë. Lëvdoi dhe falënderoi Allahun, pastaj tha:

- “Lexojeni vazhdimisht Kur’anin, të jeni sa më të sinqertë me të. Binduni ndaj urdhërësive të tij, të jeni sa më të denjë për të. Peshojeni veten, para se t’ju vënë në peshore në atë ditë. Përgatituni mirë për atë ditë të takimit të madh, kur asnjë anë e juaja nuk do të mund të mbahet e fshehtë ndaj Allahut. Nëse bëhet fjalë për të ngritur krye ndaj Allahut, njeriu nuk duhet t’i bindet asnjë mbreti.

Shikoni; në krye të arkës e thesarit të shtetit unë e vë veten në pozitën e kujdestarit të jetimëve. Që andej nuk do të marr kurrë asgjë më shumë sesa nevojat, se, në të vërtetë, kur jam i detyruar, unë ha në masë të kufizuar.”²⁴

Omeri (radijallahu anhu), gjatë një hutbeje iu qe drejtuar besimtarëve me fjalët:

- “Kërkojini vetes llogari, para se të dilni të jepni llogari përpara Zotit, sepse, nëse ju e bëni këtë, atëherë do ta keni më të lehtë gjykimin në jetën e përtejme. Matini e peshojini vazhdimisht veprat tuaja, ende

²³. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 8/327 (22525).

²⁴. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/191 (44214).

sa pa ardhur ajo ditë e gjykimit të madh, kur asnjë punë e juaja nuk mund të mbahet e fshehtë prej Allahut.”²⁵

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon për babanë e tij, se ai njëherë u ka folur besimtarëve dhe u ka thënë:

- “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ka qëndruar këtu ku po qëndrojnë unë tani dhe ka thënë:

- *“Silluni mirë me sahabët e mi. E të keni sa më shumë respekt e vlerësim për ata që do të vijnë pas tyre e më pas edhe për ata që do të vijnë pas tyre. Do të vijë një ditë dhe do të shtohen shumë ata që gënjëjnë; aq shumë do të gënjëjnë, sa që do të vijnë për të dëshmuar në të rreme edhe kur nuk i thërret askush për të dëshmuar. Kushdo prej jush që kërkon një gradë të mirë në Xhenet, le të mos largohet kurrë prej bashkësisë, sepse djalli është me ata që rrinë vetëm. Kur ata bëhen dy ai stepet pak më mbropa. Askush prej jush të mos rrijë vetëm për vetëm me atë femër, me të cilën i lejohet martesë, sepse, i treti i dy vetëve është djalli dhe ai mund t’i shtyjë ata drejt mëkatit. Nëse të mirat që ju bëni ju bëjnë të lumtur dhe të këqijat ju mërëzitin, atëherë kjo do të thotë se ju jeni besimtarë të vërtetë.”*²⁶

Tregon Abdullah bin Adiji: “Omeri (radijallahu anhu) u ngjiti në minber dhe na tha:

- “Nëse robi është i thjeshtë e modest për hir të Allahut, atëherë Allahu ia lartëson atij shkallët dhe i thotë: ‘Bëj përpara robi im, se Allahu do të të nxjerrë ty fitimtar!’ Edhe pse e sheh veten si të vogël, në sytë e njerëzve ai është shumë i vyer. Nëse një njeriu fillon t’i pëlqejë vetja për gjithë ato të mira që i ka falur Allahu dhe fillon të ndryshojë qëndrim ndaj gjithçkaje, Allahu e rrëzon atë poshtë e më poshtë, duke i thënë: ‘Aty të rrish ti, aty e ke vendin!’ Megjithëse ky njeri e sheh veten me të madh, në sytë e njerëzve ai është shumë i vogël. Madje, në sytë e njerëzve ai është më i poshtër edhe se një derr!’”²⁷

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: “Gjatë një hutbeje Omeri (radijallahu anhu) po na fliste neve në lidhje me dënimin e rexmhit (goditja me gurë), kur na tha:

- “Për sa i përket rexmhit, kujdes, mos u mashtroni nga askush. Ky është një nga dënimet e kalimit të caktuar, të cilin e ka vendosur

²⁵. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/188 (44203).

²⁶. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/18 (114).

²⁷. Bejheki, *Shuabu’l-Iman*, 6/275 (8139).

Allahu. Kujdes, këtë dënim e ka zbatuar i Dërguarit i Allahut. Pas tij e kemi zbatuar edhe ne. Nëse sot unë nuk do të isha i shqetësuar se njerëzit do të thonë: ‘Omeri shtoi në Librin e Allahut një dënim që nuk është i shkruar në të.’ do ta kisha shënuar atë diku në një anë të lidhjes së Kur’anit. Do të shkruaja: ‘Omer bin Hatabi, Abdurrahman bin Aufi, filan dhe filan njeri; e kanë parë vetë që i Dërguari i Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem) e ka zbatuar rexhmin. Pas tij atë e vumë edhe ne në zbatim. Dua t’ju bëj me dije, se pas jush do të dalin shumë njerëz, të cilët do t’i mohojnë, rexhmin, Dexhalin, ndërmjetësimin e të Dërguarit të Allahut, dënimin e varrit dhe se disa prej myslimanëve mëkatarë do të nxirren prej Xhehenemit.’”²⁸

Said bin Musejebi (radijallahu anhu) tregon: “Omeri (radijallahu anhu), pasi zbriti nga Minaja, u ndal në vendin e quajtur Ebtah për të bërë pak pushim. Bëri një si trup me rërë, e uli një pjesë të rrobës mbi rërë dhe pasi u shtri aty me shpinë, i ngriti duart nga qielli dhe u lut:

- “O Zot, shumë ka përparuar mosha ime; fuqitë më kanë lënë dhe njerëzit për të cilët jam përgjegjës janë shtuar shumë. Merrma mua shpirtin, o Zot, e merrmë mua pranë Teje, ende sa pa u ndodhur atyre ndonjë e keqe prej meje dhe para se unë të bëj pa dashje ndonjë gabim ndaj ndonjërës prej urdhëresave të Tua.”²⁹

4. FJALIMET E OSMANIT (r.a.)

Ebu Suhejl bin Maliku (radijallahu anhu) ka përcjellë nga i ati dhe na tregon se Osmani (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Mos i detyroni fëmijët e vegjël për të fituar para. Nëse ju i detyroni ata për diçka të tillë, atëherë ata do të vjedhin. Edhe shërbyeset e robinjat që nuk kanë asnjë zanat, mos i detyroni për fitime të mëdha. Nëse ju do t’i detyroni ato, atëherë nuk keni bërë gjë tjetër veçse i keni shtyrë ato drejt imoralitetit. Ruajeni ju nderin dhe ndershmërinë tuaj, që edhe Allahu t’ju shkruajë ju prej të ndershmëve të afërt me Të. Ato që do të hani të jenë të pastra dhe vetëm prej atyre që ju janë lejuar.”³⁰

²⁸. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/23 (156).

²⁹. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/334.

³⁰. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 9/355 (25647).

Bedr bin Osmani (radijallahu anhu) ka përcjellë prej xhaxhait të tij dhe ka treguar se: “Osmani (radijallahu anhu), në hutben e tij të fundit ka thënë:

- “Allahu jua ka dhënë këtë botë që ju të fitoni jetën e përtejme, e jo që ju të mbeteni të fiksuar pas saj! Kjo botë është kalimtare dhe e përkohshme, ndërsa ahireti është i përjetshëm. Të mos ju llastojnë e të mos jua rrisin mendjen të mirat kalimtare të kësaj bote dhe t’ju largojnë nga jeta e përtejme. Shikoni që të zgjidhni atë që është e përjetshme, e jo atë që është kalimtare dhe e përkohshme. Jeta e kësaj bote një ditë do të mbarojë dhe të gjithë do të kthehen para Allahut. Përpiquni të hyni nën mbrojtjen e Allahut, sepse, të hysh nën mbrojtjen e Allahut, duke iu frikësuar Atij, është jo vetëm një mburojë shumë e mirë ndaj fatkeqësive që mund t’ju vijnë prej Tij, por edhe një mjet shumë i mirë për të arritur kënaqësinë dhe pëlqimin e Tij. Kurrë mos e harroni Allahun në sjelljet tuaja me të tjerët. Mos u largoni asnjëherë prej xhematit e mos u shndërroni në grupe që i kthejnë shpinën njëri-tjetrit.”³¹

5. DISA LIGJËRIME TË ALIUT (r.a.)

Ali bin Husejni (radijallahu anhu) tregon: “Pak pasi ishte vënë në krye të kalifatit, Aliu (radijallahu anhu) mbajti hutben e parë, në të cilën, pasi lëvdoi dhe falënderoi Allahun dhe emrat e Tij, tha:

- “Allahu ka zbritur një libër që shërben si udhërrëfyes dhe e ndan të mirën nga e keqja. Për këtë arsye, ju përpiquni të bëni sa më shumë të mira dhe të hiqni dorë nga e keqja. Përmbushini të tëra detyrimet që ju janë vendosur prej Allahut, që edhe Allahu t’ju fusë ju në parajsën e Tij.

Allahu i ka shpallur të ndaluarat në një mënyrë që t’i kuptojnë të gjithë. Gjakun e myslimanit Ai e ka shpallur si të ndaluar mbi çdo të ndaluar tjetër. Myslimanët janë të lidhur fort pas njëri-tjetrit, me sinqeritet dhe bashkim zemrash dhe shpirttrash. Mysliman do të thotë njeri, nga dora dhe goja e të cilit nuk i vjen askujt asnjë dëm, përpos rasteve kur ai duhet të bëjë drejtësi. Dhe një mysliman nuk mund ta

³¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/216.

mundosh e nuk mund t'i shkaktosh vuajtje më shumë sesa mund të meritojë.

Përpiquni për të mirën e të gjithë myslimanëve. Bëhuni gati për vdekjen, sepse ju e shikoni të vërtetën e vdekjes. Pas shpinës suaj rreh pa ndërprerje tik-taku i orës së Kiametit. Bëjeni sa më të lehtë barrën e kësaj bote, të jeni bashkë me shokët tuaj në përjetësi. Ata që kanë kaluar përpara në ahiret rrinë e presin për ata që do të vijnë. Bëni shumë kujdes, që të mos bini ndesh me Allahun në marrëdhëniet tuaja me njerëz të tjerë e që vijnë nga qytete të tjera. Ju jeni përgjegjës deri edhe për kafshët që jetojnë në territorin tuaj. Lutjuni Allahut dhe mos ngrini krye ndaj urdhëresave të Tij. Nëse shikoni që po kryhet një punë e mirë, pranojeni atë; nëse shikoni që po kryhet një punë e keqe, atëherë braktiseni menjëherë atë. Këtë mos e harroni kurrë: **‘Dhe kujtohuni kur ishit pak në numër, ishit të dobët në Tokë...’**^{32,33}

Tregon Alkameja: “Aliu na pati mbajtur neve njëherë një hutbe, në të cilën na pati thënë:

- “Kam dëgjuar se disa më shohin mua më lart sesa Ebu Bekrin dhe Omerin (radijallahu anhum). Nëse unë do t’jua kisha ndaluar më parë diçka të këtyllë, nuk ka dyshim se tani do t’i dënoja shumë ashpër të gjithë ata që e mendojnë diçka të këtyllë. Por, duke qenë se unë nuk kam shpallur një ndalesë të këtyllë, e kam të pamundur që t’i dënoj. E, nëse ndokush vazhdon ta mendojë e ta shprehë një mendim si ky a të ngjashëm me të, ta dijë se ai do të ketë bërë një shpifje dhe ai do të ndëshkohet me të njëjtin dënim që ndëshkohen edhe shpifësit. Pas të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), më i miri e më i mbari ndër njerëz është Ebu Bekri (radijallahu anhu); pastaj vjen Omeri (radijallahu anhu). Pas tyre ndodhën ca ngjarje të atilla, për të cilat do të vendosë Allahu si të dojë Ai.”³⁴

6. NJË FJALIM I MBAJTUR NGA PRIJËSI I BESIMTARËVE, HASANI (r.a.)

Hubejreja (radijallahu anhu) tregon: “Kur vdiq Aliu (radijallahu

³². Enfal, 8/26.

³³. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/228.

³⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/127 (1051).

anhu), Hasani shkoi, u ngjit në minber dhe mbajti këtë fjalë:

- “O njerëz! Sonte vdiq një njeri i atillë, që vështirë të vijë më si ai në këtë botë. Sa herë që i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e dërgonte atë në ndonjë vend, atë e shoqëronin, në të majtë Xhibrili i Besuar dhe në të djathtë Mikaili (alejhis’selam), e nuk e linin vetëm për asnjë çast, gjersa ai të dilte fitimtar. Veç shtatëqind dërhemëve, që i kishin tepruar nga paga që merrte, ai nuk la asgjë tjetër si trashëgim. Edhe me to, donte të merrte e të paguante dikë për shërbim. Shpirti i tij i dëlirë shkon tek Allahu sonte, në këtë natë të njëzeteshtatë të muajit Ramazan, e njëjta natë kur u ngjit drejt Zotit edhe shpirti i Isait, të biri të Merjemit.”³⁵

7. NJË FJALIM I PRIJËSIT TË BESIMTARËVE, MUAUIJE BIN EBI SUFJANIT

Tregon Muhamed bin Ka’b el-Kuradhij (radijallahu anhu): “Njëherë, teksa po mbante hutben i ngjitur mbi minber, Muauije bin Ebi Sufjani tha:

- “O njerëz! Askush nuk mund ta ndalojë diçka që e jep Allahu. E askush nuk ka fuqi që të japë atë që nuk do që ta japë Allahu. Asnjë zotërues fuqie nuk mund të krahasohet dot me forcën dhe fuqinë e Tij. Ai, për të cilin Allahu dëshiron më të mirën e të mbarën, përsoset në fe dhe bëhet njohës shumë i mirë i saj.” Këto fjalë që po ju them, unë i kam dëgjuar vetë nga i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur i ka thënë, ja, i ngjitur mu mbi këtë minber.”³⁶

8. FJALIMET E SAHABËVE TË TJERË

Fjala e Abdullah bin Mesudit

Tregon Ebu Uaili (radijallahu anhu): “Kur kalif, në krye të të gjithë besimtarëve u vendos Osmani (radijallahu anhu), Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) erdhi nga Medina në Kufe brenda tetë ditëve. Atje ai u mbajti njerëzve një fjalim, në të cilin, pasi lëvdoi dhe falënderoi

³⁵. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/38.

³⁶. Ibn Haxher, *Fet’hu’l-Bari*, 2/332.

Allahun, tha:

- “Unë dua që ta dini: Omeri (radijallahu anhu) ka vdekur. Deri më sot unë nuk kam parë ndonjëherë njerëz që të qajnë siç qanin atë ditë. Ne u mblodhëm të gjithë, si sahabë të Resulullahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe nuk gabuam në zgjedhjen e atij që është më i virtytshmi dhe më i vyeri ndër të gjithë ne si të Parë të të gjithë Besimtarëve të Osmanit (radijallahu anhu). Ne lidhëm besën me të, ndaj dua që edhe ju të lidhni besën me të.”³⁷

Fjala e Utbe bin Gazuanit

Halid bin Umejr el-Adeuija (radijallahu anhu) tregon: “Utbeja, në kohën që ishte vali i Basrës, na pati mbajtur një fjalim, në të cilin na pati thënë:

- “Ju po largoheni nga kjo botë dhe po mërgoni drejt botës së amshimit, ku ju pret përjetësia... Bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ne ishim shtatë vetë. Nuk kishim se ç’të hanim, ndaj hanim gjethe nga të pemëve. Siç duket, ato gjethe po na i bënin gojët plagë. Ishin ditë të vështira, por unë gjeta një rrobë. Gjysmën ia dhashë Sa’d bin Malikut, ndërsa gjysmën tjetër e mbajta për vete. Pjesën time e ktheva në izar (mbulesë në mes e poshtë), ndërsa tjetrën e përdori Sa’di për vete, duke e bërë izar. Kurse sot, sot jemi që të dy vali në vende të ndryshme. Nuk kam se ku të kërkoj mbrojtje, prej të parit të vetes me të madh, duke u bërë i vogël dhe i pavlerë në sytë e Allahut, përveçse te mëshira e Allahut.”³⁸

Një fjalim i Hudhejfe bin el-Jemanit

Këtë e tregon Ebu Daud el-Ahmedi: “Në Medain, Hudhejfeja (radijallahu anhu), njëherë, na qe drejtuar me fjalët:

- “O njerëz, bëni kujdes se me çfarë punësh merren sklevërit tuaj. Mësojini mirë se nga i nxjerrin ato fitime, prej të cilave vijnë dhe ju paguajnë juve tagra, sepse një trup që ushqehet me të ndaluarën nuk

³⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/63.

³⁸. Muslim, *Sahih*, 4/2278 (2967).

mund të hyjë në Xhenet. Edhe këtë ta dini mirë, ai që shet, që blen, apo që e mban verën në dorë është po aq përgjegjës sa ç'është edhe ai që e pi atë.”³⁹

Një fjalë e Ebu Musa el-Esh'arit

Na e tregon Kasame bin Zuhejri (radijallahu anhu): “Ebu Musa el-Esh'ari (radijallahu anhu) doli përpara njerëzve në Basra dhe iu drejtua atyre me këto fjalë:

- “O njerëz, qani, edhe nëse nuk qani dot, atëherë detyrojeni e bëjeni veten të qajë. Se banorët e Xhehenemit kanë për të qarë derisa do t'u thahen kanalet e lotit. Pastaj do të fillojnë të lotojnë gjak. Aq shumë do të lotojnë, saqë gjaku i pikuar do të bëhet aq shumë, sa mbi të do të mund të lundronte anija.”⁴⁰

Një fjalë e mbajtur nga Umejr bin Sa'd

Said bin Suejdi (radijallahu anhu) tregon: “Njëri prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Umejr bin Sa'di (radijallahu anhu), gjatë kohës që ishte vali i Humusit, qe ngjitur njëherë mbi minber dhe i qe drejtuar besimtarëve vendas me fjalët:

- “Shikoni, Islami është një mur i fortë dhe i qëndrueshëm, porta e të cilit është e pamundur që të rrëzohet. Ky mur i fortë dhe i qëndrueshëm i Islamit është drejtësia, kurse porta është e drejta dhe e vërteta. Nëse plasaritet ky mur dhe dikush shpërthen portën e tij, atëherë Islami bie nën kularin dhe urdhrat e të tjerëve. Për sa kohë që i Pari i shtetit është i fortë dhe i drejtë, askush nuk mund ta rrëzojë Islamin dhe ai do të jetë aty, i palëkundur. Forca e sulltanit dhe të parit të shtetit nuk qëndron te shpata dhe te këmba, por te zbatimi i së drejtës dhe sjellja me drejtësi karshi të gjithëve.”⁴¹

³⁹. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 4/244 (9862).

⁴⁰. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/110; Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/261.

⁴¹. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/375.

KËSHILLA NGA I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ



1. KËSHILLA NGA I DËRGUARI I ALLAHUT

Ebu Dherri (radijallahu anhu) na tregon: “E pyeta njëherë të Dërguarin Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem):

- “O Resulullah! Çfarë përmbanin faqet që iu zbritën Ibrahimit (alejhis’selam)?” Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi të) m’u përgjigj duke më thënë:

“Të gjitha faqet që i erdhën Ibrahimit përmbanin këshilla me shembuj. Për shembull, njëra syresh ka qenë edhe kjo: ‘O sundimtar mendjemadh, që ty t’u ngarkuan përgjegjësitë! Po unë ty nuk të dërgova në atë botë, që ti të mbledhësh e të grumbullosh as plaçkë, as pasuri! Unë ty të kam dërguar që ti të dëgjosh klithmat e vajtimet e të dobëtëve, të cilëve u është hyrë në të drejtë, e t’i qetësosh ata për mallkimet që më së shumti bëjnë, sepse Unë kurrë nuk e kthej pas atë lutje që prej njeriut që i është bërë e padrejtë vjen, edhe nëse ai prej kryengritësve ndaj Meje është. Njerëzit e zgjuar, që nuk bien pre e lojës së egos së tyre, e ndajnë ditën e tyre në copëza kobe të caktuara: Para së gjithash, njeriu duhet të ketë një kohë kur

vetëm për vetëm me Zotin e tij të qëndrojnë, e veçmas një tjetër kohë që Atij lutje t'i drejtojnë. Dubet një orë tjetër, kur ai me veten e vet llogaritë të bëjë. Ai dubet të ketë edhe një orë kur të meditojë për artin e gjithçkaje, që vetëm Allahu e ka krijuar. Po ashtu, ai dubet të ndajë një pjesë të kohës për të siguruar ushqim e gjithçka për të përmbushur nevojat e tij. E veç këtyre, ja se cilat janë edhe disa gjëra të tjera, që, njeriu i zgjuar, dubet t'i bëjë medoemos: Të përgatisë diçka për amshimin, të përpiqet për jetesën e të mjaftohet vetëm me ato kënaqësi që ia kam lejuar Unë. Njeri i zgjuar është ai që e ka kuptuar mjaft mirë kohën, i ka zbuluar dhuntitë e veta dhe di si ta kontrollojë gjuhën, e të flasë pak dhe asgjë tjetër, përveç atyre gjërave që janë të lidhura me të.”

E, kur e pyeta:

- “Po në faqet që iu dërguan Musait (radijallahu anhu), çfarë kishte?” Ai më tha:

- “*Ishin të gjitha mësimet*.”, — e vazhdoi të më fliste rreth tyre: “*Habitem me të gjithë ata që, megjithëse e dinë se shumë shpejt do të vdesin, dhe kjo nuk ka pikë dyshimi, e prapë jetojnë fare të qetë e me mendjen të rritur e të fryrë. Besojnë plotësisht se ka një Xhehenem, e, prapëseprapë, qeshin dhe kjo më bën habi. Besojnë te kaderi, e habitem, ata qajnë dhe i ankohen vetes për veten e tyre. E shobin dhe janë vetë dëshmitarë, se në këtë botë gjithçka është e detyruar të ndryshojë dhe shndërrohet nga njëra kohë në tjetrën, e ata, prapëseprapë, arrijnë të gjejnë qetësi; habitem. Habitem, se megjithëse e dinë shumë mirë, se, nesër, do të vijë ajo ditë e gjykimit të madh, e ata nuk bëjnë kurrfarë përgatitjeje me sjelljet dhe punët e tyre që ta kenë kur të vijë ajo ditë.”*¹

2. KËSHILLA NGA OMERI (r.a.)

Omeri (radijallahu anhu) e pati këshilluar një burrë:

- “Qëndrimi me njerëzit mos të të pengojë në kryerjen e detyrave të tua, sepse ti je përgjegjësi i vetëm për ato që duhet të bësh; nuk janë ata. Ditët mos i kalo pa bërë asgjë, sepse çdo gjë që ti bën është duke u regjistruar. Kur ti bën diçka të keqe, pas saj bëj menjëherë diçka të mirë, sepse rruga më e shkurtër dhe më e shpejtë për të bërë që të të falet një mëkat i bërë më parë, është ajo e të bërit një të mirë

¹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/166.

menjëherë pas saj.”²

Muhamed bin Shihabi (radijallahu anhu) na ka treguar: “Omeri (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Mos u merr me ato punë që nuk kanë të bëjnë me ty. Qëndro sa më larg armiqve. Besoju vetëm miqve që janë të sigurt, sepse vendi dhe rëndësia e njeriut të besueshëm nuk matet e nuk zëvendësohet me asgjë e askënd. Mos u bëj shok me atë që është i shthurur; në të kundërt veset e këqija të tij do të të ngjiten edhe ty. Kurrë mos ia trego atij të fshehtat e tua. E kur të kesh nevojë të këshillohesh me ndokënd për ndonjë punë, zgjidh më mirë besimtarët që kanë respekt për Allahut dhe që zemrën e kanë plot ndjesi frike e turpi ndaj Tij.”³

Ja se si na tregon Ahnef bin Kajsi (radijallahu anhu): “Omeri (radijallahu anhu) më tha:

- “Shiko, Ahnef, ata që qeshin shumë në mesin e njerëzve nuk janë shumë të respektuar në shoqëri. Ata që bëjnë shumë shaka e humbin peshën e tyre dhe të gjithë fillojnë t’i nëpërkëmbin. E ai që flet shumë edhe gabimet i ka të shumta. Ai që gabon shumë e humbet ndjenjën e turpit e të ndrojtjes. E kushdo që nuk ka ndrojtje, bëhet i shthurur. Dhe të shthururit nuk kanë botë shpirtërore, sepse atyre u vdes çdo aftësi e ndijimit shpirtëror.”⁴

Omeri (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Ka disa rob të Allahut, të cilët e braktisin çdo punë të kotë, aq sa duket sikur ato nuk ekzistojnë më për ta. Ata e përmendin jashtëzakonisht shumë të drejtën e të vërtetën, aq sa këto gjallërohen dhe bëhen edhe më të forta. Nëse i fton ata drejt së drejtës dhe të së vërtetës, ata përgjigjen menjëherë; nëse u kërkohet që t’ia mbathin nga e kota dhe e rremja, ata ia mbathin kilometra e kilometra larg. Me dritën e largpamësisë që fitojnë sytë e tyre ata arrijnë të shohin edhe ato të vërteta që nuk i sheh syri. Shpëtimtarja e tyre ka për të qenë frika nga Allahu. Mes së përjetshmes dhe së përkohshmes ata zgjedhin atë që është e përjetshme. Ata edhe jetën e kanë mirësi të Zotit, ashtu siç vdekja e tyre është nderim. Ata do të martohen me huritë e Xhenetit,

². El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/187 (44202).

³. Ebu Nu’ajm, *Hiqe*, 1/55.

⁴. Hejthemî, *Mexhmen’-Zeuaid*, 10/542 (18173).

gjithandej do të kenë djelmosha shërbyes, të cilët do të lëvizin sa nga një vend në një tjetër, për t'u shërbyer atyre sa më mirë në përjetësi.”⁵

3. KËSHILLAT E ALIUT (r.a.)

Tregon Ukbe bin Ebu Sahbaja: “Në kohën që Aliut (radijallahu anhu) iu bë atentati nga ai njeri i quajtur Ibni Mulxhem, djali, Hasani (radijallahu anhu) erdhi tek i ati duke qarë. I ati i tha atij:

- “Po pse po qan, o bir?”

- “E si të mos qaj, o baba. Ti tanimë je duke jetuar çastet e fundit të kësaj bote dhe çastet e para të jetës së amshuar.”, – u përgjigj Hasani (radijallahu anhu). Aliu (radijallahu anhu) e dëgjoi dhe i foli të birit dhe e këshilloi:

- “Shiko, biri im; nëse do t'i ndjekësh me përpikëri të dyja këto katërshe me këshilla që do të të jap, ti çfarëdo që të bësh, nuk do të pësosh asgjë: Nuk ka pasuri dhe trashëgimi më të madhe sesa mendja. Nuk ka varfëri e fukarallëk më të madh sesa budallallëku. Nuk ka tmerr më të madh sesa mendjemadhësia e kur fillon e të pëlqen vetja; me një fjalë, kur njeriu fillon e pëlqen ato që bën vetë dhe i konsideron ato si më se të mjaftueshme. Ashtu siç edhe nuk ka nder e nderim më të epërm sesa morali i mirë.”

Hasani (radijallahu anhu) e pyeti se cilat ishin katër këshillat e tjera, e Aliu (radijallahu anhu) iu përgjigj duke i thënë:

- “Kurrë mos bëj shoqëri me budallenjtë, sepse ai që është budalla, edhe kur do që të jetë i dobishëm për ty, të sjell më shumë dëme sesa dobi. Kurrë mos u bëj shok me një gënjeshtar, sepse shoku që është gënjeshtar, jo vetëm që do të largojë prej teje edhe ata që janë afër teje, por edhe do të të afrojnë me ata që qëndrojnë larg teje. Kurrë mos u bëj shok me një koprrac, sepse njeriu që është koprrac e dorështrënguar do të largohet prej teje pikërisht atëherë kur ti ke më së shumti nevojë për të. Kurrë mos u bëj shok me ata që e kanë kthyer shthurjen në ves, sepse, ata, mes teje dhe gjërave të pavlera do të zgjedhin gjërat e pavlera.”⁶

⁵. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/55.

⁶. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 16/257 (44388).

4. KËSHILLAT E MUADH BIN XHEBELIT

Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) thotë:

- “Kushdo që i bën këto të tria, ai do të përballet me ndëshkimin e ashpër të Allahut: qesh, kur nuk ka asgjë të çuditshme ose për të qeshur; fle, edhe pse nuk i vjen gjumë e është i fjetur; ha, edhe pse nuk është i uritur.”⁷

Muadh bin Xhebeli (radijallahu anhu) thotë:

- “Ju u sprovuat me gjithfarë vështirësish dhe duruat. Në një të ardhme të afërt, ju do të sprovoheni edhe me pasurinë dhe bollëkun. Ajo që më bën të shqetësohem më shumë për ju është se mos ju viheni në provë me gratë. Me ato gra, që, kur i mbushin kyçet e dorës me byzylykë floriri dhe argjendi dhe vishen me veshje mëndafshi të qepura në Damask dhe Jemen, të kamurin e lodhin, kurse atë që është i varfër e detyrojnë që të futet në shpenzime që ata nuk mund t'i përballojnë dot.”⁸

5. KËSHILLAT E ABDULLAH BIN MESUDIT

Ja se çfarë thotë Ibni Mesudi (radijallahu anhu):

- “Asnjë nga ju të mos bëhet konformist!” – E kur e pyetën Ibni Mesudin (radijallahu anhu) se kush quhet parazit, ai u përgjigj:

- “Konformist është ai që thotë: ‘Unë jam bashkë me njerëzit. Nëse ata janë të udhëzuar, atëherë edhe unë do të ndjek rrugën e drejtë. Por, nëse ata devijojnë e bien në humbje, atëherë edhe mua më duhet që t'i ndjek pas në humbje.’ Shikoni, më dëgjoni me kujdes: ‘Forcojeni besimin tuaj aq shumë, saqë edhe sikur të gjithë njerëzit të mohojnë, ju prapë të qëndroni në këmbë e të palëkundur si besimtarë.’”⁹

Në një këshillë tjetër, që u ka dhënë besimtarëve, Ibni Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Allahu, në ahiret, do t'ua tregojë të gjithë njerëzve, një e nga një, të gjithë ata që kanë qenë dyfytirësh në këtë botë. Ai do t'ua bëjë të

⁷. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/237.

⁸. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/236.

⁹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/136.

ditur të gjithë njerëzve, të gjithë ata që e bënë ndonjë gjë për t'u dukur sa më mirë në sytë e njerëzve dhe që shkonin e i njoftonin të gjithë për veprën e tyre. Allahu i poshtëron të gjithë ata që zgjatin qafën për të treguar se janë të mëdhenj. Kurse ata që, nga respekti që kanë për Allahun, janë të thjeshtë e modestë, Allahu i lartëson drejt gradëve më të larta.”¹⁰

6. KËSHILLA NGA SELMAN FARISIU

Selmani (radijallahu anhu) thotë se:

- “Nëse Allahu dëshiron të keqen për një njeri, Ai e privon atë nga ndjenja e zorit dhe e turpër. E ti do ta dallosh menjëherë, që atë e ka goditur ndëshkimi i Allahut. Nëse dikë e prek ndëshkimi i Allahut, atij i hiqet ndjenja e keqardhjes dhe të gjithë mund të shohin se ai është një njeri i egër, pa mirëkuptim dhe keqardhje. Atij i merret besueshmëria, e amanetit, e ai shëtit lart e poshtë i shndërruar në një tradhtar të hapur. Këtij lloji tradhtari i shkëputet çdo lloj lidhjeje me Islamin, gjersa ai kthehet edhe në një njeri të mallkuar, edhe në një njeri, të cilin e urrejnë të gjithë.”¹¹

Tregon Jahja bin Saidi (radijallahu anhu): “Ebu'd-Derdaja (radijallahu anhu) i shkroi një letër Selman Farisiut (radijallahu anhu), për ta ftuar në tokat e shenjta. Selman Farisiu iu përgjigj atij po me një letër, në të cilën i thoshte:

- “Nuk është as toka, as hapësira, që e afrojnë njeriun me të shenjtën, apo që e pastrojnë. Njeriun e bëjnë më se të pastër vetëm e vetëm veprat e tij. Me sa kam dëgjuar, ti je zgjedhur kadi aty. Nëse ti je i dobishëm për ata që vijnë tek ti, atëherë kjo po që është më e mira për ty! Në të kundërt, nëse nuk e bën dot siç duhet atë punë dhe bën si ata njerëzit që pretendojnë se janë doktorë, atëherë këshilla ime është që të ruhesh nga vrasja e njerëzve dhe nga rënia në humnerat e Xhehenemit.”

Pas leximit të kësaj letre, Ebu Derdaja, sa herë që kishte ndonjë gjyq me njerëzit, u kërkonte atyre që u jepte vendimin të ecnin pak

¹⁰. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/138.

¹¹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/204.

përpara dhe i shihte nga pas se si ecnin, e thoshte me vete: “Uallahi ky ecën me të madh, njësoj si ata që pretendojnë se janë doktorë.” Sakaq, drejtohej edhe njëherë nga i ankuari dhe i kërkonte që t’ia shprehte edhe njëherë ankesën e tij.”¹²

7. KËSHILLA NGA EBU'D-DERDAJA

“Mos u jepni njerëzve detyra që i kapërcejnë fuqinë dhe aftësitë e tyre. Dhe mos u ngrini e t’u bëni atyre gjyqin para se t’ua bëjë Allahu i Madhërishëm. O i biri i Ademit! Ti shiko veten tënde, sepse mërzia dhe vuajtja e atyre që ankohen e kritikojnë çdo qëndrim e çdo sjellje të njerëzve nuk mbaron kurrë.”¹³

“Adhurimin bëjeni sikur të jeni duke parë Allahun. Asnjëherë mos e hiqni vdekjen nga mendja. Se, që ta dini ju, pak mall e pasuri që do t’ju mjaftonte për këtë botë është shumë herë më e mirë dhe e mbarë sesa pasuria dhe plaçka e madhe që do t’ju nxirrte nga rruga e drejtë. E po ashtu, ta dini mirë, se të mirat e bëra nuk harrohen kurrë, ashtu siç edhe mëkatet nuk mbeten pa një çmim që duhet paguar.”¹⁴

“Ti nuk do të bëhesh i hairit meqë ke shumë pasuri e shumë fëmijë. Mirësi e mbarësi e vërtetë është që të jesh sa i butë, aq edhe i ditur; ta adhurosh Allahun, aq shumë, saqë të garosh me njerëzit. Kur të bësh mirë, ta lëvdosh Allahun dhe t’i drejtohesh Atij me pendesë e duke i kërkuar falje, sa herë që bën diçka të keqe.”¹⁵

Një ditë, Ebu Derdaja (radijallahu anhu) u drejtua nga besimtarët dhe u foli:

- “O popull i Sirisë! Po juve a nuk ju vjen aspak turp? Mblidhni e mblidhni pasuri, sa nuk keni mundësi që t’i hani dhe ndërtoni shtëpi, në të cilat nuk do të banoni kurrë. Kohën e kaloni duke gënjyer veten me uri e plane për të ardhmen tuaj. Edhe ata që erdhën përpara jush mblidhnin pasuri, e ruanin, kalonin kohën duke thurur plane për të ardhmen, e të gjitha ëndrrat iu kthyen në zhgënjime boshe dhe shtëpitë

¹². Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/205.

¹³. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/211.

¹⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/212.

¹⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/212.

iu bënë si varre. Shikoni pasuritë e popullit të Adit po të doni, pasuritë që stivuan mes Adenit dhe Omanit dhe fëmijët e tyre të shumtë dhe nxirrni mësim. Tani, kush nga ju m'i blen mua të gjitha çfarë la populli i Adit për dy dërhemë?"¹⁶

"Gjithë çfarë keni tuajën në këtë botë, dikur më parë i ka takuar dikujt tjetër. Edhe pas teje, ajo do t'i takojë dikujt tjetër. Të tuat mbeten vetëm ato që ke bërë dhe ke dërguar në jetën e përtejme. Pasurinë përpiku që t'ua lësh fëmijëve të tu më të mirë, sepse ti do të shkosh pranë Atij që nuk i pranon justifikimet. Kurse ti pasurinë po e mbledh për ata që nuk do të të sjellin aspak dobi. Në fakt me pasurinë e vënë prej teje ose një fëmijë besimtar do të jetojë i lumtur dhe i bindur ndaj Zotit, ose një djalë kryengritës do të ngrejë edhe më shumë krye ndaj Zotit. I betohem Allahut, se as njëri, as tjetri nuk t'i lehtësojnë dot ty përgjegjësinë dhe mëkatet. Për këtë arsye, mos zgjidh trashëgimtarët e tu përpara vetes. E kurrë mos e humb shpresën, se Allahu do të sillet me mëshirë me ata që vdesin. Lërja Allahut amanet ushqimin e atyre që do të lësh pas."¹⁷

8. DISA KËSHILLA NGA EBU DHERRI (r.a.)

Tregon Sufjani Theurij (radijallahu anhu): "Ebu Dherr Gifariu (radijallahu anhu) u ngrit pranë Qabes dhe u tha njerëzve:

- "O njerëz! Unë jam Xhundubi nga Gifari. Jam një si ju, që u dua njerëzve të mirën dhe më shumë se çdo gjë dua t'u bëj njerëzve mirë. Ejani pranë meje, kam disa gjëra për t'ju treguar." Sakaq, njerëzit u mbledhën rreth tij dhe Ebu Dherri filloi që t'u flasë e t'i këshillojë:

- "Kur ndonjëri prej jush do të niset për rrugë, a nuk siguron më parë pak ushqim, si për vete, ashtu edhe për ata që do të lërë pas?" Ata që po e dëgjonin, i thanë:

- "Patjetër, ashtu bën." Atëherë Ebu Dherri (radijallahu anhu) vazhdoi fjalën e nisur:

- "Atëherë, që ta dini, udhëtimi juaj në amshim është shumë herë më i gjatë se të gjitha udhëtimet që ju ndërmerreni gjatë jetës në këtë

¹⁶. Ebu Nu'ajm, *Hiqe*, 1/217.

¹⁷. Ebu Nu'ajm, *Hiqe*, 1/216.

botë. Ju përgatitni ushqime e të mira që do t'ju bëjnë dobi atje, në jetën e asaj bote.”

Njerëzit e grumbulluar atje e pyetën sërisht:

- “E kush janë ato gjëra që do të na vijnë më shumë në ndihmë në atë rrugëtim të amshimit?” Ebu Dherri u tha atyre:

- “Që të mos përballeni me gjëra të tmerrshme, vizitoheni sa më shumë Qaben. Agjëroni, që agjërimi juaj të jetë një kalitje dhe një përgatitje për atë ditë të gjykimit, ku do të prisni gjatë e do të jetë shumë nxehtë. Çohuni gjatë natës e falni nga dy rekate namaz, se ai t'ju shpëtojë ju nga vetmia dhe tmerri që të kall bota e varrit. Mendoni për atë ditë të takimit të madh dhe ose flisni gjëra të mira e të hairit, ose heshtni. Jepni nga ajo që keni, me shpresën se do të shpëtoni nga vështirësitë e Kiametit. Kohën ta ndani në dy pjesë: një pjesë të saj harxhojeni me synimin për të fituar amshimin, ndërsa pjesën tjetër harxhojeni për të fituar ushqimin tuaj përmes rrugësh që janë të lejuara. E treta është e dëmshme, mos e kërkonti atë, sepse nuk do t'ju sjellë asnjë dobi. Për shembull, ta zëmë se ju do të fitoni vetëm dy derhemë: njërin harxhojeni si një të ardhur hallall e të lejuar për fëmijët e familjen tuaj, kurse tjetrin dërgojeni për jetën tuaj në botën tjetër. I treti është i dëmshëm, nuk ju sjell aspak dobi; mos e kërkonti.” Mandej, Ebu Dherri (radijallahu anhu) e ngriti zërin dhe sikur të ishte duke bërë titur, tha:

- “O njerëz! Lakmia dhe ëndërrimi i së ardhmes në këtë botë ju kanë shkatërruar fare!”¹⁸

9. KËSHILLA E HUDHEJFE BIN EL-JEMANIT

“Ruhuni nga ngatërresat dhe nga anarkia. Askush të mos shfaqet nëpër to. Ai që përfshihet në anarki, ajo e hedh atë tutje, njësoj siç erërat e fuqishme shpërndajnë gjethet e mbeturinat në çdo anë. Ngjarjet me qëllim sajimin e ngatërresave dhe të anarkisë fusin në dyshime deri edhe njerëzit e paditur e injorantë. Dhe, kur mbaron anarkia, pas nuk lë asgjë, veçse rrënojat. Nëse ndieni zhvillimin e ndonjë ngjarjeje që

¹⁸. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/165.

do të shkaktojë ngatërresa dhe anarki, futuni në shtëpi, thyejini me shpata e me shigjeta, gjithë ç'të keni, bëjini që nuk mund t'i përdorë më askush.”¹⁹

A'meshi (radijallahu anhu) na tregon: “Unë kam dëgjuar nga Hudhejfeja, i cili ka thënë:

- “Më i miri prej jush nuk është as ai që braktis këtë botë për hir të jetës së amshuar, as ai që braktis jetën e amshuar për këtë botë. Më i miri e më i hairit ndër ju është ai që punon duke e ruajtur më së miri drejtpeshimin mes të dyjave.”²⁰

10. KËSHILLA NGA UBEJ BIN KA'BI

Ubej bin Ka'bi (radijallahu anhu) thotë:

- “Nëse dikush e braktis diçka vetëm për hir të Allahut, Allahu i fal atij diçka edhe më të mirë sesa ajo që ka braktisur, madje në një kohë që ai as nuk e pret. Nëse ai njeri e nënvlerëson dhe nuk e bën atë sakrificë, Allahu, fare papritur, e përball atë me situata edhe më të vështira.”²¹

Ubej bin Ka'bit i tha dikush:

- “O Ebu Mundhir, çfarë më këshillon ti mua?” Ubej bin Ka'bi (radijallahu anhu) e këshilloi atë njeri duke i thënë:

- “Mos u merr me punë që nuk të përkasin dhe që nuk kanë lidhje me ty. Qëndro larg nga armiqtë e edhe ndaj miqve kurrë mos u trego i pakujdesshëm dhe i pamatur. Mos i admiro ato gjëra që nuk do t'i admirosh kurrsesi pasi të kesh vdekur dhe kurrë mos ua shpreh problemet dhe nevojat atyre njerëzve që nuk do të shqetësohen për të të ndihmuar.”²²

11. KËSHILLA NGA ZEJD BIN THABITI

Tregon Abdullah bin Dinar el-Behrani (radijallahu anhu): “Zejd

¹⁹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/273.

²⁰. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/278.

²¹. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/253.

²². Bejheki, *Sunen*, 10/112 (20112).

bin Thabiti (radijallahu anhu) i pati dërguar Ubej bin Ka'bit (radijallahu anhu) një letër në të cilën i shkruante:

- “Allahu i Madhëruar gjuhën e ka krijuar që ajo të jetë përkthyesë e zemrës. Ndërsa zemrës i ka ngarkuar detyrën që të drejtojë gjuhën drejt perceptimit të urdhërave që vijnë prej saj. Nëse te një njeri është zemra ajo që e komandon gjuhën, ke për të parë se fjala e atij njeriu është e matur dhe e drejtë; atij kurrë nuk i pengohet dhe kurrë nuk i gabon gjuha. Kurse te njeriu, gjuhën e të cilit nuk e komandon zemra, vështirë të gjesh butësi. Në qoftë se njeriu ia lë fjalën vetëm gjuhës dhe gjuha fillon të bjerë ndesh me zemrën, ai e ul dhe e poshtëron veten. Por, në qoftë se njeriu i peshon fjalët me veprat e tij, fjala e tij fiton peshë. Po të shikosh njëherë përreth vetes, do të shohësh se njerëzit dorështrenguar janë bujarë me fjalë dhe jo me vepra, sepse atij i flet gjuha përpara zemrës; është gjuha që i kontrollon zemrën. A nuk më thua: a mund të flitet për nder dhe fatbardhësi të atij njeriu që nuk mban fjalën e dhënë? Dhe ç’është më interesante, kur flasim kësi njerëzish, ata e dinë edhe vetë se ajo që thonë është e vërtetë dhe që edhe vetë duhet të ishin duke i zbatuar fjalët që thonë... Njeriu faqebardhë dhe me personalitet nuk i sheh të metat e të tjerëve, sepse ai që numëron e përhap të metat dhe turpet e të tjerëve, duke bërë sikur nuk i sheh të metat e veta, është po ai që merret me gjërat më të kota e të pavlera. Ues’selam.”²³

12. KËSHILLA NGA ABDULLAH BIN ABASI

“Tregohu sa më i kujdesshëm në përmbushjen e detyrimeve dhe në kryerjen e detyrave që të ka ngarkuar Zoti yt. Bëji ato sa më mirë dhe për këtë kërkoji ndihmë Allahut, sepse, nëse një rob e ka qëllimin të pastër dhe ka shumë dëshirë për të fituar shpërblimin e Allahut, Allahu e mban atë larg nga çdo e keqe dhe fatkeqësi. Ai është Sundimtari i vetëm; mund të bëjë ç’të dojë.”²⁴

“Allahu i Madhëruar ka caktuar ushqim nga i lejuari edhe për ata që janë të shthurur, edhe për ata që janë besimtarë. Nëse ai duron derisa

²³. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 16/201 (44239).

²⁴. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/326.

të vijë furnizimi i lejuar, Allahu medoemos që do t'ia japë atij gjithçka që ka caktuar për të. Por, nëse ai ngutet dhe e zgjat dorën kah ajo që është e ndaluar dhe e ha atë, Allahu (xhel'le xhelaluhu) ia pakëson atij atë nga të mirat e lejuara që ka caktuar për të.”²⁵

13. KËSHILLA NGA HASANI (r.a.)

“Atë që ngarend pas kësaj bote bota e lidh pas vetes. Ai që nuk lejon që të mbërthehet nga kjo botë, nuk i jep shumë rëndësi përfitimit prej saj. Ata që tregojnë interes të theksuar për kënaqësitë e kësaj bote, që rendin ku e ku ka më shumë prej kënaqësive të kësaj bote, janë të destinuar që të kthehen në skllëvërit e zonjës së tyre. Një sasi minimale e të mirave të kësaj bote është e mjaftueshme, sepse, sikur edhe të gjithën tënden ta kesh këtë botë, prapë nuk ndihesh i ngopur me të. Është mashtruar, çdokush që i ka njësoj dy ditë njëra pas tjetrës. Ç’është e vërteta, mjaft i rrezikuar është edhe ai që e ka të sotmen më të hairit se e djeshmja. Njerëzit që nuk kërkojnë për të metat dhe mangësitë e tyre janë përherë në humbje. E për një njeri që është vazhdimisht në humbje, është më e hairit që të jetë nën tokë sesa mbi të.”²⁶

“Ta dini mirë, se të jesh i butë dhe paqësor është një stoli për njeriun. Besnikëria dhe mirënjohja janë treguesit më të mirë të personalitetit. Ngutja është tregues i mendjemangësisë. Udhëtimi e dobëson njeriun. Qëndrimi me njerëz me nivel të ulët të moralit është një njollë për njeriun. Kurse qëndrimi bashkë me njerëz që i kryejnë mëkatet haptas bëhet shkak që njerëzit të kenë dyshime e mendime të këqija edhe për ju.”²⁷

14. KËSHILLA NGA EBU UMAME EL-BAHILIU

Tregon Ebu Sulejm bin Amiri (radijallahu anhu): “Bashkë me Ebu Umamen iu bashkuam një kortezhi që po shoqëronte një xhenaze në hyrje të Damaskut. Falëm xhenazen dhe filluam të përgatiteshim për varrimin, kur Ebu Umameja (radijallahu anhu) mbajti këtë fjalë:

²⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/326.

²⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/200 (44236).

²⁷. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 16/261 (44400).

- “O njerëz, ditë dhe netët e jetës suaj po kalojnë në këtë botë, ku ju ndani me njëri-tjetrin të mirat dhe të këqijat. Shumë afër është ajo ditë, kur të gjithë do të mërgojmë nga kjo botë në një tjetër botë. Varri është atdheu i vetmisë dhe errësirës. Atje ka insekte dhe krimba pa fund. Një vend i ngushtë fare është ai. I gjerë bëhet vetëm po e zgjeroi Allahu me mirësinë e Tij. Pas varrit do të ndodhë Kiameti dhe të gjithë do të kaloni në hapësirat e krijuara enkas për atë ditë. Në sheshin e gjykimit, të gjithë do të presin, derisa të vijë urdhri i Allahut. Banorët e Xhenetit do t’i kenë fytyrat të bardha dëborë, kurse ata të Xhehenemit të zeza sterrë. Mandej, ju do të kaloni në një tjetër stacion. Atje njerëzit i mbështjell një errësirë si ajo e mesnatës. Kalon një çast dhe përhapet drita. Dritë për besimtarët, sepse mohuesve dhe dyfytirëshave nuk u jepet nga ajo dritë.

Ja se si i përshkruan Kur’ani këto sa jam duke ju thënë:

“Ose janë si errësirat në detin e thellë, të cilat mbulohen nga dallgët që ngrihen njëra mbi tjetrën, duke pasur sipër tyre retë: shtresa errësire njëra mbi tjetrën, aq sa kur e nxjerr dorën e vet, njeriu pothuajse nuk e sheh fare atë. Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më dritë.” (Nur, 24/40)

“Atë Ditë, hipokritët dhe hipokritet do t’u thonë besimtarëve: ‘Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj!’ Por atyre do t’u thuhet: ‘Kthehuni prapa e kërkon tjetër dritë!’ Dhe, ndërmjet tyre, do të vendoset një mur me portë: brenda saj ka mëshirë, kurse jashtë saj ka dënim.” (Hadid, 57/13)

“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashton ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.” (Nisa, 4/142)

“Ata (hipokritët) dëgjojnë paralajmërimin dhe kthehen andej nga vendi ku është përhapur drita. Por nuk gjejnë gjë as atje. Kthehen prapë, por shohin që mes tyre dhe besimtarëve është ngritur një mur. Brenda murit mëshirë, jashtë tij dënim dhe vuajtje. Atëherë: ‘A nuk kemi qenë me ju?’, – do të thërrasin ata. – ‘Po, - do t’u përgjigjen, - por ju e çuat veten në tundim, pritët, dyshuat dhe u mashtruat nga vetë

dëshirat tuaja të kota, derisa arriti urdhri i Allahut, e djalli ju mashtroi për Allahun!”” (Hadid, 57/14)

Derisa të shpërndahet drita, hipokritët marrin shpërblimin me vuajtje e tmerr të kurtheve dhe mashtrimeve që bënë sa ishin në jetë në këtë botë. Ja, kështu ka për t'i ndarë Allahu besimtarët nga hipokritët.”²⁸

²⁸. Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/308.

NDIHMESAT E MREKULLISHME NDAJ RESULULLAHUT DHE SAHABËVE TË TIJ



1. NDIHMESA NGA ENGJËJT

Na e tregon Ibni Abasi (radijallahu anhu): “Në luftën e Bedrit, engjëjt ishin në shëmbëlltyrën e njerëzve, të veshur të gjithë me çallma të bardha. Kurse cepi i saj u varej mbi shpinë. Ndërsa engjëjt që u erdhën myslimanëve në ndihmë gjatë luftës së Hunejnit çallmat i kishin në ngjyrë jeshile. Engjëjt e zbritur në ndihmë të myslimanëve janë përleshur me armikun vetëm gjatë luftës së Bedrit. Në luftërat e tjera ata kanë shërbyer vetëm sa për t’i shfaqur myslimanët shumë herë më të shumtë në numër, duke u kallur frikë në zemra armiqve; por vetë nuk kanë luftuar.”¹

Xhubejr bin Mut’imi (radijallahu anhu) tregon: “Gjatë luftës së Hunejnit, myslimanët luftuan shumë dhe ne ishim pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Kur ç’të shoh, nga qielli po zbrisnin krijesa të veshura krejtësisht në të zeza. Ato krijesa që po

¹. Hejthemi, *Mexhmen’u-Zenaid*, 6/109 (9985).

zbriteshin nga qielli qëndruan mes nesh dhe armikut. Kaloi një kohë jo e gjatë, kur e tërë lugina u mbush plot e përplot me ta. Pak kohë ishte dhe idhujtarët pësuan disfatë. Kurrë nuk e vumë në dyshim se ato krijesa ishin engjëj.”²

Abdullah bin Fadli (radijallahu anhu): “Në luftën e Uhudit, i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) flamurin ia pati dhënë që ta valëviste Mus’ab bin Umejri (radijallahu anhu). Me të rënë dëshmor Mus’abi, flamurin e pati marrë në dorë një engjëll i Zotit, i cili ngjante njësh me Mus’abin. Ai engjëll luftoi deri në mbrëmje, derisa i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i foli:

- “*Eja tani, o Mus’ab.*” Ai u përgjigj:

- “Unë nuk jam Mus’abi.” I Dërguari Fisnik e kuptoi menjëherë se ai ishte një engjëll i dërguar enkas për t’i ardhur atij në ndihmë.”³

Beraja (radijallahu anhu) dhe disa sahabë të tjerë na thonë se: “Një nga ensarët, kishte zënë rob Abasin (radijallahu anhu) dhe e pati sjellë mu përpara të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Abasi tha:

- “O Resulullah! Për Zotin, mua nuk më zuri rob ky njeri. Ishte një tjetër, me flokët të krehura anësh, me këto e ato cilësi.” I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) atëherë tha:

- “*Domethënë ty të paska ardhur në ndihmë një engjëll i fisëm.*”⁴

Tregon Ibni Abasi (radijallahu anhu): “Ishte një mysliman, që gjatë luftës po vraponte aq shumë pas një idhujtari, për ta kapur, e nuk po e kapte dot. Përnjëherësh u dëgjua një zë kërbaci dhe një zë që thirri:

- “Hajzum, eja!” Kur ç’të shihte, ai idhujtar që ishte duke ndjekur ishte i shtrirë përtokë, me hundën të thyer dhe i mbuluar nga gjaku. Idhujtari ishte bërë i tëri mavi! Ai sahab nga ensarët, që ishte dëshmitar i kësaj ndodhie erdhi me një frymë te Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i tregoi një për një gjithë ç’i kishin parë sytë. I Dërguari i Allahut i tha atij:

- “*Ke të drejtë, ai ishte një engjëll i zbritur nga tri kate qiej, enkas për të të*

². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/334.

³. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/121.

⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 4/283 (18522).

ardhur ty në ndihmë. Atë ditë ata vranë plot shtatëdhjetë idhujtarë; shtatëdhjetë të tjerë u zunë robër.”⁵

Ebu Uname bin Sehli (radijallahu anhu) na ka përcjellë nga i ati, se ai i ka thënë: “O bir, ti të kishe parë Bedrin! Ishte njëri prej nesh, që, me të treguar kokën ndonjë nga idhujtarët, ende pa u afruar shpata jonë te koka e atij, shihnim që ajo kokë ishte ndarë sakaq nga trupi.”⁶

2. XHIBRILI (a.s.) U TREGON VENDIN ATYRE QË TALLËN ME TË DËRGUARIN E ALLAHUT

Tregon Ibni Abasi (radijallahu anhu): “Në Mekë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) po kalonte ndanë një grupi njerëzish. Ata bënë me shenjë nga Profeti ynë dhe filluan të thonë:

- “E shikoni atë njeri, thotë se është profet dhe se Xhibrili nuk i ndahet për asnjë çast!”, – përpiqeshin të talleshin duke bërë me sy e me duar. Mu në atë kohë, Xhibrili (alejhis’selam) ua bëri atyre me shenjë dhe në trupin e tyre u krijuan plagë në madhësinë e thoit. Idhujtarët u trembën tmerrësisht shumë nga ato plagë që iu hapën në trup dhe askush nuk u afrohej. Për këtë ndodhi, Allahu i Lartësuar zbriti ajetin: **“ata me siguri që do të thoshin: ‘Sy të tanë kanë qenë të shushatur, madje na kanë magjepsur!’”** (Hixhr, 15/15)⁷

3. SAHABËT ARRIJNË TË SHOHIN ENGJËJT

Aishja (radijallahu anha) tregon: “I Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dëgjoi një zë njeriu. Lëvizi menjëherë vendit dhe doli jashtë për të parë se kush ishte. Atë e ndoqa edhe unë nga pas. Pashë se ai ishte Dihjetu’l-Kelbiu, të cilin e kisha njohur edhe më parë! E kishte vendosur çallmën që i varej pas qafës. Kur i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u fut brenda, unë i thashë:

- “Dole ashtu, përnjëherësh. Pas teje dola edhe unë dhe e pashë, ishte Dihjetu’l-Kelbiu.

- “*A e pe ti atë?!*”, – më pyeti ai.

⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/279; Ebu Nu’ajm, *Delail*, 2/170.

⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 3/281.

⁷. Hejthemî, *Mexhmen’-Zenuid*, 7/133 (11112).

- “Po, e pashël”, – iu përgjigja unë. Atëherë ai më tha:
- “*Ai ishte Xhibrili (alejhis’selam). Erdhi të më urdhërojë që t’u tregoj vendin bijve të Kurejdhas.*”⁸

Xhibrilin (a.s.) e sheh edhe Ibni Abasi

Këtë e tregon vetë ibni Abasi (radijallahu anhu): “Isha bashkë me babanë tek i Dërguari i Allahut. Tek i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte edhe një burrë tjetër, i cili i fliste atij në vesh duke pëshpëritur. Dukej sikur donte ta fshihte fytyrën e të mos ia shihte babai. Pasi dolëm nga i Dërguari i Allahut, i thashë babait:

- “Babai im i dashur, tek i Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) ishte një burrë që i fliste fshehtazi në vesh.” Sakaq, u kthyem prapë tek i Dërguari i Allahut dhe babai i tha:

- “O Resulullah, unë i thashë kështu e kështu Abdullahut, ndërsa ai më tha se në prezencën tënde ishte dikush tjetër. Vërtet, a kishte njeri që po të fliste në vesh duke pëshpëritur kur ishim këtu?”

I Dërguari i Allahut më pyeti mua:

- “*E pe ti atë o Abdullah?*”

- “Po,” – u përgjigja unë, – “e pashë.” Në fund, Ai më tha mua:

- “*Ai burrë që më pengoi mua të flisja lirshëm me ty ishte Xhibrili (alejhis’selam).*”⁹

Engjëjt përshëndetin dhe shtrëngojnë duart me sahabët

Tregon Mutarrif bin Abdullahu (radijallahu anhu): “Imran bin Husajni më tha mua:

- “Mutarrif! Mua m’u shfaqën engjëjt fare pranë, ishin afër shtëpisë sime, në portën e Hixhrit në Qabe, dhe po më përshëndesnin. Por, që kur vura atë vulën në trup, ata nuk vijnë më që prej asaj dite.” Pak më vonë, kur Imranit iu shërua plaga, ai më tha mua:

- “Mutarrif! Mua më erdhën prapë shokët e mi. Vetëm, por, derisa të vdes, mos i fol kurrë askujt për këto që të kam thënë.”¹⁰

⁸. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 4/250.

⁹. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 1/293 (2679).

¹⁰. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/536 (5994).

Sahabët flasin me engjëjt

E tregon Selm bin Atijeja: “Selman Farisiu (radijallahu anhu) pati shkuar për vizitë te një burrë, i cili ishte në prag të vdekjes. Ai tha:

- “O engjëll, sillu mirë me të.” Atëherë, burri që ishte duke pritur çastin e fundit, atë të ardhjes së vdekjes, ashtu siç ishte, i shtrirë, iu përgjigj me këto fjalë:

- “Engjëlli po më thotë se: ‘Unë mirë sillem me të gjithë besimtarët.’”¹¹

4. ZBRITJA E ENGJËJVE PËR SAHABËT QË LEXONIN KUR’AN

Ebu Said el-Hudriu (radijallahu anhu) tregon: “Usejd bin Hudejri (radijallahu anhu) netët i kalonte duke lexuar Kur’an. Kur, në një çast, kali i tij nisi të hingëllinte. Ai nuk e prishi qetësinë, por vazhdoi të lexonte. Kali i ngriti sërish këmbët e përparme dhe u tremb. Ai po prapë vazhdoi leximin. Usejdi, kësaj here i shqetësuar se mos kali shtypte Jahjanë, prandaj shkoi pranë tij. Në atë kohë mbi kryet e tij pa diçka si një re të bardhë. Brenda saj shfaqej një dritë si ajo e kandilit. Hudajri e tregon kështu vazhdimin:

- “Reja u ngrit në qiell dhe unë nuk e shihja dot më. Në mëngjes, atë që më kishte ndodhur shkova dhe ia tregova një për një të Dërguarit të Allahut (sal’allahu alejhi ue sel’lem). I thashë:

- “O Resulallah! Natën, unë isha duke lexuar Kur’an. Dëgjova kalin që u tremb dhe po lëvizte e nuk po gjente qetësi.

- “*Po të kishe vazhduar leximin, o Hudajr.*”, – iu përgjigj atij i Dërguari Fisnik.

- “Ashtu bëra, vazhdova të lexoja, por ai u sikletos sërish dhe u ngrit me dy këmbët e parme dhe hingëllinte.”, – thashë unë. Ai m’u përgjigj po njësoj:

- “*Të kishe vazhduar së lexuari.*”

- “Kali u largua nga unë dhe andej nga shkoi kali ishte edhe Jahjaja. Kisha frikë se mos e shkelte. Kur shkova atje, ç’të shihja, ishte një si

¹¹. Ebu Nu’ajm, *Hijje*, 1/204.

re e bardhë që i bënte hije. Ajo re u ngrit drejt qiellit dhe nuk e dallova dot më tej se ç'u bë me të.” – shtova unë.

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- *“Ajo që ke parë dhe ke dëgjuar ti kanë qenë engjëjt. Po të kishe vazhduar me leximin e Kur'anit, njerëzit do t'i kishin parë ata me sy të lirë dhe ata nuk do të kishin mundësi që të fshiheshin.”*¹²

5. ENGJËJT LAJNË HANDHALEN E RËNË DËSHMOR

E tregon Mahmud bin Lebid (radijallahu anhu): “Handhala bin Amiri (radijallahu anhu), i vëllai i Amr bin Aufit, gjatë luftës së Uhudit, qe përballur me Ebu Sufjanin dhe e pati mundur. Ishte gati duke e vrarë atë, por në ndihmë të Ebu Sufjanit pati ardhur Shedad bin Esued, që e pati vrarë Handhalen dhe kësisoj Handhala ra dëshmor në rrugën e Allahut. Për Handhalen i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- *“Shokun tuaj po e lajnë engjëjt. Pyetni familjen dhe përpikuni të mësoni më shumë rreth gjendjes së tij.”* E shoqja tha:

- “Handhala duhej të merrte gusul, por një të dëgjuar thirrjen e tellallit për në luftë, nuk priti, doli menjëherë.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi Të) tha:

- *“Prandaj, kjo paska qenë arsyeja që për të larë Handhalen zbritën engjëjt.”*¹³

6. NË XHENAZENË E SA'D BIN MUADHIT MARRIN PJESË EDHE ENGJËJT

Tregon Seleme bin Eslemi: “Një të parë të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), dola menjëherë te pragu i derës për ta pritur. Profeti ynë Fisnik hyri në shtëpi, por aty nuk dukej askush tjetër përveç Sa'dit, i cili ishte i mbuluar. Megjithatë ai vazhdonte të hidhte hapat e tij; dukej sikur ish duke kërkuar për një vend se ku të ulej. Kur e pashë, u ndala. Ma bëri me dorë, si për të më thënë: - “Ndall!” U ndala dhe i ndalova edhe ata që po vinin pas meje. Profeti ynë Fisnik

¹². Muslim, *Sahib*, 1/548 (796).

¹³. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/357; Ibn Haxher, *el-Isabe*, 1/361.

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ndenji për njëfarë kohe i ulur, pastaj doli jashtë. Pas tij dola edhe unë dhe i thashë:

- “O Resulullah! Ti brenda nuk pe askënd, por, prapëseprapë, dukej sikur ishe duke kërkuar për ndonjë vend se ku mund të uleshe.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) m'u përgjigj:

- “Unë nuk u ula dot, derisa një engjell më bëri me shenjë me një nga flatrat e tij, duke më treguar vendin se ku mund të ulesha. Kur m'u dha një vend, vetëm atëherë arrita që të ulem.”

Në atë kohë, Profeti ynë po thoshte:

- “Henijen leke, ja Ebu Amr; të përgëztoj, o Ebu Amr! Sa mirë për ty, o Ebu Amr!”¹⁴

7. PENGIMI I SURAKAS, GJATË MËRGIMIT

Zejd bin Eslemi (radijallahu anhu) dhe shumë të tjerë tregojnë: “Suraka bin Maliku qe nisur për të kapur të Dërguarin Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe ta vriste. Hodhi tri herë shigjetë për të parë fallin, e kur pa që në asnjërin prej tyre nuk i doli ajo që dëshironte, prapë nuk u bind, por i hipi kalit të tij dhe iu vu nga pas. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu lut Zotit, që këmbët e kalit të Surakasë të nguleshin në tokë dhe ai të mos bënte dot asnjë hap përpara. Ashtu ndodhi, kalit iu zhytën këmbët në rërë. Suraka tha:

- “O Muhamed! Të lutem, përgjëroju Allahut të ma shpëtojë kalin. Të jap fjalën, nëse më le të lirë, atëherë unë do t'i kthej pas të gjithë ata që do të vihen për të të ndjekur.” Ja se si u lut Profeti i Dhembshurisë Zotit të Madhërishëm:

- “O Zot! Shpëtoja këtij njeriu kalin, nëse ai është i sinqertë në atë që thotë?” Kalit iu çliruan këmbët menjëherë.

Ndërsa, në transmetimin që i bën Ebu Ma'bed el-Huzaij kësaj ngjarjeje, do të gjejmë të pranishme edhe një të dhënë tjetër: “Vërtet, Suraka e mbajti fjalën e dhënë dhe të gjithëve që i viheshin të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), për ta ndjekur, ai u thoshte:

- “Kthehuni mbrapsht, atje kam kontrolluar unë. Ju e dini shumë

¹⁴. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 3/428.

mirë, që unë nuk gënjahem lehtë në punë të tilla.” Edhe ata ashtu bënë, u kthyen, duke bërë që të dilte se Suraka kishte qenë i singërtë në ato që kishte thënë.”¹⁵

8. MUNDJA E ARMIQVE ME DHE E GURË

Tregon Harith bin Bedeli: “Në luftën e Hunejnit e kam parë vetë me sytë e mi se në çfarë gjendjeje ishte i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Përveç Abas bin Abdulmutalibit dhe Ebu Sufjan bin Harithit, nga sahabët, gjithë të tjerët patën pësuar disfatë. Andaj, i Dërguari i Allahut mori një grusht rërë dhe na e hodhi nga sytë. Ja, aty e pësua disfatën ne. Nuk shikonim më asgjë. Shikonim vetëm që na ndiqnin nga pas.”¹⁶ Amr bin Sufjan eth-Thekafij thotë se: “Në atë çast, si i hipa kalit, frymën e mbajta drejt e në drejtim të Taifit.”¹⁷

Hakim bin Hizami (radijallahu anhu) tregon: “Në luftën e Bedrit, të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) iu dha urdhër që të merrte një grusht gurësh dhe ne ashtu na prit, me një grusht gurësh në njëren dorë. Teksa na hidhte gurët, thoshte:

- “*Të shëmtuara i paçin fytyrat.*” – Paskëtaj ne pësua disfatë. Andaj edhe Allahu i Madhërishtëm zbriti ajetin Kur’anor: **“Sigurisht, nuk ishit ju që i vratë ata, por i vrau Allahu! Kur gjuaje, nuk ishte ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante, me qëllim që t’u bënte besimtarëve një dhuratë të bukur. Vërtet, Allahu dëgjon dhe di çdo gjë.”** (Enfal, 8/17)¹⁸

9. SHFAQJA E ARMIQVE SI MË TË PAKTË NË NUMËR NË SYRIN E MYSLIMANËVE

Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) tregon: “Në luftën e Bedrit armiqtë na u shfaqën si shumë të paktë në numër. Madje shokut që kisha afër vetes i thashë:

- “Janë, apo nuk janë as shtatëdhjetë vetë?” Ai m’u përgjigj:

¹⁵. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/232.

¹⁶. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal*, 10/775 (30212).

¹⁷. Ibn Kethir, *el-Bida’je*, 4/332.

¹⁸. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 11/285 (11750).

- “Duhet të jenë diku te njëqind vetë.” Pastaj, në kohën që morëm peng një burrë, ne e pyetëm atë edhe për numrin e ushtarëve. Ai na tha:

- “Ne ishim njëmijë vetë.”¹⁹

10. USHTRI TË PADUKSHME PËR MYSLIMANËT DHE NDIHMESA NËPËRMJET ERËS

Said bin Xhubejri (radijallahu anhu), në kohën e luftës së Hendekut, ishte në Medinë. Ai e tregonte kështu atë që kishte ndodhur: Aty erdhën, Ebu Sufjani, bashkë me kurejshët dhe Kinanasit; Ujejne bin Hisni, me Gatafanasit; Tulejhaja në anën e bijve të Esedit dhe Ebu A’ueri, me bijtë e Sulejmit. Bijtë e Kurejdhas e kishin shkelur në mënyrë të njëanshme marrëveshjen që kishin bërë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe sakaq, hebrenjtë e Kurejdhas kishin kaluar në anën e idhujtarëve. Për ta u zbrit edhe ajeti Kur’anor: **“Ai i nxori nga kështjellat e tyre ithtarët e Librit që ndihmuan ushtrinë e aleatëve dhe mbolli frikë në zemrat e tyre, kështu që një pjesë e tyre i vratë dhe pjesën tjetër i zutë rob.”** (Ahzab, 33/26) Menjëherë pas zbritjes së këtij ajeti, Xhibrili (alejhis’selam) solli edhe erën. Profeti ynë, sapo e pa Xhibrilin, u tha besimtarëve:

- “Sihariq i madh për ne! Allahu dërgoi erën, për t’i ndëshkuar armiqtë e Tij.” Pa kaluar shumë kohë, era që kish nisur të frynte ishte aq e fortë, saqë rrëzonte deri edhe çatitë e shtëpive, çadrat, hunjtë e ngulur për to, armatimet, duke shkatërruar e bërë njësh me tokën gjithçka që rrihej nga era. Si përfundim, të gjithë ia mbathën kush e kush të ruante kokën e vet, duke u larguar me shpejtësi nga territori i luftës. Edhe në lidhje me këtë ngjarje, Allahu zbriti këtë ajet: **“O besimtarë! Kujtoni dhuntinë e Allahut kur ju erdhi një ushtri (idhujtarësh), e Ne dërguam mbi ta erë dhe një ushtri (engiëjsh) që ju nuk e shihnit; ndërsa Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju.”** (Ahzab, 33/9)

Menjëherë pas këtij ajeti u kthye edhe i Dërguari i Allahut (Paqja e Zotit qoftë mbi të) së andejmi.”²⁰

¹⁹. Ibn Kethir, *Tefsir*, 2/315.

²⁰. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 2/71.

Futja e armiqve në dhe

Tregon Burejdeja (radijallahu anhu): “Gjatë luftës së Uhudit, dikush bërtiti:

- “O Allah, nëse Muhamedi është vërtet një profet, zhytmë mua në dhe për së gjalli!” Dhe Allahu bëri të mundur që atë njeri ta përpijë toka dhe kështu mori fund ai.”²¹

Fundi i Ibni Kamiasë, që plagosi të Dërguarin e Allahut

E tregon Nafi bin Asimi (radijallahu anhu): “Ai njeri që përgjaku fytyrën e bekuar të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) quhej Abdullah bin Kamie dhe vinte nga fisi i Hudhejlit. Më vonë, Allahu i nxori atij përpara një cja, i cili e vrau atë duke e përplasur me brirë nga të gjitha anët.”²²

11. FUNDI I ATYRE QË MALLKOHESHIN NGA NDONJËRI PREJ SAHABËVE

Tregon Zadhani: “Aliu (radijallahu anhu) na tregoi për një hadith të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe një nga të pranishmit iu drejtua Aliut (radijallahu anhu) me fjalët:

- “Ti po gënjen!” Aliu (radijallahu anhu) iu kthye dhe i tha:
- “A do që të të mallkoj rreth së vërtetës nëse po gënjej, apo jo?”
- “Bëj ç’të duash, ti e di.”, – u përgjigj ai burrë. Sakaq, Aliu ynë (radijallahu anhu) e mallkoi atë njeri dhe ai njeri u bë i verbër mu aty në vend.”²³

12. SYTË E VERBËR QË FILLOJNË TË SHOHIN

E tregon Enesi (radijallahu anhu): “Pasi e pati liruar Ebu Bekri (radijallahu anhu) shërbyesen e tij të quajtur Zinijre, ajo kishte filluar të mos shihte më nga sytë. Kurejshët i thoshin asaj:

²¹. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 6/178 (10115).

²². Ebu Nu’ajm, *Delaïl*, 2/9.

²³. Hejthemi, *Mexhmen’z-Zenaid*, 9/153 (14684).

- “Dritën e syve ta morën Lati dhe Uzza!” Zinijreja u dha atyre një përgjigje shumë të ashpër:

- “Gënjeshtër! Unë i betohem Allahut, që është i Zoti i Qabes, se Lati me Uzzan nuk kanë fuqi të bëjnë asgjë, kështu që askujt nuk i hyjnë në punë.” Me të thënë këto fjalë, Allahu ia hapi sytë Zinijres dhe ajo filloi të shikonte si më parë.”²⁴

13. KUR OMERI (r.a.) I JEP URDHËR SARIJES NGA HUTBEJA

E tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): “Omeri (radijallahu anhu) pati dërguar një ushtri kundër armikut; në krye komandant kishte caktuar Sarijen. Njëherë, Omeri (radijallahu anhu) ishte duke mbajtur hutben, kur papritur bërtiti tri herë:

- “Mali, Sarije, mbrohu pranë malit!” Nuk kaloi shumë dhe aty erdhi kasneci i ushtrisë. Omeri (radijallahu anhu) i kërkoi atij të dhëna në lidhje me ecurinë dhe rezultatin e përleshjes. Kasneci i tha atij:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Ne ishim duke pësuar disfatë. Por në atë kohë dëgjua një zë që na thirri:

- “O Sarije, mali, mbrohu pranë malit!” Kthyem shpinën nga ana e malit dhe gjithçka u shndërrua në të mirën tonë. Allahu u shkaktoi armiqve humbje shumë të mëdha.”²⁵

Ndërsa, sipas një tjetër transmetimi, Omerin (radijallahu anhu) e pyesin se përse thirri ashtu me zë të lartë dhe ai pati dhënë këtë përgjigje:

- “Ashtu më erdhi, më erdhi në shpirt sikur armiku i kishte shtrënguar myslimanët drejt malit dhe ishte duke i shpartalluar. Në atë kohë thashë me vete: ‘Ah sikur ta dëgjonte zërin tim njëri prej robërve të Allahut dhe t’ia çonte atë komandantit të ushtrisë së myslimanëve!’”²⁶

²⁴. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 4/312.

²⁵. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 12/794 (35788).

²⁶. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 12/794 (35788).

14. SAHABËT DËGJOJNË ZËRA QË VIJNË NGA E FSHEHTA

Zëri që dëgjon Ibni Abasi pak para se të vdiste

Said bin Xhubejri (radijallahu anhu) tregon: “Ibni Abasi (radijallahu anhu) pati ndërruar jetë në Taif. Në xhenazen e tij kam qenë edhe vetë. Aty erdhi një zog i një lloji që nuk e kishim parë kurrë më parë dhe u fut aty ku qëndronte trupi i pajetë. Pritëm për një kohë të gjatë, për të parë se kur do të dilte. Mirëpo askush nuk e pa që të dilte. E varrosëm trupin dhe, kur mbaruam, nga brenda varrit dëgjuam të këndoheshin disa ajete kur'anore, vetëm se nuk e kuptonim se kush ishte duke i kënduar: **“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty. Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim.”** (Fexhr, 89/27-30)²⁷

15. XHINDET LAJMËROJNË ARDHJEN E PROFETIT TONË TË NDERUAR

Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu) tregon: “Lajmi i parë që u dëgjua në Medinë në lidhje me profetësinë e Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka qenë i këtillë: Një grua medinase kishte një xhind, i cili nuk i ndahej kurrë nga pas. Një ditë, xhindi iu shfaq asaj si një zog i bardhë dhe u vendos mbi murin e kopshtit. Ajo grua i kish thënë xhindit:

- “Nuk do të vish brenda, eja, të flasim, ta lajmërojmë njëri-tjetrin për çfarë ka ndodhur.” Dhe xhindi i qe përgjigjur duke i thënë:

- “Shiko, në Mekë ka ardhur një profet i ri, ai jo vetëm që e ka ndaluar imoralitetin, por edhe ne na ka penguar që të qëndrojmë në Tokë²⁸.”²⁹

Asim bin Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Osmani (radijallahu anhu) ka thënë:

- “Para se t'i zbritej profetësia të Dërguarit Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ne qemë nisur me një karvan për të bërë tregti në Siri. Kur

²⁷. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/626 (6312).

²⁸. “qëndrojmë në Tokë”, me kuptimin që të stabilizohemi në një vend. (shën. red.)

²⁹. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 1/190.

iu afruam Damaskut, para na doli një falltare, e cila na tha:

- “Mua më erdhi xhindi dhe më qëndroi te pragu i derës. Unë e pyeta:

- “Nuk do të hysh brenda?” E ai m’u përgjigj:

- “Kjo nuk është më e mundur; sepse ka ardhur Ahmedî (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kështu kemi urdhër dhe nuk e kundërshtojmë dot.” Mandej, unë u largova nga Siria dhe u ktheva në Mekë. Në Mekë mësova se i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kishte filluar të ftonë njerëzit në fenë e Zotit.”³⁰

Na tregon Ubej bin Ka’bi, se: “Një grup myslimanësh u nisën të shkonin në Mekë. Ec e ec, ata ngatërruan rrugën. Nuk po e gjenin dot rrugën dhe i humbën shpresat. E kuptuan se do të vdisnin, kështu që veshën qefinët dhe u shtrinë në tokë, që të prisnin të vinte vdekja. Pikërisht në atë kohë, nga mesi i pemëve u shfaq një xhind, i cili u foli:

- “Unë jam individ i fundit i bashkësisë së Profetit, që ka dëgjuar fjalën e tij. Unë kam dëgjuar prej atij Profeti, që thoshte:

- “*Myслиmani është vëlla për myslimanin. Ai bëhet sy e veshë për të vëllanë dhe i tregon rrugën e drejtë, e nuk e lë kurrë të shkojë drejt humbjes.*” Ja pra, edhe unë kam ardhur që t’ju them se në këtë anë ka ujë, kurse rruga juaj kalon që këndej.”³¹

16. XHINET DHE DJAJTË U BINDEN BESIMTARËVE

Profeti ynë mbërthen djallin

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) përcjell se i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) ka thënë:

- “Mbrëmë m’u shfaq një djall prej xhindeve, që u përpoq të më pengonte e të mos më linte të falja namaz. Mirëpo, Zoti më dha mua forcë e fuqi dhe unë e mbërtheva dhe i tregova vendin. Madje, nuk është se nuk më shkoï në mendje që ta lidhja atë pas ndonjë prej trarëve të xhamisë, që të vinit e ta shihnit edhe ju në mëngjes. Por, në atë çast m’u kujtua kjo lutje e vëllait tim, Sulejmanit, i cili ka thënë:

³⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 2/339.

³¹. Ebu Nu’ajm, *Delail*, 1/299.

“(...) dhe tha: ‘O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet që të mos e ketë askush pas meje! Me të vërtetë, Ti je dhurues i madh!’” (Sad, 38/35) Andaj e përzura, të largohej ashtu, i poshtëruar.”

Në një transmetim ekziston edhe një e dhënë më shumë: “Nëse nuk do të kish qenë lutja që ka bërë vëllai im Sulejmani, ai djall do të kishte ngelur ashtu i lidhur dhe të kthehej në një lodër, me të cilin të luanin gjithë fëmijët e Medinës.”³²

Omeri (r.a.) ndeshet me djallin dhe fiton ndaj tij

Tregon Ebu Uaili (radijallahu anhu): “Abdullahu më tregoi mua se: “Djalli u përball me një nga sahabët dhe filloi të bënte mundje me të. Myslimani e përplasi atë përtokë dhe e mundi. Madje i vuri edhe gishtin e madh në fyt, për ta mbytur. Ai i tha sahabit:

- “Nëse më lëshon, unë do të të mësoj një ajet, që kur e dëgjojnë dajhtë ia mbathin me të katra.”, – e vetëm atëherë e lëshoi sahabi djallin. Vetëm se, kur u lëshua, djalli nuk donte që t’ia tregonte ajetin. Sahabi e përplasi edhe njëherë përtokë. Djalli i dha të njëjtën fjalë, por sërish nuk e mbajti. Herën e tretë, sepse kjo u përsërit edhe njëherë tjetër, djalli i tha atij se ai ajet është Ajeti Kursij, i cili ndodhet në suren “Bekare” . Abdullahut i patën thënë:

- “A e di ti Abdullah, se kush ishte ai burrë që u mund me shejtanin?” Dhe përgjigjja që dha Abdullahu ishte:

- “E kush mund ta bënte diçka të këtillë, përveçse Omeri (radijallahu anhu)?”³³

17. SAHABËT DËGJOJNË ZËRAT E KRIJESAVE TË NGURTA (JOFRYMORE)

Ibni Mesudi dëgjon përmendjen e Allahut nga ushqimet

Këtë e ka treguar vetë Ibni Mesudi (radijallahu anhu): “Ne, të gjitha ngjarjet e mrekullishme i prananim si shenja të profetësisë. Kurse ju

³². Ibn Hibban, *Sahib*, 14/329 (6418).

³³. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 9/71.

ato i pandehni ato si qortime dhe paralajmërime të Allahut. Një ditë ne kishim dalë të udhëtonim me të Dërguarin e Allahut. Na kishte mbetur shumë pak ujë për të pirë. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na urdhëroi:

- "*Silleni këtu të gjithë ujin e mbetur.*" Aty sollën një enë në të cilën kishte mbetur shumë pak ujë. I Dërguari Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) futi njërën dorë në enë dhe pastaj tha:

- "*Ejani, të merrni abdes, se begatia vjen nga Allahu.*"

Ibni Mesudi thotë se:

- "Vërtet, e kam parë me sytë e mi, se si rridhte ujë nga gishtërinjtë e të Dërguarit të Allahut. Madje, nganjëherë, ne ishim duke ngrënë dhe dëgjonim se si ushqimet që po hanim përmendnin Allahun."³⁴

Kur dëgjohet vajtimi i trungut të hurmës

Na e tregon Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu): "I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte duke mbajtur hutben e së premtes, kur u mbështet pas një peme hurme. Një nga ensarët i propozoi atij:

- "O Resulullah, nuk do të ishte keq sikur të të gdhendnim një minber, apo jo?" Dhe Profeti ynë i nderuar u përgjigj:

- "*Po bëjeni, po të doni.*" Ata përgatitën menjëherë një minber. Erdhi dita e premte dhe i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) u ngjit në minberin e ri për të mbajtur hutben. Në atë kohë, ajo pemë e hurmës ku ishte mbështetur një javë më parë filloi të vajtonte, duke lëshuar një zë prekës për të gjithë, që i ngjante më shumë një të qare fëmije. I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) zbriti nga minberi dhe shkoi e përqafoi pemën. Edhe vajtimi i pemës filloi të ndryshojë, ashtu siç ndryshon e qara e fëmijës së qetësuar, që kërkon t'u bëjë pak naze prindërve të tij. Xhabiri thotë se:

- "Ajo pemë hurme qante sepse e kishin privuar nga të dëgjuarit e përmendjeve të Allahut që bëheshin rreth saj."³⁵

³⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/97.

³⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/127.

Teksa, në një transmetim që vjen prej Enesit (radijallahu anhu), thuhet se i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë:

- “Unë i betohem Allahut, se në dorën e fuqisë së Tij është edhe fryma e Muhamedit; nëse nuk do ta kisha qetësuar unë atë pemë, nga mërzia se e kishin ndarë nga i Dërguari i Allahut ajo do të vazhdonte të klithte e të vajtonte deri në ditën e Kiametit. Derisa, në fund, i Dërguari i Allahut dha urdhër dhe pema u fut në dhe.”³⁶

Selman Farisiu dhe Ebu Derdaja dëgjojnë përmendjet e Allahut nga ena në të cilën po hanin

Tregon Ebu'l-Buhturiu (radijallahu anhu): “Një ditë, Ebu'd-Derdaja me Selmanin (radijallahu anhu) ishin bashkë. Ebu'd-Derdaja kishte ndezur zjarrin, për ta vënë tenxheren të vlonte, kur nga tenxherja dëgjoji që doli një zë; i ngjante zërit të një fëmije. Me kalimin e kohës zëri sa vinte e rritej. Kur arriti pikën, tenxherja u kthye përmbys dhe ra në tokë. Megjithatë, nga ushqimi që ishte në të nuk u derdh aspak. Më vonë ajo u kthye vetë në gjendjen e saj të mëparshme. Ebu Derdaja tha:

- “Shiko, Selman, sa e çuditshme! Ma merr mendja se diçka të këtitill as ti as babai yt nuk e keni parë ndonjëherë gjer më sot.” Selman Farisiu (radijallahu anhu) i tha atij:

- “Po të kishe pushuar dhe të mos e kishe nxjerrë zbuluar të fshehtën dhe misterin e asaj që sapo pe, ti do të kishe parë edhe kushedi se sa argumente që do të dëshmonin drejtpërsëdrejti për Allahun e Madhëruar.”³⁷

18. SAHABËT DËGJOJNË ZËRAT E BANORËVE TË VARRIT

Jahja bin Ejubi tregon: “Me sa kam dëgjuar, në kohën e Omerit (radijallahu anhu), ishte një djalosh i ri besimtar, i cili ishte shumë i devotshëm e shkonte vazhdimisht në xhami. Omeri (radijallahu anhu) ia pëlqente tej mase këtë veçori. Por ai djalë i ri kishte edhe një baba, që

³⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/126.

³⁷. Ebu Nu'ajm, *Hilje*, 1/224.

ishte i moshuar. Ai djalosh, me të falur namazin e jacisë, kthehej drejt e pranë të atit. Njëherë, teksa po kthehej për në shtëpi, ia pret rrugën një grua. Ajo grua ishte fiksuar pas atij djali të ri, ishte dashuruar pas tij. Nuk linte ditë pa ia prerë atij rrugën në një mënyrë apo në një tjetër. Të njëjtën gjë bëri edhe asaj nate. Deshi t'i merrte mendjen. Sapo iu afruan shtëpisë së asaj gruaje dhe do të hidhte edhe ai një hap në shtëpinë e saj, djaloshit iu kujtua menjëherë Allahu dhe nga buzët nisën t'i rridhnin fjalët e ajetit kur'anor: **“E kur u vjen ndonjë mendim i ligë nga djalli, ata që i frikësohen Allahut kujtojnë** (urdhrat e Tij), **e atëherë e shohin rrugën e drejtë.”** (Araf, 7/201)

Buzët i këndonin pandërprerë këtë ajet, kur sa hap e mbyll sytë u rrëzua në tokë. Ajo grua thirri menjëherë shërbyesen, që t'i vinte në ndihmë për ta ngritur në këmbë djalin e rënë pa ndjenja dhe e morën dhe e çuan deri pranë pragut të derës. E ulën atje dhe shkuan e trokitën në derën e shtëpisë ku ishte i ati. Ai burrë, kur e pa të birin të rënë ashtu në atë gjendje, një të thirrur u bëri fqinjëve, e ndihmuan dhe e çuan djalin në shtëpi.

- “Çfarë ke, o bir, çfarë të ndodhi ty?” Djali i ri i tha:

- “Nuk kam gjë, baba.” Babai këmbënguli dhe e pyeti:

- “Cilin ajet pate kënduar ti?” Djaloshi ia këndoi edhe të atit ajetin e mësipërm, por kjo e bëri të binte sërish pa ndjenja. Por, kur e panë, kishte vdekur. E lanë dhe e çuan e varrosën natën.

Në mëngjes, ngjarjen ia treguan edhe Omerit (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu) erdhi te babai i djalit, e ngushëlloi dhe e pyeti:

- “Po mua pse nuk më lajmëruat?” Ata i thanë:

- “O Prijësi i Besimtarëve! Ishte natë, e nuk deshëm të të shqetësonim.”

- “Më çoni te varri i tij, atëherë.” – tha Omeri (radijallahu anhu) dhe bashkë me të tjerët shkuan te varri i djaloshit. Ai i foli djaloshit:

- **“O ti i rënë në atë varr, për atë që jeton i shqetësuar se një ditë do të dalë përpara Allahut ka dy xhenete.”** (Rahman, 55/46) U dëgjua një zë, ishte zëri i djaloshit të varrosur në atë varr, i cili tha:

- “O Omer! Zoti mua mi dha ato të dyja në Xhenet dyfish.”³⁸

Sahabët dëshmojnë vuajtjet e hequra prej banorëve të Xhehenemit

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Isha duke shëtitur përreth Bedrit, kur papritur, nga një gropë aty doli një burrë. Ai burrë ishte i lidhur në qafë me një zinxhir. Ai më tha mua:

- “Më jep të pi pak ujë, o Abdullah! O Abdullah, më jep të pi pak ujë! Jepmë ujë, Abdullah!” Nuk e di se nga e dinte emrin tim, apo po më thërriste ashtu meqë edhe ishte zakon mes arabëve që t’i thërrisnin njëri-tjetrit ashtu, nuk e kuptova. Nga gropa doli edhe një burrë tjetër, por ai, ndryshe nga i pari, kishte në dorë një kamxhik. Ai më tha mua:

- “Mos i jep ujë këtij njeriu, o Abdullah, se ky është mohues!” – dhe e goditi me kamxhik burrin e parë, duke e futur sakaq edhe njëherë në gropë. Vrapova dhe u ktheva tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e njoftova për atë që kishte ndodhur. Ai më tha:

- “*Me të vërtetë e pe diçka të tillë?*”

- “Po!”, – iu përgjigja unë.

- “*Epo, ai që ke parë ti është Ebu Xhebli. Ashtu ka për të vuajtur deri në ditën e Kiametit.*”, – më tha i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të).³⁹

19. ME LUTJEN E SAHABËVE NGJALLEN TË VDEKUR

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: “Në mesin e umetit unë kam qenë dëshmitar i tri ngjarjeve, që sikur ato t’u kishin ndodhur hebrenjve, brezat e ardhshëm do të garonin me njëri-tjetrin, që kush e kush t’i kishte për vete.”

- “E cilat janë ato?”, – e pyetëm ne dhe ai filloi të na i tregojë:

“Ne ishim mes sahabëve të Sufes të të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Një ditë tek ne ia behu një grua nga mërgimtarët, e cila me vete kishte edhe djaln, i cili kishte hyrë në moshën e adoleshencës. Gruaja kaloi në anën e grave, kurse fëmija u

³⁸. Ibn Kethir, *Tefsir*, 2/279.

³⁹. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/289.

afrua tek ne. Nuk kaloi shumë kohë dhe ai fëmijë u kap nga kolera që u përhap asokohe në Medinë. Ne dëgjuam se ai fëmijë kishte vdekur në shtrat në gjumë. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shkoi, ia mbylli sytë fëmijës dhe urdhëroi që t'i përgatisnin qefinin. Ne sa u bëmë gati ta lanim xhenazen, kur Profeti ynë i nderuar tha:

- “*Enes, çohu shko te nëna dhe lajmëroje!*” Enesi shkoi dhe njoftoi nënën e fëmijës. Nëna erdhi dhe i qëndroi djalit të saj te këmbët; u përqaftua me këmbët e djalit dhe tha:

- “O Zot, unë të jam dorëzuar e tëra me zemër. I braktisa të gjithë idhujt, vetëm e vetëm që të isha sa më larg shoqërimit të ndonjë shoku a ortaku në krijim e adhurim Ty, o Zot. Unë mërgova për hir të kënaqësisë Sate. O Zot, mos i bëj idhujtarët që adhurojnë idhujt e tyre të qeshin me mua. E mos më ngarko mua barrë më të rëndë sesa ajo që mund të mbaj me këtë fatkeqësi që më gjeti.”

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: “Uallahi, ende sa pa e mbaruar mirë fjalën ajo grua, këmbët e fëmijës filluan të lëviznin. Hoqi mbulesën që kishte në fytyrë dhe pa nga nëna dhe i Dërguari i Allahut (pagja e Zotit qoftë mbi të). Ai fëmijë jetoi edhe pas vdekjes së nënës së tij dhe ndërrimit jetë të të Dërguarit të Allahut.”⁴⁰

20. GJENDJE TË MREKULLISHME TE SAHABËT E RËNË DËSHMORË

Tregon Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu): “Muauija (radijallahu anhu) ishte duke ndërtuar një kanalizim të ujit, kur na pati thënë:

- “Gjeni një zgjidhje për dëshmorët e Uhudit.” Dyzet vjet më vonë, ne i nxorëm ata nga varret e tyre. Trupin e kishin të butë dhe gjymtyrët krejtësisht të paprishura; nuk ishin tretur fare.”⁴¹

Një ngjarje e ngjashme na është transmetuar po edhe ajo nga Xhabiri (radijallahu anhu). Në të thuhet: “Në kohën e Muauije bin Ebi Sufjanit, na behu papritur një burrë, i cili thirri:

⁴⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/154.

⁴¹. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 3/563.

- “Xhabir! Uallahi, punëtorët e Muauijes të kanë gërmuar varrin e babait, iu shfaq trupi. Doli edhe ai, dolën edhe trupat e dëshmorëve të tjerë!” Shkova menjëherë dhe e gjeta babanë njësoj siç e patëm varrosur. Përpos plagëve që kishte marrë në luftim e sipër, në trupin e tij nuk kishte asnjë shenjë e asnjë plagë. Ashtu, siç ishte, e varrosëm prapë.”⁴²

21. PËRHAPJA NGA VARRET E NJË AROME SI AJO E MISKUT

Tregon Muhamed bin Shurahbili (radijallahu anhu): “Dikush kishte marrë një grusht dhe nga varri i Sa’d bin Muadh (radijallahu anhu). E hapi grushtin dhe pa, mbante një aromë të mrekullueshme, si ai i miskut. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Subhanallah, Subhanallah...*”, – dhe ia kuptonim nga fytyra që ishte habitur jashtëzakonisht shumë.”⁴³

22. RUAJTJA E PAPRISHUR, ME URDHRIN E ALLAHUT, E TRUPEVE TË SAHABËVE TË RËNË DËSHMORË

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), e pati caktuar Asim bin Thabitin (radijallahu anhu) komandant të një njësie ushtarake. Asimi, teksa nisej për në luftë, pati thënë:

- “Unë nuk e duroj dot që të më mbrojnë prej një idhujtari. Edhe më parë kështu ka qenë, i jam betuar dhe i kam dhënë fjalën Allahut: Për sa kohë që ata nuk më prekin mua, as unë nuk kam për të prekur asnjë idhujtar.” Idhujtarët e kurejshëve dërguan njerëzit e tyre që të këputnin një copë mishi nga trupi i tij. (Asimi kishte vlarë disa vetë nga paria e kurejshëve në Bedër) Në atë kohë, Allahu dërgon një tufë të madhe bletësh, e cila i ngjante një reje të zezë të zbritur në Tokë dhe ato nuk lejuan askënd që t’i afrohej e ta prekte trupin e pajetë të Asimit. Andaj edhe Asimin e kanë përmendur shpesh me cilësimin “*hamijju’dabr*”, pra “i ruajturi nga bletët.”⁴⁴

⁴². Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, 7/372 (36790).

⁴³. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 3/341.

⁴⁴. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 2/245.

23. KAFSHËT U BINDESHIN TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE SAHABËVE TË TIJ

Hamza bin Ebi Usejdi (radijallahu anhu) tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) pati shkuar deri në varrezën e Përjetshme, do të merrte pjesë në xhenazen e një personi nga ensarët. Në rrugë pamë një ujk të shtrirë me këmbët e përparme të ngritura sipër! I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) tha:

- “*Ky ujk ka ardhur këtu që të kërkojë atë që i takon dhe ju duhet t’ia jepni.*”

- “O Resulullah, po çfarë është kjo e drejtë e tij?”, – e pyetën dhe i Dërguari i Allahut u përgjigj:

- “*E drejta e tij është një dele nga çdo kope njëherë në vit.*”

- “Po kjo është shumë për një ujk, o Resulullah!”, – i thamë ne të habitur. Atëherë, Profeti ynë i bëri shenjë ujkut që të ngrihej e ta merrte vetë atë që i takonte; ujku u ngrit mbi të katër këmbët dhe u kthye, iku andej nga kishte ardhur.”⁴⁵

Ibnu’l-Munkediri (radijallahu anhu) na e tregon: “Sefineja, që e kishte liruuar i Dërguari ynë Fisnik nga skllavëria, pati humbur njëherë rrugën në kufi të Bizantit. I shqetësuar dhe i trembur pak kishte nisur nga përpjekjet për të gjetur ushtrinë, kur përpara atij i shfaqet papritur një luan. Ai i tha luanit:

- “O luan, unë jam skllavi i liruuar nga vetë i Dërguari i Allahut. Ja, thashë të ta them se kush jam unë.” Luani, një të dëgjuar fjalët e Sefines, tundi bisht e kokë dhe iu afrua Sefines dhe i qëndroi pranë. Sa herë që ndiente ndonjë zë, luani drejtohej andej nga dëgjonte zëra dhe përpiquej që të mos e trembte Sefinen. Kjo sjellje e luanit zgjati derisa e shpuri Sefinen atje ku qëndronte ushtria. Kur e çoi atje, luani u kthye dhe iku.”⁴⁶

**Kur ujku flet me bariun dhe e lajmëron
për ardhjen e Profetit tonë të nderuar**

Tregon Ebu Said el-Hudriu: “Një ujk sulmoi tufën e dhenve dhe

⁴⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/146.

⁴⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/147.

mbërtheu njëren nga delet. Bariu u përpoq që ta shpëtonte delen nga kthetrat e ujkut dhe arriti që ta tërheqë. Ujku u ul në bisht dhe i tha bariut:

- “A nuk ke frikë nga Allahu, që ma merr nga duart atë që mua ma ka taksur për ushqim vetë Allahu?” Bariu tha:

- “E çuditshme, ç’të jetë ky ujk që më flet sikur të ishte njeri.” Ujku vazhdoi të fliste:

- “A do që të të them diçka edhe më interesante? Në Medinë ka ardhur Muhamedi, që po lajmëron gjithçka për të shkuarën dhe për të ardhmen.” Bariu i vuri dhentë përpara dhe mori rrugën e Medinës. E la kopenë në një vend, pastaj shkoi pranë të Dërguarit të Allahut dhe i tregoi ato që i kishin parë sytë dhe i kishin dëgjuar veshët. Në atë kohë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u kishte dhënë urdhër njerëzve që të bëheshin gati dhe të falnin namazin. Paskëtaj, Profeti ynë i nderuar doli jashtë dhe i kërkoi bariut që t’ua tregonte edhe besimtarëve ato që kishte parë dhe kishte dëgjuar. I Dërguari i Allahut, në fund, i tha atij njeriu:

- *“Të vërtetën tha ky njeri. Unë i betohem Allahut; Kiameti nuk ka për të ardhur para se njerëzit të fillojnë të flasin me kafshët e egra. Madje ai nuk ka për të ngjarë as pa ndodhur që me njeriun të flasë edhe lidhësja e këpucës, apo edhe maja e heshtës.”*⁴⁷

24. ME URDHRIN E ALLAHUT, EDHE DETET E LUMENJTË U SHËRBEJNË SAHABËVE

Kajs bin Haxhaxhi (radijallahu anhu) ka transmetuar se: “Pas ngadhënjimit të myslimanëve mbi Egjiptin, me një ushtri, në krye të së cilës ishte Amr bin Asi (radijallahu anhu), në muajin qershor, sipas përlogaritjeve kalendarike të koptëve, populli vendës u soll i tëri para Amr bin Asit dhe ata thanë:

- “O komandant! Ne kemi një zakon këtu që lidhet drejtpërsëdrejti me lumin Nil. Nëse nuk e kryejmë ritualin e përhershëm, ai nuk mbushet.” Amr bin Asi i pyeti ata se çfarë ishte ai zakon dhe ata iu përgjigjën:

⁴⁷. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/143.

- “Në ditën e dymbëdhjetë të këtij muaji, ne, me lejen dhe pëlqimin e nënës dhe babait të saj, marrim një vajzë beqare, e veshim me teshat më të bukura, i hedhim aromat më të mira dhe e hedhim atë në lumë.” Amr bin Asi (radijallahu anhu) u tha atyre:

- “Shikoni, ky është një zakon që nuk ka vend në Islam. Islami i ka zhbërë të gjitha zakonet e mëhershme.” Populli i Egjiptit priti, kaloi qershori, korriku, gushti. Dhe me lumin Nil nuk ndodhi asgjë e pazakontë. Atëherë, ata menduan të mërgonin. Amr bin Asi (radijallahu anhu) dërgoi lajm menjëherë tek Omeri (radijallahu anhu) me një letër. Në letër-përgjigjen e tij, Omeri (radijallahu anhu) shkruante këto fjalë:

- “Ti ke dhënë vendimin e drejtë, duke ua bërë të ditur atyre njerëzve se Islami i ka hedhur poshtë të gjitha zakonet e mëhershme. Shiko, unë të kam dërguar një copë letër, kur të të vijë kjo letër e imja, merre atë copë letër dhe hidhe në det.”

Me të arritur letra e Omerit (radijallahu anhu), Amri e hapi letrën dhe pa që në atë pusullë ishte shkruar:

- “Nga rob i Allahut dhe Prijësi i Besimtarëve, Omeri, për lumin e popullit të Egjiptit, Nilin:

Shiko, o Nil, nëse ti ke ndërmend të mbushesh e të dalësh nga shtrati, mos dil. Por, nëse do të jetë fuqia e pashtershme e Allahut ajo që do të të fryjë e do të të nxjerrë nga shtrati, atëherë unë i përgjerohem Atij që kësaj here mos të të derdhë nga shtrati.”

Amri, një ditë para ditës tradicionale të adhurimit të egjiptianëve e hodhi në lumë atë pusullë. Në atë kohë, populli po përgatitej për ta braktisur Egjiptin, sepse njerëzit nuk shihnin kurrfarë dobie kur lumi nuk fryhej e nuk dilte nga shtrati. Dita e adhurimit erdhi dhe Allahu e ngriti edhe disa metra më lart ujin e lumit Nil, gjersa e lëshoi jashtë shtratit. Kësisoj u zhbë edhe ai zakon i vjetër i egjiptianëve vendës.”⁴⁸

Ala bin el-Hadramiu kalon detin

Tregon Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e kishte dërguar Ala bin el-Hadramiun në

⁴⁸. Ibn Kethir, *Tefsir*, 3/464.

Bahrejn dhe bashkë me të isha edhe unë. Asokohe unë qeshë përballur me tri mirësi të mrekullishme njëra pas tjetrës: kur arritëm në breg të detit, ai u lut duke thënë:

- “O Alij, o Adhim, o Halim, o Kerim” Dhe pastaj na tha:

- “Ejani, thoni Bismil’lah dhe ecni përpara.” Thamë ‘Bismil’lah’ dhe ecëm. Kaluam matanë dhe kur shkuam në breg, pamë se as thundrat e deveve nuk na ishin lagur. Rrugën e kthimit e bëmë nga mesi i shkretëtirës. Uji na kishte mbaruar. Shkuam tek ai dhe i treguam se si qëndronte puna. U ngrit, fali dy rekate namaz, pastaj filloi të lutej. Papritur, në qiell u shfaq një re në trajtë mburoje dhe ra aq shumë shi, sa që dukej sikur ishte duke u derdhur me gota. E hoqëm etjen dhe mbajtëm edhe mjaftueshëm ujë për pjesën e mbetur të rrugës. Ndërsa mirësia e tretë e mrekullishme që pashë tek ai ishte kjo: Ai kishte vdekur dhe ne e patëm varrosur në një terren ranor. Mbaruam punë dhe u larguam. Kishim bërë një copë rruge dhe pastaj u kthyem duke thënë: “Se mos e zbulojnë kafshët grabitqare dhe e hanë.” Mirëpo, ne nuk e gjetëm më trupin atje ku e kishim varrosur.”⁴⁹

Kalimi i lumit të Tigrit gjatë ngadhënjimit mbi Medain

Ebu Bekr bin Hafs bin Omeri (radijallahu anhu) tregon: “Selman Farisiu ishte bashkë me Sa’din, kur po kalonin lumin, për të dalë në bregun tjetër. Ndërkohë që kuajt kishin hyrë pothuajse të tërët në ujë dhe po kalonin, Sadi thoshte: “Ne na mjafton Zoti, Ai është Mbrojtësi më i Mirë. Nëse nuk ndodh ndonjë kryengritje mes ushtsisë, apo nuk fillon që mëkatet t’ua kalojnë të mirave, Allahu medoemos që i ndihmon miqtë e Vet. Medoemos mundëson që të jetë feja e Tij ajo që sundon, duke u shkaktuar disfatë armiqve të Tij.”

Selmani iu tha atij:

- “Islami është një fe e re dhe e sapozbritur. E njerëzve do t’u binden edhe ujërat, ashtu siç u është bindur toka. Unë i betohem Allahut, që mban në jetë Selmanin, se kur të hyjnë myslimanët në Tigër, ata do të dalin prej andej pa u dëmtuar asnjë grimë.”

⁴⁹. Taberani, *Mu’xhemu’l-Kebir*, 18/95 (167).

Këto ishin fjalët e fundit dhe hynë në ujë. Uji ishte aq i egër, saqë fryrja e ujit e mbulonte krejtësisht pamjen e bregut matanë. Teksa po kalonin nëpër ujë, ata u përballën me më shumë vështirësi seç ishin përballur gjatë kalimit mes përmes tokës. Ushtarët, të zhytur në ujë, e kaluan lumin pa pasur asnjëfarë dëmi, siç e kishte thënë edhe Selmani.”⁵⁰

A'meshi (radijallahu anhu) përcjell nga disa nga shokët e tij, kur tregon: “Në kohën që mbërritëm në breg të lumit, lumi ishte si i tërbuar dhe rrymat i kishte të shumta. Persët ishin në anën tjetër të lumit. Një nga myslimanët tha ‘Bismil’lah’ dhe i grahu kalit përpara. Qëndronte mbi ujë dhe nuk i futeshin fare këmbët e kalit në ujë. Të njëjtën gjë e bënë edhe myslimanët e tjerë, thanë ‘Bismil’lah’ dhe u futën nëpër lumë. Persët, një të parë që myslimanët po e kalonin ujin pa u futur fare në të, filluan të bërtisnin:

- “Po vijnë djajtë, po vijnë përbindëshat!”, – dhe ia mbathën të gjithë me të katra.”⁵¹

25. EDHE ZJARRI U BINDET SAHABËVE

Muauije bin Harmeli (radijallahu anhu) tregon: “Unë pata ardhur në Medinë. Më mori Temijm Ed-Darij (radijallahu anhu) dhe më çoi për të ngrënë. Kisha ngrënë shumë atë natë, sepse kisha tri ditë që rrija në xhami, pa ngrënë dhe pa pirë asgjë. Në atë kohë, në Harre u shfaq një zjarr i papritur. Omeri (radijallahu anhu) erdhi te Temijmi dhe i ngarkoi atij detyrën e përkujdesjes për atë zjarr, duke i thënë:

- “Kontrolloje ti se çfarë po ndodh me atë zjarr.” Temijmi u përgjigj:

- “Po kush jam unë, o Prijësi i Besimtarëve, ku kam unë fuqi që t’ia dal i vetëm gjithë atij zjarri?” Pak më vonë, ata u nisën të dy për atje ku ishte ndezur zjarri. Omeri (radijallahu anhu) u fut menjëherë dhe filloi ta mblidhte zjarrin me duar dhe i dha drejtim kah një luginë aty pranë. Nga pas zjarrit iu vu edhe Temijmi. Në atë kohë, Omeri (radijallahu anhu) përsëriste:

⁵⁰. Taberi, *Tarih*, 2/460.

⁵¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/155.

- “Kush nuk sheh, nuk beson.”⁵²

26. NDRIÇIMI I RRUGËS SË SAHABËVE NË NJË MËNYRË KREJT TË JASHTËZAKONSHME

Hamza bin Amr El-Eslemij (radijallahu anhu) tregon: “Ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe ajo natë ishte një natë me shumë errësirë. Kur u ndamë nga njëri-tjetri, gishtërinjtë e mi filluan të përhapnin dritë. Madje nga ajo dritë filluan të mblidheshin të gjitha devetë. As nuk humbi, as nuk ngordhi asnjëra, sepse gishtërinjtë e mi përhapnin gjithandej dritë.”⁵³

E tregon Abdulhamid bin Ebi Absi: “Ebu Absi namazin e falte vazhdimisht pas të Dërguarit të Allahut; pastaj kthehej në lagjen e Beni Harithes. Në të njëjtën kohë, Ebu Absi ishte edhe një prej atyre që kishin marrë pjesë në Bedër. Një nate të errët dhe me shi, teksa po kthehej për në shtëpi, bastuni që mbante në dorë filloi të përhapte dritë, kësisoj ai arriti edhe më lehtë në shtëpinë e tij.”⁵⁴

27. RETË BËJNË HIJE PËR SAHABËT

Abdurrahman bin Imran bin Harithi na tregon: “Bashkë me Mikdad bin Esuedin, Amr bin Abesenë dhe Shafi bin Habijb el-Hudheliun (radijallahu anhum) u nisëm për rrugë. Amr bin Abeseja u nda prej nesh për një ditë të vetme, sepse donte të shkonte të kontrollonte njëherë kopetë e tij. Aty në të hyrë të drekës unë shkova ta takoja. Kur ç’të shihja, mbi të ishte ndalur një re dhe bënte hije për të! Shkova dhe e njoftova. Ai më tha mua:

- “E di, e vura re, por, po dëgjova se i ke treguar njeriu për këtë që ke parë këtu, prishemi bashkë!” I betohem Allahut, se, deri ditën që ai u nda nga kjo jetë unë nuk i tregova askujt për atë që më kishin parë sytë atë ditë.”⁵⁵

⁵². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/153.

⁵³. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 8/213.

⁵⁴. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/152.

⁵⁵. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 3/6.

28. LUTET PROFETI YNË DHE SAHABËT E TIJ TË ZGJEDHUR DHE NË NDER TË TYRE BIE SHI

Enesi (radijallahu anhu): “Ditën e premte, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte ulur në minber dhe po na ligjëronte, kur nga ana më afër minberit në xhami hyri një burrë, i cili tha:

- “O Resulullah! Pasurinë tuaj e mori lumi. Toka është çarë nga thatësira. Lutju Allahut që të na dërgojë shi.” I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) ngriti duart kah qielli dhe filloi të lutej me fjalët:

- “O Zot, jepna neve ujë! O Zot, jepna neve ujë!” Enesi thotë se:

- “Uallahi, në atë kohë, në qiell nuk shihje as edhe një re të vetme. Dhe mes majës së Selit në Medinë dhe nesh nuk kishte, jo vendbanim, por as sikur edhe një shtëpi të vetme. Nga pas asaj kodre u shfaq një re në formën e një mburoje. E kur iu afrua vendit ku ishim ne u zgjerua dhe filloi një shi i rrëmbyer. Uallahi, për gjashtë ditë me radhë nuk pamë dot diell me sy. Të premten tjetër, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ishte duke na mbajtur hutben, kur nga e njëjta portë u fut po i njëjti njeri, i cili foli prapë, por kësaj here për të thënë:

- “O Resulullah! U prishën i gjithë malli e tërë të mbjellat, rrugët janë prishur! Lutju Allahut e të na e ndërpresë këtë shi.” I Dërguari i Allahut hapi sërish duart dhe iu lut Zotit me këto fjalë:

- “O Zot, mos e lër më shiun të bjerë mbi ne, çoje atë të bjerë në rrethinat e tjera përreth. Bëje atë të bjerë nëpër male e nëpër kodra.”

Pas pak shiu u ndërpre. Ne dolëm nga faltorja duke ecur me njëri-tjetrin nën rrezet e një dielli plot shkëlqim.”⁵⁶

Lutja e Huxhr bin Adijit

E tregon Ibrahim bin El-Xhunejdi (radijallahu anhu): “Huxhr bin Adijit i nevojitej të merrte gusul. Ai i tha nëpunësit në detyrë:

- “Ma sill atë ujin që kam për të pirë dhe të marr gusul me të. Për të pirë po përdor atë që do të marr që nesër.” Nëpunësi i tha:

⁵⁶. Buhari, *Sahib*, 1/345 (973).

- “Kam frikë se kështu siç e ke nisur do të vdesësh nga etja. Pastaj Muauija do të më vrasë po ta marrë vesh.” Sakaq, Huxhr bin Adiji (radijallahu anhu) filloi t’i lutej Allahut. Zuri të binte pak shi. Huxhr bin Adiji mori ujë aq sa iu desh dhe shokët i thanë Huxhrit:

- “Lutju Allahut edhe që të na shpëtojë ne nga kjo gjendje, në të cilën jemi katandisur; të na marrë ne pranë vetes.” Dhe ai i ngriti duart të hapura dhe filloi të lutej:

- “O Allah! Falna ne atë që është më e mira e më e mbara për ne.” Nuk se kaloi shumë kohë e gjatë dhe Huxhri bashkë me një grup shokësh të tij u vranë, duke rënë kësisoj dëshmorë.”⁵⁷

Nga qielli zbret një kovë

Këtë e tregon Osman bin El-Kasimi (radijallahu anhu): “Gjatë mërgimit, Umu Ejmenin (radijallahu anha) e zuri darka në një vend të quajtur Munsaraf, diku ende pa mbërritur në Reuha. E kishte marrë etja, por nuk kishte asnjë pikë ujë me vete. Ishte edhe me agjërëm. Etja e kishte bërë të ndihej shumë keq. Në siklet e sipër, nga qielli asaj iu zbrit një kovë me ujë e lidhur me një litar të bardhë. E mori ujin dhe piu derisa u ngop. Umu Ejmeni thotë se: “Që pas asaj ngjarjeje unë nuk kam ndierë ndonjëherë më etje. Kam agjëruar edhe gjatë ditëve më të nxehta të verës, por që prej se kam pirë prej atij uji, unë nuk jam ankuar ndonjëherë nga etja për ujë.”⁵⁸

29. BEKIMI I UJIT

Bekimi i ujit me dorën e të Dërguarit Fisnik

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) na tregon: “Ishte kohë e namazit të ikindisë. Njerëzit kërkuan për ujë, që të merrnin abdes e të falnin namazin, por nuk arritën dot që të gjenin. Sollën pak ujë tek i Dërguari i Allahut. Profeti ynë i nderuar (pagja e Zotit qoftë mbi të) futi dorën në ujë dhe i urdhëroi të gjithë që të merrnin abdes nga ai ujë. Kam qenë vetë dëshmitar, se si nga ata gishtërinj të bekuar filloi

⁵⁷. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 1/315.

⁵⁸. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 8/224.

të rridhte ujë sikur të ishte duke rrjedhur nga ndonjë kulesë. Morën abdes të gjithë myslimanët. Kur e pyesnin Enesin (radijallahu anhu) në lidhje me numrin e atyre që kishin marrë abdes atë ditë, ai u ka kthyer përgjigje duke u thënë:

- “Mund të kenë qenë diku te tetëdhjetë a mos më shumë.” Teksa, në një transmetim tjetër që përmendet te Buhariu është regjistruar se thuhet që numri i njerëzve që morën abdes atë ditë ishte diku te treqind a mos më shumë.”⁵⁹

Imran bin Husajni (radijallahu anhu) na tregon: “Ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ishim shumë të etur. Po ecnim, kur, gjatë rrugës, përballë na doli një grua që mbante dy enë për të pirë ujë, të cilat i kishte fshehur mes këmbëve. Ne e pyetëm atë grua se ku gjendej uji dhe ajo na u përgjigj duke na thënë:

- “Nuk ka ujë.”

- “Po mirë,” – iu përgjigjëm ne, – “sa larg, në çfarë distance është uji me shtëpinë tuaj?”

- “Një ditë dhe një natë larg,”. – na tha gruaja dhe ne i thamë:

- “Ti shko tek i Dërguari i Allahut.”

- “E çfarë do të thotë kjo ‘i Dërguari i Allahut’? Ne nuk dimë gjë për tël”, – na u përgjigj neve ajo grua.

Ne e takuam atë grua me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Ajo grua i tregoi atij po ato që na kishte treguar edhe neve. Mirëpo, ajo nuk na kishte thënë neve asgjë që ajo ishte nënë jetimësh. Ai kërkoi që ato enë me ujë t’ia binin atij dhe ai e ngacmoi ujin me dorë. Nga ai ujë pimë diku te dyzet vetë, që shuam etjen. Mbushëm edhe enët që kishim me vete dhe vetëm devetë i lamë pa u dhënë ujë. Pastaj i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) na tha neve:

- “*Sillmini mua ato që keni me vete!*” Gjithë çfarë kishim, bukë të thara, thërime dhe hurma ia sollëm asaj gruaje. Kur ia dha, Profeti ynë i tha asaj gruaje:

- “*Merri këto dhe çoja familjes sate. Vetëm se dua që të dish diçka, ne nuk e pakësuam aspak ujin që na dhe ti. Ne pimë vetëm atë pjesë që na e fali Allahu.*”

⁵⁹. Buhari, *Sahib*, 3/1310 (3380).

Ajo grua u kthye te fëmijët e saj me ujë dhe me gjëra për të ngrënë. Ajo u tha atyre:

- “Gjatë rrugës u takova me njeriun më prekës dhe më me ndikim mbi tërë njerëzinë. Me ato që thoshin ai ishte një profet.” Më vonë, ajo grua me gjithë familjen e saj pranuan Islamin dhe u bënë myslimanë.”⁶⁰

30. BEKIMI I USHQIMEVE GJATË LUFTËRAVE

E tregon Ebu Amre el-Ensari (radijallahu anhu): “Ka qenë gjatë një lufte, kur ne ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Nga uria, myslimanëve dukej sikur barku do t’u ngitej me shpinën. Prandaj, ata erdhën te Profeti ynë Fisnik dhe i kërkuan që t’i thernin disa nga devetë.

- “Jemi të detyruar, nuk kemi se çfarë të bëjmë tjetër.” Omeri (radijallahu anhu) e kuptoi se Resulullahu do t’u jepte leje, ndaj tha:

- “O Resulullah! Kushedi se si do të katandisemi, nëse nesër përballemi me armiqtë të uritur dhe pasi kemi ecur në këmbë përgjatë një rruge shumë të gjatë? Nëse ne u bëjmë thirrje myslimanëve, që të mbledhin gjithë ushqimet që u ka taksur Zoti dhe ti e sheh me vend që t’i lutemi Allahut që t’i falë begati ushqimit tonë, nuk ka dyshim, se Allahu do të na sjellë neve bollëk për hir të lutjes sate për begati.”

Profeti ynë kërkoi që myslimanët të mblidhnin të gjitha ushqimet që kishin marrë me vete për rrugë dhe për luftë. Ushtarët filluan t’i sillnin pak apo shumë, ato që kishin marrë me vete. Ata që kishin sjellë më shumë ishin disa që kishin marrë me vete nga një kilogram hurma. I Dërguari i Allahut (pajja e Zotit qoftë mbi të) i mbledhi të gjitha ushqimet, pastaj u ngrit në këmbë dhe u lut për njëfarë kohe. Mandej, ai u bëri thirrje ushtarëve që të sillnin menjëherë enët dhe t’i mbushnin me ushqim. Nuk mbeti asnjë enë pa u mbushur me ushqim të bollshëm. Megjithatë, ushqimet e sjella në fillim mbetën aty, të paprekura fare.

Kur e pa i Dërguari i Allahut se çfarë kishte ndodhur, ai tha:

- “Unë dëshmoj se nuk ka asnjë zot tjetër, përveç Allahut dhe se unë jam i

⁶⁰. Buhari, *Sabih*, 3/1308 (3378).

Dërguari i Tij. Në ditën e Kiametit, mes atyre që riktbehen tek Allahu, duke i besuar këto dy dëshmi, dhe Xhebenemit do të ribet një perde.”⁶¹

Ijas bin Selemeja (radijallahu anhu) përcjell nga i ati: “Ne ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) në luftën e Hajberit. Ai na urdhëroi të gjithëve që të sillnim aty të gjitha ushqimet që kishim marrë me vete. I vuri ato të gjitha mbi një shtrojë që kishte shtruar në tokë. Zgjata kokën të shihja dhe pashë se të gjitha ato ushqime ishin a s’ishin në madhësinë e një deleje shtrirë. Si numër ne ishim njëmijë e katërqind vetë. Hëngrëm të gjithë mirë e mirë, derisa u ngopëm, por, prapëseprapë, unë pashë se ushqimet ishin ende aty, sikur ne të mos kishim ngrënë asgjë. Mandej nga ato ushqime ne mbushëm edhe çantat e lëkurës që kishim me vete.”⁶²

31. BEGATIA E USHQIMEVE QË ISHIN PËR T’U NGRËNË NË KOHË TË ZAKONSHME

Semure bin Xhundubi (radijallahu anhu) na tregon: “Të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i sollën një enë ushqimi të mbushur me therijd. Profeti ynë i nderuar dhe një grup myslimanësh hëngrën prej tij. Ata vinin grupe-grupe, hanin nga ai ushqim dhe çoheshin e iknin. Kështu vazhdoi deri në drekë, derisa erdhi një burrë dhe pyeti nëse kishte mbetur më ushqim. I Dërguari Fisnik tha:

- “*Nëse burimi i atij ushqimi do të kishte qenë kjo tokë e këtij rruzulli, që është vendi i shkakësive, përgjigjja ime për ty do të kish qenë ‘Jo.’, por, burimi i begatisë në këtë ushqim janë qiejt (mirësia dhe bujaria e Allahut).”⁶³*

Uathile bin el-Eskaja (radijallahu anhu) na ka treguar: “Unë isha njëri prej sahabëve të Suffes. Një ditë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kërkoi t’i sillnim një copë buke. E mori copën e bukës dhe e futi brenda një ene, e shtypi dhe brenda në të hodhi edhe ujë të nxehtë. Pastaj shtoi edhe pak vaj dhe e përzjeu, derisa ajo mori trajtë uniforme. Pastaj tha:

- “*Ik tani, gjej dhe sill këtu dhjetë vetë; por i dhjeti i tyre të jesh ti!*” Shkova, i gjeta dhe i solla.

⁶¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/119; Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 1/180.

⁶². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/115.

⁶³. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 5/12 (20147).

- “*Hani tani, por jo nga sipër, hani secili nga anët; sepse begatia rrjedh nga lart poshtë.*”, – tha ai. Ata që kishin ardhur hëngrën sa u ngopën.”⁶⁴

32. BEGATIA TE DRITHËRAT DHE TE FRUTAT

Bekimi i hurmave me lutjen profetike

Këtë e tregon Xhabiri (radijallahu anhu): “Tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi një burrë që ishte i uritur dhe kërkonte diçka për të ngrënë. Andaj, Profeti ynë i nderuar mori dhe i dha atij gjysmë barre deveje me elb. Ai burrë, e shoqja dhe shërbëtori i tyre hëngrën për një kohë të gjatë nga ai elb. Derisa, më në fund, u tha mendja që ta peshonin, për të parë se ‘vallë edhe sa u kishte mbetur’. Profeti ynë (pajja e Zotit qoftë mbi të) u tha atyre:

- “*Po të mos e kishit peshuar, ju do të hanit edhe nga ai elb dhe ai do t’ju kishte mjaftuar juve për sa të kishit jetë.*”⁶⁵

Hurmat e mbetura trashëgim Xhabirit (r.a.) shtohen prej begatisë së lutjes së të Dërguarit të Allahut për to

Tregon vetë Xhabiri (radijallahu anhu): “Babai im pati ndërruar jetë duke lënë borxhe pas. Unë shkova tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i thashë:

- “Babai im vdiq dhe ka lënë ca borxhe pas. E unë sot nuk kam asgjë përveç hurmave, që mund të paguaj për të shlyer borxhet e babait. Dhe me ato hurma që dalin nga kopshti, do të më duhen disa vjet për ta paguar borxhin. Të lutem, eja edhe ti me mua, të më ndihmosh, që ata që kam për t’i paguar të mos më vënë shumë në vështirësi.” I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) eci pak përreth hurmave të mbledhura dhe u lut mbi to. Pastaj kaloi dhe shëtitu pak edhe në anën tjetër të hurmave dhe pasi u ul në një vend aty, më tha mua që t’ua shpërndaja hurmat atyre që u kisha borxhe. Edhe pse unë ua shpërndava borxhet të gjithëve me hurma, aty kish mbetur po

⁶⁴. Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/490 (16049).

⁶⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/104.

e njëjta sasi hurmash, sikur të mos kishte vënë dorë njeri.”⁶⁶

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) na tregon: “Nëna më pati çuar mua tek i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe më pati prezantuar duke thënë:

- “Ja, o Profeti ynë, ky është shërbëtori juaj i vogël, lutuni për të mirën e tij.” Dhe Profeti ynë u lut me fjalët:

- “O Zot, *fali atij shumë pasuri dhe shumë fëmijë; e bëja atij jetën sa më të gjatë, e falja mëkatet.*” Në të vërtetë, unë kam marrë pjesë në varrimin e plot nëntëdhjetë e tetë vetë nga brezi im (sipas një transmetimi njëqind e dy, ndërsa në një tjetër theksohet numri njëqind e pesë). Çdo vit merrja dy herë prodhim. Kam jetuar gjersa m’u bezdis të jetuarit. E tani, tani shpresoj që të pranohet edhe pjesa e katërt e asaj lutjeje dhe të më falen mëkatet.”⁶⁷

33. BEGATIA E SHFAQUR NË VAJ DHE QUMËSHT

Ja se si na e tregon Hamza bin Amri (radijallahu anhu) këtë begati: “Ushqimin e sahabëve të Suffes, të cilët nuk ndaheshin për as edhe një çast nga i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), e kishin marrë përsipër disa nga sahabët. Një mbrëmje hanin te një sahab, ndërsa mbrëmjen tjetër shkonin pranë një tjetër sahabi. Një natë, radha ishte në shtëpinë time. Ua bëra gati ushqimet sahabëve të të Dërguarit Fisnik, vetëm se, në atë kohë, nuk ia kisha lidhur mirë grykën e calikut të vajit. E vura ushqimin pranë vendit ku ishte vaji. Pastaj bëra një lëvizje të nxituar dhe vaji u derdh, prandaj edhe ushqimi u bë që të vinte vështirë ta shihje me sy. Thashë me vete: “Ç’më gjeti! E çova dëm me dorën time ushqimin e të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).” U mërzita tej mase. Profeti ynë më tha:

- “*Sillma mua atë ushqim?*”

- “Nuk e sjell dot, o Resulullah.” – thashë unë. Pashë njëherë pas vetes dhe ç’të shihja! Nga ena e vajit po vinte një si zhurmë sikur pikonte diçka. Thashë me vete: “Ç’e vret mendjen, o njeri, zëre se

⁶⁶. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/116.

⁶⁷. Ibn Sa’d, *Tabakatu’l-Kubra*, 7/19.

është derdhur ajo që ishte tepër.”, dhe kur shkova të shihja enën e vajit, ç’të shihja, gjysma e enës ishte plot. E mora dhe u ktheva tek i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) dhe ia tregova se ç’më kishte ngjarë. Profeti ynë m’u përgjigj:

- “*Nëse do ta kishe lënë ashtu të paprekur atë enë, ajo do të mbushej plot dhe gryka e saj do të lidhej.*”

Ndërsa, në një tjetër transmetim, thuhet se ai ka thënë kështu:

- “*Po ta kishe lënë ashtu, të ndodhte ç’të donte me të, nëpër të gjithë luginën do të rridhte veç vaj.*”⁶⁸

34. TË MIRA MATERIALE QË VIJNË NË FORMË MREKULLIE

Tregon Ibni Mesudi (radijallahu anhu): “Unë punoja si çoban me kopetë e dhenve të Ukbe bin Ebi Muajtut. Një ditë tek unë erdhën i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) bashkë me Ebu Bekrin. I Dërguari i Allahut më foli mua dhe më pyeti:

- “*A ka ndopak qumësht, o djalosh?*”

- “Ka, por nuk të jap dot, sepse nuk është imi, është i tjetërkujt, tek unë është amanet.”

- “*Shumë mirë, po në mes deleve nuk ka ndonjë që është shterpë?*”, – më pyeti ai mua.

- “Ka!”, – iu përgjigja unë dhe i çova atij një nga delet shterpa. Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) preku pak gjinjtë e deles, i moli dhe filloi të pinte nga qumështi që doli prej asaj deleje. I dha edhe Ebu Bekrit e piu edhe ai. Pastaj iu drejtua gjirit të deles dhe i tha:

- “*Kthehu në gjendjen e mëparshme.*”, – dhe gjiri i deles u mblodh dhe ajo u pre sërish nga qumështi. Më vonë unë shkova sërish pranë tij dhe i thashë:

- “Mësomë edhe mua Kur’an.” Më ledhatoi kokën dhe më tha:

- “*Të faltë Zoti. Po ti zaten i di shumë gjëra dhe një ditë patjetër që do ta mësossh edhe atë.*”⁶⁹

⁶⁸. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 4/431.

⁶⁹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/102.

Ushqimi që u vjen të Dërguarit të Allahut, Ebu Bekrit (r.a.) dhe disa të tjerëve

E tregon vetë Ebu Bekri (radijallahu anhu): “Ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur, teksa ecnim, sytë na zunë një tribu arabe. Profeti ynë pa edhe një shtëpi, e cila ishte vetme mes një vendi rrafsh, ku nuk kishte asgjë tjetër dhe mori drejtim për andej. Në shtëpi ishte vetëm një grua. Ajo grua, një të na parë ne, tha:

- “O rob i Allahut! Unë jetoj këtu vetëm dhe nuk kam askënd tjetër. Nëse doni gosti, do të shkoni tek i pari i fisit.”

I Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) nuk iu përgjigj asaj gruaje. Edhe pak dhe do të binte muzgu. Nuk kaloi shumë dhe aty u kthye edhe i biri i asaj gruaje që kishte një tri-a katër dhi, që dilte dhe i kulloste. Ja si iu drejtua të birin ajo grua:

- “O bir, merre një dhi e atë thikën që është aty jashtë dhe çojua atyre njerëzve atje tej dhe thuaju nga ana ime: ta therin dhe ta hanë këtë dhi, por të na ndajnë edhe neve një pjesë.” Kur fëmija shkoi dhe ia tregoi Profetit tonë ato që e kishte porositur nëna, Profeti ynë i tha atij:

- “*Hiqe thikën dhe më sill një enë.*” Fëmija tha:

- “Po u bë natë, e kjo dhi nuk ka qumësht!”

- “*Ti bëj si të them unë.*”, – e këshilloi i Dërguari i Allahut fëmijën. Atëherë, fëmija shkoi dhe solli një enë. I Dërguari i Allahut kontrollloi pak gjinjtë e dhisë me dorë dhe e moli atë derisa u mbush plot ajo enë. Pastaj i tha fëmijës:

- “Këtë merre dhe çoja nënës.” Nëna e fëmijës piu prej atij qumështi derisa u ngop. Kur u kthye fëmija, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) i tha atij:

- “*Tani merre këtë dhe sill një tjetër.*” E moli edhe atë si të parën dhe i dha të pinte Ebu Bekrit, pastaj moli edhe një tjetër dhe nga qumështi i saj piu vetë.

Ebu Bekri (radijallahu anhu) thotë kështu: “Natën e kaluam aty, pastaj vazhduam rrugën. Ajo grua i pati vënë emrin “i Bekuari” Profetit tonë të nderuar. Me kalimin e kohës, asaj gruaje filloi t’i

shtohet kopeja. Aq sa, njëherë, patën ardhur në Medinë për të shitur. Dhe i biri i tregoi së ëmës Ebu Bekrin, duke i thënë:

- “Shiko, nënë, ky ishte njeriu tjetër që ishte atëherë me atë burrin e bekuar.” Ajo grua m’u drejtua mua:

- “O rob i Zotit, kush ishte ai njeri që pati ardhur atëherë me ty në shtëpinë tonë?”

- “A nuk e di ti se kush është ai?”, – e pyeta unë.

- “Jo, nuk e di!”, – më tha ajo.”

- “Ai ishte Profeti.”, – ia ktheva unë. Një të dëgjuar përgjigjen time, gruaja tha:

- “Atëherë do të më çosh tek ai.” E mora atë grua dhe e çova pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Profeti ynë e gostiti gruan me gjëra shumë të mira dhe i bëri edhe shumë dhurata të ndryshme. Edhe ajo grua i solli Profetit tonë të nderuar djathë dhe disa gjëra të veçanta që përgatisnin beduinët. Atëherë, Profeti ynë e veshi atë grua me tesha të reja dhe i dha edhe disa dhurata me vete. Ajo grua, atë ditë, u bë myslimane.”⁷⁰

Ardhja e rrëskut të sahabëve me një produkt të madh nga deti

Tregon Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu): “Një ditë, ne shkua tek i Dërguari Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe iu ankua se ishim shumë të uritur. Ai na tha:

- “*Shumë shpejt Allahu ka për t’ju falur juve ushqime shumë të mira dhe me bollëk madje.*” Nuk kaloi shumë kohë dhe i Dërguari i Allahut na dërgoi ne që të ndiqnim Ebu Ubejden (radijallahu anhu) si komandant dhe të viheshim në ndjekje të një karvani të kurejshëve. Me vete, për të ngrënë, na dha vetëm disa hurma; sepse nuk pati arritur të gjente dot ndonjë gjë tjetër më shumë. Ebu Ubejdeja na ndante neve nga një hurmë në ditë.

- “Si ia dilnit me një hurmë të vetme?”, – na pyesnin dhe Xhabiri u tregonte atyre:

- “Ne e mbajmë hurmën nëpër gojë dhe e thithim, njësoj siç

⁷⁰. El-Hindi, *Kenzul-Ummal*, 16/944 (46287).

foshnjat thithin qumështin, e pas saj pimë edhe shumë ujë. Deri në mbrëmje ashtu ia dlinim. Godisnim degët e pemëve me copa druri që gjenim dhe gjethet e rëna i regnim dhe i hanim.”

Derisa, në fund, arritëm pranë bregut të detit dhe përpara na u shfaq një pjesë toke me rërë, e cila u fry dhe doli diçka. Kur u afruam dhe e pamë, mësuam se ai ishte një lloj peshku, të cilin e quanin “anber”. Edhe pse Ebu Ubejdeja na tha se ai ishte i pistë, më vonë ai na tha:

- “Ne jemi məkëmbës të të Dërguarit të Allahut dhe jemi në rrugën e Allahut. Hajeni, meqë kemi mbetur në vështirësi.” Ne ishim treqind vetë dhe atje qëndruam për gati një muaj. Aty fituam shumë në peshë. Vajin që dilte nga syri i peshkut e mbushnim në enë dhe nga ai peshk këputnim copa sa një ka. Ebu Ubejdeja, një ditë, qe ulur me shokët e tij te syri i peshkut. Dhe një nga halat e peshkut nuk e pati larguar dot, ndaj e pati tërhequr me deve. Kur erdhi koha për t’u kthyer, ne poqëm edhe ca nga mishi i mbetur, që ta kishim me vete. Sa u kthyem në Medinë, ne i treguam të Dërguarit të Allahut se çfarë na kishte ndodhur dhe ai na tha:

- “*Ai peshk ishte ushqimi që Allahu jua fali juve si mirësi. Nëse ju ka mbetur ndopak prej mishit të tij, na jepni të hamë edhe ne.*” Dhe ne ua dhamë atyre mishin që kishim me vete dhe ata e hëngrën.”⁷¹

35. SAHABËVE U JEPET TË PINË UJË TEKSA JANË NË GJUMË

Abdullah bin Selami (radijallahu anhu) na tregon: “Në kohën që Osmanin (radijallahu anhu) e patën rrethuar kryengritësit, unë shkova tek ai që ta pyesja si ishte. Mbërrita dhe ai më priti duke më thënë:

- “Mirë se erdhe, vëllai im.”, – duke më treguar:

- “Sonte pashë të Dërguarin e Allahut, ja, ishte mu këtu te dera. Më tha mua:

- “*Të kanë rrethuar?*”

- “Po!”, – i thashë unë.

- “*Të kanë lënë pa ujë, apo jo, o Osman?*”

- “Po!”, – i thashë unë sërish dhe ai më zgjati një kovë me ujë. Piva gjithë qejf, derisa u ngopa, nga ai ujë. Madje, ja, edhe tani e ndiej në kraharor dhe në shpinë freskinë e atij uji. Pastaj ai më tha mua:

⁷¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 4/276.

- “Po të duash, ti mund të kesh ndihmën e Allahut kundër tyre. Ose, po deshe, iftarin mund të vish ta çelësh këtu, me ne, bë, kë do të zgjedhësh?” Unë zgjodha që të shkoj dhe ta çel atje, pranë tij, iftarin.

Atë ditë Osmanin (radijallahu anhu) e vranë dhe ai ra dëshmor.”⁷²

36. SAHABËT DHE BEGATIA E TË DHËNIT NË RRUGËN E ALLAHUT

Abdurrahman bin Jezid bin Xhabiri (radijallahu anhu) tregon: “Mua më ka treguar robinja e liruar nga Ebu Umameja, se: “Ebu Umames i pëlqente tej mase që të jepte në rrugën e Allahut, madje ai mbliidhte pasuri enkas për t’i dhënë në rrugën e Allahut. Ai nuk kthente asnjë lypës duarbosh, jepte gjithçka, qoftë edhe një kokërr qepë, apo një kokërr hurmë, gjithë ç’t’i gjendej në atë kohë. Një ditë, tek ai erdhi një lypës, por ai nuk kishte asgjë për të ngrënë, që t’ia jepte. Kishte vetëm tre dinarë. Ai i dha lypësit një dinar. Pastaj erdhi edhe një lypës tjetër, i dha edhe atij një dinar. Erdhi një lypës i tretë dhe ai i dha atij dinarin e vetëm që i kishte mbetur.

Robinja e tij thotë: “U nxeha me të dhe i thashë:

- “Po nuk na ke lënë neve asgjë!” Ebu Umameja vuri kokën në jastëk për të bërë pak nga gjumi i drekës. Kur dëgjova që po këndohej ezani i drekës, shkova dhe e zgjova. Mori abdes dhe u nis për në xhami. Atë ditë ishte me agjërim. Më erdhi keq dhe gjeta ca gjëra hua dhe thashë t’i përgatisja diçka për iftar. Ndeza edhe një kandil në shtëpi. Kur hyra në dhomë, që t’i rregulloja shtratin, kur ç’të shihja, atje ishin ca florinj! I numërova, ishin plot treqind dinarë. Thashë me vete:

- “Epo, ky njeri i paskësh marrë masat, derisa jep aq shumë lëmoshë.”

Ebu Umameja fali edhe namazin e jacisë, pastaj u kthye në shtëpi dhe kur e gjeti sofrën të shtruar dhe kandilin të ndezur, fillimisht buzëqeshi, pastaj tha:

- “Faleminderit kësaj gruaje.” Ebu Umameja hëngri iftarin dhe unë prita në këmbë derisa të mbaronte. Pasi mbaroi ushqimin, i thashë:

⁷². Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/182.

- “Zoti të faltë! Paratë që i duheshin shtëpisë i kishe lënë në shesh në shtrat, pa më thënë mua asgjë! I mora dhe i fsheha.” Ebu Uameja (radijallahu anhu) m’u kthye:

- “Për çfarë parash e ke fjalën, unë nuk kam lënë askund asnjë parë!” Ngrija shtratin dhe ia tregova; u gëzua pa masë dhe dukej që ishte i çuditur. Zaten, që nga ajo ditë edhe unë e preva dhe e hodha tutje brezin e zjarrit që mbaja gjithmonë dhe u bëra myslimane.

Ibni Xhabiri (radijallahu anhu) thotë: “Ishte po kjo robinjë, që pati liru Ebu Uameja, e kam parë vetë se si rrinte në xhaminë e Humusit dhe u mësonte grave Kur’an, Sunetin e Profetit tonë të nderuar dhe ligjësitë e Islamit, duke dhënë një kontribut shumë të veçantë që gratë ta njihnin më së miri fenë e tyre.”⁷³

37. BOLLËKU I ARDHUR ME NJË LUTJE TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

E tregon Uruetu’l-Barikiu (radijallahu anhu): “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) u përball me një shitës ambulant. I dha atij një dinar dhe e porosi që me ato para të blinte një dele. Shitësi ambulant doli në Pazar dhe me atë dinar bleu jo një, por dy dele. Gjatë rrugës ai takoi një blerës dhe ia shiti një të tjetrën nga delet për një dinar. Ai u kthye te Profeti ynë me një dele dhe një dinar në dorë. Atëherë, Profeti ynë Fisnik (paqja e Zotit qoftë mbi të) i tha atij duke u lutur:

- “*Zoti të faltë ty begati në tregti.*” Na është transmetuar, se ai burrë, falë begatisë së kësaj lutjeje nga ana e Profetit tonë, sikur dhe të merrte e të dilte për ta shitur, ai prapë do të arrinte të nxirrte fitim.”⁷⁴

Tregon Ebu Ukajli (radijallahu anhu): “Gjyshi im, Abdullah bin Hishami (radijallahu anhu) më dërgonte mua të dilja në pazar, që të blija ushqim. Atje takohesha me Ibnu’z-Zubejrin dhe Ibni Omerin dhe ata më thoshin:

- “Na lejo të bëhemi edhe ne ortakë me ty në tregtinë tënde, sepse Krenaria e Gjithësisë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) është lutur enkas

⁷³. Ebu Nu’ajm, *Hijje*, 10/129.

⁷⁴. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 2/476.

për ty, që tregtia dhe shit-blerjet e tua të jenë të begata.” Dhe gjyshti im ua plotësonte atyre këtë kërkesë. Shumë herë arrinin të nxirrnin fitime sa një barrë deveje, të cilin e dërgonte pastaj në shtëpi.”⁷⁵

38. TË SËMURËT GJEJNË SHËRIM ME LUTJEN E PROFETIT TONË TË NDERUAR

Këtë e tregon Aliu (radijallahu anhu): “Isha i sëmurë, kur aty ia behu i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe nga goja ime ishin duke dalë këto fjalë:

- “O Zot! Nëse më ka ardhur exheli, merrmë mua një çast e më parë pranë vetes. Por, nëse exheli nuk do të vijë tani, por më vonë, atëherë shpëtomë mua duke i dhënë shërim sëmundjes sime. E, nëse kjo është vetëm një sprovë, atëherë më bëj mua që të duroj.” Profeti ynë më pyeti mua:

- “*Si e the atë lutje, ma trego edhe mua njëherë?*” Dhe unë ia përsërita ato që kisha thënë teksa lutesha. Më preku lehtë me këmbë dhe u lut duke thënë:

- “*O Allah, jepi atij shërim.*” Që prej asaj kohe unë nuk kam pasur më asnjëherë as edhe një dhimbje të vetme.”⁷⁶

39. MOSPREKJA E SAHABËVE NGA HELMI, NJË MIRËSI E ALLAHUT

Tregon Muhamed bin Ebi’s-Seferi: “Një prej të parëve të Hires, Ibni Bukajla (Amr bin Abdulmesihu) kishte një shërbyes. Kudo që do të lidhte brezin ai shërbyes, aty do të gjendej një torbë. Në atë kohë atje kishte shkuar si mysafir edhe Halidi. Njëren nga herët Halid bin Uelidi (radijallahu anhu) e mori atë torbë dhe futi dorën në të, për të parë se çfarë kishte, pastaj u drejtua nga Amri dhe e pyeti:

- “Ç’është kjo kështu, o Amr?” Amri ia ktheu duke i thënë:

- “Unë betohem tek amaneti i Allahut, se ky është një helm shumë i fuqishëm, i cili do ta vriste menjëherë një njeri.”

⁷⁵. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/166.

⁷⁶. Tirmidhi, *Sunen*, 5/560 (3564).

- “Po pse e ruan këtë helm?”, – e pyeti Halidi i habitur dhe Amri i tregoi se si qëndronte puna, duke i thënë:

- “Kisha frikë se mos ju mbanit qëndrim ndryshe ndaj nesh dhe e ruajta këtë helm, që në një rast të atillë ta pija e të vrisja veten. Më mirë të vdes, sesa popullit dhe banorëve të kësaj rrethine t’u vijë ndonjë e keqe nga unë.” Halid bin Uelidi i tha atij:

- “Asnjë gjallesë nuk vdes pa i ardhur exheli i caktuar nga Allahu. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Atij që është Zoti i Tokës dhe i Qiejve dhe që ka emrat më të Bukur. Me emrin e Tij asnjë sëmundje nuk i bën dot dëm njeriut.” – dhe e mori helmin për ta futur në gojë. Edhe pse ata që gjendeshin aty bënë ç’të mundnin për ta penguar, madje iu vërsulën edhe sipër, por ai u tregua më i shpejtë dhe e kapërdiu helmin. Amri, kur pa që ai helm nuk i bëri Halidit asnjë efekt, tha:

- “O arabë! Unë i betohem Allahut, se për sa kohë që të ketë nga sahabët e të Dërguarit të Allahut, ju do të arrini të përmbushni çdo dëshirë që të keni.” – pastaj u kthye nga banorët e Hires dhe u tha këto fjalë:

- “Unë kurrë nuk kam qenë dëshmitar i një ngjarjeje kaq të hapur e kaq premtuese për të ardhmen e besimtarëve.”⁷⁷

40. ME LUTJEN E PROFETIT TË ALLAHUT NUK NDIHEN AS VAPA E AS I FTOHTI

Tregon Xhabiri (radijallahu anhu): “Bilali Habeshiu më pati treguar mua: “Në fund të një nate të ftohtë, unë dola të këndoja ezanin e sabahut. Në xhami nuk erdhi asnjë njeri. Pak më vonë unë dola dhe e këndova ezanin edhe njëherë tjetër. Sërish nuk erdhi asnjë njeri. Pas ezanit të dytë, i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më pyeti mua:

- “*Pse nuk po vjen asnjë nga xhemati, o Bilal?*” Dhe unë iu përgjigja duke i thënë:

- “Kurban t’u bëfshin ty nëna dhe babai im, o Resulullah, ndoshta myslimanët nuk po dalin dot nga shtëpia ngase është shumë ftohtë.”

⁷⁷. Hejthemî, *Meçhemu’z-Zenaid*, 9/582 (15884).

Atëherë, Profeti ynë i nderuar filloi të lutej:

- “O Zot, bëji, të lutem, myslimanët që të mos e ndiejnë të ftohtin.”

Më kujtohet fare mirë, se si, paraditen e asaj dite, myslimanët dolën nëpër rrugë dhe përpiqeshin të freskoheshin me erashka nëpër duar.”⁷⁸

41. LUTJA E PROFETIT BËN TË MUNDUR QË MYSLIMANËT TË MOS E NDIEJNË URINË

Imran bin Husajni (radijallahu anhu) na tregon: “Ishim ulur pranë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), kur aty erdhi e bija, Fatimja, e cila u ul mu përballë të atit. Profeti ynë i tha asaj:

- “*Eja, afrohu, oj Fatime!*” Fatimja u afrua edhe pak. Ai i kërkoi që të afrohej edhe pak më shumë dhe Fatimja u afrua sërish. Ai i kërkoi që të afrohej edhe pak. Në fund, Fatimja ishte ulur mu përpara Profetit tonë. Fatimja ishte zverdhur dhe dukej sikur nuk kishte asnjë pikë gjaku nën lëkurën e fytyrës. I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) hapi gishtat dhe dorën e vuri mes kockave të shpatullave të Fatimes. Ngriti kokën dhe u lut me këto fjalë:

- “*O Zoti im, që i ngop të uriturit, u përmbush nevojat gjithë nevojtarëve dhe të dobët të ngrë në këmbë! Mos i jep uri Fatimes, bijës së Muhamedit!*” Menjëherë pas kësaj lutjeje, zbehja e fytyrës së Fatimes iku sikur ta kish hequr dikush me dorë dhe unë e pashë me sytë e mi se si në fytyrën e saj erdhi gjak. Më vonë, kur e pyeta Fatimen në lidhje me atë çfarë pati ndodhur asaj dite, ajo më tha mua:

- “Shiko, Imran! Që prej asaj dite unë nuk e kam pasur më ndjesinë e urisë.”⁷⁹

42. BEGATIA E LUTJES SË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT PAKËSON SHENJAT E PLEQËRISË

Ebu Zejd el-Ensari thotë se: “Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) më tha mua që t’i shkoja pranë. Kur u afrova, ai më ledhatoi kokën dhe u lut për mua me fjalët:

⁷⁸. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/166.

⁷⁹. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 9/328 (15205).

- “O Zoti im, *zbukuroje këtë njeri dhe bëje bukurinë e tij të mos priset.*”

Edhe pse i kaloi të njëqindat, Ebu Zejd el-Ensari (radijallahu anhu) në mjekër nuk kishte më shumë sesa disa fije të bardha. Ai ishte një njeri që përherë e shihje të buzëqeshur. Dhe ashtu vazhdoi deri në çastin që dorëzoi shpirtin, askush nuk e pa ndonjëherë me fytyrë të vrenjtur.”⁸⁰

Një tjetër transmetim lidhur po me këtë temë

Përcillet nga Hajan bin Umejri: “Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) e pati ledhatuar Katade bin Milhanin (radijallahu anhu) në fytyrë. Katades, edhe pse ishte moshuar dhe trupi i ishte vjetruar dhe i kishte rënë, fytyra e tij nuk ndryshoi kurrë. Hajani thotë se: “Kur vdiq Katadeja, unë isha aty te kryet e tij. Fytyra i shkëlqente si të ishte një pasqyrë.”⁸¹

43. NJË NGA SAHABËT SHPËTON NGA IZOLIMI KU MBAHEJ PENG DUKE PËRDORUR LUTJEN QË I KISHTE MËSUAR I DËRGUARI I ALLAHUT

Adem bin Ebi Ijasi na ka përcjellë nga Muhamed bin Is’haku dhe na ka treguar se: “Malik el-Eshxhaiu shkoi te Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe e njoftoi se djali i tij, Aufi, kishte rënë peng në duart e armikut. Profeti ynë i tha atij:

- “*Dërgoji fjalë djalit dhe thuaj: Resulullahu të urdhëron ta bësh sa më shumë lutjen: ‘La haule ue la kuvete il’la bil’lah’*” Ndërsa, në një transmetim tjetër thuhet se Profeti ynë e këshillon babanë e Aufit që të bëjë durim, sepse Allahu ka për të dërguar medoemos një rrugëzgjdhje. Aufit iu dërgua fjalë dhe iu transmetua edhe lutja që i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) i kishte thënë se duhet të bënte vazhdimisht.

Aufi, një të marrë lajmin e Profetit tonë, u ul me kokën poshtë dhe filloi të thoshte vetëm ‘La haule ue la kuvete il’la bil’lah’. E kishin lidhur shumë fort, por të gjitha lidhjet u zgjidhën vetvetiu si t’i kish

⁸⁰. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 6/166; Ibn Haxher, *el-Isabe*, 4/78.

⁸¹. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 3/225.

zgjidhur dikush me dorë. Doli menjëherë jashtë dhe aty pa një deve që u përkiste atyre që e kishin zënë peng. I hipi devesë dhe u largua së andejmi me të shpejtë. Gjatë rrugës gjeti edhe kopetë e deveve të atyre që e kishin marrë peng. U bëri ca zëra kopesë dhe devetë e ndoqën nga pas. Thirrja e Aufit se ishte kthyer ishte e papritur për nënën dhe babanë e tij. Babai doli dhe tha:

- “Lëvduar qoftë Zoti i Qabes, ky është Afi ynë!” Edhe nëna bërtiste nga gëzimi:

- “Zemra ime, shpirti im!” – ashtu e pritën djalin e tyre, përqafo njëri e përqafo tjetri. Shqetësimi i vetëm që i kishte mbetur Afi ishte shenjat dhe dhimbja që kishin lënë zinxhirët në trup. Babai dhe shërbyesja e shtëpisë vrapoi për te dera. E çtë shihnin! Afi e kishte mbushur avllinë e shtëpisë plot e përplot me deve! Ai i tregoi babait se si qëndronte puna e deveve. Dhe ai shkoi menjëherë për te Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), për ta njoftuar, si për kthimin e Aufit, ashtu edhe për devetë. Profeti ynë tha kështu:

- “*T’i përdorni si të doni ato deve, i ke njësoj si devetë e tua.*” – Në atë kohë u zbrit ky ajet: “**(...) dhe do t’i japë rrësk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë.**” (Talak, 65/3)⁸²

44. NGJARJE TË HIDHURA QË U NDODHIN ATYRE QË NUK DËGJOJNË FJALËN E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Abas bin Sehl bin Sa’d es-Saidi (radijallahu anhu) tregon: “Në kohën që Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) erdhi dhe u vendos në Hixhr (vendi ku ka jetuar populli i Themudit, që u shkatërrua nga Allahu), myslimanët u përpoqën të nxirrnin ujë nga pusi i atjeshëm. Myslimanët sa po largoheshin nga gryka e pusit, kur i Dërguari i Allahut u tha atyre:

- “*Se mos pini nga uji i atij pusi; në asnjë mënyrë! As abdes mos merrni me ujin e atij pusi. Nëse keni zënë brumë me atë ujë, jepuani deveve ta hanë ato dhe mos hani nga buka e zënë duke përdorur atë ujë. Dhe sonte askush të mos dalë*

⁸². Ibn Kethir, *Tefsir*, 4/380; Taberi, *Tefsir*, 28/98.

nga shtëpia pa pasur edhe një shok me vete.”

Të gjithë sahabët iu bindën atij urdhri të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), përveç dy prej tyre. Njëri syresh ishte dikush nga Beni Saideja, i cili pati dalë jashtë për të kryer nevojat. Kurse tjetri kishte dalë për të kërkuar devenë e larguar. Ai që doli për të kryer nevojat, e sulmuan xhindet. Kurse ai që doli të kërkonte për devenë, një furtunë e tmerrshme e mori dhe e çoi deri përtej maleve Taj.

E njoftuan të Dërguarin e Allahut, i thanë se çfarë kishte ndodhur dhe i Dërguari i Allahut tha:

- *“Unë ju pata lajmëruar, që të mos dilni nga shtëpia pa pasur një shok me vete, ju pata thënë, apo nuk ju pata thënë?”* Ai u lut për atë që e kishin goditur xhindet. Me lejen e Allahut ai njeri u shërua. Kurse tjetri arriti të gjente rrugën e të bashkohej me myslimanët gjatë ekspeditës së të Dërguarit të Allahut në Tebuk.”⁸³

45. XHINET QAJNË PËR SAHABËT E RËNË DËSHMORË

Tregon Sulejman bin Jesari (radijallahu anhu): Xhindet, rënien dëshmor të Omerit (radijallahu anhu) e vajtuan me këto fjalë: “Përshëndetje ty, o Prijësi i Besimtarëve! Allahu i faltë bashkim këtij vendi, që është në prag të copëtimit! Ti nise zhvillime aq të mëdha dhe shpirtin dorëzove ende pa ua parë frytet. Daç të vrapojnë daç të hipin mbi të rejat deve; ata që duan të arrijnë punët që bëre ti dje, sot e kanë të vështirë që ndonjëren syresh ta bëjnë. Pse nxiu kështu ky qiell i Medinës, po pemëve pse po u lëkunden dhe trungjet, apo vallë marrin pjesë edhe kanë edhe ato zi, ngase ai ra dëshmor?”⁸⁴

46. SHFAQJA NË ËNDRRA E DISA SAHABËVE TASHMË TË VDEKUR

Pas vdekjes së babait të tij, Ibni Omeri e sheh atë në ëndërr

Tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): “Për mua, në këtë botë nuk

⁸³. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 5/11.

⁸⁴. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 3/374.

ka gjë më të gëzueshme sesa të marr vesh se në ç'gjendje është Omeri (radijallahu anhu) në jetën e përtejme. Në ëndërr pashë një shtëpi të madhe. Pyeta se kujt i takonte ajo shtëpi aq e madhe.

- “Kjo shtëpi e madhe është e Omer bin Hatabit.”, – më thanë. Prej saj doli vërtet Omeri (radijallahu anhu). Ishte sikur sapo ishte larë dhe ishte veshur me tesha të pastra dëborë.

- “Si je aty?”, – e pyeta.

- “Mirë jam, do të isha krejtësisht i mbaruar, po të mos kish qenë falja, dhembshuria dhe mëshira e Allahut.”

- “Sa vjet janë bërë qëkur jam larguar prej jush?”, – më pyeti.

- “Janë bërë plot dymbëdhjetë vjet.”, – i thashë unë.

- “Të pyeta, se tani shpëtova nga dhënia e llogarisë.”, – më tha ai.”⁸⁵

Abdullah bin Selami sheh në ëndërr Selman Farisiun

E ka treguar Abdullah bin Selami (radijallahu anhu): “Selmani (radijallahu anhu) më pati thënë:

- “Shiko, vëlla, ai që do të vdesë i pari nga ne, të përpiqet e të bëjë çmos që t'i shfaqet atij që do të jetë gjallë në ëndërr.” Unë i thashë:

- “A thua të jetë e mundur diçka e këtillë?”

- “Po, shpirti i besimtarit është i lirë. Ai mund të shkojë ku të dojë në Tokë; vetëm mohuesi është i burgosur dhe i izoluar.”, – mu përgjigj.

Kaloi kohë. Selmani shkoi pranë mëshirës së Atij që është më i Drejti dhe më i Vërteti. Një ditë, ishte kohë dreke dhe unë isha shtrirë për të fjetur pak në drekë dhe po shikoja ëndërr. Mu afrua Selmani dhe më përshëndeti duke më thënë:

- “Es'selamu alejke ue rahmetullahi ue berekatuh”. Dhe unë i thashë:

- “Ue alejkes'selam ue rahmetullah, o Ebu Abdullah! Si është vendi yt aty, a je i kënaqur?”

- “Vendin të mirë e kam, mos e lër për asnjë çast mbështetjen e plotë tek Allahu. S'paskësh pasur gjë më të mirë sesa mbështetja e

⁸⁵. Ebu Nu'ajm, *Hiŧje*, 1/54.

plotë tek Allahu i Madhëruar! Kurrë mos e braktis, qoftë edhe për një moment të vetëm, mbështetjen tek Ai! Veç ta dish, sa e bukur paskësh qenë mbështetja e plotë tek Allahu! Unë e pashë vetë me këta sy se ç'vëpër e virtytshme është mbështetja e plotë tek Allahu i Madhëruar, aq sa e bën njeriun të çuditet për veten e tij.”⁸⁶

⁸⁶. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra*, 4/93.

ARSYET PSE SAHABËT ISHIN TË DENJË PËR NDIHMËN E ALLAHUT



Cilat janë shkaqet që bënin që sahabët fisnikë të përfitonin aq shumë ndihmë shpirtërore? Si e perceptonin dhe si e vlerësonin ata ndihmën që u vinte nga Allahu? Sa rëndësi u jepnin ata shkaqeve materiale dhe si prireshin ata vetëm kah Ai, i Cili është Shkaktari i të gjitha shkakësive?

1. ATA NUK I TREMBESHIN ASNJË VËSHTIRËSIE

Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu) na tregon: “Islami ka përballuar shumë peripeci e shumë vështirësi. Ne i bëmë ballë çdo vështirësie, për t’u kujdesur për Islamin, që është më i bukuri ndër bukuri. Bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ne u detyruam të largoheshim nga Meka dhe të migronim në drejtim të Medinës dhe shumë të tjerë drejt shumë vendesh të tjera. Me mërgimin filloi edhe përparimi e arritjet tona. E po ashtu, me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ne u bëmë një trup dhe dolëm të luftonim në luftën e Bedrit. Gjendjen e bashkësisë së

myslimanëve të atyre ditëve asgjë nuk e përshkruan më mirë e më saktë sesa ky ajet i Kur'anit Famëllartë:

“(...) **Zoti yt të nxori nga shtëpia jote (për të luftuar) për të Vërtetën, edhe pse kjo nuk i pëlqeu një grupi prej besimtarëve. Ata polemizojnë me ty për të vërtetën (luftën), e cila u ishte bërë e qartë, sikur të ishin duke u çuar drejt vdekjes së sigurt. Allahu ju premtoi fitoren mbi njërin prej dy grupeve, që ai të ishte i juaji. Ju dëshironit që grupi i paarmatosur të ishte i juaji, ndërsa Allahu dëshironte të përmbushte premtimin e Tij dhe t’ua zhdukte rrënjët mohuesve, (...)**” (Enfal, 8/5-7)

Këtu, me grup të paarmatosur kihet parasysh karvani i kurejshëve. Allahu i Madhërishëm na fali neve fitoren e asaj lufte dhe ne i arritëm të gjitha ato të mira me shumë mund dhe duke kapërcyer vështirësi nga më të mëdhatë.”¹

2. SAHABËT U BINDEN URDHRAVE TË ALLAHUT NË MËNYRË TË PAKUSHTËZUAR

Utbe bin Abd es-Sulemiu tregon: “I Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) iu drejtua sahabëve të tij dhe u tha:

- “*Ejani, ngrihuni të luftoni.*” Dhe ata thanë:

- “Po, o Resulullah. Ne nuk do të themi siç i thanë hebrenjtë Musait (alejhis’selam): ‘**Shkoni ti dhe Zoti të luftoni, ne do të rrimë do të presim këtu!**’ Ne themi: ‘Luftoni ti dhe Zoti ynë, o Muhamed, e ne do të jemi atje, në luftë, bashkë me ju.’”

Në një transmetim tjetër thuhet kështu: “Sa’d bin Ubadeja (radijallahu anhu) i thotë të Dërguarit të Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem): - “Unë i betohem Allahut, se nëse ti na urdhëron neve që të vijmë e të luftojmë e gjaku ynë të derdhet lumë e të arrijë gjurin, ne do të vijmë pa as lëkundjen më të vogël! Edhe deri në Berku’l-Gamad të na kërkosh që të shkojmë, ne deri atje kemi për t’u grahur kuajve tanë.”

¹. Hejthemi, *Mexhmen’-Zeuaid*, 7/99 (11022).

3. MBËSHTETJA E PLOTË E SAHABËVE TEK ALLAHU DHE PËRGËNJESHTRIMI I ATYRE QË ISHIN NË RRUGËN E DEVIJUAR

Abdullah bin Auf bin el-Ahmeri tregon: “Një person i quajtur Musafir, pikërisht në kohën që Aliu (radijallahu anhu) po bëhej gati për të lëvizur nga Enbari në drejtim të Nehreuait, tha:

- “O Prijësi i Besimtarëve, mos u nis në asnjë mënyrë në këtë orë. Nisu tri orë pasi të ketë perënduar dielli e të ketë rënë muzgu.” Dhe, kur Aliu (radijallahu anhu) e pyeti se pse duhej të vepronte ashtu, Musafiri i dha këtë përgjigje:

- “Nëse nisesh tani, në këtë orë, ju ju pret diçka shumë e keqe. Ama, nëse niseni atëherë kur ju them unë, ju do të dilni fitimtarë dhe do t’ia arrini fare mirë qëllimit tuaj.” Aliu (radijallahu anhu) u përgjigj:

- “Profeti ynë nuk pranonte fallxhorë. As ne që do të vijmë pas tij nuk do të përdorim fallxhorë. Ti a e di se ç’ka në barkun e këtij kalit tim?”

- “Ma merr mendja.”, – u përgjigj Musafiri. Atëherë, Aliu (radijallahu anhu) tha:

- “Pra, ti thua që e di duke e marrë me mend. Ai që i beson fjalës sate i bie të ketë mohuar Kur’anin, sepse Allahu thotë kështu: **“Pa dyshim, vetëm Allahu e di Orën e caktuar. Ai e zbret shiun dhe e di ç’ka në barkun e shtatzënës. Asnjë njeri nuk di ç’do të fitojë nesër dhe askush nuk di se në ç’vend do të vdesë. Me të vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe Njohës i çdo gjëje.”** (Lukman, 31/34) I Dërguari ynë Fisnik (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) nuk pretendonte si ti, që e dinte të panjohurën. Ti çfarë do të thuash, që ata që do të nisen tani për rrugë, do të përballen me një fatkeqësi?”

- “Po!”, – u përgjigj Musafiri. Paskëtaj, Aliu (radijallahu anhu) tha:

- “Nëse dikush i beson kësaj fjalës sate, kjo do të thotë se ai nuk ka më nevojë për Allahun për t’u bërë ballë të këqijave që i ndodhin. E ka rënë në idhujtari çdokush që i bindet fjalës sate, sepse ti pretendon se di se kur do të përballen njerëzit me të keqen.

O Zot! Nga Ti është edhe e mira, edhe e keqja. Nuk ka zot tjetër

përveç Teje. Shiko, Musafir, ti je gënjeshtar, ne nuk do ta dëgjojmë fjalën tënde, përkundrazi, do të bëjmë pikërisht të kundërtën. Ja, pikërisht tani po nisemi, tani, që ti na thua se për ne do të jetë e rrezikshme!..”²

4. SAHABËT, NDERIN E VËRTETË, E KËRKONIN TEK TË QENËT NDJEKËS TË FESË SË ALLAHUT

Na tregon Tarik bin Shihabi (radijallahu anhu): “Omeri (radijallahu anhu) u nis për në Siri. Me vete kishte marrë edhe Ebu Ubejde bin Xherrahun (radijallahu anhu). Kur shkuan në një vend që ishte moçalishte dhe me ujë shumë, Omeri (radijallahu anhu) zbriti nga deveja, hoqi këpucët që kishte në këmbë dhe i hodhi në sup. E tërhoqi devenë nga frerët dhe hyri në ujë. Ebu Ubejdeja i foli:

- “Çfarë bën, o Prijësi i Besimtarëve! A të ka hije ty një veprim i këtillë? I heq këpucët dhe i hedh në sup dhe hyn në atë batac duke e tërhequr devenë nga frerët! Nuk shkon fare që njerëzit më të nderuar të Damaskut të të shohin ty në këtë gjendje, duke e tërhequr devenë nga frerët zbathur!” Omeri (radijallahu anhu) iu përgjigj duke i thënë:

- “I mjeri unë, ta kishte thënë ndonjë tjetër këtë fjalë, do t’i kisha dhënë një dënim të mirë, që t’i bëhej mësim gjithë umetit të Muhamedit! Ne kemi qenë një popull i mjerë. Nderin ne na e dha Allahu duke na bërë myslimanë. E, nëse ne do të presim nderim nga ndonjë gjë tjetër e vogël, përveç Islamit, me të cilin na ka nderuar Allahu, atëherë Ai na e merr mbrapsht nderin që na ka falur e na bën sërish të përbuzur e të ulët në sytë e njerëzve!”³

5. QASJA ME DREJTËSI NDAJ PASUESVE TË FEVE TË TJERA, EDHE KUR SAHABËT ISHIN MË TË FUQISHËM

Abdullah bin Handhaleja (radijallahu anhu) tregon: “Në ushtri ne ishim nën komandën e Selman Farisiut (radijallahu anhu). Njëri nga ne këndoi suren ‘Merjem’ dhe një nga besimtarët e fesë së Musait

². El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 10/494 (29439).

³. Mundhiri, *et-Tergih*, 3/351 (4393).

(alejhis'selam), që ishte aty, tha diçka fyese për Merjemin dhe Isain (alejhis'selam). Ne e rrahëm atë derisa goja iu mbush plot me gjak. Ai njeri shkoi dhe iu ankua Selmanit. Ishte hera e parë, kurrë më parë asnjë nga judejtë nuk pati shkuar ndonjëherë që të ankohej. Kushdo që mendonte se i ishte bërë ndonjë padrejtësi, shkonte drejt e te Selmani. Selmani erdhi tek ne dhe na tha:

- “Pse e keni rrahur këtë njeri?” Ne iu përgjigjëm:

- “Ishim duke lexuar suren ‘Merjem’, kur ky njeri shau Merjemin e nderuar dhe profetin Isa (alejhis'selam).”

- “Po mirë, ju pse i lexoni këto ajete që t’ju dëgjojnë edhe këta? A nuk e keni dëgjuar ju fjalën e Allahut (xhele xhelaluhu), që thotë:

“Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos shajnë Allahun armiqësisht nga padija. Kështu, Ne i paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta. Pastaj, ata do të kthehen te Zoti i tyre, i Cili do t’i lajmërojë për gjithçka që kanë bërë.”

(En’am, 6/108), duke shtuar:

- “O arabë! Për sa i përket fesë, a nuk ishit ju më keq sesa të gjithë njerëzit e tjerë? A nuk ishte vendi juaj vendi ku bëheshin edhe të këqijat më të mëdha? Mes njerëzve, a nuk ishit ju ata që bënë jetën më të shpifur nga të gjithë? Ja, ju ishit në një gjendje aq të keqe, por Allahu ju fali juve nder dhe krenari, duke ju nderuar me Islamin? Pas gjithë këtyre, tani, ju pse doni që t’i mundoni njerëzit në emër të Islamit? Uallahi, ose hiqni dorë nga kjo sjellje, ose Allahu jua merr nga duart ato që ju ka dhënë dhe ua jep ato të tjerëve!”

Mandej, Selmani (radijallahu anhu) filloi të na mësonte duke na thënë: “Namazet shtesë falini në kohën mes kohës së akshamit dhe kohës së jasisë, kështu do të mund t’i bëni më lehtë përmendjet që ju i bëni Allahut. Veç kësaj, as nuk do t’ju shkojë mbrëmja dëm, sepse atij që çon dëm pjesën e parë të natës, fundi i saj i shkon akoma edhe më keq.”⁴

⁴. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/201.

6. SAHABËT FISNIKË NXJERRIN MËSIM NGA FATKEQËSITË

Xhubejr bin Nufejri (radijallahu anhu) tregon: “Pengjet e zëna gjatë luftës së Qipros, u ndanë mes luftëtarëve myslimanë dhe disa prej tyre qanin. Pashë njëherë, edhe Ebu Derdaja ishte tërhequr drejt një qosheje dhe qante!

- “O Ebu Derda, çfarë të ka bërë për të qarë në një ditë si kjo, kur Allahu i ka nxjerrë fitimtarë dhe krenarë Islamin dhe myslimanët?” Ai m’u përgjigj duke më thënë:

- “Je shumë i çuditshëm, o Xhubejr! Shiko se sa poshtë bien, sa të përbuzur bëhen, të gjithë ata që nuk u binden urdhrave të Allahut? Njëherë e një kohë edhe këta njerëz ishin të fuqishëm, të fortë dhe me shumë pushtet, por, tani, siç e sheh, ata nuk ua vunë veshin urdhëresave të Allahut dhe Allahu i bëri të jenë robërit tanë. E një popull i rënë rob është i privuar nga ndihmesa dhe mbështetja e Allahut të Madhëruar.”⁵

7. SINQERITETI I SAHABËVE DHE NGARENDJA E TYRE DREJT FITIMIT TË JETËS SË PËRTEJME

Tregon Ebu Abdete'l-Anberi (radijallahu anhu): “Në kohën që myslimanët ngadhënjyen mbi qytetin e Medainit dhe mblodhën plaçkën e luftës, aty ia behu një burrë me një kutizë me aromë misku dhe ia dorëzoi atë personit që ishte përgjegjës për mbledhjen e plaçkës. Ata që ishin përreth nëpunësit, i thanë atij:

- “Kurrë s’kemi parë ndonjëherë diçka të tillë. Asnjëherë nuk na ka ardhur ndonjëri e të na japë si plaçkë lufte një kuti si kjo! Apo mos e ndave nga plaçka tjetër dhe e ruajte për vete?” Ai iu përgjigj:

- “Uallahi, po të mos i besoja Allahut, unë nuk vija e t’jua dorëzoja juve atë!” Pasi dëgjuan se ç’tha, njerëzit e ndienë se ai duhet të ishte ndonjë njeri i rëndësishëm.

- “Po kush je ti?”, – e pyetën ata.

- “Jo, unë nuk jua them se kush jam. Nëse jua them, atëherë edhe ju do të më thurni fjalë të mira. Do të dëgjojnë të tjerët, e në syrin e

⁵. Ebu Nu’ajm, *Hilje*, 1/216.

tyre unë do të zmadhohem akoma edhe më shumë. Unë e lëvdoj dhe e madhëroj Allahun dhe jam i kënaqur vetëm me shpërblimin që do të më japë Allahu.” Atij burri i vunë dikë nga pas, që ta ndiqte, ku do të shkonte, çfarë do të bënte. Gjetën disa nga shokët e tij dhe e pyetën për të. Si përfundim, ata mësuan se ai njeri ishte Amir bin Abdi Kajsi.”⁶

8. SAHABËT I KËRKONIN NDIHMË ALLAHUT VETËM DUKE KËNDUAR KUR’AN DHE DUKE IU LUTUR ATIJ

Zejd bin Eslemi (radijallahu anhu) tregon: “Omeri (radijallahu anhu), kur pa se ngadhënjimi mbi Egjipt po vononte, vendosi që t’i shkruante Amr bin el-Asit (radijallahu anhu) një letër, në të cilën i thoshte:

- “Për sa i përket çështjes së ngadhënjimit mbi Egjipt, unë habitem se si e keni marrë me kaq lehtësi dhe ende nuk keni arritur që të ngadhënjeni. U bënë vite që vazhdoni të luftoni në atë front. Shkaku i vetëm i kësaj duhet të jetë ai se shpirtrat duhet t’jua ketë kapluar dashuria për jetën e kësaj bote. Allahu bashkësitë njerëzore i ndihmon duke u parë atyre singëritetin që ata kanë në qëllimet e tyre. Të kam dërguar katër burra. Secili prej tyre është sa njëmijë luftëtarë, ta dish. Patjetër, nëse nuk ndryshojnë edhe ata kur të vijnë pranë jush!..

Kur të të mbërrijë kjo letër, mblidhi ushtarët dhe folu atyre. Nxiti ata që të bëjnë durim dhe të luftojnë kundër armikut me singëritet në qëllimin e tyre. Në krye të luftëtarëve cakto këta katër komandantë që të kam dërguar dhe urdhëroje ushtrinë që ta sulmojë armikun si një trup i vetëm. Si kohë të zgjedhësh ditën e premte, pikërisht në atë kohë kur dielli do të ngjitet fiks në mes të qiellit, sepse ajo kohë është një prerje e kohës kur zbret mëshira e Allahut dhe janë çaste që Allahu i pranon lutjet e atyre që i luten me singëritet. Luftëtarët t’i përgjërohen Allahut dhe t’i kërkojnë që Ai t’i ndihmojë kundër armikut.”

Me t’i ardhur në dorë kjo letër, Amri thirri luftëtarët që të grumbulloheshin pranë tij, pastaj thirri katër komandantët që kishin ardhur dhe i caktoi ata në krye të tyre. Ai u tha të gjithëve të merrnin

⁶. Ibnu’l-Xheuzi, *Sifetu’s-Safue*, 3/211.

abdes dhe të falnin dy rekate namaz dhe t'i drejtoheshin Allahut me lutje, që t'i ndihmonte e myslimanët të dilnin fitimtarë. Në fund ashtu ndodhi, Allahu me mirësinë e Tij u fali myslimanëve ngadhënjimin.”⁷

9. SAHABËT GAROJNË ME NJËRI-TJETRIN SE KUSH DO TË BËJË MË SHUMË TË MIRA

Shakiku (radijallahu anhu) tregon: “Në orët e para të ditës, përleshja pati filluar. Erdhi koha për të falur namazin e drekës dhe ne u tërhoqëm. Muezini ishte i plagosur. Shumë nga myslimanët nxituan kush e kush të thërriste ezanin. Njerëzit nuk po merreshin vesh se kush do të thërriste ezanin, edhe pak edhe u duk sikur do të nxirrnin shpatat. Në fund, Sa'di hodhi short dhe ezanin e thërriti ai që i ra shorti.”⁸

10. SAHABËT NUK I JEPNIN RËNDËSI DUKJES DHE STOLIVE TË KËSAJ BOTE

Myslimanët patën shkuar që të ngadhënjenin mbi Isfahanin dhe në krye si komandant kishin Numan bin Mukarrinin. Mes Isfahanit dhe myslimanëve ishte edhe një lumë për t'u kaluar. Si përfaqësues, në anën tjetër myslimanët dërguan Mugire bin Shuben. Ja se si e tregon këtë ngjarje Osman en-Nehdiu:

“Teksa Mugireja ishte drejtuar për andej nga ishin vendosur persët, në kalim e sipër të urës ata e ndaluan dhe nuk e lejuan që të kalonte. Për hyrjen e tij, ata i kërkuan njëherë leje Rustemit. Persët, për t'u dukur sa më lart dhe më të zhvilluar, kishin veshur të gjithë rroba të reja dhe të çmuara. Në koka kishin vënë kurora, kurse teshat i kishin të qepura me motive të derdhura në ar. Ndërsa në hyrjen e sarajeve, për miqtë kishin shtruar edhe një tapet në gjatësinë e një hedhjeje të shigjetës. Mugireja, kur shkoi atje, flokët i kishte ndarë në katërsh dhe shkoi dhe u ul drejt e mbi minderin ku ishte edhe Rustemi. Nëpunësit u vërsulën drejt e te Rustemi, madje edhe e vranë pak. Mugireja nuk e prishi fare qetësinë dhe e nisi fjalën e tij duke thënë:

⁷. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 5/894 (14220).

⁸. Taberi, *Tarih*, 2/425.

- “Kemi dëgjuar shumë për legjendat tuaja, por ma merr mendja se vështirë të ketë pasur popull më të marrë sesa ju. Ne arabët nuk e shohim njëri-tjetrin si skllevër dhe si robër. Unë pandehja se edhe ju, njësoj si ne, u vinit njerëzve në ndihmë dhe ndaj tyre tregoheshit të drejtë. Sikur të më kishit thënë se ju jeni zota të njëri-tjetrit, kjo do të kishte qenë më mirë sesa kjo që po më zënë sytë. Ky qëndrim i juaji nuk është aspak i drejtë dhe ne nuk do të veprojmë kurrë siç vepruat ju. Në fakt, unë nuk erdha këtu se kisha shumë dëshirë të vija, ju më thirrët. Por, sot, unë kuptova se fundi juaj nuk do të jetë aspak i mirë. Me këto mendje që keni ju dhe kështu siç e keni nisur, kjo mbretëri nuk e ka shumë të gjatë.” Rojtarët, kur dëgjuan këto fjalë, thanë me vete:

- “Uallahi, ky arab ka të drejtë.” Komandantët e vunë re ndryshimin e sjelljes së tyre e edhe ata thanë me vete:

- “Uallahi, ai njeri foli aq drejtë, saqë shiko, edhe rojtarët filluan t’i japin të drejtë në ato që thotë. Zoti i shkatërroftë paraardhësit tanë! Ata paskan bërë gabimin më trashanik duke i nënvlerësuar këta arabë!”⁹

11. SAHABËVE NUK U BËNTE SHUMË PËRSHTYPJE, QË ARMIQTË ISHIN MË TË SHUMTË NË NUMËR DHE MË TË FUQISHËM

Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) tregon: “Ebu Bekri (radijallahu anhu) i kishte shkruar Amr bin el-Asit (radijallahu anhu) një letër, në të cilën i thoshte:

- “Mbi ty qoftë paqja e Allahut. E mora letrën tënde. Në të më kishe shkruar se bizantinët kanë grumbulluar shumë ushtarë nga çdo anë. Kur ne luftonim bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), Allahu nuk na ndihmoi ne duke na parë se sa ishim në numër, apo se sa të fuqishëm ishim. Njëherë, ne kishim vetëm dy kuaj. Edhe deveve iu hipnim me radhë, njëherë një e njëherë një tjetër. Po në Uhud, atje kishim vetëm një kalë. Edhe atij i hipte Profeti ynë i

⁹. El-Hakim, *Mustedrek*, 3/332 (5279).

nderuar, duke na u bërë neve mbështetje shpirtërore kundër armikut.

Amr! Ta dish mirë se ai që i bindet Allahut më së shumti është ai që ndien neveri dhe i rrëqethet mishi nga mëkatet. Prandaj, edhe ti, bindju Allahut dhe urdhëroju luftëtarëve, që edhe ata t'i binden Allahut.”¹⁰

12. ÇFARË THOSHIN ARMIQTË E TYRE PËR SAHABËT?

Ebu’z-Zehra el-Kushejriu na tregon se: “Herakliu ishte nisur për luftë në drejtim të Kostandinopojës. Një bizantini, i cili kishte qenë rob i myslimanëve dhe kishte shpëtuar, ai i tha:

- “Më thuaj, çfarë mund të më tregosh mua për myslimanët.” Ai burrë iu përgjigj:

- “Unë do të të tregoj për ta ato çfarë kam parë me sytë e mi. Ditën ata i ke të gjithë të hipur mbi kuaj e të zënë duke luftuar për Zotin, kurse gjithë natën e kalojnë duke kryer adhurime për Zotin. Po deshën të hanë ndonjë gjë gjatë rrugës, do të paguajnë medoemos për atë që marrin dhe kur hyjnë në ndonjë vend, nuk hyjnë kurrë pa i përshëndetur ata që gjejnë aty. Janë të duruar derisa ta mundin armikun e tyre përfundimisht.” Herakliu e dëgjoi atë njeri dhe i tha:

- “Nëse këto që ti thua janë të vërteta, atëherë edhe kjo tokë ku shkelim ne tani ka për t’u bërë e tyrja një ditë.”¹¹

Çfarë pati thënë mbreti i kinezëve për sahabët

Sundimtari i Persisë, Jezduxherdi, i shkroi një letër mbretit të kinezëve, që ai t’i vinte në ndihmë. Mbreti i Kinës i tha kasnecit që kishte çuar letrën:

- “Unë jam i mendimit, se kur mbretërit i kërkojnë ndihmë njëri-tjetrit për të luftuar me armiqtë, ata duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin. Vetëm se unë dua që të më flasësh njëherë për këtë popull që do t’ju nxjerrë ju nga territoret tuaja. Ti më the se ata ishin të paktë në numër dhe ju jeni shumë; për mua, nëse ata njerëz që kanë shumë më pak fuqi sesa ju arrijnë që të dalin fitimtarë ndaj jush, që keni një ushtri

¹⁰. Taberani, *Mu’xhemu’l-Eusat*, 8/164 (8284).

¹¹. Ibn Kethir, *el-Bidaje*, 7/15.

shumë herë më të fuqishme dhe shumë herë më të madhe në numër, kjo nuk është shenjë treguese e asgjëje tjetër veçse e faktit se ata janë më të mirë e më të mbarë se ju dhe se ju jeni në rrugën e gabuar.”

Kasneci i tha mbretit:

- “Më pyesni për ç’të dëshironi.”, – dhe sundimtari i Kinës e pyeti atë:

- “A e mbajnë ata njerëz fjalën e dhënë?”

- “Po!”, – u përgjigj menjëherë kasneci.

- “Po, para se të luftojnë, çfarë ju sugjerojnë ata që të bëni në këmbim, që të mos luftojnë me ju?”

- “Ata na thonë që të zgjedhim një nga tri këto alternativa: ne duhet të pranojmë fenë e tyre. Kësisoj ne do të kemi të njëjtat të drejta me ta. Ose, nëse ne nuk e pranojmë fenë e tyre, të paguajmë një taksë të xhizjes, që ata të na mbrojnë ne kundër armiqve tanë. E nëse ne nuk pranojmë asnjërën nga këto të dyja, ata thonë se do të luftojnë me ne.”

- “Si janë ata në bindje? A u binden ata me përpikëri komandantëve të tyre?”

- “Ata u binden komandantëve të tyre, ashtu siç popujt u binden mendarëve më të nderuar të tyre.”, – u përgjigj përfaqësuesi i persëve.

- “Çfarë konsiderojnë ata të lejuar dhe çfarë konsiderojnë të ndaluar?”

Kasneci ia tregoi mbretit edhe se çfarë konsideronin myslimanët të lejuar dhe çfarë konsideronin si të ndaluar.

- “A e konsiderojnë ata të lejuar atë që u është urdhëruar si e ndaluar dhe të ndaluar atë që u është caktuar si e lejuar?”, – pyeti sundimtari i kinezëve.

- “Jo!”, – ishte përgjigjja e persit.

Pasi mori këto përgjigje, mbreti i kinezëve tha:

- “Asnjë popull nuk mund ta mundësh, për sa kohë që ata nuk e bëjnë të lejuarën të ndaluar dhe të ndaluarën të lejuar.”

(..) Si përfundim, sundimtari i Kinës kërkoi të shkruhej një letër, të cilën ia dha lajmëtarit dhe në të shkruhej:

- “Unë mund të të ndihmoj ty duke të mbështetur me një ushtri,

që fillon këtu në Kinë dhe mbaron në Antioki; dhe unë besoj se duhet ta bëj diçka të këtillë. Por unë e pyeta mëkëmbësin tuaj për atë bashkësi me të cilën do të luftoni, por ata kanë një fuqi, që sikur të duan t'i shkulin malet nga vendi, ata ia dalin mbanë. Nëse ata e ruajnë të paprishur këtë gjendje të tyren dhe dikush i urdhëron që të më sulmojnë edhe mua, ata edhe mua mund të më rrëzojnë nga fronti. Prandaj, këshilla ime për ty është që ti të merresh vesh me ta dhe t'u japësh atyre atë që të kërkojnë. Për sa kohë që ata nuk të prekin ty, as ti mos u ngatërro me ta.”¹²

¹². Taberi, *Tarih*, 2/549.

BURIMET



- Abdu'rr-Rrezzak**, Ebu Bekr Abdurrez'zak bin Hem'mam (h. 126 – 211); *el-Musannef*, [kontr. ~ Habiburrahman el-Adhamij], I-IX, el-Mexhlistu'l-ilmi, Bejrut, 1403/1983.
- Ahmed bin Hanbel**, Ebu Abdil'lah esh-Shejbani (h. 164 – 241); *el-Musned* I-VIII, Muessesetu Kurtuba, Egjipt, pa vit botimi.
- Ebu Daud**, Sulejman bin Esh'ath es-Sixhistanij (h. 202 – 275); *es-Sunen*, [kontr. ~ Muhammed Muhsin Abdulhamid], I-IV, el-Mektebetu'l-Islamijje, Stamboll, pa vit botimi.
- Ebu Nuajm**, Ahmed bin Abdil'lah el-Isbehanij (v. 430 h.); *Hiljetu'l-eulija ue tabakatu'l-asfija*, I-X, Daru'l-kitabi'l-Arabi, Bejrut h. 1405. – *Delailu'n-nubune*, Halep, Daru'l-Uai.
- Ebu Ja'la**, Ahmed bin Ali bin el-Muthenna (h. 210 – 307); *el-Musned*, I-XIII, Daru'l-Mem'un li't-turath, Damask 1404/1984.
- El-Bejhekij**, Ebu Bekr Ahmed bin el-Husejn (h. 384 – 485); *es-Sunenu'l-kubra*, I-X, Mektebetu dari'l-baz, Mekë, 1414/1994. – *Shuabu'l-iman*, [kontr. ~ Muhammed es-Said Besjunij ez-Zaglul], I-IX, Daru'l-kutubi'l-ilmijje, Bejrut, 1410/1990.
- El-Buharij**, Ebi Abdil'lah Muhammed bin Ismail (h. 194 – 256); *el-Edebu'l-mufred*, I-VIII, Daru'l-beshairi'l-Islamijje, Bejrut,

1409/1989.

– *Sabihu'l-Buhari*, I-VIII, el-Mektebetu'l-Islamijje, Stamboll 1979.

– *Et-Taribu'l-kebir*, I-VIII, Daru'l-fikr, Bejrut 1986.

Ed-Darimij, Abdullah bin Abdirrahman (h. 181 – 255); *es-Sunen*, I-II, Daru'l-kitabi'l-Arabi, Bejrut 1407/1987.

Ed-Dimashkij, Muhammed bin Salih 972/1535; *Peygamber Külliyati*, Ocak Yayıncılık, Stamboll 2003.

El-Hakim, Ebu Abdil'lah Muhammed bin Abdil'lah en-Nejsaburij (h. 321 – 405); *el-Mustedrek ala's-Sahibajn*, I-V, Daru'l-kutubi'l-ilmijje, Bejrut 1411/1990.

El-Halebij, Ali bin Burhanid'din (v. 1044/1635); *es-Siretu'l-Halebijje*, I-III, Daru'l-ma'rife, Bejrut 1400.

El-Hejthemij, Ali bin Ebi Bekr (v. 807 h.); *Mexhmen'z-zenaid*, I-X, Daru'r-rejjan li't-turath/Daru'l-kitabi'l-Arabi, Kajro/Bejrut h.1407.

El-Hindij, Alaudin Ali bin Abdulmelik bin Kadi Han Muttekij, (v. 975/1567); *Kenzu'l-ummal fi suneni'l-akual ue'l-ef'al*, Dairetu'l-Maarifi'l-Osmanijje, Hajderabad: 1374/1954 – 1377/1958.

El-Mubarekfurij, Ebu'l-Ali Muhammed Abdurrahman bin Abdurrahim (v. 1353/1934); *Tuhfetu'l-ahuedbij bi-sherhi xhamii't-tirmidhi* [verif. ~ Muhammed Abdulmuhsin Ketebi; pyet. ~ Abduluehhab Abdul'latif], Matbaatu'l-Medeni, Kajro 1964.

El-Munauij, Muhammed Abdurrauf bin Ali (v. 1031/1622); *Fejdu'l-kadijr sherhu Xhamii's-sagijr*, I-VI, el-Mektebetu't-tixharijjet'i'l-kubra, Egijpt 1356 h.

El-Mundhirij, Ebu Muhammed Zekijuddin Abduladhim bin Abdulkauij (v. 656/1258); *et-Tergib ue't-terhib*, Daru't-Turath, Kajro.

Et-Taberani, Ebu'l-Kasim Muhammed bin Ahmed (v. 360 h.); *el-Mu'xbemu'l-ensat*, [kontr. ~ Hamdi bin Abdilmexhid es-Selefij], I-XX, Mektebetu'l-ulum ue'l-hikem, Musul 1404 h.

– *El-Mu'xbemu'l-kebir*, [kontr. ~ Hamdi bin Abdilmexhid es-Selefij], I-XX, Mektebetu'l-ulum ue'l-hikem, Musul 1404 h.

- *El-Mu'xhemu's-sagjir*, [kontr. ~ Hamdi bin Abdulmexhid es-Selefij], I-II, el-Mektebetu'l-Islamije/Daru Amman, Bejrut/Oman 1405/1985.
- Et-Taberij**, Muhamed bin Xherir bin Jezid bin Halid (h. 224 – 310); *Taribu'l-umem ue'l-muluk* (Tarihu't-Taberi), I-V, Daru'l-kutubi'l-ilmijje, Bejrut 1407 h.
- Et-Tirmidhij**, Ebu Isa Muhammed bin Isa (h. 209 – 279); *el-Xhamiu's-Sahib*, I-V, Daru ihjai't-turathi'l-Arabi, Bejrut.
- Ibn Abdil-Berr**, Jusuf bin Abdullah bin Muhammed (v. 463 h.); *el-Istiaab*, I-V, Daru'l-xhijl, Bejrut 1412 h.
– *Xhamiu bejani'l-ilm ue fadlibi ue ma jenbagi fi rinajetibi [ue hamdibi]*/Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut.
- Ibn Asakir**, Ebu'l-Kasim Thikatud'din Ali bin Hasan bin Hibetullah (v. 571/1176); *Taribu Dimashk*, I-LXX, Daru'l-fikr, Bejrut 1417/1996.
- Ibnu'l-Xheuzij**, Abdurrahman bin Ali bin Muhammed (h. 508-597); *Sifetu's-safue*, I-IV, Daru'l-ma'rife, Bejrut 1399/1979.
- Ibn Ebi Shejbe**, Abdullah bin Muhammed (v. 235 h.); *el-Musannef fi'l-ehadith ue'l-athar*, [kontr. ~ Kemal Jusuf el-Hut], I-VII, Mektebetu'r-Rushd, Rijad 1409 h.
- Ibnu'l-Ethijr**, Ebu'l-Hasan Izzeddin Ali bin Muhammed bin Abdulkerim (v. 630/1233); *Usdu'l-gabe fi ma'rifeti's-sahabe*, Daru'sh-Shaab, Kairo 1970.
- Ibn Haxher**, Ahmed bin Ali el-Askalanij (h. 773-852); *Fet'hu'l-bari*, I-XIII, Daru'l-ma'rife, Bejrut h. 1379.
– *El-Isabe*, I-VIII, Daru'l-xhijl, Bejrut 1412 h.
- Ibn Hibban**, Ebu Hatim Muhammed el-Bustij (v. 354/965); *el-Ihsan fi takribi Sahib-i ibni Hibban*, [rreg. ~ Alauddin Ali bin Belbanu, kontr. dhe rreg.: Shuajb el-Arnaut], I-XVII, Muessesetu'r-risale, Bejrut 1988.
- Ibn Hisham**, Abdulmelik bin Hisham bin Ejjub el-Himejrij (v. 213/828); *es-Sijretu'n-nebenijje*, I-VI, Daru'l-xhijl, Bejrut 1411.
- Ibn Kethijr**, Ebu'l-Fida Ismail bin Omer bin Kethir ed-Dimashkij (v. 774 h.); *Tefsiru'l-Kur'ani'l-adhim*, I-IV, Daru'l-fikr, Bejrut 1401 h.

– *El-Bidaje ue'n-nihaje*, I-XIV, Daru'l-mearif, Bejrut.

– *Es-Sijretu'n-nebenijje*, Daru'l-Ma'rife, Bejrut 1976.

Ibn Maxhe, Muhammed bin Jezid el-Kazuinij (h. 207-275); *es-Sunen*, I-II, Daru'l-fikr, Bejrut.

Ibn Sa'd, Ebu Abdullah bin Sa'd bin Menij' (h. 168-230); *et-Tabakatu'l-kubra*, I-VIII, Daru's-sadir, Bejrut.

Kadi Ijad, Ebu'l-Fadl Ijad bin Musa bin Ijad el-Jahsubij (v. 544/1149); *Esh-Shifa bi ta'rifi hukuki'l-Mustafa* (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), [kontr. ~ Husejin Abdulhamid Nil], Daru'l-erkam, Bejrut 1415/1994.

Malik bin Enes, Ebu Abdullah el-Esbahij (h. 93 – 179); *el-Muuatta*, I-II, Daru ihjai't-turathi'l-Arabi, Bejrut 1985.

Muhammed Rida, *Uthman bin Affan: Dhi'n-nurejn*, Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut 1982.

Muslim, Ebu'l Husejn Ibn el-Haxhaxh en-Nejsaburij (h. 206/261); *Sabihu Muslim*, I-V, Daru ihjai't-turathi'l-Arabi, Bejrut.

Said bin Mensur, Ebu Osman Said bin Mensur bin Shu'be el-Horasanij (v. 227/842); *Sunen* [kontr. ~ Habiburrahman Adhami], Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut 1985.

PËRMBAJTJA

SAHABËT JAPIN NGA PASURIA E TYRE NË RRUGËN E ALLAHUT	5
---	---

1. I Dërguari i Allahut i nxit sahabët e tij të japin prej pasurisë së tyre dhe sahabët i përgjigjen gjithë dëshirë	5
2. Dhënia në rrugën e Allahut edhe e gjërave më të çmuara e më të dashura	11
3. Kur ndan dhe jep nga e veta edhe vetë nevojtarë	13
4. Dhënia borxh për hir të kënaqësisë së Allahut	15
5. Dhënia në rrugën e Allahut për përhapjen e Islamit	16
6. Dhënia për luftën në rrugën e Allahut	17
7. Dhënia të skamurve, të varfërve dhe nevojtarëve	19
8. T'u japësh atyre që dalin për të lypur	21
9. Lëmosha dhe të dhënët vullnetarisht	22
10. T'u japësh njerëzve për të ngrënë për hir të Allahut	24
11. Kur i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij shpërndanin ushqim	35
12. Të veshurit e të varfërve dhe nevojtarëve	36
13. Si jepte Profeti ynë në rrugën e Allahut?	37
14. Kujdesi i veçantë në ndarjen e zekatit, sadakasë dhe plaçkës së luftës	40
15. As i Dërguari i Allahut, as sahabët e tij nuk i gëzoheshin pasurisë së kësaj bote	56
16. Qëndrimi asketik ndaj kësaj bote i Profetit tonë dhe i sahabëve të tij	70
17. Gjikimi i atyre njerëzve që nuk i vinin fre vetes ndaj të mirave dhe kënaqësive të kësaj bote	84

SAHABËT FISNIKË I MPOSHTNIN DËSHIRAT EGOISTE DHE QEJFET E TYRE	89
---	----

1. Si arritën sahabët të shkëputnin çdo lidhje me kohën e injorancës, duke forcuar besimin dhe lidhjen e tyre me Islamin?	89
2. Dashuria e thellë e sahabëve fisnikë për Profetin tonë të dashur	93

3. Sahabët zgjidhnin atë që donte më shumë i Dërguari i Allahut në vend të asaj që donin vetë	98
4. Respekti që ndienin sahabët për Profetin tonë	101
5. Sahabët nisën të qanin, kur në Uhud dikush tha “Vranë Resulullahun!”	105
6. Si qanin sahabët fisnikë, kur kuptuan se Profeti ynë do të ndahej nga kjo botë	106
7. Ndarja nga jeta e Profetit tonë të dashur	108
8. Ndarja nga jeta e Profetit tonë i bënte sahabët të prekeshin e të qanin edhe më pas	112
9. Cilat ishin fjalët e para të sahabëve kur morën vesh për vdekjen e Profetit tonë?	113
10. Realizimi i përpiktë i çdo urdhri të Profetit tonë	116
11. Qëndrimi i sahabëve ndaj atyre që nuk i bindeshin fjalës së Profetit tonë të nderuar	124
12. Shqetësimi i madh i sahabëve fisnikë se mos silleshin ndryshe nga ajo që u kishte urdhëruar Profeti ynë	125
13. Sahabët fisnikë rrekeshin që ta imitonin Profetin tonë në çdo lëvizje të tij	127
14. Çfarë kishte parasysh i Dërguari Fisnik në sjelljen e tij me sahabët, familjen dhe umetin	135
15. Jeta dhe pasuria e myslimanëve është e paprekshme	139
16. Ndalimi i derdhjes së gjakut të myslimanëve dhe shëmtia e të luftuarit për të vënë pasuri	145
17. T'i shqetësosh apo trembësh myslimanët	152
18. Përçmimi ose nënvlerësimi i myslimanëve	153
19. Të nevrikosësh një mysliman	153
20. Të mallkosh myslimanët	154
21. Të shash një mysliman	155
22. Të flasësh pas krahëve për myslimanët	156
23. Të përgojosh myslimanët	157
24. Të kërkosh të metat e myslimanëve në fshehtësi	159
25. Të mbuluarit e gabimeve të myslimanëve	162
26. Toleranca dhe të qenët falës ndaj myslimanëve	163
27. Mëri ndaj vetë mëkatit, jo ndaj atij që e kryen atë	167
28. Pastrimi i zemrës nga smira dhe mllëfi	168
29. Gëzimi prej sjelljeve dhe bëmave të mira të myslimanëve	169
30. Udhëheqja e njerëzve dhe kalimi sa më mirë me ta	170
31. Marrja me të mirë e myslimanëve	171
32. Plotësimi i nevojave të një myslimani dhe ndihma ndaj tij	173

33. Kur merr vesh se myslimanët janë në nevojë	173
34. Të përpiqesh si e si që të zgjidhësh çdo punë të myslimanëve	174
35. Të shkuarit për vizitë te myslimanët	175
36. Gostitja e atyre që vinin për vizitë	175
37. Nderimi dhe dhënia vlerë ndaj të parëve të një populli duke i respektuar sa më shumë	176
38. Kur Resulullahu gostit pjesëtarët e familjes së bekuar	177
39. Respektimi i njerëzve të ditur dhe të virtytshëm dhe gostitja e tyre herë pas here	178
40. Qëndrimi ndaj atyre që flisnin keq për të mëdhenjtë	180
41. Të qarët dhe mërzitja nga vdekja e të mëdhenjve	182
42. Ndryshimi në shpirt i njerëzve pas vdekjes së të mëdhenjve	183
43. Dhënia vlerë edhe atyre që janë të varfër dhe të dobët	183
44. Dhënia vlerë nënës dhe babait	185
45. Dhembshuria ndaj fëmijëve dhe sjellja me ta me drejtësi	187
46. Vlerësimi i fqinjëve dhe gostitja e tyre	188
47. Gostitja e shokut të mirë	189
48. Sjellja me njerëzit sipas pozitës së tyre	190
49. Dhënia selam myslimanëve dhe pranimi i selamit të myslimanit	190
50. Dërgimi i selamit	191
51. Shprehja e dashurisë, shtrëngimi i dorës dhe përqaftimet	193
52. Puthja e dorës, e këmbës dhe e ballit të një myslimani	194
53. Të priturit në këmbë e një myslimani	195
54. Ruajtja e sekretit që ndan me ty një mysliman	197
55. T'i bësh jetimët të gëzojnë	198
56. Përkujdesja për miqtë e babait dhe nderimi i tyre	199
57. Përgjigjja ndaj ftesës së një myslimani	200
58. Largimi nga rruga i gjërave që mund të mendojnë udhëtarët	200
59. T'i thuash 'jerhamukallah' atij që teshtin	201
60. Vizitat e myslimanëve te njerëzit e tyre të sëmurë	201
61. Të kërkuarit e lejes dhe edukata e të trokiturit në derë	204
62. Ta duash myslimanin për hir të Allahut	205
63. Mërzitja dhe hidhërimi i myslimanëve me njëri-tjetrin	207
64. Zgjidhja e konflikteve mes njerëzve dhe pajtimi i tyre	208
65. Shmangia nga të menduarit keq për të tjerët	209
66. Lavdërimet e pranura dhe jo të pranura për myslimanët	211
67. Prerja e marrëdhënieve me njerëz të familjes dhe të afërm	212

MORALI DHE PAMJA E JASHTME

E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE E SAHABËVE TË TIJ	215
1. Morali i të Dërguarit Fisnik	215
2. Morali i sahabëve fisnikë	218
3. Butësia dhe toleranca e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij	219
4. Thellësia e dhembshurisë dhe mëshirës së të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij	223
5. Ndjenja e turpit tek i Dërguari i Allahut	224
6. Ndjenja e turpit te sahabët fisnikë	225
7. Thjeshtësia dhe modestia e të Dërguarit të Allahut dhe sahabëve	226
8. Thjeshtësia dhe modestia e sahabëve fisnikë	229
9. Ilustrime nga humori dhe shakatë e të Dërguarit të Allahut dhe të sahabëve të tij	233
10. Shakatë e sahabëve	234
11. Bujaria e të Dërguarit të Allahut	236
12. Durimi tek i Dërguari i Allahut dhe te sahabët e tij	236
13. Falënderimi i Zotit nga i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij	240
14. Dëshira e zjarrtë dhe vendosmëria e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij për të fituar shpërblimin e Allahut	243
15. Ndërmjetësimi i të Dërguarit të Allahut	245
16. Devotshmëria e madhe e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij (qëndrimi larg gjërave të dyshimta)	247
17. Mbështetja e plotë te Zoti e të Dërguarit të Allahut dhe i sahabëve të tij	248
18. Pranimi i rrjedhave të kadasë-caktimit të Allahut	250
19. Devotshmëria dhe frika ndaj Allahut te Profeti dhe sahabët e tij	251
20. Të derdhësh lot prej respektit ndaj Allahut të Madhërisëm	252
21. Llogaria me veten	255
22. Kontrollimi i gjuhës dhe heshtja	255
23. Si fliste i Dërguari i Allahut?	256
24. Madhështia	259
25. Të qenët xheloz për hir të Allahut	259
26. Të urdhërosh për mirë dhe të bëhesh pengesë për të keqen	260
27. Rruga e ndjekur nga i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij drejt martesës	263
28. I Dërguari i Allahut dhe burrat e familjes së bekuar ia kalonin shumë mirë me gratë dhe fëmijët e tyre	268
29. Qëndrimi që mbante i Dërguari i Allahut me fëmijët	270
30. Interesimi i Profetit ndaj problemeve të bashkëshorteve të sahabëve	270
31. Edukata në të ngrënë e në të pirë e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij	272

32. Veshja e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve të tij	273
33. Shtrati ku flinte i Dërguari i Allahut	274

BESIMI I SAHABËVE TE BOTA E PADUKSHME277

1. Përmasat e mëdha të besimit	277
2. Kuvendet e besimit	279
3. Rifreskimi i besimit	279
4. Besimi është burimi i trimërisë dhe i shpresës	279
5. E vërteta dhe përsosja e besimit	280
6. Besimi tek engjëjt	282
7. Besimi te kaderi	283
8. Besimi te shenjat e Kiametit	284
9. Besimi në jetën e përtejme	286
10. Besimi i sahabëve te ngjarjet që do të ndodhin në ditën e Kiametit	286
11. Besimi i sahabëve se ndërmjetësimi i të Dërguarit është i vërtetë	287
12. Besimi i sahabëve tek ekzistenca e Xhenetit dhe Xhehenemit	289
13. Tu besosh premtimeve të Allahut për të ardhmen me bindje të plotë	293
14. Të besuarit plotësisht te lajmet e dhëna prej të Dërguarit të Allahut	295
15. Të besosh prerazi, se çdo vepër do të ketë shpërblimin e saj	295
16. Forca e besimit të sahabëve	297

NDJESHMËRIA DHE KUJDESI PËR NAMAZIN

TEK I DËRGUARI FISNIK DHE TE SAHABËT E TIJ301

1. I Dërguari Fisnik i nxit njerëzit për të falur namaz	301
2. Kur sahabët i nxitin myslimanët kah namazi	303
3. Disa fjalë dhe disa veprime të të Dërguarit të Allahut për të treguar rëndësinë e veçantë të namazit	304
4. Rëndësia që kishte namazi për sahabët fisnikë	305
5. Ndërtimi i xhamive	306
6. Mbajtja pastër e xhamive	307
7. Mirësia e shkuarjes në xhami duke ecur	307
8. Urtësitë dhe funksionet e xhamive	307
9. Sjelljet që janë të pahijshme për t'u bërë në xhami	309
10. I Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij fisnikë i jepnin shumë rëndësi ezanit ...	310
11. I Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij prisnin hyrjen e kohës së namazit dhe grumbullimin e xhematit	312
12. Rëndësia e të falurit me xhemat e të pesë kohëve të namazit	313
13. Lidhja e radhëve fort dhe të rregullta gjatë namazit	313
14. Imami kujdeset për nevojat e ndryshme të xhematit	314

15. Të bëhesh imam dhe ndjekja e imamet me përpikëri	314
16. Kur i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij qanin gjatë faljes së namazit	315
17. Përlujta në namaz	316
18. Kujdesi i veçantë që tregonte i Dërguari i Allahut për sunetet	316
19. Rëndësia e namazit të natës për të Dërguarin e Allahut dhe sahabët e tij	318
20. Rëndësia që i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij i jepnin namazit nafle	319
21. Namazi i terauiisë dhe sahabët	320
22. Namazi i nevojës	321

DASHURIA E PROFETIT DHE E SAHABËVE PËR DIJEN

DHE NXITJA DREJT SAJ	325
1. Si i nxishte i Dërguari i Allahut njerëzit drejt dijes	325
2. Aliu (r.a.) i nxit njerëzit drejt dijes	326
3. Nxitja e Ebu'd-Derdasë për dijen	328
4. Nxitja e Ebu Dherrit dhe e Ebu Hurejres për dijen	328
5. Ebu Hurejreja rend pas ditorisë	328
6. Cila është vërtetësia e dijes?	329
7. Të mjaftuarit vetëm me atë që ka sjellë Resulullahu	330
8. Qëndrimi i sahabëve karshi lajmeve të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij	331
9. Tërësia besim-dije-veprim të sahabët	334
10. Mësimi i detyrimeve të Fesë Islame	334
11. I Dërguari i Allahut dhe sahabët u mësojnë njerëzve namazin	335
12. I Dërguari i Allahut dhe sahabët u mësojnë njerëzve lutjen dhe si ta përmendin Allahun	336
13. Mësimi i njohurive të fesë për miqtë bujtës në Medinën e ndritur	337
14. Sahabët luftonin, por as dijen nuk e linin pas dore	338
15. Sahabët merreshin me tregti, por as dijen nuk e braktisnin	339
16. I Dërguari i Allahut u kërkon besimtarëve që t'ua mësojnë edhe fëmijëve të tyre fenë	340
17. I Dërguari i Allahut u mëson sahabëve të mësojnë gjuhën e rivalëve të tyre	340
18. Në rast nevojë, kalifi detyrohej që t'i mbante njerëzit e ditur pranë vetes në qendër	341
19. Sahabët shpërndahen nëpër vende të ndryshme, që t'u mësojnë njerëzve Islamit	341
20. Udhëtimi për hir të dijes	343
21. Dijen ta marrësh nga njerëzit e duhur	344
22. Përgëzimi dhe nxitjet e sahabëve për ata që kërkojnë dijen	345
23. Rëndësia që i jepnin i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij kuvendeve të dijes	346

24. Respekti që duhet treguar në kuvendet e dijes	346
25. Etika e dijetarit dhe e nxënësit	347
26. Etika e sahabëve kur u përçonin dijen të tjerëve	348
27. Nxënia e Kur'anit, mësimi i tij të tjerëve dhe leximi para bashkësisë	353
28. Në kohën kur pagesa për mësimdhënien e Kur'anit nuk shihet me sy të mirë	355
29. Këshilla e sahabëve për ata që lexojnë Kur'an	356
30. Cilësitë që duhet të kenë ata që merren me hadithin	357
31. Sahabët, më shumë sesa dijes së thatë, i jepnin rëndësi veprimit	357
32. Të ndjekurit e Sunetit të çmuar, të ecurit në rrugën e të parëve të mirë dhe braktisja e stisjes së gjërave të paqena në fe	358
33. Sahabët ruhen nga ndjekja e pikëpamjeve të pabaza	359
34. Gjykimet e sahabëve	360
35. Shkallët e ndryshme të dijes te sahabë të ndryshëm	360
36. Dijetarët me frymëzime prej Allahut dhe dijetarët e këqij në syrin e sahabëve	361
37. Zhdukja dhe harresa e dijes	362
DHIKRI	365
1. I Dërguari i Allahut i nxit besimtarët që ta përmendin Allahun sa më shumë ...	365
2. Sahabët fisnikë i nxitin besimtarët ta përmendin sa më shumë Allahun	367
3. Bashkësitë dhe kuvendet e bashkëbisedimit ku përmendet emri i Allahut	368
4. Leximi rregullisht i Kur'anit Famëllartë	369
5. Virtyti i përmendjes vazhdimisht të fjalës së bukur “La ilahe il’lallah”	372
6. Disa përmendje të Allahut dhe virtytet e tyre	372
7. Lutja dhe përmendja e Allahut shkurt e me fjalë të thukëta	375
8. Lutjet që duhen thënë para se të flesh	376
9. Të përmendësh Allahun në kohët kur të gjithë bien në përhumbe	379
10. Përmendja e Allahut gjatë udhëtimit	379
11. Salavatet për të Dërguarin Fisnik	380
12. Një tjetër dimension i përmendjes së Allahut: kërkimi i faljes me pendesë	381
13. Përmbajtja e dhikrit dhe korniza e tij	382
14. Kur ka filluar bërja e tesbihut?	384
SAHABËT DHE LUTJA	385
1. Çfarë duhet kërkuar gjatë një lutjeje dhe çfarë jo? “Etika e duasë”	385
2. Lutja me zë të lartë në mes të bashkësisë dhe kur bashkësia i thotë “amin” lutjes sate	387
3. T’u kërkosh besimtarëve të mirë që të luten për ty	387

4. Lutja për mëkatarët që devijojnë nga rruga e drejtë	388
5. Si duhet nisur një lutje?	389
6. Lutja e umetit të të Dërguarit të Allahut	389
7. Lutjet e të Dërguarit të Allahut për katër kalifët	390
8. Lutja e Krenarisë së Gjithësisë për pjesëtarët e familjes së bekuar	391
9. Lutjet e të Dërguarit të Allahut për sahabët e tjerë	392
10. Lutjet që bënte i Dërguari i Allahut pas namazit	395
11. Lutja që bënte vazhdimisht i Dërguari i Allahut në mëngjes dhe në mbrëmje	396
12. Lutjet që bënte i Dërguari i Allahut para se të binte për të fjetur dhe kur zgjohej	396
13. Lutjet e të Dërguarit të Allahut kur hynte dhe dilte në xhami, në shtëpi, apo në mesin e njerëzve	398
14. Lutja që bënte i Dërguari i Allahut, sa herë që shihte hënën e parë, kur dëgjonte bubullimën, apo kur kishte erë dhe re	401
15. Lutje të të Dërguarit të Allahut, të cilat nuk lidheshin me një kohë a ndodhi të caktuar	402
16. Lutjet gjithëpërfshirëse të të Dërguarit të Allahut	403
17. Profeti ynë nuk kërkonte mbrojtje prej askujt tjetër veç Allahut	403
18. Lutja që duhet bërë nga frika e udhëheqësit të padrejtë të shtetit	407
19. Lutja që këshillohet të bëjë ai që ka hyrë në borxhe	408
20. Lutja që duhet bërë për t'u bërë hafiz i Kur'anit	409
21. Lutjet e sahabëve fisnikë	410

FJALIMET E PROFETIT TË PROFETËVE

DHE TË SAHABËVE TË TIJ	415
------------------------------	-----

1. Disa nga fjalët dhe fjalimet e mbajtura prej të Dërguarit të Allahut	415
2. Disa nga fjalët dhe fjalimet e Ebu Bekrit (r.a.)	426
3. Fjalimet e prijësit të besimtarëve, Omerit (r.a.)	428
4. Fjalimet e Osmanit (r.a.)	430
5. Disa ligjërime të Aliut (r.a.)	431
6. Një fjalim i mbajtur nga prijësi i besimtarëve, Hasani (r.a.)	432
7. Një fjalim i prijësit të besimtarëve, Muauije bin Ebi Sufjanit	433
8. Fjalimet e sahabëve të tjerë	433

KËSHILLA NGA I DËRGUARI I ALLAHUT DHE SAHABËT E TIJ

1. Këshilla nga i Dërguari i Allahut	437
2. Këshilla nga Omeri (r.a.)	438
3. Këshillat e Aliut (r.a.)	440

4. Këshillat e Muadh bin Xhebelit	441
5. Këshillat e Abdullah bin Mesudit	441
6. Këshilla nga Selman Farisiu	442
7. Këshilla nga Ebu'd-Derdaja	443
8. Disa këshilla nga Ebu Dherri (r.a.)	444
9. Këshilla e Hudhejfe bin El-Jemanit	445
10. Këshilla nga Ubej bin Ka'bi	446
11. Këshilla nga Zejd bin Thabiti	446
12. Këshilla nga Abdullah bin Abasi	447
13. Këshilla nga Hasani (r.a.)	448
14. Këshilla nga Ebu Umame El-Bahiliu	448

NDIHMESAT E MREKULLISHME

NDAJ RESULULLAHUT DHE SAHABËVE TË TIJ	451
1. Ndhimesa nga engjëjt	451
2. Xhibrili (a.s.) u tregon vendin atyre që tallen me të Dërguarin e Allahut	453
3. Sahabët arrijnë të shohin engjëjt	453
4. Zbritja e engjëjve për sahabët që lexonin Kur'an	455
5. Engjëjt lajnë Handhalen e rënë dëshmor	456
6. Në xhenazën e Sa'd bin Muadh marrin pjesë edhe engjëjt	456
7. Pengimi i Surakas, gjatë mërgimit	457
8. Mundja e armiqve me dhe e gurë	458
9. Shfaqja e armiqve si më të paktë në numër në syrin e myslimanëve	458
10. Ushtri të padukshme për myslimanët dhe ndihmesa nëpërmjet erës	459
11. Fundi i atyre që mallkoheshin nga ndonjëri prej sahabëve	460
12. Sytë e verbër që fillojnë të shohin	460
13. Kur Omeri (r.a.) i jep urdhër Sarijes nga hutbeja	461
14. Sahabët dëgjojnë zëra që vijnë nga e fshehta	462
15. Xhindet lajmërojnë ardhjen e Profetit tonë të nderuar	462
16. Xhindet dhe dajtë u binden besimtarëve	463
17. Sahabët dëgjojnë zërat e krijesave të ngurta (jofrymorë)	464
18. Sahabët dëgjojnë zërat e banorëve të varrit	466
19. Me lutjen e sahabëve ngjallen të vdekur	468
20. Gjendje të mrekullshme të sahabët e rënë dëshmorë	469
21. Përhapja nga varret e një arome si ajo e miskut	470
22. Ruajtja e paprishur, me urdhrin e Allahut, e trupave të sahabëve të rënë dëshmorë	470
23. Kafshët u bindeshin të Dërguarit të Allahut dhe sahabëve të tij	471

24. Me urdhrin e Allahut, edhe detet e lumenjtë u shërbejnë sahabëve	472
25. Edhe zjarri u bindet sahabëve	475
26. Ndrichi i rrugës së sahabëve në një mënyrë krejt të jashtëzakonshme	476
27. Retë bëjnë hije për sahabët	476
28. Lutet Profeti ynë dhe sahabët e tij të zgjedhur dhe në nder të tyre bie shi	477
29. Bekimi i ujit	478
30. Bekimi i ushqimeve gjatë luftërave	480
31. Begatia e ushqimeve që ishin për t'u ngrënë në kohë të zakonshme	481
32. Begatia te drithërat dhe te frutat	482
33. Begatia e shfaqur në vaj dhe qumësht	483
34. Të mira materiale që vijnë në formë mrekullie	484
35. Sahabëve u jepet të pinë ujë teksa janë në gjumë	487
36. Sahabët dhe begatia e të dhënit në rrugën e Allahut	488
37. Bollëku i ardhur me një lutje të të Dërguarit të Allahut	489
38. Të sëmuret gjejnë shërim me lutjen e Profetit tonë të nderuar	490
39. Mosprekja e sahabëve nga helmi, një mirësi e Allahut	490
40. Me lutjen e Profetit të Allahut nuk ndihen as vapa e as i ftohti	491
41. Lutja e Profetit bën të mundur që myslimanët të mos e ndiejnë urinë	492
42. Begatia e lutjes së të Dërguarit të Allahut pakëson shenjat e pleqërisë	492
43. Një nga sahabët shpëton nga izolimi ku mbahej peng duke përdorur lutjen që i kishte mësuar i Dërguari i Allahut	493
44. Ngjarje të hidhura që u ndodhin atyre që nuk dëgjojnë fjalën e të Dërguarit të Allahut	494
45. Xhindet qajnë për sahabët e rënë dëshmorë	495
46. Shfaqja në ëndrra e disa sahabëve tashmë të vdekur	495
 ARSYET PSE SAHABËT ISHIN TË DENJË	
PËR NDIHMËN E ALLAHUT	499
1. Ata nuk i trembeshin asnjë vështirësie	499
2. Sahabët u binden urdhrave të Allahut në mënyrë të pakushtëzuar	500
3. Mbështetja e plotë e sahabëve tek Allahu dhe përgënjeshtrimi i atyre që ishin në rrugën e devijuar	501
4. Sahabët, nderin e vërtetë, e kërkonin tek të qenët ndjekës të fesë së Allahut ...	502
5. Qasja me drejtësi ndaj pasuesve të feve të tjera, edhe kur sahabët ishin më të fuqishëm	502
6. Sahabët fisnikë nxjerrin mësim nga fatkeqësitë	504
7. Singëriteti i sahabëve dhe ngarendja e tyre drejt fitimit të jetës së përtejme	504
8. Sahabët i kërkonin ndihmë Allahut vetëm duke kënduar Kur'an dhe duke iu lutur Atij	505

9. Sahabët garojnë me njëri-tjetrin se kush do të bëjë më shumë të mira	506
10. Sahabët nuk i jepnin rëndësi dukjes dhe stolive të kësaj bote	506
11. Sahabëve nuk u bënte shumë përshtypje, që armiqtë ishin më të shumtë në numër dhe më të fuqishëm	507
12. Çfarë thoshin armiqtë e tyre për sahabët?	508
BURIMET	511
PËRMBAJTJA	516

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Kandehleui ed-Dihleui, Muhamed Jusuf ibn
Muhamed Iljas

Jeta e sahabëve / M. Jusuf Kandehleui ;
përkth. Silvester Manaj ;

red. Andrin Rasha, Mehmet Disha, Detin Kotrri.

Tiranë : Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2020

Vëllimi 2: 528 f. ; 14.8x21 cm.

Tit. origj.: Hajatu's-sahabe

ISBN 978-9928-194-86-2

1. Feja islame 2. Myslimanë 3. Histori